HARKU I TRIUMFIT NË DITË TË VËSHTIRA

1.

Harku i Triumfit ndodhet në Paris, në fillim të bulevardit *Shanz-Elize* që konsiderohet nga më të bukurit në botë. I ngritur si homazh për fitoret e Napoleonit, ai është kthyer prej kohësh në një prej simboleve kryesore të Parisit. Dhe krijimi i simboleve ka përherë arsye. Ky monument masiv e hijerëndë, i ndërtuar sipas traditës romake, për ceremoni e parakalime festive, ka parë shpesh herë ditë të vështira, madje të përzishme. Dhe ndoshta pikërisht për këtë, ndoshta pikërisht për faktin se ai ka qëndruar atje në ditë të mira e të këqija për Francën, dëshmitar e gardian i historisë, triumfues e jotriumfues, i qeshur sa edhe i zymtë, krenar sa edhe qortues, ai e ka fituar dalëngadalë hijen dhe peshën e simbolit.

Dihet se për Parisin është shkruar e vazhdon të shkruhet shumë. Asnjë qytet tjetër nuk ka një urbanistikë të dyzuar siç e ka ky qytet në letërsi. E megjithatë, ndonëse shumë udhëtarë që e vizitojnë për të parën herë, kanë dëshirë të bëjnë pohimin klishe: para se të vija në Paris, e njihja atë nga librat – për atë që e njohu disi qytetin, ky pohim tingëllon fare naiv.

Asnjë qytet nuk mund të njihet plotësisht nga librat, e aq më pak një qytet si Parisi. Si gjithë qytetet e mëdha e me themele të ngulura thellë në histori, ai është i komplikuar e i shumëfytyrshëm si vetë jeta. Shtoji kësaj edhe optikën e ndryshme të secilit shkrimtar apo përshkrues, për të kuptuar se sa larg është Parisi balzakian nga ai prustian ose Parisi i Ficxheraldit nga ai i Hemingueit e kështu me radhë. Parisi i shkrimtarit gjerman Erih Maria Remark në romanin e tij *Harku i Triumfit* është një nga më dramatikët në letërsi. Në një

3rj0n1xxx

rajon tepër të njohur për të gjithë të huajt që vijnë në këtë qytet, në zonën rreth Sheshit Etual – fillimi i avënysë Vagram, fillimi i *Shanz-Elizesë*, restoranti i njohur Fuke, avënyja Zhorzh V, Ura e Almës – në një zonë pra të ngushtë rrotull, Harkut të Triumfit, vërtiten personazhet e kësaj historie të rëndë e të pikëllueshme.

Jemi ende në fund të viteve '30 dhe në mjaft libra të tjerë pikërisht kjo zonë e Parisit është përshkruar plot dritë e ëmbëlsi, me dyert e kafeneve e të restoranteve prej nga dalin gra të bukura, me heronj e heroina që jetojnë në luks dhe që, bashkë me parfumin e shtrenjtë, shpërndajnë të qeshurat e tyre të lodhura, të qeshurat e fundme të një epoke që i është afruar pragut të tragjedisë.

Erih Maria Remarku ngre një tjetër perde dhe na zbulon një tjetër Paris. Ai është i zymtë e i trishtueshëm, sepse e tillë është optika e këtij shkrimtari antifashist të dëbuar nga vendi i vet. Ai dëshiron të dëshmojë gjithashtu për epokën, do të shkruajë për Harkun e Triumfit, por dëshmia e tij do të jetë jo e gëzueshme dhe Harku i Triumfit i tij do të shëmbëllejë herë pas here me Portën e Hadit – sepse së shpejti nën këmbët e tij do të kalojnë trupat naziste gjermane, do të kalojë vetë Hitleri.

2.

Si shumë shkrimtarë seriozë, Erih Maria Remarku ka krijuar në veprën e tij një botë të vetën. Kjo botë ka shtrirjen e saj në kohë dhe në hapësirë, pra ka historinë dhe gjeografinë e saj. E gjithë drama për të cilën dëshmon Remarku, kap një thellësi kohore jo më shumë se dyzetvjeçare, kurse skena në të cilën ajo shpaloset është kontinenti evropian, madje jo krejt, por pjesa qendrore e tij, në radhë të parë Gjermania dhe Franca, e më pak periferitë.

Këto përmasa kanë rëndësi për peshën e një shkrimtari, ndonëse ato nuk janë vendimtare për gjithçka. Bashkëkohësi i Remarkut, Ernest Heminguei, ndërsa ka pothuajse të njëjtën shtrirje kohore, ka ndërkaq një gjeografi shumë më të gjerë, që kap tre kontinente, Amerikë, Afrikë, Evropë (madje në këtë të fundit personazhet e tij lëvizin jo vetëm në qendër, por edhe në tre gadishujt, Pirenejtë, Apeninet dhe Ballkanet), pra ndonëse Heminguei ka një shtrirje më të gjerë, nuk është kjo që e bën shkrimtar më të madh se Remarku, por tjetër gjë. Le të kujtojmë me këtë rast Balzakun, pjesa kryesore e veprës të së cilit shtjellohet në një kohë e në një skenë shumë më të ngushtë, gjë që s'i prish asnjë punë madhështisë së tij. Ndërkaq

3rj0n1xx

Danteja ka një thellësi kohore mijëvjeçare dhe një gjeografi totale (nëntokësore, qiellore), që s'mund të mos konsiderohen si pjesë e qenësishme e vlerave të tij.

Remarku, megjithëse kritika botërore nuk ia dha cilësimin "shkrimtar i madh", është quajtur gati njëzëri prej saj si një nga shkrimtarët e shquar e seriozë të kohës, si një nga ata, pa të cilët tabloja e trazimeve të kohës do të mbetej e mangët.

Me të vërtetë, me veprën e tij ai la një dëshmi të zymtë, të ndershme, të besueshme dhe emocionuese për një nga dukuritë më të trishtueshme e të egra të shekullit XX, fashizmin. I gjithë universi i këtij shkrimtari organizohet nga ky motiv, madje romanet e tij mund të kishin pasur fare mirë një titull të përgjithshëm të përbashkët: "Kronika e një murtaje".

Prologun e tragjedisë ai e ka dhënë shumë bukur e qartë me romanin e tij të parë *Asgjë të re nga Fronti i Perëndimit*, i cili brenda një kohe të shkurtër u bë thesar i tërë njerëzimit. Librat e tjerë të tij janë pasqyrime të fazave të ndryshme të hovzimeve të murtajës naziste, gjer në zhdukjen e saj.

Në këtë univers *Harku i Triumfit* zë një vend të veçantë. Pa qenë kronologjikisht kulmi ose mbyllja e historisë së nazizmit, ai është libri më i bukur e më i plotë i shkrimtarit, qendra e gjithë veprës së tij.

3.

Harku i Triumfit është një roman i fuqishëm, i bukur, dramatik. Ai është shkruar me nerv, me ngjyra të forta, dhe faqet e tij pasionante, të përkthyera me mjeshtëri të lartë nga Robert Shvarci, e rrëmbejnë lexuesin në universin që shpalosin.

Në këtë vepër jepet tërë tragjedia e një pjese të Evropës, veçanërisht e emigracionit antifashist në prag të luftës. Por kjo dramë është inkuadruar në dramën e një bote të tërë që lëviz sipas një mekanizmi të egër, të zymtë e, në pamje të parë, të pashpresë. Megjithatë, me gjithë klimën e ashpër, Remarku i ka gjithmonë filizat e së ardhmes. Prapa tragjedisë personale vegon një dritëz, jo për ta, por për të tjerët që vijnë pas.

Parisi i fundit të viteve '30 ishte qyteti dramatik, ku hijet e krimit të ardhshëm përvijoheshin turbull mbi fatet e njerëzve. Në shtetin fqinj, në Gjermani, nazizmi kishte triumfuar. Evropa e tërë, e në radhë të parë Franca, po kërcënohej prej tij; por borgjezia franceze, e verbër dhe e shurdhër përpara kanosjes, në mënyrë mendjelehtë e

3rj0n1xx

kriminale po i hapte rrugën fatkeqësisë. E zhytur në dëfrime e korrupsion, ajo nuk vë re se festat e saj kanë një ngjyrim të përzishëm. Kjo mospërfillje fatale do të lahej me gjakun e miliona njerëzve, kjo klimë e përgjithshme ndjellazezë ka kushtëzuar koloritin e romanit të Remarkut. Por Remarku nuk është pesimist. Ai është i dëshpëruar, i revoltuar, i nervozuar me atë që po ndodh, por as dëshpërimi, as nervozizmi e aq më pak revoltimi nuk janë kurrë pesimizëm. Përkundrazi, ato dëshmojnë për përgjegjësinë e madhe të shkrimtarit përballë kohës dhe njerëzimit.

Remarku denoncon në këtë vepër me forcë indiferencën e shtetëve evropiane dhe të shoqërisë evropiane në përgjithësi përballë nazizmit. Pesimizëm do të kishte, në qoftë se heroi kryesor i veprës, mjeku Ravik, do të pajtohej me rënien, do të hiqte dorë nga lufta dhe armikun e tij të madh, nazistin oficer të Gestapos, Haken, do ta falte sipas mësimeve kristiane apo çifute. Mirëpo ai nuk e bën këtë. E vret nazistin në mënyrën më brutale, pa asnjë fije pendimi, dhe me këtë tregon se i përket një race tjetër personazhezh, në krahasim me ata që ofron një pjesë e letërsisë pacifiste sot në perëndim.

Drama e emigracionit antifashist dhe jo më pak e atij çifut, pasqyrohet më konkretisht nëpërmjet lidhjeve dhe historisë së dhimbshme midis Ravikut dhe Xhoanë Madusë. Xhoana, pjellë e një shoqërie që vizatohet si në prag të një katastrofe, kurse Raviku, mjeku emigrant antinazist, përpara të cilit ende nuk është zhvilluar tërë tragjedia janë dy njerëz të pashpresë. Nuk duhet harruar se jemi në vitin 1938, në prag të pushtimit të Francës nga Hitleri.

Në roman pasqyrohen shumë qartë pozitat çnjerëzore të administratës borgjeze, të kolaboracionistëve të ardhshëm ndaj emigracionit antifashist. Bastisjet, egërsia e policisë, sjellja e burokratëve ndaj emigrantëve, lajmërojnë sinjalet e para të asaj që do të ndodhë më vonë: kapitullimin e Francës përpara Hitlerit dhe bashkëpunimin e reaksionit francez me nazistët, futjen e antifashistëve ndër kampe përqendrimi.

Ismail Kadare

Tiranë, dhjetor 1988

Erjonixx

1

Gruaja po i afrohej Ravikut duke i rënë rrugës tërthorazi. Ajo ecte me nxit, por çuditërisht e shushatur. Raviku e vuri re vetëm kur iu gjend fare pranë. Ai pa një fytyrë të zbehtë me mollëza të kërcyera dhe me ca sy tepër të larguar anash. Fytyra ishte e ngrirë si maskë; dukej sikur qe rrënuar, dhe sytë, nën dritën e fanarëve, kishin një shprehje të tillë zbrazëtie të qelqtë, saqë ai u bë kureshtar...

Gruaja i kaloi aq pranë, sa mend e çiku me trup. Ai zgjati dorën dhe e rroku për krahu. Një çast më vonë asaj iu morën këmbët dhe do të qe rrëzuar, po të mos e kishte mbajtur ai.

Raviku ia shtrëngoi krahun.

– Për ku jeni nisur? – e pyeti pas pak.

Gruaja i hodhi një shikim të shastisur.

– Lëshomëni, – pëshpëriti ajo.

Raviku nuk i dha përgjigje, por vazhdoi ta shtrëngonte për krahu.

– Lëshomëni! Ç'do të thotë kjo? – Gruaja mezi lëvizte buzët.

Raviku pati përshtypjen sikur ajo s'po e shihte fare. Vështronte mes për mes tij, diku, në natën e zbrazët. Për të ai ishte vetëm një diçka që e pengonte, dhe kundër kësaj diçkaje ajo fliste:

– Lëshomëni!

Ai e pati kuptuar menjëherë se nuk kishte të bënte me një prostitutë dhe as me ndonjë femër të pirë. Tani s'po ia shtrëngonte më krahun aq fort. Po të donte, ajo mund të qe shkëputur fare lehtë prej tij; por këtë ajo as që e vuri re. Raviku priti një copë herë.

– Ku po shkoni kështu, në këtë orë të natës, vetëm nëpër Paris? – i foli pastaj edhe një herë qetë e qetë dhe ia lëshoi krahun.

Erjonixx

Gruaja heshti, por nuk lëvizi nga vendi. Dukej sikur tani, që u ndal më në fund, nuk mund të hidhte asnjë hap më tej.

Raviku u mbështet pas parmakëve të urës. Ai ndjeu nën gishtërinj gurin e lagësht dhe poroz.

– Mos ishit nisur për atje? – Ai bëri me kokë një lëvizje nga pas, poshtë, ku ujët e Senës, me vezullim të murrmë, rrëshqiste pa pushim drejt hijeve që lëshonin harqet e *Pon dë l'Alma.*

Gruaja nuk iu përgjigj:

– Është shumë shpejt, – tha Raviku. – Shumë shpejt dhe shumë ftohtë tani, në nëntor.

Ai nxori një paketë cigaresh dhe zuri të rrëmonte nëpër xhepa duke kërkuar shkrepëset. Kur i gjeti, vuri re se në kartonin e ngushtë i kishin mbetur vetëm dy fije; u përkul me kujdes për ta mbrojtur me duar flakën prej erës së lehtë, që frynte nga lumi.

– Më jepni edhe mua një cigare, – i tha gruaja me zë të mekur.

Raviku drejtoi trupin dhe i tregoi paketën.

– Janë algjeriane. Duhan i zi i Legjionit të huaj.[1] Është shumë i fortë për ju, por cigare të tjera nuk më ndodhen.

Gruaja tundi kokën dhe mori një cigare. Raviku ia zgjati shkrepësen e ndezur. Ajo tymoste me rrëmbim, duke e thithur cigaren thellë. Raviku e flaku shkrepësen përtej parmakut. Ajo ra në errësirë si një meteor i vogël dhe u shua vetëm kur çiku sipërfaqen e ujit.

Një taksi iu afrua me ngadalë urës. Shoferi ndaloi. Hodhi sytë nga ata dhe priti disa çaste; pastaj i dha gaz makinës dhe vazhdoi rrugën, duke iu ngjitur avënysë[2] *Zhorzh V.*, që shkëlqente e zezë nga lagështia.

Raviku ndjeu përmjëherësh që ishte i lodhur. Tërë ditën kishte punuar shumë dhe, kur ra, nuk mundi të bënte asnjë sy gjumë. Prandaj kishte dalë përsëri për të pirë diçka. Por tani, papritur e papandehur, në atë lagështirën e ftohtë të natës së vonë, lodhja iu lëshua mbi kokë si një thes.

I hodhi një shikim gruas. E pse e kishte ndalur, vallë? Ajo kishte një hall, kjo dukej qartë. Por ç'i duhej atij ajo punë? Sa gra që kishin ndonjë hall kishte parë ai, e sidomos natën, sidomos në Paris! Por tani kjo nuk i bënte më përshtypje, tani ai kishte vetëm një dëshirë: të flinte disa orë.

---

1. *Légion étrangère* (Legjioni i huaj): ushtri mercenare, e krijuar për herë të parë më 1835 në Algjeri dhe e përbërë prej shtetasve të huaj, që hynin në shërbim të Francës. *(Shënimet janë të përkthyesit).*

2. *Avenue*: rrugë e gjerë me pemë, shëtitore.

Erjonixx

– Shkoni në shtëpi, – i tha. – Ç'kërkoni akoma rrugëve në këtë orë? Përveç andrallave, nuk do të fitoni gjë tjetër.

Ai ngriti jakën e palltos dhe u mat të largohej. Gruaja e vështroi, sikur s'po e kuptonte.

– Në shtëpi? – belbëzoi ajo.

Raviku ngriti supet.

– Po, në shtëpi, në banesën tuaj, në hotel, quajeni si të doni. Kudo qoftë. Nuk besoj se keni dëshirë t'ju zërë policia!

– Në hotel! O Zot! – tha gruaja.

Raviku qëndroi në vend. Ja, përsëri një njeri që nuk dinte ku të shkonte, mendoi ai. Këtë gjë mund ta kishte kuptuar që në fillim. Natën kësi njerëzish nuk dinin ku të shkonin, kurse të nesërmen në mëngjes zhdukeshin përpara se të të dilte gjumi. Atëherë dinin ku të shkonin. Ky ishte dëshpërimi i vjetër dhe i rëndomtë i errësirës, që vinte dhe ikte bashkë me të. Ai e flaku cigaren tej. Sikur nuk e njihte edhe vetë këtë gjendje që i kishte ardhur në majë të hundës!

– Ejani, të pimë një gotë bashkë, – i tha.

Kjo ishte gjëja më e thjeshtë. Pastaj ai mund të paguante dhe të ikte, kurse ajo le të bënte si të bënte.

Gruaja bëri një lëvizje të pasigurt dhe u pengua. Raviku e zuri për krahu.

– Jeni e lodhur? – e pyeti.

– Nuk e di. Më duket se po.

– Aq e lodhur, sa nuk keni as gjumë?

Ajo pohoi me kokë.

– Ndodh nganjëherë. Ejani, se ju mbaj unë.

Ata morën të përpjetën e avënysë *Marso*. Raviku e ndjeu se si mbështetej gruaja pas tij. Ajo mbështetej në një mënyrë të tillë, sikur do të rrëzohej nga çasti në çast, po të mos mbahej fort diku.

Kapërcyen avënynë *Pjetri I i Serbisë*. Pas kryqëzimit të rrugës *Shajo*, pamja u zgjerua dhe larg, si i varur në errësirë, u shfaq nën qiellin e zymtë masivi i Harkut të Triumfit.

Raviku zgjati dorën drejt një hyrjeje të ngushtë e të ndriçuar, që të shpinte në një bodrum.

– Këtu! Me siguri do të gjejmë diçka.

*

* *

Ishte një pijetore shoferësh. Në atë orë po rrinin aty disa shoferë

Erjonixx

taksish dhe disa prostituta. Shoferët luanin bixhoz. Prostitutat pinin vermut. Ato e hetuan gruan me një shikim të shpejtë. Pastaj i kthyen përsëri kokat me mospërfillje. Më e vjetra gogësiu, duke e hapur gojën sa një çorap; të tjerat filluan të pispilloseshin e të pasqyliseshin me lëvizje të ngathta. Në anën e pasme të lokalit, një *pikkolo*[1] që e kishte surratin si mi i pikëlluar, hodhi tallash mbi dysheme dhe nisi t'i binte me fshesë. Raviku zuri vend bashkë me gruan te një tryezë pranë hyrjes së lokalit. Kjo ishte më e volitshme, sepse, më vonë do ta kishte për kollaj të largohej më shpejt. Pallton nuk e hoqi.

– Ç'dëshironi të pini? – e pyeti gruan.

– Nuk e di. Çfarëdo që të jetë.

– Dy *Kalvados*[2], – i tha Raviku kamerierit, që mbante një jelek dhe që i kishte përveshur mëngët e këmishës gjer lart. – Edhe një paketë cigare *Çestërfild*.

– Nuk kemi, – ia bëri kamerieri. – Mbajmë vetëm franceze.

– Mirë. Atëherë më sillni një paketë *Laurens* të gjelbër.

– As të gjelbër nuk kemi. Vetëm blu.

Raviku soditi llërën e kamerierit, që kishte tatuazhin e një gruaje lakuriqe duke ecur përmbi re. Kamerieri e pikasi shikimin e tij, mblodhi dorën grusht dhe fryu muskujt e krahut. Gruaja lakuriqe filloi të spërdridhte belin në mënyrë të pahijshme.

– Atëherë një blu, – tha Raviku.

Kamerieri nxori dhëmbët:

– Mbase më ka mbetur edhe ndonjë e gjelbër, – tha dhe u largua duke hequr këmbët zvarrë.

Raviku e ndoqi me sy.

– Me pantofla të kuqe, – ia bëri pastaj. – Dhe me tatuazh kërcimtareje, nga ato që tundin barkun! Duhet të ketë shërbyer në marinën turke.

Gruaja vuri duart mbi tryezë. Këtë e bëri në një mënyrë të tillë, sikur nuk kishte ndër mend t'i ngrinte kurrë më që andej. Duart ishin të mbajtura mirë, por kjo nuk tregonte kushedi se çë. Ato duar mund t'i quaje edhe jo fort të mbajtura mirë. Raviku vuri re se thoi i gishtit të mesit të dorës së djathtë ishte thyer dhe, me sa dukej, qe këputur, por jo lëmuar me limë. Përveç kësaj, në disa vende i ishte hequr edhe manikyri.

Kamerieri solli gotat dhe një paketë cigare.

---

1. *Piccolo*: emër që përdoret për djemtë e vegjël, që mësojnë zanatin e kamerierit.
2. *Calvados*: një lloj pijeje që bëhet nga lëngu i mollës; emri rrjedh nga ajo krahinë e Francës ku prodhohet.

Erjonixx

– Urdhëroni. Ju gjeta edhe një *Laurens* të gjelbër.

– E mora me mend. Mos keni shërbyer në marinë?

– Jo. Në cirk.

– Aq më mirë! – Raviku ia zgjati gruas njërën gotë. – Pijeni. Është gjëja më e mirë që mund të gjesh në këtë kohë. Apo doni një kafe?

– Jo.

– Pijeni me fund.

Gruaja bëri një shenjë pohimi me kokë dhe e zbrazi gotën. Raviku e shikoi me vëmendje. Kishte një fytyrë të shuar, të zbehtë, pothuajse pa shprehje. Buzët ishin të plota, por pa ngjyrë; të gjitha përvijimet dukeshin si të fshira, dhe vetëm flokët i kishte shumë të bukur – blondë natyralë me një shkëlqim të fortë. Mbante një beretë baske, dhe poshtë pardesysë i dukej kostumi blu. Kostumi dukej që kishte dalë nga dora e një rrobaqepësi të mirë, por guri i blertë i unazës që mbante në njërin gisht, ishte tepër i madh për të mos qenë fals.

– Doni edhe një tjetër? – pyeti Raviku.

Ajo pohoi.

Ai i bëri shenjë kamerierit.

– Edhe dy *Kalvados*. Por në gota më të mëdha.

– Në gota më të mëdha? Domethënë, më shumë?

– Po.

– Pra, dy *Kalvados* dopio.

– I ratë më të.

Raviku vendosi ta pinte shpejt gotën e vet dhe pastaj të largohej. Kishte filluar të mërzitej dhe ndiente një kapitje të madhe. Në përgjithësi nuk e humbiste durimin në këso rastesh; kishte pas shpine dyzet vjet jetë plot variacione. Por situata të tilla, si kjo e sotmja, njihte me tepricë. Kishte disa vjet që po jetonte në Paris dhe natën s'para bënte shumë gjumë; kështu që i kishin parë sytë mjaft nga kjo botë.

Kamerieri solli gotat. Raviku e mori rakinë e mollës që kishte një kundërmim të fortë dhe aromatik dhe e vendosi me kujdes përpara gruas.

– Pijeni edhe këtë. Nuk do t'ju ndihmojë shumë, por do t'ju ngrohë. Dhe, çfarëdo që të keni, mos i jepni aq shumë rëndësi. Pak gjëra e ruajnë rëndësinë për shumë kohë.

Gruaja e vështroi, por nuk piu.

– Kështu është, – tha Raviku. – Dhe veçanërisht natën. Nata i zmadhon gjërat.

Erjonixx

Gruaja vazhdoi ta vështronte.

– Nuk është nevoja të më ngushëlloni, – i tha pastaj.

– Aq më mirë.

Raviku kërkoi me sy kamerierin. Ai e njihte këtë tip femre. Me siguri do të jetë ruse, tha me vete. Ato e kishin për zakon që, sapo zinin vend diku dhe duke qenë akoma të qullura, ia fillonin përnjëherësh të të jepnin hazërxhevape.

– Mos jeni ruse? – e pyeti.

– Jo.

Raviku pagoi dhe u ngrit që të përshëndetej me të. Po atë çast u ngrit edhe gruaja. Ajo e bëri këtë heshturazi dhe krejt natyrshëm. Raviku i hodhi një vështrim mëdyshas. Epo mirë, tha me vete; mund të ndahem prej saj edhe jashtë.

Kishte filluar të binte shi. Raviku u ndal te dera.

– Nga e keni rrugën? – Atij i qe mbushur mendja top të largohej në drejtim të kundërt.

– Nuk e di. Do të marr ndonjë rrugë...

– Po ku banoni, xhanëm?!

Gruaja bëri një lëvizje të rrëmbyer.

– Atje nuk mund të shkoj! Jo! Nuk mundem! Atje jo!

Sytë i morën befas një shprehje tmerri. Do të jetë grindur, mendoi Raviku. Ka pasur ndonjë shamatë në shtëpi dhe ka marrë rrugët. Gjer nesër në drekë do të pendohet dhe do të kthehet përsëri.

– Nuk njihkeni njeri, tek i cili mund të shkonit? Ndonjë shoqe? Mund t'i telefononit nga pijetorja.

– Jo. Nuk njoh njeri.

– Po diku duhet të shkoni! A keni të holla për të marrë një dhomë?

– Kam.

– Atëherë shkoni në ndonjë hotel. Këtu, ndër rrugët anësore, keni hotele sa të doni.

Gruaja nuk i dha përgjigje.

– Diku duhet të shkoni! – përsëriti Raviku me padurim. – Nuk mund të rrini këtu në rrugë në mes të shiut!

Gruaja u mbështoll me pardesy.

– Keni të drejtë, – tha, sikur më në fund iu mbush mendja të merrte një vendim. – Keni plotësisht të drejtë. Falemnderit. Mos u merrni më me mua. Do të gjej ndonjë vend. Falemnderit. – Ajo mblodhi me njërën dorë dy çipat e jakës. – Falemnderit për gjithçka.

Gruaja i hodhi Ravikut edhe një shikim të brengosur nga poshtë-lart

Erjonixx

dhe u përpoq të vinte buzën në gaz; por buzëqeshja i dështoi. Pastaj u largua përmes shiut dhe mjegullës, pa mënuar dhe me hap të lehtë.

Raviku mbeti për një çast pa luajtur vendit.

– Ta marrë e mira, ta marrë! – shkrofëtiu i habitur dhe i hutuar. Ai nuk e mori vesh si i ndodhi dhe çfarë i ndodhi... Ndoshta buzëqeshja e trishtuar, apo vështrimi i saj, apo rruga e shkretë, apo nata... Ai dinte vetëm se nuk mund ta linte atë grua të ikte ashtu e vetmuar, atë grua, e cila tani atje, në mes të mjegullës iu duk befas si një fëmijë që kishte humbur rrugën.

Ai e ndoqi pas.

– Ejani me mua, – i tha pak si me të ashpër. – Do të gjendet edhe diçka për ju.

Ata arritën te *Plas d'Etuali*[1]. Sheshi shtrihej përpara tyre i madhërishëm dhe i pafund nën vesën e murrme të shiut. Mjegulla ishte dendësuar dhe rrugët që degëzoheshin rretheqark, nuk dalloheshin më. Ekzistonte vetëm sheshi i gjerë me fanarët e tij, që dukeshin si hënëza të turbullta e të shpërndara, dhe me qemerin e gurtë të Harkut, i cili humbiste madhështor lart, në pafundësinë e mjegullës, a thua se i bëhej mbështetje qiellit të trishtuar dhe mbronte nën vete flakëzën e vetmuar e të zbehtë mbi Varrin e Ushtarit të Panjohur, që dukej si i fundmi varr i njerëzimit aty, në mes të natës dhe të braktisjes.

Ata i ranë sheshit mes për mes. Raviku ecte me ngut. Ishte tepër i lodhur, sa të rrinte tani e të vriste mendjen për ndonjë gjë. Pranë vetes dëgjonte çapitjen e lehtë e të çrregullt të gruas, e cila e ndiqte heshturazi, kokulur, me duart të groposura në xhepat e pardesysë... një dritëz e vogël dhe e huaj jete... Dhe përnjëherësh, në vetminë e vonët të sheshit, megjithëse ai nuk dinte asgjë për të, ajo, pikërisht për këtë, iu duk çuditërisht e afërt dhe sikur i përkiste prej kohësh. Ajo qe e huaj për të, po ashtu siç ndihej edhe ai kudo i huaj - dhe kjo, në një mënyrë të pashpjegueshme, sikur i afronte më shumë sesa mijëra fjalë dhe sesa forca zvarritëse e zakonit dhe e kohës.

* * *

Raviku banonte në një hotel të vogël në njërën nga rrugët anësore të *avënysë Vagram*, mbas *Plas dë Ternës*. Ishte një rrangallë mjaft

1. *Place d'Etoile*: Sheshi i Yllit në Paris, ku ngrihet Harku i Triumfit dhe nga i cili, në formë ylli, shpërndahen në thellësi të qytetit dymbëdhjetë bulevardet kryesore.

Erjonixx

e vjetruar, e cila kishte vetëm një gjë të re: tabelën përmbi hyrje, me mbishkrimin: *Hotel Internacional*.

Ai i ra ziles

– Keni ndonjë dhomë të lirë? – e pyeti djalin që ia hapi portën.

Djali ia nguli sytë e mbufatur nga gjumi.

– Portieri nuk është këtu, – belbëzoi më në fund.

– Këtë e mora vesh. Të pyeta në ka ndonjë dhomë të lirë.

Djali ngriti supet i hutuar. Ai po e shihte që Raviku kishte sjellë me vete një grua, por s'po e kuptonte dot pse i dashkej edhe një dhomë tjetër. Me sa dinte e me sa kishte parë ai, gratë nuk silleshin me vete për t'i futur në një dhomë tjetër.

– Zonja po fle. Ajo do të më përzërë nga puna, po ta zgjoj në këtë orë, – tha ai dhe filloi të kruante njërën këmbë pas tjetrës.

– Mirë. Atëherë do të mundohemi ta rregullojmë punën vetë.

Raviku i dha një bakshish djalit, mori çelësin dhe i priu gruas nëpër shkallë. Përpara se të hapte dhomën e vet, i hodhi një sy derës fqinje. Jashtë saj nuk ishin nxjerrë këpucë. Ai trokiti dy herë. Askush nuk u përgjigj. E uli me kujdes dorezën. Dera ishte e kyçur.

– Mbrëmë nuk kishte njeri në këtë kotec, – murmuriti. – Po e provojmë një herë nga ana tjetër. Me sa duket, e zonja e hotelit e ka kyçur nga frika se mos i arratisen tartabiqet.

Ai hapi dhomën e vet.

– Uluni një minutë, – dhe i tregoi një divan të shtruar me lëkurë kali qimekuq. – Nuk do të vonohem.

Hapi një derë që bënte edhe punën e dritares dhe që të nxirrte në një ballkon të ngushtë me parmakë hekuri; kapërceu rrjetën që e ndante nga ballkoni ngjitur dhe provoi derën e dhomës tjetër. Edhe ajo ishte e mbyllur. U kthye përsëri si një njeri që i nënshtrohet fatit.

– Nuk kam se ç'të bëj. Këtu nuk po mund t'ju gjej dhomë.

Gruaja qe ulur në cep të divanit.

– A mund të rri një çast këtu ku jam?

Raviku e vështroi me vërejtje. Asaj i qe prishur fytyra nga lodhja. Dukej sikur nuk ishte e zonja të ngrihej më.

– Mund të qëndroni këtu, – tha ai.

– Vetëm një çast...

– Mund të flini këtu. Kjo është zgjidhja më e thjeshtë.

Gruaja dukej sikur nuk po e dëgjonte fare. Ajo lëvizi kokën ngadalë, pothuajse në mënyrë automatike.

– Duhej të më kishit lënë në rrugë. Tani... Më duket se tani s'po mundem më...

Erjonixx

– Kështu më duket edhe mua. Mund të rrini të flini këtu. Kjo do të ishte puna më me mend. Nesër shohim e bëjmë.

Gruaja e vështroi.

– Nuk dua t'ju...

– O zot! – tha Raviku. – Nuk më bezdisni aspak. Nuk është hera e parë që dikush e kalon natën këtu, sepse nuk di nga t'ia mbajë. Ky është një hotel refugjatësh. Dhe të tilla raste ka pothuajse përditë. Mund të bini në krevat. Unë do të fle në divan. Jam mësuar.

– Jo, jo... po rri ndenjur këtu ku jam. Më mjafton të rri vetëm ndenjur.

– Mirë, si të doni.

Raviku hoqi pallton dhe e vari në vendin e vet. Pastaj mori nga shtrati një batanije dhe një jastëk dhe afroi një karrige pranë divanit. U fut në banjë, mori edhe robdëshambrin dhe e la mbi karrige.

– Kështu, – tha ai. – Këto mund t'jua jap. Po të dëshironi, mund të merrni edhe një palë pizhame. I keni atje në sirtar. Dhe tani nuk do të merrem më me ju. Edhe në banjë mund të shkoni. Unë kam edhe ca punë këtu.

Gruaja tundi kokën.

Raviku shkoi dhe u ndal para saj.

– Sidoqoftë atë pardesynë do ta heqim, – i tha ai. – Është mjaft e qullur... Pa ma jepni edhe beretën!

Ajo ia dha të dyja. Ai e vuri jastëkun në krye të divanit.

– Këtë e keni për kokën. Kurse karrigen... që të mos rrëzoheni kur të flini. – Ai e shtyu karrigen pranë divanit. – Tani na mbeten këpucët. Tërë ujë, s'do mend! Shumë të përshtatshme për t'u plevitosur. – Ai ia hoqi këpucët nga këmbët, nxori nga sirtari një palë çorape të shkurtra leshi dhe ia mbathi. – Kështu, pra! Tani sikur jeni pak më në rregull. Në kohë kritike njeriu duhet të kujdeset për pakëz komoditet. Ky është një ligj i vjetër ushtarësh.

– Falemnderit! – tha gruaja. – Falemnderit!

Raviku hyri në banjë dhe hapi rubinetet. Uji vërshoi në lavaman. Ai liroi kravatën dhe filloi ta kundronte veten në pasqyrë si i përhumbur. Sy vëzhgues, të futur thellë në hijet e gropëzave; një fytyrë e hequr, e kapitur për vdekje po të mos ekzistonin ata sy; buzë, që ishin tepër të buta për ato rrudha, të cilat zbrisnin nga hunda gjer te goja; dhe, përmbi syrin e djathtë, në një vijëzë të gjatë e të dredhur që humbiste nën flokë, dallohej shenja e një plage të mbyllur.

Tringëllima e telefonit e shkëputi nga mendimet.

Erjonixxx

– Ta marrë djalli! – Për disa sekonda ai i pati harruar të gjitha. Nganjëherë ekzistonin në jetë të tilla çaste përhumbjeje të plotë... Tani iu kujtua edhe gruaja matanë.

– Erdha! – thirri ai. – U trembët? – e pyeti gruan dhe ngriti dorezën e telefonit. – Si? Po. Mirë... posi... Natyrisht... do të rregullohet... po. Ku? Mirë, po nisem menjëherë. Kafe të nxehtë, kafe të fortë... po...

Ai e vuri dorezën në vend me shumë kujdes dhe qëndroi disa çaste i kredhur në mendime pranë divanit.

– Duhet të shkoj, – tha pastaj. – E kam me ngut.

Gruaja u ngrit menjëherë. Këmbët iu morën pak dhe u mbështet pas karriges.

– Jo, jo... – Raviku u mallëngjye për një çast nga kjo gatishmëri e urtë dhe e shtruar. – Ju mund të qëndroni këtu. Flini. Më duhet të largohem për një ose dy orë; nuk e di me siguri se sa do të vonohem. Rrini këtu dhe mos u merakosni.

Ai veshi pallton. Ashtu kalimthi i shkrepi një mendim, por e dëboi menjëherë. Gruaja nuk do ta vidhte. Nuk ishte nga ai brumë. Ato ai i njihte fort mirë. Pastaj, ç'kishte aty për të vjedhur...?

Ai ndodhej te dera, kur gruaja e pyeti:

– A mund të vij edhe unë me ju?

– Jo, punë që s'bëhet. Rrini këtu. Merrni ç'të keni nevojë. Bini në shtratin tim, po të doni. Konjakun e keni atje. Flini...

Ai u kthye për të dalë.

– Lëreni dritën ndezur, – ia bëri gruaja përnjëherësh e me rrëmbim.

Raviku e lëshoi dorezën e derës.

– Keni frikë? – e pyeti.

Ajo pohoi me kokë. Ai i tregoi çelësin.

– Kyçeni derën, pasi të dal dhe hiqeni çelësin nga brava. Poshtë ndodhet edhe një tjetër, me të cilin mund të hyj kur të kthehem.

Ajo tundi kokën.

– Nuk është puna atje. Por ju lutem, mos e shuani dritën.

– Aha! – Raviku e shikoi me vërejtje. – As që kisha ndër mend ta shuaja. Lëreni ndezur, pra. Ju kuptoj. Kam kaluar edhe vetë kohë të tilla.

Në qoshen e rrugës *Akasia* i doli përpara një taksi.

– Më çoni në rrugën *Loriston*, numër 14... Shpejt!

Shoferi e ktheu makinën dhe ata u futën në *avënynë Karno*. Kur po kryqëzonin *avënynë Dë la Gran Arme*, nga e majta u doli përpara një dyvendëshe e vogël. Të dyja makinat do të ishin përplasur sikur

Erjonixx

rruga të mos qe e lagët dhe e lëmuar. Kështu që dyvendëshja, në fresisë. Automobili i lehtë filloi të rrotullohej si një karusel. Ishte një tip nim e sipër, rrëshqiti drejt mesit të rrugës, mu anës radiatorit të taki vogël i markës *Rëno*, që kishte në timon një burrë me syze dhe me një kapele të zezë e të ngrirë. Në çdo rrotullim i dallohej për një çast fytyra e bardhë e inatosur. Pastaj makina erdhi në vijë dhe u sul në drejtim të Harkut të Triumfit që shquhej në fund të rrugës, sikur po nisej drejt portës gjigante të *Hadit* – një insekt i vockël, i gjelbër, nga i cili ngrihej kërcënues drejt qiellit të natës një grusht i zbehtë.

Shoferi i taksisë ktheu kokën nga pas.

– Keni parë apo s'keni parë kështu?

– Kam parë, – tha Raviku.

– Kështu... me të tillë kapelë!? E ç'i duhet një njeriu me kapelë të tillë të bredhë natën me kaq shpejtësi?

– Ai kishte të drejtë. Ndodhej në rrugën kryesore. Po ju, ç'keni që e shani?

– Natyrisht që kishte të drejtë. Prandaj po e shaj.

– Po ç'do të bënit sikur të mos kishte të drejtë?

– Edhe atëherë do ta shaja.

– Duket që s'e bëkeni qejfin qeder.

– Do ta shaja ndryshe, – vazhdoi shoferi dhe u kthye në *avënynë Fosh*. – Jo me kaq habi, më kuptoni?

– Jo. Ecni më ngadalë te kryqëzimet.

– Këtë e kisha ndër mend vetë. Çfarë t'i bësh kësaj dreq rruge të qullur! Po a s'më thoni, pse më pyesni kur nuk paskeni qejf t'i dëgjoni përgjigjet e mia?

– Sepse jam i lodhur, – ia priti Raviku me padurim. – Sepse është natë. Dhe, në ju pëlqeftë, edhe pse ne të gjithë jemi si shkëndija mes një ere të panjohur. Shkeljani tani!

– Atëherë ndryshuaka puna. – Shoferi e çoi dorën me njëfarë nderimi në strehën e kasketës. – Kështu mund t'ju kuptoj.

– Pa më thoni, – ia bëri Raviku, të cilit i lindi një dyshim. – Mos jeni rus?

– Jo. Por lexoj lloj-lloj gjërash, në kohën kur rri e pres klientë.

Sonte nuk paskam fat me rusët, mendoi Raviku dhe mbështeti kokën mbrapa. Kafe, tha me vete. Kafe të zezë dhe valë të nxehtë. Shpresoj se do t'u ndodhet ca. S'duhet të më dridhen duart. Po s'ia dola dot, le të më bëjë Veberi një injeksion. Por do t'ia dal... Ai e uli xhamin e taksisë dhe thithi ngadalë e thellë ajrin e lagësht.

Erjonixx

2

Salla e vogël e operacionit ishte e ndriçuar sikur të qe ditë. Dukej posi një kasaphanë higjienike. Kudo të zinte syri kova me pambuk të qullur nga gjaku; fasho dhe tampona ishin hedhur sa andej-këtej, dhe ngjyra e kuqe sikur shpërthente në brohoritje triumfuese kundër bardhësisë së shumtë të sallës. Veberi rrinte në paradhomë pranë një tryeze metalike të lustruar dhe bënte disa shënime; një infermiere po dezinfektonte instrumentet; uji valonte; drita dukej sikur po këlthiste, dhe vetëm trupi mbi tryezën e operacionit shtrihej mospërfillës – të gjitha këto gjëra nuk i interesonin më.

Raviku hodhi sapunin e lëngshëm mbi duar dhe filloi të lahej. Lahej me zemëratë e tërbim të ndrydhur, sikur donte ta rripte lëkurën e vet.

– Punë dreqi! – murmuriste me vete. – Punë e mallkuar!

Infermierja e vështroi me neveri. Veberi ngriti sytë.

– Qetësohuni, Ëzheni! Të gjithë kirurgët shajnë. Sidomos kur u shkon puna ters. Ju duhej të ishit mësuar me këtë gjë.

Infermierja hodhi një tok instrumentesh në ujin e valuar.

– Profesori Perrie nuk shante kurrë, – ia priti ajo e fyer. – E megjithatë shpëtonte gjithë ata njerëz.

– Profesori Perrie ishte specialist për operacionet e trurit. Mekanizmi më delikat, Ëzheni. Kurse ne i fusim thikat nëpër bar qe. Kjo është diçka tjetër. – Veberi e mbylli regjistrin e shënimeve dhe u ngrit nga vendi. – Punuat mirë, Ravik. Por, në fund të fundit, kasapëve nuk kemi ç't'u bëjmë!

– Nuk është ashtu... Nganjëherë edhe mund të bëjmë diçka. – Raviku fshiu duart dhe ndezi një cigare.

Erjonixx

Infermierja, turivarur, por pa bërë zë, nxitoi të hapte njërën nga dritaret.

– Ju lumtë, Ëzheni! – e lëvdoi Veberi. – Gjithmonë sipas rregullores.

– Unë kam disa detyrime në jetë. Nuk ma ka ënda aspak të fluturoj në hava.

– Kjo është diçka e mirë, Ëzheni. Diçka që të fal njëfarë qetësie.

– Kurse disa nuk kanë detyrime. Dhe as që duan të kenë.

– Jua hodhi, Ravik! – Veberi qeshi. – E mira është të zhdukemi që këtej. Mëngjeseve, Ëzhenia është fort agresive. Këtu s'kemi se ç'bëjmë më.

Raviku hodhi sytë përreth. E vështroi edhe infermieren që kishte detyrime. Ajo ia ktheu vështrimin pa drojë. Syzet me rrathët e nikeluar i jepnin fytyrës së saj thatime një hije të rëndë, që të shtynte t'i rrije larg. Ishte njeri si ai edhe ajo, por i dukej më e huaj nga ç'mund të jetë një pemë.

– Më falni, – i tha. – Keni të drejtë.

Mbi tryezën e bardhë të operacionit shtrihej ajo që, vetëm disa orë më parë, pati qenë akoma shpresë, frymë, dhimbje dhe jetë e dritheruar. Kurse tani s'ishte veçse një kufomë pa vlerë – dhe automatja njerëzore, e quajtur infermierja Ëzheni, e cila krenohej që nuk kishte bërë kurrë ndonjë gabim, e mbuloi kufomën dhe, mbi rrota, e nxori jashtë sallës. Këta njerëz mbijetojnë gjithmonë, mendoi Raviku. Drita nuk i do këta shpirtra prej druri, prandaj i harron dhe i lë të rrojnë gjatë...

– Mirupafshim, Ëzheni, – tha Veberi. – Ngopuni me gjumë sot.

– Mirupafshim, doktor Veber. Ju falemnderit!

– Mirupafshim, – tha Raviku. – Ju kërkoj ndjesë për sharjet e mia.

– Ditën e mirë, – ia priti Ëzhenia me zë të akullt.

Veberi vuri buzën në gaz.

– Karakter i hekurt, – tha ai.

*

* *

Jashtë nderej mëngjesi i murrmë. Makinat e plehrave rrapëllinin nëpër rrugë. Veberi ngriti jakën.

– Ç'mot i poshtër! Doni të vini me mua, Ravik?

– Jo, falemnderit. Dëshiroj ta bëj rrugën më këmbë.

– Në këtë farë kohe? Mund t'ju shpie me makinën time. S'më kushton gjë.

Erjonixx

Raviku tundi kokën.

– Falemnderit, Veber.

Veberi e shikoi me vërejtje.

– Më vjen çudi që shqetësoheni kaq shumë, sa herë ju mbetet ndokush në dorë. Keni pesëmbëdhjetë vjet që merreni me këtë zanat dhe duhej të ishit mësuar.

– Po, ashtu është. Dhe s'po shqetësohem aspak.

Veberi qe ngulur përpara Ravikut, ashtu i bëshëm siç ishte. Fytyra e madhe rrumbullake i shkëlqente posi mollë Normandie. Mustaqet e zeza i qenë lagur nga shiu dhe i vezullonin. Buzë trotuarit qëndronte një veturë e markës *Buik* që vezullonte gjithashtu. Me të Veberi do të nisej tani rehat-rehat për në shtëpi – në një shtëpi ngjyrë trëndafili si shtëpi kukullash në periferi të qytetit, ku e priste një grua e pastër tërë gaz e dritë, dy fëmijë të pastër tërë gaz e dritë me një jetë të pastër tërë gaz e dritë. E si mund t'i shpjegohej atij diçka nga ajo tendosje që ta merrte frymën, kur bisturia niste të bënte prerjen e parë, kur vija e ngushtë dhe e kuqe e gjakut ndiqte shtypjen e lehtë, kur trupi nën gjilpërat dhe kapëset shpalosej si një perde plot kinda, kur zbuloheshin organe që nuk kishin parë kurrë dritë, kur, posi një gjahtar në thellësi të xhunglës, njeriu ndiqte një gjurmë dhe, papandehur, mes zorrësh, damarësh, koklavitjesh dhe të prerash, ndodhej ballë për ballë me bishën e madhe grabitqare, që quhej Vdekje... futej në atë përleshje, ku nuk i nevojitej asgjë tjetër përveç një bisturie të hollë, një gjilpëre dhe një dore shumë, shumë të sigurt...? E si mund t'i shpjegohej atij se ç'do të thotë, kur pastaj, gjatë atij përqendrimi të jashtëzakonshëm që e vishte çdo gjë me një bardhësi verbuese, papritmas ta turbullonte gjakun një hije e errët, një qesëndi e madhërishme, e cila dukej sikur ia thyente bisturisë tehun dhe gjilpërës majën dhe sikur ta rëndonte dorën... dhe kur kjo gjëja e padukshme, e mistershme, tërë rrahje pulsi, që quhej Jetë, të tretej përnjëherësh nën duart e pafuqishme, si ta tërhiqte rryma e një vorbulle të zezë të hatashme, të cilën as e arrije dhe as e largoje dot... kur një fytyrë, e cila pak çaste më parë merrte akoma frymë, ishte një Unë dhe kishte një emër, shndërrohej befas në një maskë të ngrirë e të paemër... Si mund ta shpjegoje, pra, këtë pafuqi të pakuptimtë dhe aq rebele... si mund ta shpjegoje, vallë, dhe ç'gjë kishte për t'u shpjeguar këtu?...

Raviku ndezi një cigare tjetër.

– Ajo ishte njëzet e një vjeç, – tha ai.

Veberi nxori një shami dhe fshiu pikat e shiut nga mustaqet.

Erjonixx

– Ju punuat shkëlqyeshëm. Unë s'do të punoja dot ashtu. Por që s'arritët të shpëtonit dot atë që ka katranosur dora e një kasapi, për këtë s'duhet ta vrisni mendjen. Si do të vente halli ynë, po të mendonim ndryshe?

– Po, – tha Raviku. – Si do të vente halli ynë?...

Veberi e futi shaminë në xhep.

– Pas gjithë atyre që keni hequr në jetë, duhej të ishit shumë i regjur tani.

Raviku i hodhi një vështrim pak ironik.

– Njeriu nuk regjet kurrë. Ai vetëm mund të mësohet me shumë gjëra.

– Këtu e kam fjalën edhe unë.

– Ashtu është. Por ka edhe gjëra me të cilat nuk mund të mësohet kurrë. Vetëm se që t'u biesh më të këtyre gjërave, kjo është shumë e vështirë. Le ta zëmë se ishte kafeja. Ndoshta ishte vërtet kafeja ajo që më solli kaq në vete. Kurse këtë ne e ngatërrojmë me shqetësimin.

– Kafeja qe e mirë, apo jo?

– Shumë e mirë.

– Më vjen mjaft ndoresh të bëj kafe. Kisha një si parandjenjë që do t'ju nevojitej, prandaj edhe e bëra vetë. Ndryshonte shumë nga ai lëng i zi gështenjash, që na bën zakonisht Ëzhenia, apo jo?

– As që krahasohet! Sa për kafe, ju jeni mjeshtër!

Veberi hipi në veturën e vet. E ndezi motorin dhe u përkul jashtë xhamit.

– A s'po vini t'ju çoj shpejt e shpejt? Duhet të jeni tmerrësisht i rraskapitur, – tha ai.

Sa i ngjan fokës, mendoi Raviku, pa ia varur fare tjetrit. Tamam si një fokë e shëndoshë. Po fundja, ç'rëndësi ka kjo? Pse m'u kujtua? Pse rri e mendoj gjithmonë në mënyrë të dyfishtë?

– Nuk jam i rraskapitur, – tha. – Kafeja më shkundi. Gjumin e mirë, Veber!

Veberi qeshi. Dhëmbët i shndritën nën mustaqet e zeza.

– Nuk do të bie fare të fle. Do t'i futem punës në kopshtin tim. Kam për të mbjellë disa tulipanë dhe narcisë.

Tulipanë dhe narcisë, mendoi Raviku. Të mbjellë në shtretër të rregulluar mirë e bukur dhe të ndarë nga rrugina të pastra e të shtruara me zhur... Të kujtojnë puhinë e parë plot ngjyra të pranverës...

– Mirupafshim, Veber, – tha ai. – Besoj se për të tjerat do të kuj-deseni vetë.

Erjonixx

– Natyrisht. Do t'ju marr në telefon në darkë. Honorari, mjerisht, do të jetë i pakët. As që e vlen të përmendet. Vajza ishte e vrafër dhe, me sa duket, nuk kishte asnjë të afërm. Por këtë do ta shikojmë edhe një herë.

Raviku bëri një lëvizje kundërshtimi me dorë.

– Ajo i dorëzoi Ëzhenisë njëqind franga. Duket se kjo ishte e tërë pasuria e saj. Kështu që ju bie për të marrë vetëm njëzet e pesë.

– Mirë, mirë, – tha Raviku me padurim. – Mirupafshim, Veber!

– Mirupafshim nesër në mëngjes, më ora tetë.

*

* *

Raviku mori ngadalë rrugën *Loriston*. Po të kishte qenë verë, do të qe ulur mbi ndonjë bankinë diku në *Bua*[1], dhe nën rrezet e diellit mëngjesor do të kishte kundruar pa ndonjë mendim në kokë ujin ose pyllin e gjelbëruar, derisa të lehtësohej nga ajo tendosje nervash. Pastaj do të ishte nisur për në hotel dhe do të kishte rënë për të fjetur.

Hyri në një bar në qoshen e rrugës *Buasjer*. Disa punëtorë dhe shoferë kamionësh rrinin pranë banakut. Pinin kafe të nxehtë dhe ngjyenin në të biskota. Raviku qëndroi një copë herë duke i soditur. Ja tek ishte jeta e sigurt dhe e thjeshtë... një ekzistencë që njeriu duhej ta mbërthente me grushte dhe për të cilën duhej të rropatej... natën lodhje, darka, një grua dhe gjumë i rëndë, pa ëndrra...

– Një *Kirsh*, – porositi ai.

Vajza që vdiq, kishte pasur rreth këmbës së djathtë një zinxhir të hollë e të lirë prej imitacioni floriri; ishte një nga ato marrëzirat që mund t'i bëje vetëm kur ishe i ri, sentimental dhe pa shije. Një zinxhir me një pllakë të vogël, ku lexohej mbishkrimi: *"Tuzhur Sharl"*[2] dhe që nuk mund të hiqej kurrë nga këmba; një zinxhir, i cili tregonte për të dielat e kaluara ndër pyjet buzë Senës, për rënien në dashuri dhe për budallallëqet e rinisë, për një kujunxhi të vogël, që banonte diku në Neji, për net shtatori në një papafingo të mobiluar varfërisht... dhe pastaj, papritur e pakujtuar, vinin me radhë gjithë të tjerat: vonesa e menstruacioneve, pritja, frika dhe ankthi, *Tuzhur Sharli* që zhdukej si i fshirë nga faqja e dheut, shoqja që dinte një adresë, mamia në ndonjë skutë të qytetit, një tryezë e shtruar me mushama, dhimbje çjerrëse dhe gjak, gjak, një fytyrë plake e shushatur,

1. *Bois de Boulogne*: Pylli i Bulonjës.
2. *Toujours Charles*: Gjithmonë Sharli; ose: Sharli, dhe asnjë tjetër.

Erjonixx

krahë që të rrasnin me rrëmbim në një taksi për të të hequr qafe, ditë torturash dhe ndrydhjeje në vetvete dhe, më në fund, shtrimi në spital, njëqind frangat e fundit, të zhubrosura në dorën e nxehtë e të lagësht, dhe megjithatë: tepër vonë!

Radioja filloi të pëlliste. Ishte një zë hundak që këndonte një tango me ca vargje idiote. Raviku pikasi vetveten tek po e përsëriste me mend gjithë operacionin edhe një herë që nga fillimi. Rikujtoi çdo lëvizje të dorës. Po të ishte ndodhur atje disa orë më parë, do të ekzistonte një mundësi shpëtimi. Veberi e pati lajmëruar me telefon, por ai nuk ndodhej në hotel. Kështu që vajza duhej të vdiste, sepse ai sillej vërdallë nëpër *Pon dë L'Alma*. Veberi nuk mund të kryente vetë të tilla operacione. Një rastësi absurde!... Këmba me zinxhirin e imituar, e mpirë dhe e përdredhur nga brenda... *"Eja, moj, në varkën time/ Hënëza po na ndriçon"*, kuakte falseti i tenorit që nga radioja.

Raviku pagoi dhe doli. Jashtë ndaloi një taksi.

– Më çoni në *Osiris!*

*

* *

Osirisi ishte një bordel i madh borgjez me një bar madhështor në stil egjiptian.

– Tani po e mbyllim, – tha portieri. – Nuk ka më asnjeri.

– Asnjeri?

– Vetëm madam Rolanda. Damat kanë ikur që të gjitha.

– Mirë.

Portieri, me qejf të prishur, përplasi disa herë galloshet mbi trotuar.

– A s'po e mbani taksinë? Më vonë do ta keni të vështirë të gjeni tjetër. Këtu i kanë dhënë fund.

– Këtë e mora vesh; ma thatë një herë. Sa për taksi, kam për të gjetur edhe më vonë.

Raviku i rrasi portierit një paketë cigaresh në xhepin e setrës dhe, nëpër derën e ngushtë, u fut në sallën e madhe duke kaluar përpara gardërobës. Bari ishte bosh; si zakonisht ruante gjurmët e një orgjie mikroborgjeze – pellgje vere të derdhur, disa karrige të përmbysura, bishta cigaresh në dysheme dhe aroma e duhanit, e parfumit të ëmbël dhe e lëkurës.

– Rolandë, – tha Raviku.

Ajo rrinte përpara një tryeze, mbi të cilën ishte hedhur një pirg veshmbathjesh të mëndafshta bojë rozë.

Erjonixx

– Ravik, – tha ajo pa treguar pikë habie. – Është vonë. Çfarë dëshiron? Një vajzë apo diçka për të pirë? Apo të dyja?

– Vodkë. Nga ajo polakja.

Rolanda solli shishen dhe një gotë.

– Mbushe vetë. Më duhet t'i ndaj teshat dhe t'i regjistroj. Makina e lavanderisë do të kalojë tani këtej. Po të mos i shënoj të gjitha, një për një, ajo bandë të vjedh sikur të ishte një trumbë laraskash. E kam fjalën për shoferët, më kupton? I qërojnë dhe ua bëjnë peshqesh çupkave të tyre.

Raviku bëri një shenjë pohimi me krye.

– Na vër një muzikë, Rolandë. Hape fort.

– Mirë.

Rolanda ndezi radion. Muzika me orkestrën e saj uturoi si stuhi nëpër sallën e madhe e të zbrazët.

– Mos bën shumë zhurmë, Ravik?

– Jo.

Shumë zhurmë...? Çfarë bënte shumë zhurmë? Vetëm heshtja. Heshtja, në të cilën pëlcisje si në një dhomë pa ajër.

– Mori fund edhe kjo punë.

Rolanda iu afrua tryezës së Ravikut. Kishte një trup të lidhur, një fytyrë të pastër dhe sy të zinj e të qetë. Fustani i zi serioz që mbante veshur, tregonte se ishte kujdestarja; ai e dallonte nga prostitutat që rrinin pothuajse krejt lakuriq.

– Pi edhe ti një me mua, Rolandë.

– Mirë.

Raviku shkoi e mori një gotë nga banaku dhe filloi ta mbushte. Kur gota u mbush përgjysmë, Rolanda ia hoqi shishen nga dora.

– Mjaft! Unë nuk pi më shumë.

– Gotat përgjysmë nuk durohen. Atë që s'do ta pish, lëre më mirë.

– E pse? Do të ishte harxhim i kotë.

Raviku ngriti sytë. I soditi tiparet e saj të zgjuara që të ngjallnin besim dhe vuri buzën në gaz.

– Harxhim i kotë! Ja, frika e vjetër franceze. E pse të kursejmë? As ty nuk të kursen njeri.

– Kësaj këtu i thonë punë. Është tjetër gjë.

Raviku qeshi.

– Eja të ngremë një gotë për këtë që the! Ç'do të ishte bota pa moralin e punës!? Një grumbull kriminelësh, idealistësh dhe dembelësh.

Erjonixx

– Ti ke nevojë për një vajzë, – i tha Rolanda. – Mund t'i telefonoj Kikit. Është shumë e mirë. Njëzet e një vjeçe.

– Ashtu! Edhe ajo njëzet e një vjeçe qenka? Nuk bëka për mua sot. – Raviku e mbushi përsëri gotën e vet deri në buzë. – Përse mendon ti, Rolandë, përpara se të të zërë gjumi?

– Më të shumtën nuk mendoj për asgjë. Jam tepër e lodhur.

– Po kur nuk je tepër e lodhur?

– Më shkon mendja në Tur.

– Pse?

– Një tetoja ime ka atje një shtëpi bashkë me një dyqan. Unë kam dhënë dy hipoteka për të. Po të vdesë ajo, se tani i ka mbushur të shtatëdhjetegjashtat, shtëpinë e marr unë. Pastaj dyqanin kam ndër mend ta kthej në kafene. Mure të çelëta të pikturuara me lule; një orkestër prej tre vetash: piano, violinë, çelo; dhe banaku, i futur në një skutë. Do të jetë një lokal i vogël dhe i këndshëm. Shtëpia ndodhet në një lagje të mirë. Them se nëntë mijë e pesëqind franga do të më dalin për ta pajisur; kam llogaritur, bile, edhe perdet edhe llambat. Pastaj dua të kem mënjanë, si rezervë, edhe pesë mijë franga të tjera për periudhën e parë. Dhe, natyrisht, do të marr edhe qiranë e katit të parë e të dytë... Ja, për këto mendoj përpara se të më zërë gjumi.

– Po ti, në Tur ke lindur?

– Po. Vetëm se askush nuk e di ku kam qenë tërë këtë kohë. Dhe, po të më vejë mbarë puna e kafenesë, prapë askush nuk ka për ta çarë kokën për këtë. Paraja i mbulon të gjitha.

– Jo të gjitha, por shumë gjëra.

Raviku ndjeu se si po i rëndoheshin qepallat dhe po i vështirësohej të folurit.

– Më duket se e mbusha masën time, – tha dhe nxori nga xhepi disa monedha. – A do të martohesh në Tur, Rolandë?

– Jo menjëherë. Por pas disa vjetësh. Kam një shok atje.

– Ke shkuar herë pas here për ta takuar?

– Rrallë. Ai më shkruan nganjëherë... në një adresë tjetër, kuptohet. Është i martuar, por të shoqen e ka në spital. Tuberkuloze. Mjekët thonë se, shumë-shumë, i ka edhe një ose dy vjet jetë. Pastaj ai do të jetë i lirë.

Raviku u ngrit.

– Të bekoftë perëndia, Rolandë. Ti ke një mendje të shëndoshë.

Ajo nënqeshi, pa i vënë në dyshim fjalët e tij. Iu duk se Raviku kishte të drejtë. Fytyra e saj e pastër nuk tregonte asnjë gjurmë lodhje.

Erjonixx

jeje. E kishte të freskët, thua se sapo ishte ngritur nga gjumi. Ajo e dinte, çfarë kërkonte. Jeta për të nuk kishte asnjë të fshehtë.

Ndërkohë jashtë ishte bërë ditë. Shiu nuk breronte më. Pisuarët nëpër qoshet e rrugëve ngjanin me tanke të vogla. Portieri ishte zhdukur, nata ishte fshirë, dita e re po fillonte dhe grumbuj njerëzish të ngutshëm shtyheshin para hyrjeve të metrosë – sikur të ishin shpella nëntokësore, në të cilat ata suleshin për t'iu bërë theror një perëndie nursëze.

*
* *

Gruaja u hodh përpjetë nga divani. Ajo nuk bërtiti, por vetëm u hodh përpjetë me një britmë të lehtë e të mbytur; u mbështet mbi bërryla dhe ngriu në vend.

– Mos u trembni, mos u trembni, – tha Raviku. – Jam unë. Po ai që ju solli këtu përpara disa orësh.

Gruaja mori frymë përsëri. Raviku nuk e shquante mirë; llambat e ndezura përziheshin me mëngjesin, që po rrëshqiste brenda dritares, dhe dhoma qe kredhur në një dritë verdhacuke, të zbehtë e të sëmurë.

– Mendoj se këto mund t'i shuajmë tani, – tha ai dhe mbylli çelësin. Pas ballit ndjeu përsëri goditjen e çekanëve të butë të dehjes. – Doni të hani mëngjes? – e pyeti. E pati harruar fare gruan, dhe pastaj, kur mori çelësin poshtë, pandehu se ajo kishte ikur. Qejfi ia kishte që ta hiqte qafe. Kishte pirë mjaft, kulisat e trurit i kishin lëvizur, vargoi tingëllues i kohës ishte këputur dhe tani, të fuqishme e të patrembura, po e qarkonin kujtimet dhe ëndrrat. Donte të mbetej vetëm.

– Dëshironi një kafe? – pyeti ai. – Është e vetmja gjë e mirë që mund të gjesh këtu.

Gruaja tundi kokën. Ai e shikoi më me vërejtje.

– Ka ndodhur gjë? Mos ju erdhi njeri këtu?

– Jo.

– Po diçka duhet të ketë ndodhur. Ju m'i keni ngulur sytë, a thua se jam ndonjë fantazmë.

Gruaja lëvizi buzët.

– Kundërmimi... – murmuriti ajo pastaj.

– Kundërmimi? – përsëriti Raviku pa kuptuar gjë fare. – Vodka nuk ka erë. As *Kirshi* dhe konjaku. Kurse cigare pini dhe vetë. E ç'ka këtu për t'u trembur?

Erjonixx

– Nuk e kam fjalën atje...
– Po ku e keni hallin atëherë?
– Është po ajo... po ajo erë...
– O perëndi e madhe, do të jetë kloroformi, – tha Raviku, duke i rënë më të menjëherë. – Për kloroformin e keni?
Ajo pohoi me kokë.
– Mos jeni operuar ndonjëherë?
– Jo... por është...
Raviku nuk ia vuri veshin, por shkoi dhe hapi dritaren.
– Ikën menjëherë. Ndërkaq pini një cigare.
Ai hyri në banjë dhe hapi rubinetet. Në pasqyrë pa fytyrën e vet. Po kështu pati qëndruar edhe përpara disa orësh. Por ndërkohë kishte vdekur një njeri. Kjo nuk ishte ndonjë gjë e madhe. Çdo çast vdisnin me mijëra njerëz. Kishte edhe statistika për këtë. Kjo nuk ishte ndonjë gjë e madhe. Por për atë që vdiste, kjo ishte e gjitha, ishte dhe më e rëndësishme se e tërë bota që vazhdonte të rrotullohej...
U ul buzë vaskës dhe hoqi këpucët... Kjo mbetej gjithmonë e njëllojtë: Gjërat dhe zgjedha e tyre e heshtur. E rëndomta dhe zakoni i ngushtë gjatë gjithë kësaj rrëshqitjeje mashtruese. Bregu i lulëzuar i zemrës buzë ujërave të dashurisë... Por çfarëdo që të ishe, poet, gjysmëperëndi apo idiot – gjithnjë, krye disa orësh, të duhej të zbrisje nga qiejt e tu për të urinuar. Kësaj nuk mund t'i shpëtoje! Ishte ironia e natyrës! Ylberi romantik mbi reflekset e mëshikëzave dhe gurgullimës së aparatit tretës. Organet e ekstazës, që në mënyrë djallëzore, ishin dënuar njëkohësisht edhe të shteronin... Raviku i flaku këpucët në një qoshe. Zakoni i urryer i të zhveshurit! Bile as këtij nuk i shpëtoje dot. Vetëm kush jetonte i vetmuar, mund ta kuptonte këtë. Ishte një zakon fatal, të cilit duhej t'i nënshtroheshe. Shpeshherë kishte rënë të flinte me gjithë rroba, vetëm e vetëm për t'i shpëtuar këtij nënshtrimi të mallkuar; por pati qenë vetëm një shtyrje e përkohshme. Atij nuk i shpëtoje dot.
Hapi dushin. Uji i ftohtë iu derdh mbi lëkurë. Mori frymë thellë dhe zuri të fshihej. Ngushëllimi i gjërave të vogla. Ujë, frymëmarrje, shi mbëmjesor. Vetëm kush jetonte i vetmuar, i njihte edhe këto. Lëkurë mirënjohëse. Gjak i lehtë, që vërshonte nëpër dejet e errëta. Të shtriheshe tani mbi një lëndinë! Mështekna! Re të bardha verore! Qielli i rinisë! Ku mbetën lajthitjet e zemrës? U vranë nga lajthitjet e ngrysura të jetës...
Ai u kthye në dhomë. Gruaja rrinte e kruspullosur në cep të divanit, e mbështjellë gjer në mjekër me batanije.

Erjonixx

– Ftohtë? – e pyeti ai.
Ajo tundi kokën.
– Frikë?
Ajo pohoi.
– Nga unë?
– Jo.
– Nga ajo që ndodhet jashtë?
– Po.
Raviku e mbylli dritaren.
– Falemnderit, – tha ajo.

Ai vështroi zverkun përpara tij. Shpatulla. Diçka që merrte frymë. Pakëz jetë e huaj... por sidoqoftë jetë. Ngrohtësi. Jo trup që ngrinte përgjithmonë. E ç'mund t'i falje vetvetes, përveçse pakëz ngrohtësi? E ku kishte më shumë se kjo?

Gruaja lëvizi. Zuri të dridhej dhe e vështroi Ravikun. Ai e ndjeu zbaticën e valës së fuqishme. Ftohtësia e thellë, pa peshë, erdhi. Tendosja kaloi. Një hapësirë e pamat u shpalos. Iu duk sikur po kthehej nga një natë e kaluar në një planet të huaj. Papandehur çdo gjë erdh e u bë e thjeshtë, - mëngjesi, gruaja... nuk kishe çfarë të mendoje më gjatë.

– Eja, – tha ai.
Ajo e vështroi e shastisur.
– Eja, – tha ai me padurim.

Erjonixx

3

Raviku u zgjua. Kishte përshtypjen se po e vërenin. Gruaja ishte veshur dhe rrinte mbi divan. Por ajo nuk e vështronte; sytë i kishte drejtuar jashtë dritares. Ai kishte pritur që ajo të ishte larguar qëkur. Nuk i erdhi mirë që ndodhej akoma aty. Mëngjeseve s'para duronte dot njerëz rreth vetes.

U mendua në s'do të ishte më mirë sikur të flinte edhe pak; por ideja se ajo mund ta kundronte, nuk e linte të qetë. Vendosi ta hiqte qafe sa më shpejt. Po qe se po priste që ai t'i jepte të holla, atëherë puna ishte shumë e thjeshtë. Por edhe sikur të mos qe ashtu, prapëseprapë puna do të ishte e thjeshtë. Ai u ngrit përgjysmë.

– Keni kohë që jeni zgjuar?

Gruaja u tremb dhe u kthye nga ai.

– Nuk kisha më gjumë. Më vjen keq, po t'ju kem zgjuar.

– Nuk më zgjuat ju.

Ajo u çua nga vendi.

– Kisha ndër mend të ikja. Nuk e di pse ndenja akoma këtu.

– Prisni. Për dy minuta jam gati. Do t'ju vijë edhe mëngjesi. Kafeja e famshme e hotelit. Kemi aq kohë sa ta presim.

Ai u ngrit dhe i ra ziles. Pastaj u fut në banjë. E pa që edhe gruaja e kishte përdorur; por çdo gjë ishte vënë përsëri me kujdes në vendin e vet, bile edhe peshqirët. Ndërsa po lante dhëmbët, dëgjoi kamerieren e hotelit që solli mëngjesin. Ai shpejtoi.

– Ju erdhi rëndë? – e pyeti kur doli nga banja.

– Si?

– Që ju pa kamerierja. Më doli fare nga mendja.

– Jo. As ajo s'u duk e habitur.

Erjonixx

Gruaja vështroi tabakanë. Ishte për dy veta, kurse Raviku nuk kishte thënë gjysmë fjale.

– Sigurisht që jo. Prandaj jemi në Paris. Ja tek e keni kafenë tuaj. Mos ju dhemb koka?

– Jo.

– Mirë. Mua më dhemb pak. Por pas një ore do të më kalojë. Ja tek keni edhe biskota.

– Nuk mund të fus gjë në gojë.

– Nuk është e vërtetë. Ashtu ju duket. Pa provojeni një herë.

Ajo mori një biskotë. Pastaj e vuri përsëri në pjatë.

– Vërtet që nuk mundem.

– Atëherë pijeni kafenë dhe ndizni një cigare. Ky është mëngjesi i ushtarëve.

– Mirë.

Raviku filloi të hante.

– Nuk ju mori akoma uria? – e pyeti pas një copë here.

– Jo. – Gruaja e fiku bishtin e cigares. – Them se… – foli ajo dhe heshti përsëri.

– Çfarë? – e pyeti Raviku pa ndonjë kureshtje.

– Them se tani duhet të shkoj.

– E dini rrugën? Këtu ndodhemi pranë *avënysë Vagram*.

– Nuk e di.

– Po ku banoni?

– Në hotel *Verdën*.

– Nuk mban as disa minuta që këtej. Mund t'jua tregoj jashtë. Sidoqoftë, do t'ju përcjell gjersa të kalojmë portierin.

– Po… por s'e kisha aty…

Ajo heshti sërish. Paraja, mendoi Raviku. Si gjithmonë… paraja e shkretë.

– Mund t'ju ndihmoj fare lehtë, po qe se jeni ngushtë. – Ai nxori portofolin.

– Lëreni këtë! Ç'do të thotë kjo? – ia bëri gruaja me vrazhdësi.

– Asgjë. – Raviku e futi portofolin përsëri në xhep.

– Më falni… – Ajo u ngrit më këmbë. – Ju ishit… Më duhet t'ju falënderoj… Kjo natë… do të kishte qenë…. E vetme nuk do të dija…

Ravikut iu kujtua se çfarë kishte ndodhur. Do t'i qe dukur qesharake, sikur ajo ta kishte bërë çështje… por që ta falënderonte, këtë nuk e priste, bile kjo nuk i pëlqeu aspak.

– Vërtet që nuk do të dija si do të më vente halli, – tha gruaja.

Ajo qëndronte akoma përpara tij, ashtu e pavendosur. "Pse nuk

E.N

po ikën?" – mendoi ai.

– Por tani e dini... – i tha, sa për të thënë diçka.

– Jo. – Ajo e vështroi drejt e në sy. – Prapë nuk e di. Di vetëm se duhet të bëj diçka dhe se nuk mund të marr arratinë.

– Ditkeni mjaft. – Raviku mori pallton. – Tani do t'ju përcjell gjer jashtë.

– Nuk është nevoja. Vetëm më thoni... – Ajo ngurroi dhe dukej se po kërkonte fjalët e përshtatshme. – Ndoshta e dini... çfarë duhet bërë... kur...

– Kur çfarë? – e pyeti Raviku pas pak.

– Kur vdes një njeri, – shpërtheu gruaja dhe, papritmas, u mek e u ligështua. Ajo zuri të qante. Nuk dëneste, vetëm qante, pothuajse heshturazi.

Raviku priti gjersa u qetësua pak.

– Ka vdekur njeri?

Ajo pohoi me krye.

– Mbrëmë?

Ajo pohoi përsëri.

– E vratë ju?

Gruaja ia mbërtheu sytë me tmerr.

– Çfarë? Çfarë thatë ashtu?

– Pyeta në e bëtë ju? Kur kërkoni nga unë një këshillë, atëherë duhet të më tregoni gjithçka!

– Ai vdiq! – klithi gruaja. – Papritmas...

Ajo fshehu fytyrën midis duarve.

– Ishte i sëmurë? – e pyeti Raviku.

– Po.

– Morët ndonjë mjek?

– Po... Por ai s'donte të shtrohej në spital...

– E vizitoi mjeku dje?

– Jo. Para tri ditësh. Por ai e... ai e shau dhe nuk deshi t'ia shihte sytë.

– Nuk morët ndonjë mjek tjetër pastaj?

– Nuk njihnim tjetër. Kemi vetëm tri javë këtu. Edhe atë na e gjeti kamerieri... Kurse ai nuk e donte më... Thoshte... kujtonte se mund të bënte vetë derman, më mirë se një mjek...

– Nga se vuante?

– Nuk e di. Mjeku tha se kishte bronkopneumoni... por ai nuk e besonte... thoshte se të gjithë mjekët janë batakçinj... Dje e ndjeu veten më mirë. Por pastaj, papandehur...

Fsociety

– Pse nuk e shtruat në ndonjë spital?

– Nuk donte... Thoshte... se po të shtrohej, unë do ta tradhtoja... Ai... Ju nuk e njihnit... Ishte punë që s'bëhej.

– Akoma në hotel ndodhet?

– Po.

– E keni njoftuar pronarin e hotelit?

– Jo. Kur u nemit, ashtu përnjëherësh... dhe rretheqark gjithçka e nemitur... dhe sytë e tij... atëherë nuk durova dot më dhe mora rrugët.

Ravikut iu kujtua nata. Për një çast i erdhi rëndë. Por ajo që ndodhi, ndodhi tani; s'kishte më rëndësi... si për të ashtu edhe për gruan. Veçanërisht për gruan. Vetëm një gjë kishte pasur rëndësi për të; ta kalonte natën e të vinte mëngjesi. Jeta nuk përbëhej vetëm prej krahasimesh sentimentale. Atë natë kur mori vesh që i vdiq e shoqja, Lavinji[1] e kaloi në një shtëpi publike. Prostitutat e shpëtuan; priftërinjtë nuk do t'i kishin bërë hall. Kush e kuptonte këtë, le ta kuptonte. Shpjegime për këtë nuk kishte. Por kush e kuptonte, ama, kishte disa detyrime.

Ai veshi pallton.

– Ejani! Po vij me ju. Burrë e kishit?

– Jo, – tha gruaja.

*

* *

Pronari i hotel *Verdënit* ishte një burrë i bëshëm. Në kokë s'i kishte mbetur asnjë qime floku; por në mungesë të flokëve, kishte një palë mustaqe të ngjyera me të zezë dhe vetulla të zeza e të dendura. E gjetën në sallon, dhe pas i qëndronin një kamerier, një kameriere dhe një arkëtare me gjoksin dërrasë. Nuk kishte pikë dyshimi se, ndërkohë, ai i kishte marrë vesh të gjitha. Prandaj filloi edhe të turfullonte, sapo e vuri re gruan që hyri brenda. Fytyra iu bë spec e kuqe, duart e vogla e të dhjamura i tundte sa andej-këtej, buçiste i tëri nga inati, indinjata dhe – siç e vuri re Raviku – edhe nga lehtësimi. Kur nuk la fjalë pa thënë dhe arriti te policia, të huajt, dyshimi dhe burgu, Raviku e ndërpreu:

– Mos jeni nga Provansa? – e pyeti i qetë.

I zoti i hotelit e preu yryshin.

– Jo. Ç'është kjo pyetje kështu? – ia bëri i shushatur.

1. *Huberl Lavigne* (1818 -1882), skulptor i dëgjuar francez.

Erjonixx

– Asgjë, – ia priti Raviku. – Desha vetëm t'ju ndërpres. Dhe kjo arrihet më mirë me një pyetje krejtësisht të pakuptimtë. Ndryshe do të kishit grirë sallatë edhe një orë të tërë.

– Kush jeni ju, zotëri? Çfarë kërkoni?

– Këto janë fjalët më me mend që keni thënë gjer tani.

Pronari e kishte mbledhur veten.

– Kush jeni ju? – pyeti më i përmbajtur, duke pasur kujdes që në asnjë mënyrë të mos fyente ndonjë njeri me influencë.

– Mjeku.

Tani pronari nuk po nuhaste më asnjë rrezik.

– Këtu nuk kemi nevojë për mjek, – zuri të turfullonte përsëri. – Këtu kemi nevojë për policinë.

Ia mbërtheu sytë Ravikut dhe gruas. Priste ndonjë shenjë frike, ndonjë protestë, ndonjë lutje.

– Shumë mendim i mirë. Por pse nuk paska ardhur akoma policia? Ju keni disa orë që e dini se burri ka vdekur.

Pronari nuk bëri zë. Vetëm se vazhdoi ta shikonte Ravikun me inat.

– Ja tek po jua them unë psenë. – Raviku bëri një hap përpara. – Sepse nuk doni ta bëni të madhe për shkak të klientëve tuaj. Ka shumë njerëz që ikin nga hoteli, kur dëgjojnë diçka të tillë. Por policia do të vijë, ky është ligj! Është në dorën tuaj t'i vini kapak çështjes pa shumë zhurmë e bujë. Sidoqoftë, ju nuk e kishit aspak hallin këtu. Ju patët frikë se mos ua kishin mbathur, duke ua lënë juve të gjitha telashet. Kot u merakosët. Përveç kësaj, u trembët se mos mbeteshit duartharë. Do të paguheni. Dhe tani dua ta shoh të vdekurin. Pastaj do të kujdesem vetë për gjithë të tjerat.

Raviku kaloi përpara të zotit të hotelit.

– Ç'numër ka dhoma? – e pyeti gruan.

– Katërmbëdhjetë.

– S'është nevoja të vini me mua. Mund të mbaroj punë vetë.

– Jo. Nuk dua të qëndroj këtu.

– Do të jetë më mirë sikur të mos shikonit më asgjë.

– Jo. Nuk dua të rri këtu.

– Mirë. Si të dëshironi.

*

* *

Dhoma kishte tavan të ulët dhe binte nga rruga. Përpara derës shtyheshin disa kameriere katesh, shërbëtorë dhe garsonë. Raviku i

Erjonixx

hapi rrugë vetes me bërryla. Dhoma kishte dy shtretër; në atë pranë murit që shtrirë burri, i verdhë e i ngrirë si një figurë prej dylli, me flokë të zinj kaçurrelë dhe i veshur me një palë pizhame të kuqe prej mëndafshi. Duart ia kishin kryqëzuar mbi gjoks. Pranë tij, mbi komodinë, ndodhej një Shën Mëri e vogël prej druri nga ato që kushtonin lirë, dhe mbi fytyrën e saj dalloheshin gjurmë të kuqi buzësh. Raviku e ngriti figurinën përpjetë. *Prodhuar në Gjermani* ishte shkruar në kurrizin e saj. I hodhi një shikim fytyrës së të vdekurit; ai nuk kishte të kuq mbi buzë; as që dukej si ndonjë nga ata meshkujt që përdornin të kuq buzësh. Sytë i kishte gjysmë të hapur; njërin pak më shumë se tjetrin – kjo i jepte trupit një pamje fort mospërfillëse, a thua se kishte ngrirë në një mërzi të përjetshme.

Raviku u përkul mbi të. I soditi shishet mbi tryezën pranë shtratit dhe e kontrolloi trupin. Nuk dukej asnjë gjurmë që të dëshmonte se ishte përdorur forca. Ai drejtoi shtatin.

– Si quhej mjeku që e vizitoi? – e pyeti gruan. – Ia dini emrin?

– Jo.

Ai e vështroi. Ajo ishte shumë e zbehtë.

– Pa uluni një herë atje. Atje matanë, në karrigen që është në qoshe. Dhe mos u ngrini fare nga vendi. A ndodhet këtu ai kamerieri që jua gjeti mjekun?

Ai u hodhi një sy fytyrave të grumbulluara përpara derës. Në të gjitha dallohej e njëjta shprehje: tmerr dhe kërshëri e ethshme.

– Fransuai shërben në këtë kat, – tha një pastruese që e mbante fshesën në dorë si heshtë.

– Ku është Fransuai?

Një kamerier çau rrugën përmes grumbullit.

– Si quhej mjeku që erdhi këtu?

– Bone, Sharl Bone.

– E keni numrin e telefonit të tij?

Kamerieri rrëmoi nëpër xhepa dhe nxori një pusullë.

– Passi, 27-43.

– Mirë. – Raviku vuri re se te dera u shfaq fytyra e pronarit të hotelit. – Sikur ta mbyllnin një herë atë derë tani! Apo keni ndonjë interes që të na futen brenda edhe njerëz nga rruga?

– Jo! Jashtë! Të gjithë jashtë! E, ç'më silleni këtu vërdallë e ma harxhoni kot kohën që jua paguaj?

Hotelieri i përzuri punonjësit e vet dhe mbylli derën. Raviku ngriti dorezën e telefonit. Ai mori Veberin dhe foli një copë herë me të. Pastaj kërkoi mjekun me numrin e Passisë. Boneja i doli dhe i

Erjonixx

vërtetoi fjalët e gruas.

– Burri vdiq, – i tha Raviku. – A mund të vini pak, sa për të plotësuar çertifikatën e vdekjes?

– Ai njeri më ka nxjerrë jashtë. Në mënyrën më fyese!

– Tani s'ka për t'ju fyer më.

– Ai s'më ka paguar as honorarin. Bile më quajti hajvan, që di vetëm të zhvatë e të shkarravisë receta.

– A do të vini t'jua likuidojmë llogarinë?

– Mund të dërgoj njeri tjetër.

– Do të qe më mirë sikur të vinit vetë. Ndryshe s'do t'i merrni kurrë paratë tuaja.

– Mirë, – tha Boneja pas një ngurrimi të shkurtër. – Por unë nuk nënshkruaj gjë prej gjëje, përpara se të më paguajnë hakun. Treqind franga bën hesapi.

– Në rregull. Treqind franga. Do t'i merrni.

Raviku e vuri dorezën në vend.

– Më vjen keq që u detyruat ta dëgjoni këtë bisedë, – i tha gruas. – Nuk kishte rrugë tjetër. Ai njeri na duhet.

Gruaja filloi të nxirrte disa kartëmonedha.

– Nuk prish punë, – u përgjigj ajo. – Kjo s'është ndonjë gjë e re për mua. Ja tek janë paratë.

– Prisni edhe pak. Ai do të vijë tani. Mund t'i jepni pastaj.

– Nuk mund ta mbushnit vetë certifikatën e vdekjes? – pyeti gruaja.

– Jo, – tha Raviku. – Për këtë na duhet një mjek francez. Më mirë ai që e ka mjekuar.

*

* *

Kur Boneja doli dhe e mbylli derën pas vetes, pllakosi përnjëherësh një qetësi e thellë. Ishte më qetësi se ç'bëhet zakonisht, kur del një njeri i vetëm nga dhoma. Rrapëllima e automobilave në rrugë zuri të dëgjohej si kërcitja e një teneqeje, sikur përplasej pas një shtrese të trashë ajri, nëpër të cilën ajo depërtonte me shumë vështirësi. Pas gjithë atyre ecejakeve të orës së kaluar, tani, për herë të parë, filloi të ndihej prania e të vdekurit. Heshtja e tij madhështore e mbushte dhomën e thjeshtë, dhe nuk kishte fare rëndësi në qe veshur me pizhame mëndafshi të kuq e të ndritshëm – ai mbretëronte, po ashtu siç mund të mbretërojë edhe një palaço cirku i vdekur – ai

Erjonixx

mbretëronte, sepse nuk lëvizte më. Çdo gjë që jetonte, lëvizte... Dhe çfarë lëvizte, mund të ishte e fuqishme dhe e hijshme dhe qesharake – por nuk mund ta kishte atë madhështi të huaj e të pakapshme të asaj që s'do të lëvizte më, të asaj që do të tretej. Vetëm e përsosura e kishte këtë... Dhe njeriu bëhej i përsosur vetëm në vdekje – dhe vetëm për një kohë të shkurtër...

– Nuk ishit të martuar? – pyeti Raviku.

– Jo. Pse?

– Është ajo puna e ligjit. E trashëgimit. Policia do të bëjë një listë për sendet që ju përkasin juve dhe për ato që i përkasin atij. Tuajat do t'i merrni. Kurse të tijat i mban policia. Për të afërmit që mund të paraqiten. A kishte njeri?

– Nuk i ka në Francë.

– Ju bashkëjetonit me të?

Gruaja nuk u përgjigj.

– Kishit kohë?

– Dy vjet.

Raviku hodhi sytë përreth.

– Po valixhe s'paskeni?

– Si jo... Këtu ishin... ja, atje pranë murit... Mbrëmë atje i lashë.

– Aha, hotelieri! – Raviku hapi derën. Pastruesja bëri një kërcim nga pas me gjithë fshesë. – Moj nënë, – i tha ai, – jeni shumë kureshtare për moshën që keni! Thirreni të zotin e hotelit!

Pastruesja deshi të protestonte.

– Keni të drejtë, – e ndërpreu Raviku. – Në moshën tuaj, njeriut vetëm kureshtja i mbetet. Por, sidoqoftë, thirrmëni padronin!

Plaka seç hungëroi nëpër dhëmbë dhe u zhduk, duke e hequr fshesën zvarrë.

– Më vjen keq, – tha Raviku. – Por ndryshe nuk bën dobi. Ndoshta mund t'ju duket si sjellje e pagdhendur, por është më e udhës t'i mbarojmë punët një herë e mirë dhe sa më shpejt. Dhe ndoshta do të jetë edhe më mirë, sikur tani për tani të mos e kuptoni fare këtë punë.

– E kuptoj, – tha gruaja.

Raviku e vështroi.

– E kuptokeni?

– Po.

Hotelieri u fut në dhomë duke mbajtur një letër në dorë. Ai nuk trokiti fare.

– Ku janë valixhet? – e pyeti Raviku.

3rj0n1xx.ro0t

– Shikoni një herë llogarinë. Ja! Më parë dua të më paguani.

– Më parë të kthehen valixhet në vend. Gjer tani askush nuk ka kundërshtuar t'jua paguajë faturën. Dhoma është akoma e zënë. Dhe herë tjetër trokisni, para se të hyni. Ma jepni faturën dhe sillnani valixhet!

Hotelieri i hodhi një shikim të inatosur.

– Nuk jua ha njeri paratë, – i tha Raviku.

Padroni doli duke përplasur derën me forcë.

– Ndodhen të holla në valixhet? – e pyeti Raviku gruan.

– Unë... Jo... nuk besoj.

– E dini ku ndodhen? Ndoshta i ka në xhepat e kostumit. Apo s'ka pasur fare?

– Ai kishte para në kuletë.

– Ku është kuleta?

– Poshtë... – Gruaja ngurroi. – Zakonisht e mbante poshtë jastëkut.

Raviku u ngrit. Me kujdes e çoi pak jastëkun bashkë me kokën e të vdekurit dhe nxori që përposh një kuletë prej lëkure të zezë. Ia dha gruas.

– Nxirrini paratë dhe çdo gjë tjetër që mund të ketë rëndësi për ju. Shpejt! Nuk kemi kohë për sentimentalizma. Ju duhet të jetoni. E për çfarë tjetër vlejnë paratë? Apo të zënë myk në polici?

Për disa çaste ai vështroi jashtë dritares. Një shofer kamioni po shamatohej në rrugë me karrocierin e një karroje të tërhequr prej dy kuajsh e të ngarkuar me zarzavate të freskëta. Shoferi po e shante me atë superioritet të plotë që të jepte një motor i rëndë. Raviku i ktheu kurrizin dritares.

– Mbaruat?

– Po.

– Ma jepni kuletën!

Ai e vuri përsëri poshtë jastëkut. E ndjeu që ajo ishte më e hollë se qëparë.

– Futini ato gjëra në çantën tuaj, – tha ai.

Ajo u tregua e dëgjueshme. Raviku mori faturën dhe e shqyrtoi.

– Faturë tjetër keni paguar këtu?

– Nuk e di me saktësi. Por më duket se po.

– Kjo është një faturë për dy javë. A i paguante... – Raviku hezitoi për një çast. I dukej e çuditshme të fliste për të vdekurin duke e quajtur zoti Raçinski. – A paguheshin faturat gjithmonë në afatin e duhur?

– Po, gjithmonë. Ai thoshte shpeshherë se... në atë gjendje që

Erjonixx

ndodhej, kishte shumë rëndësi të paguante në rregull atë që i kërko-
nin.

– Ç'batakçi ky hotelieri! Mos e dini ku mund ta gjejmë atë fatu-
rën e fundit që është paguar?

Dikush trokiti në derë. Raviku nuk mundi të përmbahej pa vënë
buzën në gaz. Shërbëtori solli valixhet. Hotelieri e pasonte.

– Kaq ishin? – e pyeti Raviku gruan.

– Po.

– Natyrisht që kaq ishin! – shkrofëtiu padroni. – Ç'pandehët ju?

Raviku mori një valixhe të vogël.

– E keni çelësin e kësaj? Jo? Ku mund të jenë çelësat?

– Në dollap. Në kostumin e tij.

Raviku shkoi dhe hapi dollapin. Ai ishte bosh.

– E? – iu drejtua hotelierit.

Hotelieri iu kthye shërbëtorit.

– E? – i shfryu.

– Kostumi është jashtë, – ia bëri shërbëtori duke iu marrë goja.

– Pse?

– Për pastrim dhe hekurosje.

– Nuk besoj të jetë më nevoja, – tha Raviku.

– Sille shpejt këtu, kusar i mallkuar! – u hakërrye hotelieri.

Shërbëtori i hodhi një shikim pak të habitur, puliti sytë dhe doli. Disa çaste më vonë e solli kostumin. Raviku e shkundi një herë xha-ketën dhe pastaj i shkundi edhe pantallonat. Ndër pantallona u dëg-jua një tringëllimë. Raviku ngurroi. Ndjesi e çuditshme të fusje duart ndër xhepat e pantallonave të një vdekuri! Të dukej sikur edhe kostumi kishte vdekur bashkë me të. Por ishte edhe e çuditshme të mendoje kështu. Një kostum mbetej gjithmonë kostum. Ai nxori çelësat dhe hapi njërën nga valixhet. Sipër fare ndodhej një dosje prej meshini.

– Mos është kjo? – e pyeti gruan. Ajo bëri një shenjë pohimi me kokë.

Raviku e gjeti faturën menjëherë. Ishte e likuiduar. Ia dëftoi hotelierit.

– Keni përllogaritur një javë më tepër.

– Ashtu!? – ia plasi padroni aty për aty. – Po telashet që më ranë mbi kokë, ku i latë? Rrëmujën? Andrallat? Apo nuk i vini në hesap fare këto, ë? Po krizat e tëmthit që më zunë përsëri... mos përfshi-hen gjë në shërbim këto, ë? Ju e thatë vetë që do të më ikin klientët e tjerë! Dëmi që do të kem, është shumë më i madh! Po shtrati? Po

Erjonixx

dhoma që duhet të dezinfektohet me squfur? Po shtresat që janë fëliqur?

– Shtresat i keni vënë në faturë. Përveç kësaj, keni shënuar edhe një darkë, që na paskësh ngrënë ai mbrëmë... njëzet e pesë franga. Mos hëngrët gjë ju mbrëmë? – iu kthye Raviku gruas.

– Jo. Po sikur ta paguaj? Më mirë... Do t'i jap fund sa më shpejt kësaj pune...

T'i jap fund sa më shpejt, tha Raviku me vete. E di unë se çfarë do të ndodhte pastaj: Qetësia dhe i vdekuri... Goditjet si prej çekani të heshtjes... Më mirë të veprohet në këtë mënyrë, qoftë edhe pse është e ulët...

Ai mori një laps nga tryeza dhe filloi të bënte llogari. Pastaj ia ktheu faturën hotelierit.

– Dakord?

Padroni i hodhi një sy shumës.

– Mos pandehni se më ka lënë mendja?

– Dakord? – e pyeti Raviku edhe një herë.

– Po kush jeni ju, xhanëm? Pse i fusni hundët në këto punë?

– Jam i vëllai, – tha Raviku. – Dakord?

– Plus dhjetë për qind për shërbim e taksa. Ndryshe s'kemi gjë në vijë.

– Mirë. – Raviku e shtoi shifrën. – Keni për të paguar dyqind e nëntëdhjetë e dy franga, – i tha gruas.

Ajo nxori nga çanta tre kartëmonedha njëqindfrangëshe dhe ia zgjati hotelierit, i cili i mori dhe u nis për të ikur.

– Më ora gjashtë dhoma duhet të jetë e lirë. Përndryshe do të paguani edhe për një ditë tjetër.

– Tetë frangat e restit! – i tha Raviku.

– Po për portierin?

– Atij ia japim vetë. Edhe bakshishet po ashtu. Hotelieri, me turinj të varur, i numëroi të tetë frangat mbi tryezë.

– *Salz etranzhe!*[1] – shau ai nëpër dhëmbë dhe doli nga dhoma.

– Disa hotelierë francezë e kanë për krenari t'i urrejnë të huajt, prej të cilëve nxjerrin bukën. – Raviku e vuri re shërbëtorin, i cili qëndronte akoma te pragu me një fytyrë prej bakshishi. – Merreni...

Shërbëtori e kontrolloi një herë kartëmonedhën.

– *Mersi, mësjë*[2] – ia bëri pastaj dhe u largua.

– Tani do të vijë edhe policia e pastaj mund ta marrin, – tha

1. *Sales entrangers*: jabanxhij të ndyrë.
2. *Merci, Monsieur*: falemnderit, zotëri.

Erjonixx

Raviku dhe e vështroi gruan. Ajo rrinte e heshtur atje në qoshe, në mes të valixheve, ndërsa muzgu po depërtonte dalëngadalë në dhomë. – Kur njeriu vdes, atëherë i japin shumë rëndësi... Por kur është gjallë, askush nuk e çan kokën për të. – Ai e vështroi gruan edhe një herë. – Nuk do të ishte më mirë sikur të zbrisnit poshtë? Më duket se atje ka një si dhomë pritjeje.

Ajo tundi kokën.

– Mund të vij edhe unë me ju. Një miku im do të mbërrijë nga çasti në çast për ta rregulluar punën me policinë. Doktor Veberi. Mund ta presim poshtë.

– Jo. Dua të qëndroj këtu.

– Nuk keni ç'të bëni më. Pse doni të rrini këtu?

– Nuk e di. Ai... ai s'ka për të mbetur edhe shumë kohë këtu. Dhe unë shpeshherë... ai s'ka qenë i lumtur me mua. Shpeshherë kam ikur dhe e kam lënë vetëm. Tani dua të qëndroj këtu.

Ajo i tha ato fjalë me zë të qetë, pa sentimentalitet.

– Ai nuk i di më këto gjëra, – tha Raviku.

– Nuk është puna aty...

– Mirë. Atëherë do të merrni diçka për të pirë. Keni nevojë.

Raviku nuk e priti përgjigjen e saj, por i ra ziles. Garsoni ia mbërriti çuditërisht shpejt.

– Sillnani dy konjakë dopio.

– Këtu?

– Po. Pse, ku tjetër?

– Si urdhëroni, zotëri.

Garsoni solli dy gota dhe një shishe *Kurvuazje*. Ai i hodhi një shikim qoshes, ku shtrati i bardhë fekste në mugëtirë.

– A ta ndez dritën? – pyeti.

– Jo. Por atë shishen mund ta lini këtu.

Garsoni e lëshoi tabakanë mbi tryezë dhe ia mbathi menjëherë, duke i hedhur edhe një shikim të dytë shtratit.

Raviku e mori shishen dhe mbushi gotat.

– Pijeni. Do t'ju bëjë mirë.

Ai priste që gruaja ta kundërshtonte dhe që do t'i duhej t'ia mbushte mendjen. Por ajo e zbrazi gotën pa mënuar.

– Mos ndodhet edhe ndonjë gjë e rëndësishme në valixhet që nuk janë tuajat?

– Jo.

– Ndonjë gjë që mund të keni dëshirë ta mbani. Që është e vlefshme për ju. A s'po u hidhni një sy?

Erjonixx

– Jo. Nuk kanë gjë. Unë e di.

– As në valixhen e vogël?

– Ndoshta. Nuk e di se ç'mbante ai në të.

Raviku e mori valixhen, e vuri mbi tryezën pranë dritares dhe e hapi. Disa shishe; pak ndërresa; disa blloqe shënimesh; një kuti me bojëra uji; disa penela dhe një libër; në një të ndarë të dosjes prej meshini gjeti dy kartëmonedha të mbështjella me letër transparente. I ngriti drejt dritës elektrike.

– Këtu keni njëqind dollarë, – i tha gruas. – Merrini. Me to mund të jetoni për ca kohë. Valixhen po e vendosim pranë tuajës. Kush mund të thotë që s'ka qenë edhe ajo juaja!

– Falemnderit, – tha gruaja.

– Ndoshta tani e gjithë kjo mund t'ju duket e ulët. Por është diçka që duhet bërë. Ka rëndësi për ju, sepse fitoni njëfarë kohe.

– Nuk më duket e ulët. Veçse nuk do të mund të veproja kështu po të isha vetëm.

Raviku i mbushi gotat deri në buzë.

– Pijeni edhe këtë.

Ajo e zbrazi gotën me ngadalë.

– A ndiheni më mirë tani? – e pyeti.

Ajo e vështroi.

– As më mirë dhe as më keq. Nuk ndiej asgjë.

Ajo rrinte aty në mugëtirë, dhe trajtat mezi i dalloheshin. Nganjëherë flakërimi i kuq i ndonjë reklame i rrëshqiste përmbi fytyrë e përmbi duar.

– Nuk mund të mendoj asgjë, – foli ajo përsëri, – sa të jetë ai këtu.

*

* *

Të dy infermierët e ambulancës hoqën mbulesën e shtratit dhe afruan barelën. Pastaj e ngritën trupin dhe e shtrinë mbi të. Ata e bënin punën shpejt e shpejt, ashtu siç ua donte zanati. Raviku i rrinte gruas afër për ta ndihmuar, po t'i binte të fikët. Përpara se infermierët ta mbulonin trupin, ai u përkul dhe mori nga komodina Shën Mërinë e vogël prej druri.

– Më duket se është juaja, – i tha gruas. – A s'po e mbani?

– Jo.

Ai ia zgjati figurinën. Ajo nuk e mori. Ai hapi valixhen e vogël dhe e vuri brenda.

Erjonixx

Infermierët e ambulancës e mbuluan kufomën me një çarçaf. Pastaj ngritën barelën. Dera ishte e ngushtë, po ashtu edhe korridori jashtë. U orvatën të kalonin, por nuk ia dolën dot. Ishte e pamundur, barela takonte.

– Duhet ta heqim trupin, – tha ai më i vjetri. – Nuk e marrim dot kthesën me gjithë të.

Ai i hodhi një vështrim Ravikut.

– Ejani, – i tha Raviku gruas. – Mund të presim poshtë.

Gruaja tundi kokën.

– Mirë, – u tha ai infermierëve. – Veproni si ta shikoni të udhës.

Ata të dy e ngritën trupin duke e zënë nga këmbët e nga supet dhe e shtrinë mbi dysheme. Raviku u mat të thoshte diçka. Vështroi gruan. Ajo nuk lëvizte. Ai heshti. Infermierët e nxorën barelën jashtë. Pastaj u kthyen dhe e ngritën peshë trupin duke e nxjerrë nga dhoma në korridorin e ndriçuar prej një drite të turbullt. Raviku u shkoi pas. Ata ishin të detyruar ta ngrinin trupin shumë lart për të zbritur shkallët. Fytyrat iu skuqën dhe iu dërsinë nga pesha, dhe i vdekuri nderej përmbi ta, i rëndë si plumb. Raviku i ndoqi me sy, derisa arritën poshtë. Pastaj u kthye.

Gruaja qëndronte pranë dritares dhe vështronte jashtë. Në rrugë priste autoambulanca. Infermierët e futën barelën në të, posi një furrtar që fut bukën në furrë. Pastaj hipën në vendet e tyre, motori ulëriti sikur po këlthiste dikush që poshtë dheut dhe makina u zhduk pas qoshes duke e marrë kthesën menjëherë.

Gruaja u kthye nga ai.

– Duhej të ishit larguar që më parë, – tha Raviku. – Ç'ishte nevoja ta shihnit edhe këtë të fundit?

– Nuk mundja. Nuk mundja të largohesha prej tij. Si nuk e kuptoni?

– Mirë. Ejani tani. Pijeni edhe një gotë.

– Jo.

Veberi e kishte ndezur dritën kur erdhën ata të ambulancës dhe të policisë. Qëkur e patën nxjerrë kufomën, dhoma dukej më e madhe. Më e madhe dhe çuditërisht e vdekur, a thua se trupi kishte dalë dhe vdekja kishte mbetur vetëm.

– Dëshironi të qëndroni në këtë hotel? Sigurisht që jo.

– Jo.

– A keni ndonjë të njohur këtu?

– Jo. Asnjeri.

– Dini ndonjë hotel, ku mund të shkoni?

Erjonixx

– Jo.

– Këtu afër ndodhet një hotel i vogël, i ngjashëm me këtë. Është i pastër dhe ka nam të mirë. Mund të gjenim ndonjë dhomë për ju. Quhet hotel *Milan*.

– Po sikur të shkoja në atë hotelin, ku... në hotelin tuaj?

– Në *Internacional*?

– Po. Unë... është ... Tani e njoh pakëz... Është më mirë se sa të shkoj në një të panjohur fare.

– *Internacionali* nuk është hotel i përshtatshëm për gratë, – tha Raviku. Edhe këtë kisha mangët, mendoi me vete. Në të njëjtin hotel! Unë s'jam kujdestar të sëmurësh. E pastaj... mbase ajo pandeh se tani e ndiej veten të ngarkuar me njëfarë përgjegjësie ndaj saj. Edhe të tilla gjëra ndodhin. – Unë nuk do t'jua këshilloja, – i tha ai më me ashpërsi nga ç'kishte pasur ndër mend. – Është gjithmonë i mbushur deng me refugjatë. Më mirë të shkoni në hotel *Milan*. Në mos ju pëlqeftë, prapë keni mundësi ta ndërroni.

Gruaja i hodhi një shikim. Ai pati përshtypje që ajo ia zbuloi mendimet, dhe i erdhi pak turp. Por ishte më mirë të turpërohej për një çast e të binte rehat më vonë.

– Mirë, – tha gruaja. – Keni të drejtë.

Raviku porositi t'i zbrisnin valixhet poshtë, në një taksi. Hotel *Milani* ndodhej vetëm disa minuta larg. I zuri një dhomë dhe u ngjit lart bashkë me gruan. Ishte një dhomë në katin e dytë, me mure të veshura me tapiceri të pikturuara me trëndafila, me një shtrat, një dollap, një tryezë dhe dy karrige.

– Ju mjaftojnë këto? – pyeti ai.

– Po. Shumë mirë.

Raviku e soditi tapicerinë. Të kallte datën.

– Sidoqoftë, qenka një dhomë e pastër dhe që e zë dielli, – tha ai.

– Po.

Valixhet i sollën lart.

– Pra, tani jeni në rregull. I'keni të gjitha.

– Po. Falemnderit. Falemnderit shumë!

Gruaja u ul mbi shtrat. Fytyrën e kishte shumë të zbehtë e si të shpëlarë.

– Do të bënit mirë sikur të flinit ca. A do të jeni në gjendje?

– Do të përpiqem.

Raviku nxori nga xhepi një tubet prej alumini.

– Merrini këto hape. Janë për gjumë. Do t'i pini tani, me një gotë ujë?

Erjonixx

– Jo, më vonë.

– Mirë. Unë po shkoj tani. Do të pyes pas disa ditësh qysh i keni punët. Mundohuni të flini sa më shpejt që të jetë e mundur. Ja tek po jua lë edhe adresën e ndërmarrësit të varrimeve, po t'ju nevojitet për ndonjë gjë. Por ju mos shkoni atje. Shikoni veten. Do të pyes për ju.

– Raviku ngurroi për një çast. – Si quheni?

– Madu. Xhoanë Madu.

– Xhoanë Madu. Mirë. Do ta mbaj mend. – Ai e dinte që as do ta mbante mend dhe as do të pyeste për të. Por pikërisht psę e dinte, donte të shtirej ndryshe. – Më mirë po e shënoj, – tha ai dhe nxori nga xhepi një bllok recetash. – A s'ma shënoni ju vetë? E keni më kollaj.

Ajo e mori bllokun dhe shkroi emrin e vet. Ai i hodhi një sy, e këputi fletën dhe e futi në xhepin e palltos.

– Bini tani, – i tha gruas. – Nesër do t'i shikoni gjithë gjërat me sy tjetër. Ndoshta kjo ju tingëllon e lehtë dhe e cekët, por është e vërtetë; tani keni nevojë vetëm për gjumë dhe për pakëz kohë. Kohë që duhet ta kapërceni. E dini këtë?

– Po, e di.

– Merrini hapet dhe flini.

– Po. Falemnderit. Falemnderit për të gjitha... Nuk e di, ç'do të kisha bërë pa ju. Vërtet që nuk e di...

Ajo i dha dorën. Ishte një dorë e ftohtë, por kishte një shtrëngim të fuqishëm. Mirë, mendoi ai. Duket se tani ka marrë njëfarë vendimi.

Raviku doli në rrugë. Thithi ajrin që ishte i lagësht e i butë. Automobila, njerëz, disa prostituta që kishin zënë qoshet qysh tani, birrari, bare, erë duhani, aromë pijesh dhe erë benzine... jetë e lëkundshme dhe e rrëmbyer. Ai ngriti sytë nga fasada e hotelit. Disa dritare të ndriçuara. Prapa njërës prej tyre rrinte tani ajo gruaja, me shikimin të përhumbur diku. Ai nxori nga xhepi fletën me emrin e saj, e çori dhe e flaku në rrugë. Harrim. Ç'fjalë! Plot tmerr, ngushëllim dhe përftime! Kush mund të jetonte pa harruar? Por kush mund të harronte aq sa duhej? Pellgjet e kujtimit, që ta bënin zemrën copë e çikë. Vetëm kur s'të mbetet më asgjë, për të cilën e vlen të jetosh – vetëm atëherë je i lirë...

Ai u drejtua nga *Etuali*. Një mori njerëzish mbushte sheshin. Pas Harkut të Triumfit ishin vendosur projektorë. Ata ndriçonin varrin e Ushtarit të Panjohur. Një flamur shumë i madh blu-bardhë-kuq valëvitej në erë. Ishte njëzetvjetori i armëpushimit të 1918-s.

Qielli ishte i ngrysur dhe rrezet e projektorëve e hidhnin hijen e

Erjonixx

flamurit si të mekur, të shpëlarë e të grisur në drejtim të reve shtegtare. Dukej sikur atje një flamur i leckosur po zhytej në errësirën që sa vinte e shtohej më tepër. Një bandë ushtarake dëgjohej diku. Muzika tingëllonte e mprehtë, si kërcitje teneqeje. Askush nuk këndonte. Turma rrinte e nemitur.

– Armëpushim, – ia bëri një grua pranë Ravikut. – Burri më ra në luftën e fundit. Tani e ka radhën im bir. Armëpushim. Kushedi ç'do të na shohin sytë akoma...

Erjonixx

4

Tabela e temperaturës përmbi shtrat sapo ishte vënë dhe akoma s'përmbante ndonjë shënim. Në të qe shkruar vetëm emri: Lysienë Martine. *Byt Shomon,* rruga *Klavel.*

Mbi jastëkun e bardhë, fytyra e vajzës dukej e murrme. Ishte operuar natën që shkoi. Raviku i dëgjoi me kujdes zemrën.

– Është më mirë, - tha ai. – Transfuzioni i gjakut ka bërë një çudi të vogël. Po të rezistojë deri nesër, ia hodhi.

– Shumë bukur, – tha Veberi. – Urime. I kisha humbur shpresat. Njëqind e dyzet pulsi, tetëdhjetë tensioni; kafeinë, koraminë... keq i kishte punët!

Raviku ngriti supet:

– Këtu s'ka asgjë për të uruar. Kjo erdhi më shpejt se ajo tjetra. Ajo me zinxhirin e artë rreth këmbës. Kjo është e gjitha. – Ai e mbuloi vajzën. – Rasti i dytë brenda një jave. Në vazhdoftë kështu, keni për t'u kthyer në një klinikë për dështimet që katranosen në *Byt Shomon.* Më duket se edhe ajo tjetra andej rrinte, apo jo?

Veberi bëri një shenjë pohimi me kokë.

– Po, pikërisht në rrugën *Klavel.* Me sa duket njiheshin dhe kanë shkuar tek e njëjta mami. Bile edhe kjo erdhi po në atë kohë, në mbrëmje, si ajo tjetra. Mirë që u ndodhët në hotel, kur ju lajmërova. Thashë se nuk do të ishit aty.

Raviku e vështroi.

– Kur banon në hotel, në më të shumtën e rasteve nuk je atje mbrëmjeve. Dhomat e hotelit në nëntor s'të ngushëllojnë edhe aq fort, Veber.

– E marr me mend. Po pse vallë banoni gjithmonë në hotel?

Erjonixx

– Sepse atje ndihesh rehat dhe i lirë. Edhe je vetëm, edhe s'je.

– Ju pëlqen kjo?

– Po.

– Po kështu mund të jetonit edhe gjetkë. Sikur të merrnit me qira një apartament të vogël... po njëlloj do të ishte.

– Ndoshta. – Raviku u përkul mbi vajzën.

– Si thoni ju, Ëzheni, a nuk është kështu? – iu drejtua Veberi infermieres.

Ëzhenia ngriti sytë.

– Zoti Ravik s'ka për ta bërë kurrë këtë, – tha ajo me ftohtësi.

– Doktor Raviku, Ëzheni, – e korrigjoi Veberi. – Ai ka qenë kryekirurgu i një spitali të madh në Gjermani. Shumë më në zë se unë.

– Këtu te ne... - ia nisi infermierja dhe ndreqi syzet.

Veberi e ndërpreu me dorë:

– Mirë! Mirë! I dimë këto. Te ne shteti nuk i njeh diplomat e huaja. Budallallëk me brirë! Po ju ku e ditkeni kaq mirë që ai s'ka ndër mend të marrë apartament?

– Zoti Ravik është një njeri që ka marrë fund me të tëra; kurrë s'do të krijojë familje!

– Çfarë? – pyeti Veberi i topitur. – Çfarë thoni kështu?

– Për zotin Ravik s'ka më asgjë të shenjtë. Këtu është e keqja.

– Bravo! – ia bëri Raviku që nga shtrati i vajzës.

– Keni parë apo s'keni parë kështu?! – Veberi e vështroi Ëzhenin-në si i shastisur.

– Pa pyeteni njëherë vetë, doktor Veber.

Raviku drejtoi trupin.

– I keni rënë pikës, Ëzheni. Por kur njeriut s'i mbetet më asgjë e shenjtë, atëherë i shenjtërohet gjithçka, por tashmë në një plan më njerëzor. Atëherë njeriu e adhuron deri edhe atë shkëndijëz jete që regëtin te krimbi i tokës dhe që e shtyn të dalë herë pas here në dritë. Por ky krahasim nuk ju drejtohet juve.

– Ju s'më fyeni dot. Ju s'keni fe. – Ëzhenia shtriu me energji përparësen e bardhë mbi gjoks. – Kurse unë, lavdi zotit, e kam fenë time!

Raviku shkoi e mori pallton nga varësja.

– Kush beson, bëhet shumë kollaj fanatik. Prandaj edhe të gjitha besimet kanë kushtuar aq shumë gjak. – Ai u ngërdhesh açik. – Toleranca është bija e dyshimit, Ëzheni. Ju, me tërë atë besimin tuaj, a s'jeni më agresive ndaj meje, se ç'jam unë i pabesi, që kam marrë fund me të tëra, ndaj jush?

Erjonixx

Veberi qeshi:

– Ç'ju duhej kjo punë, Ëzheni? Mos u përgjigjni. Do të ngatërroheni më keq!

– Dinjiteti im prej gruaje...

– Mirë! – e ndërpreu Veberi. – Qëndroni në tuajën! Kjo është gjithmonë gjë e mirë. Unë po shkoj tani. Kam edhe ca punë në zyrë. Ejani, Ravik. Ditën e mirë, Ëzheni.

– Ditën e mirë, doktor Veber.

– Ditën e mirë, motra Ëzheni, – tha Raviku.

– Ditën e mirë, – iu përgjigj Ëzhenia me zor, vetëm pasi Veberi e ktheu njëherë kokën nga ajo.

*

* *

Zyra e Veberit ishte mbushur plot e përplot me mobilie të kohës së perandorisë: të bardha, të praruara dhe të brishta. Përmbi tryezën e punës qenë varur fotografi të shtëpisë e të kopshtit të tij. Pas një faqeje muri ishte një shezlong i gjerë modern. Veberi flinte në të kur i rastiste ndonjëherë ta kalonte natën atje. Klinikën e kishte pronë të vetën.

– Ç'dëshironi të pini, Ravik? Një konjak apo një *Dybone*?

– Kafe, po qe se ju ka mbetur ndopak.

– Posi jo. – Veberi vuri mbi tryezë makinën e vogël të ekspresit dhe e ndezi. Pastaj iu kthye Ravikut: – A më zëvendësoni dot sot pasdreke në *Osiris*?

– Patjetër.

– S'ju prish ndonjë punë?

– Aspak. Jam krejt i lirë.

– Në rregull. Atëherë s'do të jetë nevoja të vij enkas në qytet. Mund të punoj pak në kopsht. Do t'i kisha thënë Foshoit, por është me lejë.

– Ç'kuptim ka! – tha Raviku. – Se mos është hera e parë që po shkoj atje.

– Vërtet. Por sidoqoftë...

– Fjala sidoqoftë nuk ekziston më sot. Të paktën për mua.

– Po, ashtu është. Idiotizëm i madh që një njeri me aftësitë tuaja të mos ketë mundësi të punojë këtu zyrtarisht, por të jetë i detyruar të fshihet si kirurg kontrabandist!

– Ç'thoni kështu, Veber! Kjo tani u bë mesele e vjetër. Të gjithë

Erjonixx

mjekët e arratisur nga Gjermania këtë fat kanë pësuar.

– Megjithatë është qesharake! Ju ia bëni Dyranit operacionet më të vështira, kurse ai fiton nam!

– Më mirë që ia bëj unë e s'i bën vetë.

Veberi qeshi.

– Ç'është e vërteta, mua s'më përket të flas fare. Edhe operacionet e mia ju i bëni. Por fundja unë jam gjinekolog dhe jo kirurg specialist.

Makina e ekspresit filloi të vërshëllente. Veberi e fiku. Shkoi e mori filxhanat nga një bufe dhe i mbushi me kafe.

– Një gjë nuk kuptoj, Ravik, – tha ai. – Pse banoni akoma në atë furrik, në *Internacional?* Pse nuk merrni me qira një nga ata apartamentet e reja afër *Bua dë Bolonjës*? Ato pak mobilie që ju duhen, mund t'i gjenit kudo me çmim të lirë. Kështu, të paktën, do të dinit se ku jeni.

– Po, – tha Raviku. – Do të dija se ku jam.

– E pse nuk e bëni pra?

Raviku piu një gllënjkë kafe. Ishte e hidhur dhe shumë e fortë.

– Veber, – tha, – ju jeni një shembull i shkëlqyer i sëmundjes së epokës sonë: mendoni pa e lodhur kokën. Në fillim ju vjen keq që jam i shtrënguar të punoj këtu ilegalisht, dhe pastaj, pa një pa dy, më pyesni, pse nuk marrkam një apartament me qira.

– E ç'kanë të bëjnë këto me njëra-tjetrën?

Raviku qeshi, megjithëse po e humbte durimin.

– Po të marr një apartament, duhet të regjistrohem në polici. Për këtë më nevojitet pasaportë dhe vizë.

– Hë, po. Për këtë s'më vajti mendja fare. Po në hotel, s'ju kërkojnë dokumente?

– Edhe atje më kërkojnë. Por lavdi zotit në Paris ka disa hotele që nuk u japin edhe aq rëndësi regjistrimeve. – Raviku hodhi pak konjak në filxhanin e kafesë. – Njëri nga ata është edhe *Internacionali.* Prandaj banoj atje. Se si e rregullon e zonja e hotelit, këtë nuk di. Ma merr mendja se do të ketë ca lidhje të forta. Ose policia nuk e di vërtet, ose merr ryshfet. Sido që të jetë, ka shumë kohë që banoj atje dhe gjer më sot s'më ka ngarë njeri.

Veberi u mbështet në poltronë.

– Ravik, – tha ai, – këtë nuk e dija. Pandehja vetëm se e kishit të ndaluar të punonit. Po kjo qenka një situatë shumë e ndërlikuar!

– Është një parajsë, po të krahasohet me një kamp përqendrimi gjerman.

Erjonixx

– Po policia? Sikur t'i mbushet ndonjëherë e t'ju vijë atje?

– Në na zënçin, na fusin disa javë në burg dhe na dëbojnë jashtë kufirit. Në më të shumtën e rasteve na degdisin në Zvicër. Po ta përsërisim, hamë gjashtë muaj burg.

– Çfarë?

– Gjashtë muaj, – tha Raviku.

Veberi e vështroi gojëhapur.

– Po kjo është e pamundur! Kjo është çnjerëzore!

– Kështu thosha edhe unë, derisa u mësova.

– Si... u mësuat? Ju ka ndodhur ndonjëherë?

– Jo vetëm një herë. Tri herë. Po ashtu si edhe qindra të tjerëve. Më ndodhi në fillim fare, kur nuk i dija këto marifete dhe kur kisha akoma besim tek i ashtuquajturi humanizëm: përpara se të shkoja në Spanjë, ku s'kisha nevojë për pasaportë; pastaj mora edhe një mësim të mirë humanizmi në praktikë nga pilotë gjermanë dhe italianë. Kështu që më vonë, kur m'u desh të kthehesha përsëri këtu, e kisha mësuar zanatin.

Veberi u ngrit.

– O perëndi!... – Ai zuri të numëronte me mend. – Domethënë paskeni qenë më se një vit kot së koti në burg!

– Jo aq shumë. Vetëm dy muaj.

– Pse? Po ju thatë qëparë se, në rast përsëritjeje, dënoheshit me gjashtë muaj!

Raviku buzëqeshi lehtë.

– Po pate përvojë, nuk të quhet rast përsëritjeje: jashtë kufirit të nxjerrin me një emër... kurse ti kthehesh me një emër tjetër; e mira është të futesh nga një pikë tjetër kufitare. Kështu i shpëton burgimit. Meqenëse nuk kemi dokumente, mund të na zënë vetëm po të na njohë ndonjëri personalisht. Por kjo rastis fort rrallë. Ravik është emri im i tretë. Kam pothuajse dy vjet që po e mbaj. Që atëherë s'më ka ndodhur gjë. Siç duket më ka sjellë fat dhe dita-ditës po më hyn më shumë në qejf. Emrin tim të vërtetë mezi e mbaj mend.

Veberi tundi kokën.

– Dhe të gjitha këto vetëm e vetëm sepse nuk jeni nazist!

– Natyrisht. Nazistët pajisen me dokumente shumë të mira. Marrin edhe çdo vizë që t'u dojë qejfi.

– Ama, në ç'botë të bukur po jetojmë dhe ne! Çuditem me qeverinë tonë që nuk e rregullon këtë gjë.

– Qeveria ka disa miliona të papunë, për të cilët duhet të kujdeset në radhë të parë. Nga ana tjetër, kjo gjë nuk ndodh vetëm në

Erjonixx

Francë. Kudo njëlloj është. – Raviku u ngrit.- Mirëmbetshi, Veber. Pas dy orësh do të vij ta shoh vajzën përsëri. Do të kaloj njëherë këtej edhe natën.

Veberi e përcolli gjer te dera.

– Dëgjoni, Ravik, – i tha, – na dilni ndonjë mbrëmje andej nga ne. Ejani për darkë.

– Patjetër. – Raviku e dinte që nuk do të shkonte. – Do t'ju vij së shpejti. Mirupafshim, Veber.

– Mirupafshim, Ravik. Dhe mbajeni fjalën.

*

* *

Raviku u fut në barin më të afërt. Zuri vend pranë një dritareje, në mënyrë që ta shihte rrugën. Këtë e kishte shumë qejf – të rrinte ashtu bjerraditës dhe të ndiqte me sy njerëzit që kalonin andej pari. Parisi ishte qyteti ku s'mund ta kaloje kohën më mirë sesa kështu.

Kamerieri e fshiu tryezën dhe qëndroi në pritje.

– Një *Perno*, – tha Raviku.

– Me ujë e doni, zotëri?

– Jo. Prisni pak! – Raviku u mendua. – Mos më sillni *Perno*.

Seç ndiente diçka që duhej ta shpëlante: një si shije të hidhur. Prandaj likeri i ëmbël s'ia mbushte syrin.

– Një *Kalvados*, – i tha kamerierit. – Dopio.

– Si urdhëroni, zotëri.

E kishte fajin ftesa që i bëri Veberi. Ato fjalët e tij dhe ajo gjurmë mëshire në to: për t'i dhënë tjetrit mundësi që të kalonte një mbrëmje në gjirin e një familjeje. Francezët i ftonin shumë rrallë miqtë nëpër shtëpitë e tyre; këto punë u pëlqente t'i kryenin nëpër restorante. Ai s'kishte qenë kurrë te Veberi. Sigurisht që Veberi ia tha për të mirë, por kjo ishte diçka që s'kapërdihej lehtë. Kundër fyerjeve njeriu mund të mbrohej – por kundër mëshirës jo.

Ai piu një gllënjkë nga rakia e mollës. Ç'e shtyu t'ia tregonte Veberit arsyen pse banonte në *Internacional*? S'ishte nevoja. Veberi dinte aq sa duhej të dinte. Ai e dinte që Raviku nuk lejohej të operonte – dhe kjo ishte mjaft. Që, megjithatë, ai e fuste në punë – kjo ishte çështja e tij. Veberi fitonte në këtë mes dhe mund të merrte përsipër operacione që nuk guxonte t'i kryente vetë. Askush nuk e dinte këtë; vetëm ai dhe infermierja asistente – dhe ajo nuk kallëzonte. Po kështu ndodhte edhe me Dyranin. Vetëm se pak më me ceremoni.

Erjonixx

Kur kishte ndonjë rast operacioni, ai qëndronte pranë pacientit derisa i vinin narkozën. Pastaj vinte Raviku dhe e bënte atë operacion, për të cilin Dyrani ishte tepër plak dhe tepër i pazoti. Kur pacienti përmendej, atëherë Dyrani paraqitej përsëri pranë shtratit të tij si kirurg krenar. Raviku e shihte të sëmurin vetëm të mbuluar, njihte vetëm atë pjesë të ngushtë të trupit, të lyer me jod, që lihej zbuluar për operacion. Shpeshherë as që dinte se kë operonte. Dyrani i jepte diagnozën dhe ky fuste thikën. Ai i paguante Ravikut më pak se një të dhjetën e asaj që merrte vetë për operacionin. Raviku s'kishte ndonjë kundërshtim. Të paktën kështu ishte më mirë sesa të mos operonte fare. Me Veberin punonte mbi një bazë më miqësore. Veberi i paguante një të katërtën. Kjo ishte më e ndershme.

Raviku hodhi një sy jashtë dritares... Po tjetër? Ç'i kishte mbetur, nuk ishte shumë. Ishte gjallë – kjo i mjaftonte. Nuk kishte ndër mend të rimëkëmbte gjësend në një kohë kur lëkundej çdo gjë... të rindërtonte diçka që pas pak do të shembej përsëri. Më mirë të të shtynte rrjedha, sesa të harxhoje fuqitë; fuqia ishte e vetmja gjë që nuk mund të zëvendësohej më. Ta shtyje ishte gjithçka: ta kaloje disi, derisa të të shfaqej përsëri ndonjë cak diku. Sa më pak fuqi të harxhoje për këtë, aq më mirë ishte; ajo të mbetej pastaj për më vonë. Si mizat e dheut, duke filluar gjithnjë nga e para, të mundoheshe për të ngritur një ekzistencë borgjeze në një shekull që po shkatërrohej – kjo ishte ajo, pas së cilës ai kishte parë ta thyenin kokën shumë njerëz. Ishte një gjë prekëse, heroike dhe qesharake njëherësh – dhe e kotë. Të kalbte. Një ortek që fillon të rrokulliset, nuk pengohet dot më; kush përpiqet ta bëjë këtë, ai zihet përfund. Ishte më e udhës të prisje, dhe më vonë t'i nxirrje të mbuluarit që përposh gurëve. Kush marshonte shumë, duhej ta kishte ngarkesën të lehtë. Po kështu edhe kush arratisej...

Raviku vështroi orën. Erdhi koha për ta vizituar edhe një herë Lysienë Martinenë. Dhe pastaj do të shkonte në *Osiris*.

*

* *

Në *Osiris* prostitutat po rrinin në pritje. Në të vërtetë ato vizitoheshin rregullisht nga një mjek zyrtar; por pronares kjo nuk i mjaftonte. Ajo nuk mund të rrezikonte që ndokujt t'i ngjitej ndonjë sëmundje në lokalin e saj, prandaj kishte rënë në ujdi me Veberin që çupat të vizitoheshin edhe një herë privatisht çdo të enjte. Qëllonte që Raviku ta zëvendësonte Veberin në këtë punë.

Erjonixx

Në katin e parë pronarja kishte rregulluar dhe mobiluar një dhomë ku bëhej kontrolli. Ajo ndihej shumë krenare që, prej një viti e ca, asnjë nga klientët s'kishte marrë ndonjë sëmundje në lokalin e saj; por, me gjithë kujdesin e madh të çupave, shtatëmbëdhjetë vizitorë kishin përhapur sëmundje veneriane aty.

Rolanda, kujdestarja, i solli Ravikut një shishe konjaku dhe një gotë.

– Më duket se Marta ka diçka, – tha ajo.

– Mirë. Do ta vizitoj imtësisht.

– Qysh dje ia kam ndaluar të punojë. Ajo, natyrisht, e mohon. Por ndërresat e saj...

– Mirë, Rolandë.

Vajzat, të veshura vetëm me nga një këmishë, u futën brenda, njëra pas tjetrës. Raviku i njihte pothuajse të gjitha; midis tyre vetëm dy ishin të reja në zanat.

– Mua s'është nevoja të më vizitoni, doktor, – tha Leonia, një gaskonjase flokëkuqe.

– Pse?

– S'kam pasur klientë tërë javën.

– Po zonja ç'thotë për këtë?

– Asgjë. I kam bërë goxha xhiro me shampanjë. Nga shtatë shishe për çdo natë. Ishin tre tregtarë nga Tuluza. Të martuar. Të treve ua kishte qejfi, por druheshin nga njëri-tjetri: Secili kishte frikë se, po të binte me mua, të tjerët do t'i nxirrnin fjalë në shtëpi. Prandaj ia shtronin me të pirë; secili pandehte se, më në fund, do të mbetej vetëm. – Leonia qeshi dhe u krojt me përtesë. – Por ai që mbetej i fundit, s'ishte i zoti të lëvizte më nga vendi.

– Mirë. Por megjithatë duhet të të vizitoj.

– Si të doni. Mos ju ndodhet një cigare, doktor?

– Po, merre.

Raviku mori materialin, e shtriu në xhama dhe e ngjyrosi. Pastaj e pa preparatin në mikroskop.

– A e dini se çfarë nuk kuptoj? – ia bëri Leonia teksa po e vërente Ravikun.

– Çfarë?

– Që ju, kur i bëni këto punë, keni akoma qejf të bini me një grua.

– Këtë nuk e kuptoj as unë. Ti je në rregull. Cila e ka radhën tani?

– Marta.

Marta ishte e zbehtë, e imët dhe bionde. Kishte fytyrën e një engjëlli të Botiçelit, por fliste në zhargonin e rrugës *Blondel*.

Erjonixx

– Unë s'kam gjë, doktor!

– Shumë mirë. Do ta shohim.

– Vërtet që s'kam asgjë.

– Aq më mirë.

Rolanda hyri papandehur në dhomë. Ajo ia nguli sytë Martës. Vajza nuk foli më. E shqetësuar vështronte Ravikun. Ai e vizitoi me kujdes.

– Po s'kam gjë, doktor! Ju e dini se sa e kujdesshme që jam.

Raviku nuk i dha përgjigje. Vajza vazhdoi të fliste... iu pre goja dhe pastaj ia nisi sërish. Raviku bëri preparatin dhe e kontrolloi.

– Ti je e sëmurë, Marta, – tha ai.

– Qysh? – Me një kërcim ajo u hodh përpjetë. – Kjo s'është e mundur!

– Është e mundur.

Ajo e vështroi. Pastaj shpërtheu përnjëherësh në një rrëke të tërë sharjesh dhe mallkimesh:

– Ai derr! Ai derr i poshtër! Që në fillim s'i zura besë asaj qelbësire dinake! Ishte student, më tha, duhej ta dinte, pra! Si mos ta dinte, kopuku, kur ishte student i mjekësisë!

Raviku tundi kokën, gjithmonë e njëjta mesele... Një student i mjekësisë që kishte marrë skollamento dhe e kishte mjekuar vetë. Pas dy javësh do të ketë pandehur se qe shëruar dhe nuk i kishte rënë më pas.

– Sa do të zgjasë, doktor?

– Gjashtë javë. – Raviku e dinte se do të zgjaste më shumë.

– Gjashtë javë? Gjashtë javë pa nxjerrë asnjë grosh! Në spital? A duhet të shtrohem në spital?

– Do ta shohim. Ndoshta të kurojmë më vonë në shtëpi... po na premtove që...

– Ju premtoj ç'të dëshironi! Vetëm mos më çoni në spital!

– Në fillim duhet të shtrohesh medoemos. S'kemi si t'ia bëjmë ndryshe.

Vajza, e trembur, ia mbërtheu sytë Ravikut. Spitali u kallte datën të gjitha prostitutave. Kontrolli atje ishte shumë i rreptë. Por rrugë tjetër nuk kishte. Po të qëndronin në shtëpi, me gjithë premtimet e tyre, ato, fshehurazi, do të dilnin shëtitje pas disa ditësh e do të kërkonin klientë që të fitonin ndonjë grosh, dhe kështu do t'u ngjitnin sëmundjen.

– Zonja t'i paguan shpenzimet, – tha Raviku.

– Po unë! Unë! Gjashtë javë pa asnjë fitim! S'ka shumë ditë që

Erjonixx

bleva me këste një peliçe kunadheje të bardhë. Do të më skadojë afati dhe do të mbetem përsëri me gisht në gojë.

Ajo u shkreh në vaj.

– Eja, Marta, – i tha Rolanda.

– Ju s'do të më merrni më! Unë e di! – Marta zuri të qante me dënesa. – Ju s'do të më merrni më pastaj! Këtë nuk e bëni kurrë në raste të tilla! Do të detyrohem të dal rrugëve. Dhe të gjitha këto për faj të atij qen bir qeni!...

– Do të të marrim përsëri. Ti bëje shumë punë. Klientët të duan.

– Vërtet? – Marta ngriti sytë.

– Natyrisht. Dhe tani eja.

Marta doli bashkë me Rolandën. Raviku e ndoqi me sy. Ajo s'do të kthehej më. Padronia ishte tepër e kujdesshme në këso punësh. Stacioni i ri i Martës do të ishte ndoshta ndonjë nga ata bordelet e lira të rrugës *Blondel*. Pastaj rruga e madhe. Pastaj droga, spitali, shitja e luleve ose e cigareve. Ose, po të kishte fat, ndonjë mashkull me emrin Lui, i cili do ta zhdëpte në dru, do ta shfrytëzonte dhe, më vonë, do ta flakte përsëri në mes të katër rrugëve.

*

* *

Restoranti i hotelit *Internacional* ndodhej nën tokë. Prandaj ata që banonin atje ia kishin vënë emrin *Katakombë*. Gjatë ditës ai ndriçohej nga një dritë e mekur dhe e turbullt, që futej nga oborri përmes disa xhamash qumështi të trasha; kurse dimrit në restorant drita mbahej ndezur tërë ditën. Ajo sallë shërbente në të njëjtën kohë si dhomë duhani, dhomë shkrimi, sallon, lokal mbledhjesh dhe si vendshpëtim i atyre emigrantëve që nuk kishin dokumente; kur bëhej ndonjë kontroll nga policia, ata mund të iknin nga restoranti duke kaluar oborrin e duke u futur në një garazh, i cili i nxirrte në rrugën tjetër.

Raviku bashkë me portierin e kabaresë *Sheherezade*, Boris Marozovin, po rrinte në një qoshe të *Katakombës*, qoshe, të cilën e zonja e hotelit e quante "dhoma e palmës". Një palmë e mjeruar, e mbjellë në një vazo të madhe majolike të vendosur mbi një tryezë këmbëhollë, po ngryste atje jetën e saj. Marozovi kishte pesëmbëdhjetë vjet që jetonte në Paris. Ai ishte refugjat i Luftës së Parë Botërore, një nga ata rusët e paktë, të cilët nuk pretendonin se kishin shërbyer në ndonjë regjiment të gardës dhe nuk shisnin mend se ishin prej dere të madhe.

Erjonixx

Ata po luanin shah. *Katakomba* ishte bosh, me përjashtim të një tryeze ku rrinin disa njerëz që pinin, flisnin me zë të lartë dhe çdo pesë minuta ngrinin nga një dolli.

Marazovi i vështroi me inat.

– A mund të më thuash, Ravik, ç'është gjithë kjo potere sonte? Pse nuk shkojnë të flenë këta emigrantë?

Raviku qeshi:

– Ata emigrantët atje në qoshe nuk më interesojnë aspak. Ata janë seksioni fashist i hotelit.

– Nga Spanja? Po atje ke qenë edhe ti!

– Po, por në anën tjetër. Përveç kësaj, unë isha atje si mjek, kurse këta këtu janë monarkistë spanjollë që u ka hyrë krimbi i fashizmit. Mbeturinat e fundit; të tjerët janë kthyer me kohë matanë. Kurse këtyre nuk u është mbushur mendja plotësisht.

Marozovi vendosi gurët e vet mbi fushën e shahut.

– Atëherë me siguri që po festokan masakrën e Guernikës. Ose fitoren e mitralozave italianë dhe gjermanë mbi minatorët dhe fshatarët. Po si nuk i paskam parë asnjëherë këtu këta bandillë?

– Ata kanë vite që ndodhen këtu. Por ti nuk i ke parë, sepse nuk ha kurrë në *Katakombë*.

– Pse, ti në *Katakombë* ha?

– Jo.

Marozovi u skërmit.

– Mirë, – tha ai, – le ta kursejmë pyetjen tjetër që do të të bëja si edhe përgjigjen tënde, e cila me siguri do të ishte fyese. S'më prish punë edhe sikur të kenë lindur këtu në *Katakombë*. Vetëm të flisnin pak me zë më të ulët. Ja tek po ta hap lojën me gambitin e mbretëreshës!

Raviku përparoi me ushtarin që ndodhej përkundruall. Lëvizjet e para ata i bënë shpejt e shpejt. Pastaj Marozovi filloi ta vriste mendjen:

– Kam pas ditur dikur një variant të Aljehinit...

Njëri nga spanjollët u ngrit nga vendi, ishte një burrë me sy tepër afër njëri-tjetrit. Ai u ndal pranë tryezës së tyre. Marozovi e vështroi me qejf të prishur. Spanjolli s'para e mbante trupin fort drejt.

– Zotërinj, – tha ai me mirësjellje, – koloneli Gomes ju lutet që të pini një gotë me të.

– Zotëri, – iu përgjigj Marozovi po me aq mirësjellje, – ne sapo filluam një lojë shahu, që është e vlefshme për kampionatin e Lagjes XVII. Ju falënderojmë së tepërmi, por nuk mund të vijmë.

Erjonixx

Në fytyrën e spanjollit nuk lëvizi asnjë muskul. Tani ai iu kthye Ravikut në një mënyrë aq formale, a thua se ndodhej në oborrin e Filipit II:

– Para disa kohësh ju i patët bërë një nder kolonelit Gomes. Prandaj ai ka shumë dëshirë që, përpara se të niset, të pijë edhe një gotë me ju.

– Partneri im, – ia priti Raviku po aq formalisht, – jua shpjegoi që jemi të detyruar ta mbarojmë sonte këtë ndeshje. E falënderoni kolonelin. Më vjen jashtëzakonisht keq.

Spanjolli bëri një përkulje dhe u largua.

Marozovi vuri buzën në gaz:

– Tamam si rusët gjatë viteve të para. Mbaheshin pas titujve dhe etiketës, siç mbahen të mbyllurit pas topave të shpëtimit.. E ç'nder i paske bërë atij majmuni?

– I dhashë njëherë një recetë për purgativ. Popujt latinë i japin shumë rëndësi tretjes së mirë.

– Bukur fort. – Marozovi picërroi sytë. – Ke treguar dobësinë e vjetër të demokracisë. Një fashist, po të ishte në vendin tënd, do t'i jepte arsenik një demokrati.

Spanjolli u kthye përsëri.

– Jam kapiten Navarroja, – shpalli ai me seriozitetin e thellë të një njeriu që ka pirë shumë, por që nuk e kupton akoma. – Jam adjutanti i kolonelit Gomes. Koloneli do të largohet po këtë natë nga Parisi. Ai do të kthehet në Spanjë për t'u bashkuar me armatën e lavdishme të gjeneralisimit Franko. Prandaj dëshiron ta ngrejë një gotë me ju për lirinë e Spanjës dhe për ushtrinë spanjolle!

– Kapiten Navarro, – i tha Raviku prerazi, – unë nuk jam spanjoll.

– Ne e dimë këtë; ju jeni gjerman. – Mbi fytyrën e Navarros rrëshqiti hija e një nën qeshjeje konspirative. – Pikërisht ky është shkaku i dëshirës së kolonelit Gomes. Gjermania dhe Spanja janë mike.

Raviku e vështroi Marozovin në sy. Ironia e situatës ishte e fortë. Marozovi shtrëngoi buzët.

– Kapiten Navarro, – tha ai, – më vjen keq që jam i detyruar të ngul këmbë për ta përfunduar këtë ndeshje me doktor Ravikun. Rezultatin duhet ta nisim telegrafisht që sonte për në Nju – Jork dhe Kalkutë.

– Zotëri, – ia priti Navarroja me ftohtësi, – ne e prisnim që ju do të refuzonit; Rusia është armike e Spanjës. Ftesa i përkiste vetëm doktor Ravikut. Na u desh t'ju ftonim edhe juve vetëm e vetëm sepse

3rj0n1xx

jeni bashkë me të.

Marozovi mori një kalë që kishte fituar, e vuri mbi pëllëmbën e dorës së tij prej vigani dhe e vështroi Ravikun:

– Si thua, më duket sikur po e teprojmë me këtë teatër majmunësh?

– Po. – Raviku u kthye nga spanjolli: – Më duket se është mirë të ktheheni në vendin tuaj, djalosh. Ju po e fyeni pa të drejtë kolonelin Marozov, – i tha dhe, pa pritur përgjigje, u përkul mbi fushën e shahut. Navarroja qëndroi një çast i pavendosur. Pastaj u largua.

– Është i dehur dhe, përveç kësaj, si shumica e latinëve nuk ka as humor, – tha Raviku. – Por kjo s'do të thotë që edhe ne të mos kemi humor. Prandaj tani sapo të gradova kolonel. Me sa di unë, ti ke qenë vetëm një togeruc i mjerë. M'u duk e padurueshme që të mos kishe po atë gradë ushtarake si ai Gomesi.

– Mos fol, kalama! Më vajti në djall varianti i Aljehinit, ngaqë na bezdisën kaq shpesh. Këtë oficer e kam të humbur. – Marozovi ngriti kokën. – O perëndi, ja tek po na vjen përsëri një nga ata. Një adjutant tjetër. Ama, ç'njerëz!

– Ky është vetë koloneli Gomes. – Raviku u mbështet rehat-rehat në karrige. – Tani do të zhvillohet një diskutim midis dy kolonelësh.

– Por do të jetë shumë i shkurtër, biri im.

Koloneli ishte edhe më formal se Navarroja. Ai i kërkoi ndjesë Marozovit për gabimin e adjutantit të vet. Ndjesa u pranua. Dhe tani, meqë u kapërcyen gjithë vështirësitë, Gomesi, me ceremoni të madhe, i ftoi të pinin së bashku një gotë për shëndetin e Frankos, në shenjë pajtimi. Këtë radhë ishte Raviku ai që ia prishi.

– Por... si aleat gjerman... – Koloneli u hutua me gjithë mend.

– Kolonel Gomes, – i tha Raviku, i cili pak nga pak filloi ta humbiste durimin, – le ta lëmë situatën ashtu siç është. Ju pini për kë t'ua ketë qejfi dhe unë po luaj shah.

Koloneli u përpoq të mendohej.

– Atëherë ju qenkeni një...

– Është më mirë të mos na jepni asnjë mendim, – e ndërpreu Marozovi. – Mendimet mund të na shpien vetëm në zënkë.

Gomesi po hutohej gjithnjë e më shumë.

– Por, ju si rus i bardhë dhe ish-oficer i carit, duhej të...

– Ne s'duam asgjë. Jemi krijesa të vjetruara. Mendimet i kemi të ndryshme e megjithatë nuk ia thyejmë kokën njëri-tjetrit.

Më në fund Gomesi sikur u sqarua. Ai u ngrefos.

– Po e shoh, – tha me ton therës, – se qenkeni nga ai soji i qullët i demokratëve dhe...

– I dashuri im, – ia bëri Marozovi dhe zëri i mori papandehur një theks kanosës, – mbushuni që këtej! Duhej të ishit mbushur që përpara shumë vjetësh... për në Spanjë. Atje ta tregonit se sa trim jeni. Kurse për ju po luftojnë gjermanët dhe italianët! Mbetshi me shëndet!

Ai u ngrit më këmbë. Gomesi bëri një hap prapa dhe e vështroi Marozovin me sy të kërcyer nga habia. Pastaj ktheu majat nga kishte thembrat dhe u nis për në tryezën e vet. Marozovi u ul përsëri në karrige. Psherëtiu dhe thirri kamerieren:

– Na sillni dy *Kalvados* dopio, Klarisë.

Klarisa bëri një shenjë pohimi me kokë dhe u zhduk.

– Shpirtra besnikë ushtarakësh. – Raviku qeshi. – Arsyen e kanë të rëndomtë, por nderin e kuptojnë në mënyrë të komplikuar. Dhe kjo gjë ta rëndon jetën kur je xurxull.

– Ashtu më duket edhe mua. Por pa shih... po na vjen një tjetër. S'paskan të mbaruar. Cili do të jetë këtë radhë? Mos ndoshta vetë Frankoja?

Ishte Navarroja. Ai u ndal dy hapa larg tryezës dhe iu drejtua Marozovit:

– Kolonelit Gomes i vjen keq që s'mund t'ju dërgojë ftesë për duel. Ai duhet të largohet që sonte nga Parisi. Përveç kësaj, ka një mision aq të rëndësishëm, saqë s'mund ta fusë veten në telashe me policinë. – Ai iu kthye Ravikut: – Koloneli Gomes ju ka borxh honorarin për vizitën që i bëtë. – Ai i hodhi mbi tryezë një kartëmonedhë pesëfrangëshe të palosur dhe deshi të largohej.

– Një minutë, – i tha Marozovi. Klarisa, që sapo kishte ardhur atë çast, qëndroi pranë tij me tabakanë në dorë. Ai mori njërën prej gotave me *Kalvados*, por, si e pa një çast, tundi kokën dhe e la prapë në vend. Pastaj mori njërën prej gotave me ujë dhe ia hodhi Navarros në fytyrë. – Kjo ka për t'ju bërë esëll, – e sqaroi q etësisht. – Dhe mbajeni mend që sot e tutje se paratë nuk hidhen ashtu. Tani qërohuni që këtej, idiot mesjetar!

Navarroja, i topitur, s'luajti nga vendi, por fshiu surratin. Spanjollët e tjerë u afruan. Ishin katër veta. Marozovi u ngrit me ngadalë. Për nga gjatësia dilte një kokë sipër spanjollëve. Raviku nuk lëvizi nga karrigia, por ia qepi sytë Gomesit.

– Mos u bëni qesharak, – i tha. – Jeni të gjithë të rrumbullosur. Nuk keni as shansin më të vogël. Pas dy minutash do të dergjeni për-

Erjonixx

tokë me kërbishte të thyera. Edhe po të ishit esëll, prapëseprapë s'do të kishit asnjë shans. – Ai u ngrit më këmbë, e rroku me shpejtësi Navarron nga bërrylat, e rrotulloi nga ana tjetër duke e ngritur peshë dhe e lëshoi aq pranë Gomesit, saqë këtij iu desh të tërhiqej mënjanë. – Dhe tani lërnani rehat! Ne nuk ju ftuam të na bezdisni. – Mori pesëfrangëshin nga tryeza dhe e vuri mbi tabaka. – Kjo është për ju, Klarisë. E keni nga këta zotërinjtë këtu.

– Hera e parë që marr diçka prej tyre, – tha Klarisa. – Falemnderit.

Gomesi seç foli diçka në spanjisht. Të pestë bënë prapaktheu dhe shkuan në tryezën e tyre.

– Gjynah, – tha Marazovi. – Kisha qejf t'i zhdëpja njëherë ata birbot. Por ç'e do që kam hallin tënd, o fëmijë ilegale. A s'të vjen keq edhe ty që s'mund t'ua thyejmë dot brinjët?

– Për këta s'më vjen keq. Po ka ca të tjerë që dua t'i shtie në dorë.

Nga tryeza atje në qoshen tjetër u dëgjuan disa fjalë spanjisht. Të pestë u ngritën më këmbë. Një "hurra" gjëmoi tri herë me radhë. Gotat u lanë përsëri mbi tryezë me trokëllimë të madhe dhe grupi u largua nga salla ashtu siç u kishte hije bijve të vërtetë të Marsit.

– Për pak sa s'ia hodha surratit *Kalvadosin* tonë të dashur. – Marozovi e mori gotën e vet dhe e piu me fund. – Ja, ky taraf na qeveris sot në Evropë! Por ne a kemi qenë ndonjëherë kaq matufër?

– Po, – tha Raviku.

*

* *

Ata luajtën afro një orë. Pastaj Marozovi ngriti kokën.

– Po vjen Sharli, – tha ai. – Më duket se të kërkon ty.

Raviku ngriti kokën. Djali i portinerisë së hotelit iu afrua. Mbante në dorë një pako të vogël.

– Këtë e sollën për ju.

– Për mua?

Raviku e soditi pakon. Ishte e vogël, e mbështjellë me letër të bardhë mëndafshi dhe e lidhur. Adresë nuk kishte sipër.

– Unë nuk pres ndonjë pako. Do të jetë bërë ndonjë gabim. Kush e solli?

– Një grua... një damë... – belbëzoi djali.

– Një grua apo një damë? – e pyeti Marozovi.

– Edhe kështu edhe ashtu... diçka e ndërmjetme.

Eejonixx

Marozovi buzëqeshi:

– Je mjaft i mprehtë.

– Pakoja s'ka emër. A të tha që është për mua?

– Nuk e tha tamam ashtu. Nuk e përmendi emrin tuaj. Por tha se është për mjekun që banon këtu. Dhe... ju e njihni atë damë.

– Ta tha këtë?

– Jo, – ia plasi më në fund djali. – Por ajo erdhi para disa netësh këtu bashkë me ju!

– Dama vijnë me mua herë pas here, Sharl. Por ti duhej ta dije se ruajtja e një të fshehte është virtyti i parë i një punonjësi hoteli. Kurse nxjerrja në shesh e së fshehtës është ves i kavalierëve të shoqërisë së lartë.

– Hape pakon, Ravik, – tha Marozovi. – Edhe në mos qoftë për ty. Ne kemi bërë prapësira më të mëdha gjatë jetës sonë të mjeruar.

Raviku qeshi dhe e hapi duke nxjerrë në dritë një send të vogël. Ishte Shën Mëria e drunjtë, të cilën e kishte parë në dhomën e gruas... U mendua një hop për të rikujtuar emrin... Si quhej! Madlenë... Mad... E kishte harruar. Diçka e ngjashme... I hodhi një sy letrës së pakos se mos gjente ndonjë pusullë. S'kishte gjë.

– Mirë, – i tha djalit. – Për mua qenka.

E vuri figurinën mbi tryezë. Ajo qëndronte çuditërisht e huaj në mes të gurëve të shahut.

– Ruse ishte? – pyeti Marozovi.

– Jo. Edhe unë në fillim ashtu pandeha.

Raviku vuri re se i kuqi i buzëve ishte fshirë.

– E ç'të bëj tani me këtë?

– Gjeji ndonjë vend. Shumë gjërave mund t'u gjendet vendi. Në botë ka mjaft vend për të gjitha. Vetëm për njerëzit nuk ka.

– Atë burrin do ta kenë varrosur.

– Ajo gruaja ta dërgon?

– Po.

– Je interesuar më për të?

– Jo.

– Çudi! – tha Marozovi. – Gjithmonë na duket se kemi bërë diçka; por kur tjetri bie edhe më ngushtë pastaj, e lëmë në baltë.

– Unë s'jam institut bamirësie, Boris. Kam parë gjëra më të rënda e prapëseprapë s'kam bërë gjë. E pse të ketë rënë tani më ngushtë ajo?

– Sepse tani është me gjithë mend e vetmuar. Deri atëherë burrin e kishte akoma pranë, edhe pse të vdekur. Ai ishte mbi dhe, kurse

tani është nën dhe... është zhdukur... s'ekziston më. Kjo këtu – Marozovi tregoi me dorë Shën Mërinë – nuk është shenjë falënderimi. Është thirrje për ndihmë.

– E di si është puna, unë fjeta me të pa e ditur se ç'i kishte ndodhur, – tha Raviku. – Tani dua ta harroj këtë gjë.

– Gjepura! Ajo është gjëja më e parëndësishme në botë, derisa nuk ka dashuri në mes. Kam njohur një grua që thoshte se ishte më lehtë të flije me një burrë sesa ta thërrisje në emër. – Marozovi u përkul përpara. Koka e madhe tullace i shkëlqente në dritë. – Dëgjo të të them një fjalë, Ravik: kur kemi mundësi dhe për aq kohë sa të kemi mundësi, duhet të jemi zemërmirë... sepse gjatë jetës sonë kemi për të bërë edhe disa të ashtuquajtura gjynahe. Unë, të paktën, po. Por sigurisht edhe ti.

– Po.

Marozovi ia hodhi krahun vazos ku qe mbështjellë palma anemike. Ajo u lëkund paksa.

– Të jetosh do të thotë të jetosh nga të tjerët. Ne të gjithë hamë nga njëri-tjetri. Pra, nuk duhet ta shuajmë shkëndijën e mirësisë që na lind herë pas here. Është një gjë që të jep forcë, kur e ke jetën të vështirë.

– Mirë. Nesër do të shkoj të interesohem për të.

– Bukur fort, – tha Marozovi. – Këtu ta kisha llafin. Dhe tani lëri fjalët e shumta. Kush i ka gurët e bardhë?

5

Hotelieri e njohu menjëherë Ravikun.

– Zonja është në dhomën e saj, – i tha.

– A mund t'i telefononi që kam ardhur unë?

– Dhoma s'ka telefon. Mund të ngjiteni vetë lart.

– Në ç'numër është?

– Njëzet e shtatë.

– S'po më bie ndër mend emri i saj tani. Si quhej?

Hotelieri nuk u tregua aspak i habitur.

– Madu. Xhoanë Madu, – shtoi. – Por nuk e besoj ta quajnë vërtet kështu. Do të jetë ndonjë pseudonim artistësh, me ç'duket.

– Artistësh? Pse?

– Sepse si artiste u regjistrua. Edhe emri ashtu tingëllon, apo jo?

– Këtë nuk e di. Kam pas njohur një artist që quhej Gustav Shmid. Kurse emrin e vërtetë e kishte Aleksandër Maria, kont i Xambonës. Gustav Shmid e kishte pseudonimin si artist. Nuk tingëllon aspak ashtu, apo jo?

Hotelieri nuk kishte ndër mend të dorëzohej me kaq.

– Sot çfarë s'po ndodh, – vazhdoi ai.

– Nuk po ndodhin edhe aq shumë sa ç'i bëjnë, jo. Po të lexoni historinë, do të shihni se po jetojmë akoma në kohëra pak a shumë të qeta.

– Falemnderit, kaq më mjafton.

– Edhe mua gjithashtu. Por njeriu duhet ta kërkojë ngushëllimin ku të mundet... Në numrin njëzet e shtatë, thatë?

– Si urdhëroni, zotëri.

Erjonixx

* * *

Raviku trokiti. Askush nuk u përgjigj. Ai trokiti edhe një herë dhe dëgjoi një zë të paqartë. Sa hapi derën, e pa gruan. Po rrinte mbi shtratin pranë faqes së murit përballë dhe ngriti sytë ngadalë. Ishte e veshur po me atë kostum blu që mbante në trup kur Raviku e kishte takuar për herë të parë. Do të dukej më pak e braktisur dhe e vetmuar sikur të qe shtrirë shkujdesur, me ndonjë penjuar të hedhur përsipër. Por kështu, me kostum, e veshur për asnjeri dhe për asnjë rast, e shtyrë vetëm nga një zakon që tani ishte krejt i parëndësishëm, ajo femër të ngjallte diçka, që Ravikut i pikoi mu në zemër. E njihte këtë gjendje... kishte parë me qindra njerëz të ulur kështu, emigrantë, të përplasur në këndet më të huaja të mërgimit. Një ishull i vogël ekzistence të pasigurt... Kështu rrinin ata, pa ditur nga t'ia mbanin... Dhe vetëm forca e zakonit i lidhte akoma pas jetës.

Ai e tërhoqi derën pas vetes.

– Shpresoj se nuk ju shqetësoj, – tha dhe e ndjeu menjëherë sa pa kuptim ishin ato fjalë. E çfarë mund ta shqetësonte akoma atë grua? S'kishte asgjë që mund ta shqetësonte më.

Raviku e la kapelën mbi një karrige.

– A mundët t'i rregullonit të gjitha punët? – e pyeti pastaj.

– Po. Nuk ishin edhe aq shumë.

– Nuk patët ndonjë vështirësi?

– Jo.

Raviku u ul në të vetmin kolltuk që ndodhej në dhomë. Sustat kërcitën dhe e ndjeu se njëra ishte e këputur.

– Mos deshët të dilnit? – pyeti.

– Po. Por nuk e kisha caktuar se kur. Më vonë desha të dilja pak. S'do të shkoja gjëkund... vetëm ashtu kot. E ç'mund të bësh tjetër?

– Asgjë. Do të bënit mirë të dilnit shpesh këto ditë. Nuk njihni njeri në Paris?

– Jo.

– Asnjeri?

Gruaja ngriti kokën me një lëvizje të lodhur.

– Asnjeri... përveç jush, hotelierit, kamerierit dhe shërbyeses. – Një buzëqeshje e lehtë ia vijosi fytyrën. – S'janë shumë, apo jo?

– Jo, s'janë. A s'njihte... – Raviku u mundua ta rikujtonte emrin e të vdekurit. Por i kishte dalë mendjeje fare.

– Jo, – tha gruaja. – Raçinski nuk kishte të njohur këtu, ose mundet

Erjonixx

që unë mos t'i di, sepse nuk i kam parë kurrë. Ai u sëmur menjëherë sapo erdhëm.

Raviku s'kishte dashur të qëndronte shumë. Tani, tek e shihte gruan që rrinte ashtu si e humbur, ndërroi mendje.

– Keni ngrënë darkë?

– Jo. Por as që kam uri.

– Desha të di nëse keni shtënë gjë në gojë sot tërë ditën?

– Posi. Në drekë. Ditën e kam më të lehtë. Kurse natën...

Raviku hodhi sytë përqark. Dhoma e vogël dhe e zymtë binte erë trishtimi dhe nëntori.

– Më duket se ka ardhur koha të dilni njëherë që këtej, – tha ai. – Ejani të shkojmë ta hamë darkën bashkë.

Kishte pandehur se gruaja do ta kundërshtonte. Ajo dukej aq mospërfillëse, thua se nuk ishte e zonja ta mblidhte veten për të bërë qoftë edhe gjënë më të vogël. Por tani u ngrit menjëherë më këmbë dhe mori mushamanë.

– Kjo nuk mjafton, – i tha Raviku. – Është shumë e hollë. Nuk keni ndonjë mantel më të trashë? Jashtë bën ftohtë.

– Qëparë po binte shi...

– Shi po bie akoma. Por bën ftohtë. Nuk mund të vishni diçka tjetër poshtë? Një mantel tjetër ose të paktën ndonjë triko.

– Kam një triko...

Ajo iu afrua valixhes së madhe. Raviku vuri re se nuk kishte nxjerrë pothuajse asnjë plaçkë që andej. Gruaja mori një triko të zezë, hoqi xhaketën dhe e veshi trikon mbi bluzë. Kishte supe të drejta e të bukura. Pastaj mori edhe beretën baske dhe veshi përsëri xhaketën dhe mushamanë.

– Jam më mirë kështu?

– Shumë më mirë.

Ata zbritën shkallët. Hotelieri nuk ndodhej më atje. Në vend të tij, pranë raftit të çelësave, rrinte portieri. Ai po rendiste disa letra që kishin ardhur dhe kutërbonte i tëri hudhër. Pranë tij qe shtrirë një mace laramane dhe e sodiste.

– Akoma e keni mendjen që s'mund të hani gjë? – e pyeti Raviku kur u ndodhën jashtë.

– Nuk e di. Sidoqoftë, shumë nuk ha dot.

Raviku i bëri shenjë një taksie.

– Mirë. Atëherë do të shkojmë në *Bel Ororë*. Atje s'do të jetë nevoja të hamë darkë të bollshme.

Erjonixx

*
* *

Në *Bel Ororë* nuk kishte edhe aq shumë njerëz. Në atë orë të vonët klientët rralloheshin. Gjetën një tryezë në pjesën e sipërme të sallës, ku tavani ishte shumë i ulët. Përveç tyre atje ndodhej edhe një çift tjetër që rrinte pranë dritares dhe hante djathë, si edhe një burrë thatim, i vetëm, i cili qe shtruar përpara një pjate plot me karavidhe. Kamerieri erdhi dhe i hodhi një sy kritik mbulesës kutia-kutia të tryezës. Më në fund iu mbush mendja ta ndërronte.

– Dy vodka, – porositi Raviku. – Veç të jenë të ftohta!

– Do të pimë diçka dhe do të marrim nga një antipastë, – i tha gruas. – Besoj se kjo është ajo që ju duhet. Ky restorant është restorant antipastash. Gjë tjetër këtu nuk gjen. Sidoqoftë, as nuk të vete mendja për gjellë të tjera. Antipastat i kanë me duzina. Të ngrohta e të ftohta. Dhe të gjitha janë fort të shijshme; le ta provojmë njëherë.

Kamerieri solli vodkën dhe nxori bllokun e porosive.

– Një brokë verë të kuqe, – tha Raviku. – Keni verë *Anzhu*?

– Si urdhëroni, zotëri, *Anzhu* të hapur, të kuqe.

– Mirë. Një brokë të madhe me akull. Sillni edhe antipasta.

Kamerieri u largua. Te dera mend u përplas me një grua që kishte vënë në kokë një kapelë të kuqe me pendë palloi dhe po u ngjitej shkallëve me turr. Ajo e shtyu mënjanë dhe u derdh për nga tryeza ku rrinte ai burri thatim i karavidheve.

– Albert, – tha ajo. – Albert, mor derr...

– Shët, shët, – ia bëri Alberti dhe hodhi sytë përqark.

– S'ka shët, shët këtu! – Gruaja vuri ombrellën e lagur mbi tryezë dhe, tërë vendosmëri, u lëshua në një karrige.

Alberti nuk dukej aspak i habitur.

– E dashur, – tha ai dhe zuri të pëshpëriste: Raviku buzëqeshi dhe ngriti gotën.

– Ta pimë këtë me fund, *Salute!*

– *Salute*! – tha Xhoanë Maduja dhe piu.

Antipastat i sollën mbi tryeza të vogla me rrota gome.

– Çfarë dëshironi? – Raviku e vështroi gruan. – Mendoj se e mira e të mirave do të qe sikur t'ju zgjidhja unë diçka.

Ai mbushi një pjatë dhe ia zgjati.

– Nuk prish punë, në qoftë se nuk ju shijon. Do të vijnë edhe disa tryeza të tjera si këto. Kjo ishte vetëm sa për fillim.

Ai mbushi edhe një pjatë për vete dhe filloi të hante, pa e çarë

Erjonixx

kokën më për të. Por befas ndjeu që ajo po hante. Mori një karavidhe, e qëroi dhe ia zgjati:

– Pa provojeni njëherë. Është e mirë. Dhe tani merrni pak nga ky pashtet mëlçie. Hajeni me koren e kësaj bukës së bardhë. Kështu pra, më mirë s'ka se ku të vejë. Dhe tani pini ca verë. Është e lehtë, brusko dhe e ftohtë.

– Po e vini veten shumë në mundim për mua.

– Ashtu është. Tamam si një kryekamerier. – Raviku vuri buzën në gaz.

– Jo. Por ju po kujdeseni shumë për mua.

– Nuk ma ka ënda të ha vetëm. Kjo është e gjitha. Njëlloj si ju.

– Unë s'jam partnere e mirë.

– Përkundrazi, – ia priti Raviku. – Për të ngrënë qenkeni partnere e klasit të parë. Njerëzit llafazanë unë nuk i honeps dot. Dhe as ata që çirren me zë të lartë.

Ai hodhi sytë në drejtim të Albertit. Kapelekuqja, në atë kohë, po i shpjegonte në një mënyrë mjaft të shkoqur pse ishte një derr i tillë dhe, në fjalë e sipër, i binte tryezës me ombrellë sipas një ritmi të caktuar. Alberti e dëgjonte me durim dhe s'para dukej fort i prekur.

Mbi fytyrën e Xhoanë Madusë rrëshqiti një buzëqeshje e lehtë.

– Unë s'di të çirrem ashtu.

– Ja tek po vjen tryeza tjetër. T'i përvishemi edhe kësaj, apo doni të pini më parë një cigare?

– Më mirë një cigare.

– Në rregull. Sonte kam cigare të tjera, jo nga ato me duhan të zi.

Ai ia ndezi. Ajo u mbështet në karrige dhe e thithi tymin fort. Pastaj e vështroi Ravikun drejt e në sy.

– Është mirë kur rri kështu, – tha dhe, për një çast, atij iu duk sikur do t'ia plaste të qarit.

*

* *

Ata e pinë kafenë në *Kolize*. Lokali i madh me hyrjen nga *Shans-Elizeja* ishte i mbushur plot e përplot; megjithatë gjetën një tryezë të lirë poshtë në bar, ku gjysma e sipërme e mureve ishte e veshur me xhama; pas xhamave rrinin strukur papagaj dhe fluturonin andej-këtej zogj tropikalë me pendë lara-lara.

– A e keni vrarë mendjen gjatë kësaj kohe se çfarë do të bëni? – pyeti Raviku.

Erjonixx

– Jo, akoma.

– Kur erdhët në Paris, a kishit ndonjë plan të caktuar?

Gruaja ngurroi.

– Jo, asgjë të caktuar.

– Nuk po ju pyes i shtyrë nga kureshtja.

– E di, ju mendoni se duhet të merrem me ndonjë punë. Edhe unë atë dua. Çdo ditë ia them vetes. Por pastaj...

– Hotelieri më tha se jeni artiste. Nuk e shtyva unë të ma rrë-fente. Ma tha vetë kur e pyeta për emrin tuaj.

– E kishit harruar?

Raviku ngriti sytë, ajo e vështroi qetë.

– Jo, – tha ai. – E kisha lënë pusullën në hotel dhe aty për aty s'po më binte ndër mend.

– Po tani e dini?

– Po. Xhoanë Madu.

– S'jam ndonjë artiste e mirë, – tha gruaja. – Kam luajtur vetëm role të vogla, bile kohët e fundit, s'jam marrë fare me atë punë. Nga ana tjetër edhe frëngjishten nuk e flas aq mirë sa duhet.

– E ç'gjuhë flisni?

– Italisht. Jam rritur në Itali. Edhe pak anglisht e rumanisht. Im atë ishte rumun. Më ka vdekur. Kurse nëna është angleze; jeton akoma në Itali, por nuk e di se ku.

Raviku e dëgjonte vetëm me gjysmë veshi. Kishte filluar të mërzitej e s'po dinte qysh ta vazhdonte bisedën.

– Po përveç kësaj, a jeni marrë me ndonjë punë tjetër? – pyeti ai, sa për të thënë diçka. – Dua të them, përveç atyre roleve të vogla që keni luajtur.

– Di edhe ca gjëra që duhen ditur në këtë zanat. Pak këngë e pak vallëzim.

Ai e vështroi me dyshim. Ajo nuk ta mbushte syrin. Kishte diçka si të shpëlarë në vetvete, diçka si të fshirë, dhe s'të jepte përshtypjen se mund të ishte tërheqëse në skenë. Nuk dukej aspak si artiste. Fundja, kjo fjala "artiste" ishte një fjalë me kufij të gjerë.

– Po një gjë të tillë ju mund ta provoni më lehtë këtu, – tha ai. – Për këtë s'është nevoja ta flisni gjuhën në mënyrë të përsosur.

– Keni të drejtë. Por më parë duhet të gjej një vend. Dhe kjo është e vështirë kur nuk njeh asnjeri.

Marozovi, i shkrepi Ravikut befas në mendje. Lokali *Sheherezade!* Patjetër që Marozovi duhej të kishte haber nga këto punë. Ky mendim e gjalleroi. Marozovi e kishte shtyrë t'i futej edhe

3rj0n1xx

njëherë kësaj valleje; tani ai mund t'ia linte atij në dorë këtë grua, dhe Borisi le ta tregonte zotësinë e vet.

– A dini rusisht? – pyeti ai.

– Pak. Vetëm disa këngë. Këngë cigane. Ato u ngjajnë këngëve rumune. Por pse më pyetët?

– Njoh një njeri që merr erë nga këto punë. Ndoshta mund t'ju ndihmojë. Do t'jua jap adresën e tij.

– Kam frikë se s'do të dalë gjë nga kjo. Ndërmjetësit janë kudo njëlloj. Në këso rastesh rekomandimet s'bëjnë shumë dobi.

Raviku e vuri re që ajo kujtoi se donte ta hiqte qafe me lezet. Dhe meqë kjo ishte e vërtetë, ai zuri të protestonte:

– Njeriu, për të cilin e kam fjalën, nuk është ndërmjetës. Është portieri i *Sheherezades*. Dhe *Sheherezadja* është një klub nate në Monmartrë.

– Portier? – Xhoanë Maduja ngriti kokën. – Atëherë ndryshon puna. Portierët dinë më shumë se ndërmjetësit. Këtu mund të dalë diçka. E njihni mirë?

– Po.

Raviku u habit. Papritur e pa kujtuar ajo e kishte kthyer pllakën dhe po i fliste me një ton krejt zyrtar. Qenka mjaft e shpejtë, mendoi.

– Miku im quhet Boris Marozov, – i tha. – Ka dhjetë vjet që punon në *Sheherezade*. Aty japin gjithmonë shfaqje mjaft të pasura. Numrat e programit i ndërrojnë shpesh. Marozovi ka shumë shoqëri me drejtorin. Në mos pastë ndonjë vend të lirë për ju në *Sheherezade*, ai me siguri do t'ju gjejë një punë tjetër... gjetkë. Dëshironi ta provoni?

– Po. Kur?

– Më mirë andej nga ora nëntë e darkës. Në atë orë s'ka filluar mirë puna dhe ai ka kohë të lirë. Do ta lajmëroj.

Raviku u gëzua qysh tani kur përfytyroi surratin e thartuar të Marozovit. Filloi ta ndiente veten më mirë. Ajo pak përgjegjësi që i pati rënduar deri atëherë, tani u zhduk papritmas. Më tepër se kaq s'mund të bënte, tani ajo le të ecte me këmbët e veta.

– Mos jeni e lodhur? – e pyeti.

– Nuk jam e lodhur, – tha ajo. – Por e di që nuk është ndonjë qejf i madh të rrini këtu me mua. Ju patët mëshirë për mua dhe për këtë ju falënderoj. Erdhët e më nxorët nga dhoma ku isha strukur dhe më mbajtët me muhabet. Për mua kjo ishte gjë e madhe, sepse ka shumë ditë që s'kam këmbyer fjalë me njeri. Tani po iki. Keni bërë shumë për mua. Që në fillim. Të mos kishit qenë ju, kushedi si do të kisha përfunduar!

O perëndi, mendoi Raviku, tani ia nisi edhe këtij avazi! Ai s'e ndjeu veten mirë dhe ia qepi sytë murit prej xhami që kishte përballë. Atje, një pëllumb i qe ngjitur e s'i shqitej një papagalli. Papagalli dukej aq i mërzitur, saqë nuk merrte as mundimin ta hiqte qafe, por vazhdonte të hante, pa ia varur fare pëllumbit.

– Nuk ishte mëshirë, – tha Raviku.

– Po ç'ishte atëherë?

Pëllumbi hoqi dorë nga qëllimi i tij. Zbriti nga kurrizi i gjerë i papagallit dhe filloi të çukiste pendët. Papagalli ngriti bishtin me mospërfillje dhe lëshoi një glasë.

– Tani do të pimë një Armanjak të vjetër e të shijshëm, – tha Raviku. – Kjo është përgjigjja më e mirë që mund t'ju jap. Besomëni: unë s'para e dua edhe aq shumë shoqërinë e njerëzve. Shumë net i kaloj duke ndenjur fillikat në ndonjë qoshe. Mos ju duket gjë interesante kjo?

– Jo. Por unë jam një partnere e mërzitshme. Dhe kjo është edhe më keq se të rrish vetëm.

– Ka kohë që nuk kërkoj më partnerë. Ja tek e keni *Armanjakun* tuaj. *Salute!*

– *Salute!*

Raviku e la gotën në tryezë.

– Dhe tani le të zhdukemi nga ky kopsht zoologjik. Ju me siguri nuk keni ndër mend të ktheheni qysh tani në hotel?

Xhoanë Maduja tundi kokën.

– Mirë. Atëherë ngrihemi. Shkojmë drejt e në *Sheherezade*. Atje do të pimë. Me sa duket, për këtë kemi nevojë që të dy, dhe me këtë rast mund ta shihni vetë se ç'bëhet atje.

*

* *

Ora po shkonte tre pas mesnate. Ata qëndruan përpara hotel *Milanit*.

– A keni pirë sa duhet? – e pyeti Raviku.

Xhoanë Maduja ngurroi për një çast.

– Kur ishim në *Sheherezade*, thashë se kisha pirë mjaft. Por tani që po shoh derën e hotelit... them se nuk kam pirë aq sa duhet.

– Kësaj mund t'i gjendet ilaçi. Mbase do të ketë diçka këtu në hotel. Ndryshe shkojmë në një pijetore dhe blejmë një shishe. Ejani.

Ajo e vështroi. Pastaj vështroi derën.

– Mirë, – tha me zë të vendosur. Por prapë nuk luajti nga vendi.
– Të kthehem atje, – tha ajo. – Në atë dhomë si qivur...
– Do t'ju shpie unë. Dhe do të marrim një shishe me vete.
Portieri u zgjua.
– Ju ka mbetur gjësend për të pirë? – e pyeti Raviku.
– Dëshironi koktej shampanje? – ia ktheu menjëherë pyetjen portieri tepër i gatshëm, megjithëse gogësinte akoma.
– Jo, falemnderit. Duam diçka më të fortë. Konjak. Një shishe.
– Ç'markë? *Kurvuazje, Martel, Henesi, Biskui Dybyshe...?*
– *Kurvuazje.*
– Si urdhëroni zotëri. Sa të heq tapën, po jua sjell vetë lart.
Ata iu ngjitën shkallëve.
– E keni çelësin? – e pyeti Raviku gruan.
– Dhoma nuk është e mbyllur.
– Mund t'jua vjedhin paratë dhe dokumentet, në qoftë se e lini kështu hapur.
– Këtë mund ta bëjnë edhe sikur ta kyç.
– Keni të drejtë... Me këto farë bravash që kanë dyert... Megjithatë... kur dera është e kyçur, puna vështirësohet.
– Ndoshta. Por mua s'më pëlqen të vij këtu, fillikat vetëm, nga rruga, të marr çelësin dhe të hap një derë, për të hyrë pastaj në një dhomë të zbrazët... Kjo është njëlloj sikur të hapësh një varr. Ç'e do çelësin, kur futesh këtu... këtu, ku nuk të pret asgjë përveç disa valixheve!
– Askund nuk të pret gjë, – tha Raviku. – Të gjitha njeriu duhet t'i sjellë përherë me vete.
– Mund të jetë edhe ashtu si thoni ju. Por ashtu të paktën e gënjen veten dhe ngushëllohesh disi. Kurse këtu s'ke gjë prej gjëje...
Xhoanë Maduja hodhi mbi shtrat mushamanë dhe beretën baske dhe e vështroi Ravikun. Sytë në atë fytyrë të zbehtë i dukeshin të shndritshëm e të mëdhenj, si të ngrirë, nga një dëshpërim inatçor. Për një çast qëndroi ashtu pa lëvizur. Pastaj filloi të bridhte poshtë e përpjetë dhomës së vogël, me duart ndër xhepat e xhaketës; hapat i hidhte të gjata dhe trupin e rrotullonte me shkathtësi kur kthehej. Raviku e shikonte me vërejtje. Ajo dukej sikur qe mbushur përnjëherësh tërë forcë, rrëmbim e hijeshi, dhe dhoma ishte tepër e ngushtë për të.
Dera trokiti. Portieri solli konjakun.
– Dëshironi gjësend për të ngrënë? Pulë të ftohtë, sanduiçe...
– Kjo do të ishte humbje kohe, o vëlla. – Raviku ia pagoi të hollat

Erjonixx

dhe e përcolli. Pastaj mbushi dy gota. – Merreni. Është diçka e thjeshtë dhe barbare... por në situata të vështira primitivja është gjëja më e mirë. Stërhollimet janë të përshtatshme vetëm për kohë të qeta. Pijeni!

– Dhe pastaj?

– Pastaj pini edhe një tjetër.

– Edhe këtë e kam provuar. Por s'bën dobi. Nuk është mirë të dehesh kur je vetëm.

– Puna është të dehesh mirë. Pastaj çdo gjë rregullohet.

Raviku u ul në shezlongun e ngushtë që ishte vendosur pranë murit përballë shtratit. Ai s'e pati vënë re më parë.

– Këtu ishte ky kur e morët dhomën? – pyeti.

Ajo tundi kokën:

– U thashë që të ma sillnin. Nuk doja të flija në shtrat. Më dukej pa kuptim... shtrati, të zhveshurit dhe të gjitha... E pse? Mëngjeseve dhe ditën ndryshon puna. Por natën...

– Duhet të merreni me ndonjë punë. – Raviku ndezi një cigare. – Sa keq që nuk e takuam Marozovin. Nuk e dija që sot e kishte ditë pushimi. Shkojini nesër mbrëma. Andej nga ora nëntë. Ka për t'ju gjetur me siguri diçka. Qoftë edhe ndonjë punë në kuzhinë. Atëherë do të kishit me se të merreshit natën. Këtu e keni hallin, apo jo?

– Po. – Xhoanë Maduja reshti së shëtituri nëpër dhomë. E zbrazi gotën e konjakut dhe u ul mbi shtrat. – Kam bredhur çdo natë nëpër rrugë. Përderisa ecën, gjithçka të duket më e lehtë. Por kur rri në një vend, të duket sikur do të të shembet tavani mbi kokë...

– Nuk ju ka ndodhur ndonjë gjë kur bridhnit rrugëve? Nuk ju kanë vjedhur?

– Jo. Nuk besoj të jap përshtypjen se ia vlen barra qiranë të më vjedhin. – Ajo ia zgjati Ravikut gotën e zbrazur. – Sa dëshiroja të më ndodhte diçka! Sa shpesh kam pritur të më fliste të paktën ndokush! Por të mbetesh kështu... një hiç që bredh e asgjë tjetër!... Të të marrë malli për një palë sy që të vështrojnë, sy njeriu dhe jo vetëm gurë kalldrëmi! Të mos të duket vetja si e përzënë, si njeri i ndonjë planeti të huaj... – Ajo i hodhi flokët nga pas me një lëvizje të prerë koke dhe mori gotën nga dora e Ravikut. – Nuk e di pse po flas për këtë gjë. As që dua të flas. Por ndoshta kjo vjen sepse kam gjithë këto ditë që rri si memece. Apo sepse sonte, për herë të parë... – Ajo e preu fjalën. – Po ju sikur s'po më dëgjoni fare...

– Unë po pi, – tha Raviku. – Flisni çfarë të doni. Është natë. Askush s'po ju dëgjon. Unë dëgjoj veten time. Dhe nesër të gjitha

këto janë të shkuara e të harruara.

Ai mbështeti kurrizin në shezlong. Diku, në një dhomë, rridhte uji nga rubineti. Tubat e ngrohjes kërcisnin dhe mbi xhamat e dritares shiu vazhdonte të trokiste me gishtërinjtë e tij të butë.

– Dhe kur kthehesh pastaj përsëri dhe shuan dritën... dhe errësira të bie përsipër si një shuk pambuku me kloroformë... dhe e ndez dritën sërish dhe vështron e vështron...

Duhet të më ketë zënë pija, tha Raviku me vete. Sonte më paska zënë më shpejt se radhët e tjera. Apo e ka fajin kjo dritë e mekur? Apo të dyja? Kjo nuk është më ajo gruaja e rëndomtë e pa gjallëri. Kjo është diçka tjetër. Tani po shoh befas një palë sy. Po shoh një fytyrë për të qenë. Diçka po më vështron ashtu siç duhet... Apo janë hijet që na rrethojnë... zjarri i butë pas ballit tim, i cili po hedh dritë mbi këtë grua... shkëlqimi i parë i dehjes...?

Ai nuk po ua vinte veshin fjalëve të Xhoanë Madusë. I dinte ato fjalë dhe s'ia kishte ënda t'i dëgjonte më. Të jesh vetëm – refreni i përhershëm i jetës. Por kjo s'ishte as më e keqe dhe as më e mirë se shumë gjëra të tjera të kësaj bote. Vetëm se e zinin në gojë më tepër nga ç'duhej... Njeriu ishte gjithmonë vetëm dhe s'ishte kurrë vetëm... Befas mund të dëgjoje tingujt e ndonjë violine, që përhapeshin diku në mugëtirë. Mund të të fanitej një kopsht në kodrat e Budapestit. Mund të ndieje aromën e rëndë të gështenjave. Erën. Dhe, si zogj të vegjël qyqesh, të strukur mbi supin tënd, mund të të pushtonin papritmas ëndrrat – tamam si sytë e qyqeve që bëheshin më të ndritshëm në errësirë. Binte një natë që s'bëhej kurrë natë. Vinin disa orë kur të gjitha gratë ishin të bukura dhe ndieje mbi vete mbrëmjen me flatrat e saj të mëdha e të buta si prej fluture.

Ai u shkund dhe ngriti sytë.

– Falemnderit, – tha Xhoanë Maduja.

– Përse?

– Sepse më latë të flisja, pa më dëgjuar fare. Kjo më bëri mirë. Kisha nevojë të zbrazesha.

Raviku tundi kokën në shenjë pohimi. Ai vuri re që gota e saj qe boshatisur përsëri.

– Në rregull, – tha ai. – Këtë shishe po jua lë këtu.

Pastaj u ngrit më këmbë... një dhomë. Një grua. Asgjë më tepër. Një fytyrë e zbehtë, ku s'ndriçonte më asgjë.

– Po shkoni? – pyeti Xhoanë Maduja dhe hodhi sytë përqark, sikur të qe fshehur njeri në dhomë.

– Këtu keni adresën e Marozovit. Po ju shënoj edhe emrin që të

Erjonixx

mos e harroni. Do ta takoni nesër mbrëma në orën nëntë.

Raviku e shënoi emrin në bllokun e recetave. Pastaj e grisi fletën dhe e la mbi valixhe.

Xhoanë Maduja ishte ngritur në këmbë. Me rrëmbim mori mushamanë dhe beretën e saj. Raviku e vështroi.

– Nuk është nevoja të më përcillni.

– Nuk kisha ndër mend t'ju përcillja. E kam hallin që të mos rri këtu. Nuk dua të qëndroj në dhomë tani. Dua të bredh diku.

– Po prapë do t'ju duhet të ktheheni më vonë. A nuk është po e njëjta gjë? Pse nuk rrini këtu? Tani i kaluat disi çastet e vështira.

– Pas pak do të zbardhë. Kur të kthehem, do të jetë ditë. Dhe atëherë do ta kem më të lehtë.

Raviku iu afrua dritares. Shiu breronte akoma. Të lagështa e të murrme luhateshin në erë degët e pemëve, të ndriçuara nga drita verdhacuke e fanarëve.

– Ejani, – tha ai. – Po pimë edhe nga një gotë bashkë e pastaj bëni një sy gjumë. Ky mot s'është për shëtitje.

Ai rroku shishen. Xhoanë Maduja i qe avitur befas fare pranë.

– Mos më lër këtu, – pëshpëriti ajo me rrëmbim e me ngulm, dhe ai ndjeu afshin e ngrohtë të frymës së saj. – Mos më lër vetëm këtu... vetëm sot jo. Nuk di çfarë kam, por sot mos më braktis. Nesër do të kem guxim, por tani nuk mundem; jam ligështuar e s'kam pikë fuqie; nuk duhej të më merrje për darkë sonte... ja, tani s'mund të rri më vetëm...

Raviku vuri me kujdes shishen në vend dhe ia hoqi duart nga krahu.

– Foshnjë, – tha ai, – vjen një kohë kur, duam s'duam, mësohemi me vetminë. – Ai e soditi për një hop shezlongun. – Unë mund të fle këtu. S'ka kuptim të shkoj gjetkë tani. Më duhen disa orë gjumë. Nesër më nëntë kam për të bërë një operacion. Edhe këtu mund të fle po aq mirë sa në dhomën time. Ta zëmë sikur kam rojë nate... dhe kjo s'është hera e parë... Jeni e kënaqur?

Ajo bëri një shenjë pohimi me kokë. Akoma po qëndronte fare pranë tij.

– Më shtatë e gjysmë më duhet të dal. Është shumë herët dhe kam frikë se mos ju zgjoj.

– S'ka gjë. Do të ngrihem e do t'ju përgatis mëngjesin, të gjitha do t'jua...

– Ju s'do të bëni asgjë, – i tha Raviku. – Do ta ha mëngjesin në kafenenë më të afërt, si çdo punëtor me mend; kafe me rum dhe

qifle. Hallet e tjera mund t'i kryej në klinikë. S'do të jetë keq sikur t'i them Ëzhenisë të më rregullojë një banjë... Mirë pra, po rrimë këtu. Dy shpirtra të humbur në muajin e trishtë të nëntorit. Ju bini në shtrat. Po të doni, mund të zbres poshtë e të bëj pak muhabet me portierin plak, gjersa të mbaroni punët tuaja.

– Jo, – tha Xhoanë Maduja.

– Nuk do t'ju iki. Le që na duhen edhe disa sende... jastëk, mbulesë...

– Mund t'i bie ziles e t'i kërkoj.

– Këtë mund ta bëj edhe unë. – Raviku kërkoi sustën e ziles. – Është më mirë që me këtë punë të merret një burrë.

Portieri ia behu shpejt. Në dorë mbante një shishe të dytë konjaku.

– Ju po na mbivlerësoni, – tha Raviku. – Falemnderit shumë! Ne i përkasim brezit të pasluftës. Na mjafton një batanije, një jastëk dhe një çarçaf. Më duhet të fle këtu. Jashtë bën shumë ftohtë dhe bie shi. Ka dy ditë që u ngrita nga shtrati pas një pleuriti të rëndë. Mund të m'i rregulloni ato që ju kërkova?

– Patjetër, zotëri. E kisha marrë me mend që do të flinit këtu.

– Në rregull. – Raviku ndezi një cigare tjetër. – Po dal pak në korridor dhe po sodis këpucët përpara dyerve. Është një sport, me të cilin merrem prej kohësh. Mos kini frikë. Nuk iki, – shtoi kur vuri re shikimin e Xhoanë Madusë. – Nuk jam Josifi i Egjiptit që braktisi gunën e vet.

*

* *

Portieri i solli sendet e kërkuara. Kur e pa Ravikun tek rrinte në korridor, u hutua dhe ngriu në vend. Pastaj mbi tiparet e tij rrëshqiti një buzëqeshje.

– Këtë sjellje rrallë e has te burrat, – tha ai.

– Edhe unë rrallë e bëj. Vetëm për ditëlindje dhe krishtlindje. M'i lini këtu, se i fus vetë brenda. Po kjo ç'është?

– Borsë me ujë të ngrohtë... meqë paskeni hequr pleurit...

– Mrekulli! Por mushkëritë e mia unë i ngroh me konjak.

Raviku nxori nga xhepi disa kartëmonedha.

– Zotëri, ju sigurisht nuk keni pizhame. Mund t'ju jap unë një palë.

– Falemnderit, vëlla. – Raviku e vështroi plakun. – Me siguri do të më bien të vogla.

– Përkundrazi, do t'ju bien tamam. Janë krejt të reja. T'ju them të drejtën, një amerikan m'i fali para ca kohësh. Kurse atij ia pati falur një zonjë. Unë s'mbaj gjëra të tilla. Jam mësuar me këmishë nate... Janë krejt të papërdorura, zotëri.

– Mirë, m'i sillni lart. T'i shoh njëherë.

Raviku priti në korridor. Përpara dyerve ishin nxjerrë tri palë këpucë. Një palë me qafa e me gomë të shkolitur. Pas derës së asaj dhome dëgjohej një e gërhitur e fortë. Të tjerat ishin një palë këpucë gjysma burrash dhe një palë lustrafini grash me taka të larta. Qenë vendosur përpara së njëjtës derë dhe dukeshin çuditërisht të vetmuara, megjithëse rrinin pranë e pranë.

Portieri solli pizhamet. Ishin vërtet të mrekullueshme. Mëndafsh artificial blu me yje të arta. Raviku i kundroi një copë herë gojëhapur. Pastaj e kuptoi pse i kishte falur amerikani.

– Të bukura, ë? – e pyeti portieri me krenari.

Pizhamet ishin të reja. Bile ndodheshin akoma në kutinë prej kartoni të dyqanit *Dy Luvrë*, ku qenë blerë.

– Gjynah, – tha Raviku. – Do të kisha shumë dëshirë ta shihja atë zonjën që i ka zgjedhur.

– Mund t'i përdorni për sonte. S'është nevoja të m'i blini, zotëri.

– Sa kushton, sikur t'i marr me qira?

– Jepni sa të dëshironi.

– Ju s'jeni francez?

– Posi jo! Nga Sen Nazari.

– Atëherë qenkeni prishur duke ndenjur me amerikanët. Sidoqoftë, për këto farë pizhamesh asgjë s'më duket e shtrenjtë.

– Gëzohem që po ju pëlqekan kaq shumë. Natën e mirë, zotëri. Nesër vij e i marr nga zonja.

– Do t'jua dorëzoj vetë nesër në mëngjes. Zgjomëni më shtatë e gjysmë. Trokitni avash se ju dëgjoj. Natën e mirë, pra!

*

* *

– Pa vështroni se ç'kam! – i tha Raviku Xhoanë Madusë dhe i tregoi pizhamet. – Kostum për plakun e Vitit të Ri. Ky portieri na qenka magjistar. M'u mbush mendja që t'i vesh. Që të bëhesh qeshajen e nevojshme.

rak s'të mjafton vetëm guximi, por duhet të kesh edhe moskokëçar-

Ai rregulloi mbulesat në shezlong. Për të ishte njëlloj se ku flinte

– në hotelin e tij apo këtu. Në korridor i kishte zënë syri një banjë që ta mbaronte punën disi, dhe portieri i pati sjellë një furçë të re dhëmbësh. Të gjitha të tjerat nuk i bënin përshtypje. Ajo gruaja atje zëre se ishte një paciente.

Ai mbushi një gotë uji me konjak, mori edhe njërën nga gotat e vogla që kishte sjellë portieri dhe i vuri të dyja pranë shtratit.

– Besoj se këto ju mjaftojnë, – tha pastaj. – Kështu është më kollaj. S'do të kem nevojë të ngrihem e t'ju hedh konjak. Shishen dhe gotën tjetër po e marr me vete.

– Gota më e vogël nuk më duhet. Mund të pi nga e madhja.

– Aq më mirë.

Raviku u shtri në shezlong. I pëlqeu që gruaja s'po e çante më kokën në ndihej rehat atje ku ishte rregulluar. Ajo e kishte arritur atë që deshi; tani mirë që s'po i tregonte virtytet e tepërta të zonjës së shtëpisë.

Ai mbushi një gotë plot dhe e vuri shishen në dysheme.

– *Salute!*

– *Salute*! Dhe falemnderit!

– Jemi në rregull. T'ju them të drejtën, s'ma kishte qejfi aspak të dilja nëpër shi.

– Akoma bie shi?

– Po.

Trokitja e ngadaltë depërtonte nga jashtë në heshtjen e dhomës; dukej sikur diçka kërkonte të hynte brenda... diçka e murrme, e brengosur dhe e paformë, diçka më e trishtuar se vetë trishtimi... një kujtim i largët, anonim, një valë e pafund që avitej dhe që donte të merrte përsëri me vete e të varroste në gjirin e saj atë që e kishte pas sjellë dikur dhe e kishte pas harruar në një ishull: një grimëz njeri, një grimëz dritë, një grimëz mendim...

– Natë e përshtatshme për të pirë.

– Po... Dhe e padurueshme për të qëndruar vetëm.

Raviku heshti një copë herë.

– Me vetminë na u desh të mësohemi të gjithë, – tha ai pastaj. – Ajo që dikur na mbante të bashkuar, sot ka marrë fund. Tani jemi rrokullisur sa andej-këtej, si rruazat e një gjerdani që i është këputur filli. Asgjë s'është më e qëndrueshme. – Ai e mbushi përsëri gotën e vet. – Kur isha akoma djalë, fjeta një natë në fushë. Ishte verë dhe qielli qe shumë i qartë. Përpara se të më zinte gjumi, pashë Orionin përmbi pyjet tej në horizont. Pastaj u zgjova në mesnatë dhe Orioni qëndronte tani lart, mu sipër kokës sime. Këtë nuk e harrova kurrë.

Kisha mësuar se Toka është një yll që rrotullohet; por e kisha mësuar ashtu siç mësohen shumë gjëra të shkruara ndër librat e shkollës dhe nuk e kisha vrarë mendjen tamam. Tani, për herë të parë, e ndjeva që ishte vërtet ashtu. E ndjeva se si Toka po fluturonte pa zhurmë nëpër hapësirën e pamat. E ndjeva aq fort, sa më erdhi të mbahesha për të mos u gremisur tatëpjetë. Ndoshta kjo më ndodhi meqë, duke u zgjuar nga një gjumë i thellë dhe duke qenë i braktisur për një çast nga kujtesa e zakoni, vështrova drejt në qiellin e largët e të pakufishëm që kishte shkarë. Kështu, papritur e pa kujtuar, Toka për mua s'ishte më e qëndrueshme... – Ai e zbrazi gotën. – Kjo vështirëson shumë gjëra, por edhe lehtëson shumë gjëra. – Ai hodhi sytë nga Xhoanë Maduja. – Nuk e di sa jeni në gjendje të më dëgjoni, – i tha. – Por në qofshi e kapitur, mos më jepni përgjigje fare.

– Akoma s'jam lodhur. Edhe pak. Kam edhe një vend që rri zgjuar. Zgjuar dhe i ftohtë.

Raviku e lëshoi shishen përdhe. Nga ngrohtësia e dhomës depërtoi gjer tek ai lodhja, kapitja e murrme... Hijet filluan të zbresin e ta rrethojnë. Flatrat e natës. Një dhomë e huaj, natë dhe jashtë – si trokitje e shurdhër tamburësh – reshja monotone e shiut... Një kolibe me pak dritë të mekur buzë greminës së kaosit... një zjarr i vogël në xhunglën e pakuptimtë... një fytyrë, së cilës i flisje...

– Po juve a ju ka qëlluar ta ndjeni këtë? – pyeti ai.

Ajo heshti pak.

– Po. Por jo kështu. Tjetërsoj. Kur nuk flisja me njeri ditë me radhë, kur sorollatesha natën rrugëve dhe shihja kudo njerëz që e kishin vendin diku, që kishin ku të shkonin, diku nën një strehë. Kurse vetëm unë nuk shkoja gjëkundi. Atëherë dalëngadalë e gjithë bota më dukej si e paqenë, sikur isha mbytur dhe bridhja nëpër një qytet të huaj, të cilin e kishte mbuluar uji...

Jashtë dikush po u ngjitej shkallëve. Një çelës kërkëlliti në bravë dhe një derë u hap e u mbyll. Menjëherë u dëgjua vërshimi i ujit nga rubineti.

– Pse rrini në Paris, kur nuk njihni njeri këtu? – pyeti Raviku. Ai e ndjeu se po i vinte gjumë.

– Nuk e di. E ku të shkoj gjetkë?

– Nuk keni asgjë tek e cila të mund të ktheheshit?

– Jo... Pastaj, mua më duket se njeriu nuk kthehet dot gjëkundi. Era e përplasi shiun me vrull mbi xhamat e dritares.

– Pse erdhët në Paris? – e pyeti Raviku.

Xhoanë Maduja nuk u përgjigj. Ai pandehu se e kishte zënë gjumi.

– Raçinski dhe unë erdhëm në Paris sepse donim të ndaheshim, – tha ajo pastaj.

Raviku i dëgjoi ato fjalë pa u habitur. Kishte disa çaste në jetë para pak kohësh filloi të villte. Rënkimet e tij të mbytura dëgjoheshin nëpërmjet derës.

– Po atëherë pse ishit aq e dëshpëruar? – pyeti Raviku.

– Sepse ai vdiq! Vdiq! Sepse përnjëherësh nuk ndodhej më këtu! Nuk mund të kthehej më që andej ku shkoi! Vdiq! Nuk mund të ndreqej më asgjë! Si nuk e kuptokeni!

Xhoanë Maduja qe ngritur përgjysmë në shtrat dhe ia kishte mbërthyer sytë Ravikut... Sepse ai iku, përpara se të mund të ikje ti. Sepse të la vetëm, përpara se ti të ishte përgatitur...

– Unë... unë duhej të isha sjellë ndryshe me të... unë isha...

– Harrojeni këtë. Pendimi është gjëja më e pavlerë në botë. Asgjë nuk mund të kthehet që andej ku ka shkuar. Asgjë nuk mund të ndreqet më. Ndryshe ne të gjithë do të ishim shenjtorë. Jeta nuk ka pasur ndër mend të na bënte të përsosur. Ai që është i përsosur, e ka vendin në ndonjë muzeum.

Xhoanë Maduja nuk u përgjigj. Raviku vuri re se si piu dhe se si u mbështet në jastëk. Ai vuri re edhe diçka tjetër... por ishte tepër i lodhur, saqë ta vriste mendjen shumë. Nuk i bënte asnjë përshtypje. Donte të flinte. Nesër duhej të operonte. Të gjitha këto nuk i interesonin më. Ai vuri gotën e zbrazur në dysheme, pranë shishes. Çudi se ku zbarkon nganjëherë njeriu, tha me vete.

6

Kur hyri Raviku, Lysienë Martinenë e gjeti pranë dritares.

– Si ju duket, – pyeti ai, – tani që u ngritët për herë të parë nga shtrati?

Vajza e vështroi, pastaj hodhi sytë jashtë, në atë pasdreke ngjyrëhiri dhe përsëri i ktheu nga ai.

– Sot nuk kemi mot të mirë, – tha Raviku.

– Pse jo? – ia priti vajza. – Për mua është i mirë.

– Si kështu?

– Sepse nuk jam e detyruar të dal në rrugë.

Ajo rrinte e mbledhur kruspull në një karrige dhe mbi supe kishte hedhur njëròbdëshambrë pambuku nga ato të lirat fare – një krijesë e imët, me dhëmbë të prishur, që s'ta mbushte syrin kurrsesi; por Ravikut, në ato çaste, i dukej më e bukur se Helena e Trojës. Ajo ishte një copëz jete që ai e kishte shpëtuar me duart e veta. Në të vërtetë s'kishte pse të krenohej edhe aq shumë: një jetë gruaje e pati humbur përsëri dhe në fund fare i humbisje të gjitha, bile edhe vetveten. Por, sidoqoftë, këtë këtu e kishte shpëtuar tani për tani.

– Nuk i thonë shaka të çosh kapela te klientët në këtë farë moti, – tha Lysiena.

– Pse, ju çonit kapela?

– Po. Punoja te zonja Lanver. Tek ajo që e ka dyqanin në *avënynë Matinjo*. Na duhej të punonim gjer në orën pesë. Pastaj kisha për detyrë t'i çoja te klientët kapelat ndër kutia kartoni. Tani është ora pesë e gjysmë. Në këtë kohë do të isha në udhë e sipër... – Ajo hodhi një shikim jashtë në rrugë. – Sa keq që s'po bie më shi. Dje binte me shtamba.

Raviku shkoi dhe u ul përkarshi, mbi parvazin e dritares. Çudi, tha me vete. Gjithmonë të duket sikur njerëzit që shpëtojnë nga vdekja duhet të jenë pafundësisht të lumtur. Kurse në të vërtetë nuk janë pothuajse kurrë. As kjo vajzë nuk është. I ndodhi një mrekulli e vogël dhe ajo që i intereson më shumë në këtë mes, është se nuk do të jetë e detyruar të bredhë nëpër shi.

– Si ndodhi që erdhët pikërisht në këtë klinikë, Lysienë? – e pyeti.

Ajo e vështroi me druajtje.

– Ma tregoi dikush.

– Kush?

– Një e njohura ime.

– Cila e njohur?

Vajza ngurroi.

– Një e njohur që ka qenë vetë këtu. E pata përcjellë unë gjer te dera. Prandaj e dija.

– Sa kohë ka?

– Një javë përpara se të vija unë.

– Mos ishte ajo që vdiq gjatë operacionit?

– Po.

– E megjithatë ju erdhët këtu?

– Po, – tha Lysiena pa u turbulluar. – Pse të mos vija?

Raviku nuk e tha atë që deshi të thoshte. Ai vetëm se e sodoti atë fytyrë të hequr e të ftohtë, që dikur kishte qenë e butë dhe që jeta e kishte ashpërsuar aq shpejt.

– Mos keni shkuar më parë edhe ju tek e njëjta mami? – e pyeti vajzën.

Lysiena nuk iu përgjigj.

– Apo tek i njëjti mjek? Mund të ma thoni pa frikë. Unë nuk ua di emrat.

– Maria kishte qenë atje përpara meje. Nja dhjetë ditë më parë.

– Dhe ju shkuat më pas, megjithëse e dinit çfarë i ndodhi Maries?

Lysiena ngriti supet.

– E ç'të bëja? Duhej të përplasesha atje, megjithëse ishte punë me zarar. Njeri tjetër nuk njihja. Të bëhesha me fëmijë... e ku të mbytes-ha pastaj me fëmijën? – Ajo i hodhi sytë jashtë dritares. Në një ball-kon përballë qëndronte një burrë në këmishë e në pantallona të mbajtura me tiranda llastiku; në dorë kishte një ombrellë të hapur. – Edhe sa kohë duhet të rri këtu, doktor?

– Edhe nja dy javë.

– Edhe nja dy javë?

– Nuk janë shumë. Po pse pyesni?

– Kushton, kushton shumë...

– Ndoshta mund t'ju nxjerrim disa ditë përpara.

– Kujtoni se do të jem në gjendje të paguaj? Nuk kam aq para. Është shtrenjtë. Tridhjetë franga dita.

– Kush jua tha këtë?

– Infermierja.

– Cila? Ëzhenia, me siguri...

– Po. Ajo më tha se operacioni dhe bandazhet do të paguhen veç. Më vete shumë, doktor?

– Operacionin e keni paguar.

– Infermierja më tha se ato të holla ishin shumë pak.

– Këto punë nuk i di infermierja, Lysienë. Më mirë pyesni doktor Veberin.

– Do të desha ta merrja vesh sa më shpejt.

– Pse?

– Se pastaj mund ta llogaris më mirë, sa kohë do të më duhet të punoj për t'i nxjerrë këto shpenzime. – Lysiena u hodhi një sy duarve të veta. Gishtërinjtë i kishte të hollë e të shpuar nga gjilpërat. – Më duhet të paguaj edhe një muaj qira për dhomën time, – tha ajo. – Kur erdha këtu ishte data trembëdhjetë. Më pesëmbëdhjetë duhej ta lajmëroja të zonjën e shtëpisë. Kurse tani jam e shtrënguar ta paguaj gjithë muajin. Kot së koti.

– S'keni njeri që t'ju ndihmojë?

Lysiena ngriti kokën. Fytyra i mori befas një shprehje të shuar, thua se ishte plakur dhjetë vjet përnjëherësh.

– Ju e kuptoni vetë, doktor! Ai s'bëri gjë tjetër veçse i vari turinjtë. Nuk e dinte që isha aq budallaçkë. Ndryshe s'do të ishte mplekur kurrë me mua.

Raviku pohoi me krye. Kjo s'ishte ndonjë gjë e re.

– Lysienë, – tha ai, – po sikur ta provonim se mos nxirrnim ca të holla nga ajo gruaja që vuri dorë herën e parë. Ajo e kishte fajin. Mjafton të na tregoni emrin e saj.

Vajza u shkund dhe drejtoi menjëherë trupin. E gjithë qenia e saj shprehte kundërshtim.

– Me ndihmën e policisë? Jo... se atëherë do të bie vetë brenda.

– Pa ndihmën e policisë. Vetëm do ta kërcënojmë.

Ajo qeshi hidhur:

– Me këtë metodë s'do të nxirrnim asnjë grosh prej saj. Ajo është e rrahur me vaj e me uthull. M'u desh t'i numëroja treqind franga në dorë. Dhe përse... – Vajza shkoi dorën mbi robdëshambrë. – Ç'të bësh? Ja që disa njerëz nuk kanë fat në këtë botë, – tha ajo pa pikën e keqardhjes, thua se fliste për dikë tjetër e jo për vete.

– S'është ashtu, – ia priti Raviku. – Ju patët shumë fat.

*

* *

Ai e pa Ëzheninë në sallën e operacionit tek po merrej me pastrimin e instrumenteve të nikeluara. Ishte një nga kënaqësitë e saj më të mëdha. Aq fort qe dhënë pas asaj pune, saqë nuk e dëgjoi fare kur hyri.

– Ëzheni, – tha ai.

– Ah, ju qenkeni! Pse jua ka ënda t'i trembni gjithmonë njerëzit?

– Nuk ma merr mendja të kem aq shumë personalitet sa t'ju tremb. Por ju nuk duhet t'i trembni pacientët me përrallat që u rrëfeni për punë honorarësh e shpenzimesh.

Ëzhenia kërceu menjëherë nga vendi:

– Prostitutkës nuk i qenka duruar pa llapur. S'do mend!...

– Ëzheni, – tha Raviku, – ka më shumë prostituta ndërmjet grave që s'kanë fjetur kurrë me një burrë, se sa ndërmjet atyre që janë të detyruara të nxjerrin bukën e gojës me atë zanat të vështirë. Pa le pastaj gratë e martuara... më mirë të mos i përmendim fare. Por sidoqoftë, vajza nuk ka llapur. Ju e keni fajin, sepse ia prishët humorin dhe e futët në mendime. Kjo është e gjitha.

– Punë e madhe! Na qenka dhe i ndjeshëm ky soj, pale!

Ah, ti soj gjithë moral, ti ungjill shëtitës predikimesh, tha Raviku me vete. Ti thes i shpuar virtytesh! Ku e kupton ti dot vetminë e kësaj modistre varfanjake, e cila pati guximin t'i trokiste në derë po asaj mamie që e mori në qafë shoqen e saj, dhe erdhi po në atë spital ku vdiq ajo tjetra... dhe e cila nuk thotë gjë tjetër, veçse: E ç'të bëja? Dhe: Si do t'i paguaj paratë?...

– Do të bënit mirë sikur të martoheshit, Ëzheni, – i tha ai. – Të merrnit një burrë të ve me fëmijë. Ose ndonjë ndërmarrës varrimesh.

– Zoti Ravik, – tha Ëzhenia tërë dinjitet, – ju lutem shumë mos u përzieni në çështjet e mia private! Ndryshe do të ankohem te doktor Veberi!

– Ju dhe kështu i ankoheni tërë ditën për mua. – Raviku vuri re

me gëzim se si Ëzhenisë iu formuan dy pulla të kuqe në faqe. – Mund të më thoni, Ëzheni, pse vallë njerëzve fetarë shumë rrallë u pëlqen e drejta? Karakterin më të mirë e kanë cinikët; kurse ata që nuk durohen fare, janë idealistët. A s'ju shtyn kjo që t'ia vini pak gishtin kokës?

– Lavdi Zotit jo.

– E mora me mend. Unë po shkoj tani në *Osiris*, do t'u bëj një vizitë fëmijëve të mëkatit. Në më kërkoftë doktor Veberi, ta dini se ku ndodhem.

– Nuk besoj që doktor Veberi do t'ju kërkojë.

– Të jesh virgjëreshë nuk do të thotë të jesh edhe orakull, Ëzheni. Ndoshta ai mund të ketë ndonjë punë me mua. Deri në orën pesë do të jem atje. Pastaj mund të më gjejë në hotelin tim.

– Ama për hotel që është ai kotec çifutësh!

Raviku u kthye me vrull:

– Ëzheni, të gjithë refugjatët nuk janë çifutë. Bile as të gjithë çifutët nuk janë çifutë. Dhe ka disa që janë, por që s'të mbushet mendja fare që janë të tillë. Unë pata rast të njihja një zezak çifut. Ishte njeri tmerrësisht i vetmuar. E vetmja gjë që i pëlqente, ishin gjellët kineze. Kështu e ka kjo botë.

Infermierja nuk iu përgjigj. Ajo po fërkonte me leckë një pllakë të nikeluar, që ishte krejt e pastër.

*

* *

Raviku po rrinte në një bar të rrugës *Buasierë* dhe po sodiste ashtu kot jashtë dritareve të lagura nga shiu, kur, papritur e pa kujtuar, i zuri syri atë burrin. Iu duk sikur e goditi dikush me forcë në stomak. Në çastin e parë ndjeu vetëm tronditjen, pa e ditur çfarë ishte – por pastaj, menjëherë, shtyu tryezën mënjanë, brofi nga karrigia dhe i hapi rrugë vetes nëpër lokalin e mbushur plot me njerëz, duke çarë përpara drejt derës.

Dikush e zuri me forcë për krahu. Ai u kthye me rrëmbim.

– Ç'është? – pyeti i hutuar. – Ç'është?

Ishte kamerieri.

– Nuk keni paguar, zotëri.

– Si?... Ah, po... Tani kthehem... – Ai e tërhoqi krahun.

Kamerieri erdhi e u skuq në fytyrë.

– Te ne s'ka kështu...

– Merreni! – Raviku nxori një kartëmonedhë nga xhepi, ia la

kamerierit në dorë dhe hapi derën. Kaloi me të shtyra një grup njërëzish dhe u derdh nga e djathta në kthesën e rrugës *Buasierë*.

Dikush ia këputi një të share nga prapa. Ai e mblodhi veten, pushoi së renduri dhe vazhdoi udhën me nxit, duke u përpjekur të mos binte në sy. Është e pamundur, mendoi. Është krejtësisht e pamundur, unë jam çmendur, s'ka si të jetë! Ajo fytyrë, ajo fytyrë duhej të ketë qenë ndonjë ngjashmëri, ndonjë ngjashmëri e poshtër, e mallkuar, një lodër e marrë që po ma punojnë nervat e mia... Ajo fytyrë s'ka si të ndodhet në Paris... Ajo është në Gjermani, në Berlin... Xhami i dritares kishte qenë i veshur nga shiu, nuk mund të dalloja qartë nëpërmjet tij... Duhet të jem gabuar... me siguri... ja, soditi me vërejtje çdo fytyrë që linte pas, vështroi poshtë kapelave, sytë iu kryqëzuan me vështrime të inatosura e të habitura. Gjithnjë më tutje, gjithnjë më tutje... fytyra të tjera, kapela të tjera, gri, të zeza, blu... I linte pas, kthehej sërish dhe i vështronte si i shastisur...

Në kryqëzimin e *avënysë Kleber* u ndal. Një grua me një kone – iu kujtua përnjëherësh. Fill pas saj e pati vënë re atë tjetrin.

Gruan me konen ai e kishte lënë pas qëkur. Me të shpejtë u kthye andej nga erdhi. Kur e pikasi që larg gruan me gjithë qenin, qëndroi buzë trotuarit. Mblodhi grushtet ndër xhepa dhe zuri të kundronte me vëmendje çdo kalimtar. Qeni u ndal rrëzë një shtylle elektriku, shfryu nga flegrat e hundës dhe, me ngadalësi të madhe, ngriti njërën nga këmbët e pasme. Pastaj gërvishti me putrat kalldrëmin e trotuarit dhe vazhdoi udhën. Befas Raviku ndjeu se e kishte qafën qull në djersë. Priti edhe disa minuta – por ajo fytyrë nuk u duk gjëkundi. U hodhi një sy veturave që qëndronin në vendet e caktuara për parkim pranë trotuarit. Askush nuk ndodhej brenda. Ai u kthye përsëri dhe shkoi gjer te metroja në *avënynë Kleber*. Zbriti poshtë në hyrje, preu një biletë dhe u drejtua nga stacioni. Njerëz kishte plot. Përpara se të arrinte në vend, erdhi një tren, ndaloi dhe u nis prapë, duke u zhdukur në tunel. Stacioni u boshatis.

Me ngadalë ai u kthye përsëri në bar. Shkoi e zuri vend në tryezën ku qe ulur pak më parë. Edhe gota e tij, e mbushur përgjysmë me *Kalvados*, qe akoma atje. I erdhi çudi që e gjeti po në atë vend.

Kamerieri iu afrua me druajtje.

– Më falni, zotëri. Nuk e dija që...

– Mirë, mirë, – tha Raviku. – Më sillni një gotë tjetër me *Kalvados*.

– Një gotë tjetër? – Kamerieri vështroi gotën e mbushur përgjysmë që ndodhej në tryezë. – S'doni t'i jepni fund kësaj më parë?

– Jo, më sillni një tjetër.

Kamerieri ngriti gotën dhe i mori erë.

– A s'është i mirë?

– Është. Por unë dua një tjetër.

– Si urdhëroni, zotëri.

Jam gabuar, mendonte Raviku. Xhami qe i dërsirë, i veshur me avull, si mund të dallosh qartë nëpër të?!... Ai vazhdoi të vështronte si i shastisur jashtë dritares. Pastaj shikimi i tij i mjegulluar u kthye në shikim ngulmues; vërente si një gjahtar në pritë, ndiqte me sy çdo njeri që kalonte andej pari, por, në të njëjtën kohë, si copëza hijesh të murrme të një filmi ngjethës, i dilnin përpara herë pas here fragmente kujtimesh...

Berlin. Një natë vere e vitit 1934; godina e Gestapos; gjak; një dhomë e zhveshur, pa asnjë dritare; llamba të forta, pa abazhurë, si projektorë verbues; një tryezë e spërkatur me gjak, me rripa lëkure që shërbenin për të lidhur duar, këmbë dhe trup; truri i tij që i kishte kaluar kufijtë e pagjumësisë dhe të kapitjes, i shkundur kushedi sa herë nga kllapia me anë të një kove me ujë të ftohtë; veshkat e tij, që ishin dërrmuar aq shumë nga rrahjet, saqë nuk i dhembnin më; tiparet e shfytyruara e të shushatura të Sibilës; disa këlyshë xhelatësh në uniformë, që e mbanin nga krahët... dhe një fytyrë djallëzisht e qesharë, e cila, me një zë ledhatar i shpjegonte se çdo të ndodhte me atë grua. Po të mos depononte ai ose ajo... Ah, Sibila, tri ditë më vonë, u gjend gjoja e varur vetë në litar...

Kamerieri erdhi dhe ia vuri gotën përpara, në tryezë.

– Kjo është një markë tjetër, zotëri. E Didiesë, prodhuar në Kaen. Është më e vjetër.

– Mirë, mirë. Falemnderit.

Raviku e ktheu gotën me fund. Nxori paketën nga xhepi dhe ndezi një cigare. Duart i dridheshin akoma pak. E flaku shkrepësen përtokë dhe porositi një *Kalvados* tjetër.

... Atë fytyrë, atë fytyrë të qeshur e cinike, iu duk sikur e pa qëparë – e megjithatë duhej të qe gabuar! Ishte e pamundur që Hakeja të ndodhej tani në Paris. E pamundur!...

Ai u shkund nga kujtimet. S'kishte kuptim ta torturoje veten me to, përderisa nuk mund të ndërmerrje gjë prej gjëje. Do të vinte koha... koha, kur matanë do të shembeshin të gjitha këto dhe njeriu do të mund të kthehej në atdheun e vet... Por gjer atëherë...

Thirri kamerierin dhe pagoi; por, kur doli në rrugë, nuk mundi ta përmbante dot veten pa ia ngulur sytë me vërejtje çdo kalimtari.

* * *

Në darkë po rrinte me Marozovin në *Katakombë*.

– Ti s'beson që ishte ai? – e pyeti Marozovi.

– Jo. Por dukej krejt si ai. Këtu ose e ka fajin ndonjë ngjashmëri e mallkuar, ose ka filluar të më lërë kujtesa dhe s'jam më i sigurt.

– Keq që u ndodhe brenda në bar.

– Po.

Marozovi heshti ca.

– Një gjë e tillë t'i ngre nervat në hava, apo jo? – ia bëri pastaj.

– Jo. Pse?

– Sepse nuk di ç'të mendosh.

– Unë di ç'të mendoj.

Marozovi nuk i dha përgjigje.

– Shoh fantazma me sy hapur, – tha Raviku. – Pandehja se kisha shpëtuar prej tyre.

– Prej tyre nuk shpëton kurrë. Edhe unë vuaja nga kjo. Sidomos në fillim fare, gjashtë vitet e para, pasi erdha këtu. Kam një hesap për të larë me nja tre vetë. Gjithsej ishin shtatë. Katër kanë vdekur. Dy prej të katërve u pushkatuan nga partia e tyre. Kam njëzet e ca vjet që po pres. Qysh më 1917. Njëri nga ata të tre që janë ende gjallë, tani është rreth të shtatëdhjetave. Dy të tjerët po u afrohen të pesëdhjetave. Shpresoj se këta do të më bien në dorë. Janë ata për babain tim.

Raviku i hodhi një vështrim të gjatë Marozovit. Për nga shtati, ai dukej alamet gjiganti, por të gjashtëdhjetat i kishte kaluar.

– Ke për t'i shtënë në dorë! – i tha.

– Po. – Marozovi hapi dhe mbylli pëllëmbët e tij të mëdha. – Këtë po pres edhe unë. Prandaj jam duke jetuar më me kujdes. Pijen e kam rralluar mjaft. Ndoshta do të më duhet të pres edhe ca. Por, kur të vijë koha, duhet të jem i fortë. Nuk dua të shtie dhe nuk dua të ther.

– As unë.

Ata ndjenjën një copë herë pa folur.

– A bëjmë një lojë shah? – pyeti Marozovi.

– Bëjmë. Por nuk po shoh ndonjë fushë të lirë.

– Ja, atje matanë! Profesori sapo e mbaroi lojën me Levin. Fitoi, si gjithmonë.

Raviku shkoi të merrte fushën dhe gurët e shahut.

– Keni luajtur shumë, profesor, – tha ai. – Tërë pasdreken.

Burri plak pohoi me kokë.

– Shahu t'i heq andrallat. Është më i përsosur se bixhozi. Bixhozi është punë fati dhe njëkohësisht edhe punë tersllëku. Nuk të çlodh aq sa duhet. Kurse shahu është një botë më vete. Gjatë kohës që luan, ajo botë zë vendin e botës së vërtetë. – Ai ngriti për një çast sytë e tij të skuqur. – Dhe kjo botë nuk është aq e përsosur.

Levi, partneri i tij, seç murmuriti nëpër dhëmbë. Pastaj pushoi përnjëherësh, vështroi rretheqark i trembur dhe u ngrit e iku pas profesorit.

Ata bënë dy lojë. Pastaj Marozovi u ngrit.

– Më duhet të shkoj e të hap dyert për ajkën e njerëzimit. Po zotrote pse s'na ke dalë kohët e fundit andej?

– S'e di. S'kam pasur rast.

– Do të vish nesër mbrëma?

– Nesër mbrëma jam i zënë. Do të shkoj të ha darkë në *Maksims.*

Marozovi u skërmit:

– Si i arratisur ilegal që je, sikur po shet shumë mend duke u sorollatur nëpër lokalet më elegante të Parisit!

– Këta janë të vetmet lokale ku mund ta ndiesh veten krejtësisht të sigurt, Boris. Ai që sillet si refugjat, bie në sy shpejt dhe është në rrezik ta kapin nga çasti në çast. Këtë ti duhet ta dish mirë, meqenëse ke edhe vetë pasaportën e atyre që janë pa shtetësi fare.

– Ke të drejtë. Po me kë do të hake darkë atje? Mos vallë me ambasadorin gjerman si mbrojtës?

– Me Keti Hegshtrëmin.

Marozovi lëshoi një vërshëllimë të lehtë

– Me Keti Hegshtrëmin?... Qenka kthyer?

– Do të vijë nesër në mëngjes. Nga Vjena.

– Mirë. Atëherë do të kaloke në orët e vona andej nga ne.

– Ndoshta edhe jo.

Marozovi bëri një lëvizje mospërfillëse me dorë.

– E pamundur! Kur vjen Keti Hegshtrëmi në Paris, *Sheherezaden* e ka si shtabin e saj të përgjithshëm.

– Por këtë radhë puna qëndron ndryshe. Ajo vjen për t'u shtruar në klinikë. Pas disa ditësh do të operohet.

– Atëherë do të ardhka me siguri në lokalin tonë. Ti nuk ke haber fare nga gratë. – Marozovi picërroi sytë. – Apo nuk ta ka qejfi që ajo të vijë andej nga ne?

– Pse jo?

– Tani po më bie ndër mend, ashtu kot, se nuk ke ardhur fare në

Sheherezade qëkur ma dërgove atë gruan, Xhoanë Madunë. Prandaj kjo puna e mosardhjes sate s'po më duket si gjë e rastit.

– Gjepura. Unë as që e di fare se qenka akoma te ju. A mundët t'i rregullonit ndonjë punë?

– Posi. Në fillim e futën në kor. Tani ka një program të vetin, solo. Këndon çdo natë nja dy-tri këngë.

– A është ambientuar ndopak?

– Natyrisht. Pse të mos ambientohej?

– Ishte tmerrësisht e dëshpëruar ca kohë. Ta këpuste shpirtin.

– Si the? – pyeti Marozovi.

– Thashë se ta këpuste shpirtin. Ishte një krijesë e gjorë.

Marozovi vuri buzën në gaz.

– Ravik, – ia nisi pastaj me ton atëror dhe me një fytyrë ku të bëhej sikur dalloje stepa, hapësira, lëndina dhe gjithë përvojën e botës. – Mos fol marrëzira. Ajo është një zuskë e madhe.

– Çfarë? – ia bëri Raviku.

– Është zuskë. Jo prostitutë. Zuskë, thashë. Po të ishe rus, do ta kuptoje këtë.

Raviku qeshi.

– Atëherë duhet të ketë ndryshuar shumë kohët e fundit. Mirupafshim, Boris! Perëndia t'i bekoftë sytë!

7

– Kur duhet të ndodhem në klinikë, Ravik? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

– Kur të doni. Nesër, pasnesër. Një ditë nuk prish punë.

Ajo qëndronte përpara tij, e imët si një çupë e vogël, e sigurt në vetvete, e hijshme, por jo më aq e re.

Përpara dy vjetësh Raviku i kishte operuar apendicitin. Pati qenë operacioni i tij i parë në Paris. Ajo i solli fat. Që atëherë kishte vazhduar të punonte me mbarësi dhe s'kishte pasur telashe me policinë. Keti Hegshtrëmi ishte për të si njëfarë hajmalie.

– Këtë radhë kam frikë, – tha ajo. – Nuk e di përse, por ja që kam frikë.

– S'duhet të keni frikë. Është diçka krejt e rëndomtë.

Ajo iu afrua dritares dhe vështroi jashtë. Poshtë shtrihej kopshti i hotel *Lankastërit*. Një gështenjë vigane shtriqte krahët e saj të lashtë drejt qiellit plot lagështi.

– Ah, ky shiu, – tha ajo. – Kur u nisa nga Vjena, binte shi. Kur u zgjova në Zyrih, prapë binte shi. Edhe këtu ai s'paska të pushuar... – Ajo lëshoi perdet e dritares. – Nuk e di ç'po ndodh me mua. Me duket se po plakem.

– Kështu na duket gjithmonë, kur s'jemi plakur akoma.

– Duhej të isha ndryshe. Përpara dy javësh u shkurorëzova. Duhej të isha e gëzuar. Por ja që ndihem e kapitur. Gjithçka përsëritet, Ravik. Pse, vallë?

– Asgjë nuk përsëritet. Ne përsëritemi; kjo është e gjitha.

Ajo buzëqeshi dhe u ul në një kanape që ndodhej pranë oxhakut të rremë.

– Bëra mirë që u ktheva, – tha ajo. – Vjena të duket si kazermë. E trishtuar sa s'ka ku të vejë më. Gjermanët e kanë shkelur me çizmet e tyre të rënda e të ndyra. Dhe, bashkë me ta, e kanë përdhosur edhe austriakët. Po, edhe austriakët, Ravik. Në fillim pandeha se një nazist austriak ishte diçka e pamundur, diçka kundër natyrës! Por pastaj i pashë vetë, i pashë me sytë e mi.

– Këtu s'ka asgjë për t'u çuditur. Pushteti është sëmundja më ngjitëse që ekziston.

– Po, por është edhe sëmundja që të deformon më tepër se çdo sëmundje tjetër. Prandaj edhe u shkurorëzova. I lezetshmi dhe bukuroshi dembel, me të cilin u martova para dy vjetësh, na u bë, papritur e pa kujtuar, një *shturmfyrer*[1] nga ata që ulërijnë gjer në kupë të qiellit; ai urdhëroi që profesori plak Bernshtajn të pastronte rrugët dhe rrinte e bënte sehir duke mbajtur ijet me dorë nga të qeshurit. Dhe kë? Bernshtajnin, i cili para një viti e shëroi nga një infeksion i rëndë veshkash! Gjoja mori hak, sepse honorari pati qenë tepër i madh. – Keti Hegshtrëmi mblodhi buzët me përçmim. – Honorari që ia pagova unë profesorit, dhe jo ai!

– Nuk thoni shyqyr që e hoqët qafe!

– Ai më kërkoi dyqind e pesëdhjetë mijë shilinga për shkurorëzimin.

– Lirë, – tha Raviku. – Çdo gjë, që mund të rregullohet me para, është lirë.

– Nuk i dhashë asnjë grosh. – Keti Hegshtrëmi ngriti fytyrën e imët, me ato tipare të rregullta e të skalitura si një gur i çmuar i punuar mjeshtërisht. – Ia thashë troç mu në surrat se ç'mendim kisha për të, për partinë dhe për *Fyrerin* e tij, dhe se këtë gjë do ta bëja edhe tani e tutje publikisht. Ai më kërcënoi me Gestapo e me kamp përqendrimi. Unë e përqesha sa munda. I thashë se isha akoma nënshtetase amerikane dhe se ndodhesha nën mbrojtjen e ambasadës sime. Mua s'do të më ndodhte gjë prej gjëje, por kishte rrezik ta pësonte ai vetë, meqë ishte martuar me mua. – Ajo qeshi. – Te kjo s'i kishte vajtur mendja. Që atëherë nuk më bezdisi më.

Ambasadë, mbrojtje, proteksion, mendoi Raviku. I dukej sikur të gjitha këto ndodhnin në ndonjë planet tjetër.

– Çuditem se si e lejokan akoma Bernshtajnin të bëjë vizita, – tha ai.

– Jo, ia kanë ndaluar. Por mua më vizitoi fshehurazi, kur pata hemoragjinë e parë. Mirë që s'më lejohet ta mbaj fëmijën. Edhe këtë do të kisha mangët... fëmijë me një nazist! – Ajo u shkund e tëra me neveri.

1. *Sturmführer*: Gradë oficeri eses në Gjermaninë naziste.

Erjonixx

Raviku u ngrit.

– Më duhet të shkoj tani. Veberi do t'ju vizitojë edhe njëherë pasdreke. Vetëm sa për formë.

– E di. Megjithatë... këtë radhë kam frikë.

– Ç'thoni kështu, Keti...? S'është hera e parë që bëni operacion. Do të jetë më i thjeshtë se ai që ju bëra përpara dy vjetësh. – Ai e përfshiu lehtë nga supet. – Ju ishit operacioni im i parë kur erdha në Paris. Kjo është si ajo puna e dashurisë së parë. Do t'ju kem shumë kujdes. Përveç kësaj, ju kam edhe si hajmali. Më keni sjellë fat. Dhe dua që të më sillni prapë fat.

– Po, – tha ajo dhe e vështroi në sy.

– Në rregull. Mirupafshim, Keti. Do të vij t'ju marr në darkë, në orën tetë.

– Mirupafshim, Ravik. Tani po shkoj të blej një fustan mbrëmje te Menbosheja. Duhet ta shporr këtë kapitje që më ka pllakosur shpirt e trup. Duhet të shpëtoj nga ideja se kam ngecur në një rrjetë merimange... Ah, ajo Vjena, – tha ajo me një buzëqeshje të hidhur, – qyteti i ëndrrave...

Raviku zbriti poshtë me ashensor dhe, duke kaluar pranë barit, i ra mes për mes hollit të hotelit. Disa amerikanë ishin ulur atje. Në mes, mbi një tryezë, qe vendosur një tufë shumë e madhe gladiolash të kuqe. Nën atë dritë të murrme e të shpërhapur, ato kishin marrë ngjyrën e gjakut të mpiksur dhe vetëm kur ai u afrua fare pranë, vuri re që ishin krejt të freskëta. Ishte drita që vinte nga jashtë ajo që i bënte të dukeshin ashtu.

*

* *

Në katin e dytë të *Internacionalit* kishte shumë lëvizje. Një sërë dhomash qenë hapur, kamerierja dhe shërbyesi suleshin sa andej-këtej dhe pronarja i drejtonte të gjitha punët që nga korridori.

Raviku po ngjitej përpjetë shkallëve.

– Ç'ka ndodhur? – pyeti ai.

Pronarja ishte një grua trupngjeshur, me gjinj të mëdhenj e me një kokë tepër të vogël, të qarkuar prej kaçurrelash të shkurtër e të zinj.

– Na u larguan spanjollët, – tha ajo.

– Këtë e di. Po pse po i rregulloni dhomat tani kaq vonë?

– Na duhen për nesër në mëngjes.

– Do të vijnë emigrantë të rinj gjermanë?

– Jo, spanjollë.

– Spanjollë? – pyeti Raviku, i cili për një çast nuk e kuptoi çfarë deshi të thoshte ajo me atë fjalë. – Si kështu? Po ata sapo ikën!

Hotelierja e vështroi me sytë e saj të zinj e të ndritshëm dhe vuri buzën në gaz. Ishte një buzëqeshje pa të keq, megjithëse ironike.

– Do të kthehen të tjerët, – tha ajo.

– Cilët të tjerë?

– Ata të anës kundërshtare, natyrisht. Gjithmonë kështu ka ndodhur. – Ajo i dha ca urdhra kamerieres që po pastronte. – Hoteli ynë është i vjetër, – vazhdoi pastaj me njëfarë krenarie. – Klientët kthehen me qejf te ne. Ka kohë që presin t'u lirohen dhomat që kishin pasur më parë.

– Ka kohë që presin? – pyeti Raviku i habitur. – Cilët janë ata që presin?

– Zotërinjtë e anës kundërshtare. Shumica kanë qenë njëherë këtu. S'do mend që një pjesë e tyre janë vrarë ndërkohë. Por të tjerët kanë pritur në Biarric dhe në Sen Zhan dë Lyz derisa të liroheshin dhomat te ne.

– Po pse, paskan qenë edhe herë tjetër këtu?

– Ama, edhe ju, zoti Ravik! – Hotelierja u çudit se si ishte e mundur që ai të mos e dinte këtë. – Si nuk paskan qenë?! Kanë qenë në atë kohë kur në Spanjë ishte diktator Primo de Rivera. Atëherë u detyruan të arratiseshin dhe erdhën e jetuan këtu. Pastaj, kur Spanja u bë republikane, ata u kthyen atje dhe këtu na erdhën monarkistët dhe fashistët. Tani të fundmit e këtyre po shkojnë në Spanjë dhe republikanët po vijnë përsëri... domethënë, ata republikanë që kanë mbetur gjallë.

– Keni të drejtë. Kjo s'më kishte shkuar në mendje.

Hotelierja futi kokën në njërën prej dhomave. Mbi shtrat qe varur një portret me ngjyra i ish-mbretit Alfons.

– Zhanë, – i thirri ajo kamerieres, – ma hiq atë që andej!

Vajza ia solli portretin. Hotelierja ia mori nga dora, e mbështeti pas murit në të djathtë të korridorit dhe shkoi më tutje. Në dhomën tjetër ndodhej një portret i gjeneralit Franko.

– Hiqe edhe këtë. Vendose pranë tjetrit.

– Po pse këta spanjollët nuk i paskan marrë me vete portretet e tyre? – pyeti Raviku.

– Emigrantët, kur kthehen, rrallë i marrin me vete portretet, – e sqaroi hotelierja. – Portretet të ngushëllojnë vetëm në dhé të huaj.

Kur kthehesh në vatanin tënd, s'ua ke më nevojën. Kornizat të rën-dojnë kur udhëton dhe xhami thyhet lehtë. Kështu që portretet, pothuajse gjithmonë, lihen nëpër hotele.

Ajo vuri në korridor, pranë të tjerave, edhe dy portrete: një të gjeneralisimit të dhjamur dhe një tjetër, më të vogël, të Kuipo de Ljanos.

– Ikonat mund t'i lëmë aty ku janë, – vendosi ajo, tek pikasi në një dhomë një Shën Mëri të pikturuar me ngjyra të ndezura. – Shenjtorët janë neutralë.

– Jo gjithmonë, – tha Raviku.

– Në kohë të vështira perëndia ka gjithmonë njëfarë shansi. Këta sytë e mi kanë parë shumë këtu. Kam parë bile edhe ateistë duke u falur. – Me një lëvizje energjike, hotelierja shpuri në vend gjirin e majtë, që i kishte shkarë. – Po ju a s'jeni falur ndonjëherë, kur e keni pasur punën shumë pisk?

– Natyrisht. Por unë s'jam ateist, ama. Jam vetëm një njeri që s'beson kollaj.

Shërbyesi i hotelit ngjiti shkallët, duke tërhequr pas vetes nëpër korridor një mori portretesh.

– Po përgatitni dekore të reja? – pyeti Raviku.

– S'do mend. Në këtë zanatin tonë duhet të kesh shumë takt. Dhe takti është ai që i nxjerr vërtet namin e mirë një hoteli. Veçanërisht në rastin e klientelës sonë, e cila, të flasim me dorë në zemër, është tepër delikate në kësi punësh. S'mund të presësh që ndonjërit t'i pëlqejë një dhomë, ku e vështron me krenari nga muri portreti i armikut të tij më të betuar, i stamposur me ngjyra të bukura, bile, ngandonjëherë, edhe i qarkuar nga një kornizë ari. A kam të drejtë, apo jo?

– Qind për qind!

Hotelierja iu kthye shërbyesit:

– Vendosi fotografitë këtu, Adolf. Jo, vëri më mirë atje, në murin matanë, që t'u bjerë drita më tepër!

Shërbyesi seç hungëroi nëpër dhëmbë, pastaj u përkul për të rregulluar atë farë ekspozite.

– Po tani ç'do të varni nëpër dhoma? – pyeti Raviku me kërshëri. – Kaproj, peizazhe apo ndonjë shpërthim Vezuvi?

– Ato i mbajmë rezervë, kur s'na mjaftojnë të vjetrat.

– Cilat të vjetra?

– Ato të përparshmet. Ato që kanë lënë zotërinjtë, kur e morën pushtetin.

Ajo shtriu dorën drejt anës së majtë të korridorit. Shërbyesi, ndërkohë kishte rreshtuar atje fotografitë e reja përkundrejt atyre që ishin nxjerrë nga dhomat. Ishin dy Marksa, tre Lenina, njëri prej të cilëve qe mbuluar përgjysmë me një letër, një Trocki dhe disa klishe të zeza, më të vogla, që paraqitnin Negrinin dhe udhëheqës të tjerë republikanë të Spanjës. Ata nuk binin fort në sy dhe asnjëri nuk ishte ngarkuar aq me ngjyra të larme, dekorata dhe urdhra, sa radha pompoze e portreteve të Alfonsove, Primove dhe Frankove, të vendosur përkundrejt, në anën e djathtë. Të dy rreshtat me botëkuptime të ndryshme vështroheshin të nemitur atje në korridorin e mugët, dhe në mes qëndronte hotelierja franceze, me atë takt, atë përvojë dhe atë urtësi ironike, që e shquante racën e saj.

– Unë i pata ruajtur këto sende, – tha ajo, – qysh atëherë, kur zotërinjtë ikën nga hoteli im. Në ditët tona, qeveritë nuk e kanë të gjatë. Ju e shihni vetë që pata të drejtë... Tani këta portrete po më hyjnë në punë. Në zanatin tonë duhet të jesh largpamës.

Ajo filloi të jepte udhëzime, ku duheshin varur portretet. Trockin e nisi përsëri andej nga kishte ardhur; ai nuk i dukej edhe aq i sigurt. Raviku kontrolloi klishenë e Leninit, mbi gjysmën e së cilës qe ngjitur një letër. Ai e gërvishti pak letrën me thua në lartësinë e kokës së Leninit... dhe prapa letrës u shfaq një kokë tjetër, ajo e Trockit, që i buzëqeshte Leninit. Me sa dukej, ndonjë ithtar i Stalinit ia kishte ngjitur përsipër atë shirit të bardhë letre.

– Ja! – tha Raviku. – Edhe një Trocki i fshehur. Nga koha e vjetër dhe e lumtur e miqësisë dhe e vëllazërimit!

Hotelierja e mori portretin.

– Këtë mund ta hedhim në kosh. S'ka asnjë vlerë. Njëra gjysmë po fyen vazhdimisht gjysmën tjetër. – Ajo ia la shërbyesit në dorë. – Adolf, këtë kornizë na e ruaj. Është prej lisi të mirë.

– Po me të tjerat, ç'do të bëni? – pyeti Raviku përsëri.– Me Alfonsët e me Frankot?

– Ato e kanë vendin në qilar.

– Ai qilari juaj duhet të jetë fantastik! Një mauzole provizor. Keni edhe të tjera atje?

– Oh, natyrisht! Një rus që vrau veten, la pas një portret origjinal të carit të fundit me bojë vaji e me një kornizë të rëndë prej ari. Pastaj kemi edhe italianët: tre mbretër dhe një Musolin pak të grisur, shkëputur nga një gazetë, që nga koha kur ndodhej në Zyrih dhe e quante veten akoma socialist. Natyrisht kjo farësoj fotografie ka vlerë vetëm sepse është diçka e rrallë; asnjeriu s'ia ka qejfi ta shohë

Erjonixx

të varur në mur.

– Po gjermanë keni?

– Kemi një Lasal dhe një Bebel. Por kemi edhe një fotografi në grup: Ebertin, Shajdemanin, Nosken dhe ca të tjerë. Noskes ia kanë nxirë surratin me një okë bojë; zotërinjtë më thanë se ai na qenka bërë nazist.

– Kjo është e vërtetë. Atë mund ta varni pranë Musolinit socialist. Po nga pala tjetër e gjermanëve nuk ju ndodhet ndonjë, ë?

– Posi jo! Kemi një Hindenburg, një perandor Vilhelm, një Bismark dhe... – hotelierja vuri buzën në gaz, – kemi bile edhe një Hitler me mushama. Jemi, si të thuash, të kompletuar më së miri.

– Si? – ia bëri Raviku. – Edhe Hitlerin?! Po atë ku e paskeni psonisur?

– E kemi kujtim nga një homoseksual. Ai erdhi këtu më 1934, kur Hitleri e qëroi Ernst Rëmin me shokë. Ai kishte shumë frikë dhe falej tërë kohën. Më vonë e mori me vete një pasanik argjentinas. E thërrisnin Puci. Doni ta shihni fotografinë? E kemi poshtë, në qilar.

– Jo tani. S'dua ta shoh në qilar. Ma ka qejfi më shumë ta sodis kur t'i kemi mbushur të tëra dhomat me atë monstër.

Hotelierja e zhbiroi për një çast me sy.

– Aha! – ia bëri ajo pastaj. – E keni fjalën kur nazistët do të na vijnë këtu si emigrantë?

*

* *

Borisi, i ngrefosur me uniformën e tij tërë kopsa e shirita ari, qëndronte përpara *Sheherezades* dhe hapte dyert e taksive.

Raviku zbriti nga një taksi. Marozovi shtrembëroi buzët me qesëndi:

– Sikur the që s'doje të vije?

– Vërtet që s'doja.

– E tërhoqa me zor, Boris. – Keti Hegshtrëmi e përqafoi Marozovin. – Sa mirë që u ktheva përsëri te ju!

– Ju keni shpirt rus, Katja. Djalli e di, pse u desh që të lindnit pikërisht në Boston. Eja, Ravik. – Marozovi shtyu me bërryl derën e hyrjes. – Njeriu është i madh kur llap për parimet e veta; por është i dobët kur vjen puna për t'i zbatuar. Këtu qëndron fatkeqësia jonë dhe lezeti ynë.

Sheherezadja ishte pajisur si një shatorre kaukaziane. Kamerierët

Erjonixx

ishin veshur me uniforma të kuqe çerkezësh. Orkestra përbëhej prej ciganësh. Klientët rrinin pranë tryezash të vogla, të vendosura përpara një minderi, që shtrihej përgjatë gjithë murit. Salla ishte e kredhur në një dritë të mugët dhe pothuajse plot.

– Ç'dëshironi të pini, Keti? – pyeti Raviku.

– Vodkë. Pastaj dua që të luajnë edhe ciganët. Më ka ardhur në majë të hundës "Pylli i Vjenës", të cilin tani na e kanë aranzhuar si marsh parade. – Ajo zbathi këpucët dhe mblodhi këmbët mbi minder. – Tani më iku lodhja, Ravik, – vazhdoi ajo. – Vetëm ca orë në Paris... dhe ndryshova! Por akoma më vjen sikur jam arratisur nga një kamp përqendrimi. A mund ta përfytyroni këtë lloj ndjenje?

Raviku e vështroi drejt e në sy.

– Më duket se po, – tha ai.

Çerkezi solli një shishe të vogël vodke dhe gotat. Raviku i mbushi dhe ia dha njërën Keti Hegshtrëmit. Ajo e piu me të shpejtë dhe e etur. Pastaj hodhi sytë rretheqark.

– Kjo është një fole tenjash, – tha dhe buzëqeshi. – Por natën shndërrohet në një guvë shpëtimtare ëndërrimesh. – Ajo u mbështet në jastëkët e minderit. Drita e butë, e montuar poshtë xhamit të tryezës, ia ndriçoi fytyrën. – Pse ndodh kështu, Ravik? Pse natën çdo gjë të duket e larmishme... dhe ne pandehim se mund t'i bëjmë të gjitha... dhe atë që s'e arrijmë dot, e mbushim pastaj me ëndrrat tona... Pse?

Ai vuri buzën në gaz.

– Ëndrrat i kemi, sepse pa ato nuk do ta duronim dot të vërtetën.

Orkestra zuri të ushtrohej. Ca harqe filluan të fërkoheshin mbi tela violinash.

– Ju nuk ta jepni përshtypjen se mund të gënjeheni me ëndrra, – tha Keti Hegshtrëmi.

– Njeriu mund të gënjehet edhe me të vërtetën. Kjo është një ëndërr akoma më e rrezikshme.

Orkestra zuri të luante. Në fillim u dëgjua vetëm çembaloja. Çekiçët e butë dukej sikur rrëmbenin ngadalë e ngadalë, thuajse pa u ndier, një melodi diku nga mugëtira, e ngrinin lart dhe ia përcillnin pastaj me ngurrim violinave.

Një cigan i ra mes për mes parketit të vallëzimit dhe iu afrua tryezës së tyre. Atje qëndroi, me fytyrën e vijosur nga një buzëqeshje e lehtë, me violinën te supi dhe me sy ngulmues, por që mundoheshin të rrëfeheshin mospërfillës. Pa violinë, ai do të të jepte përshtypjen e një xhabazi – por me të, ai ishte lajmëtari i stepës, i

Erjonixx

netëve të gjata, i horizonteve të pafundme dhe i gjithë atyre gjërave që s'ishin kurrë të vërteta...

Keti Hegshtrëmi e ndjeu melodinë t'i shkiste përmbi lëkurë si një burimi në prill. Iu bë sikur dëgjonte kudo oshtima, por askush nuk ndodhej atje që ta thërriste në emër. Zëra të mekur murmuritnin diçka... copëza të grisura kujtimesh të largëta i afroheshin nga diku... ngandonjëherë i vezullonte diçka përpara syve – por të gjitha shuheshin e zhdukeshin shpejt e shpejt dhe askush nuk ndodhej atje që ta thërriste. Askush nuk e thërriste...

Cigani u përkul përpara tyre. Raviku i zgjati nën tryezë një kartëmonedhë dhe ia la në dorë. Keti Hegshtrëmi u shkund atje, në qoshen e vet.

– A keni qenë ndonjëherë i lumtur, Ravik?

– Shpesh.

– S'e kam fjalën aty. Ju pyes në keni qenë vërtet i lumtur, i lumtur sa s'bëhet, gjer në çmenduri, shpirt e trup i lumtur!

Raviku e vështroi atë fytyrë të hequr dhe aq shprehëse që kishte përballë, atë fytyrë, e cila njihte vetëm një kuptim të lumturisë: atë më të lëkundshmin e gjithë kuptimeve – dashurinë dhe asnjë lumturi tjetër.

– Shpesh, Keti, – përsëriti ai duke pasur në mendje diçka krejt tjetër dhe duke e ditur se as ajo nuk ishte lumturia.

– Ju s'doni të më kuptoni. Ose s'doni të flisni për këtë temë... Cila është ajo që po këndon tani, e shoqëruar nga orkestra?

– Nuk e di. Ka kohë që s'kam qenë në këtë lokal.

– Këngëtarja s'dallohet që këndej. S'është bashkë me ciganët. Duhet të jetë ulur në ndonjë tryezë aty pranë.

– Atëherë do të jetë ndonjë kliente. Të tilla gjëra ndodhin shpesh këtu.

– Zë i çuditshëm, – tha Keti Hegshtrëmi. – I trishtuar dhe rebel njëherësh.

– Janë vetë këngët të tilla.

– Ose jam vetë e tillë sonte. E kuptoni, çfarë po këndon ajo?

– *Ja vas ljubill*, të kam dashur. Një lirikë e Pushkinit.

– E dini rusishten?

– Vetëm aq sa ç'më ka mësuar Marozovi. Më shumë kam haber nga sharjet. Rusishtja është e prerë për sharje.

– Ju s'para keni qejf të flisni për veten tuaj, apo e kam gabim?

– Unë s'para kam qejf as të mendoj për veten time.

Ajo ndenji një copë herë pa folur.

– Nganjëherë më vjen të besoj sikur jeta e vjetër kaloi, shkoi e vate, – tha ajo pastaj. – Moskokëçarja, pritja... të gjitha ato që ndjenim dikur.

Raviku buzëqeshi.

– Jeta s'kalon kurrë, Keti. Jeta është një çështje tepër e madhe saqë të kalojë, përpara se ne të pushojmë së marruri frymë.

Ajo s'po ua vinte veshin fjalëve të tij.

– Shpesh të pushton një frikë, – tha ajo. – Një frikë e befasishme, e pashpjegueshme. Të vjen sikur, po të dalësh që këtej, do ta gjesh botën përjashta të rrënuar, të shkatërruar. Ju ka qëlluar ta provoni edhe ju ndonjëherë këtë ndjenjë?

– Po, Keti. Gjithkush e ka provuar këtë. Është një sëmundje europiane. Një sëmundje që po zgjat tani njëzet vjet.

Ajo heshti.

– Po kjo tjetra nuk qenka këngë ruse, – tha pastaj dhe zuri të dëgjonte muzikën.

– Jo. Është italiane. *Santa Lucia Luntana.*

Projektori lëvizi nga violinisti dhe ndriçoi një tryezë pranë orkestrës. Raviku e dalloi tani gruan që po këndonte. Ishte Xhoanë Maduja. Ajo rrinte atje vetëm, me kokën mbështetur në njërën dorë, syulur, a thua se ishte e kredhur në mendime dhe se, përveç asaj, nuk ndodhej njeri tjetër në lokal. Drita e bardhë i jepte një pamje shumë të zbehtë fytyrës së saj. Nuk ishin më ato tipare të shuara dhe pa shprehje, që mbante mend ai. Ajo fytyrë tregonte tani një bukuri që të shqetësonte e të shushaste dhe atij iu kujtua sikur njëherë – natën, në dhomën e saj, – e kishte parë kështu siç po e shihte tani; por atëherë kishte kujtuar se qe mashtrimi i ëmbël i pijes, sepse gjithë ajo bukuri që shuar e zhdukur aty për aty. Kurse tani ndodhej atje e tëra; nuk po shuhej, nuk po zhdukej; bile, atje ndodhej edhe diçka më tepër se aq.

– Ç'keni kështu, Ravik? – e pyeti Keti Hegshtrëmi.

Ai ktheu fytyrën nga ajo.

– Asgjë. E njoh këtë këngë. Psherëtima të ëmbla napolitane.

– Mos ju zgjon ndonjë kujtim?

– Jo. Unë nuk kam kujtime.

Këto fjalë i tha më me rrëmbim nga ç'deshi t'i thoshte. Keti Hegshtrëmi ia qepi sytë e saj të bukur.

– Nganjëherë kam vërtet dëshirë të di se ç'ju ka ndodhur, Ravik.

Ai bëri një lëvizje mospërfillëse me dorë:

– As më shumë dhe as më pak se kujtdo tjetër. Sot bota është

mbushur me aventurierë pa dashka. Mund t'i gjeni në çdo hotel refugjatësh. Dhe çdonjëri prej tyre ka historinë e vet, një histori, e cila, për Aleksandër Dymanë apo për Viktor Hygonë, do të ishte një sensacion i vërtetë. Por ne sot fillojmë e gogësijmë, sapo ndokush matet të na rrëfejë historinë e jetës së vet... Ja tek mbërriti edhe një gotë vodkë për ju, Keti. Sot, aventura më e madhe për ne është një jetë e qartë dhe e qetë.

Orkestra filloi të ekzekutonte një bluz melankolik. Muzikës së vallëzimit ajo nuk i binte edhe aq mirë. Disa klientë zunë të kërcenin, Xhoanë Maduja u ngrit nga vendi dhe u drejtua nga dalja. Ecte në një mënyrë të tillë, thua se salla ishte bosh fare. Befas Ravikut iu kujtuan fjalët që i pati thënë Marozovi për Xhoanën. Ajo kaloi shumë afër tryezës së tyre. Atij iu duk sikur e vuri re; por vështrimi i saj rrëshqiti mbi të me mospërfillje dhe ajo doli nga lokali.

– E njihnit atë grua? – pyeti Keti Hegshtrëmi, e cila e pati vërejtur Ravikun me vëmendje.

– Jo.

8

– I shikoni këto, Veber? – pyeti Raviku. – Ja, këtu... edhe këtu... edhe këtu...

Veberi u përkul mbi plagën e hapur, të mbajtur me klema.

– Po.

– Këto tuberkula të vogla që shihni, nuk janë as tumore, as aderenca...

– Jo...

Raviku drejtoi trupin.

– Kancer, – tha ai. – Rast kanceri! I qartë dhe i padiskutueshëm! Operacioni më ters që kam bërë prej kohësh: me spekulum nuk dallohet asgjë; ekzaminimi nga sipër tregon vetëm një zbutje të lehtë në njërën anë, pak enjtje, domethënë mundësinë e një cisti ose të një fibromiome... asnjë me rëndësi të madhe; meqë nuk mund të ndërhyjmë nga poshtë, fusim thikën... kur, papritur e pa kujtuar, gjejmë kancerin!

Veberi e vështroi drejt e në sy.

– Çfarë keni ndër mend të bëni tani?

– Duhet të shohim më parë rezultatin e biopsisë. A do të jetë akoma në laborator Buasoni?

– Me siguri.

Veberi porositi infermieren ta merrte në telefon laboratorin. Ajo iku me të shpejtë, pa bërë as më të voglën zhurmë me këpucët prej gome.

– Duhet ta hapim më tej... Të bëjmë histerektominë, t'ia heqim mitrën, – tha Raviku. – S'kemi ç'të bëjmë tjetër. Por e keqja është se ajo nuk di gjë... Si e ka pulsin? – e pyeti infermieren që po merrej me narkozën.

– Të rregullt. Nëntëdhjetë.

– Po tensionin?

– Njëqind e njëzet.

– Mirë. – Raviku vështroi trupin e Keti Hegshtrëmit, që, me kokën varur poshtë, në pozicionin gjinekologjik, qe shtrirë atje mbi tryezën e operacionit. – Duhej ta kishim vënë në dijeni të kësaj pune përpara se ta operonim. Duhej të jepte pëlqimin e vet. S'na lejohet t'ia fusim thikën ashtu si pa të keq... Apo na lejohet?

– Sipas ligjit jo. Por... ne tani i kemi hyrë kësaj pune, kemi filluar...

– Ishim të detyruar. Histerektominë s'mund ta bënim nga poshtë. Kurse tani ndodhemi përpara një operacioni krejt tjetër. Është ndryshe të heqësh një mitër dhe ndryshe të bësh një kyretazh.

– Kam përshtypjen se ju gëzoni plotësisht besimin e saj, Ravik.

– Nuk e di. Ndoshta. Por të them se ajo do të ishte dakord me këtë gjë... këtë s'e them dot me siguri... – Ai rregulloi me bërryl përparësen prej llastiku që i kishte shkarë mbi bluzën e bardhë. – Sidoqoftë... po provoj njëherë të vazhdoj më tej. Pastaj përsëri mund të vendosim në duhet ta heqim mitrën ose jo. Ëzheni, sillmëni bisturinë!

Ai e bëri prerjen gjer në kërthizë dhe i zuri me klema enët e vogla të gjakut. Pastaj të mëdhatë i mobilizoi me ligaturë të dyfishtë; mori një bisturi tjetër dhe e preu linjën alba. Muskujt përposh i veçoi me kurrizin e bisturisë; sakaq ngriti peritoneumin, e hapi dhe e zuri gjithashtu me klema.

– Dilatatorin!

Aparatin zgjerues infermierja po e mbante gati. Ajo e vendosi zinxhirin me peshë në mes të këmbëve të Keti Hegshtrëmit dhe preu paretin e mëshikëzës urinare.

– Pece!

Ai futi pecet e njomura e të ngrohta, zbuloi kavitetin abdominal dhe vendosi me kujdes pincat. Pastaj ngriti sytë.

– Shikoni këtu, Veber!... Edhe këtu... këtë ligament të gjerë, këtë masë të trashë e të fortë. Është e pamundur ta përdorësh këtu "pincën Koher". Ka përparuar shumë!

Veberi vështronte syzgurdulluar vendin që po i rrëfente Raviku.

– E shikoni këtë këtu? – tha Raviku. – Nuk kemi mundësi t'i kapim arteriet me klema. Janë të sklerozuara. Edhe këtu po bulon e shpërthen kanceri. Rast i pashpresë.

Ai shkëputi me kujdes një pjesëz nga organi.

– A ishte Buasoni në laborator?

– Po, – tha infermierja. – I telefonova dhe ai po të pret.

– Mirë. Çojani këtë. Mund ta presim rezultatin e biopsisë. S'besoj të zgjatë më shumë se dhjetë minuta.

– I thoni të na telefonojë, – tha Veberi. – Menjëherë. Ne po e ndërpresim operacionin.

Raviku drejtoi trupin.

– Si është pulsi?

– Nëntëdhjetë e pesë.

– Tensioni?

– Njëqind e pesëmbëdhjetë.

– Mirë. Veber, unë besoj se tani nuk kemi pse ta vrasim më mendjen në ta operojmë me ose pa pëlqimin e saj. Nuk kemi ç'të bëjmë më.

Veberi pohoi me kokë.

– Ta qepim, – tha Raviku. – T'ia heqim fëmijën, kjo është e gjitha. Ta qepim dhe të mos i themi asgjë.

Ai qëndroi një copë herë ashtu i heshtur dhe soditi trupin e hapur që shtrihej atje në mes çarçafësh të bardhë. Nga drita tepër e fortë çarçafët dukeshin edhe më të bardhë, si dëborë e porsarënë, përposh së cilës gogësinë krateri i kuq i plagës së hapur. Keti Hegshtrëmi, tridhjet e katër vjeçe, pak tekanjoze, trupbrishtë, zeshkane, e mbajtur mirë, plot dëshirë e vullnet për të jetuar – e dënuar me vdekje nga ato kthetra mjegullisht të padukshme, që ia kishin shkatërruar qelizat.

Ai u përkul përsëri mbi atë trup.

– Po ne kemi edhe një punë për të kryer...

Fëmija! Në këtë trup që po shkatërrohej, po rritej edhe një krijesë tjetër, e verbër, e pafuqishme. Një krijesë që gjithashtu ishte e dënuar të vdiste. Një qenie, një diçka, që akoma po ushqehej nga trupi i së ëmës, që thithte pa ndërprerje, që kërkonte vetëm të rritej e të rritej... një diçka, që dikur do të dëshironte të luante ndër kopshte, do të dëshironte të bëhej dikushi – inxhinier, prift, ushtar, vrasës, njeri... një diçka, që do të dëshironte të jetonte, të vuante, të njihte lumturinë dhe, së fundi, të thyhej përgjithmonë...

Instrumenti shkau me kujdes përgjatë paretit të padukshëm, e gjeti rezistencën, e këputi me kujdes dhe e nxori jashtë... Mbaroi... Mbaroi e ardhmja e panjohur, mbaroi frymëmarrja e pajetuar, klithja e hareshme, ankimi, rritja, pjekuria. Nuk mbeti asgjë përveç pak mish i zbehtë e i vdekur dhe pak gjak që po mpiksej...

– A njoftoi gjë Buasoni?

– Akoma jo. S'besoj të vonohet.

– Mund të presim edhe ca minuta.

Raviku u largua nga tryeza e operacionit.

– Pulsi?

Pas telit në formë harku që mbante çarçafin të mos binte mbi fytyrën e pacientes, ai vuri re sytë e Keti Hegshtrëmit. Ajo po e vështronte... jo me shikim të ngrirë, por sikur po e shihte me të vërtetë dhe sikur i dinte të gjitha. Për një çast ai pandehu se qe përmendur nga narkoza. U zmbraps një hap dhe përsëri u step. E pamundur! Do të ketë qenë diçka e rastit... ndoshta e kishte fajin drita...

– Sa e ka pulsin?

– Njëqind. Tensionin njëqind e dymbëdhjetë. Po i bie.

– Tani s'na pret më koha, – tha Raviku. – Buasoni duhej të kishte mbaruar punë.

Zilja e telefonit tringëlloi e mbytur nga paradhoma. Veberi vështroi në drejtim të derës. Raviku nuk i shpuri sytë fare andej, por qëndroi në pritje. Pastaj dëgjoi derën tek hapej. Infermierja hyri dhe iu afrua Veberit.

– Po, – tha Veberi. – Ishte kancer.

Raviku tundi vetëm kokën dhe iu përvesh menjëherë punës. Liroi pincat dhe klemat. Nxori jashtë dilatatorin dhe pecet. Pranë tij Ëzhenia numëronte instrumentet. Pastaj filloi ta qepte plagën. Bënte një punë të hollë, metodike, të saktë, i përqendruar sa s'ka më dhe krejt i patrubulluar. Varri u mbyll, lëkurët puthtisën gjer tek e fundmja, te më e jashtmja; ai i dha fund punës dhe drejtoi trupin.

– Mbaroi.

Ëzhenia e ktheu tryezën e operacionit përsëri në pozicion horizontal dhe e mbuloi Keti Hegshtrëmin.

Sheherezadja, mendoi Raviku... Jo më larg se pardje ajo kishte veshur një fustan të blerë në magazinën Menbosher... A keni qenë ndonjëherë i lumtur?... Shpesh, Keti... Kam frikë, Ravik... Është diçka krejt e rëndomtë, Keti... Cigani i binte violinës.

Raviku i hodhi një sy sahatit të madh mbi derën e sallës së operacionit. Ishte ora dymbëdhjetë. Kohë dreke. Jashtë hapeshin tani dyert e zyrave e të fabrikave dhe njerëz të shëndoshë vërshonin në rrugë... Dy infermieret e nxorën jashtë sallës tryezën e sheshtë të operacionit. Raviku hoqi me rrëmbim dorezat prej llastiku, hyri në banjë dhe filloi të lahej.

– Hiqeni cigaren, – i tha Veberi që po lante duart pranë tij, në lavamanin tjetër. – Po digjni buzët!

– Po, falemnderit. Kush do ta marrë përsipër t'ia thotë tani asaj, Veber?

– Ju, – ia priti Veberi aty për aty.

– Duhet t'ia shpjegojmë, përse e kemi operuar. Ajo e dinte se do të ndërhynim vetëm nga poshtë. S'kemi si t'ia kallëzojmë çfarë kishte në të vërtetë.

– Kam shpresë se do të sajoni ndonjë gjë, – tha Veberi me bindje.

– Vërtet thoni?

– Natyrisht. Gjer në mbrëmje keni mjaft kohë.

– Pse nuk e merrni përsipër t'ia thoni ju?

– Mua nuk do të më besonte. Ajo e di që e keni operuar ju dhe do të kërkojë ta marrë vesh prej jush. Po të filloja të dërdëllisja unë, ajo do të dyshonte menjëherë.

– Keni të drejtë.

– Nuk e kuptoj si arriti të zhvillohet kaq shpejt ky kancer!

– Ashtu zhvillohet. Ah, sikur ta dija çfarë t'i thosha!

– Do t'ju bjerë diçka ndër mend, Ravik. Me siguri. Ndonjë punë cisti ose fibromiome.

– Po, – tha Raviku. – Ndonjë punë cisti ose fibromiome...

*
* *

Natën ai shkoi edhe njëherë në klinikë. Keti Hegshtrëmi po flinte. Në mbrëmje ishte zgjuar, kishte vjellë, kishte kaluar një orë plot shqetësime në shtrat e pastaj e kishte zënë përsëri gjumi.

– Ju pyeti për ndonjë gjë?

– Jo, – tha infermierja faqekuqe. – Ishte akoma shumë e shushatur dhe nuk pyeti asgjë.

– Ma ha mendja se nuk do të zgjohet më gjer nesër. Por në i daltë gjumi dhe ju pyet, i thoni se gjithçka kaloi mirë. I thoni të mos e prisë terezinë, por të flejë. Në qoftë nevoja, i jepni ndonjë ilaç për gjumë. Po të ketë shqetësime, merreni në telefon doktor Veberin ose mua. Në hotel do të lë shënim se ku ndodhem.

Ai doli në rrugë dhe iu duk vetja si dikush që shpëtoi edhe njëherë nga diçka. I kishin mbetur vetëm disa orë afat dhe pastaj do t'i duhej të dilte përpara një fytyrëze të njohur e të dhembshur e t'i këpuste një gënjeshtër me bisht. Nata iu duk papritmas e ngrohtë dhe vezulluese. Ndohtësinë e murrme të jetës po e mbulonin edhe njëherë me bamirësi disa orë të qeta, të dhuruara, që rrihnin flatrat si një trumbë pëllumbash. Por edhe ato ishin gënjeshtra – njeriut nuk i dhurohej asgjë; ato orë ishin vetëm një e shtyrë, një e zvarritur...

Erjonixx

Por çfarë nuk mund të quhet zvarritje në këtë jetë? A nuk ishte gjithçka një shtyrje, një zvarritje bamirëse, një flamur i larmë, që mbulonte atë portën e largët, të zezë, e cila të avitej gjithnjë e më fortë, pa pikën e mëshirës?

Ai u fut në një bar dhe u ul në një tryezë mermeri pranë dritares. Lokali ishte plot tym e plot zhurmë. Kamerieri iu afrua.

– Një *Dybone* dhe një paketë cigare *Kolonial!*

Raviku e hapi paketën dhe ndezi një nga ato cigaret me duhan të zi. Pranë tij, ca francezë diskutonin për qeverinë e korruptuar dhe për Paktin e Mynihut. Raviku i dëgjonte me gjysmë veshi. Çdokush e dinte se bota po voziste në mënyrën apatike drejt një lufte të re. Askush nuk kishte ndonjë kundërshtim... Shtyrje... edhe një vit zvarritje... Kjo ishte e tëra, për kaq gjë kishin fuqi të luftonin njerëzit. Edhe këtu një shtyrje... gjithmonë e njëjta gjë.

Ai e piu gotën me *Dybone*. Aroma e ëmbël dhe mbytëse e aperitivit ia rrudhi gojën dhe e mbushi me neveri. Pse e kishte porositur vallë? I bëri shenjë kamerierit që të vinte.

– Më sillni edhe një konjak!

Pastaj zuri të vështronte tej xhamave që të shkundej pakëz nga mendimet. Kur njeriu s'ishte i zoti të bënte gjë, atëherë, të paktën, le të mos e çmendte veten duke i bluar dhe ribluar mendimet. Atij iu kujtua se në ç'rrethana ky pësim i ishte bërë mësim. Dhe ishte një nga mësimet më të mëdha që kishte marrë në jetë...

Ndodhi në gushtin e 1916-s, në afërsi të qytetit belg Ypern. Një ditë më parë, kompania e tyre sapo ishte kthyer nga fronti. Pati qenë një sektor i qetë i vijës së zjarrit, ku ata, për të parën herë që kur i kishin thirrur nën armë, patën rastin të njiheshin së afërmi me të. Por asgjë nuk u kishte ndodhur. Dhe tani, nën rrezet e ngrohta të diellit të gushtit, po rrinin rreth një zjarri të vogël e po piqnin ca patate që i kishin psonisur diku nëpër arat aty rrotull. Një minutë më vonë asaj copëze vatre s'i mbeti as nami as nishani. Një breshëri e papritur artilerie... një granatë, e cila pëlciti mu në mes të zjarrit të tyre... Kur ai e mblodhi veten përsëri nga gjithë ai llahtar dhe pa se kishte shpëtuar shëndoshë e mirë, vuri re se dy nga shokët e tij kishin mbetur top në vend... ndërsa pak më tej i zunë sytë Paul Mesmanin, shokun e vet të fëmijërisë, të cilin e njihte që kur kishin mësuar të dy të hidhnin hapat e parë; bashkë kishin luajtur, bashkë kishin bërë sa e sa zarare, bashkë kishin shkuar në shkollë dhe kurrë s'ishin shqitur nga njëri-tjetri... Dhe tani Paul Mesmani dergjej atje, ca hapa më tej, me bark e stomak të çarë si mos më keq dhe me zorrët jashtë...

E vunë mbi një cohë çadre dhe e bartën gjer te spitali fushor, duke i rënë sa më shkurt, mes për mes një are e pastaj përpjetë një shpati kodre. Ishin katër veta që e bartën, duke e mbajtur secili nga një cep i çadrës; dhe ai qe shtrirë atje, mbi atë cohë të murrme, me duart e groposura në zorrët e bardha, të dhjamura e të gjakosura, me gojën e çapërlyer nga gulçimat e me sy tmerrësisht të zgurdulluar nga dhimbjet.

Dy orë më vonë vdiq. Gjatë njërës prej këtyre dy orëve ulëriti pa pushim.

Ravikut iu kujtua çfarë ndodhi pasi u kthyen nga spitali. Ai kishte vajtur dhe ishte strukur pastaj, i ngrirë e i shushatur, në një kënd të barakës. Ishte hera e parë që pati jetuar diçka të tillë. Atje e gjeti më vonë Katçinski, togëkomandanti i tij, në jetën private këpucar. "Çohu dhe eja me mua", i pati thënë ai. "Pijetorja jonë është furnizuar sot me birrë e konjak. Do të gjejmë bile edhe suxhuk." Ai e kishte vështruar krejt i shtangur. Nuk e kishte kuptuar dot këtë lloj brutaliteti. Katçinski e pati soditur një copë herë me vërejtje, pastaj i kishte thënë: "Do të vish me mua se s'bën. Po të jetë nevoja, do të të marr përpara me dru. Sonte do të zhdëpesh së ngrëni dhe së piri, dhe pastaj do të shkosh edhe në bordel." Ai nuk i pati dhënë përgjigje fare. Katçinski i qe ulur pranë. "Unë e kuptoj ku të dhemb. Bile e di dhe ç'mendon këtë çast për mua. Por unë po mbush dy vjet në ushtri, kurse ti vetëm dy javë. Dëgjo këtu! A kemi si e ndihmojmë më Mesmanin?... Jo!... Ti a e beson se ne do të bënim çmos sikur të kishte qoftë edhe një fije shprese për ta shpëtuar?" – Atëherë ai kishte ngritur sytë. Po, këtë e besonte. E dinte se Katçinski ishte nga ata burra që i bënin të gjitha. – "Mirë, pra. Ai ka vdekur tani. Ne s'kemi ç't'i bëjmë më. Por pas dy ditësh do të na ngrenë që këtej me gjithë lecka dhe do të na degdisin përsëri në front. Këtë radhë s'ma merr mendja se do ta kalojmë edhe aq rehat andejza. E, po vazhdove të rrish këtu si tutkun e të mos e heqësh Mesmanin nga mendja, kokës sate do t'i bësh dëm. Do të shkatërrosh nervat, do të humbasësh sigurinë në vetvete. Mjafton të humbasësh pusullën vetëm aq, sa të mos jesh i shpejtë sa duhet në luftimin e ardhshëm. Një gjysmë sekonde hezitim – dhe do të tërheqim zvarrë, siç tërhoqëm Mesmanin. Kujt i vlen kjo? Mesmanit? Jo. Dikujt tjetër? Jo. Vetëm ti do të merrem më qafë – kjo është e gjitha. A më kupton tani?" – "Po. Por nuk mundem." – "Kyçe, të them! Mundesh që ç'ke me të! Edhe të tjerët kanë mundur. Nuk je ti as i pari as i fundit!"

Pas asaj nate ai pati marrë veten disi. Kishte vajtur me

Katçinskin, e kishte mësuar leksionin e parë. Ndihmo, po munde. Bëj çdo gjë, po munde... Por, në mos qofsh më i zoti të bësh gjë – atëherë harro! Kthe kokën dhe mbahu fort! Mëshira është diçka që u shkon kohëve të qeta, të paqta. Mëshira nuk bën kur vjen puna për jetë o vdekje. Varrosi të vdekurit – dhe kapërdije jetën, ekzistencën tënde! Do të të duhet kjo jetë. Të mbash zi është diçka – kurse fakti, e vërteta, është diçka tjetër. Njeriu nuk mban zi më pak, në qoftë se, megjithatë, e shikon të vërtetën drejt e në sy dhe e pranon që është e vërtetë. Vetëm kështu mund të mbijetosh...

Raviku zbrazi gotën e konjakut. Në tryezën pranë, francezët akoma po grinin sallatë për qeverinë e tyre. Për dështimin e Francës. Për Anglinë. Për Italinë. Për Çambërlenin... Llafe, vetëm llafe. Të vetmit që vepronin, ishin ata të tjerët. Jo se qenë më të fortë, por vetëm më të vendosur. Ata nuk ishin më trima, por vetëm se e dinin që të tjerët nuk do të luftonin. Shtyrje – po përse vlente kjo shtyrje? Për t'u armatosur, për t'i arritur të tjerët, për t'u shkundur? Jo – vetëm për të bërë sehir se si të tjerët vazhdonin të armatoseshin gjer në dhëmbë... dhe për të pritur, për të shpresuar në ndonjë shtyrje tjetër, duke ndenjur duarkryq. Kjo ishte si ajo historia e kopesë së luanëve të detit. I gjeje me qindra në breg, dhe në mes tyre shikoje gjahtarin që i merrte mbarë, njërin pas tjetrit, duke u rënë me çomage kokës. Të gjithë bashkë, ata mund ta shtypnin e ta bënin petë fare lehtë... Por ja që rrinin atje e shtriqeshin, e shikonin se si po u afrohej, po i vriste – e prapëseprapë nuk tundeshin nga vendi; fundja, ai po dërgonte në atë botë fqinjin – njërin fqinjë pas tjetrit... Kjo ishte historia e luanëve europianë të detit. Perëndimi i qytetërimit. Një muzg i purpurt perëndish, por një muzg i lodhur, i kapitur, i paformë. Flamuj të zvetënuar të të drejtave njerëzore. Shitblerja e një kontinenti. Apokalipsi që po avitej. Bakallëqe të ndyra, allishverishe për çmimin e fundit. Vallja e vjetër dhe e njohur, vallja e mjerueshme mbi një vullkan në shpërthim e sipër. Popuj që i kanë vënë përpara e po i shpien rishtaz në thertoren e madhe. Po të bëhej kurban dashi, pleshtat do të bënin si do të bënin dhe do të shpëtonin me siguri – ashtu si gjithmonë.

Raviku shoi cigaren në tavllë. Pastaj hodhi një sy rreth e rrotull. E ç'po i bluante këto mendime? A nuk iu pat dukur nata qëparë porsi një pëllumb, porsi një pëllumb i butë e i murrmë? Varrosi të vdekurit – dhe kapërdije jetën, ekzistencën tënde! Koha është e shkurtër. Të kapërcesh – është gjithçka. Dikur do të ta kenë nevojën. Për këtë "dikur" duhej ta mbaje veten të pacenuar e të gatshëm...

Ai i bëri shenjë kamerierit që të vinte për të marrë të hollat.

Erjonixx

*
* *

Kur hyri në *Sheherezade*, lokali ishte kredhur pothuajse në errësirë të plotë. Orkestra e ciganëve po luante, dhe vetëm drita e projektorit binte e plotë mbi tryezën ku qe ulur Xhoanë Maduja.

Raviku u ndal te pragu. Një kamerier u afrua dhe i rregulloi një tryezë. Por Raviku s'u tund nga vendi dhe vazhdoi të vështronte Xhoanë Madunë.

– Vodkë? – pyeti kamerieri.

– Po. Një shishe.

Raviku u ul. Mbushi një gotë me vodkë dhe e piu shpejt e shpejt. Donte të shpëtonte nga mendimet që e patën pllakosur qëparë. Donte ta shuante nga kujtesa surratin e së kaluarës dhe surratin e vdekjes..., një bark të çarë nga predhat dhe një bark të ngrënë nga kanceri. Vuri re se kishin zënë vend në po atë tryezë ku qe ulur para dy ditësh me Keti Hegshtrëmin. Pranë tij u lirua një tryezë tjetër. Ai nuk e ndërroi vendin. S'kishte ndonjë rëndësi në rrinte në këtë apo në atë tryezë – kjo nuk i bënte ndonjë dobi Keti Hegshtrëmit. Çfarë i pati thënë njëherë ai Veberi?... Më vjen çudi se si shqetësoheni gjithmonë kur ju mbetet ndokush në dorë?! Njeriu bën sa mundet – e pastaj shkon në shtëpi. Ndryshe si do të vente halli ynë?... Po, tamam. Ndryshe si do të vente halli ynë?...

Ai dëgjoi zërin e Xhoanë Madusë që matanë, pranë orkestrës. Keti Hegshtrëmi kishte pasur të drejtë, ai zë ishte një zë që të eksitonte. Rroku për gryke shishen me vodkën e kulluar. Ja tek po kalonte tani një prej atyre çasteve kur të gjitha ngjyrat zbeheshin, jeta bëhej e murrme dhe njeriu s'kishte pikë force. Ishte ajo zbatica mistike. Ajo pauza në mes dy dihatjeve. Kafshimi i kohës, që ta brente zemrën dalëngadalë. *Santa Lucia Luntana* – këndonte zëri atje pranë orkestrës. Kënga vinte si valët e detit – nga një breg tjetër i harruar, ku lulëzonte diçka.

– Si ju duket ajo?

– Cila? – Raviku u ngrit nga vendi. Drejtori i lokalit po qëndronte pranë tij. Ai bëri një lëvizje koke në drejtim të Xhoanë Madusë.

– E mirë. Shumë e mirë.

– Ç'është e vërteta, ajo s'është ndonjë sensacion për ne. Por, megjithatë, na hyn në punë për të thyer monotoninë mes numrave të programit.

Drejtori rrëshqiti më tej me hap të lehtë. Mjekra e tij spicë nxiu për një çast në fushën e bardhë të dritës së projektorit. Raviku e ndoqi me sy dhe mori përsëri gotën e vet.

Projektori u shua. Orkestra filloi të luante një tango. Tryezat e ndriçuara dolën përsëri në pah, dhe mbi to, fytyrat e paqarta të njerëzve. Xhoanë Maduja u ngrit nga vendi i vet dhe zuri të ecte mes tryezave. Disa herë iu desh të ndalonte, sepse e pengonin çiftet që ngriheshin për të kërcyer. Raviku e vështroi, edhe ajo e vështroi. Fytyra nuk i rrëfeu pikë habie. Ajo eci drejt tij. Ai u ngrit dhe shtyu tryezën pak mënjanë. Një kamerier nxitoi për ta ndihmuar.

– Falemnderit, – i tha Raviku, – këtë e rregulloj vetë. Ajo që na nevojitet, është vetëm një gotë tjetër.

Ai e rregulloi përsëri tryezën dhe mbushi gotën e dytë që solli kamerieri.

– Kjo është vodkë, – i tha Xhoanë Madusë – Nuk e di nëse e pini.

– Posi jo. E kemi pirë bashkë njëherë. Në *Bel Ororë*.

– Aha, po!

Edhe këtu kemi qenë njëherë bashkë, mendoi Raviku. A mbahet mend se kur? Përpara tri javësh. Atëherë ti rrije këtu, e tulatur në mushamanë tënde, një shuk fatkeqësie, një gjë e shuar në gjysmerrësirë. Kurse tani...

– *Salute*! – i tha ai.

Mbi fytyrën e saj rrëshqiti një rreze drite. Ajo nuk qeshi; vetëm se u çel.

– Kisha kohë pa e dëgjuar këtë fjalë, – tha ajo. – *Salute*!

Ai e piu gotën e vet dhe vështroi gruan që kishte pranë. Vetullat e larta, sytë e larguar anash, goja – të gjitha këto, që më parë patën qenë si të mjegulluara, si të shkëputura e si pa lidhje, ishin bashkuar përnjëherësh në një fytyrë të çelur, por misterioze, në një fytyrë, e fshehta e së cilës ishte çiltërsia e saj. Ajo fytyrë nuk të fshihte gjë, por edhe nuk të rrëfente gjë. Si nuk e paskam vënë re që më parë këtë, mendoi ai. Por ndoshta në atë kohë s'ka qenë e tillë... ndoshta ka qenë e mbushur vetëm me hutim e tmerr.

– A keni një cigare? – pyeti Xhoanë Maduja.

– Vetëm algjeriane. Nga ato me duhan të zi e të fortë.

Raviku deshi të thërriste kamerierin.

– Nuk janë edhe aq të forta, – tha ajo. – Më patët dhënë njëherë një cigare të tillë. Në *Pon dë l'Alma*.

– Po, është e vërtetë.

Është e vërtetë dhe s'është e vërtetë, mendoi ai. Atëherë ti ishe

një krijesë e drobitur, e venitur, nuk ishe ti; midis nesh pati edhe ca gjëra të tjera – dhe përnjëherësh asgjë nga ato s'është më e vërtetë...

– Kam qenë edhe njëherë tjetër këtu, – tha ai. – Pardje.

– E di. Ju pashë.

Ajo nuk pyeti fare për Keti Hegshtrëmin. Rrinte aty në qoshe, e qetë dhe e lirshme, thithte cigaren dhe dukej sikur ishte e dhënë krejt pas tymosjes. Pastaj piu nga gota e vet, e qetë dhe ngadalë, dhe dukej sikur ishte e dhënë krejt pas pijes. Pas çdo gjëje që bënte, dukej sikur jepej e tëra, sado e parëndësishme që të ishte... Edhe atëherë pati qenë dhënë e tëra pas dëshpërimit – mendoi Raviku... Kurse tani s'është më aspak. Ajo shpërndante njëfarë ngrohtësie dhe shkujdesjeje të natyrshme e të sigurt. Ai nuk e dinte në vinte kjo për arsye, sepse tani për tani jetën e saj nuk e trazonte asgjë; ai ndiente vetëm rrezatimin e kësaj ngrohtësie dhe shkujdesjeje.

Shishja me vodkë ishte boshatisur.

– Do të vazhdojmë të pimë nga kjo? – pyeti Raviku.

– Ç'ishte ajo që më patët dhënë të pi atëherë?

– Kur? Këtu? Më duket se atë natë kemi përzier shumë lloje pijesh.

– Jo. Jo këtu. Atë natën e parë.

Raviku u mendua.

– S'po më kujtohet... Mos ishte konjak?

– Jo. Ngjyrën e kishte si të konjakut, por ishte diçka tjetër. U mundova ta kujtoja, por nuk e gjeta dot.

– Pse? Aq e mirë ishte?

– Jo për këtë. Por të ngrohte më shumë se çdo gjë që kam pirë në jetën time.

– Ku e pimë?

– Në një bar të vogël, në afërsi të Harkut. Mbaj mend se zbritëm disa shkallë në një qilar. Atje kishte ca shoferë dhe ca vajza. Kamerieri kishte në llërë tatuazhin e një gruaje.

– Aha, e di. Do të ketë qenë *Kalvados*. Raki molle nga Normandia. Po këtu keni pyetur?

– Nuk besoj që ta kenë.

Raviku i bëri me shenjë kamerierit.

– A keni *Kalvados*?

– Jo. Mjerisht nuk kemi. Nuk na e kërkon njeri.

– Është lokal tepër elegant për të mbajtur *Kalvados*. Sa keq që s'po e gjejmë dot. Por më e mira do të qe sikur të shkonim prapë tek ai bari. Fatkeqësisht tani s'kemi se si të shkojmë.

– Pse jo?
– A nuk duhet të qëndroni këtu akoma?
– Jo. Kam mbaruar punë për sonte.
– Mirë atëherë. Nisemi?
– Po.

* * *

Raviku nuk hoqi zor për ta gjetur barin. Lokali s'kishte pothuajse njeri fare. Kamerieri me tatuazhin e gruas në llërë u hodhi një vështrim të dyve; pastaj lëvizi nga banaku dhe erdhi të pastronte tryezën.

– Paska përparime këtu, – ia bëri Raviku. – Radhën e fundit nuk e pastroi fare.

– Të mos ulemi në këtë tryezë, – tha Xhoana. – Në atë tjetrën.

Raviku vuri buzën në gaz.

– Mos jeni supersticioze?

– Nganjëherë.

Kamerieri qëndronte përpara tyre.

– Tamam, – tha ai dhe fryu muskujt e krahut, duke e bërë tatuazhin të hidhte valle. – Këtu ishit ulur edhe radhën tjetër.

– E mbakeni mend?

– Patjetër.

– Duhej të ishit bërë gjeneral, – tha Raviku. – Me këtë farë kujtese që paskeni!

– Unë kurrë nuk i harroj gjërat.

– Atëherë po çuditem që jetokeni akoma... Por, a nuk ju bie ndër mend, çfarë pimë radhën e fundit?

– *Kalvados*, – ia priti kamerieri aty për aty.

– Mirë. Atë duam të pimë edhe sonte. – Raviku iu kthye Xhoanë Madusë. – Sa thjesht që zgjidhen nganjëherë problemet! Tani do të shohim në do të na shijojë po aq sa atëherë.

Kamerieri solli gotat.

– Janë dopio. Edhe radhën e fundit *Kalvados* dopio porositët.

– Ju po më kallni datën pak e nga pak, i dashur. Mos vallë e mbani mend edhe si ishim veshur atë natë?

– Me mushama. Dama mbante edhe një beretë baske.

– Paskeni humbur kot këtu. Vendin e keni në ndonjë variete.

– Po atje kam qenë, – iu përgjigj kamerieri me habi. – Në cirk. Jua

kam treguar. E paskeni harruar?

– Po. Për turpin tim më duhet ta pohoj që e kam harruar.

– Zotëria harron shpejt, – i tha Xhoanë Maduja kamerierit. – Është mjeshtër i harrimit. Ashtu siç jeni edhe ju mjeshtër i mosharrimit.

Raviku ngriti sytë. Ajo e vështroi. Ai buzëqeshi.

– Ndoshta s'jam edhe aq mjeshtër, – tha ai. – Dhe tani ta provojmë këtë *Kalvadosin... Salute!*

– *Salute!*

Kamerieri s'kishte lëvizur nga vendi.

– Po të harrojë njeriu diçka, zotëri, ajo i mungon më vonë gjatë jetës, – deklaroi ai. Për të kjo temë s'kishte shterur akoma.

– Vërtet! Kurse atë që s'e harron dot, ajo ta nxin jetën e ta bën skëterrë.

– Mua jo. Përderisa ka kaluar, ka marrë fund. E si mund të ma bëka jetën skëterrë pastaj?

Raviku e vështroi.

– Pikërisht për këtë arsye, vëllaçko. Po ju nuk qenkeni vetëm artist, qenkeni edhe njeri i lumtur... A është po ai *Kalvados?* – e pyeti ai Xhoanë Madunë.

– Është më i mirë.

Ai ia qepi sytë. Një valë e nxehtë ia skuqi ballin; e kuptoi se ç'deshi të thoshte ajo me atë fjalë, por për të kjo ishte diçka çarmatosëse. Xhoana dukej sikur s'po e çante kokën fare. Rrinte aty, në atë lokalin e zhveshur, thua se merrej vetëm me mendimet e veta. Drita e llambave elektrike pa abazhurë ishte e pamëshirshme. Dy prostituta, që rrinin ca tryeza më tutje, dukeshin nën atë dritë si gjyshet e tyre. Ndërsa asaj drita nuk i bënte asgjë. Ajo që ai pati vënë re qëpatyre në mugëtirën e klubit të natës, ekzistonte edhe këtu – e paprekur: ajo fytyrë e guximshme, e çelur, që nuk pyeste asgjë, që vetëm rrinte aty dhe priste...

Është një fytyrë e zbrazur – mendoi ai. Një fytyrë të cilën mund ta ndryshonte edhe më i lehti fllad i shprehjes. Në atë fytyrë mund të kridheshe me të gjitha ëndrrat e tua. Ishte si një shtëpi e bukur, e zbrazur, që priste të mbushej me qilima e me piktura. Si një shtëpi që i kishte të gjitha mundësitë – ajo mund të bëhej edhe pallat, por edhe fole prostitutash. Varej nga ai që do ta mbushte. Dhe, në krahasim me të, sa e kufizuar dhe e zbehtë dukej çdo gjë që ishte e mbushur deng dhe që mbante një maskë...

Ai vuri re që Xhoana e kishte zbrazur gotën e vet.

– Nderimet e mia! – i tha. – Ishte *Kalvados* dopio. Dëshironi edhe një tjetër?

– Po. Në paçi kohë.

Pse të mos kem kohë, mendoi ai. Pastaj iu kujtua se herën e fundit ajo e kishte parë në shoqëri me Keti Hegshtrëmin. Ngriti sytë dhe e pa. Fytyra e saj nuk rrëfente asgjë.

– Kam kohë, – tha ai. – Nesër në ora nëntë kam një operacion për të bërë. Punë tjetër s'kam.

– Mund të operoni kur rrini kaq vonë natën?

– Po. Kjo s'ka të bëjë fare. Është punë zakoni. Pastaj unë nuk operoj çdo ditë.

Kamerieri i mbushi gotat përsëri. Bashkë me shishen solli edhe një paketë cigaresh dhe e la mbi tryezë. Ishin të markës *Laurens* të gjelbër.

– Këto porositët edhe atëherë, apo e kam gabim? – e pyeti Ravikun me një theks ngadhënjimi në zë.

– Nuk e mbaj mend. Ju dini më tepër nga unë. Sidoqoftë, ju besoj plotësisht.

– Ashtu është, – tha Xhoanë Maduja. – Ishin *Laurens* të gjelbër.

– E shikoni! Dama ka kujtesë më të fortë sesa ju, zotëri.

– Kjo s'dihet akoma. Por, sido që të jetë, këto cigare na hyjnë në punë.

Raviku e hapi paketën dhe ia zgjati Xhoanës.

– Po në atë hotel banoni akoma? – e pyeti ai.

– Po. Vetëm se kam zënë një dhomë më të madhe.

Një trumbë shoferësh u fut brenda. Ata u ulën në një tryezë aty pranë dhe ia nisën muhabetit me zë të lartë.

– A ngrihemi? – pyeti Raviku.

Ajo bëri një shenjë pohimi me kokë.

Ai thirri kamerierin dhe pagoi.

– Mos duhet të ktheheni prapë në *Sheherezade?*

– Jo...

Ai ia mori pallton, por ajo nuk e veshi; vetëm e hodhi krahëve. Ishte një peliçe nga ato që kushtonin lirë; ndoshta mund të ishte vetëm një imitacion – por asaj i shkonte shumë dhe nuk dukej aq e pakushtueshme. E pakushtueshme është vetëm ajo që njeriut nuk i rri natyrshëm – mendoi Raviku.

– Atëherë po ju përcjell gjer në hotel, – tha ai kur u ndodhën jashtë te hyrja, ndërsa një shi i imët breronte pa zhurmë dhe pa ndërprerje.

Ajo u kthye ngadalë nga ai:

– S'do të shkojmë te ti?

Fytyra e saj ndodhej nën të tijën, shumë afër, dhe ajo kishte ngritur pak kokën për ta parë në sy. Drita e fanarit në rrugë binte e plotë mbi tiparet e saj. Piklat e imëta të shiut i vezullonin ndër flokët e bukur.

– Po, – tha ai.

Një taksi u afrua dhe qëndroi buzë trotuarit. Shoferi priti një copë herë. Pastaj kërciti gjuhën, ndezi motorin dhe vazhdoi udhën.

– Të kam pritur. A e dije që të kam pritur? – e pyeti ajo.

– Jo...

Sytë e saj shndritnin nën pasqyrimin e llambave të fanarëve. Mund të vështroje tej për tej tyre dhe ata dukeshin sikur s'kishin ndonjë fund.

– Vetëm sot të kam parë tamam, – i tha ai. – Ajo e mëparshmja nuk ke qenë ti.

– Jo, nuk kam qenë unë.

– Asgjë nga e mëparshmja nuk ka ekzistuar ndonjëherë.

– Jo. Unë e kam harruar.

Ai e ndjeu zbaticën dhe baticën e lehtë të frymës së saj. E padukshme ajo po avitej drejt tij... e butë, pa peshë, e gatshme dhe plot besim – një jetë e huaj në një natë të huaj. Ai ndjeu befas gjakun e vet. I erdhi nga diku, buçiti – dhe ishte më shumë se sa gjaku i vet: ishte jetë, ajo jetë një mijë herë e mallkuar dhe një mijë herë e brohoritur, shpesh e humbur dhe prapë e rifituar... ajo jetë që, deri përpara një ore, i ngjante një peizazhi të shkretë, të zhveshur, plot kujtime nga e djeshmja dhe pa farë ngushëllimi – kurse tani vështronte dhe i afrohej atij çasti të çuditshëm, të cilin ai s'kishte dashur ta besonte kurrë më... Ndihej si njeriu i parë në breg të detit... dhe nga valët po ngrihej diçka... e bardhë dhe farfuritëse... pyetje dhe përgjigje njëherësh... ngrihej dhe avitej e avitej... Dhe shtrëngata filloi t'ia vishte sytë...

– Më mbaj! – tha Xhoana.

Ai ia soditi fytyrën me vëmendje dhe e pushtoi ndër krahë. Supet e saj filluan t'i afroheshin, si një anije që kërkon të hyjë në liman.

– A ke nevojë të të mbaj? – e pyeti ai.

– Po.

Duart e saj u shtrënguan pas gjoksit të tij.

– Do të të mbaj.

– Mirë.

Një taksi tjetër frenoi me vërshëllimë ndanë trotuarit. Shoferi u hodhi një shikim flegmatik që të dyve. Mbi sup i rrinte një kone e veshur me një jelek leshi.

– Doni taksi? – krakariti shoferi dhe lëvizi mustaqet e verdha si kashtë.

– Vështro, – tha Raviku. – Ai atje nuk di asgjë. Nuk di që na ka pushtuar diçka. Ai na shikon dhe nuk sheh që kemi ndryshuar. Kjo është marrëzia e kësaj bote: ti mund të shndërrohesh në një engjëll, në një budalla apo në një kriminel, dhe askush nuk e vë re. Por në të mungoftë ndonjë kopsë, këtë e shohin të gjithë.

– Kjo s'është marrëzi. Është diçka e mirë. Është ajo që na lë pranë njëri-tjetrit.

Raviku e pa në sy. Pranë njëri-tjetrit – mendoi ai. Ç'fjalë! Fjalët më misterioze të botës.

– Taksi! – krakariti shoferi me padurim, por kësaj radhe me zë më të lartë, dhe ndezi një cigare.

– Eja, – tha Raviku. – Këtë mikun s'e heqim dot qafe. Ai ka përvojë pune.

– Mos na hip në taksi. Të ecim në këmbë.

– Po bie shi.

– Ky s'është shi. Është mjegull. Nuk dua taksi. Dua të bredh me ty.

– Mirë. Por të paktën lërmë të sqaroj që ndërkohë këtu te ne ka ndodhur diçka.

Raviku iu afrua makinës dhe filloi të fliste me shoferin. Burri në timon qeshi me një të qeshur mrekullisht të ëmbël, përshëndeti Xhoanën me një gjest, të cilin vetëm francezët janë të zotë ta bëjnë në të tilla raste, dhe pastaj ia shkeli.

– Qysh e sqarove? – pyeti ajo kur u kthye Raviku.

– Me anë të parasë. Është gjëja më e thjeshtë. E kuptoi menjëherë, si punëtor nate dhe cinik që ishte. U tregua zemërgjerë, me një fije përçmimi dashamirës.

Ajo qeshi dhe u mbështet pas tij. Ai ndjeu se si po i hapej diçka përbrenda, se si po zgjerohej, e ngrohtë dhe e butë dhe e pamatë, diçka që po e tërhiqte poshtë si me mijëra duar – dhe përnjëherësh iu duk e padurueshme që po rrinin ashtu pranë njëri-tjetrit, mbi ca këmbë që s'ishin veçse platforma të ngushta, qesharake dhe balancuese: në vend që të harronin gjithçka dhe të shtriheshin, t'i përgjigjeshin klithjes ngashëruese të lëkurës, kushtrimit të parë të fshehur

pas mijëvjeçarëve, kur nuk kishte akoma tru dhe pyetje dhe mundim dhe dyshim – por vetëm lumturi dehëse gjaku...

– Eja, – tha ai.

Ata ecën përmes shiut të butë drejt rrugës së shkretë e të lagur dhe befas, kur arritën në krye të saj, panë përsëri Sheshin e Yllit, që po shtrihej para tyre i madhërishëm e i pamatë dhe, atje larg, si i varur pezull, dallohej mes mjegullës së argjendtë qemeri i trashë e i murrmë i Harkut të Triumfit.

Erjonixx

9

Raviku po kthehej në hotelin e tij. Kur iku që andej në mëngjes, Xhoanën e la në gjumë. Kishte pandehur se do kthehej pas një ore, kurse tani kishin kaluar tri orë.

– Ej, doktor! – i thirri dikush që i doli përpara te shkallët, teksa po ngjitej në katin e dytë.

Raviku e vështroi atë burrë. Një fytyrë e zbehtë, një tufë flokësh të zinj e të pashtruar, një palë syze. Ai nuk e njihte këtë njeri.

– Alvares, – tha burri. – Haime Alvares. S'po ju kujtohem?

Raviku tundi kokën.

Burri u përkul dhe ngriti pantallonin e njërës këmbë. Shenja e një plage të mbyllur zgjatej që nga kërciri gjer sipër te gjuri. – A ju kujtohem tani?

– Unë jua kam bërë këtë operacion?

Burri bëri një shenjë pohimi me krye:

– Më operuat mbi një tryezë kuzhine, në prapavijat e frontit. Ishte një spital ushtarak provizor në Aranhues... Një vilë e vogël, e bardhë, në mes të një kopshti bajamesh. Ju bie ndër mend? Raviku e ndjeu përnjëherësh aromën e rëndë të luleve të bajames. E nuhati, a thua se ajo erë po ngjitej që përposh shkallinave të errëta të hotelit – e ëmbël në të kalbur, padallimisht e përzier me erën akoma më të ëmbël e më të kalbur të gjakut.

– Po, – tha ai. – Më bie ndër mend.

Të plagosurit i patën shtruar radhë-radhë mbi tarracën e ndriçuar nga një hënë e plotë. Disa aeroplanë gjermanë dhe italianë e kishin bërë atë kasaphanë: fëmijë, gra, fshatarë, të copëtuar nga cifla bombash – një fëmijë pa fytyrë; një grua me barrë me bark e stomak

të hapur gjer te gjoksi; një burrë plak, i cili, i frikësuar sa s'ka më, mbante në njërën dorë gishtërinjtë e prerë të dorës tjetër, sepse besonte që do të mund t'ia qepnin përsëri. Dhe mbi të gjitha këto nderej aroma e rëndë e natës dhe vesa e lagësht...

– Po këmbën e keni në rregull tani? – pyeti Raviku.

– Pothuajse. Por akoma nuk mund ta përkul gjurin plotësisht. – Burri vuri buzën në gaz. – Të paktën e kisha aq në rregull, sa të kaloja Pirenejtë. Gonsalesi vdiq.

Ravikut nuk i kujtohej se cili ishte ky Gonsalesi. Por tani iu kujtua dikush tjetër: një student i ri, i cili e pati ndihmuar shumë gjatë operacioneve.

– Mos e dini se ç'u bë me Manolon?

– E zunë rob dhe e pushkatuan.

– Po Serna, komandanti i brigadës?

– U vra. Përpara Madridit. – Burri vuri përsëri buzën në gaz. Ishte një buzëqeshje e ngrirë, automatike, që vinte vetvetiu dhe që ishte pa pikën e emocionit. – Edhe Murën dhe La Penën i zunë. I pushkatuan.

Ravikut nuk i binte ndër mend fare se cilët ishin Mura dhe La Pena. Ai ishte larguar nga Spanja pas gjashtë muajsh, kur fronti qe çarë dhe spitali qe hequr fare.

– Karneroja, Orta dhe Goldshtajni ndodhen në kamp përqendrimi, – vazhdoi Alvaresi. – Në Francë. Edhe Blacki ndodhet në siguri. I fshehur diku pas kufirit.

Ravikut i kujtohej vetëm Goldshtajni. Asokohe kishte parë shumë e shumë fytyra dhe nuk i mbante dot mend të gjithë.

– Edhe ju në këtë hotel banoni tani? – e pyeti spanjollin.

– Po. Pardje zumë disa dhoma nga ajo anë atje. – Burri rrëfeu me dorë dhomat në katin e dytë. – Qëndruam shumë kohë në kampin e përqendrimit, atje pranë kufirit. Tani na liruan më në fund. Na kishin mbetur edhe ca para. – Ai buzëqeshi sërish. – Ah, shtretër! Përsëri shtretër të vërtetë! Ky është hotel i mirë. Bile edhe fotografitë e udhëheqësve tanë i kemi ndër mure.

– Po, ashtu është, – tha Raviku pa kurrfarë ironie në zë. – Duhet të jetë diçka e kënaqshme për ju, pas gjithë asaj që hoqët atje matanë.

Ai u përshëndet me Alvaresin dhe u ngjit në dhomën e vet.

*

* *

Dhoma ishte pastruar dhe rregulluar, por ishte bosh. Xhoana

kishte ikur. Ai hodhi sytë përqark. Ajo s'kishte lënë asnjë shënim. Por edhe ai s'kishte pritur ndonjë gjë të tillë.

I ra zileS. Vajza që shërbente në kate, erdhi pas pak.

– Dama ka ikur, – ia bëri ajo, përpara se ai të mund ta hapte gojën.

– Këtë e mora vesh vetë. Po ku e dini ju që paska pasur njeri këtu?

– Ama edhe ju, zoti Ravik! – tha vajza dhe e la me kaq, duke shtrembëruar fytyrën, a thua se ishte prekur rëndë në sedër.

– Po mëngjesin ia sollët?

– Jo. Unë nuk e pashë. Ndryshe do të isha kujdesur vetë. Kaq gjë e kam mësuar te ju!

Raviku e vështroi. Fjalët e fundit s'para i pëlqyen shumë. Ai nxori ca franga dhe ia futi vajzës në xhepin e përparëses.

– Bukur fort, – i tha. – Herën tjetër veproni prapë kështu. Silleni mëngjesin vetëm po t'ju them unë. Dhe mos më hajdeni për të ndrequr dhomën, në qoftë se nuk e dini me siguri që do ta gjeni bosh.

Vajza i buzëqeshi me familjaritet.

– Si urdhëroni, zoti Ravik.

Ai e vështroi shtrembër gjersa doli nga dhoma. E dinte se ç'bluante në kokë vajza. Kujtonte se Xhoana ishte grua e martuar dhe s'donte ta shihnin të tjerët. Kohë më parë atij do t'i kishte ardhur për të qeshur. Por tani nuk i pëlqeu kjo gjë. Po pse ndodh kështu? – mendoi. Sakaq ngriti supet dhe iu afrua dritares. Hotelet ishin hotele. Kjo ishte diçka që s'mund të ndryshohej.

Ai hapi dritaren. Në atë orë mesdite mbi shtëpitë nderej një qiell plot re. Trumcakët cijatnin nëpër ullukët e shiut. Një kat më poshtë grindeshin dy zëra. Duhej të qe familja Goldberg. Burri ishte njëzet vjet më i madh se e shoqja. Tregtar grosist bereqeti nga Breslau. E shoqja kishte marrëdhënie me emigrantin Vizenhof. Ajo pandehte se askush nuk e dinte këtë gjë. I vetmi që nuk e dinte, ishte Goldbergu.

Raviku e mbylli dritaren. Atë paradreke pati operuar një mëshikëz tëmthi. Një mëshikëz tëmthi anonime për Dyranin. Ia kishte futur thikën një barku të panjohur burri, në emër të Dyranit. Dyqind franga honorar. Pas operacionit kishte shkuar ta shikonte Keti Hegshtrëmin. E gjeti me temperaturë. Me temperaturë më të lartë nga ç'duhej. Kishte qëndruar një orë në dhomën e saj. Ajo pati bërë një gjumë të trazuar. Kjo s'ishte asgjë e jashtëzakonshme. Por e mira do të qe sikur të mos ishte ashtu.

Erjonixx

Ai vështroi jashtë dritares me shikim të ngrirë, të ngulitur diku. Ishte pushtuar prej asaj ndenje të çuditshme e të zbrazët të asaj që kalon e nuk kthehet më. Në dhomë ndodhej shtrati që nuk thoshte më asgjë. Jashtë ndodhej dita e re që po e shqyente të djeshmen pa mëshirë, si një çakall, lëkurën e një sorkadheje. Ku ishin tani ato pyjet fëshfëritëse të natës, magjikisht depërtuese në errësirë, por përsëri të tretura në largësitë e pamata – të mbetura vetëm si një vegim i ndërur mbi shkretëtirën e orëve...

I ktheu krahët dritares. Diku në tryezë i zuri syri adresën e Lysienë Martinesë. Ajo kishte dalë para pak kohësh nga spitali. Nuk i kishte lënë rehat, gjersa e nxorën. Para dy ditësh ai e pati vizituar në shtëpi. Në të vërtetë s'ishte nevoja ta vizitonte prapë sot; por, meqë s'kishte punë tjetër, vendosi të kalonte njëherë nga ajo.

*

* *

Shtëpia ndodhej në rrugën *Klavel*. Në katin përdhes ishte një dyqan mishi, në të cilin një grua e bëshme e kishte marrë tani punën në dorë. Tërë ditën vërviste në hava satërin dhe priste mishin. Gruaja ishte në zi. I shoqi i kishte vdekur para dy javësh dhe ajo e drejtonte tani dyqanin bashkë me një çirak. Raviku e pa kur kaloi andej pari. Gruaja dukej sikur ishte nisur diku për vizitë. Mbante në kokë një kapelë me vello të gjatë e të zezë dhe, siç dukej, po i priste një kofshë derri, për miqësi, ndonjë të njohure, përpara se të ikte. Velloja valëvitej mbi derrin e varur në çengel, satëri vezullonte dhe kërciste mbi të.

– E preva me një të rënë, – tha vejusha e kënaqur dhe e hodhi kofshën në peshore.

Lysiena banonte në katin e sipërm, në një dhomë të vogël nën çati. Kur hyri Raviku, nuk e gjeti vetëm. Një birbo rreth të njëzetepesave qe lëshuar gjerë e gjatë mbi një karrige. Kishte ngjeshur në kokë një kasketë çiklistësh dhe pinte një cigare nga ato me të dredhur, që kur fliste, i mbetej e ngjitur në buzën e sipërme. Kur hyri Raviku, ai nuk u tund nga vendi fare.

Lysiena qe shtrirë në krevat. Ajo u turbullua dhe u skuq.

– Doktor... nuk e dija që do të vinit prapë sot... – Ajo hodhi sytë nga djaloshi. – Ky është...

– Dikushi, – e ndërpreu djaloshi me vrazhdësi. – S'është nevoja të përmenden emra këtu. – Ai u mbështet në karrige. – Kështu, ë? Ju

na qenkeni ai doktori?

– Si e ndjeni veten Lysienë? – pyeti Raviku, pa e përfillur fare birbon. – Bëtë mirë që keni qëndruar shtrirë.

– Ajo mund të qe ngritur me kohë, – deklaroi djaloshi. – Tani nuk i dhemb më asgjë. Po të mos punojë, vetëm shpenzimesh pas shpenzime do të ketë.

Raviku u kthye nga ai.

– Pa dilni njëherë jashtë, – i tha.

– Qysh?

– Jashtë! Pas derës! Dua ta vizitoj Lysienën.

Djaloshi ia plasi gazit.

– Këtë gjë mund ta bëni edhe në praninë time. Ne s'para jemi nga ata njerëzit me naze shumë. Pastaj, ç'është kjo vizitë? S'ka dy ditë që ishit këtu. Dashkeni t'ju paguajmë edhe një vizitë tjetër ekstra, ë?

– Vëllaçko, – i tha Raviku qetë e qetë. – Ju s'më dukeni nga ata që e kanë zakon të paguajnë. Pastaj, nëse kushton apo nuk kushton kjo vizitë, kjo është tjetër mesele. Dhe tani avullohuni që këtej!

Birboja u skërmit dhe shtriqi këmbët, pa e prishur terezinë. Ai mbante këpucë të zeza lustrafini me shumë majë dhe çorape ngjyrë vjollce.

– Të lutem, Bobo, – i tha Lysiena. – S'ka për të zgjatur as dy minuta.

Boboja nuk ia vari fare, por ia mbërtheu sytë Ravikut.

– Bëtë shumë mirë që erdhët, – i tha. – Tani, të paktën mund ta bëjmë muhabetin shtruar. Në pandehshi, i dashur, se mund t'i bini qarit me ndonjë faturë për punë spitali, operacioni e këso dënglash, dijeni se me mua s'keni gjë në torbë! Ne nuk kërkuam që ajo të shtrohej në spital, pale për operacion që nuk bëhej fjalë fare! Pra, hiqeni mendjen se do të mund të zhvatni ndonjë shumë të majme. Bile, mund të jeni i kënaqur që s'po ju kërkojmë ndonjë dëmshpërblim: për operacion me zor! – Ai zbardhi dhëmbët e prishur. – Po habiteni, ë? S'ke ç'i bën. Ja që Boboja është i rrahur me vaj e me uthull; s'ia hedh dot njeri.

Birboja dukej mjaft i kënaqur nga vetja. I qe mbushur mendja top se doli nga vallja për mrekulli. Lysienës s'i kishte mbetur pikë gjaku në fytyrë. Vështronte e trembur herë Bobon e herë Ravikun.

– E qartë? – pyeti Boboja me tonin e fitimtarit.

– Ky ishte ai? – e pyeti Raviku Lysienën. Ajo nuk iu përgjigj. – Domethënë, ky paska qenë! – ia bëri Raviku dhe e soditi Bobon me vëmendje.

Një zdap i hollë e i gjatë, me një shall mëndafshi artificial të lidhur rreth qafës prej lejleku, ku fikthi lëvizte sa lart poshtë. Supe të rëna, hundë tepër e gjatë, mjekër e shëmtuar – një nga ata kodoshët e përsosur të lagjeve periferike.

– Ç'do me thënë, ky paska qenë? – pyeti Boboja me ton kanosës.

– Më duket se jua thashë disa herë me radhë që të dilni jashtë. Dua të bëj një vizitë mjekësore.

– Pleh! – ia priti Boboja.

Raviku iu afrua ngadalë. Tani ky Boboja ia kishte sjellë në majë të hundës. Por birboja brofi në këmbë, u spraps disa hapa dhe se nga nxori papritur e pa kujtuar një copë të hollë litari nja një metër të gjatë. Raviku e dinte fort mirë se ç'kishte ndër mend të bënte ajo pjellë e keqe. Po t'i avitej Raviku edhe më shumë, ai do të kërcente njëherë anash dhe pastaj do t'i dilte me të shpejtë nga pas, për t'ia hedhur litarin mbi kokë e për ta shtrënguar nga fyti. Kjo metodë s'ishte e keqe, kur tjetri nuk e njihte ose kur bënte gabim t'i vërsulej kundërshtarit me grushta.

– Bobo! – thirri Lysiena. – Mos, Bobo!

– More qurravec! – i tha Raviku. – Nuk ditke ndonjë marifet tjetër, përveç litarit! Kësaj lodre i ka dalë boja. – Ai qeshi.

Boboja mbeti për një çast me gojë hapur. Sytë i morën një shprehje pasigurie. Një sekondë më vonë Raviku e zuri për jake dhe ia shqiti xhaketën nga supet poshtë, në mënyrë që të mos i lëvizte dot më krahët.

– Këtë marifetin tjetër që ti s'e dije, po ta mësoj unë, – i tha, hapi derën me të shpejtë dhe e flaku jashtë djaloshin e shushatur krejt. – Në t'i ka qejfi këto lodra, shko e bëhu ushtar, por mos u shit mend të rriturve, karafil!

Ai e mbylli derën nga brenda.

– Tani, Lysienë, mund të merremi pak me ju, – i tha vajzës.

Ajo dridhej si purtekë.

– Qetësohuni, qetësohuni. – Ai e hoqi mbulesën e pambuktë, vende-vende të grisur, dhe e vuri mbi karrige. Pastaj ngriti batanijen e gjelbër. – Pizhame? Pse i paskeni veshur pizhamet? S'janë aspak të rehatshme. S'duhet të bëni lëvizje të tepërta, Lysienë.

Ajo heshti për një çast.

– I vesha vetëm sa për sot, – ia bëri pastaj me gjysmë zëri.

– S'keni këmishë nate? Po ju dërgoj nja dy nga klinika jonë.

– Jo, s'është kjo arsyeja. I vesha pizhamet, sepse e dija... – ajo vështroi nga dera dhe vazhdoi duke pëshpëritur: – Sepse e dija që ai

do të vinte. Thotë që s'jam më e sëmurë dhe që s'ka ndër mend të presë më gjatë.

– Ashtu? Sa keq që s'e dija këtë më parë. – Raviku vështroi me inat nga dera. – Ai do të presë se s'bën!

Lysiena kishte atë lëkurën shumë të bardhë të grave anemike. Dejet e kaltra dalloheshin nën sipërfaqen e hollë. Kishte një trup të bukur, dukej pak e imët, por jo thatime. Një nga ato vajzat e panumërta, mendoi Raviku, të cilat, kur i sheh, njeriu fillon e pyet veten, pse natyra e mori vallë mundimin t'i krijonte kaq të lezetshme, kur dihej që më parë se si do të përfundonin shumica e tyre – krijesa të rropatura nga puna e rëndë, që do t'i humbisnin shumë shpejt format e bukura nga një jetë e pashëndetshme dhe plot abuzime.

– Edhe nja një javë duhet të rrini shumë në shtrat, Lysienë. Mund të ngriheni nga pak e të lëvizni nëpër dhomë. Por kini kujdes. Mos ngrini asgjë të rëndë. Dhe mos ngjitni shkallë. Keni njeri që të kujdeset për ju? Përveç këtij Bobos, dua të them?

– Të zonjën e shtëpisë. Por edhe ajo ka filluar të varë turinjtë.

– Po njeri tjetër?

– Jo. Më parë kisha Marien. Por ajo vdiq.

Raviku soditi dhomën. Një dhomë varfanjake, por e pastër. Te dritarja ishin vendosur ca vazo lulesh.

– Po ky Boboja? – pyeti ai. – Na paska mbirë përsëri, tani që kaloi gjithçka...

Lysiena nuk bëri zë.

– Pse nuk e nxirrni jashtë?

– Nuk është edhe aq i keq, doktor. Vetëm se është pak i egër...

Raviku e pa me vërejtje. Ja dashuria, tha me vete. Edhe kësaj i thënkan dashuri. Mrekullia e lashtë. Ajo nuk ngre vetëm ylbere ëndrrash në qiellin gri të të vërtetave, por është e zonja të prarojë me dritë romantike edhe një grumbull plehu... Një mrekulli dhe, njëkohësisht, një qesëndi e çmendur... Befas ai pati përshtypjen sikur, në një mënyrë apo një tjetër, ishte bërë bashkëfajtor në këtë mesele.

– Mirë, Lysienë, – i tha vajzës. – Mos u mërzitni. Shërohuni njëherë mirë.

Ajo pohoi me krye dhe sikur u lehtësua.

– Dhe ajo puna e parave, – tha pastaj me druajtje dhe pak me rrëmbim, – nuk është ashtu, siç e tha ai. Ai e tha vetëm ashtu kot. Unë do t'i paguaj të gjitha. Të gjitha. Me këste. Kur do të jem në gjendje të punoj përsëri?

– Pas nja dy javësh, po të mos bëni ndonjë marrëzi. Dhe me

3rj0n1xx.ro0t

Bobon mos u ngatërroni fare! Fare, po ju them! Ndryshe mund të vdisni. Më kuptoni, Lysienë?

– Po, – u përgjigj ajo, por zëri i saj nuk shprehte bindje.

Raviku e mbuloi trupin e brishtë me batanije. Kur ngriti sytë, pa se ajo po qante.

– Nuk ka mundësi të filloj nga puna më përpara? – pyeti ajo. – Unë mund të punoj edhe ndenjur. Më duhet të...

– Ndoshta. Do ta shikojmë. Kjo varet në do të rrini urtë këto ditët e para. S'do të ishte keq sikur të ma tregonit emrin e asaj mamisë që ju katandisi në atë gjendje.

Ai e dalloi menjëherë kundërshtimin ndër sytë e saj.

– Nuk do të shkoj në polici, filloi ta qetësonte. – Ju jap fjalën. Dua të provoj vetëm se mos ia marr ato paratë që ia keni paguar. Kjo do t'ju ndihmonte shumë. Sa i keni dhënë?

– Treqind franga. S'ka për t'jua kthyer kurrë.

– Të bësh një provë, s'është kurrë keq. Si quhet dhe ku banon? S'keni për t'ia pasur më nevojën, Lysienë. Nuk mund të lindni më fëmijë. Kurse ajo s'ka ç'ju bën fare.

Vajza ngurronte akoma.

– Hapeni atë sirtarin atje, – tha ajo pastaj. – Atje, majtas, do ta gjeni.

– Kjo pusulla këtu?

– Po.

– Në rregull. Këto ditë do të shkoj tek ajo. Mos kini frikë. – Raviku veshi pallton. – Ç'është? Pse doni të ngriheni?

– Kam hallin e Bobos. Ju s'e dini ç'kokë që ka.

Ai vuri buzën në gaz.

– Më duket se kam parë koka më të forta. Rrini në shtrat e mos u bëni merak. Me aq sa pashë unë, s'kemi pse të trembemi fare. Mirupafshim Lysienë. Do të vij t'ju shoh përsëri.

Raviku rrotulloi çelësin në bravë dhe, në të njëjtën kohë, uli edhe dorezën duke e hapur derën me rrëmbim. Në korridor nuk ndodhej asnjeri. Për këtë ai kishte qenë i sigurt që më parë; tipat si atë Bobon i njihte mirë.

Poshtë, në dyqanin e mishit, ndodhej tani çiraku, një njeri verdhacuk, të cilit i mungonte pasioni për punë i padrones së tij. Ai po e copëtonte mishin me përtesë të dukshme. Që kur i vdiq i zoti, kishte filluar të lodhej shumë. Shpresa për t'u martuar me të zonjën e dyqanit, po i shuhej dita-ditës. Një tregtar furçash, që u ndodh në barin përkarshi, i rrëfente këto gjëra me zë të lartë; ai shtoi se, sipas

mendimit të tij, ajo kishte për ta kallur edhe këtë në varr, si atë tjetrin. Çiraku kishte filluar të tretej e të thahej, kurse vejusha po lulëzonte e po fryhej sërish. Raviku piu një konjak, pagoi dhe doli. Kishte pandehur se do ta takonte Bobon në atë bar; por Boboja s'dukej gjëkundi.

*

* *

Xhoanë Maduja doli nga *Sheherezadja*. Ajo hapi derën e taksisë, në të cilën po e priste Raviku.

– Eja, – i tha ajo. – Eja të ikim që këtej. Shkojmë te ti.

– Mos ka ndodhur gjë?

– Jo. Asgjë. Vetëm se jeta e klubeve të natës më ka ardhur në majë të hundës.

– Një minutë! – Raviku i bëri shenjë luleshitëses që rrinte te hyrja e lokalit. – Nënoke, – i tha. – M'i jep të gjithë trëndafilat që ke. Sa bëjnë? Por mos ma hidh!

– Gjashtëdhjetë franga! Për ju. Sepse më patët dhënë dikur atë recetën për reumatizëm.

– Të bëri dobi?

– Jo. E ç'dobi të më bënte, përderisa rri tërë natën në lagështirë!

– Ti je pacientja më me mend që kam takuar në jetë.

Ai i mori trëndafilat.

– Me këto të kërkoj ndjesë për sot në mëngjes, që nuk gjete njeri kur u zgjove dhe që nuk të sollën për të ngrënë, – i tha Xhoanës dhe i vendosi lulet diku nga fundi i taksisë. – Ke qejf të pish diçka?

– Jo. Të shkojmë te ti. Dhe lulet mos i plas atje, por vëri këtu te ndenjësja.

– Mirë janë atje. Lulet t'i duash, por jo t'ua varësh aq shumë.

Ajo ktheu kokën me rrëmbim.

– Pra, ti thua që, atë që do, të mos e përkëdhelësh fort?

– Jo. Unë them që gjërat e bukura nuk duhen dramatizuar. Përveç kësaj, tani për tani, është më mirë të mos kemi lule midis nesh këtu, ku jemi ulur.

Xhoana e vështroi një hop me dyshim. Pastaj u çel në fytyrë.

– E di ç'kam bërë sot? Kam jetuar. Kam jetuar rishtas. Jam mbushur me frymë. Ndjeva që ekzistoja. Ndjeva rishtas që ekzistoja. Për herë të parë, pas kaq kohësh. Dhe kam përsëri duar. Dhe sy dhe gojë.

Shoferi manovronte me kujdes, që ta nxirrte taksinë nga ajo

Erjonixx

rrugë e ngushtë me një mori automjetesh të tjera. Së fundi, pasi i dha një kolpo makinës, ia shkeli lirisht. Tronditja e përplasi Xhoanën pas Ravikut. Ai e mbajti për një çast ndër krahë dhe e ndjeu të tërën. Ishte si një gulç ere, i butë e i ngrohtë, si një fllad që buronte prej saj dhe që dukej sikur po e mbështillte, sikur po ia shkrinte koren e akullt të ditës, atë ftohtësinë e çuditshme, që kishte ngritur strofkën në shpirtin e tij dhe që mundohej gjithnjë të sprapste çdo gjë të bukur... Dhe ajo rrinte aty pranë tij, dhe ai e dëgjonte tek fliste, e pushtuar e tëra nga ndjenjat e saj dhe nga vetvetja...

– Gjithë ditën... më dukej sikur buronin ngado gurra ledhatuese, sikur më spërkatnin qafën, gjoksin... më dukej sikur do të gjelbërohesha dhe do të çelja gjethe e bulëza lulesh... më dukej sikur më mbante diçka pezull, më pushtonte e nuk më lëshonte... Dhe tani ja tek jam, ja tek më ke... pranë teje... me ty...

Raviku e vështronte me vëmendje. Ajo rrinte aty pranë tij, në ndenjësen njolla-njolla të taksisë, dhe supet e saj të zhveshura zbardhëllonin më fort nga kontrasti me fustanin e zi të mbrëmjes. Në ato çaste ajo ishte krejt e çiltër, pa asnjë mendim të fshehur dhe pa asnjë druajtje, duke shprehur gjithçka që ndiente – dhe atij iu duk vetja varfanjak dhe i thatë nga shpirti përpara saj.

Unë u mora me operacione, tha ai me vete. Të harrova. Isha te Lysiena. Isha zhytur diku në të kaluarën. Pa ty. Pastaj, kur erdhi mbrëmja, erdhi e më përfshiu ngadalë edhe vala e ngrohtësisë. Unë nuk isha te ti. Mendoja Keti Hegshtrëmin.

– Xhoanë, – i tha dhe i vuri duart e tij mbi të sajat. – Ne nuk mund të shkojmë qysh tani tek unë. Më duhet të kaloj edhe njëherë nga klinika. Vetëm për disa minuta.

– Duhet ta shohësh atë gruan që ke operuar?

– Jo atë që operova sot në mëngjes. Duhet të shoh një tjetër. Ke dëshirë të më presësh gjëkundi?

– Është e nevojshme të shkosh qysh tani?

– Do të jetë më mirë. S'kam qejf të më thërresin më vonë me telefon.

– Mund të të pres në dhomën tënde. A të del koha sa të kalojmë nga hoteli yt?

– Po.

– Atëherë le të nisemi për atje. Kur të mbarosh punë, kthehu. Do të të pres.

– Mirë.

Raviku ia tha adresën shoferit. Pastaj u mbështet përsëri në ndenjëse. Duart i kishte akoma mbi duart e Xhoanës. E ndjeu që ajo

priste ndonjë fjalë prej tij. Ndonjë fjalë që të kishte të bënte me të dy. Por ai s'dinte çfarë t'i thoshte. Ajo vetë i kishte thënë qëparë të gjitha.

Taksia ndaloi.

– Ti vazhdo rrugën, – i tha Xhoana Ravikut. – Do të mbaroj punë vetë këtu. Nuk kam frikë. Vetëm më jep çelësin e dhomës.

– Çelësin e ke në hotel.

– Mirë, do ta marr në portineri. Do të mësohem edhe me këtë punë. – Ajo mori tufën e trëndafilave. – Me një burrë që më braktis duke më lënë në gjumë dhe që më vjen prapë kur nuk e pres fare, do të më duhet të mësohem edhe me plot gjëra të tjera. Prandaj po filloj qysh tani.

– Po të çoj vetë gjer lart. Le të mos e teprojmë. Mjaft që jam i detyruar të të lë tani prapë vetëm.

Ajo qeshi. Në ato çaste dukej shumë e re.

– Ju lutem, prisni një minutë, – i tha Raviku shoferit.

Shoferi ia shkeli syrin.

– Mund të të pres edhe më shumë.

– Ma jep çelësin, – tha Xhoana tek po ngjisnin shkallët.

– Pse?

– Ma jep.

Ajo hapi derën. Pastaj qëndroi te pragu.

– Bukur fort, – tha, duke iu drejtuar dhomës së errët ku, pas dritares, dallohej një hënë e shogët që llamburiste mes resh të rralla.

– I bukur? Ky kotec?

– Po, i bukur fort! Këtu gjithçka është e bukur.

– Ndoshta vetëm tani që është në errësirë. Por... – Raviku vuri dorën mbi çelësin elektrik.

– Lëre se e ndez vetë. Dhe tani shko. Por mos m'u kthe nesër në drekë!

Ajo qëndronte akoma te pragu i derës. Drita e sermtë, që derdhej nga dritarja në dhomë, i rrinte mbi krye dhe mbi supe. E tëra dukej si e mjegullt, tunduese dhe misterioze. Manteli i hollë i kishte shkarë nga supet dhe i kishte rënë te këmbët, si një tog shkume e zezë. Qe mbështetur me njërën dorë te dera dhe një pjesë e llërës i ndriçohej nga një tufë rrezesh drite që lëshonte llamba e korridorit.

– Shko dhe eja prapë, – i tha Ravikut dhe mbylli derën.

*

* *

Keti Hegshtrëmit i kishte zbritur temperatura.

– A është zgjuar ndonjëherë? – e pyeti Raviku infermieren e përgjumur.

– Po. Në orën njëmbëdhjetë. Pyeti për ju dhe unë ia thashë ato që më patët porositur.

– A foli gjë për fashat?

– Po. I thashë se ju ishte dashur të përdornit thikën. Një operacion i lehtë. Dhe se do t'ia shpjegonit vetë nesër.

– Kjo qe e tëra?

– Po. Ajo tha se, meqë ju e patë të udhës të vepronit ashtu, ishte çdo gjë në rregull. Më porositi t'ju bëj të fala, po të kalonit këndej sonte dhe t'ju them se ka besim te ju.

– Ashtu...?

Raviku qëndroi një copë herë pa lëvizur dhe soditi nga lart poshtë flokët e zinj të infermieres, që i dilnin përposh skufjes së bardhë.

– Sa vjeç jeni? – e pyeti pastaj.

Ajo ngriti kokën me habi.

– Njëzet e tre.

– Njëzet e tre. E prej sa kohësh merreni me këtë punë?

– Kam dy vjet e gjysmë. Në janar bëhen dy vjet e gjysmë.

– Ju pëlqen ky zanat?

Infermieres i rrëshqiti një buzëqeshje mbi fytyrën që e kishte si mollë të rrumbullaktë.

– E kam qejf, – deklaroi ajo dhe nuk e la me kaq, por filloi nga llafet: – Natyrisht që disa të sëmurë janë edhe të bezdisshëm, por më të shumtët janë mjaft të sjellshëm. Zonja Briso më dhuroi dje një fustan mëndafshi pothuajse krejt të ri. Dhe javën e shkuar zonja Lërne më dha një palë këpucë lustrafini; është ajo zonja që vdiq pastaj në shtëpi. – Ajo buzëqeshi prapë. – Unë nuk harxhoj pothuajse asgjë për veshje. Gjithmonë më dhurojnë diçka. Kur s'më hyn në punë ndonjë plaçkë, e këmbej te një shoqe që ka një dyqan. Kështu që nuk vuaj për asgjë. Edhe zonja Hegshtrëm është shumë bujare. Më jep të holla. Radhën e fundit më fali njëqind franga. Dhe s'kishte as dymbëdhjetë ditë që ishte shtruar te ne. Sa ditë do të qëndrojë këtë radhë, doktor?

– Shumë më tepër. Ndoshta disa javë.

Infermierja dukej e lumtur. Pas ballit të saj pa rrudha, ajo siguronte llogariste se sa të ardhura do të nxirrte nga ky shtrim kaq i gjatë. Raviku u përkul edhe një herë mbi Keti Hegshtrëmin. Frymëmarrjen e kishte të qetë. Era e lehtë e ilaçeve përzihej me parfumin

E.N

e flokëve të saj. Përnjëherësh ai filloi ta ndiente veten keq: ajo kishte besim tek ai. Besim!... Barku i ngushtë, i prerë, ku bisha-kancer vazhdonte të brente pa ndërprerje. Barku i qepur sërish – kurse ai: i pazoti të bënte gjë prej gjëje... Besim!...

– Bëfshi natën e mirë! – i tha infermieres.

– Natën e mirë, doktor!

Infermierja topolake shkoi e u rehatua në kolltukun që ndodhej në një kënd të dhomës, uli abazhurin e llambës elektrike, që drita të mos binte mbi shtratin e të sëmurës, mbështolli këmbët me një batanije dhe hapi një revistë. Ishte një nga revistat e lira me tregime policore e me fotografi artistësh kinemaje. Ajo u shtriq mirë e mirë dhe nisi të lexonte. Pranë saj, mbi një tryezë të vogël, ndodhej një copë e madhe çokollate me letër të grisur. Para se të dilte, Raviku arriti të shihte se si ajo, pa e ngritur kokën fare, këputi një copë të madhe çokollate dhe e rrasi të tërën në gojë. Nganjëherë njeriu nuk i kupton dot as gjërat më të thjeshta, mendoi ai – që në të njëjtën dhomë ndodhet një e sëmurë për vdekje, kurse tjetrës kjo gjë nuk i bën pikë përshtypje... E mbylli derën pas vetes... Po me mua a s'po ndodh e njëjta gjë? A nuk po dal edhe unë nga kjo dhomë e po shkoj në një dhomë tjetër, ku...

*

* *

Dhoma ishte e kredhur në errësirë. Dera e banjës ishte lënë pakëz hapur. Pas saj kishte dritë. Raviku ngurroi. Nuk e dinte nëse Xhoana ndodhej akoma në banjë. Por pastaj dëgjoi frymëmarrjen e saj. I ra dhomës mes për mes dhe hyri në banjë. Nuk tha asnjë fjalë. E dinte që ajo ndodhej aty dhe që nuk po flinte. Por as ajo nuk tha asnjë fjalë. Dhoma dukej sikur qe mbushur befas plot me heshtje e me pritje e me tension... si një vorbull që të thërriste në heshtje... si një greminë e panjohur, diku përtej mendimeve, nga e cila ngrihej përpjetë një avull i kuq e marramendës...

Ai e mbylli derën e banjës. Nën dritën e fortë të llambave të bardha gjithçka iu duk përsëri e afërt dhe e njohur. Hapi rubinetat e dushit. Ky ishte i vetmi dush i hotelit. Raviku e kishte blerë vetë dhe kishte paguar edhe për montimin. Ai e dinte se, kur nuk ndodhej aty, hotelierja ua kallëzonte herë pas here dushin kushërinjve dhe miqve të saj, sikur të qe ndonjë kuriozitet i rrallë.

Uji i ngrohtë iu derdh mbi lëkurë. Atje, në dhomë, qe shtrirë

Agjenti22E3

Xhoana dhe e priste. Lëkurën e kishte të lëmuar, tufa e flokëve i derdhej mbi jastëk si një valë deti e rrëmbyer që përplaset mbi zall dhe sytë i ndrisnin edhe në atë dhomë pothuajse krejt të errësuar, a thua se grumbullonin atë dritë të pakët yjesh dimërore që hynte nga dritarja, dhe e pasqyronin pastaj përsëri. Ajo qe shtrirë atje, tërë gjallëri e jetë, e shndërruar dhe drithëruese, sepse nuk i kishte mbetur më asgjë nga ajo gruaja që njohu përpara një ore; ajo përfaqësonte tani gjithçka që mund të falte kënaqësi e ngashënjim pa dashuri... E megjithatë, ai ndjeu përnjëherësh një si përçmim ndaj saj, një neveri të çuditshme, të përzier me një ndjenjë të rrëmbyer e të befasishme tërheqjeje dhe afrimi... Në mënyrë krejt të pavetëdijshme hodhi një vështrim rreth e qark; sikur banja të kishte pasur edhe një dalje tjetër, kishte shumë të ngjarë që ai të qe veshur e të kishte ikur prapë, për të pirë.

U fshi me peshqir dhe u vonua edhe ca, përpara se të dilte në dhomë. Çudi, ç'paskësh qenë kjo që e kishte pushtuar, duke ardhur fluturimthi, ashtu si nga hiçi? Një hije, një asgjë. Ndoshta ia kishte behur dhe ishte lëshuar mbi të, sepse qëparë pat qenë te Keti Hegshtrëmi. Apo ndoshta i erdhi nga ato fjalë që i pati thënë Xhoana në taksi, fjalë të thëna më shpejt e më lehtë nga ç'duhej. Apo ndoshta i dukej ashtu vetëm sepse po e priste dikush – në vend që ta priste ai... Mblodhi buzët dhe hapi derën e banjës.

– Ravik, – i foli Xhoana nga errësira. – *Kalvadosin* e ke mbi tryezën pranë dritares.

Ai u ndal në vend. E kuptoi sé tërë atë kohë pati qenë me nerva të tendosura. Sikur ajo t'i kishte thënë diçka tjetër, ndoshta s'do ta duronte dot. Kurse kjo që i tha tani, ishte pikërisht ajo që i duhej. Tendosja filloi të lirohej e t'i lëshonte vendin qetësisë dhe sigurisë.

– E paske gjetur shishen? – e pyeti ai.

– Nuk hoqa shumë zor. E gjeta mbi tryezë. E vetmja punë që bëra, ishte që e hapa. Tapënxjerrësen e zbulova diku mes rraqeve të tua. Mbushma edhe mua një gotë.

Ai mbushi dy gota dhe ia solli njërën.

– Merre...

Sa mirë që e ndieje forcën e atij lëngu të kulluar mollësh! Sa mirë që Xhoana kishte gjetur qëparë fjalët e duhura.

Ajo ngriti kokën dhe piu. Flokët iu derdhën mbi supe, dhe në këtë çast dukej e dhënë krejt pas të pirit dhe pas asgjëje tjetër. Edhe më parë Raviku e kishte pasë vënë re këtë gjë tek ajo. Ajo jepej e tëra pas asaj gjëje që bënte në atë çast. Vagëllt i shkoi nëpër mend se kjo

gjë ishte po aq e këndshme sa edhe e rrezikshme. Ajo jepej krejt pas pijes, kur pinte; krejt pas dashurisë, kur dashuronte; krejt pas dëshpërimit, kur dëshpërohej; dhe krejt pas harrimit, kur harronte.

Xhoana hoqi gotën nga buzët dhe zuri të qeshte.

– Ravik, – i tha, – unë e di se ç'po mendoje.

– Vërtet?

– Po. Qëparë, kur më solle në hotel, t'u duk vetja si gjysmë i marr-tuar. Edhe mua po ashtu m'u duk vetja. Të të lënë mu përpara derës, bile edhe me një tufë trëndafilash në duar... kjo s'është për t'u pasur zili. Por, të paktën, m'u ndodh *Kalvadosi* pranë. Mos : kurse aq shumë atë shishe!

Raviku i mbushi gotat sërish.

– Je një grua e hatashme, – i tha Raviku. – Vërtet që, kur ndodhesha aty në banjë, sikur s'po të honepsja edhe aq. Kurse tani po më dukesh e mrekullueshme. *Salute!*

– *Salute!*

Ai e zbrazi gotën me fund.

– Kjo është nata e dytë, – tha. – Është natë e rrezikshme. Magjia e së panjohurës ka kaluar tanimë, kurse magjia e besimit s'ka mbërritur akoma. Besoj se do ta hedhim disi edhe këtë natë.

Xhoana e la gotën mbi komodinë.

– Ti na qenke shumë i ditur në këtë fushë!

– S'jam aspak i ditur. Vetëm flas. Njeriu s'është kurrë i ditur. Çdo gjë të del gjithmonë ndryshe. Edhe tani kështu po ndodh. Kjo nuk është nata e dytë. Është gjithmonë e parë. E dyta do të ishte fundi.

– Sa qejf! Po të ishte ndryshe, do të merreshim tani me aritmetikë. Dhe tani eja. Nuk kam ndër mend të fle. Dua të pi me ty. Yjet më duken lakuriq atje lart, në të ftohtë. Sa shumë ngrin njeriu, kur është vetëm! Qoftë edhe vapë. Kurse vetë i dytë nuk ngrin kurrë.

– Vetë i dytë ka mundësi të ngrish edhe akull fare!

– Ne jo.

– Natyrisht që jo, – tha Raviku, dhe në errësirë ajo s'e dalloi dot shprehjen e fytyrës së tij. – Ne jo.

10

– Ç'ka ndodhur me mua, Ravik? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

Ajo rrinte shtrirë në krevatin e saj, gjysmë e ngritur mbi dy jastëkë të mëdhenj. Dhoma kundërmonte kolonjë dhe parfum. Xhami i sipërm i dritares ishte pak i hapur. Ajri i freskët dhe pak i akullt futej nga jashtë dhe përzihej me ngrohtësinë e dhomës, a thua se s'ishte janar, por prill.

– Keni pasur ca ditë ethe, Keti. Pastaj keni fjetur. Gati njëzet e katër orë rresht. Tani temperatura ju ka rënë dhe çdo gjë është në rregull. Si ndiheni?

– E kapitur. Akoma. Por pak më ndryshe se përpara. Dhimbje dhe të prera pothuajse nuk ndiej fare.

– Do të keni edhe ca dhimbje. Jo shumë. Dhe ne do të kujdesemi që t'i duroni. Por gjendja s'do të mbetet kështu si tani. Këtë e dini vetë...

Ajo pohoi me kryet.

– Më keni operuar, Ravik...

– Po, Keti.

– Ishte e nevojshme?

– Po.

Raviku priti. Ishte më mirë ta linte që ta pyeste.

– Sa kohë do të më duhet të rri shtrirë?

– Disa javë.

Ajo heshti një copë herë.

– Besoj se ky pushim do të më bëjë mirë. Kam nevojë për qetësi. Më kishin ardhur të gjitha në majë të hundës. Tani po e kuptoj. Isha

e rraskapitur, por s'doja ta besoja, sepse s'më pëlqente. Mos vallë ajo lodhje kishte të bënte me sëmundjen time?

– Sigurisht, patjetër.

– Po gjaku që humbisja midis dy cikleve?

– Edhe këtë nga sëmundja e kishit, Keti.

– Epo atëherë paska qenë e nevojshme të prehem ca. Po të ngrihesha tani, nuk besoj se do t'u bëja dot ballë gjithë atyre telasheve.

– S'keni për ta prishur më gjakun. Harrojini. Mendoni vetëm për gjërat më të zakonshme. Për shembull, për të ngrënë mëngjes.

– Mirë. – Mbi fytyrën e saj rrëshqiti një buzëqeshje e mekur. – Atëherë ma jepni pak atë pasqyrën atje!

Ai i dha pasqyrën që ndodhej mbi komodinë. Ajo u pa në të me vëmendje.

– Ato lulet ju m'i sollët, Ravik?

– Jo. Janë të klinikës.

Ajo e la pasqyrën mbi shtrat.

– Klinikat s'kanë ku të gjejnë në mes të janarit jargavanë. Klinikat të sjellin lule të tjera, të rëndomta. Pastaj, klinikat nuk e dinë që jargavanët janë lulet e mia më të dashura.

– Këtu te ne e dinë. Këtu ju kanë si veterane, Keti. – Raviku u ngrit. – Tani më duhet të shkoj. Andej nga ora gjashtë do të vij t'ju shoh edhe njëherë.

– Ravik...

– Urdhëroni...?

Ai u kthye dhe e vështroi në sy. Tani, ja tani do të më pyesë, mendoi.

Ajo i zgjati dorën.

– Falemnderit, – i tha. – Ju falënderoj për lulet dhe ju falënderoj që jeni përkujdesur kaq fort për mua. Nuk e di pse ndihem kaq e sigurt pranë jush.

– Mirë, Keti, mirë. S'ishte ndonjë përkujdesje kushedi se çë. Dhe tani bëni një sy gjumë në mundshi. Në paçi dhimbje, i bëni zë infermieres. Do t'i lë një ilaç qetësues. Në darkë do të kaloj përsëri këndej.

*
* *

– Veber, ku është konjaku?

– Kaq zor e patët? Ja tek është shishja. Ëzheni, na nxirrni edhe një gotë!

Ëzhenia, me turiçka si gjithmonë, shkoi e mori një gotë.

– Po kjo është sa një gishtëz! – protestoi Veberi. – Sillni një gotë për të qenë, ose më mirë lëreni se mos thyeni dorën. Po e marr vetë.

– Nuk e marr vesh, doktor Veber, – zuri të ligjëronte Ëzhenia me ton thumbues, – sa herë që vjen zoti Ravik, ju filloni e bëheni...

– Mirë, mirë, – e ndërpreu Veberi duke mbushur një gotë të madhe me konjak. – Merreni, Ravik. A folët me të? Ç'mendonte?

– Nuk më pyeti fare. Ajo beson, pa pyetur.

Veberi ngriti sytë.

– E shikoni! – ia priti me ton ngadhënjimtar. – A s'jua thashë që në fillim?

Raviku e ktheu gotën menjëherë.

– A ju ka rastisur që ndonjë pacient t'ju falënderojë kur s'keni mundur të bëni asgjë për të?

– Shpesh.

– Dhe jua ka besuar të gjitha?

– Natyrisht.

– Po ju si e ndienit veten pastaj?

– Të lehtësuar, – tha Veberi i habitur. – Shumë të lehtësuar.

– Kurse mua më vjen për të vjellë. Ndihem si një mashtrues.

Veberi qeshi dhe e vuri shishen në vend.

– Për të vjellë, – përsëriti Raviku.

– Është hera e parë që po zbuloj një ndjenjë njerëzore te ju, – tha Ëzhenia. – Pavarësisht nga mënyra se si shpreheni.

– Ju s'jeni zbuluese, jeni vetëm një infermiere, Ëzheni. Dhe këtë e harroni shpesh, – deklaroi Veberi. – Domethënë, ajo punë u rregullua, Ravik?

– Po, të paktën përkohësisht.

– Mirë. Sot në mëngjes ajo i tha infermieres se, kur të dilte nga spitali, do të nisej për në Itali. Kështu që do të shpëtojmë nga të gjitha telashet. – Veberi fërkoi duart. – Pastaj me këtë punë le të merren doktorët atje matanë. Mua s'para më pëlqen kur na vdes njeri këtu, se pastaj na del nami i keq.

*

* *

Raviku i ra ziles në derën e mamisë që ia pati bërë dështimin Lysienës. Pasi priti mjaft kohë përjashta, derën ia hapi një burrë zeshkan; por kur e pa Ravikun, nuk e hoqi dorën nga doreza.

– Ç'kërkoni? – hungëroi nëpër dhëmbë.

– Dua të flas me zonjën Busher.

– Është e zënë.

– S'prish punë. Mund të pres.

Burri u mat të mbyllte derën.

– Meqë nuk paska mundësi të pres, atëherë po kthehem pas një çerek ore, – i tha Raviku. – Por nuk do të kthehem vetëm. Do të vij me dikë, të cilin ajo me siguri do të ketë kohë ta presë.

Burri ia zgurdulloi sytë.

– Ç'doni të thoni me këtë? Ç'kërkoni?

– Sikur jua thashë njëherë. Dua të flas me zonjën Busher.

Burri u mendua ca.

– Prisni pak, – ia bëri pastaj dhe mbylli derën.

Raviku e soditi derën e vjetër, të lyer me bojë kafe, me kutinë postare prej teneqeje dhe me pllakën prej zinku, ku ishte shënuar emri i banores. Shumë mjerim dhe shumë llahtar kishte kaluar nëpër atë derë. Dhe shkaku ishin ca ligje të pakuptimta, të cilat i detyronin njerëzit që, në vend që të shkonin te mjekët, të përfundonin në duart e kasapëve. As kjo gjë nuk e ndihmonte shtimin e fëmijëve. Kush nuk donte fëmijë – dinte gjithmonë ku ta gjente rrugëzgjidhjen. Me ligj apo pa ligj. Ndryshimi ishte vetëm se çdo vit shkatërroheshin mijëra nëna.

Dera u hap përsëri.

– Nga policia vini? – pyeti burri i parruar.

– Po të isha i policisë, s'do të më gjenit këtu duke pritur akoma pas derës.

– Futuni brenda.

Burri e drejtoi Ravikun nëpër një korridor të errët dhe e çoi në një dhomë të mbushur deng me orendi. Një kanape kadifeje dhe disa kolltukë të lyer me vernik, një imitacion qilimi persian, një bufe prej dru arre dhe, nëpër muret, stampime pikturash me tema baritore. Përpara dritares, mbi një këmbalec metali, ishte vendosur një kafaz me një kanarinë brenda. Kudo ku kishte pakëz vend, të zinte syri sende porcelani dhe qelqurina.

Zonja Busher ia bëhu më në fund. Ishte një grua tepër e ngjallur, e veshur me një robdëshambër të gjerë, që i valëvitej nëpër trup dhe që s'ishte fort i pastër. Kur e shihje ashtu, të dukej si monstër – por fytyrën e kishte të lëmuar e të lezetshme, me përjashtim të syve të shqetësuar e tinëzarë.

– Me se mund t'ju shërbej, zotëri? – pyeti ajo me ton zyrtar dhe

u ngul përpara Ravikut.

Raviku u ngrit më këmbë.

– Vij për punën e Lysienë Martinesë. Ju i keni bërë një dështim.

– Gjepura! – ia priti gruaja aty për aty dhe krejt e qetë. – Unë nuk njoh ndonjë Lysienë Martine dhe nuk merrem me dështime. Duhet ta keni gabim, ose ju kanë gënjyer.

Ajo bëri sikur kjo punë kishte marrë fund me kaq dhe sikur donte të dilte nga dhoma.

Por nuk doli. Raviku qëndroi në pritje. Ajo u kthye prapë nga ai.

– Dëshironi ndonjë gjë tjetër?

– Dështimi nuk doli me sukses. Vajza pati shumë hemorragji dhe mend vdiq. U desh të operohej. Operacionin ia bëra unë.

– Gënjeshtra me bisht! – turfulloi Bushervica papritmas. – Profka! Këto bushtra të poshtra! Fusin duart vetë dhe pastaj duan t'i marrin edhe të tjerët më qafë! Por ia tregoj unë qejfin asaj! Kuçkat!... Avokati im do ta rregullojë këtë punë fët e fët. Mua më njohin cila jam dhe taksat ia paguaj shtetit në rregull. Dhe do ta shohim nëse një zuskë e tillë e pacipë, që kurvëron poshtë e lart do të...

Raviku e kundronte pothuajse i magjepsur. Gjatë këtij shpërthimi inatçor, fytyra e saj s'kishte ndryshuar fare. Ajo kishte mbetur e lëmuar dhe e lezetshme; vetëm goja i ishte rrudhur dhe i nxirrte fjalët me breshëri, si mitralozi fishekët.

– Vajza kërkon shumë pak, – e ndërpreu ai gruan. – Kërkon vetëm t'i kthehen paratë që ju ka paguar.

Bushervica ia dha të qeshurit.

– Paratë? T'ia kthej paratë? E kur paskam marrë unë para prej saj? Mos ka ndonjë dëftesë?

– Natyrisht që s'ka. S'ma ha mendja që ju të lëshoni dëftesa.

– Sepse s'ia kam parë kurrë surratin! E kush do t'i besojë fjalët e saj!

– Do ta besojnë, sepse ajo ka dëshmitarë. Është operuar në klinikën e doktor Veberit. Diagnoza e saj ishte më se e qartë, dhe për këtë ekziston një procesverbal i rregullt.

– Akoma s'paski bërë një mijë procesverbale! Thotë gjë procesverbali që e kam prekur unë? Ç'është ky doktor Veberi? Ç'po më ardhka për të qeshur! Një kuçkë e tillë na u shtroka në një klinikë aristokratësh! S'paskeni halle të tjera ju atje?

– Posi si s'kemi. Shumë, bile. Dhe tani dëgjoméni: vajza ju ka paguar treqind franga. Ajo mund t'ju hedhë në gjyq e t'ju kërkojë dëmshpërblim.

Dera u hap dhe burri zeshkan u dha te pragu.

– Ka ndodhur gjë, Adelë?

– Jo... Domethënë, do të më hidhka në gjyq e do të kërkoka dëmshpërblim? Po të më padisë mua, do të dënohet vetë. Pra, në fillim do ta hajë ajo vetë. Këtë s'e luan topi, sepse do t'i duhet të pranojë që është bërë një tentativë dështimi. Pastaj do t'i duhet të provojë që isha unë ajo që ia bëra. Dhe këtë s'ka si e vërteton.

Burri zeshkan seç zuri të llomotiste nëpër dhëmbë.

– Rri urtë, Rozhe, – i tha zonja Busher. – Mund të shkosh.

– Ka ardhur Brynieja dhe pret jashtë.

– Mirë. I thuaj të presë edhe ca. Ti e di punën...

Burri pohoi me kokë dhe u zhduk. Me të u zhduk edhe një erë e fortë konjaku. Raviku ngriti hundën dhe nuhati.

– Ky është konjak, i vjetër, – tha ai. – Të paktën tridhjetë ose dyzetvjeçar. I lumi ai që paska mundësi ta pijë qysh pasdreke!

Për një çast Bushervica e vështroi e hutuar. Pastaj mblodhi buzët.

– I keni rënë në të. Dëshironi një gotë?

– Pse jo?

Me gjithë tulet që kishte, ajo u ndodh menjëherë te dera e dhomës.

– Rozhe!

Te pragu u duk përsëri burri zeshkan.

– I paske rënë prapë atij konjakut të zgjedhur? Mos gënje se të vjen era një kilometër larg! Sille shishen! Mos e zgjat, por sillma shishen këtu, të them!

Rozheri e solli shishen.

– I dhashë një gotë Bryniesë, dhe ai më detyroi me zor që ta ktheja edhe unë një, sa për shoqëri.

Bushervica nuk i dha përgjigje. Mbylli derën dhe shkoi te bufeja prej dru arre dhe nxori andej një gotë me fron, gjithë zbukurime. Raviku e vështroi gotën me neveri. Në qelqin e saj ishte skalitur një kokë gruaje. Bushervica e mbushi gotën dhe ia vuri përpara mbi tryezën e mbuluar me një shtrojë plot stampime pavodash.

– Më dukeni njeri i arsyeshëm, zotëri, – i tha.

Raviku nuk mundi t'ia mohonte krejt njëfarë respekti. Ajo nuk ishte prej hekuri, siç i pati thënë dikur Lysiena; ajo ishte më keq – ishte prej llastiku. Hekurin mund ta thyeje, kurse llastikun jo. Kundërshtimi i saj për të paguar ndonjë dëmshpërblim ishte krejt me vend.

– Ndërhyrja juaj nuk pati sukses, – i tha ai. – Prej saj ajo pati pasoja të rënda. Besoj se kjo është një arsye e mjaftueshme që ju t'ia

ktheni paratë.

– Po ju i ktheni paratë kur një pacient ju vdes pas operacionit?

– Jo. Por ka raste kur nuk u marrim para fare për operacionin; për shembull Lysienës.

Bushervica e vështroi drejt e në sy.

– Ashtu pra! Atëherë pse e zgjat këtë mesele, në vend që të rrijë urtë e të thotë shyqyr?!

Raviku ngriti gotën.

– Zonjë, – i tha. – Nderimet e mia! S'paska njeri që t'ju vërë përfund.

Gruaja e vendosi shishen mbi tryezë, ngadalë e ngadalë, sikur donte t'i peshonte fjalët që do të thoshte.

– Zotëri, këtë kanë provuar ta bëjnë shumë veta. Por ju më dukeni më me mend. Mos pandehni se puna ime është punë qejfi ose vetëm punë fitimi? Nga të treqind frangat që përmendët, njëqind i përlan policia. Mos pandehni se ndryshe do të më linin të punoja? Ja, atje përjashta, në paradhomë, po pret përsëri njëri që kërkon hisen e vet. Duhet zgjidhur qesja, gjithmonë duhet zgjidhur. Ndryshe s'të ecën. Këtë po jua them juve, këtu, në mes nesh. Dhe mos t'ju gënjejë mendja se mund të më paditni për këto që ju thashë tani! Unë do t'i bie hasha dhe policia do ta mbulojë çështjen. Për këtë mos kini hiç dyshim.

– Nuk kam dyshim.

Bushervica i hodhi rrëshqitas një shikim të shpejtë. Kur e kuptoi që në përgjigjen e tij s'kishte aspak ironi, mori një karrige dhe iu ul pranë. Karrigen e përfshiu dhe e afroi me një dorë, thuajse ishte pendë: nën gjithë ato shtresa dhjami dukej se fshihej një forcë e madhe. Ajo ia mbushi edhe një herë gotën me konjak ryshefti.

– Treqind franga duken si shumë para... Por me to nuk lyhet vetëm policia. Po qiraja? Natyrisht këtu ajo është më e lartë se gjetkë. Po teshat, aparatet? Mua m'i japin me çmim dyfish më të shtrenjtë se mjekëve... Pastaj përqindjet, ryshfetet... Duhet ta kesh grurë me të gjithë; t'u bësh peshqeshe për vitin e ri dhe për ditëlindje... nëpunësve, grave të tyre... e të tjera e të tjera, i dashur zotëri! Nganjëherë s'të mbetet asgjë për vete.

– Megjithatë, ajo gjë nuk justifikohet.

– Cila gjë?

– Ja, që të ndodhë ashtu me Lysienën.

– Pse, te ju mjekët nuk ndodhka kurrë ashtu? – pyeti Bushervica me rrëmbim.

– Nuk ndodh kurrë aq shpesh.

– I dashur zotëri! – Ajo u ngrit më këmbë. – Unë jam njeri i ndershëm. Secilës që më vjen, i them se mund t'i ndodhë diçka. Dhe asnjëra nuk vë majat nga ka thembrat. Më luten e më përgjërohen që t'i ndihmoj. Zënë e qajnë e lebetiten para meje. Më thonë se do të vrasin veten, po t'i lë në baltë. Nuk e mermi dot me mend se ç'skeqilim, duke m'u lutur e duke m'u ankuar! E shihni atë bufenë atje, atë qoshen që i është hequr lustra? Një damë pasanike e ka prishur në dëshpërim e sipër. Dhe unë e ndihmova. Doni të shihni edhe diçka tjetër? Në kuzhinë kam pesë kile marmelatë kumbullash që m'i dërgoi ajo dje, megjithëse ma kishte paguar hakun. Dëgjoëni t'ju them edhe dy fjalë, zotëri... – Zëri i Bushervicës erdhi e u ngrit e u bë më i kumbueshëm: – Ju mund të më quani kasape, por të tjerët ama, më quajnë bamirësen dhe engjëllin e tyre shpëtimtar!

Ajo qe ngritur në këmbë. Robdëshambri i palosej mbretërisht mbi trup. Kanarina në kafaz filloi të këndonte përnjëherësh, si me komandë. Edhe Raviku u ngrit nga vendi. Ai kishte mjaft haber nga melodramat. Por gjithashtu e dinte që Bushervica nuk i kishte stërzmadhuar gjërat.

– Mirë, pra, – tha ai. – Po shkoj tani. Sidoqoftë, për Lysienën ju s'ishit as bamirëse dhe as engjëll.

– Duhej ta kishit parë si ishte katandisur në fillim! E ç'kërkon më tepër? Tani u shërua, fëmijën ia hoqën... Këto deshi. Bile as klinikën s'paska nevojë ta paguajë...

– Ajo s'mund të bëjë më kurrë fëmijë.

Bushervica u step për një çast.

– Aq më mirë, – ia pati pastaj, pa e prishur terezinë. – Kushedi sa është kënaqur, kurvica e vogël.

Ravikut iu mbush mendja se këtu nuk do të nxirrte gjë në dritë.

– Mbetshi me shëndet, zonja Busher, – tha ai. – Takimi me ju ishte shumë interesant.

Ajo iu avit fare pranë. Raviku do të kishte pasur shumë dëshirë të shpëtonte pa i dhënë dorën. Por ajo s'e kishte aspak hallin aty. E uli zërin dhe filloi t'i fliste mbyturazi e në konfidencë:

– Ju jeni njeri i arsyeshëm, zotëri. Më i arsyeshëm se shumica e mjekëve. Sa keq që ju... – Ajo e preu fjalën në mes dhe i hodhi një shikim, si për t'i dhënë zemër. – Nganjëherë, për ca raste të veçanta të del nevoja për... Një mjek i zoti mund të ishte një ndihmë e madhe...

Raviku as nuk e ndërpreu dhe as nuk e kundërshtoi. Donte ta dëgjonte gjer në fund.

– Nuk do t'ju dilte keq, – shtoi Bushervica. – Sidomos në raste të veçanta. – Ajo e vërente si një mace që shtiret sikur i do zogjtë. – Na qëllon shpesh të kemi edhe klientë të kamur... Natyrisht paratë parapaguhen dhe, për sa i përket policisë, jemi rehat, fare rehat... Ma ha mendja se mund t'ju hyjnë në punë patjetër ca qindra franga fitime jashtë planit... – Ajo i ra shpatullave miqësisht. – Një burrë i pashëm si ju... – Duke u skërmitur vesh më vesh, Bushervica mori në dorë shishen nga tryeza. – E, si thoni?

– Falemnderit, – i tha Raviku duke bërë një shenjë kundërshtimi. – Nuk dua më. S'para e mbaj shumë pijen. – E pati vështirë t'i nxirrte ato fjalë nga goja, sepse konjaku ishte vërtet i hatashëm. Shishja nuk kishte etiketë dhe, me siguri, ishte marrë nga ndonjë qilar me nam. – Për atë punën tjetër do të mendohem. Mund të kaloj prapë këtej nga ju. Do të kisha dëshirë t'i shikoja njëherë instrumentet që përdorni. Mbase mund t'ju jap pastaj ndonjë këshillë.

– Po të vini, do t'jua tregoj instrumentet e mia. Dhe ju do të më tregoni dokumentet tuaja. Besimi shpërblehet me besim.

– Ju sikur më dhatë ca besim?!

– Aspak! As kaq! – qeshi Bushervica. – Unë ju bëra vetëm një propozim, të cilin mund ta mohoj kur të dua. Ju s'jeni francez; kjo kuptohet, megjithëse e flisni frëngjishten mjaft mirë. Le që as dukeni si francez. Ma merr mendja se jeni refugjat. – E qeshura iu shndërrua në një ngërdheshje dhe ajo e soditi Ravikun me një shikim të ftohtë. – Po të më paditnit, nuk do t'ju besonin; do t'ju dilte edhe një telash tjetër, sepse do t'ju kërkonin diplomën franceze të doktorit, të cilën nuk e keni. Jashtë, në paradhomë, po rri një punonjës i policisë. Po të doni, mund të më paditni qysh tani. E di që s'do ta bëni këtë. Por propozimin tim mund ta shoshitni edhe njëherë. Emrin dhe adresën tuaj s'doni të ma lini, ë?

– Jo, – tha Raviku, që e ndjeu veten të mundur.

– E mora me mend. – Tani Bushervica dukej vërtet si një goxha mace e majme dhe e ngopur. – Mirupafshim, zotëri. Shqyrtojeni atë propozimin tim. Më ka shkuar shpesh në mendje të marr një mjek refugjat për konsulent.

Raviku vuri buzën në gaz. Ai e dinte psenë e kësaj dëshire. Mjekun refugjat ajo do ta kishte kurdoherë në dorë. Po të ndodhte gjësend, faji do t'i ngarkohej atij.

– Do të mendohem, – tha ai. – Mirupafshim zonjë.

Ai eci përgjatë korridorit të mugët. Prapa një dere i zuri veshi ca rënkime. E mori me mend që dhomat ishin të pajisura me nga një shtrat si ato kabinat e vaporëve. Gratë rrinin atje ca orë e pastaj hiqeshin zvarrë për në shtëpi.

Në paradhomë po rrinte një burrë truphedhur me një palë mustaqe spic e me një lëkurë ngjyrë ulliri. Ai e pa Ravikun me vërejtje. Pranë tij kishte zënë vend Rozheri. Mbi tryezë ndodhej një shishe tjetër nga ai konjaku i vjetër. Sapo e pa Ravikun, Rozheri deshi ta fshihte shishen. Por pastaj u zgërdhi dhe e hoqi dorën.

– Natën e mirë, doktor, – ia bëri duke zbardhur dhëmbët e krimbur. Dukej se kishte përgjuar pas derës.

– Natën e mirë, Rozhe.

Raviku e pa të udhës të sillej në mënyrë familjare. Brenda një gjysmë ore ajo gruaja-shkëmb atje brenda kishte arritur ta kthente nga një armik të hapur, pothuajse në një bashkëpunëtor. Prandaj i dukej si njëfarë lehtësimi të mos i fliste me shumë formalitete Rozherit, i cili, pas gjithë kësaj, kishte marrë papritur e pakujtuar disa tipare çuditërisht njerëzore.

Poshtë, te shkallët, takoi dy vajza. Ato vështronin dyert dhe dukej sheshit se kërkonin dikë.

– Zotëri, – iu drejtua më së fundi, me një ton disi të vendosur, njëra prej tyre, – mos banon në këtë shtëpi zonja Busher?

Raviku ngurroi. Po ç'kuptim do të kishte sikur t'u thoshte ndonjë fjalë? S'do të bënte asnjë dobi. Ato prapëseprapë do ta gjenin e do të shkonin tek ajo.

– Në katin e tretë. Ka një pllakë te dera.

*

* *

Fusha me fosfor e orës vezullonte në errësirë, si një diell i vockël i marrë hua. Po shkonte pesë e mëngjesit. Xhoana duhej të kishte ardhur qysh në orën tre. Ndoshta mund të vinte edhe tani. Por ndoshta kishte qenë tepër e lodhur dhe ishte kthyer drejt e në hotelin e saj.

Raviku u kthye nga ana tjetër dhe u mundua të flinte përsëri. Por gjumi s'po e zinte më. U rrotullua në kurriz dhe soditi për një kohë të gjatë tavanin e dhomës, mbi të cilin, me ndërprerje të rregullta, kalonte si shirit i kuq filmi drita e një reklame të vendosur në godinën përballë. Ndihej bosh dhe s'e gjente dot shkakun. I dukej

;ikur ngrohtësia e trupit po i pikonte dalëngadalë jashtë lëkurës e po i zhdukej diku... sikur gjaku i tij kërkonte të mbështetej pas diçkaje që nuk ishte aty dhe derdhej e derdhej tatëpjetë një pafundësie të butë. Kryqëzoi duart poshtë kokës dhe ndenji pa lëvizur. Tani e kuptoi se ishte pritja ajo që po e mundonte. Dhe e dinte se nuk ishte vetëm vetëdija e tij që po e priste Xhoanën, por edhe duart, edhe damarët, edhe një ndjenjë ëmbëlsie çuditërisht e huaj po prisnin e po prisnin...

U ngrit, veshi robdëshambrin dhe u ul pranë dritares. E ndjeu ngrohtësinë e rrobës së leshtë mbi lëkurë. Robdëshambri ishte mjaft i vjetruar; ai e kishte zvarritur me vete shumë vite me radhë. Kishte fjetur, i mbështjellë me të, gjatë arratisjes; ishte ngrohur me të netëve të ftohta të Spanjës, kur kthehej i kapitur e i dërrmuar nga spitali ushtarak në barakën e tij. Huana, dymbëdhjetë vjeçe, me sy që dukeshin si të një tetëdhjetëvjeçareje, kishte hequr shpirt, e mbuluar me të, në një hotel të Madridit bërë shoshë nga predhat – dhe dëshira e saj e fundit pati qenë: të bëhej edhe ajo ndonjëherë me një fustan prej leshi të tillë të butë dhe të harronte se si ia kishin përdhunuar nënën dhe se si ia kishin ngordhur me shkelma babanë.

Ai vështroi përreth. Dhoma, ca valixhe, ca orendi, një pirg i vogël librash të stërlexuar – një mashkulli i duhet shumë pak gjëra për të jetuar. Ishte mirë që njeriu të mos mësohej me shumë sende, kur jeta është e tallazitur. Se pastaj do të ishe i shtrënguar të ndaleshe gjithmonë prej tyre, ose mund të t'i rrëmbenin të tjerët. Çdo ditë duhej të ishe gati për t'ia mbathur diku. Kjo ishte edhe arsyeja pse ai kishte parapëlqyer të jetonte vetëm; kur njeriu ndodhej vazhdimisht për rrugë, s'duhej të kishte asgjë që të mund ta mbante ngulur në një vend. Asgjë, që të mund ta zgjonte dhe t'ia turbullonte zemrën. Ndonjë aventurë, po – por asgjë më tepër.

I hodhi sytë mbi shtrat. Çarçafë të zbehtë e të zhubravitur. S'ka gjë sepse po priste. Ai kishte pritur shpesh që t'i vinin gratë. Por tani po e ndiente se i kishte pritur në një mënyrë krejt tjetër – të rëndompë, brutale e me mendje të kthjellët; ndonjëherë, ndoshta, edhe me atë ëmbëlsinë anonime, që e praron si me argjend epshin – por kishte shumë kohë që nuk kishte pritur si sot... Seç e kishte pushtuar, ashtu fshehurazi dhe tinëzisht, diçka që ai s'e kishte përfillur... Seç po lëvizte prapë në thellësi të tij... Seç po e trondiste sërishmi... Sa kohë kishte që nuk pati ndier asgjë, asgjë?! Po tani – ç'kishte kjo që po e thërriste së largu, që nga e kaluara, që nga thellësitë e kaltra të harresës?... A s'po ndiente qysh tani nga afër aromë fushash e

luleshqerrash... a s'po fillonin t'i faniteshin radhë plepash tej në horizont... a s'po e nuhaste kundërmimin e pyjeve në prill...? Nuk donte... nuk donte të ndiente më asgjë, nuk donte të kishte asgjë të tijën. Dhe nuk donte që as të tjerët ta kishin të tyrin. Sepse gjithmonë ai ndodhej gati për rrugë...

U ngrit dhe filloi të vishej. Njeriu duhej të mbetej i pavarur. Çdo prapësi fillonte me vartësirat e vockla. Në fillim nuk u kushtoje vëmendje – por pastaj e shihje veten befas të kapur në rrjetën e zakonit. E një zakoni, të cilin mund ta pagëzoje me gjithfarë emrash – një nga ata emra quhej "dashuri". Njeriu s'duhej të mësohej me asgjë. As me një trup të bukur.

Kur doli nga dhoma, nuk e kyçi derën. Po të vinte Xhoana, s'do ta gjente. Po të donte le të priste. U mendua një hop në t'i linte një copë letër ose jo. Por nuk i pëlqente ta gënjente dhe as nuk kishte dëshirë t'i thoshte se ku po shkonte.

*

* *

U kthye andej nga ora tetë e mëngjesit. Kishte bredhur nëpë mugëtirën e ftohtë, teksa fanarët e rrugëve shuheshin njëri pas tjetrit, dhe e kishte ndier veten të qetë e të çlodhur. Por kur arriti përpara hotelit, e ndjeu rishtas tendosjen e nervave.

Xhoana nuk ishte në dhomë. Raviku arriti t'ia mbushte mendjen vetes se, në të vërtetë, as që kishte pritur ta gjente aty. Por dhoma iu duk më e zbrazët se zakonisht. Vështroi përreth, duke kërkuar ndonjë shenjë të saj po të kishte qenë atje. Nuk gjeti asgjë.

I ra ziles për t'i ardhur vajza që shërbente nëpër katet. Ajo e la të priste ca.

– Dua të ha mëngjes, – i tha.

Ajo e vështroi dhe nuk tha gjë. As ai nuk deshi ta pyeste.

– Kafe dhe qifle, Eva.

– Si urdhëroni, zoti Ravik.

Ai soditi shtratin. Edhe sikur Xhoana të kishte pandehur, s'mund të prisje që të ishte shtrirë në një shtrat të pandrequr dhe bosh. Çudi, sa e vdekur dukej çdo gjë që kishte të bënte me trupin, kur nuk e kishte më ngrohtësinë e tij – edhe shtrati, edhe rrobat, bile edhe banja. Bëheshin të neveritshme, kur e humbisnin atë ngrohtësi.

Pas pak ndezi një cigare. Ajo mund të kishte ardhur se e patën thirrur me ngut te ndonjë pacient. Por atëherë ai mund t'i kishte

lënë, të paktën, një pusullë. Befas iu duk vetja idiot. Kishte dashur të bëhej i pavarur, por ishte bërë vetëm i vrazhdë e i pagdhendur. I vrazhdë e mendjelehtë, si një çunak tetëmbëdhjetëvjeçar që kërkon t'ia mbushë mendjen vetes me zor për diçka. Dhe këtu kishte shumë më tepër vartësi nga ç'do të kishte pasur sikur të kishte ndenjur atje duke e pritur Xhoanën.

Vajza i solli mëngjesin.

– A t'jua ndreq shtratin? – e pyeti.

– Pse që tani?

– Thashë se mos donit të binit pak. Flihet më mirë në një shtrat të rregulluar. – Vajza e vështroi me një fytyrë pa shprehje.

– Ka qenë njeri këtu? – e pyeti ai.

– Nuk e di. Vetë erdha në punë në orën shtatë.

– Eva, – tha Raviku. – Si e ndien veten njeriu, kur është i detyruar të ndreqë çdo mëngjes shtretërit e botës.

– Çka, zoti Ravik, ecën. Përderisa zotërinjtë nuk kërkojnë gjë tjetër... Por ka gjithmonë të tillë që të bien në qafë. Kurse, po të mendosh që bordelet janë aq të lira në Paris...

– Në mëngjes herët nuk shkohet në bordel, Eva. Dhe sidomos mëngjeseve disa klientë e ndjejnë veten shumë të fortë.

– Po, veçanërisht pleqtë. – Vajza ngriti supet. – Po s'e bëre, humbet bakshishin... Kjo është meseleja. Pastaj ka edhe ca që fillojnë e të hapin àndralla më vonë, duke u ankuar çdo minutë... jo dhoma s'na qenka pastruar mirë, jo shërbyesja e paska llapën të gjatë, e të tjera e të tjera. Nga marazi, natyrisht. Kësaj s'ke çfarë t'i bësh. Kështu qenka jeta...

Raviku nxori një kartëmonedhë nga xhepi.

– Merreni sot jetën pak më shtruar, Eva. Shkoni e blini me këto të holla një kapelë ose një triko.

Sytë e Evës u gjallëruan.

– Falemnderit, zoti Ravik. Dita po më filloka mbarë. A t'jua rregulloj shtratin më vonë?

– Po.

Ajo e vështroi ndër sy.

– Ajo dama është një damë shumë interesante, – i tha pastaj. – Ajo dama që vjen tani gjithmonë këtu.

– Edhe një fjalë dhe jua mora prapë atë që jua dhashë! – Raviku e shtyu Evën drejt derës. – Ashikët pleq po ju presin. Mos i lini me gisht në gojë.

Ai u ul në tryezë dhe iu përvesh mëngjesit; por meqë nuk i shi-

joi, u ngrit dhe vazhdoi të hante më këmbë; kështu i dukej më i mirë.

Dielli doli i kuqërremtë përmbi çatitë. Hoteli nisi të zgjohej. Plaku Goldberg, një kat më poshtë, filloi koncertin e vet mëngjesor. Kollitej e kakariste sikur të kishte gjashtë palë mushkëri. Emigranti Vizenhof hapi dritaren dhe zuri të vërshëllente një marsh parade. Një kat më lart vërshonte uji nga ndonjë rubinet i hapur gjer në fund. Dyert përplaseshin. Vetëm në dhomat e spanjollëve nuk pipëtinte asgjë. Nata mbaroi. Kaloi edhe zvetënimi i errësirës. Raviku vendosi të rrinte ca ditë vetëm.

Jashtë, çunakët gazetashitës shpallnin me zë të lartë lajmet e mëngjesit: Incidente në kufirin çek!... Trupat gjermane në Malet e Sudetëve!... Pakti i Mynihut në rrezik!...

11

Djaloshi nuk bërtiste. Vetëm se i vështronte mjekët me sy të qelqtë. Ishte akoma tepër i shushatur dhe s'e ndjente dhimbjen. Raviku i hodhi një sy këmbës së shkëlfitur ligsht.

– Sa vjeç është? – e pyeti të ëmën.

– Si? – ia ktheu pyetjen gruaja e habitur.

– Sa vjeç është djali?

Gruaja me shami në kokë lëvizi buzët.

– Këmba! – tha ajo. – Këmba e tij! Ishte një kamion...

Raviku vuri veshin te zemra e djalit.

– Ka qenë ndonjëherë i sëmurë?

– Shikojani këmbën! – tha gruaja. – Këmbën e tij!

Raviku drejtoi trupin. Zemra e djalit dridhej si zemër zogu, por s'kishte asgjë për t'u alarmuar. Gjatë narkozës duhej ta kishte shumë kujdes djalin, i cili dukej i dobët dhe rakitik. Duhej t'i futej punës menjëherë. Këmba e sakatuar kishte marrë tërë pisllëkun e rrugës.

– Do të ma prisni këmbën? – pyeti djali.

– Jo, – tha Raviku, duke mos e besuar as vetë atë që thoshte.

– Më mirë të ma prisni fare, sesa të më mbetet si copë dru.

Raviku e soditi me vërejtje atë fytyrëzë që rrëfente mençurinë e një plakushi. Në tiparet e djaloshit s'po dallohej akoma asnjë shenjë dhimbjeje.

– Do ta shikojmë, – i tha Raviku. – Tani do të të vëmë njëherë në gjumë. Është një punë shumë e thjeshtë. Mos ki frikë. Rri i qetë.

– Një minutë, zotëri! Numri ishte FO-2019. Shënojeni, ju lutem, se i duhet nënës!

Erjonixx

– Çfarë? Si the, Zhano! – e pyeti e ëma, duke u shkundur e trembur.

– E mbajta mend numrin. Targën e kamionit. FO-2019. E kisha mu përpara syve. Semafori tregonte dritë të kuqe. Gjithë fajin e pati shoferi. – Djaloshi filloi të merrte frymë me zor. – Sigurimet duhet të paguajnë. Targa...

– E kam shënuar, – e qetësoi Raviku. – Mos u bëj merak. I kam shënuar të gjitha. – Ai i bëri shenjë Ëzhenisë që të fillonte nga narkoza.

– Nëna duhet të shkojë në polici. Sigurimet duhet të paguajnë medoemos! – Sakaq fytyra e djalit u mbulua e tëra me bulëza djerse, saqë të krijohej përshtypja sikur mbi të kishte rënë shi. – Po të ma prisni këmbën... ata do të paguajnë më shumë... se sa... po të më mbetet e paralizuar...

Sytë iu mjegulluan dhe qepallat e rënduara filluan t'i mbylleshin. Djali rënkoi thellë dhe u përpoq të thoshte shpejt e shpejt edhe diçka:

– Nëna ime... nuk di... Duhet... duhet ta ndihmoni... – Më tej nuk mundi të vazhdonte. Zuri të ulërinte, mbyturazi, me gulçime, sikur të ishte shndërruar në një bishë të plagosur.

*
* *

– Ç'po bëhet jashtë nëpër botë, Ravik? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

– Ç'po ju duhet, Keti? Mendoni më mirë diçka më gazmore.

– Kam përshtypjen sikur ndodhem këtu që prej shumë javësh. Të gjitha të tjerat sikur kanë mbetur shumë larg, sikur janë fundosur diku.

– Lërini ashtu të fundosura për ca kohë.

– Jo, se pastaj kam frikë që kjo dhomë do të më duket si varka e Noes dhe sikur jashtë dritares do të ngjitet uji që do të përmbytë botën mbarë. Vërtet, Ravik, tregomëni ç'po ndodh jashtë?

– Asgjë e re, Keti. Bota po vazhdon me zell të madh të përgatitë vetëvrasjen e saj dhe njëkohësisht të gënjehet që s'është duke ia hapur varrin vetes.

– Do të kemi luftë?

– Që do të kemi luftë, këtë e di çdokush. Çfarë nuk dihet akoma, është se kur do të plasë. Secili pret të ndodhë ndonjë çudi. – Raviku nënqeshi. – S'kam parë kurrë kaq shumë burra shteti që besojnë në

Erjon... x

çudira, sa ç'ka tani në Francë e në Angli. Dhe kurrë kaq pak, sa në Gjermani.

Ajo qëndroi një copë herë pa folur.

– Si ka mundësi t'ia fillojmë prapë... – tha pastaj.

– Po, duket aq e pamundur, sa prisni kur të shpërthejë një ditë prej ditësh. Dhe kjo ndodh pikërisht, sepse njerëzit e quajnë të pamundur dhe nuk bëjnë asgjë për ta ndalur... Keni dhimbje, Keti?

– Jo edhe aq sa të mos i duroj. – Ajo rregulloi jastëkun poshtë kokës. – Dua të arratisem diku larg, larg gjithë këtyre gjërave, Ravik.

– Po, – iu përgjigj ai, ashtu sa për të thënë diçka. – E kush është ai që s'e ka këtë dëshirë?

– Kur të dal që këtej dua të shkoj në Itali. Në Fiezole. Atje kam një shtëpi të vjetër, të qetë, me një kopsht. Do të jetoj ca kohë në atë vend. Moti do të jetë akoma i ftohtë. Edhe dielli do të jetë i zbehtë, por më i qeshur. Në kohë dreke do t'i shoh hardhucat e para mbi murin e kopshtit. Mbrëmjeve do të dëgjoj kambanat e Firences. Dhe natën do të kundroj hënën dhe yjet pas qiparisave. Në atë shtëpi ka shumë libra. Kam edhe një oxhak të madh prej guri me stola druri anash. Oxhaku ka ca skara hekuri, ku mund të vendosësh një gotë verë. Dhe vera e kuqe ngrohet shumë mirë ashtu. S'ka njerëz. Është vetëm një çift pleqsh që kujdeset për shtëpinë.

Ajo e vështroi Ravikun.

– Bukur fort, – tha ai. – Qetësi, një zjarr, libra dhe paqe. Më parë kësaj i thonin rehati borgjeze. Kurse sot është ëndrra për parajsën e humbur.

Ajo pohoi me krye.

– Dua të rri ca kohë atje. Disa javë. Ndoshta edhe disa muaj. Nuk e di akoma. Dua të qetësohem. Pastaj do të vij prapë këtu e do të kthehem në Amerikë.

Raviku dëgjoi nga korridori trokëllimën e enëve. Të sëmurëve po u sillnin ushqimin me tabaka të mëdha.

– Mirë, Keti, – i tha.

Ajo hezitoi pak, përpara se ta nxirrte pyetjen.

– A mund të bëj më fëmijë, Ravik?

– Jo tani shpejt. Duhet të merrni fuqi.

– Nuk e kam fjalën atje. A jam në gjendje të lind, kurdoqoftë... pas këtij operacioni? A s'më keni...

– Jo, – i tha Raviku. – Nuk ju kemi hequr asgjë, Keti.

Ajo mori frymë thellë.

– Këtë desha të di.

– Por duhet të kalojë një kohë e gjatë, Keti. I gjithë organizmi duhet të përtërihet.

– S'prish punë sa kohë do të kalojë. – Ajo shkoi dorën përmbi flokë. Guri i unazës llamburiti në mugëtirën e dhomës. – Ishte qesharake kjo pyetja ime, apo jo? Dhe pikërisht tani!

– Jo, aspak. Të tilla pyetje bëhen shpesh.

– Më janë mërzitur të gjitha. Më ka zënë trishtimi, papritur e pa kujtuar. Dua të kthehem e të martohem. Të martohem tamam, ashtu sipas modës së vjetër. Dua të bëj fëmijë e të jem e qetë e ta dua jetën.

Raviku vështroi jashtë dritares. Një buzëmbrëmje e përflakur, e ndezur nderej mbi çatitë. Reklamat e dritareve zhyteshin në të, si hije anemike gjaku të zbehtë.

– Këto që ju thashë, duhet t'ju duken naive dhe fëmijërore; kështu s'jam më ajo që më njihni, – tha Keti Hegshtrëmi pas kurrizit të tij.

– Jo, aspak. Aspak, Keti.

*

* *

Xhoanë Maduja erdhi nga ora katër pas mesnate. Raviku u zgjua kur dëgjoi derën tek hapej. Ai pati rënë të flinte dhe nuk e kishte pritur. E dalloi te pragu, ndërsa po mundohej të fuste në dhomë një alamet tufe me krizantema. Fytyrën nuk ia pa. Pa vetëm siluetën e saj dhe lulet e shumta.

– Ç'janë këto? – tha ai. – Një pyll i tërë krizantemash! Ç'dreqin i solle të gjitha këtu?

Xhoana arriti t'i fuste lulet përmes derës dhe i hodhi drejt e mbi shtrat. Ishin të lagështa e të ftohta dhe gjethet e tyre lëshonin një kundërmim të rëndë vjeshte e dheu.

– Peshqesh, – tha ajo. – Që kur u njoha me ty, kanë filluar të më mbytin me peshqeshe.

– Hiqmi këtej. Akoma s'kam vdekur. Pah! I varrosur nën lule... për më tepër nën krizantema! Ma shndërrove shtratin plak e besnik të hotel *Internacionalit* në një qivur të vërtetë!

– Mos! – Xhoana i mblodhi lulet me një lëvizje të rrëmbyer dhe i flaku në dysheme. – Mos fol ashtu! Të lutem, mos ma përmend më këtë!

Raviku e vështroi. I kishte dalë fare nga mendja se në ç'rrethana ishin njohur.

– Harroje, – i tha. – Nuk ta thashë me qëllim.

Erjonixx

– Mos fol më kështu. Qoftë edhe me shaka. Premtomë!
Buzët i dridheshin.
– Ç'ke kështu, Xhoanë... – tha ai. – Kaq fort të tremb kjo?
– Po. Është më tepër se frikë. As unë nuk e di se ç'është...
Raviku u ngrit nga shtrati.
– Nuk do të bëj më shakara të tilla. A je e kënaqur tani?
Ajo mbështeti kokën te supi i tij.
– Nuk e di se ç'është. Di vetëm që nuk mund ta duroj dot. Më duket sikur diku nga errësira shtrihet drejt meje një dorë dhe kërkon të më kapë... Kam frikë... është një frikë e çmendur... Më duket sikur dikush më ka zënë pusi. – Ajo u shtrëngua edhe më fort pas tij.
– Por ti mos e lejo të më kapë!
Raviku e mbërtheu fort ndër krahë.
– Jo, nuk do ta lejoj.
Ajo luajti kokën si në shenjë pohimi.
– Ti je i zoti ta bësh këtë.
– Po, – tha ai me një zë plot trishtim e njëkohësisht plot qesëndi, sepse i shkoi mendja te Keti Hegshtrëmi. – Jam i zoti, natyrisht që jam i zoti...
Ajo u tulat pas gjoksit të tij.
– Dje isha këtu...
Raviku nuk lëvizi.
– Ashtu?
– Po.
Ai heshti. Sa fëmijë ishte treguar! Të presësh apo të mos presësh – e pse gjithë këto naze? Ç'i duhej kjo lojë boshe me një njeri që nuk luante!?
– Por ti nuk ishe këtu.
– Jo, nuk isha.
– E di që s'duhet të të pyes se ku ishe...
– Jo, mos më pyet.
Ajo u shkëput prej tij.
– Dua të bëj një banjë, – i tha me zë të ndryshuar. – Jam e ftohtë. Lejohet të bësh banjë në këtë orë, apo zgjohet hoteli?
Raviku buzëqeshi.
– Kur ke ndër mend të bësh diçka, mos pyet për pasojat. Përndryshe nuk e bën kurrë.
Ajo e vështroi.
– Për gjërat e vogla s'është keq të pyesësh. Për të mëdhatë, kurrë!

Erjonixx

Ajo u fut në banjë dhe lëshoi ujin. Raviku shkoi e u ul pranë dritares dhe ndezi një cigare. Jashtë, përmbi çatitë, nderej akoma vezulimi i kuqërremtë i qytetit dhe fjollat e imëta të dëborës lodronin pa zhurmë nëpër hapësirë. Një taksi hungëronte nëpër rrugë. Krizantemat feksnin të zbehta mbi dysheme. Mbi kanape qe hedhur një gazetë. E pati blerë në darkë... Luftime në kufirin çek, luftime në Kinë, një ultimatum, një kabinet i rrëzuar. E mori gazetën dhe e rrasi përposh luleve.

*

* *

Xhoana doli nga banja. Ishte ngrohur dhe shkoi e u ul përtokë, pranë tij dhe pranë luleve.

– Ku ishte mbrëmë? – e pyeti.

Ai i zgjati një cigare.

– Vërtet kërkon ta dish?

– Po.

Ai ngurroi paksa.

– Isha këtu, – ia bëri pastaj. – Isha këtu dhe po të prisja. Pandeha se nuk do të vije më dhe dola.

Xhoana nuk tha gjë. Cigarja e saj skuqte herë pas here në errësirë.

– Kjo është e gjitha, – tha Raviku.

– Shkove të pish?

– Po...

Xhoana u kthye e tëra nga ai dhe e vështroi.

– Ravik, – tha ajo, – vërtet ike, sepse pandehe që nuk do të vija?

– Po.

Ajo mbështeti krahët mbi gjunjët e tij. Ai ndjeu ngrohtësinë e saj t'i depërtonte nëpër robdëshambër. Ishte ngrohtësia e saj dhe ngrohtësia e robdëshambrit, të cilin e njihte shumë më mirë nga mjaft vite të jetës së tij; dhe atij iu duk përnjëherësh se ata të dy i përkisnin njëri-tjetrit qysh prej shumë kohësh dhe se Xhoana ishte kthyer përsëri nga diku në jetën e tij.

– Po unë kam ardhur çdo natë te ti, Ravik. Ti duhej ta dije se do të vija edhe dje. Mos ike sepse nuk deshe të më shohësh?

– Jo.

– Mund të ma thuash pa frikë, kur nuk ke qejf të më shohësh?

– Do të ta them.

– Pra, nuk ishte kjo arsyeja?

– Jo, vërtet që nuk ishte kjo.
– Atëherë jam e lumtur.
Raviku e vështroi.
– Çfarë the ashtu?
– Jam e lumtur, – përsëriti ajo.
Ai heshti një hop.
– Po ti a e di se çfarë po thua? – e pyeti pastaj.
– Po.
Drita e zbehtë që vinte nga jashtë pasqyrohej në sytë e saj.
– Gjëra të tilla nuk duhen thënë ashtu si kot, Xhoanë.
– As unë nuk e thashë ashtu si kot.
– Lumturi, – ia bëri Raviku. – Ku fillon e ku mbaron vallë lumturia?
Këmba i çiku krizantemat. Lumturia, tha ai me vete. Horizontet blu të rinisë! Lumturia – balanca e artë e jetës! O perëndi, ku kishte humbur kjo lumturia?...
– Ajo fillon me ty dhe mbaron me ty, – tha Xhoana. – E shikon sa e thjeshtë që është!
Raviku nuk i dha përgjigje. Ç'po flet kjo kështu, mendoi.
– Tani do të më thuash edhe se më dashuron, – ia bëri ai pastaj.
– Të dashuroj.
Ai bëri një lëvizje.
– Po ti akoma nuk më njeh!
– Ç'lidhje ka kjo me atë?
– Ka shumë lidhje. Të dashurosh do të thotë të lidhesh me dikë, me të cilin do të plakesh.
– Kaq thellë s'ma pret mendja mua. Unë di vetëm që është dikush, pa të cilin nuk mund të jetosh. Kaq di unë.
– Ku është *Kalvadosi*?
– Mbi tryezë. Po ta sjell. Mos luaj.
Ajo solli shishen dhe një gotë dhe i vuri përtokë, pranë luleve.
– E di që ti s'më dashuron, – tha ajo.
– Atëherë ditke më shumë se unë.
Ajo ngriti kokën me rrëmbim.
– Por do të më dashurosh!
– Mirë. Për këtë le ta ngremë një gotë.
– Prit! – Ajo e mbushi gotën dhe e piu. Pastaj e mbushi përsëri gjer në buzë dhe ia zgjati.
Raviku ia mori dhe e mbajti një copë herë në dorë. E gjitha kjo s'është e vërtetë, mendoi ai. Një gjysmë ëndrre në një natë të

Erjonixx

vyshkur. Fjalë të pështpëritura në errësirë... E si mund të jenë të vër-
teta? Fjalët e vërteta kanë nevojë për shumë dritë.

– Pse je kaq e sigurt? – e pyeti Xhoanën.

– Sepse të dashuroj.

Sa fort po ma përdor këtë fjalë, mendoi Raviku. Pa e çarë kokën fare, a thua se ka në dorë ndonjë enë të zbrazët. E mbush me diçka dhe ma quan dashuri. E me çfarë s'e kanë mbushur atë enë! Frikë nga vetmia, mbërthim pas një qenieje tjetër, vetëbesim i tepruar, pasqyrim vezullues i fantazisë! Po kush e di se ç'është në të vërtetë? A s'është ajo që i thashë qëparë për punën e lidhjes dhe të plakjes marrëzia e të gjitha marrëzive? A s'ka ajo shumë më tepër të drejtë me atë moskokëçarjen e saj? Dhe unë ç'po rri këtu në këtë natë dimri, në mes luftës që shkoi dhe luftës që po vjen, duke çarë dërrasa si një mësues filloreje? Përse po mbrohem, në vend që të zhytem, edhe në mos besofsha, në këtë vorbull të vakët e qetësuese?

– Përse po mbrohesh? – pyeti Xhoana.

– Si the?

– Përse po mbrohesh? – përsëriti ajo.

– Nuk jam duke u mbrojtur... Kundër kujt të mbrohem?

– Nuk e di. Te ti diçka është e kyçur, dhe ti nuk lejon asgjë dhe askënd të futet brenda.

– E di ç'ke ti, – tha Raviku, – më jep të pi edhe ca.

– Unë jam e lumtur dhe dëshiroj që edhe ti të jesh i lumtur. Jam shumë e lumtur. Zgjohem me ty dhe bie të fle me ty. Tjetër gjë nuk di. Kur mendoj për ne të dy, më vjen sikur në kokë më tingëllojnë kambana të argjendta dhe nganjëherë edhe violina. Kur bredhim nëpër rrugë, më duket sikur ekzistojmë vetëm ne të dy dhe kudo që shkojmë ka muzikë; herë pas here na futen në mes zëra njerëzish dhe, si ndër filma, na rrëshqasin kuadro përpara syve... por muzika mbetet. Ajo mbetet gjithmonë.

Përpara disa javësh nuk ishe aspak e lumtur, por fatkeqe, dhe mua s'më njihje fare, mendoi Raviku. Ç'lumturi e lehtë! Ai e zbrazi gotën e *Kalvadosit*.

– Ke qenë shpesh e lumtur?

– Jo edhe aq shpesh.

– Por nganjëherë ke qenë. Kur e ke dëgjuar për herë të fundit tingëllimën e kambanave të argjendta?

– Përse më pyet kështu?

– Vetëm sa për të të pyetur diçka. Ashtu kot.

– E kam harruar. Dhe as që dua ta kujtoj e ta di. Ishte ndryshe.

Erjonixx

– Gjithmonë është ndryshe.

Ajo i buzëqeshi. Fytyrën e kishte të çiltër e të ndritshme, si një lule me petale të rralla që nuk fsheh asgjë.

– Përpara dy vjetësh kam qenë e lumtur, – tha ajo. – Në Milano. Por nuk zgjati shumë.

– Vetëm ishe në atë kohë?

– Jo. Isha me dikë. Ishte njeri shumë fatkeq e xheloz dhe s'kuptonte asgjë.

– Natyrisht, që s'kuptonte asgjë.

– Kurse ti do të kuptoje. Ai më bënte skena të tmerrshme. – Ajo mori një jastëk nga kanapeja, e vuri pas kurrizit dhe u mbështet rehat-rehat buzë kanapesë. – Më bërtiste e më shante. Më thoshte që isha lavire, e pabesë dhe mosmirënjohëse. Por kjo s'ishte e vërtetë. Për aq kohë sa e dashuroja, i qëndrova besnike. Ai s'e kuptonte që nuk e doja më.

– Kjo nuk kuptohet kurrë.

– Jo, ti do ta kuptoje. Por unë do të të dashuroj gjithmonë. Ti je ndryshe dhe gjithçka është ndryshe mes nesh. Ai donte të më vriste. – Ajo zuri të qeshte. – Gjithmonë duan të të vrasin. Disa muaj më vonë deshi të më vriste ai tjetri. Por për ta bërë, s'e bëjnë kurrë. Ti s'do të doje të më vrisje asnjëherë, apo jo?

– Shumë-shumë mund të të vrisja me *Kalvados*, – tha Raviku. – Pa ma jep atë shishe. Po shoh që biseda jonë po bëhet më njerëzore. Para pak minutash u tremba shumë.

– Sepse të dashuroj?

– Le të mos ia fillojmë prapë nga kjo. Është njëlloj sikur të dalësh shëtitje me fustan me tel e me parukë. Ne jemi bashkë tani... për pak ose për shumë kohë, kjo nuk dihet. Puna është që jemi bashkë, dhe kjo mjafton. Ç'na duhet t'i ngjitim edhe nga një etiketë përsipër?

– Për pak ose për shumë kohë... Kjo sikur s'më pëlqen. Fundja, këto janë vetëm fjalë. Por ti s'ke për të më braktisur. Edhe këto janë vetëm fjalë, dhe ti e di.

– Natyrisht. Po ty a të ka braktisur ndonjë që e dashuroje?

– Po. – Ajo ia nguli sytë. – Gjithmonë njëri braktis i pari. Dhe nganjëherë ai tjetri është më i shpejtë.

– E ti ç'bëre pastaj?

– I bëra të gjitha! – Ajo ia mori gotën nga dora dhe e piu fundin.

– Të gjitha! Por pa asnjë dobi. Isha tmerrësisht fatkeqe.

– Sa të zgjati?

– Një javë.

Erjonixx

– S'të paska zgjatur shumë.

– Kur je vërtet fatkeqe, një javë është sa një jetë e tërë. Ndihesha fatkeqe fund e krye, me të tëra që kam; kështu që pas një jave isha krejt e kapitur, e thyer, e zbrazur. Deri flokët i kisha fatkeqë, lëkurën, shtratin, bile edhe rrobat. Aq isha e mbushur me fatkeqësi, saqë për mua s'ekzistonte gjë tjetër. Dhe kur s'ekziston më asgjë, fatkeqësia fillon të mos jetë më fatkeqësi... Sepse mbetesh bosh fare dhe s'ke me çfarë e krahason më vuajtjen. Dhe pastaj të mbetet vetëm rraskapitja e plotë, e shurdhër... dhe çdo gjë kalon e shuhet. Dhe njeriu nis dalëngadalë të jetojë përsëri.

Ajo ia puthi dorën. Ai i ndjeu buzët e buta, të kujdesshme.

– Ç'po mendon? – e pyeti ajo.

– Asgjë, – tha ai. – Po mendoja vetëm se ti ke në vetvete një pafajni të egër. Je krejtësisht dhe aspak e korruptuar. Dhe kjo është gjëja më e rrezikshme në botë. Nëma gotën. Dua ta ngre njëherë për mikun tim Marozovin, njohësin e shpirtit njerëzor.

– Mua s'më pëlqen Marozovi. A s'mund të pimë për diçka tjetër?

– S'do mend që s'të pëlqen Marozovi. Ai ka sy të fortë. Atëherë le të pimë për ty.

– Për mua?

– Po, për ty.

– Unë s'jam e rrezikshme, – tha Xhoana. – Jam e rrezikuar, por jo e rrezikshme.

– E ke gabim, në qoftë se mendon kështu. Ty kurrë s'ka për të të gjetur gjë. *Salute!*

– *Salute!* Por ti s'po më kupton...

– E ç'i duhet njeriut të kuptojë? Nga kuptimi i tepërt vijnë gjithë keqkuptimet në këtë botë. Ma jep atë shishen.

– Ti po pi shumë. Pse kërkon të pish kaq shumë?

– Xhoanë, – tha Raviku. – Do të vijë një ditë e do të më thuash: Ti po pi jashtë mase! Do të më thuash kështu e do të besosh se më do vetëm të mirën. Kurse në të vërtetë do ta kesh hallin gjetkë: t'i pengosh bredhjet e mia në një zonë, të cilën nuk mund ta kontrollosh dot. *Salute!* Sonte kemi festë. Arritëm të arratiseshim nga thonjtë e patetikës, që na rrinte, kanosëse si një re, atje jashtë dritares. E vdiqëm patetikën me patetikë. *Salute!*

Ai e ndjeu sesi Xhoana u drodh. Ajo u ngrit përgjysmë, duke u mbështetur me duar në dysheme, dhe e kundroi më vëmendje. Bebëzat e syve i kishte të zmadhuara, robdëshambri i kishte shkarë

Erjonixx

nga njëri sup, flokët i derdheshin tufë nga pas dhe, ashtu në mugëtirën e dhomës, ngjasonte e tëra me një luaneshë të re.

– E di, – tha ajo e qetë. – E di që po më përqesh. Por aq më bën. Unë e ndiej që po jetoj; e ndiej me të gjitha shqisat e mia... Frymëmarrjen e kam tani ndryshe dhe gjumin e bëj ndryshe... Gjymtyrët nuk i kam më të mpira dhe duart kanë se ç'të shtrëngojnë... Dhe prandaj aq më bën se ç'thua ti... Unë fluturoj, vrapoj, shtrihem, e lirë dhe pa e vrarë mendjen aspak; jam e lumtur dhe nuk ndiej as ngurrim e as frikë që ta them se jam e lumtur, edhe në qoftë se ti qesh e më tall...

Raviku heshti një copë herë.

– Nuk po tallem me ty, – tha pastaj. – Po tallem me veten, Xhoanë...

Ajo u mbështet pas tij.

– Pse? Ti se ç'ke diçka atje pas ballit, që nuk do, që kundërshton... Pse?

– Atje s'ka asgjë që nuk do e që kundërshton. Puna është vetëm që unë jam ca më i ngadalshëm se ti.

Ajo tundi kokën.

– Nuk është vetëm kjo. Atje ka diçka që dëshiron të mbetet vetëm. Unë e ndiej. Është si një barrikadë.

– Nuk është barrikadë. Janë vetëm pesëmbëdhjetë vjet jetë më tepër nga ç'ke ti. Jo çdokush e ka jetën si një shtëpi të vetën, që e stolis gjithnjë e më bukur me orenditë e kujtimeve. Shumëkush jeton ndër hotele, ndër shumë hotele. Vitet përplasen e mbyllen pas tij si dyer dhomash hoteli... dhe e vetmja gjë që mbetet është një çikëz kurajë dhe as një thërrime keqardhjeje.

Për një copë herë të gjatë ajo nuk i dha përgjigje. Ai nuk ishte fort i sigurt në e pati dëgjuar. Vështronte jashtë dritares dhe ndiente ndër deje rrymën e zjarrmishme por të qetë të *Kalvadosit*. Rrahjet e pulsit heshtnin si të mbuluara me tisin e një qetësie të paanë, heshtnin edhe tiktaket e orës së pandalshme të kohës. Hëna ngrihej e mjegullt dhe e kuqërremtë mbi çatitë, si kubeja e një xhamie të kredhur përgjysmë midis reve, që ngrihej e ngjitej ngadalë, ndërsa toka humbiste e tretej mes flokëve të dëborës.

– E di, – tha Xhoana, me duart mbështetur mbi gjunjët e tij dhe kokën mbi duart e veta. – E di që është marrëzi të t'i rrëfej këto gjërat e mia, që i përkasin një kohe të shkuar. Mund të heshtja ose mund të të gënjeja, por nuk dua. E pse mos të t'i tregoj të gjitha që më kanë ndodhur në jetë, ose pse t'i shtoj e t'i zmadhoj? Më mirë t'i zvogëloj,

sepse tani më duken qesharake dhe s'para i kuptoj më, dhe ti mund të tallesh e të qeshësh me to e, po të duash, edhe me mua.

Raviku ia qepi sytë. Gjunjët e saj i shtypnin lulet e mëdha e të bardha përmbi gazetën, të cilën ai e pati rrasur qëparë përposh krizantemave. Ç'natë e çuditshme, mendoi. Diku po qëllojnë tani me pushkë e me top, njerëz ndiqen e burgosen, torturohen e masakrohen; një copëz bote paqësore po shkelet me egërsi – kurse njeriu është këtu, e di ç'po ndodh dhe, prapëseprapë, s'ka ç'bën; dhe në baret e ndritshme të natës gumëzhin jeta, askush s'e çan kokën, njerëzia shkojnë e bien të flenë të qetë, dhe unë rri këtu me një grua mes krizantemash të zbehta dhe një shisheje *Kalvadosi*, dhe hija e dashurisë zë e ngrihet duke fërgëlluar, si e huaj dhe si e trishtë, vetmitare edhe ajo, e përzënë nga kopshtet e blerta të së kaluarës, e druajtur dhe e egër dhe e nxituar, a thua se s'ka të drejtë të qëndrojë në një vend...

– Xhoanë, – i tha me zë të ulët, ndërsa kishte ndër mend t'i thoshte diçka krejt tjetër, – më bëhet mirë që ti ndodhesh këtu.

Ajo e vështroi.

Ai ia mori duart në të tijat:

– Ti e kupton se ç'do të thotë kjo? Është më shumë se mijëra fjalë...

Ajo pohoi me krye. Sytë iu mbushën aty për aty me lot.

– Kjo s'do të thotë asgjë, – ia bëri ajo. – E di.

– S'është e vërtetë, – iu përgjigj Raviku dhe e dinte që ishte e vërtetë.

– Jo! Asgjë! Ti duhet të më dashurosh, i dashur. Kjo është gjithçka!

Ai nuk i dha përgjigje.

– Ti duhet të më dashurosh, – përsëriti ajo. – Ndryshe jam e humbur.

E humbur, mendoi ai. Sa me nxitim e thotë këtë! Ai që është vërtet i humbur, nuk flet fare...

12

-Ma pretë këmbën? – pyeti Zhanoi.

Gjaku i kishte ikur nga fytyra e hequr dhe ajo dukej e bardhë si një mur i vjetër shtëpie. Qukat i dalloheshin aq fort me atë ngjyrën e tyre të errët, a thua se s'bënin pjesë në lëkurë, por ishin hedhur mbi të si ca pikla boje me penel. Cungu i këmbës prehej poshtë një rrjete teli, sipër së cilës qe hedhur mbulesa e shtratit.

– Ke dhimbje? – e pyeti Raviku.

– Po, në këmbë. Këmba më dhemb shumë. E pyeta infermieren, por shtriga plakë nuk tregon gjë.

– Këmbën ta kemi prerë, – i tha Raviku.

– Sipër apo poshtë gjurit?

– Dhjetë centimetra më lart. Gjuri të ishte thyer dhe s'kishte më shpëtim.

– Mirë, – tha Zhanoi. – Kështu do të marr nja pesëmbëdhjetë për qind më shumë nga sigurimet shoqërore. Shumë mirë. Këmba artificiale mbetet gjithmonë artificiale, qoftë sipër, qoftë poshtë gjurit. Por pesëmbëdhjetë për qind më shumë janë diçka që mund ta fusësh çdo muaj në xhep. – Ai u mendua një copë herë. – Më mirë mos i thoni gjë nënës sime tani për tani. Le që ajo s'ka për ta dalluar dot cungun nën këtë kafaz papagallësh që më keni vënë përsipër.

– Nuk do t'ia themi, Zhano.

– Sigurimet duhet të më paguajnë pension për tërë jetën. Kështu është, apo jo?

– Më duket se po.

Fytyra e bardhë u skërmit.

– Ama ç'do t'ua punoj! Jam trembëdhjetë vjeç. Do të më kenë në kurriz tërë jetën. Morët gjë vesh cilat sigurime janë?

– Akoma jo. Por ne kemi targën e kamionit. Ti e kishe mbajtur mend. Policia erdhi një herë këtu. Desh'i të të merrte në pyetje, por sot në mëngjes ti flije akoma. Thanë që do të vijnë përsëri andej nga mbrëmja.

Zhanoi u mendua.

– Po dëshmitarë a kemi? – ia bëri pastaj. – Dëshmitarët kanë shumë rëndësi.

– Më duket se nëna jote ka nja dy adresa. Sikur ia pashë pusullat në dorë.

Djali filloi të shqetësohej.

– Do t'i humbasë! Në mos i ka humbur që tani!... Ju e dini si janë pleqtë. Po ku është?

– Ajo s'të është ndarë nga shtrati tërë natën gjer sot në drekë. Në drekë ia mbushën mendjen që të shkonte. Por do të kthehet shpejt.

– Shpresoj të mos i ketë humbur adresat. Sa për policinë... – Ai bëri një lëvizje të vogël me dorën e dobësuar. – Kopukë, – murmuriti nëpër dhëmbë. – Të gjithë janë kopukë. U ngrohin kurrizin sigurimeve. Por, po të kesh ca dëshmitarë të saktë, atëherë... Kur kthehet nëna?

– Së shpejti. Mos u bëj merak për atë punë. Do ta rregullojmë.

Zhanoi lëvizi gojën, sikur po përtypte diçka.

– Nganjëherë t'i paguajnë paratë të gjitha në dorë. S'të japin pension, por e përfundojnë çështjen njëherë e mirë. Si punë ujdie. Me ato para mund t'i futeshim tregtisë, unë dhe nëna...

Qetësohu tani, – i tha Raviku. Ke kohë të mendohesh për këtë.

Djali tundi kokën.

Po, - nguli këmbë Raviku. – Kur të vijë policia, duhet të jesh freskët.

– Ah, tamam! Po ç'të bëj?

– Të flesh.

– Por pastaj...

– Të zgjojmë ne.

– Drita e semaforit ishte e kuqe. Këtë e mbaj mend mirë. Shoferi e pati fajin.

– Sigurisht. Dhe tani mundohu të bësh një sy gjumë. Në paç nevojë për ndonjë gjë, ja tek është zilja.

– Doktor...

Raviku u kthye.

– Sikur të rregullohet... – Zhanoi rrinte mbështetur mbi jastëkë dhe një buzëqeshje e lehtë ia vijoste fytyrën e mençur e të shtrembëruar nga dhimbjet. – Nganjëherë njeriu ka edhe fat, si thoni ju?

*
* *

Mbrëmja ishte e ngrohtë dhe me lagështirë. Disa re të shkalafitura dyndeshin ultas mbi qytet. Përpara restorantit të *Fukesë* ishin vendosur stufa të rrumbullakëta që ngroheshin me qymyr koks dhe rreth tyre disa tryeza e karrige. Te njëra nga tryezat po rrinte Marozovi. Ai ia bëri me dorë Ravikut:

– Eja, të pimë nga një bashkë.

Raviku u ul pranë tij.

– Ne rrimë ca si shumë nëpër dhoma, – ia bëri Marozovi. – S'të ka rënë në sy kjo gjë?

– Po ti nuk rri në dhomë. Ti qëndron vazhdimisht në rrugë, përpara *Sheherezades*.

– Lëre atë logjikën tënde varfanjake, kalama! Natën unë jam vetëm një derë dykëmbëshe e *Sheherezades*, por jo njeri që rri jashtë. Ne rrimë ca si shumë nëpër dhoma, të thashë. Ne mendojmë ca si shumë nëpër dhoma. Ne jetojmë ca si shumë nëpër dhoma. Ne dëshpërohemi ca si shumë nëpër dhoma. A mund të dëshpërohet njeriu në natyrën e lirë?

– Posi jo! – tha Raviku.

– Atëherë ai dëshpërohet vetëm, sepse jeton shumë nëpër dhoma, dhe jo sepse është mësuar. Unë mendoj se në natyrë njeriu dëshpërohet më me nder sesa në një apartament me dy dhoma e kuzhinë. Më me nder dhe më rehat... Mos më kundërshto! Kundërshtimi tregon varfëri intelekti perëndimor. E kush ka pasur ndonjëherë të drejtë? Sonte kam pushim dhe dua ta shijoj jetën. Më duhet të shtoj që ne edhe pimë ca si shumë nëpër dhoma.

– Edhe urinojmë shumë nëpër dhoma.

– M'u hiq qafe me atë ironinë tënde, të lutem. Faktet e jetës janë të thjeshta e të rëndomta. Vetëm fantazia jonë u jep gjallëri. Nga hunjtë e zakonshëm të fakteve, si ata hunjtë ku nderen rrobat, ajo bën shtylla flamurësh të ëndrrave. A kam të drejtë?

– Jo.

– S'do mend që jo. As që dua të kem.

– Natyrisht që ke të drejtë.

Erjonixx

– Mirë, vëllaçko. Ne edhe flemë ca si shumë nëpër dhoma; po shndërrohemi në orendi. Godinat prej guri na e kanë thyer shtyllën kurrizore. Jemi bërë shtretër, komodina, kasaforta, kontrata qiraje, mëditës, tenxhere dhe WC-ra shëtitëse.

– Tamam. Jemi bërë edhe programe qeverish, fabrika municionesh, institute qorrash dhe çmendina shëtitëse.

– Mos ma prit vazhdimisht fjalën! Pi, hesht dhe jeto, ti vrasës me thikë kirurgu. Pa shiko si jemi katandisur! Me sa di unë, vetëm gjykët e vjetër kishin perëndira të pijes e të gëzimit të jetës: Bakun dhe Dionizin. Kurse ne, në vend të tyre, kemi shfaqjet e vetënënçmimit dhe psikanalizën... frikë nga fjalët e mëdha në dashuri dhe shumë fjalë të mëdha në politikë. Jemi brez për të ardhur keq. – Marozovi puliti sytë.

Edhe Raviku puliti sytë.

– Cinik plak e i urtë, që sheh ëndrra me sy hapur, – tha ai.

Marozovi zbardhi dhëmbët.

– Romantik i mjerë pa iluzione që, për një kohë të shkurtër mbi këtë dhé, ke marrë emrin Ravik.

– Për një kohë fort të shkurtër. Po të nisesh nga emrat, kjo do të ishte jeta ime e tretë. Kjo vodkë polake është?

– Estone. Nga Riga. Më e mira. Mbushe gotën e pastaj na lër të rrimë rehat këtu, t'ia qepim sytë rrugës më të bukur të botës, t'i thurim lavde kësaj mbrëmjeje të butë e me qetësi të plotë t'i pështyjmë dëshpërimit mu në surrat.

Zjarri në stufat e koksit kërciste. Një burrë me violinë zuri vend buzë trotuarit dhe filloi t'i binte këngës *"Pranë biondinkës sime"*. Kalimtarët përplaseshin me të. Harku filloi të gërvishtte, por burri vazhdonte t'i binte sikur të qe vetëm. Tingujt shpërndaheshin të thata e të shkreta. Dukej sikur violina mërdhinte. Dy marokenë vërtiteshin rreth tryezave dhe ofronin qilima prej mëndafshi artificial.

Gazetashitësit kaluan andej me gazetat e fundit. Marozovi bleu një *Pari suar* dhe një *Edtranzizhan*. U hodhi një sy titujve dhe pastaj i la gazetat mënjanë.

– Falsifikues monedhash, – hungëroi. – A e ke vënë re ndonjëherë që po jetojmë në epokën e falsifikuesve të monedhave?

– Jo. Pandehja se jetonim në epokën e konservave.

– Konservave? Pse?

Raviku rrëfeu me dorë gazetat.

– Se s'kemi nevojë të mendohemi. Gjithçka është e paramenduar, e parapërtypur, e parandier. Punë konservash! Mjafton t'i

Erjonixx

hapim. Mjafton të na i sjellin tri herë në ditë në shtëpi. S'kemi më nevojë të kultivojmë gjë vetë, të rrisim gjë vetë, të gatuajmë gjë vetë mbi zjarrin e pyetjeve, të dyshimeve e të mallit. Vetëm konserva! – Ai u ngërdhesh. – Nuk po jetojmë lehtë, Boris. Po jetojmë lirë.

– Ne jetojmë si falsifikues monedhash. – Marozovi ngriti gazetat përpjetë. – Pa shikoje vetë se ç'shkruajnë! Uzinat e tyre të armëve i ndërtokan pse dashkan paqe; kampet e tyre të përqendrimit i hapkan pse dashurokan të vërtetën; drejtësia është maskë për çdo lajthitje parlamentesh; gangsterët politikë i quajnë shpëtimtarë dhe liria është fjala e madhe që fsheh gjithë etjen për pushtet. Monedha të falsifikuara! Monedha shpirtërore të falsifikuara! Propagandë mashtrimi. Makiavelizëm kuzhine. Idealizmi në duart e fundërrinave. Sikur të ishin të paktën të ndershëm... – Ai i mblodhi gazetat shuk dhe i flaku tej.

– Ne lexojmë edhe ca si shumë gazeta nëpër dhoma, – tha Raviku.

Marozovi qeshi.

– Natyrisht. Në natyrë ato vetëm për zjarr mund të...

Ai e preu fjalën. Raviku nuk ndodhej më pranë tij. Kishte brofur në këmbë dhe tani po shtyhej midis turmës në trotuar, në drejtim të bulevardit *Zhorzh V.*

Marozovi u topit vetëm për një sekondë. Pastaj nxori ca para nga xhepi, i hodhi në njërën prej pjatave të porcelanit ku ishin vënë gotat dhe ndoqi Ravikun. Nuk e dinte se ç'kishte ndodhur, por e ndoqi që, po t'ia kishte nevojën, t'i ndodhej pranë për çdo rast. Nuk vuri re njerëz të policisë. As ndonjë detektiv civil që t'i ishte qepur Ravikut pas. Në trotuar gëlonte një mizëri njerëzish. Shumë më mirë për të, mendoi Marozovi. Po ta ketë njohur ndonjë polic, mund t'i shpëtojë fare kollaj. Ia zuri syri përsëri vetëm kur arriti bulevardin *Zhorzh V.* Sapo ishte dhënë shenja për makinat dhe radhët e paralizuara të automjeteve u derdhën përpara. Megjithatë, Raviku u përpoq ta kalonte rrugën. Mend e shkeli një taksi. Shoferi filloi të turfullonte e të shante. Marozovi e zuri Ravikun për krahu dhe e tërhoqi mbrapa.

– Luajte mendsh? – i bërtiti. – Ke qejf të vrasësh veten? Ç'ka ndodhur?

Raviku nuk iu përgjigj. I kishte mbërthyer sytë në anën tjetër të rrugës. Qarkullimi ishte shumë i dendur. Radhë të tëra makinash shtyheshin njëra pas tjetrës. Ishte e pamundur të kaloje matanë. Raviku qëndronte buzë trotuarit, me trupin prirur përpara dhe, nuk ia shqiste sytë anës tjetër të rrugës.

Marozovi e shkundi.

– Ç'ka ndodhur? Policia?

– Jo. – Raviku nuk po ua shqiste sytë automobilave që i rrëshqi-snin përpara.

– Po çfarë ke atëherë, Ravik?

– Hakeja...

– Qysh? – Sytë e Marozovit u ngushtuan. – Ç'pamje ka?... Thuajma shpejt!

– Është me një pallto gri...

Vërshëllima e mprehtë e policit që drejtonte trafikun u dëgjua që nga mesi i *Shanz-Elizesë*. Raviku u sul përpara, duke kaluar për-mes makinave të fundit. Një pallto gri e errët – vetëm kaq dinte. Kapërceu bulevardin *Zhorzh V.* dhe *rrugën Basano*. Përnjëherësh i dolën përpara sysh duzina palltosh gri. Ia këputi një të share dhe u shty më tej, duke nxituar përmes turmës. Në rrugën *Galilea* ishte ndalur qarkullimi. Ai kaloi matanë me të shpejtë dhe vazhdoi të çante turmën e njerëzve drejt *Shanz-Elizesë*. Arriti në rrugën *Presburg*, kaloi kryqëzimin dhe befas u step në vend: përpara tij shtrihej *Plas dë l'Etualë*, ai sheshi i madh në trajtë ylli që të merrte mendtë me qar-kullimin e dendur e me rrugët që shpërndaheshin nga të gjitha anët. Mori fund! Këtu s'kishte se ç'të gjente më.

U kthye, duke ecur tani shumë ngadalë e duke soditur përsëri me vërejtje fytyrat e turmës – por ankthi iu shtua. Përnjëherësh e ndjeu veten krejt bosh. Ose ishte gabuar sërish, ose Hakeja i kishte shpëtuar nga dora për të dytën herë! Por a mund të gabonte njeriu dy herë rresht? A mund të zhdukej njeriu dy herë rresht si ta për-pinte dheu? Ja tek ishin edhe rrugët anësore. Ndoshta Hakeja ishte futur në njërën prej tyre... Ai i hodhi një sy rrugës *Presburg*. Automobila, automobila dhe njerëz, njerëz. Ora më me gjallëri e mbrëmjes. S'kishte kuptim të kërkonte më. Përsëri vonë, tepër vonë...

– Nuk e gjete? – e pyeti Marozovi që i doli përpara.

Raviku tundi kokën.

– Më duket se po shoh përsëri fantazma.

– A e njohe?

– Më duket se po. Por tani... tani s'di asgjë.

Marozovi ia nguli sytë.

– Ka shumë fytyra që i ngjajnë njëra-tjetrës.

– Po. Por ka edhe fytyra që nuk i harron dot tërë jetën!

Raviku u ndal.

Erjonixx

– Ç'ke ndër mend të bësh tani? – e pyeti Marozovi.
– Nuk e di. Fundja, ç'mund të bëj?
Marozovi ia mbërtheu sytë turmës.
– Tersllëk i madh! Është tamam koha kur dalin nga puna. Kudo gjullurdi...
– Ashtu është...
– E pastaj edhe kjo dreq drite! Gjysmerrësirë... Po ti a e dallove mirë?
Raviku nuk iu përgjigj. Marozovi i shkoi krahun.
– Dëgjo këtu, – i tha. – S'ka kuptim të bredhësh akoma rrugëve dhe udhëkryqeve. Kur të jesh në njërën, do të pandehësh që ai ndodhet në tjetrën. S'ke asnjë shans. Eja të kthehemi te *Fukeja*. Atje është vendi më i përshtatshëm. Që andej mund të vëzhgosh më mirë sesa po të vërtitesh kot rrugëve. Po të kthehet, ti me siguri do ta diktosh.
Ata zunë vend te një tryezë që ndodhej buzë trotuarit, prej nga mund të shikoje nga të gjitha anët. Ndenjën gjatë atje.
– E ç'do të bësh, po ta takosh? – pyeti Marozovi pas një copë here. – E ke vrarë mendjen për këtë?
Raviku tundi kokën.
– Mendohu një herë. Është më mirë kur e di që më parë. S'ka kuptim të hutohesh pastaj e të bësh marrëzira. Sidomos në këtë gjendje që ndodhesh ti. S'besoj se ta ka qejfi të hash disa vjet burg këtu në Francë!
Raviku ngriti kokën. Nuk i dha përgjigje, por i hodhi vetëm një shikim.
– Mos bëj sikur s'e çan kokën, – vazhdoi Marozovi. – Apo do që ta çaj unë për ty? Epo mirë. Ç'do të kishe bërë sikur të qe vërtet ai dhe ti ta kishe zënë atje matanë në një qoshe?
– Nuk e di, Boris. Vërtet që nuk e di.
– Nuk të ndodhet gjë me vete, ë?
– Jo.
– Po të ishe vërsulur mbi të pa u menduar mirë, brenda një minute do t'ju kishin ndarë të tjerët. Ti do të ndodheshe tani në polici, kurse ai do të shpëtonte vetëm me disa vula të zeza në trup. Besoj se këtë e ke të qartë, apo jo?
– Po. – Raviku vështronte rrugën si i shastisur.
Marozovi u mendua një hop.
– Shumë-shumë mund ta kishe shtyrë nën rrotat e automobilave në ndonjë kryqëzim rruge. Por edhe kjo s'do të ishte fort e sigurt. Ai mund të shpëtonte vetëm me ca të gërvishtura.

Erjonixx

– Nuk kam për ta shtyrë nën rrota. – Raviku vështronte rrugën si i shastisur.

– Ta besoj, – i tha Marozovi dhe heshti. – Ravik, – ia bëri pastaj, – sikur të ketë qenë vërtet ai dhe sikur të arrish ta takosh, atëherë duhet të jesh fort i sigurt në punën tënde. Ma merr mendja që këtë e di edhe vetë. Mos harro se do të kesh vetëm një rast, vetëm një!

– Po, e di. – Shikimi i ngrirë i Ravikut nuk shkulej nga rruga.

– Po ta pikasësh prapë, atëherë ndiqe. Mos bëj asgjë tjetër. Vetëm bjeri pas. Gjeje ku banon. Asgjë tjetër, dëgjon? Për të tjerat mund të mendohesh më vonë. Merre shtruar. Mos bëj marrëzira, dëgjon?

– Po, – i tha Raviku si i hutuar, pa ia shqitur sytë rrugës.

*

* *

Një shitës fëstëkësh iu afrua tryezës së tyre. Pas tij erdhi një djalë i vogël që ofronte minj-lodër. I bënte të hidhnin valle mbi pllakën e mermertë të tryezës dhe të ngjiteshin mbi krahun e tij. Violinisti u shfaq për së dyti në trotuar. Tani lozte këngën *"Folmë për dashurinë"* dhe kishte ngjeshur një kapelë në kokë. Një plakë me hundë sifilitike u zgjaste klientëve vjollca.

Marozovi vështroi orën.

– Tetë, – tha ai. – S'ka kuptim të presim më, Ravik. Kemi më se dy orë që po rrimë këtu. Në këtë kohë ai s'të kalon më këtej. Çdo njeri në Francë i është shtruar tani darkës.

– Ik ti, Boris. Ç'të duhet të rrish kot së koti me mua?

– Nuk e kam hallin aty. Mund të rri me ty sa të duash. Por nuk dua që të marrosesh. Nuk ka asnjë kuptim të rrish e të presësh këtu me orë të tëra. Mundësia për ta takuar atë është tani kudo njëlloj. Bile tani kjo mundësi është edhe më e madhe në çdo restorant, në çdo klub nate, në çdo bordel.

– E di, Boris.

– Marozovi vuri dorën e tij të madhe e leshtore mbi krahun e Ravikut.

– Ravik, – tha ai, – dëgjomë. Në qoftë e thënë që ta takosh atë njeri, do ta takosh. Dhe në mos qoftë e thënë, mund të presësh vite të tëra. Ti e kupton se ç'dua të them. Bëji sytë katër... kudo. Dhe ji i përgatitur për çdo gjë. Kurse për të jetuar, jeto sikur je gabuar. Ndoshta edhe je gabuar. Kjo është e vetmja gjë që mund të bësh. Ndryshe do të shkatërrosh veten. – Ai e piu gotën me fund. – Dhe

tani eja me mua. Të shkojmë e të hamë gjëkundi.

– Shko ti, Boris. Unë vij më vonë.

– Ke ndër mend të rrish këtu?

– Edhe pak. Pastaj do të nisem për në hotel. Kam një punë atje. Marozovi i hodhi një shikim. E dinte se ç'punë kishte Raviku në hotel. Por gjithashtu e dinte se s'kishte ç't'i bënte më tepër. Kjo çështje i përkiste vetëm Ravikut.

– Mirë, – i tha. – Mua mund të më gjesh në *Mer Mari*. Më vonë më ke në *Bubilshki*. Më telefono ose eja vetë. – Ai rrudhi vetullat e trasha. – Dhe mos e fut kokën në torbë. Mos u bëj hero kotnasikoti! As hajvan mos u bëj! Qëllo vetëm atëherë kur të jesh i bindur se do të mund t'ia mbathësh me siguri. Kjo s'është lodër fëmijësh dhe as film gangsterësh.

– E di, Boris. Mos u bëj merak.

*

* *

Raviku shkoi në hotel *Internacional* dhe doli prapë. Rrugës kaloi përpara hotel *Milanit*. I hodhi një sy orës. Ishte tetë e gjysmë. Xhoanën mund ta gjente akoma në dhomën e saj.

Ajo i doli përpara.

– Ravik, – i tha me habi, – tek unë po vjen?

– Po.

– Po ti s'ke ardhur më kurrë këtu! Qysh atëherë, kur erdhe të më marrësh...

Ai u mundua të vinte buzën në gaz.

– Është e vërtetë, Xhoanë. Ne bëjmë një jetë të çuditshme.

– Po. Si urithët, si lakuriqët e natës, a si bufët. Shihemi vetëm kur errësohet.

Ajo zuri të bridhte nëpër dhomë me hapa të gjatë e të butë. Kishte veshur një robdëshambër blu të prerë si për burra dhe në bel e kishte shtrënguar fort me një rrip. Mbi shtrat ishte hedhur fustani i zi i mbrëmjes që e vishte kur shkonte në *Sheherezade*. Dukej shumë e bukur dhe tejet e largët.

– S'të erdhi koha për të shkuar në punë, Xhoanë?

– Akoma jo. Pas një gjysmë ore. Kjo është koha ime më e dashur. Ora përpara se të shkoj në punë. Ti e sheh sa gjëra të mira kam në këtë orë. Kafe dhe kohë boll. Tani të kam edhe ty. Në daç ta dish, kam edhe një shishe *Kalvados*.

Erjonixx

Ajo solli shishen. Ai e mori dhe e la të pahapur mbi tryezë. Pastaj i shtrëngoi me butësi duart e saj.

– Xhoanë... – i tha.

Drita në sytë e saj u shua dhe ajo iu avit më pranë.

– Thuajma shpejt, çfarë ke...

– Pse? Çfarë mund të kem?

– Diçka. Kur sillesh kështu, ti gjithmonë ke diçka. Prandaj ke ardhur?

Atij iu bë sikur duart e saj po i largoheshin. Ajo nuk lëvizte. As duart nuk i lëviznin. Dukej vetëm sikur diçka po i tërhiqte ato duart larg tij.

– Sonte nuk mund të vish tek unë, Xhoanë. Sonte jo, ndoshta as nesër dhe as për disa ditë me radhë.

– Duhet të rrish në klinikë?

– Jo. Është diçka tjetër. Nuk mund të ta them dot. Por është diçka që s'ka të bëjë as me ty e as me mua.

Ajo qëndroi një copë herë pa lëvizur.

– Mirë, – tha pastaj.

– E kupton?

– Jo. Por meqë e thua ti, sigurisht ashtu do të jetë.

– Nuk zemërohesh?

Ajo e vështroi.

– Ah, Ravik, – ia bëri sakaq. – Si mund të të zemërohem ty?

Ai ngriti sytë me rrëmbim. Iu duk sikur një dorë iu lëshua e rëndë mu mbi zemër. Atë që tha Xhoana, e tha pa qëllim; por çfarë-do të kishte bërë tjetër, s'do ta kishte goditur dot më shumë. Ai nuk u jepte fort rëndësi atyre gjërave që murmuriste e pëshpëriste ajo netëve; ato harroheshin sapo avujt e mëngjesit të murrmë ngriheshin përpara dritares. Ai e dinte që ekstaza e atyre orëve kur ajo rrinte ose shtrihej pranë tij, ishte po aq ekstazë edhe për veten e saj, dhe ai e konsideronte si një dehje apo si një pohim të zjarrtë të disa çasteve – por asgjë më tepër se aq. Kurse tani, për herë të parë, pa diçka më tepër – si ai piloti që, përmes një të çare në grumbullin e ndritshëm të reve ku drita luan mbyllasyza, dallon befas poshtë vetes tokën e blertë e ngjyrëkafe. Nën ekstazën ai pa një shpirt të përkushtuar, nën dehjen pa ndjenjën, nën tingëllimën e fjalëve besimin e thjeshtë. Ai pati pritur shfaqje dyshimi, pyetje dhe moskuptim – por jo këtë. Gjithmonë ishin gjërat e vogla ato që të bindnin, kurrë të mëdhatë. Të mëdhatë ndodheshin shumë pranë gjesteve dramatike dhe tun-dimit për ta gënjyer tjetrin...

Erjonixx

Një dhomë. Një dhomë hoteli. Disa valixhe, një shtrat, një dritë; përpara dritares zbrazëtira e zezë e natës dhe e së kaluarës – dhe këtu një fytyrë e çiltër me sy gri, me vetulla të larta e me një kurorë krenare flokësh... Jetë, jetë e brishtë, e kthyer nga ai, krejt e shpalosur, si një tufë lule landre e kthyer nga drita... Ja tek ishte, ja tek qëndronte, në pritje, në heshtje e, prapëseprapë duke i thirrur: Merrmë! Mbamë! – A nuk i kishte thënë dikur, para shumë kohësh: Do të të mbaj!...

Ai u ngrit.

– Natën e mirë, Xhoanë.

– Natën e mirë, Ravik.

*

* *

Ai po rrinte përpara lokalit të *Fukesë*. Rrinte po në të njëjtën tryezë. Dhe e kishte bërë zakon këto ditët e fundit të rrinte atje me orë të tëra, i varrosur në errësirën e së kaluarës, të cilën e ndriçonte vetëm një dritëz e mekur: shpresa për hakmarrje...

...E patën arrestuar në gusht të 1933-shit. Kishte fshehur në shtëpinë e vet për dy javë rresht dy shokë që i kërkonte Gestapoja; dhe pastaj i ndihmoi të arratiseshin. Njëri prej tyre ia pati shpëtuar jetën më 1917, pranë Biksshotes, në Flandër, duke e tërhequr nën breshërinë e mitralozave nga vija e parë, ku qe shtrirë i mbytur në gjak. Tjetri ishte një shkrimtar hebre, të cilin e njihte prej vitesh... E morën në pyetje; deshën të nxirrnin prej tij se në ç'drejtim ishin arratisur ata të dy, ç'dokumente kishin me vete dhe kush do t'u ndihmonte gjatë rrugës. Hetuesi ishte Hakeja. Pas zalisjes së parë, ai u orvat ta vriste Haken me revolverin e tij ose ta mbyste. Por qe vetëm një kërcim drejt një errësire shungulluese, ku sytë i shihnin vetëm xixa të kuqe. Qe një përpjekje e çmendur kundër katër burrave të fuqishëm e të armatosur. Pastaj, për tri ditë me radhë, në mes alivanit, dhimbjeve të tërbuara dhe kllapisë, i dilte vazhdimisht përpara fytyra e Hakes, e vijosur nga një buzëqeshje e akullt e djallëzore. Tri ditë me radhë të njëjtat pyetje – tri ditë me radhë i njëjti trup, i sakatosur, thuajse i paaftë për të vuajtur më... Dhe pastaj, pasdreken e ditës së tretë, sollën gruan. Ajo nuk dinte gjë prej gjëje. E ballafaquan me të që të tmerrohej e të tregonte. Ajo ishte një krijesë e bukur dhe mondane, që kishte kaluar një jetë zbavitëse e pak a shumë të sipërfaqshme. Ai priste që ajo të ulërinte e të ligështohej. Por ajo nuk u ligështua, u derdh mbi

Erjonixx

xhelatët dhe i fyeu për vdekje. Dhe vdekja e priste, dhe ajo e dinte këtë. Hakeja nuk kishte buzëqeshur më, por i kishte ndërprerë pyetjet. Të nesërmen e asaj dite ai i shpjegoi Ravikut se çfarë do të përsonte ajo në kampin e përqendrimit të grave, në rast se ai nuk do të pohonte. Raviku nuk i kishte dhënë përgjigje. Atëherë Hakeja i kishte shpjeguar se çfarë do të përsonte ajo përpara se ta shpinin në kamp. Raviku nuk kishte pohuar gjë, sepse nuk kishte çfarë të pohonte. Ai u përpoq ta bindte Haken se gruaja s'mund të dinte gjë. I tha që e njihte vetëm përciptazi; që ajo në jetën e tij kishte qenë diçka më tepër se një portret i bukur; që kurrë s'do të kishte mundur t'i hapte zemrën për ndonjë gjë. Të gjitha këto ishin të vërteta. Por Hakeja kishte vënë vetëm buzën në gaz. Tri ditë më vonë gruaja vdiq. Kishte varur veten në kampin e përqendrimit. Një ditë më pas sollën njërin nga të arratisurit. Ishte shkrimtari hebre. Kur e pa Raviku, nuk e njohu dot – as nga zëri. Hakeja e mori shkrimtarin edhe një javë në pyetje, gjersa e vdiq fare. Pastaj edhe për Ravikun erdhi kampi i përqendrimit. Spitali. Arratisja nga spitali...

*

* *

Hëna varej e argjendtë mbi Harkun e Triumfit. Fanarët në të përpjetën e *Shanz-Elizesë* luhateshin në erë. E gjithë ajo llamburitje pasqyrohej në gotat mbi tryezë... Si e pavërtetë më duket çdo gjë – këto gota, kjo hënë, kjo rrugë, kjo natë dhe kjo orë, që më qarkon si fllad, sikur e kam jetuar dikur, në një jetë tjetër, në një planet tjetër... Si të pavërteta më duken këto kujtime vitesh të shkuara, që janë fundosur diku, të gjalla e të vdekura njëherësh, që kanë mbetur fosforeshente vetëm në trurin tim dhe që janë ngurtësuar në fjalë... Dhe si e pavërtetë është kjo lëndë që më lëvrin nëpër errësirën e dejeve, e shqetësuar, 36.7 gradë e ngrohtë, me shije pak të kripur, katër litra fshehtësi dhe lëvizje e pareshtur: gjak, pasqyrim në sistemin qelizor, trazim i padukshëm në mbretërinë e Hiçit që quhej kujtesë dhe që hidhte përpjetë yll pas ylli, vit pas viti, një të bardhë, një tjetër të përgjaktë, si përmendorja e Marsit në rrugën *Berri*, dhe shumë të tjerë me vezullim të zymtë e plot njolla – ky është qielli i kujtimeve, nën të cilin e tanishmja e shqetësuar bënte jetën e saj të turbullt.

Drita e gjelbër e hakmarrjes. Qyteti që notonte ngadalë në dritën e hënës dhe në rrapëllimën e motorëve të automjeteve. Radhë shtëpish – të gjata e të shtrira gjer në pafundësi. Radhë dritaresh – dhe

pas tyre një mori fate njerëzish. Rrugë. Rrugë. Rrugë. Trokitje zemre miliona njerëzish, trokitje të pareshtura zemre, si të një motori milio-na cilindrash, që shtyhej dalëngadalë përgjatë rrugës së jetës dhe, me çdo trokitje, i afrohej një milimetër vdekjes...

Ai u ngrit nga karrigia. *Shan-Elizeja* ishte tani pothuajse e shkre-të. Disa prostituta kishin zënë pritë nëpër qoshe. Ai mori bulevardin teposhtë, kaloi pranë rrugëve *Pjerr Shardo, Marbëf, Marinjan* dhe pastaj shkoi gjer te *Ron-Pue* dhe u kthye përsëri te Harku i Triumfit. Kapërceu zinxhirin dhe u ndal përpara Varrit të Ushtarit të Panjohur. Llamba e vogël blu flakëronte në hije. Një kurorë lulesh që po vyshkeshin qe vendosur poshtë saj. E kaloi *Etualin* dhe u fut në barin, nga kujtonte se e pati vënë re Haken për herë të parë. Brenda ndodheshin disa shoferë. Ai zuri vend pranë dritares ku qe ulur edhe radhës tjetër dhe piu një kafe. Jashtë rruga ishte krejt e shkretë. Shoferët kuvendonin për Hitlerin. U dukej qesharak dhe i profetizo-nin një fund të shpejtë, po t'ia mbante të prekte vijën e fortifikuar *Mazhino*. Raviku nuk i shqiste sytë nga rruga. Ç'po rri akoma këtu, tha me vete. Mund të rrija edhe në çdo vend tjetër të Parisit, shansi do të qe i njëjtë. Vështroi orën. Po shkonte tre pas mesnate. Tepër vonë. Hakeja – sikur të kishte qenë vërtet ai – nuk do të bridhte më rrugëve në këtë orë.

Në u ktheftë do të ngrihem, mendoi ai. Prostituta u kthye. Ai nuk u ngrit. Jashtë i zuri syri një prostitutë që vinte vërdallë. Ajo hodhi një sy brenda dritares dhe eci më tej. Në u ktheftë edhe njëherë, do të ngrihem se s'bën e do të iki që këtej, vendosi ai. Atëherë Hakeja nuk qenka më në Paris. Prostituta u kthye, i bëri një shenjë me kokë dhe kaloi. Ai nuk lëvizi nga vendi. Ajo u kthye edhe një herë tjetër. Ai nuk u tund.

Kamerieri filloi t'i vinte karriget mbi tryeza. Shoferët paguan dhe dolën nga bari. Kamerieri fiku dritën e banakut. Lokali u zhyt në një mugëtirë të ndotur. Raviku hodhi sytë përreth.

– Ejani të paguaj, – i tha kamerierit.

*

* *

Përjashta kishte filluar të frynte erë e të bënte ftohtë. Retë dyndeshin më lart dhe më shpejt. Raviku kaloi përpara hotelit të Xhoanës dhe qëndroi. Të gjitha dritaret ishin të errësuara, përveç njërës, ku, pas perdeve, vezullonte një llambë. Ishte dhoma e

Erjonixx

Xhoanës. E dinte që asaj nuk i pëlqente të hynte në një dhomë pa dritë. E kishte lënë llambën ndezur, sepse sonte s'do të vinte tek ai. Raviku filloi të mos e kuptonte më veten. Ç'iu shkrep që nuk deshi ta takonte? Kujtimi për atë gruan tjetër ishte tretur me kohë, vetëm kujtimi i vdekjes së saj kishte mbetur... Po çështja tjetër? Ç'lidhje kishte ajo me Xhoanën? Bile, ç'lidhje kishte edhe me atë vetë? A s'ishte ai një i krisur që rendte pas një përftimi, pas një pasqyrimi kujtese të trazuar e të zezë, pas një reagimi të turbullt...? Pse po rrëmonte përsëri në llumin e viteve të vdekura, i shtyrë nga një rastësi, nga një ngjashmëri e nëmur...? Pse po lëndonte një neurozë të posashëruar, pse po hapte një plagë të kalbur të së kaluarës dhe po rrezikonte të shkatërronte atë që kishte mëkëmbur brenda vetes dhe, bashkë me të, edhe të vetmin njeri, me të cilin qe lidhur në këto rrugë rrëshqitëse...? Ç'lidhje kishte njëra me tjetrën? A s'e pat mësuar veten të mendonte gjithmonë kështu? Ndryshe si do t'ia kishte dalë në jetë? Ndryshe ku do të kishte përfunduar?

Ndjeu se si po shkrihej dalëngadalë plumbi që ia rëndonte gjymtyrët. Mori frymë thellë. Era frynte nëpër rrugët me gulshe të shpejta. Ai ngriti sytë dhe vështroi përsëri dritaren e ndriçuar. Atje jetonte një njeri, për të cilin ia vlente diçka, një njeri, për të cilin ishte i rëndësishëm, një qenie, fytyra e së cilës ndërronte sa herë që e shihte – dhe ai kishte dashur ta therorizonte atë krijesë për hir të një iluzioni të turbullt, për hir të një krenarie dhe padurimi që i ngjallte shpresa e zbehtë e hakmarrjes...

Po çfarë kërkonte? Pse mbrohej akoma? Pse ruhej? Jeta po i falej, kurse ai nxirrte bishta. Jo pse ishte tepër pak ajo që po i falej – por pse ishte vërtet shumë. Vallë, për ta kuptuar këtë, a ishte e nevojshme që më parë të vërshonte mbi të shtrëngata e përgjaktë dhe mizore e së kaluarës?... Ai ngriti supet. Zemra, tha me vete. Zemra! Si po gufonte! Si po trazohej! Dritarja, tha me vete. Dritarja e vetmuar që ndriçonte nëpër natë, rrezatim i një jete tjetër, që i qe hedhur me rrëmbim ndër krahë, e hapur, e gatshme, gjersa edhe ai vetë i qe hapur asaj. Flaka e ëmbëlsisë, zjarri si shpërthim rrufeje i dashurisë, vetëtimat e ndritshme e të shpejta të gjakut – të gjitha këto njeriu i njihte, i njihte aq shumë, saqë pandehte se kurrë më s'do mund t'ia përmbytte trurin kjo turbullirë e artë... Por ja që pastaj, ashtu papritur, vinte një natë si kjo dhe po ky njeri ngulej përpara një hoteli të dorës së tretë, dhe këto ndjenja aq të njohura ngriheshin si tym nga asfalti... dhe të dukej sikur vinin nga ana tjetër e botës, nga ishujt e kaltër të kokosëve... të dukej sikur nxehtësia e një pranvere tropiku

filtrohej nëpërmes oqeanesh, koralesh, elavash dhe mugëtirash dhe sikur ngrihej pastaj me rrëmbim mbi Paris, në rrugën e shëmtuar *Dë Ponsële*, përzier me aromë mimozash dhe lule akshami, në një natë të tillë plot hakmarrje dhe kujtime të së kaluarës... Kështu ngriheshin, të papërmbajtshme, të pakundërshtueshme këto ndjenja të çliruara e misterioze...

*
* *

Sheherezadja ishte plot me njerëz. Xhoana rrinte në një tryezë me disa të tjerë. Ajo e vuri re Ravikun menjëherë atje te dera, ku kishte qëndruar. Lokali notonte në tym e muzikë. Ajo u tha diçka njerëzve në tryezë dhe eci me të shpejtë drejt tij.

– Ravik...

– Ke punë akoma këtu?

– Pse?

– Dua të të marr me vete.

– Po ti më the sikur...

– Ajo kaloi. Ke punë akoma këtu?

– Jo. Vetëm se duhet t'u them atyre që po shkoj.

– Bëje shpejt... Po të pres jashtë, në taksi.

– Mirë. – Ajo ndaloi një hop. – Ravik...

Ai e vështroi.

– Për mua u ktheve? – e pyeti ajo.

Ai ngurroi për një sekondë.

– Po, – i tha pastaj me zë të ulët fytyrës gulçuese që i qe avitur fare pranë. – Po, Xhoanë. Për ty. Vetëm për ty!

Ajo bëri një lëvizje të rrëmbyer.

– Eja, – i tha. – Të ikim! Ç'na duhen këta njerëz këtu.

*
* *

Taksia kaloi nëpër rrugën *Liezhë*.

– Çfarë të ndodhi, Ravik?

– Asgjë.

– Unë pata shumë frikë.

– Harroje. S'ishte gjë.

Xhoana i hodhi një vështrim.

– Thashë se s'do të vije kurrë më.

Ai u përkul mbi të. Ndjeu se si dridhej.

– Xhoanë, – i tha. – Mos mendo për asgjë dhe mos pyet për asgjë. I sheh këto drita fanarësh dhe këto qindra e qindra reklama? Ne jetojmë në një kohë që po vdes, kurse ky qytet gjëmon nga jeta. Jemi shkulur nga të gjitha dhe na kanë mbetur vetëm zemrat tona. Unë isha gjer në hënë dhe u ktheva sërish. Dhe ti je këtu, dhe ti je jeta. Mos pyet më gjatë. Më shumë të fshehta ka në flokët e tu sesa në mijëra pyetje. Këtu, para nesh, shtrihet nata: disa orë, por edhe një pafundësi e tërë, gjersa të vijë mëngjesi e të trokasë në dritare. Që njerëzit dashurohen, kjo është gjithçkaja; është çudia vetë dhe njëkohësisht gjeja më e natyrshme që ekziston... Këtë e ndjeva sonte, kur nata u shkri në një pemë plot bulëza dhe kur era kundërmonte aromë manash... Dhe pa dashurinë njeriu është vetëm një i vdekur që ka ardhur me lejë, s'është gjë tjetër veçse disa data dhe një emër i rastit... dhe do të ishte më mirë sikur të vdiste fare.

Drita e fanarëve të rrugës futej përmes xhamit të taksisë si projektorët rrotullues të një fari, kur hyjnë në errësirën e një kabine vapori. Sytë e Xhoanës në fytyrën e zbehtë herë merrnin një ngjyrë shumë të çelët e herë shumë të zezë.

– Ne nuk vdesim, – pëshpëriti ajo në krahët e Ravikut.

– Jo. Ne jo. Vetëm koha. Koha e mallkuar. Ajo vdes gjithmonë. Ne jetojmë. Ne jetojmë gjithmonë. Kur zgjohesh ti, është pranverë, dhe kur bie ti në gjumë, është vjeshtë; dhe një mijë herë në mes këtyre dy stinëve është dimër e verë; dhe po qe se duhemi shumë, jemi të përjetshëm e të pathyeshëm, si rrahjet e zemrës, si shiu, si era... dhe kjo është gjë e madhe! Ne fitojmë ditë, o e dashura ime e ëmbël, dhe humbasim vite. Por kush do t'ia dijë dhe kush e çan kokën për këtë? Ora është jeta. Çasti më afër përjetësisë... Sytë e tu vezullojnë, yjet pikojnë zjarr mbi Gjithësinë, perënditë thinjen nga pleqëria, por goja jote është e re dhe e freskët, e fshehta fërgëllon mes nesh: Ti dhe Unë... thirrje dhe përgjigje, që lindin nga gjiri i mbrëmjeve, nga mugëtirat, nga mrekullimi i të gjithë dashnorëve, të shtrydhur në mes të më të largtave klithje të zjarrta e gjer te stuhia e artë, që nga rruga e stergjatë prej amebës te Ruthi, Esteri, Helena dhe Aspasia e gjer te shën Mëritë kaltëroshe të kishave buzë rrugëve, që nga zvarritja dhe kafsha e gjer te Ti e tek Unë...

Ajo rrinte strukur në gjirin e tij, pa lëvizur, me fytyrë të zbehtë dhe aq e dhënë, saqë dukej si e magjepsur – dhe ai përkulej mbi të dhe i fliste e i fliste... Dhe në fillim atij iu duk sikur e vështronte

Erjonixx

dikush pas supeve, një hije që fliste bashkë me të, pa zë e me një buzëqeshje të mjegullt... Dhe ai u përkul edhe më shumë dhe ndjeu se si po i afrohej edhe ajo. Hija ndodhej akoma atje, por pastaj u zhduk...

Erjonixx

13

– Një skandal! – tha gruaja me smeraldet, që rrinte përkundrejt Keti Hegshtrëmit. – Një skandal plot qyfyre! I gjithë Parisi po gajaset së qeshuri. A të ka shkuar ndonjëherë mendja që Luisi të ishte homoseksual? Sigurisht që jo. E pra, as ne nuk e dinim; ai kishte ditur ta mbulonte me shumë marifet. Lina dë Njuburgu mbahej si mantenuta e tij zyrtare... Kurse tani përfytyro se ç'na ndodhi: përpara një jave Luisi kthehet nga Roma, tri ditë më parë nga ç'kishte thënë, dhe në mbrëmje e mban vrapin drejt e tek apartamenti i atij Nikit, dylberit të vet; kishte qejf t'i bënte një surprizë... E kë, thua ti, na gjeti atje?

– Gruan e vet, – ia priti Raviku duke hyrë në mes të muhabetit.

Gruaja me smeralde ngriti sytë. Atë çast të jepte përshtypjen sikur sapo kishte marrë lajmin që i shoqi falimentoi me të tëra.

– Pra, e paskeni marrë vesh këtë histori? – e pyeti ajo Ravikun.

– Jo. Por kështu duhej të ketë ndodhur.

– S'po ju kuptoj... – Ajo e vështroi Ravikun e shastisur dhe e acaruar. – Askush nuk e mendonte që mund të ndodhte ashtu. Ishte diçka krejt e pabesueshme!

Keti Hegshtrëmi vuri buzën në gaz:

– Doktor Raviku ka teorinë e vet, Dejzi. Ai e quan "sistemi i rastësisë". Sipas kësaj teorie, e pabesueshmja është pothuajse gjithmonë më logjikja.

– Interesant. – Dejzi buzëqeshi me mirësjellje dhe krejtësisht e painteresuar. – Kësaj pune s'do t'i kishte dalë era fare, – vazhdoi ajo, – sikur Luisi të mos kishte bërë goxha skandal. Nuk e kishte më veten në dorë. Tani banon në hotel *Krijo*. Kërkon shkurorëzim. Por

tërë bota pret të marrë vesh arsyet që do të nxjerrë në padi. – Ajo u mbështet në karrige dhe i gjithë qëndrimi i saj rrëfente pritje. – Po ti ç'i thua kësaj?

Keti Hegshtrëmi i hodhi një shikim rrëshqitas Ravikut. Ai po merrej me soditjen e një dege orkidesh që ndodhej mbi tryezë, në mes kutish me kapela dhe një shporte frutash me rrush e pjeshkë – orkide të bardha, me petale si flatra fluturash plot pikla të kuqe.

– E pabesueshme, Dejzi, – tha ajo. – Vërtet e pabesueshme!

Dejzi e shijoi suksesin e vet.

– Këtë s'besoj se mund ta kishit ditur që më parë, ë? – e pyeti Ravikun.

Ai e vendosi përsëri me kujdes degën e orkideve në vazon e ngushtë prej kristali.

– Jo, këtë jo.

Dejzi tundi kokën e kënaqur dhe filloi të mblidhte sendet e veta – çantën, kutinë e pudrës dhe dorashkat.

– Më duhet t'ia mbath tani. Luiza jep në orën pesë një koktej. Do të vijë ministri i saj. Seç po pështpëritet poshtë e përpjetë. – Ajo u ngrit nga vendi. – Ah, mend harrova të të thosha se Feri me Martën janë prishur prapë. Ajo ia ktheu të gjitha stolitë. Kjo është e treta herë. Dhe atij gomarit akoma i bën përshtypje! Sa budalla që është! Pandeh se ajo e dashuron pa asnjë interes, vetëm për hir të tij. Shih po s'ia ktheu prapë të gjitha dhe, për shpërblim, edhe ca më tepër. Si gjithmonë. Ai nuk e di, por ajo që tani ia ka vënë syrin peshqeshit që do t'ia kishte qejfi. E ka parë tek argjendari Ostertag... Aty ia blen Feri zakonisht stolitë... Është një karficë rubini; katërkëndëshe, me gurë të mëdhenj, të kuq si gjak pëllumbi... Marta është femër e zgjuar. S'ke ç'i thua.

Ajo e puthi Keti Hegshtrëmin në të dyja faqet.

– Mirupafshim, shqerrka ime! Tani, të paktën, e more vesh se ç'ndodh në botë... A ke ndër mend të dalësh së shpejti këtej? – Ajo vështroi Ravikun.

Ai kapi një shikim të Keti Hegshtrëmit.

– Tani për tani jo, – i tha Dejzit. – Më vjen shumë keq.

Pastaj ia mbajti pallton. Ishte një peliçe e zezë, pa jakë. Një peliçe për Xhoanën, mendoi.

– Të na urdhëroni ndonjëherë me Ketin për çaj, – i tha Dejzi. – Të mërkurave s'ka shumë njerëz tek unë. Mund të bënim ca muhabet shtruar. Interesohem shumë për operacionet.

– Me kënaqësi.

Raviku mbylli derën pas saj dhe u kthye.

– Smeralde të bukura, – tha ai.

Keti Hegshtrëmi qeshi.

– Kështu ka qenë më parë edhe jeta ime, Ravik. A mund ta kuptoni këtë?

– Po. Pse jo? Është mrekulli kur je në gjendje ta kalosh jetën kështu. Të mbron nga shumë gjëra.

– Tani s'jam më e zonja ta kuptoj. – Ajo u ngrit nga kolltuku dhe u drejtua me kujdes nga shtrati.

– Raviku e ndoqi me sy.

– Nuk ka fort rëndësi se ku jeton njeriu, Keti. Mund të ndodhë që bën një jetë më të rehatshme, por kjo nuk ka kurrë rëndësi. Rëndësi ka vetëm se çfarë bën njeriu me jetën e vet.

Ajo i shtriu këmbët e gjata e të bukura mbi shtrat.

– Asgjë s'ka më rëndësi, kur ke ndenjur ca javë në shtrat e tani mund të ecësh përsëri, – tha Keti Hegshtrëmi.

– Në mos paçi dëshirë, s'është nevoja të qëndroni më këtu. Mund të banoni në hotelin tuaj, në *Lankastër;* por vetëm me kusht që të merrni edhe një infermiere pas.

Keti Hegshtrëmi tundi kokën.

– Do të qëndroj këtu, gjersa të jem në gjendje për udhëtim. Këtu jam e mbrojtur nga Dejzi me shoqe.

– Nxirrini jashtë, po t'ju vijnë. S'ka gjë më të lodhshme se thashethemet.

Ajo u shtri me kujdes në shtrat.

– A mund ta besoni që kjo Dejzi, me gjithë llafet e saj të shumta, është një nënë shembullore? Të dy fëmijët e vet i edukon për mrekulli.

– Rastis nganjëherë, – ia bëri Raviku ftohtë.

Ajo tërhoqi mbulesën mbi vete.

– Në klinikë është si në manastir, – tha ajo. – Njeriu mëson t'i vlerësojë përsëri gjërat më të thjeshta: të ecurit, të marrurit frymë, të parët...

– Po. Lumturia është shpërndarë rretheqark nesh. Mjafton të kërrusemi pak e ta ngremë.

Ajo i hodhi një shikim.

– E kam me gjithë mend, Ravik.

– Edhe unë, Keti. Vetëm gjërat e thjeshta nuk të zhgënjejnë kurrë.

Zhanoi rrinte në shtrat, me një tok broshurash shpërndarë mbi mbulesë.

– Pse nuk e ndez dritën? – e pyeti Raviku.

– Shoh edhe kështu. I kam sytë të fortë.

Broshurat ishin përshkrime protezash dhe këmbësh artificiale. Zhanoi i kishte grumbulluar andej nga s'ta priste mendja. E ëma ia solli edhe ato të fundit fare. Ai i rrëfeu Ravikut një broshurë të bukur me ngjyra. Raviku ndezi dritën.

– Kjo është më e shtrenjta, – tha Zhanoi.

– Por jo më e mira, – ia priti Raviku.

– Sidoqoftë, është më e shtrenjta. Sigurimeve do t'ua them troç që e dua këtë model. Natyrisht që unë s'e dua fare! Sigurimet vetëm sa të ma paguajnë. Unë dua një cung të thjeshtë druri dhe paratë!

– Sigurimet kanë mjekë të besuar që kontrollojnë gjithçka, Zhano.

Djali u ngrit ndenjur.

– Ju mendoni se nuk do të më aprovojnë një këmbë artificiale?

– Posi jo! Vetëm se jo atë më të shtrenjtën. Dhe paratë nuk do të t'i japin ty në dorë; ata do të kujdesen që këmbën ta marrësh vërtet.

– Atëherë do ta marr e do ta shes menjëherë. E di që do të jetë punë me humbje. Si thoni ju... a janë mjaft, sikur ta shes me njëzet përqind zbritje? Në fillim do të ofroj vetëm dhjetë përqind. Ndoshta e rregullojmë me tregtarin që më parë... E ç'u duhet sigurimeve e marr a s'e marr këmbën? Ata duhet të tundin paratë; të tjerat nuk u interesojnë fare, apo jo?

– Natyrisht. Mund ta bësh një provë.

– Do të ishte punë me leverdi. Me ato para mund të blinim banakun dhe pajisjet për një bulmetore të vogël. – Zhanoi i shkeli syrin Ravikut. – Një këmbë e tillë me kyçe e ku di unë se me çë tjetër, është, lavdi zotit, mjaft e shtrenjtë. Helbete, punë precizioni!

– A erdhi njeri nga ata të sigurimeve?

– Jo. Për këmbën artificiale dhe marrëveshjen akoma jo. Vetëm për operacionin e për klinikën. A do të dalë nevoja të marrim ndonjë avokat? Si thoni ju?... Drita e semaforit ishte e kuqe! Me siguri! Policia...

Infermierja solli darkën dhe e la pranë Zhanoit, në komodinë. Djali nuk foli, gjersa u largua ajo.

– Këtu të japin shumë për të ngrënë, – ia bëri pastaj. – Kaq mirë s'e kam kaluar ndonjëherë. Vetëm nuk i ha dot të gjitha këto gjëra. Nëna vjen gjithmonë dhe ha ç'mbetet. Na del e na tepron të dyve. Kështu edhe ajo bën ca kursime. Le pastaj edhe kjo dhomë kushedi sa kushton...

– Atë e paguajnë sigurimet. Pavarësisht se në ç'dhomë je shtruar.

Mbi fytyrën e murrëtyer të djalit rrëshqiti një rreze drite.

– Fola me doktor Veberin. Ai do të më japë dhjetë përqind. Kurse faturën, për aq sa bën, do t'ua çojë sigurimeve. Ata do të paguajnë. Por mua, ama, doktor Veberi do të më kthejë dhjetë përqind në dorë.

– Ti je djalë i shkathët, Zhano.

– Kur je i varfër, duhet të jesh i shkathët se s'bën!

– Këtu ke hak. Po dhimbje a ndien?

– Po, te këmba që nuk e kam më.

– Ato janë nervat, që i ke akoma.

– E di. Megjithatë të vjen çudi kur ndien dhimbje në diçka që s'është më. Ndoshta ka mbetur akoma shpirti i këmbës sime atje. – Zhanoi u zgërdhi. I kishte pëlqyer shakaja e vet. Pastaj i ngriti kapakët e enëve me radhë. – Supë, pulë, barishte, buding. Ja diçka që do t'i pëlqejë nënës. Sidomos pulën e ka shumë qejf. Në shtëpi atë e shohim me dylbi. – Ai u shtri i kënaqur në kurriz. – Shpesh më del gjumi natën dhe mendoj se do të na duhet t'i paguajmë vetë të gjitha këto. I ndodh ndonjëherë njeriut të zgjohet natën i trembur dhe të mos dijë se ku është. Por pastaj më kujtohet se jam shtruar në këtë klinikë si djalë zotërinjsh të lartë dhe se kam të drejtë të kërkoj ç'të më teket, t'i bie ziles që të vijnë infermieret, dhe ato duhet të vijnë se s'bën, dhe njerëz të tjerë duhet t'i paguajnë të gjitha shpenzimet. Mrekulli, ë?

– Po, – tha Raviku. – Mrekulli.

*

* *

Ai ndodhej në *Osiris*, në dhomën e vizitave.

– A ka të tjera? – pyeti.

– Po, – tha Leonia, – Edhe Ivona. Ajo është e fundit.

– Dërgoma këtu. Ti je shëruar, Leoni.

Ivona ishte njëzet e pesë vjeçe, plot tule, bionde, me një hundë të shtypur dhe me duar e këmbë të shkurtra e të trasha, siç i kanë

zakonisht shumë prostituta. Ajo hyri duke u tundur e duke u shkundur, me një shprehje vetëkënaqësie në fytyrë dhe ngriti përpjetë copën e mëndafshtë që kishte hedhur përsipër.

– Shtrihu atje! – i tha Raviku.

– Pse, s'bëhet dot më këmbë? – ia ktheu Ivona.

– Si e ke hallin?

Në vend që të përgjigjej, ajo u rrotullua dhe i tregoi Ravikut prapanicën e saj të gjerë. Shirita mavi e mbulonin të tërën. Dukej açik se dikush e kishte zhdëpur në dru mirë e mirë.

– Shpresoj se ai klient që të paska katandisur në këtë dritë, të ka paguar mirë, – i tha Raviku. – Kësaj nuk i thonë shaka!

Ivona mohoi me kokë.

– As edhe një grosh, doktor. Nuk ishte klient.

– Atëherë e paska bërë për qejfin tënd. Nuk e dija që të pëlqekan gjëra të tilla...

Ivona tundi përsëri kokën dhe fytyrën ia përshkoi një buzëqeshje misterioze që rrëfente njëfarë kënaqësie. Raviku e kuptoi që asaj po i pëlqente kjo gjendje dhe që po i jepte rëndësi vetes.

– Unë nuk jam masohiste, – tha ajo. Ishte krenare që e dinte atë fjalë.

– Po si ndodhi atëherë? Ndonjë zënkë?

Ivona priti një sekondë.

– Dashuri! – ia plasi pastaj dhe shtriqi supet gjithë kënaqësi, si një mace pranë vatrës.

– Xhelozi?

– Po. – Ivonës i shkëlqeu fytyra.

– Të dhemb shumë?

– Një gjë e tillë nuk dhemb. – Ajo u shtri me kujdes. – E dini, doktor, që madamë Rolanda s'deshi të më linte të punoja fare? Unë iu luta: Lërmëni të punoj vetëm një orë në ditë; ta provoj vetëm një orë! Do ta shikoni pastaj! ... Dhe tani, me këtë prapanicë të mavijosur, unë kam shumë më tepër sukses se kurrndonjëherë.

– Si kështu?

– Nuk e di. Ka ca bandillë që çmenden kur shikojnë diçka të tillë. Eksitohen tej mase. Ditët e fundit nxora dyqind e pesëdhjetë franga më tepër se zakonisht. Edhe për sa kohë do të më duken këto shenja?

– Të paktën edhe nja dy a tri javë.

Ivona kërciti gjuhën.

– Në vazhdoftë puna kështu, do të mund të blej një peliçe..., gëzof dhelpre.

– Po s'të dolën, ai miku yt mund të të ndihmojë shumë kollaj: le të të japë edhe një dru tjetër të shëndoshë.

– Këtë ai s'e bën, – u hodh Ivona. – S'është i tillë. S'është maskara që shkon me hesape. Ai e bën vetëm për pasion. Kur i vjen dallga. Edhe po t'i bija më gjunjë e t'i përgjërohesha, ai s'do ta bënte.

– Qenka me karakter. – Raviku ngriti kokën. – Edhe ti je në rregull, Ivonë!

Ajo u ngrit.

– Atëherë mund t'ia nis nga puna. Poshtë po më pret një plakush. Ka një mjekër majuce, të thinjur. Ia rrëfeva vijat e mavijosura. U tërbua fare. Në shtëpi s'i shkon fjala hiç dhe s'ia var njeri. Dhe më duket se ëndrra e tij më e madhe është t'i fusë një hu plakës së vet. – Ajo ia plasi një të qeshure të kristaltë. – Doktor, bota është komike, si thoni ju? – Sakaq doli nga dhoma, prapë duke u tundur e duke u shkundur, e kënaqur sa s'bëhet.

Raviku lau duart. Pastaj i vuri mënjanë sendet që kishte përdorur dhe iu afrua dritares. Mugëtira nderej e sermtë përmbi shtëpitë. Pemët e zhveshura ngjanin si duar të zeza të vdekurish që dilnin sipër asfaltit. Nëpër transhetë e mbuluara ai kishte parë disa herë duar të tilla. E hapi dritaren dhe vështroi përjashta. Ishte ora e së pavërtetës, ora që varej midis ditës dhe natës. Ora e dashurisë ndër hotelet e vogla – e përshtatshme për njerëzit që ishin të martuar dhe që në darkë rrinin gjithë dinjitet në krye të tryezës familjare. Ora, kur italiankat e Luginës Lombarde fillonin të thoshin *feliçisima note.*[1] Ora e dëshpërimit dhe ora e ëndrrave.

Ai mbylli dritaren. Dhoma iu duk përnjëherësh shumë më e errët. Hije ishin futur brenda fluturimthi dhe tani strukeshin nëpër qoshe e përrallisnin pa zë. Shishja e konjakut që ia pat sjellë Rolanda, shndriste mbi tryezë si një gur i latuar topazi. Raviku ngurroi për një çast – pastaj zbriti poshtë, në katin e parë.

Aparati muzikor mjaullinte dhe salla e madhe notonte në dritë. Vajzat e veshura me këmishët e tyre ngjyrërozë rrinin mbi dy radhë kolltukësh pa mbështetëse. Të gjitha i kishin gjinjtë jashtë. Klientët donin të shihnin, çfarë blinin. Kishin ardhur nja një gjysmë duzine syresh. Shumica ishin mikroborgjezë, rreth të dyzetave. Ishin nga ata specialistët e kujdesshëm, që e dinin se në ç'kohë bëhej kontrolli mjekësor; prandaj edhe vinin pikërisht atëherë, që të mos merrnin në asnjë mënyrë ndonjë sëmundje veneriane. Ivona i ishte qepur plakushit të saj. Ai rrinte te një tryezë dhe përpara vetes kishte një gotë

1. *Felicissima notte*: natë e lumtur.

Dybone. Kurse ajo qëndronte pranë tij, me njërën këmbë mbi kolltuk dhe pinte shampanjë. Për çdo shishe shampanje vajzat merrnin dhjetë përqind të çmimit. Plaku duhej të ishte shumë i krisur që e qeraste me shampanjë. Këtë marifet e bënin vetëm të huajt. Dhe Ivona po e shijonte rastin. Qëndrimi i saj të kujtonte një zbutëse tigrash në një arenë cirku.

– Mbarove, Ravik? – e pyeti Rolanda që po qëndronte te dera.

– Po. Gjithçka në rregull.

– Dëshiron të pish diçka?

– Jo, Rolandë. Dua të kthehem në hotel. Kam punuar deri tani. Një banjë e nxehtë dhe ndërresa të pastra, këto më duhen tani.

Ai doli përjashta përmes garderobës, pranë barit. Mbrëmja, me sy ngjyrëvjollce, përgjonte te dera. Në qiellin blu zukaste i vetmuar dhe i shpejtë një aeroplan. Një zog i zi dhe i vockël cicëronte mbi degën e lartë të një peme të zhveshur.

Një grua, të cilën kanceri po e brente si një bishë e murrme, e frikshme dhe e verbër... Një sakat që bënte hesap pensionin e vet... Një prostitutë me një prapanicë që e shfrytëzonte si minierë floriri... Trumcaku i parë mbi degën e një peme... Të gjitha këto rrëshqisnin e i rrëshqisnin përpara syve, kurse ai, ngadalë e i paturbulluar, po shkonte te një grua, mes për mes mugëtirës që binte erë shtrati të ngrohtë...

*

* *

– Do edhe një *Kalvados*?

Xhoana pohoi me krye.

– Po, ma porosit.

Raviku i bëri shenjë kamerierit.

– Mos ju ndodhet ndonjë *Kalvados* më i vjetër se ky?

– Nuk ju pëlqeu?

– Na pëlqeu. Por ndoshta ju ndodhet ndonjë lloj tjetër në qilar.

– Po shkoj të pyes.

Ai u nis drejt arkës, ku hotelierja ia kishte këputur gjumit me gjithë macen e vet. Që andej u zhduk pas një dere me xhama qumështi, prapa së cilës padroni kontrollonte qitapët e llogarisë. S'kaloi shumë kohë dhe u shfaq përsëri, këtë radhë me fytyrë shumë serioze dhe, pa e vështruar fare Ravikun, zbriti shkallët që të çonin në qilar.

– Më duket se e rregulluam.

Kamerieri u kthye me një shishe që e mbante ndër krahë sikur të ishte foshnjë në shpërgenj. Ishte një shishe e ndotur; jo nga ato gjithë etiketa, lajle e lule, që u ofroheshin turistëve për t'ua marrë mendtë, por një shishe shumë e ndotur, e cila kishte qëndruar mjaft vite në qilar. Ai e hapi me kujdes të madh, i mori erë tapës dhe pastaj shkoi e solli edhe dy gota të mëdha.

– Urdhëroni, zotëri, – i tha Ravikut dhe i hodhi disa pika në gotë.

Raviku e mori dhe nuhati aromën. Pastaj piu, u mbështet në karrige dhe tundi kokën në shenjë pohimi. Kamerieri tundi gjithashtu kokën me shumë solemnitet dhe i mbushi të dyja gotat përgjysmë.

– Pa provoje njëherë, – i tha Raviku Xhoanës.

Ajo piu një gllënjkë dhe e la gotën përsëri në vend. Kamerieri s'ia ndante sytë. Xhoana e pa Ravikun me habi.

– Të tillë s'kam pirë ndonjëherë, – i tha dhe e ngriti përsëri gotën. – Ke përshtypjen sikur nuk e pi, por e thith si ajrin.

– Pikërisht kështu është, zonjë, – tha kamerieri i kënaqur. – I ratë më të.

– Ravik, – tha Xhoana, – je duke bërë diçka të rrezikshme. Pas këtij *Kalvadosi*, unë s'kam për të vënë kurrë më një tjetër në gojë.

– Oh jo, ke për të pirë edhe tjetër.

– Por do të ëndërroj gjithmonë këtë!

– Bukur fort. Kështu do të bëhesh romantike. Një romantike *Kalvadosi*.

– Por ai tjetri s'do të më shijojë më!

– Përkundrazi, ai do të të shijojë bile më shumë nga ç'duhej të të shijonte në të vërtetë. Do të jetë një *Kalvados* me mall për një *Kalvados* tjetër. Vetëm ky fakt do ta bëjë më pak të rëndomtë nga ç'është.

Xhoana qeshi.

– Kjo është marrëzi. Dhe ti e di vetë që është marrëzi.

– S'do mend që e di. Por ne me marrëzi jetojmë dhe jo me bukën e thatë të fakteve. Ndryshe ç'do të bëhej me dashurinë?

– Ç'ka të bëjë kjo me dashurinë?

– Ka të bëjë shumë. Siguron vazhdimësinë. Ndryshe do të dashuronim vetëm një herë dhe, më vonë, do të hiqnim dorë nga të tilla gjëra. Kurse kështu ai pak mall për atë që braktisim, ose që na braktis, nis e bëhet brerore përreth kokës së njeriut që vjen paskëtaj. Dhe vetë fakti që kemi humbur më parë diçka, i jep këtij njeriu të ri një farë magjie romantike. Ky është një lloj marifeti shumë i lashtë, pothuajse i shenjtë.

Erjonixx

Xhoana e vështroi në sy.

– Më duket gjë e poshtër kur flet kështu!

– Edhe mua.

– S'duhet të flasësh kështu. As me shaka. Kjo e kthen mrekullinë e vërtetë në një truk cirku.

Raviku nuk u përgjigj.

– Dhe tingëllon sikur je mërzitur, – vazhdoi Xhoana, – dhe po mendon si të më braktisësh.

Raviku e vështroi me një ëmbëlsi të vagëlluar.

– Për këtë s'ke nevojë ta vrasësh mendjen kurrë, Xhoanë. Kur të vijë puna gjer atje, do të më braktisësh ti mua. Jo unë ty. Kjo është e sigurt.

Ajo e lëshoi gotën mbi tryezë, duke e përplasur fort.

– Ç'janë këto gjepura! Unë s'do të të braktis kurrë. Ku e ke hallin që po më fut nëpër këto katakombe fjalësh?

Ah, këta sy! mendoi Raviku. Thua se po përshkëndriten nga shkreptimat. Nga shkreptima të buta, të kuqërremta, xixa qirinjsh të panumërt.

– Xhoanë, – tha ai. – Unë s'po dua të të fus nëpër katakombe fjalësh, por dua të të rrëfej njëherë atë historinë e valës dhe të shkëmbit. Është një histori e vjetër. Më e vjetër se ne. Dëgjoje: Na ishte seç na ishte, na ishte njëherë një valë; ajo dashuronte një shkëmb diku në det, le të themi diku në gjirin e Kaprit. Vala fërkohej pas tij gjithë shkumbë e uturimë, e përqafonte dhe e puthte çmendurisht ditë e natë, e pushtonte me llërët e saj bardhoshe. Psherëtinte e qante e i përgjërohej shkëmbit që të vinte tek ajo; e dashuronte me afsh të papërshkruar e i sillej përqark dhe, ndërkohë, e gërryente dalëngadalë nga poshtë. Dhe një ditë prej ditësh ai u dorëzua, humbi mbështetjen dhe u lëshua ndër krahët e saj...

Ai piu një gllënjkë *Kalvados*.

– E pastaj, çë? – pyeti Xhoana.

– E pastaj, përnjëherësh, ai s'ishte më një shkëmb për t'u qafuar, për t'u dashuruar e për t'iu përgjëruar. Mbeti vetëm një copë gur në fund të detit, i kredhur në thellësi të valës. Dhe vala e ndjeu veten të zhgënjyer e të mashtruar dhe shkoi e kërkoi një shkëmb tjetër.

– E pastaj? – Xhoana e vështroi me dyshim. – Ç'kuptim na paska kjo? Shkëmbi le të mbetej më mirë shkëmb!

– Edhe valët gjithmonë kështu thonë. Por ajo që lëviz është më e fortë se ajo që rri e ngrirë. Uji është më i fortë se shkëmbi.

Ajo bëri një lëvizje padurimi.

Erjonixx

– Ç'lidhje ka e gjithë kjo me ne? Kjo është vetëm një përrallë që s'thotë asgjë. Ose ty ta ka ënda të më vësh përsëri në lojë, siç e ke zakon. Po të vijë ndonjëherë puna gjer atje, do të më braktisësh ti. Kaq di unë e kaq them, dhe jam e sigurt!

– Kjo, – i tha Raviku duke qeshur, – do të jetë fjala jote e fundit kur të më lësh. Do të vish e do të më thuash se të kam lënë unë. Dhe do të gjesh ca arsye, të cilat edhe do t'i besosh. Dhe e drejta do të jetë në anën tënde përpara gjykatës më të lashtë të botës: Natyrës.

Ai i bëri shenjë kamerierit.

– Mund ta blejmë këtë shishe?

– Dëshironi ta merrni me vete?

– I ratë më të.

– Kjo është në kundërshtim me parimet tona, zotëri. Ne nuk shesim me shishe.

– Pyeteni padronin.

Kamerieri u kthye me një gazetë. Ishte një *Pari Suar.*

– Padroni ynë po bën një përjashtim, – tha ai, e ngjeshi tapën mirë dhe e mbështolli shishen me gazetë, pasi e shqiti më parë me kujdes rubrikën sportive, e palosi dhe e futi në xhep. – Urdhëroni, zotëri. Është mirë që ta vini në një vend të errët e të freskët. Kjo shishe ka mbetur që nga koha e gjyshit të padronit tonë.

– Bukur fort! – Raviku pagoi. E ngriti përpjetë shishen e mbështjellë dhe i mbajti një fjalim: – O shkëlqim dielli që ke qëndruar një verë të tërë të nxehtë dhe një vjeshtë të kaltër mbi mollët e një kopshti të vjetër frutash plot shushurima erërash diku në Normandi, eja tani me ne! Ta kemi nevojën. Diku në univers po ngrihet stuhia.

Ata dolën në rrugë. Kishte filluar të binte shi. Xhoana u ndal.

– Ravik! A më dashuron?

– Po, Xhoanë. Më shumë nga ç'kujton.

Ajo u mbështet pas tij.

– Por, nganjëherë, nuk duket aspak ashtu.

– Përkundrazi. Ndryshe s'do të të rrëfeja kurrë gjëra të tilla.

– Do të ishte më mirë sikur të më rrëfeje të tjera gjëra.

Ai e vështroi, ashtu nëpër shi, dhe vuri buzën në gaz.

– Xhoanë, dashuria nuk është një krua ku njeriu mund të pasqyrohet gjithmonë. Ajo ka zbaticë dhe baticë. Dhe ka mbeturina anijesh dhe qytete të fundosura dhe oktapodë dhe shtrëngata dhe arka me florinj e me perla. Por perlat ndodhen shumë thellë.

– Nuk di nga këto unë! Dashuri do të thotë t'i përkasësh njëritjetrit. Përgjithmonë!

Erjonixx Scanned with CamScanner

Përgjithmonë! mendoi ai. Përrallë e vjetër fëmijësh. Kur njeriu s'është i zoti të mbajë as minutën!...

Xhoana kopsiti pallton.

– Do të desha të ishte verë, – tha ajo. – Nuk e kam dëshiruar kurrë verën sa këtë vit.

*

* *

Ajo nxori fustanin e mbrëmjes nga rafti dhe e hodhi mbi shtrat.

– Sa e urrej nganjëherë këtë! Këtë fustan të zi që s'më hiqet qafe. Këtë *Sheherezaden* e përhershme! Gjithmonë e njëjta gjë, gjithmonë e njëjta gjë!

Raviku ngriti kokën, por nuk foli.

– Ti nuk e kupton këtë? – e pyeti ajo.

– Posi jo...

– Pse nuk më heq që andej, i dashur?

– Ku të të çoj?

– Diku! Kudo qoftë.

Raviku çmbështolli shishen e *Kalvadosit* dhe ia hoqi tapën. Pastaj mori një gotë dhe e mbushi gjer në buzë.

– Eja, – tha ai. – Pije.

Ajo tundi kokën.

– Nuk bën dobi. Nganjëherë nuk bën dobi as pija. Nganjëherë nuk bën dobi asgjë. Sonte nuk dua të shkoj atje, tek ata idiotët!

– Rri këtu.

– E pastaj?

– Telefonoju që je sëmurë.

– Por prapë do të më duhet të shkoj nesër. Dhe kjo është akoma më keq.

– Mund të bëhesh e sëmurë për ca ditë me radhë.

– Po ajo gjë është. – Ajo e vështroi. – Ç'është kjo gjendje, vallë? Ç'po ndodh kështu me mua, i dashur? Mos e ka fajin shiu, kjo errësirë e lagësht? Shpesh më bëhet sikur jam shtrirë në një qivur. Sikur po më mbysin pasdreket e murrme... Qëparë e harrova, isha e lumtur me ty në atë restorantin e vogël... Po ç'të hipi të më dërdëllitësh për punë braktisjesh? Nuk dua të dëgjoj të tilla gjëra! Kjo më trishton, më nxjerr ca pamje që s'dua t'i shikoj. Më shqetëson. E di që ti s'e ke me gjithë mend, por mua më godet. Më godet, dhe pastaj vjen shiu dhe errësira. Ti nuk i njeh këto. Ti je i fortë.

– I fortë? – përsëriti Raviku.

– Po.

– Ku e di ti që jam i fortë?

– Sepse ti s'ke frikë.

– Unë nuk ndiej më frikë. Por kjo nuk është e njëjta gjë, Xhoanë.

Ajo nuk e dëgjonte se çfarë po i thoshte. Ecte poshtë e përpjetë me ata hapat e saj të gjatë, për të cilët dhoma ishte tepër e vogël. Ajo ecën gjithmonë, thua se shkon kundër erës, mendoi Raviku.

– Dua të iki nga këto të gjitha, – tha Xhoana. – Larg këtij hoteli, larg atij lokali nate plot me shikime të lyrshme që të ngjiten mbi trup. Larg! – Ajo qëndroi. – Ravik, a është nevoja të jetojmë kështu siç po jetojmë? A s'mund të rrojmë si gjithë njerëzit e tjerë që dashurohen? Të rrimë përherë bashkë e të kemi sende që na përkasin, të kemi netët tona dhe sigurinë tonë, në vend të këtyre valixheve dhe ditëve të zbrazëta dhe të këtyre dhomave hoteli, ku njeriu e ndien veten të huaj...

Në fytyrën e Ravikut nuk lexohej asgjë. Ja tek e nxori, mendoi ai. E kisha pritur qëkur.

– Vërtet shikon një jetë të tillë për ne, Xhoanë?

– Pse jo? Edhe të tjerë e kanë! Ngrohtësi, jetë të përbashkët, disa dhoma... Dhe kur mbyllet dera, ikën edhe shqetësimi e nuk zvarritet e depërton përmes mureve si këtu.

– Vërtet shikon një jetë të tillë? – përsëriti Raviku.

– Po.

– Një shtëpi të vockël e të bukur, me një jetë borgjeze të vockël e të bukur; një siguri të vockël e të bukur buzë kraterit të vullkanit! Vërtet e shikon kështu?

– Mund të gjenden edhe fjalë të tjera për këtë, – tha ajo me trishtim. – S'është nevoja të flitet kështu... me përçmim. Kur njeriu dashuron dikë, gjen edhe fjalë të përshtatshme.

– Por mbetet e njëjta gjë, Xhoanë. Vërtet e shikon kështu? Që të dy nuk jemi krijuar për një jetë të tillë.

Ajo i ndërpreu sërishmi bredhjet nëpër dhomë.

– Unë po.

Raviku buzëqeshi. Në atë buzëqeshje kishte ëmbëlsi, dhembshuri, ironi dhe një hije pikëllimi.

– Xhoanë, – tha ai. – As ti jo. Ti aq më pak nga unë. Por nuk është kjo e vetmja arsye. Ka edhe një arsye tjetër.

– Po, – iu përgjigj ajo me ton të hidhur. – E di.

– Jo, Xhoanë. Ti nuk di asgjë. Por unë do të ta them. Është më

mirë kështu. S'duhet të mendosh atë që po mendon tani. – Ajo qëndronte akoma përpara tij. – Do të ta them shpejt, – vazhdoi ai. – Dhe paskëtaj mos më pyet shumë.

Ajo nuk i tha asnjë fjalë. Fytyra iu bë e bardhë dhe pa asnjë shprehje. Ishte po ajo fytyrë që kishte pasur dikur.

Ai ia mori duart në të tijat.

– Unë jetoj ilegalisht në Francë, – i tha. – Nuk kam asnjë dokument. Kjo është arsyeja e vërtetë. Dhe prandaj nuk kam asnjë mundësi të zë shtëpi. Dhe nuk kam asnjë mundësi të martohem, po të dua njeri. Për këtë me nevojiten dokumente dhe një vizë qëndrimi. Ato nuk i kam. Bile mua nuk më lejohet as të punoj. Këtë e bëj kontrabandë. Pra, si përfundim, nuk do të mund të jetoj kurrë ndryshe nga ç'jetoj tani.

Ajo e vështronte si e shastisur.

– A është e vërtetë kjo?

Ai ngriti supet.

– Ka disa mijëra njerëz që jetojnë pak a shumë si unë. Besoj se edhe ti e di këtë. Sot këtë e dinë të gjithë. Dhe unë jam njëri nga ata mijëra njerëz. – Ai vuri buzën në gaz dhe ia lëshoi duart. – Një njeri pa të ardhme, siç e quan Marozovi.

– Po... por...

– Bile unë mund të them se e çoj shumë mirë. Punoj, jetoj, të kam ty... E pse ta çaj kokën për ca vështirësi të vogla?

– Po policia?

– Policia nuk merakoset shumë për këso çështjesh. Në më zënçin rastësisht, do të më dëbojnë jashtë kufirit, dhe kjo është e tëra. Por kjo ka shumë pak të ngjarë... Dhe tani shko e i telefono klubit tënd të natës që s'do të paraqitesh sonte në punë. Sonte e duam mbrëmjen për vete. Të gjithë mbrëmjen. Thuaj që je e sëmurë. Po të duan ndonjë raport, të sjell unë një me firmën e Veberit.

Ajo nuk lëvizi.

– Mund të të dëbojnë jashtë kufirit? Jashtë Francës? Dhe pastaj s'do të jesh më këtu...?

– Vetëm për pak kohë.

Ajo dukej sikur s'po e dëgjonte.

– S'do të jesh më këtu... – përsëriti. – Do të jesh larg? Po unë ç'të bëj pastaj?

Raviku i buzëqeshi me ëmbëlsi.

– Po, – i tha. – Ç'do të bësh ti pastaj?

Ajo rrinte atje, si e mpirë.

– Xhoanë, – tha Raviku. – Kam dy vjet këtu dhe gjer tani s'më ka ndodhur gjë.

Fytyra e saj nuk ndërroi shprehje.

– Po sikur të të ndodhë?

– Atëherë do të kthehem shpejt. Për një ose dy javë. Është si punë udhëtimi, asgjë tjetër. Dhe tani merre në telefon *Sheherezaden*.

Ajo ngurronte.

– Çfarë t'u them?

– Thuaju që ke bronkit. Bëje zërin një çikë të ngjirur.

Ajo u nis drejt telefonit, por u kthye në mes të rrugës.

– Ravik...

Ai u shkëput me kujdes nga krahët e saj.

– Shko tani, – i tha. – Le ta harrojmë këtë. Bile gjëra të tilla janë një bekim i vërtetë. S'na lënë të bëhemi pensionistë të pasionit. E mbajnë të pastër dashurinë... dhe ajo mbetet flakë... dhe s'bëhet sobë për të zier lakrat e familjes... Shko e telefono tani.

Ajo ngriti dorezën. Ai e kundronte tek fliste. Në fillim Xhoana s'e kishte mendjen fare te telefoni, por rrinte dhe e shikonte, sikur do ta arrestonin nga çasti në çast. Por pastaj zuri të gënjente me lehtësi të madhe dhe krejt natyrshëm. Bile gënjeu më shumë nga ç'ishte nevoja. Fytyra iu gjallërua dhe i pasqyronte gjithë dhimbjet e gjoksit që po i përshkruante atje në telefon. Zëri iu këput, erdhi e u bë më i ngjirur dhe, në fund fare, ajo zuri edhe të kollitej. Ravikun nuk e vështronte më; ishte zhytur krejt në rolin e vet. Ai e sodiste në heshtje, duke pirë herë pas here pak *Kalvados*. Iu zhdukën shfaqjet e nervozizmit, mendoi ai. Një pasqyrë që pasqyron në mënyrë të mrekullueshme, por që nuk mban asgjë.

Xhoana e la dorezën në vend dhe shkoi dorën ndër flokët që i patën rënë mbi ballë.

– M'i besuan të gjitha.

– Ishe e hatashme.

– Më thanë të rri në shtrat. Dhe, në qoftë se nesër s'do të bëhem më mirë, të mos lëviz në asnjë mënyrë nga shtrati. Në asnjë mënyrë!

– E sheh! Kështu e rregulluam edhe punën e së nesërmes.

– Po, – ia bëri ajo, pak e ngrysur, – po ta marrësh ashtu... – Pastaj iu afrua. – Më trembe, Ravik. Thuaj që s'është e vërtetë. Ti shpesh i hedh fjalët ashtu si pa të keq. Thuaj që s'është e vërtetë. Që s'është ashtu siç e the!

– S'është e vërtetë.

Ajo mbështeti kokën në supin e tij.

– S'ka si të jetë e vërtetë. S'dua të mbetem përsëri vetëm. Ti duhet të më qëndrosh pranë. Kur jam vetëm, s'jam asgjë. Pa ty unë s'jam asgjë, Ravik.

Raviku e vështronte nga lart.

– Xhoanë, – i tha. – Nganjëherë dukesh si vajza e një portieri e nganjëherë si Diana e pyjeve. Kurse nganjëherë si të dyja bashkë.

Ajo nuk lëvizi nga supi i tij.

– Po tani si të dukem?

Ai buzëqeshi.

– Si Diana me harkun e argjendtë. E paplagosshme dhe vdekjeprurëse.

– Të ma thuash shpesh këtë.

Raviku heshti. Ajo s'e pati kuptuar çfarë kishte dashur t'i thoshte. Dhe as që ishte nevoja ta kuptonte. Ajo merrte atë që i pëlqente dhe si i pëlqente, dhe s'bëhej merak për asgjë tjetër. Po a s'ishte pikërisht kjo, që e tërhiqte drejt saj? E kush donte dikë që ishte si ai vetë? E kush pyeste për moral në dashuri? Kjo ishte një shpikje e të dobtëve. Kuja e viktimave.

– Ç'po mendon ashtu? – e pyeti ajo.

– Asgjë.

– Asgjë?

– Po mendoj, – tha ai, – që të ikim për ca ditë, Xhoanë. Atje ku ka diell. Në Kanë ose në Antibë. Në djall të vejë kujdesi i tepruar! Në djall edhe ëndrrat për një apartament me tri dhoma dhe brohoritjet prej korbi të jetës borgjeze! Ato s'janë për ne. A s'je ti vetë Budapesti dhe aroma e shëtitoreve të tij plot me gështenja të lulëzuara, natën, kur e gjithë bota e prushtë bie të flejë me hënën? Ti ke të drejtë! Le të ikim nga kjo errësirë dhe nga kjo ftohtësi dhe nga ky shi i mërzitshëm! Të paktën për disa ditë.

Ajo ishte shkundur menjëherë dhe po e vështronte.

– Me gjithë mend e thua këtë?

– Po.

– Por... policia...

– Në djall të vejë edhe policia! Atje nuk është më me rrezik sesa këtu. Vendet turistike nuk kontrollohen edhe aq fort. Sidomos hotelet e mira. S'ke qenë ndonjëherë atje?

– Jo. Kurrë. Kam qenë vetëm në Itali dhe buzë Adriatikut. Kur do të nisemi?

– Pas dy ose tri javësh. Ajo është koha më e përshtatshme.

– Po para, a kemi?

– Kemi ca. Pas dy javësh do të kemi edhe të tjera, që do të na mjaftojnë.

– Po ne mund të banojmë edhe në ndonjë pension të vogël!

– Ti s'e ke vendin në pensione të vogla. E ke ose në ndonjë kotec si ky këtu, ose në ndonjë hotel të klasës së parë. Do të banojmë në hotelin *Kap*, në Antibë. Të tilla hotele janë krejtësisht të sigurta, askush s'të kërkon dokumente atje. Gjatë këtyre ditëve kam në plan t'ia hap barkun një peshkaqeni të madh... seç është një zyrtar i lartë, që s'ia di emrin... Ai ka për të qenë burimi i të hollave që na nevojiten për pushimet tona.

Xhoana brofi në këmbë. Fytyra i ndriste.

– Më jep edhe ca nga ai *Kalvadosi*, – tha ajo. – Qenka vërtet *Kalvadosi* i ëndrrave. – Ajo iu afrua shtratit dhe mori në dorë fustanin e mbrëmjes. – O perëndi... dhe unë kam vetëm këto dy lecka të zeza e të vjetruara!

– Ndoshta do ta rregullojmë edhe këtë punë. Në dy javë çfarë nuk ndodh!... Ndonjë apendicit në rrethet e larta ose ndonjë thyerje e rëndë te një milioner...

14

Andre Dyrani dukej vërtet i indinjuar.

– Me ju s'mund të punohet më! – deklaroi ai.

Raviku ngriti supet. E kishte marrë vesh nga Veberi që Dyrani do të zhvatte dhjetë mijë franga për atë operacion. Po të mos binte në ujdi që më parë për shumën që kërkonte, Dyrani do ta përcillte me siguri vetëm me dyqind franga. Edhe radhën e fundit kështu ia kishte punuar.

– Dhe këtë ma thoni tani, gjysmë ore përpara operacionit! S'e prisja kurrë prej jush, doktor Ravik!

– As unë prej jush, – i tha Raviku.

– Ju e dini fort mirë se mund të mbështeteshit gjithmonë në shpirtgjerësinë time. S'e kuptoj arsyen që, pa pritur e pa kujtuar, qenkeni bërë kështu... kaq zyrtar në këto gjëra. Mua më vjen rëndë që, në këto çaste, kur pacienti e di se jeta e tij ndodhet në duart tona, të flas për çështje parash!

– Kurse mua s'më vjen aspak rëndë, – ia priti Raviku.

Dyrani ia nguli sytë. Fytyra e tij e rrudhur me atë mjekrën thinjoshe rrëfente dinjitet dhe zemëratë. Ai rregulloi me nervozizëm skeletin e artë të syzeve mbi hundë.

– Po sa mendoni ju? – pyeti më së fundi me një ngurrim të dukshëm.

– Dy mijë franga.

– Sa?! – Dyrani të jepte përshtypjen sikur ishte i pushkatuar, por nuk e besonte akoma. – Qesharake! – ia bëri pastaj shkurt.

– Në rregull, – tha Raviku. – Ju s'e keni problem të gjeni ndonjë

tjetër. Mermi Binonë; është shumë i zoti.

Ai hoqi pallton nga varësja. Dyrani s'ia shqiste sytë. Në fytyrën dinjitoze lëviznin të gjithë muskujt.

– Pa prisni, xhanëm! – bërtiti, teksa Raviku po merrte edhe kapelën. – Si mund të më lini kështu në baltë! Pse s'ma thatë që dje?

– Dje ishit në vilën tuaj në fshat dhe s'kisha ku t'ju gjeja.

– Dy mijë franga! A e dini që as unë s'ia kam kërkuar këtë shumë? Pacienti është një miku im, të cilit do t'i llogaris vetëm shpenzimet e mia efektive.

Andre Dyrani dukej si plaku i Vitit të Ri ndër ilustrimet e libra-ve për fëmijë. Tani ishte shtatëdhjetë vjeç, një diagnostikues jo i keq, por i dobët si kirurg. Namin e kishte fituar kryesisht nga puna e asi-stentit të tij të mëparshëm, Bino, i cili, përpara dy vjetësh, ia kishte arritur më së fundi qëllimit për t'u bërë i pavarur. Që nga ajo kohë Dyrani e shfrytëzonte Ravikun për operacionet e vështira. Raviku bënte prerje jashtëzakonisht të vogla dhe punonte në të tillë mënyrë që shenjat e plagëve mezi dalloheshin më vonë. Dyrani ishte njohës i mirë i verës *Bordo*, mysafir i mirëpritur nëpër festa e mbrëmje ele-gante, dhe shumica e pacientëve të tij vinin nga sferat e larta.

– Sikur ta kisha ditur që më parë... – murmuriti ai me gjysmë zëri.

Por këtë ai e kishte ditur gjithmonë. Kjo ishte edhe arsyeja që, përpara operacioneve të vështira, ia mbathte për një ose dy ditë në vilën e tij jashtë Parisit. Donte t'i bënte bisht bisedës rreth çmimit përpara operacionit. Më vonë puna paraqitej më e thjeshtë për të... Pastaj mund të të jepte shpresa për herën tjetër... Dhe herën tjetër përsëritej po ajo mesele... Mirëpo kësaj radhe, për habinë e Dyranit, Raviku s'kishte ardhur për operacion minutën e fundit, por gjysmë ore përpara, dhe e kishte kapur plakun përpara se pacienti të vihej nën narkozë. Pra, s'kishte asnjë mundësi të nxirrte si shkak punën e narkozës dhe ta mbyllte diskutimin.

Infermierja futi kokën në derë.

– Zoti profesor, a të fillojmë nga narkoza?

Dyrani e vështroi; pastaj, në mënyrë lutëse dhe njerëzisht, vështroi edhe Ravikun. Raviku ia ktheu vështrimin, njerëzisht, por i paepur.

– Si thoni ju, doktor Ravik?

– Kjo është krejtësisht në dorën tuaj, profesor.

– Një minutë, zonjushë. S'jemi akoma të qartë si do të veprojmë.

Infermierja u largua. Dyrani iu kthye Ravikut.

– Si t'ia bëjmë tani? – e pyeti gjithë qortim.

Raviku futi duart ndër xhepa.

– Shtyjeni operacionin për nesër... ose për një orë dhe thërrisni Binonë t'jua bëjë.

Për njëzet vjet rresht Binoi i kishte bërë Dyranit thuajse të gjitha operacionet dhe ndërkaq s'pati qenë i zoti të ngrihej vetë lart, sepse Dyrani ia kishte prerë sistematikisht të gjitha mundësitë për t'u bërë i pavarur. Ai e urrente Dyranin dhe, po të pranonte t'ia bënte këtë operacion, do t'i kërkonte të paktën pesë mijë franga; Raviku e dinte fort mirë këtë. Por edhe Dyrani e dinte.

– Doktor Ravik, – tha ai, – profesioni ynë s'duhet të degjenerojë në diskutime parash.

– Ashtu them edhe unë.

– Pse nuk keni besim në fjalën time që do ta rregullojmë këtë çështje? Gjer tani ju gjithmonë keni qenë i kënaqur.

– Kurrë! – tha Raviku.

– Por këtë s'ma keni thënë asnjëherë!

– Nuk jua kam thënë, sepse nuk do të kishte shumë kuptim. Përveç kësaj, edhe s'më ka interesuar fort. Kurse këtë radhë më interesón. Ato të holla më duhen.

– Zoti profesor, pacienti është i shqetësuar.

Dyrani ia vetëtiu sytë Ravikut. Raviku ia vetëtiu sytë Dyranit. Ai e dinte që ishte tepër e vështirë t'ia nxirrje paratë një francezi. Më e vështirë sesa një çifuti. Çifuti shikon të mirën e punës në tërësi, kurse francezi shikon vetëm paranë që duhet të nxjerrë nga xhepi.

– Një minutë, zonjushë, – tha Dyrani. – Matjani pulsin, tensionin dhe temperaturën.

– Ia kam matur.

– Atëherë filloni nga narkoza.

Infermierja u largua me nxit.

– E po mirë, – tha Dyrani me një theks disi të vendosur. – Do t'jua jap një mijë franga.

– Dy mijë, – e korrigjoi Raviku.

Dyrani nuk e tha fjalën e fundit. Shkoi dorën mbi mjekrën e thinjur dhe ia bëri pak si më ngrohtë:

– Dëgjoni, Ravik... si refugjat që jeni dhe që s'ju lejohet të ushtroni profesionin...

– ... nuk duhej të operoja as te ju, – ia priti Raviku qetësisht. Tani priste atë leksionin tradicional, sipas të cilit ai duhej të ishte mirënjohës që po e duronin praninë e tij në këtë shtet.

Por Dyrani s'kishte ndër mend ta zgjaste më. Ai e kuptoi më në

fund se s'kishte për të nxjerrë gjë në dritë dhe koha s'priste.

– Dy mijë! – ia bëri me ton aq të hidhur, a thua se kjo fjalë ishte një kartëmonedhë që po i fluturonte nga gurmazi. – Do të më duhet t'jua paguaj nga xhepi. Pandeha se do t'ju kujtohej çfarë kam bërë për ju!

Ai qëndroi në pritje.

Çudi, mendoi Raviku. Sa fort ua ka qejfi gjakpirësve të të shesin moral! Ky maskara plak, me shiritin e Legjionit të Nderit në xhaketë, më fajëson se po e shfrytëzoj, në vend që t'i vijë turp nga vetja. Dhe e bukura është që edhe e beson atë që thotë!

– Epo mirë, dy mijë, – psherëtiu Dyrani. – Dy mijë, – përsëriti sakaq, dhe dukej sikur po thoshte: Atdhe, perëndi, thëllëza të pjekura, shampanjë... shkuat e vatë! – A mund të fillojmë tani nga operacioni?

*

* *

Pacienti kishte një bark majuc të dhjamur dhe krahë e këmbë të holla. Raviku e pati marrë vesh rastësisht se cili qe. Quhej Lëval dhe ishte një zyrtar i lartë që merrej me çështjet e emigrantëve. Këtë ia kishte treguar Veberi duke qeshur, sepse i gjithë ky rast i dukej si punë anekdote. Lëval ishte një emër që dinte çdo refugjat në hotel *Internacional*.

Raviku bëri shpejt prerjen e parë. Lëkura u hap si një libër. Ai e zuri me klema dhe vështroi dhjamin e verdhë që dukej sikur po derdhej nga një enë e mbushur.

– Do ta lehtësojmë falas nga disa kile peshë të tepërt. Pastaj mund të zhdëpet përsëri së ngrëni e të vërë dhjamë tjetër, – i tha ai Dyranit.

Dyrani nuk i dha përgjigje. Raviku hoqi shtresat e dhjamit për të arritur gjer te muskuli. Ja tek po na rri shtrirë, kjo Perëndia e Vogël e refugjatëve, mendoi ai. Njeriu që ka qindra fate në dorë, në këtë dorë të bardhë e të squllët, që tani duket si e pajetë. Njeriu që përzuri profesorin plak Mejer; Mejerin, i cili s'kishte më forca t'i futej sërishmi rrugës së mundimshme të Golgotës dhe që, ditën përpara se ta nxirrnin jashtë kufirit, vari veten në dollapin e dhomës së vet në hotel *Internacional*. U var në dollap, sepse nuk gjeti gjëkundi tjetër ndonjë çengel. Nuk e pati zor ta bënte këtë: ishte tharë e tretur aq shumë nga uria, saqë varësja e rrobave e mbajti për bukuri. Një shuk

Erjonixx

rrobash, me një grimë jetë të mbytur brenda tyre, ishte ajo gjë që gjeti shërbyesja e hotelit të nesërmen në mëngjes në dollap. Po të kishte pasur vetëm pakëz mëshirë ky barkalec i shtrirë këtu, profesori Mejer do të jetonte edhe sot e kësaj dite.

– Klemat! – tha Raviku. – Edhe tamponin!

Ai vazhdoi të priste më tej. Precizioni i bisturisë së mprehtë. Ndjesia e një prerjeje të hollë e të saktë. Hapësira e barkut. Zorrët si krimba të bardhë spiralë... Edhe ky, që rrinte shtrirë atje me bark të hapur, kishte parimet e veta morale. Ndjente keqardhje njerëzore për Mejerin, por kishte edhe diçka tjetër, që e quante detyrën e vet kombëtare. Gjithmonë gjendej një mburojë, pas së cilës njeriu mund të fshihej: një epror që kishte mbi vete përsëri një epror tjetër; urdhra, udhëzime, vendime, detyra dhe, së fundi, atë monstrën shumëkrerëshe me emrin Moral, që quhej edhe Domosdoshmëri. E vërteta Lakuriqe, Përgjegjësi, e të tjera e të tjera... Gjithmonë do të gjendej një mburojë, për t'u bërë bisht ligjeve të thjeshta të humanizmit.

Ja tek ishte edhe kjo mëshikëza e tëmthit, e sëmurë dhe e kalbur. Pasojë e brumërave të shumta, e kukurecëve, e rosave të egra dhe e salcave plot yndyrë, të cilave u duhej shtuar edhe prishja e herëpashershme e humorit dhe një mori shishesh nga ajo vera e zgjedhur *Bordo*. Plaku Mejer nuk i kishte pasur këto halle. Po të mos e përdorje mirë bisturinë tani, po të prisje më gjerë apo më thellë nga ç'duhej – atëherë, pas një jave, a do të emëronin vallë ndonjë burrë më të mirë në atë zyrën me erë të mykur dosjesh, ku emigrantë të drithëruar prisnin vendimin e vdekjes ose të jetës? Një burrë më të mirë – por ndoshta edhe ndonjë më të lig!... Ky trup pa ndjenja, i vjetër gjashtëdhjetë vjeç, i shtrirë mbi tryezën e operacionit nën llambat e forta, e mbante veten pa dyshim për njeri human. Ai ishte me siguri një baba i kujdesshëm dhe një bashkëshort i mirë – por, në çastin kur futej në zyrën e vet, kthehej në një tiran, i cili fshihej pas frazave: Kjo gjë nuk na lejohet... Ose: Ç'do të ndodhte sikur ne... E ç'do ta gjente Francën, sikur Mejeri të kishte vazhduar të hante një herë në ditë drekën e vet modeste... sikur vejusha Rozental të lejohej të qëndronte akoma në atë dhomëz shërbyesish të *Internacionalit*, duke pritur të birin, sepse nuk e kishte marrë vesh që ia kishin masakruar në Gjermani... sikur komisionari tuberkuloz Shtalman të mos hante gjashtë muaj burg për kalim ilegal kufiri dhe të dilte nga burgu vetëm sa për të dhënë shpirt, përpara se ta dëbonin përsëri nga Franca...?!

Mirë. Kjo prerje ishte mjaft e mirë. As më thellë dhe as më gjerë

nga ç'duhej. Pejzat. Nyja. Mëshikëza e tëmthit. Ia tregoi Dyranit. Nën dritën e bardhë ajo kishte shkëlqimin e dhjamit. E flaku në kovën e mbeturinave. Vazhdojmë! Pse në Francë e bëjnë qepjen me gjilpërë? Ta heqim klemën! Barku i ngrohtë i një zyrtari jo të zakonshëm, me një rrogë vjetore prej tridhjetë gjer dyzet mijë frangash. Po si mund të paguante atëherë dhjetë mijë për operacionin? Nga i nxirrte para- të e tjera? Edhe ky barkalec do të ketë luajtur ndonjëherë me zare, kur ishte i vogël. Kjo qepje s'doli e keqe. Shumë e mirë, bile. Në fytyrën e Dyranit dallohej akoma tmerri i dy mijë frangave, megji- thëse qe mbuluar përgjysmë dhe mjekra majuce nuk i dukej. Ai tmerr i dallohej ndër sy. Në secilin sy një mijë franga!... Dashuria ta prishka karakterin. Ndryshe a thua se do ta kisha vënë në mengene këtë plakush dhe do t'ia kisha lëkundur besimin ndaj të perëndish- mit rend botëror të shfrytëzimit? Nesër ai do të qëndrojë i urtë e i mallëngjyer pranë shtratit të barkalecit duke dëgjuar prej tij falënde- rimet e rastit për operacionin e kryer. Kujdes – ja edhe një klemë tje- tër! Ky barkalec për mua dhe për Xhoanën është baras me një javë pushime në Antibë. Një javë dritë nën shiun e hirtë të kohës sonë. Një copëz qielli blu përpara se të shpërthejë stuhia. Dhe tani i erdhi radha lëkurës së barkut. Duhet t'i bëjmë një punë të hollë për të dy mijë frangat që do të marrim. E mira do të ishte sikur t'ia lija gërs- hërën brenda në bark, si kujtim për plakun Mejer! Ah, kjo dritë e bardhë verbuese! Pse njeriut i vijnë kaq shumë mendime të ngatër- ruara në kokë? Ndoshta e kanë fajin gazetat. Radioja. Blegërima e pareshtur e gënjeshtarëve dhe e burracakëve. Mungesë përqendrimi për faj të llafeve që po na mbulojnë si ortekë. Tru konfuzë. Të gats- hëm për të thithur çdo ndyrësirë demagogjike. Janë çmësuar të përtypin bukën e fortë të së vërtetës. Tru pa dhëmbë. Marrëzira... Edhe kjo punë mori fund. Tani na mbetet vetëm të lajmë duart. Pas disa javësh ky mashkull mund të fillojë përsëri nga dëbimi i refugja- tëve të drithëruar. Por ndoshta, tani që ia hoqëm mëshikëzën e tëm- thit, do të bëhet më i butë. Në qoftë se nuk na vdes. Por ç'e do që gjëja e keqe vdes zakonisht kur i kalon të tetëdhjetat, i nderuar, me respekt ndaj vetes dhe me nipër e mbesa krenarë. Kaq e pati edhe kjo punë. Mund të ma heqin sysh!

Raviku hoqi dorezat prej llastiku dhe maskën nga fytyra. Nëpunësin e lartë e nxorën mbi rrota të heshtura nga salla e opera- cionit. Raviku e ndoqi me sy. Ah, sikur ta dije ti, Lëval! mendoi ai. Sikur ta dije që tëmthi yt superlegal do të më rregullojë mua, refug- jatit ilegal, të kaloj ca ditë pushimi jashtëzakonisht ilegale në Rivierë!

Ai nisi të lahej. Pranë tij, Dyrani po lante gjithashtu duart, me ngadalë e metodik. Ishin duart e një burri plak me tension të lartë. Ndërsa fërkonte me kujdes gishtërinjtë, lëvizte me ritëm të ngadalshëm e duke u përtypur nofullën e poshtme, thua se po bluante grurë. Kur pushonte së fërkuari gishtërinjtë, pushonte edhe së përtypuri. Kur ia niste sërish, fillonte përsëri edhe nga të përtypurit. Këtë radhë ai po lahej shumë avash dhe po e zgjaste atë punë ca si tepër. Dashka t'i mbajë të dy mijë frangat edhe disa minuta më shumë, mendoi Raviku.

– Ç'po prisni akoma? – e pyeti Dyrani pas një copë here.

– Po pres çekun tuaj.

– Paratë do t'jua dërgoj kur të më paguajë pacienti. Kjo do të ndodhë disa javë pasi të ketë dalë nga klinika.

Dyrani zuri të fshinte duart. Pastaj mori një shishe kolonjë të markës *D'orse* dhe filloi të fërkohej fort.

– Shpresoj se keni kaq besim tek unë... apo jo? – pyeti ai.

Maskarai! tha Raviku me vete. Kërkon të shtrydhë nga unë edhe ca përulje.

– Po ju sikur thatë që pacienti është një miku juaj dhe do t'ju paguajë vetëm shpenzimet efektive?!

– Po, – ia priti Dyrani shkurt.

– E pra... shpenzimet efektive përbëjnë vetëm disa franga për materialin dhe për infermieret. Klinika është prona juaj. Po të përllogaritni nja njëqind franga për të gjitha, ato mund t'i zbrisni tani e të m'i shlyeni më vonë.

– Shpenzimet, doktor Ravik, – ia priti Dyrani dhe u krekos ca, – janë, mjerisht, shumë më të larta nga ç'pandeha në fillim. Ndër to përfshihen edhe të dy mijë frangat për ju. Si përfundim, jam i detyruar t'ia kërkoj edhe ato pacientit. – Ai u mori pak erë duarve. – Siç e shikoni pra...

Ai buzëqeshi. Dhëmbët e verdhë binin në kontrast shumë të fortë me mjekrën e tij të bardhë dëborë. Sikur ka urinuar njeri në dëborë, i shkoi mendja Ravikut. Sidoqoftë, për të më paguar, do të më paguajë se s'bën. Do t'i them Veberit të m'i japë tani ato të holla. Këtij çapit plak s'do t'ia bëj qejfin tani duke iu lutur edhe një herë.

– Bukur fort, – tha ai. – Meqë e paskeni kaq të vështirë, atëherë m'i dërgoni më vonë.

– Nuk e kam të vështirë... megjithëse kërkesa juaj ishte e beftë dhe e habitshme. Më tepër e kam për hir të rregullit.

– Mirë atëherë, e lëmë kështu: për hir të rregullit; po ajo gjë është.

– S'është në asnjë mënyrë po ajo gjë!

– Efekti është po ai, – tha Raviku. – Dhe tani më falni. Më është tekur të shkoj të pi një gotë. Tungjatjeta.

– Tungjatjeta, – ia bëri Dyrani i habitur.

*

* *

Keti Hegshtrëmi vuri buzën në gaz.

– Pse nuk vini me mua, Ravik? – Ajo qëndronte përpara tij, e hajthme, tepër e sigurt mbi këmbët e saj të gjata, me duart e groposura në xhepat e mantelit. – Tani atje në Fiezole duhet të kenë çelur jargavanët e verdhë, ato janë si flakëza të florinjta përgjatë murit të kopshtit. Një oxhak, libra, paqe.

Një kamion kaloi me rrapëllimë përjashta, mbi kalldrëmin e rrugës. Xhamat e kornizave në sallonin e vogël të klinikës u drodhën. Ishin fotografi me pamje të katedrales së Shartrës.

– Pastaj... ajo qetësia e natës. Larg... larg çdo gjëje, – vazhdoi Keti Hegshtrëmi. – A s'do t'ju pëlqente?

– Po. Megjithatë, ndoshta, s'do ta duroja dot.

– Po pse?

– Qetësia është e mirë vetëm atëherë kur je vetë i qetë.

– Unë s'jam e qetë.

– Ju dini çfarë kërkoni. Kjo është pothuajse e njëjta gjë.

– Po ju nuk e dini çfarë kërkoni?

– Unë s'kërkoj asgjë.

Keti Hegshtrëmi kopsiti me ngadalë mantelin.

– Po çfarë është kjo, Ravik? Lumturi apo dëshpërim?

Ai i buzëqeshi dhe në atë buzëqeshje i dallohej njëfarë padurimi.

– Me sa duket, të dyja. Të dyja, si pothuajse gjithmonë. Është më mirë që njeriu të mos e vrasë mendjen shumë për këtë.

– Po ç'duhet bërë?

– Të gëzohemi.

Ajo e pa në sy.

– Për t'u gëzuar, njeriu s'ka nevojë për dikë tjetër, – i tha.

– Jo. Ka gjithmonë nevojë për dikë tjetër.

Ai heshti. Ç'po dërdëllis kështu, mendoi. Gjepura. Druajtje përpara lamtumirës. Bëlbëzime të kota murgjish...

– Por jo për ato lumturitë e vogla, të cilat m'i përmendët njëherë, – vazhdoi ai. – Ato lulëzojnë kudo, si vjollcat përqark një shtëpie

të shkrumbuar. Ai që nuk pret gjë, nuk zhgënjehet... kjo është një bazë e sigurt. Dhe çdo gjë, që të dhurohet pastaj, është, si të thuash, një dhuratë më shumë.

– Është hiç, – iu përgjigj Keti Hegshtrëmi. – Ashtu të duket vetëm kur je në shtrat dhe lodh mendjen. Por kur ngrihesh e fillon të bredhësh, të duket hiç. Pastaj e humbet edhe atë pak gjë, që të duket aq e madhe, dhe kërkon gjithnjë e më shumë.

Një rreze drite nga dritarja ra pjerrtazi mbi fytyrën e saj. Sytë ia la në hije; vetëm goja dukej sikur i lulëzonte e vetmuar.

– Njihni ndonjë mjek në Firence? – e pyeti Raviku.

– Jo. Pse, mos do të kem nevojë për ndonjë?

– Gjithmonë mund të ndodhë diçka. Diçka sado e vogël. Do ta ndiej veten më të qetë, po ta di që keni ndonjë mjek atje.

– Unë ndihem shumë mirë. Dhe, po të ndodhë diçka, mund të kthehem prapë këtu.

– Natyrisht. Kjo që ju thatë, është vetëm njëfarë kujdesi... Në Firence ndodhet një mjek i zoti: profesor Fiola. Do ta mbani mend këtë emër? Fiola.

– Do ta harroj. S'besoj që ka fort rëndësi kjo gjë, Ravik.

– Kurse unë do t'i shkruaj. Dhe ai do të përkujdeset për ju.

– Po pse? Unë s'kam asgjë.

– Kujdes profesional, Keti. Asgjë tjetër. Do t'i shkruaj që t'ju marrë në telefon.

– Si të doni. – Ajo mori çantën. – Mbetshi me shëndet, Ravik. Po shkoj. Ndoshta nuk qëndroj shumë në Firence, por nisem për në Kanë dhe prej andej, me *"Konte di Savojën"* për në Nju-Jork. Po të vini ndonjëherë në Amerikë, do të takoni një grua me një shtëpi fshati, me burrë e fëmijë, me kuaj e qen. Keti Hegshtrëmin që njihnit ju, po e lë këtu. Varri i saj i vogël ndodhet në *Sheherezade.* Kur ta kaloni andej, ngrijeni edhe nga një gotë për të.

– Mirë. Një gotë me vodkë.

– Po, me vodkë. – Ajo qëndronte si e pavendosur atje, në mugëtirën e sallonit. Rrezja e dritës i binte tani në shpinë, me njërën prej fotografive të katedrales së Shartrës. Ishte pamja e altarit të madh me kryqin në sfond.

– Çudi, – tha ajo. – Duhej të isha e kënaqur, por s'jam aspak...

– Kështu e ka çdo lamtumirë, Keti. Bile, edhe kur ndahesh nga dëshpërimi, kështu të ndodh.

Ajo qëndronte akoma përpara tij si me ngurrim, e butë dhe e trishtuar.

– Gjithmonë gjëja më e lehtë në ndarje është të ikësh, – i tha Raviku. – Ejani, po ju përcjell.

– Mirë.

Ajri ishte i butë dhe i lagësht. Qielli, porsi hekur i skuqur, varej shumë poshtë mes çative.

– Po ju marr një taksi, Keti.

– Jo. Dua të eci gjer te qoshja. Atje do të gjej ndonjë taksi. Pas kaq kohësh është hera e parë që po dal në rrugë.

– Si ju duket?

– Sikur kam pirë verë.

– Them do të ishte më mirë t'ju merrja një taksi.

– Jo. Dua të eci.

Ajo vështroi me kujdes rrugën e lagur. Pastaj qeshi.

– Seç më ka mbetur një çikëz frikë, diku, në një çip. Edhe kjo bën pjesë në lamtumirën?

– Po. Edhe kjo.

– Pra, lamtumirë, Ravik!

– Lamtumirë, Keti!

Ajo qëndroi edhe një çast, sikur deshi të thoshte diçka. Pastaj zbriti shkallët; me hapa të kujdesshëm, e hollë dhe elegante doli në rrugë dhe vazhdoi të ecte drejt mbrëmjes ngjyrëvjollcë dhe drejt vdekjes së saj. Kokën nuk e ktheu më.

*

* *

Raviku u fut përsëri në klinikë. Kur kaloi para dhomës, ku pati qenë shtruar Keti Hegshtrëmi, dëgjoi muzikë. U ndal i habitur. E dinte mirë që atë dhomë nuk e kishte zënë ndonjë pacient i ri.

E hapi derën me kujdes dhe pikasi infermieren që rrinte në gjunjë përpara një gramafoni. Ajo u tremb kur dëgjoi hapat dhe kërceu në këmbë. Gramafoni lozte një pllakë të vjetër: *Valsi i fundit*.

Vajza rregulloi fustanin.

– Zonja Hegshtrëm ma dhuroi gramafonin, – tha ajo. – Është një prodhim amerikan dhe këtu s'mund ta blesh. S'e gjen në gjithë Parisin. E provova ca. Mund t'i vësh pllaka përnjëherësh. Është automatik. Model i fundit. – Nga krenaria asaj i qe bërë fytyra prush i gjallë. – Kushton të paktën tri mijë franga. Pastaj edhe gjithë ato pllaka që më fali! Pesëdhjetë e gjashtë copë, jo shaka! Gramafoni ka edhe një radio të vogël brenda. Këtij i thonë fat!

Fat! mendoi Raviku. Përsëri na doli fati. Këtu na u paraqitka në trajtën e një gramafoni. I vuri veshin muzikës. Violina ngrihej fluturimthi si një pëllumb mbi orkestrën, vajtuese dhe sentimentale. Ishte një nga ato pjesët e lehta që, nganjëherë, të mallëngjenin më tepër se gjithë nokturnet e Shopenit. Raviku hodhi sytë përreth. Mbulesat dhe çarçafët e shtratit qenë hequr dhe dysheku qe ngritur. Çarçafët dhe teshat e tjera qenë hedhur pirg pranë derës. Nga dritaret e hapura mbrëmja vështronte me ironi në dhomë. Një kundërmim i davaritur parfumi dhe akordet e mbytura të një valsi sallonesh ishin gjithë ç'kishin mbetur nga Keti Hegshtrëmi.

– Nuk mund t'i marr të gjitha përnjëherësh, – tha infermierja. – Janë shumë të rënda. Do të marr në fillim gramafonin dhe pastaj, dyherëshe, pllakat. Ndoshta do të më duhet t'i marr edhe triherëshe. Është një mrekulli e vërtetë! Me gjithë këto, njeriu mund të hapë një kafene.

– Ide e mirë, – tha Raviku. – Kini kujdes, se mos thyeni gjë!

15

Ravikut mezi po i dilte gjumi. Për një copë herë ndenji ashtu në mes të atij dyzimi të çuditshëm ëndrreje dhe të vërtete... Ëndrra ishte akoma atje, pak e zbehur dhe e hapërdarë – dhe ai, me sy hapur, e dinte se po vazhdonte të ëndërronte: Ndodhej në Shvarcvald[1] në afërsi të kufirit gjerman, para një stacioni të vogël treni. Një ujëvarë zhurmonte diku pranë. Aroma e pishave zbriste që nga malet. Ishte verë dhe lugina qe mbushur me kundërmimin e rrëshirës e të lëndinave. Shinat e hekurudhës vezullonin të kuqe nga dielli mbrëmjesor, thua se përmbi to kishte kaluar një tren që pikonte gjak... Po unë ç'kërkoj këtu? mendoi Raviku. Ç'po bëj këtu, në Gjermani? Unë sikur jam në Francë! Jam në Paris!... Ai rrëshqiti mbi një dallgë të butë e të ndritshme, që e mbuloi edhe më shumë me napën e mjegulluar të gjumit. Parisi... Ja tek u shkri edhe Parisi, u fundos nën mjegull, humbi, u tret. Ai nuk ndodhej në Paris. Ndodhej në Gjermani. Po pse djallin ishte kthyer përsëri këtu?

Iu afrua stacionit të vogël. Rojtari po lexonte gazetën Fëlkisher Beobahter[2] dhe ishte një mesoburrë me një fytyrë të buhavitur e me vetulla shumë të verdha.

– Kur niset treni tjetër? – e pyeti Raviku.

Rojtari e vështroi si me përtesë.

– Po për ku doni të shkoni?

Ravikun e pushtoi përnjëherësh një valë e nxehtë frike. Ku ndodhej? Si quhej ky stacion? Po sikur t'ia këpuste në tym e të thoshte se

1. *Schwarzwald*: Pylli i Zi; vargmale në Gjermaninë jugperëndimore dhe krahina përreth.
2. *Völkischer Beobachter*: gazeta "Vëzhguesi popullor", organ qendror i partisë naziste të Gjermanisë.

donte të shkonte në Frajburg? Ta marrë e mira, ta marrë, pse nuk e dinte ku ndodhej? Hodhi sytë nga binarët. Asgjëkundi ndonjë tabelë që të rrëfente vendin. Asgjëkundi ndonjë emër. Ai vuri buzën në gaz.

– Jam me lejë, – i tha rojtarit.

– Po për ku doni të shkoni? – e pyeti ky.

– Unë udhëtoj kështu vërdallë. Zbrita ashtu kot. Ky vend më pëlqeu kur e sodita nga dritarja. Tani s'po më pëlqen më. Nuk i duroj dot ujëvarat. Dua të vazhdoj udhëtimin.

– Po për ku doni të shkoni, xhanëm? Duhet ta dini se ku dëshironi të shkoni!

– Pasnesër duhet të jem në Frajburg. Gjer atëherë kam kohë. Më vjen qejf të bredh kështu sa andej-këtej, pa ndonjë cak.

– Kjo linjë nuk kalon nga Frajburgu, – i tha rojtari dhe e pa me vërejtje.

Ç'janë këto marrëzira që po bëj? mendoi Raviku. Ç'dreqin pata që e pyeta? Më mirë të rrija urtë e të prisja. Po këtu ç'më solli, vallë?

– E di, – i tha rojtarit. – Por unë kam mjaft kohë të lirë. Ku mund të gjej këtu afër ndonjë *Kirsh* të mirë. Një *Kirsh* të vërtetë *Shvarcvaldi?*

– Atje matanë, në bufenë e stacionit, – i tha rojtari dhe vazhdoi ta shikonte me vërejtje.

Raviku kapërceu me ngadalë pistën e stacionit. Hapat e tij shungulluan mbi çimento, nën çatinë e lartë e të hapur. Në sallën e pritjes pa dy burra ulur. I ndjeu shikimet e tyre sikur po e zhbironin pas kurrizit. Ca dallëndyshe fluturuan nën çati. Ai bëri sikur po kundronte zogjtë, ndërsa me bisht të syrit vështronte rojtarin që nga larg; ky i fundit palosi gazetën dhe pastaj e ndoqi pas Ravikun. Raviku u fut në bufe. Lokali i vogël binte erë birre. Brenda s'kishte asnjeri. Ai doli përsëri jashtë. Edhe rojtari qëndronte jashtë. Ai e pa Ravikun tek doli dhe vetë u drejtua pastaj për nga salla e pritjes. Raviku shpejtoi hapin. Kishte ngjallur dyshime dhe kishte rënë në sy – këtë e kuptoi tani menjëherë. Kur mbërriti te qoshja e godinës, ktheu kokën. Në pistë nuk dukej asnjeri. Me nxitim kaloi depot e bagazhit, para të cilave qenë grumbulluar disa bidona qumështi; u ul gërmuq përpara dritares, pas së cilës dëgjohej tik-taku i një telegrafi, dhe arriti anën e pasme të godinës. Me kujdes ktheu kokën edhe njëherë prapa. Pastaj kapërceu me të shpejtë shinat dhe ia dha vrapit nëpër një lëndinë të bleruar drejt pyllit me pisha. Kurorat e luleradhiqeve shprisheshin në erë e ngriheshin fluturim, teksa ai rendte me një frymë përmes tyre. Kur arriti më së fundi pranë pishave, pa rojtarin me ata dy burrat që qëndronin te pista e stacionit. Rojtari rrëfeu me gisht në drejtim të tij

dhe të dy burrat nisën të vraponin. Raviku u fut në pyll dhe zuri të çante rrugën mes pishave. Degët halore ia fshikullonin fytyrën. Bëri një qark të madh nga vendi ku qe futur në fillim në pyll dhe pastaj u ndal, i ngrirë e duke mbajtur frymën, për të mos u zbuluar ku ndodhej. Pas pak i dëgjoi burrat tek çanin pyllin dhe thyenin degët diku afër tij. Nisi të rendte përsëri dhe, kohë pas kohe, ndalej për të përgjuar; hera-herës, megjithëse i bënte veshët katër, nuk dëgjonte asgjë – dhe priste gjithë ankth. Pastaj kërcitjen e degëve e ndiente rishtazi fare pranë dhe ai filloi të tërhiqej zvarrë mbi tokë për të bërë sa më pak zhurmë. Kur përgjonte, mblidhte grushtet dhe mbante frymën. E pushtonte si ngërç dëshira për të brofur në këmbë e për t'ia dhënë vrapit me sa kishte fuqi – por ashtu do ta zbulonte veten. Mund të lëvizte vetëm, kur lëviznin edhe ata të dy. Rrinte atje mes shkurresh dhe anemonash të kaltra. *Hepatica triloba*, mendoi. *Hepatica triloba*, anemona. Pylli dukej pa fund e pa anë. Tani kudo po dëgjoheshin kërcitje e zhurma. E ndjeu se si i shpërtheu djersa nga të gjitha poret, a thua se trupi po i kullonte shi. Dhe përnjëherësh iu prenë gjunjët, iu duk sikur gjymtyrët i ishin zbrujtur si brumë. U përpoq të ngrihej, por u rrëzua menjëherë. Toka i dukej si moçalishte. Vështroi poshtë vetes. Toka ishte e fortë. Ishin këmbët ato që ia jepnin atë përshtypje. Këmbët i kishte si prej gome. Tani i dëgjoi ndjekësit e vet shumë afër. Po vinin tamam në drejtim të tij. Kërceu përpjetë me stërmundim, por gjunjët prej gome nuk e mbajtën për asnjë çast. U shemb përdhe, nguli thonjtë ndër këmbë, i tundi e i shkundi fort, por më kot. Vazhdoi të tërhiqej rrëshqanthi, qull në djersë e duke gulçuar, ndërsa kërcitja e degëve sa vinte e i afrohej... Para syve i doli një copëz qielli blu midis pemësh të rralluara dhe pak më tutje, pa përsëri një lëndinë të vogël... E dinte se ishte i humbur, po të mos e kalonte tani, në këto çaste, lëndinën dhe të arrinte anën tjetër të pyllit. I zuri përsëri këmbët me duar, i shkundi, ktheu kokën dhe vuri re pas vetes një fytyrë që skërmitej me ligësi e cinizëm – ishte fytyra e Hakes... Ai filloi të kridhej diku në pafundësi, i pafuqishëm, i pazoti të lëvizte më... Fryma iu mor, duart i mbërtheu pas fytit, ndërsa nga goja i dilnin rënkime e dënesa...

* * *

Po rënkonte vërtet? Ku ndodhej? I ndjeu duart në grykën e vet. I kishte qull në djersë. Edhe fytyrën e kishte qull. Edhe gjoksin. Hapi

sytë. Akoma s'po dinte ku ndodhej – në mes të pyllit të pishave apo gjetkë. As për Parisin nuk dinte gjë... Një hënë e bardhë qëndronte varur në një kryq përmbi një botë të panjohur. Një dritë e zbehtë, si brerore e shkalafitur shenjtori, nderej pas një kryqi të errët. Një dritë e bardhë, e vdekur klithte pa zë në mes të një qielli ngjyrë çeliku... Ishte hëna e plotë pas listelave të kryqëzuara të dritares në një dhomë të hotel *Internacionalit*, në Paris... Raviku u ngrit ndenjur në shtrat. Çfarë kishte ndodhur kështu? Një tren që kullonte gjak, duke uturuar përmes një muzgu vere përmbi shina të përgjakura... Ëndrra që kishte parë me qindra herë, po ajo ëndërr, sikur ndodhej përsëri në Gjermani, i ndjekur këmba-këmbës nga larot e një regjimi mizor që e kishte legalizuar vrasjen... Sa e sa herë i pati ndodhur kjo?... Ai ia mbërtheu sytë hënës, e cila, me atë dritën e saj të huajtur, ia thithte botës ngjyrat... Ah, këto ëndrra, mbushur plot me tmerret e kampeve të përqendrimit... me fytyra të pajeta shokësh e miqsh të masakruar... me dhimbjen e ngurosur e pa lot të atyre që mbeteshin gjallë... me ndarje të trishtuara... dhe me një ndjenjë vetmie që i kalonte gjithë kufijtë e ankimit... Gjatë ditës edhe mund të krijoje njëfarë barrikade: atë murin që e kalonte lartësinë e syve e s'të linte të shihje përtej, në të kaluarën; ishte një mur i ndërtuar gjatë vitesh të rënda e të gjata, ngadalë e gur mbi gur, duke i mbytur dëshirat në baltën e cinizmit, duke i flakur kujtimet në gropën e harresës, duke i çimentuar ndjenjat e duke shkulur çdo gjë nga vetja, bile edhe emrin!... Dhe kur, megjithatë, ndonjëherë, në një orë të pakontrolluar mirë, ngrihej e ëmbël, e mjegullt dhe joshëse fytyra e së kaluarës, i futeshe alkoolit dhe e mbysje në të çmendurisht. Mirë, ditën – po natën?!... Natën njeriu edhe mund t'i dorëzonte armët, frenat e disiplinës liroheshin dhe karroja fillonte e shkiste tatëpjetë... Pas horizontit të vetëdijes ngrihej sërishmi e zbehta fytyrë e së kaluarës... diçka mëkëmbej nga varret... ngërçi i ngrirë çlirohej... avitesshin hijet... gjaku ziente... plagët pikonin dhe një stuhi sterrë e zezë ulërinte e fishkullonte mbi gjithë muret, pirgjet dhe barrikadat e ngritura! Të harrosh – kjo ishte gjë e lehtë vetëm përderisa fanari i vullnetit ndriçonte botën; por kur ai shuhej dhe fillonte e dëgjohej lëvrimi i krimbave, kur një botë e shembur ngrihej sipër dallgësh porsi një *Vinetë*[1] e fundosur dhe ringjallej sërish – atëherë kjo ishte diçka tjetër. Mund të jepeshe i tërë pas dehjes plumb të rëndë. Mund ta bëje këtë natë për natë – dhe të harroje... Mund t'i ktheje netët në

1. *Vineta*: Sipas legjendës, një qytet në brigjet gjermane të Balltikut, i përpirë nga deti.

ditë dhe ditët në net, sepse ditën njeriu ëndërronte ndryshe – jo ashtu si natën, i humbur, i braktisur, i përzënë nga të gjithë edhe nga të gjitha... Po a s'e kishte provuar edhe këtë? Sa herë ishte kthyer në hotel vetëm atëherë, pasi nëpër rrugë fillonte e zvarritej mugëtira e mëngjesit? Ose sa herë kishte pirë në *Katakombë* me çdokënd që pranonte të zbrazte nga një kupë me të, duke pritur gjersa të kthehej Marozovi nga *Sheherezadja* e duke vazhduar të pinte pastaj edhe me orë të tëra, në atë qilar pa dritare, mes palmash artificiale, ku vetëm ora e madhe në mur rrëfente sa ishte ngritur dielli përjashta? Kësaj i thoshin të bëheshe xurxull në një nëndetëse. Ishte kollaj të tundje kokën e të thoshe se njeriu duhet të jetë i arsyeshëm. Por, ta marrë djalli, ta marrë – në të vërtetë kjo s'ishte aspak aq e lehtë! Jeta ishte jetë; nuk vlente asgjë dhe vlente gjithçka; atë mund ta flakje tutje – edhe kjo ishte e lehtë... Por, bashkë me të, a nuk e flakje pastaj edhe hakmarrjen, a nuk e flakje edhe atë, i cili, i përbuzur, i pështyrë e i tallur dita-ditës dhe ora-orës, quhej megjithatë "besim te njerëzorja dhe te njerëzimi"?... Një jetë të zbrazët nuk mund ta flakje dot tutje si një gëzhojë të zbrazët. Ajo të vlente akoma aq sa për të luftuar, kur të vinte koha për këtë dhe kur ajo do mund të të nevojitej. Për të luftuar – i shtyrë jo nga arsye personale, bile as nga hakmarrja që zakonisht është aq e rrënjosur thellë në gjak, as nga egoizmi, dhe as nga shkaqe altruizmi, sado e rëndësishme që do të ishte sikur të ndihmoje për të lëvizur qoftë edhe një milimetër përpara rrotën e kësaj bote gjaku dhe gërmadhash, – për të luftuar, fundja, thjesht sa për të luftuar, duke pritur rastin për t'iu futur kësaj lufte gjersa merrje frymë akoma!... Por pritja të gërryen dhe, ndoshta, e gjitha kjo ishte diçka e pashpresë; pastaj të pushtonte edhe ajo djall frike e fshehtë, se mos, kur të arrinte më së fundi puna gjer atje, do të ishte tepër i ronitur, tepër i brejtur, tepër i dembelosur nga pritja dhe i kapitur gjer në palcë, për të mundur të marshoje krahas me të tjerët!... Pra, a s'ishte kjo arsyeja që të shtynte të flakje në honin e harresës gjithçka që mund të të brente nervat... që të shtynte ta shuaje çdo gjë me egërsi, me sarkazëm e me ironi, bile edhe me kundërsentimentalizëm, me arratisjen nga vetvetja në krahët e një njeriu tjetër, drejt një "uni" të huaj? Dhe kështu të veproje gjithnjë e gjithnjë, përderisa nuk vinte ai çast i mallkuar, kur të pushtonte përsëri ajo pafuqia brutale dhe kur u dorëzoheshe pa kushte gjumit dhe fantazmave...

Hëna zvarritej rëndë-rëndë pas listelave të kryqëzuara të dritares. Tani ajo s'ishte më si brerore e shkalafitur shenjtori, por si një rrugaçe e pacipë, që shtinte sytë nëpër dhomat dhe shtretërit e botës.

Ravikut i kishte dalë gjumi fare. Ajo ëndërr që pa, nuk pati qenë edhe aq me zarar. Ai njihte edhe ëndrra të tjera. Por ishte bërë një kohë mjaft e gjatë qëkur s'kishte parë më ëndrra. U mendua pak... Po, nuk kishte parë nga ato ëndrra që kur nuk flinte më vetëm...

Zgjati dorën jashtë shtratit. Shishja nuk ndodhej më aty pranë. Kishte kohë që nuk e linte më aty. Tani vendi i saj ishte mbi tryezën në kënd të dhomës. Ngurroi për një çast. Nuk ishte nevoja të pinte. Ai e dinte këtë. Por nuk ishte as nevoja të mos pinte. U ngrit dhe iu afrua këmbëzbathur tryezës. Gjeti një gotë, ia hoqi tapën shishes dhe piu. Ishte fundi i atij *Kalvadosit* të vjetër. E ngriti gotën dhe e ktheu në drejtim të dritares. Hëna e bënte të dukej si gur opali. Pijet s'duhet t'i mbash në dritë, mendoi ai. As në diell dhe as në hënë. Ushtarët e plagosur që kalonin një natë përjashta, nën hënën e plotë, e ndienin veten më të dobët se netët e tjera. Ai tundi kokën dhe e rrëkëlleu gotën në gurmaz. Sakaq mbushi edhe një tjetër. Kur ngriti kokën, vuri re që Xhoana i kishte hapur sytë dhe po e vështronte. Ai e la të pirët. Nuk ishte krejt i sigurt nëse ajo qe zgjuar dhe po e sodiste vërtet.

– Ravik, – tha Xhoana.

– Urdhëro...

Ajo u drodh sikur të qe zgjuar atë çast.

– Ravik, – tha me një zë krejt të ndryshëm. – Ravik... ç'po bën aty?

– Po pi diçka.

– Po pse...? – Ajo u ngrit ndenjur. – Çfarë ke? – e pyeti e shushatur. – Ka ndodhur gjë?

– Asgjë.

Ajo shkoi gishtërinjtë nëpër flokë dhe i shtroi nga pas. – O zot, – tha, – sa u tremba!

– Nuk desha të të trembja. Pandeha se do të flije e qetë.

– Ti m'u fanite befas atje... në qoshe... M'u duke si tjetërkush...

– Më vjen keq, Xhoanë. Nuk ma mori mendja që do të të dilte gjumi.

– E ndjeva që s'ishe më pranë meje. Pata ftohtë. Ndjeva një si erë... si një llahtar të akullt... E pastaj të dallova përnjëherësh atje... Mos ka ndodhur gjë?

– Jo, asgjë. Asgjë, Xhoanë. Më doli gjumi ashtu kot dhe më hipi të pija diçka.

– Nëm edhe mua një gllënjkë.

Raviku e mbushi gotën dhe iu afrua shtratit.

– Tani më dukesh si fëmijë, – i tha.

Ajo e zuri gotën me të dyja duart. Pinte ngadalë dhe e kundronte që nga sipër gotës.

– Pse u zgjove? – e pyeti.

– Nuk e di. Më duket se e kishte fajin hëna.

– Unë e urrej hënën.

– Në Antibë s'ke për ta urryer më.

Ajo vuri gotën mbi komodinë.

– Do të nisemi vërtet për pushime?

– Po, do të nisemi.

– Larg kësaj mjegulle dhe këtij shiu?

– Po... larg kësaj mjegulle dhe këtij shiu të mallkuar.

– Mbushma edhe një gotë.

– Nuk do të flesh tani?

– Jo. Është gjynah ta kalosh kohën me gjumë. Ne humbasim shumë nga jeta kur flemë. Mbushma edhe një gotë, pra! Mos ishte ky nga ai *Kalvadosi* i mirë? Ne sikur thamë që atë shishen do ta mermim me vete!

– S'duhet marrë asgjë me vete.

Ajo i hodhi një shikim.

– Kurrë?

– Kurrë.

Raviku shkoi te dritarja dhe tërhoqi perdet. Ato mbylleshin vetëm përgjysmë. Drita e hënës binte në mes tyre dhe e ndante dhomën në dy gjysma errësire të vagëlluar.

– Pse nuk vjen të biesh? – e pyeti Xhoana.

Raviku qëndronte pranë kanapesë në pjesën tjetër të dhomës, përtej dritës së hënës. Ai e dallonte turbull Xhoanën të ulur mbi shtrat. Flokët i derdheshin mbi supe me një shkëlqim të zbehtë. Ajo s'kishte gjë veshur. Mes asaj dhe atij, si mes dy brigjesh të errëta, derdhej drita e ftohtë, ajo dritë që nuk rridhte për asgjëkundi, por vetëm brendapërbrenda vetes. Ajo dritë, duke kaluar nëpër një rrugë të pafund, përmes eterit të zi e të paajër, derdhej në katërkëndëshin e dhomës, mbushur me erën e ngrohtë të gjumit... Një dritë e thyer, e përplasur mbi një yll të largët e të vdekur dhe e shndërruar në mënyrë magjike nga një shkëlqim i ngrohtë dielli në këtë rrjedhë të plumbtë e të akullt... Dhe ajo rridhte e rridhte e, megjithatë, qëndronte në një vend dhe s'e mbushte dhomën kurrë...

– Pse nuk vjen? – përsëriti Xhoana.

Raviku eci nëpër dhomë, nëpër errësirën dhe dritën dhe përsëri nëpër errësirën – ishin vetëm pak hapa, por atij iu duk larg.

– E solle shishen?

– Po.

– E do gotën? Sa shkoi ora?

Raviku i hodhi një sy fushës së vogël të sahatit me shifrat fosforeshente.

– Pesë pa ca.

– Pesë! Mund të ishte edhe tre. Ose shtatë. Natën koha qëndron në vend. Vetëm orët ecin.

– Po. E, megjithatë, të gjitha bëhen natën. Ose për shkak të natës.

– Çfarë?

– Ato që duken pastaj ditën.

– Mos fillo të më frikësosh...

Ajo ia mori gotën nga dora dhe piu. Ishte shumë e bukur dhe ai e ndjeu që e dashuronte. Ajo s'ishte e bukur si një statujë apo si një pikturë; ishte e bukur si një lëndinë, mbi të cilën kalonte e fëshfërinte flladi. Ishte jeta ajo që regëtinte brenda saj dhe që e kishte formuar ashtu siç qe, fshehtësisht nga përplasja e dy qelizave... nga hiçi diku në një prehër... Ishte po i njëjti, i pakuptueshmi mister, që në një kokërr fare, të vogël sa s'bëhej, ndodhej e gjithë pema, vërtet amorfe, mikroskopike, por ekzistuese, e paracaktuar, me degë e me kokra, me bulbëzat e me lulet e gjithë mëngjeseve të prillit mbi të... Misteri që, nga një natë dashurie dhe nga pak farë që zinte, formohej një fytyrë, formoheshin dy supe dhe një palë sy – pikërisht këto supe dhe këta sy, që ndodheshin diku, midis miliona njerëzve diku në botë... Dhe pastaj, një mbrëmje nëntori, njeriu rrinte te *Pon dë l'Alma* në Paris, dhe ata sy e ato supe të dilnin befas përpara...

– Po përse natën...? – e pyeti Xhoana.

– Sepse... – Zëri i Ravikut erdhi e u bë shumë i butë. – Afromu, e dashur, ti që m'u ridhurove nga honet e gjumit, që m'u riktheve nga kushedi se ç'lëndina fantastike të hënës... Kërkon ta dish përse-në? Sepse nata dhe gjumi, e dashur, janë tradhtarë! A të kujtohet si na zuri gjumi këtë natë, njëri pranë tjetrit; ishim aq afër sa ç'mund të jenë dy njerëz afër në këtë botë. Fytyrat tona, lëkura jonë, mendimet tona, fryma jonë takoheshin, përziheshin... E pastaj, dalëngadalë, midis nesh filloi të depërtonte gjumi, si një masë e murrme njolla-njolla dhe, më vonë, erdhi e u përhap posi zgjebe mbi mendimet tona, u fut në gjakun tonë, pika-pika na hodhi verbimin... E pastaj, përnjëherësh, secili nga ne u ndodh i vetëm; ne lundronim të braktisur dikur nëpër kanale të errëta, nën mëshirën e forcave të panjohura dhe të kanosjeve të padukshme. Kur u zgjova, të pashë. Ti

flije. Ndodheshe akoma shumë larg meje. Më ishe zhdukur fare. Më kishe harruar dhe s'dije asgjë për mua. Ndodheshe diku, ku unë nuk të ndiqja dot. – Ai ia puthi dorën. – E si mund të jetë e përsosur dashuria, kur unë të humbas çdo natë për faj të gjumit, kur ai të rrëmben nga krahët e mi!

– Po unë isha shtrirë pranë teje! Ngjitur me ty! Në krahët e tu!

– Ti ishe në vise të panjohura. Ishe shtrirë pranë meje, por në të vërtetë ke qenë po aq larg sa ylli Sirius. Kur s'më ndodhesh pranë ditën, atëherë kjo s'është asgjë; gjithçka që ka të bëjë me ditën, unë e di. Po kush është ai që di gjë për natën?

– Po unë isha me ty!

– Ti s'ishe me mua. Vetëm ishe shtrirë pranë meje. Kush është ai që mund ta dijë sesi do të kthehet nga ato vise pa kontroll? I ndryshuar, pa e ditur as vetë.

– Atëherë kjo vlen edhe për ty!

– Po, edhe për mua, – tha Raviku. – Dhe tani nëma atë gotë. Ndërsa unë po flas marrëzira, ti po na e mbaron shishen.

Ajo ia zgjati gotën.

– Mirë që u zgjove, Ravik. Bekuar qoftë hëna. Pa të ne do të vazhdonim të flinim dhe s'do të dinim gjë për njëri-tjetrin. Ose mund të ndodhte që, te njëri prej nesh të ishte hedhur fara e ndarjes, ndërsa ne s'do të ishim në gjendje të mbroheshim. Dhe ajo do të rritej e do të rritej ashtu e padukshme, derisa një ditë prej ditësh do ta nxirrte kokën. – Ajo qeshi mbyturazi.

Raviku e vështroi.

– Ti s'para i merr seriozisht këto gjëra, ë?

– Jo. Po ti?

– As unë. Por ka diçka të vërtetë në këtë mes. Prandaj edhe ne nuk i marrim seriozisht. Në të tilla raste njeriu tregohet shpirtmadh.

Ajo qeshi përsëri.

– Unë s'kam frikë nga këto gjëra. Kam besim në trupat tanë. Ata e dinë më mirë çfarë duan, nga ç'mund ta dinë mendimet fantastike që bredhin natën në kokat tona.

Raviku e zbrazi gotën e vet.

– Mirë, – tha ai. – Edhe kjo është e drejtë.

– Po sikur t'i vinim vizë gjumit tani, si thua?

Raviku ngriti shishen nga tufa e rrezeve të hënës që binin në dhomë. Kishte mbetur një e treta e saj.

– S'na ka tepruar shumë, – tha ai. – Por mund ta provojmë me kaq sa kemi.

Ai e la shishen mbi komodinë. Pastaj u kthye dhe vështroi Xhoanën.

– Ti më dukesh si të gjitha dëshirat e një burri plus një dëshirë më tepër, të cilën ai s'e kishte ditur.

– Në rregull, – tha ajo. – Që tani e tutje do të zgjohemi gjithmonë në mes të natës, Ravik. Natën ti je ndryshe nga ditën.

– Më i mirë?

– Më ndryshe. Natën ti e mahnit tjetrin: vjen gjithmonë nga ca vise që askush nuk i njeh.

– Pse, ditën jo?

– Jo gjithmonë. Rrallë.

– Pohim i bukur fort, – tha Raviku. – Përpara disa javësh s'do të më kishe folur kështu.

– Jo. Atëherë edhe të njihja më pak.

Ai ia nguli sytë. Në fytyrën e saj nuk dallohej as hija e një kuptimi të dyfishtë. Ajo kështu mendonte dhe këtë e gjente krejt të natyrshme. Nuk donte as ta lëndonte dhe as t'i thoshte ndonjë gjë të veçantë.

– E paske nisur mirë, – i tha ai.

– Pse?

– Do të kalojnë edhe ca javë të tjera dhe do të më njohësh edhe më mirë, dhe pastaj do të jem më pak mahnitës.

– Njëlloj si unë, – tha Xhoana dhe qeshi.

– Ti jo.

– Pse unë jo?

– Psenë e kësaj duhet ta kërkosh në pesëdhjetë mijë vjet biologji. Dashuria e bën gruan të mprehtë, ndërsa burrin konfuz.

– Po ti a më dashuron?

– Po.

– Shumë rrallë ma thua këtë. – Ajo u shtriq trup e gjymtyrë.

Si një mace e ngopur, mendoi Raviku. Si një mace e ngopur që është e sigurt për gjahun e vet.

– Nganjëherë më vjen të të hedh nga dritarja, – i tha.

– E pse s'më hedh?

Ai e vështroi.

– Do ta bëje dot? – e pyeti ajo përsëri.

Ai nuk i dha përgjigje. Ajo u mbështet në jastëkët.

– Të shkatërrosh një njeri sepse e dashuron? Ta vrasësh sepse e do shumë?

Raviku zgjati dorën dhe rrëmbeu shishen.

– O perëndi, – tha ai. – Ç'të keqe paskam bërë kështu, që të më dënosh të zgjohem natën e të dëgjoj të tilla fjalë?

– Pse, a s'është e vërtetë?

– Po. Vetëm për poetë të klasës së tretë dhe për ca gra që nuk u ndodh një gjë e tillë.

– Është e vërtetë edhe për ata që e bëjnë.

– Epo mirë, zëre sikur është ashtu.

– Po ti, a do ta bëje dot?

– Xhoanë, – tha Raviku, – lëri këto gjepura. Unë s'jam i përshtatshëm për të tilla spekulime. Kam vrarë mjaft njerëz gjer tani. Si amator dhe si profesionist. Si ushtar dhe si mjek. Kjo të pajis me përbuzje, mospërfillje dhe respekt për jetën. Me vrasje nuk arrin ta shuash shumë. Kush ka vrarë shpesh, nuk vret më nga dashuria. Atëherë vdekja bëhet e vockël dhe qesharake. Por vdekja nuk është kurrë e vockël dhe qesharake. Pastaj, ajo s'është as punë grash; është vetëm çështje burrash. – Ai heshti një copë herë. – Ç'po llomotisim kështu? – ia bëri pastaj dhe u përkul mbi Xhoanën. – A nuk je ti lumturia ime pa rrënjë? Lumturi resh dhe projektorësh? Eja të të puth! Kurrë s'ka qenë jeta kaq e çmuar sa sot, kur vlen kaq pak...

16

Dritë... Përsëri kjo dritë që vinte fluturimthi si shkumë bardhoshe, tutje horizontit, në mes blusë së thellë të detit dhe asaj më të çeltës së qiellit; vinte fluturim, pa pikën e frymës e, njëkohësisht, e tejpërshkuar e gjitha me frymë, ndriçim e refleks njëherësh... Ç'lumturi e thjeshtë, e stërlashtë kjo lumturia e dritës – të jesh kaq e çiltër, kaq vezulluese, të endesh nëpër hapësirë kështu, pa farë substance!...

Si i rri Xhoanës pas kokës! mendoi Raviku. Porsi një brerore pa ngjyrë! Hapësirë pa perspektivë. Si i derdhet përmbi supe! Porsi qumësht *Kanaani*,[1] porsi mëndafsh i endur prej rrezesh! Nën këtë dritë askush s'është lakuriq. Lëkura e tërheq dhe e rrezaton sërishmi, ashtu siç e tërheqin dhe e lëshojnë sërishmi shkëmbinjtë detin. Shkumë deti, hutim i tejdukshëm, më e holla veshje prej më të çeltës mjegull...

– Sa u bë që jemi këtu? – pyeti Xhoana.

– Tetë ditë.

– Duken si tetë vjet. Si thua ti?

– Jo, – tha Raviku. – Duken si tetë orë. Tetë orë dhe tri mijë vjet. Aty ku je ti tani, qëndronte po kështu, tri mijë vjet më parë, një etruske e re... Dhe po kështu era frynte tej nga Afrika, duke marrë përpara dritën dhe duke e shtyrë nëpër det.

Xhoana erdh e u ul pranë tij, mbi shkëmb.

– Kur duhet të kthehemi në Paris?

– Këtë do ta tregojë mbrëmja e sotme, në kazino.

– A kemi fituar ndonjë metelik?

1. *Kanaan*: Emri antik i bregdetit të Palestinës dhe të Finikisë.

– Jo edhe aq sa na duhen.

– Ti luan sikur ke luajtur tërë jetën dhe sikur je usta i mbaruar. Ndoshta edhe je. E ku mund ta di unë? Se mos m'i tregon të gjitha ti! Dhe tani më thuaj, si shpjegohet që *krupjeri*[1] të përshëndeti sikur të ishe ndonjë fabrikant municionesh i krimbur në para?

– Më ngatërroi me një fabrikant municionesh.

– S'është e vërtetë. Edhe ti i dhe të njohur!

– E bëra vetëm për mirësjellje.

– E kur ke qenë këtu radhën e fundit?

– Nuk e mbaj mend. Dikur, para shumë vjetësh... Sa qenke nxirë! Të shkon e nxira; duhet të jesh gjithmonë kështu.

– Atëherë duhej të jetoja gjithmonë këtu.

– Do të të pëlqente?

– Jo gjithmonë. Por do të më pëlqente të jetoja përherë kështu, siç po jetoj tani. – Ajo i hodhi flokët pas supeve me një lëvizje të rrëmbyer të kokës. – Të duket fort e cekët kjo që thashë, apo jo?

– Jo, – tha Raviku.

Ajo buzëqeshi dhe u kthye nga ai.

– E di që është e cekët, i dashur. Por, o zot i madh, në jetën tonë të mallkuar kemi hasur shumë pak gjëra të cekëta e të lehta! Luftë, uri, përmbysje dhe inflacione kemi pasur boll, s'kemi pse të qahemi... Por kurrë s'patëm pakëz siguri e lehtësi, kohë e qetësi për vete... Dhe ti vjen e më thua tani se do të shpërthejë një luftë e re. Vërtet që prindërit tanë e kanë pasur më të lehtë nga ne, Ravik.

– Po.

– Njeriu ka vetëm një jetë, një dhe të shkurtër... e edhe ajo i shkon kot... – Xhoana mbështeti duart mbi shkëmbin e ngrohtë. – Mua s'para më vlen shumë lëkura, Ravik. S'para i jap fort rëndësi në jetoj në kohëra historike ose jo. Dua të jem vetëm pakëz e lumtur dhe s'më pëlqen që gjithçka të jetë kaq e rëndë dhe kaq e vështirë. Kaq dua, dhe asgjë tjetër.

– E kush nuk e do këtë, Xhoanë?

– Edhe ti?

– Natyrisht.

Ah, kjo bluja, mendoi Raviku. Kjo bluja pothuajse e pangjyrë tej në horizont, ku qielli kridhet në det... Dhe këta sy, që këtu janë më blu se në Paris...

– Sa mirë do të ishte sikur të mund të bënim një jetë të tillë! – tha Xhoana.

1. *Croupier:* Punonjës i kazinosë; ndihmësi i atij që mban arkën gjatë lojës.

Erjonixx.ro0t

– Po ne po e bëjmë... tani për tani.

– Po, tani për tani; për disa ditë; por pastaj do të kthehemi prapë në Paris; në atë klub nate ku nuk ndryshon asgjë; në jetën e përditshme të atij hoteli pis...

– Ti po e tepron, më duket. Hoteli yt s'është pis. Imi, po... me përjashtim të dhomës sime.

Ajo u mbështet mbi bërryla. Era e detit ia shpupurishte flokët.

– Marozovi thotë që je një mjek i mrekullueshëm. Sa keq që i ke punët aq të ngatërruara. Do të mund të fitoje shumë para. Sidomos si kirurg. Profesor Dyrani...

– Ku e njihke ti Dyranin?

– Vjen nganjëherë në *Sheherezade*. Rëneja, kryekamerieri, thotë se nën dhjetë mijë franga ai s'të prek gjë me dorë.

– Rëneja qenka informuar mirë.

– Dhe qëllon të bëjë edhe nga dy, tre operacione në ditë. Ka një vilë përrallore, një veturë *Pakard*...

Çudi! mendonte Raviku. Fytyra nuk i ndërron shprehje. I është bërë bile më tërheqëse, teksa dërdëllit këto marrëzira grash mijëra vjet të lashta. I ngjan një amazone me sy ngjyrëdeti, ndërsa, me instinktin e saj prej femre, na predikon ideale bankierësh. Po a nuk ka të drejtë, vallë? A nuk ka gjithmonë të drejtë një bukuri e tillë? Dhe, njëkohësisht, a nuk i ka të gjitha shfajësimet e botës në anën e vet?

Ai e vuri re që nga larg motobarkën tek afrohej me shpejtësi, duke ngritur përpjetë një mori stërkalash; e dinte pse po vinte ajo motobarkë në drejtim të tyre dhe nuk u tund nga vendi.

– Po na vijnë miqtë e tu, – i tha Xhoanës.

– Pse? – Xhoana e kishte pikasur qëkur barkën. – Pse qenkan miqtë e mi? Më tepër janë miqtë e tu. Të kanë njohur më parë se mua.

– Dhjetë minuta më parë.

– Sidoqoftë, më parë.

Raviku qeshi.

– Mirë, Xhoanë.

– S'është nevoja që të shkoj me ta. Punë e thjeshtë. Nuk do të shkoj.

– Natyrisht që jo.

Raviku u shtri mbi shkëmb dhe mbylli sytë. Dielli iu bë menjëherë si një mbulesë e ngrohtë, e artë. Ai e dinte çfarë do të ndodhte tani.

– Ne s'jemi edhe aq të sjellshëm, – ia nisi Xhoana pas pak.

Erjonixx

– Dashnorët s'janë kurrë të sjellshëm.

– Ata të dy po vijnë për hatrin tonë. Duan të na marrin. Meqë s'kemi qejf të shëtisim me ta në det, zbrit të paktën poshtë dhe ua thuaj.

– Mirë. – Raviku hapi sytë përgjysmë. – Le t'i biem shkurt. Zbrit ti poshtë, thuaju se më duhet të punoj, dhe shko ti me ta. Ashtu siç bëre dje.

– Të punosh?... Kjo tingëllon pak si e çuditshme! E kush punon këtu? Pse nuk vjen edhe ti, xhanëm? Ata të dy kanë shumë simpati për ty. Dje u erdhi shumë keq që na le vetëm.

– O perëndi! – Raviku i hapi sytë krejt. – Pse vallë të gjitha gratë i kanë qejf këto biseda idiote? Ti ke dëshirë të lundrosh, unë nuk kam barkë, jeta është e shkurtër, ne do të rrimë këtu vetëm pak ditë... e ç'më duhet pastaj të shtirem sikur po tregohem bujar ndaj teje dhe të të detyroj ta bësh atë, të cilën ti prapëseprapë do ta bësh? Të tregohem shpirtmadh, vetëm e vetëm që ti ta ndiesh veten më mirë?

– S'ke nevojë të më detyrosh. Mund ta bëj edhe vetë.

Ajo i hodhi një vështrim. Sytë e saj e ruanin po atë intensitet shkëlqimi, vetëm gojën e shtrembëroi sa për një çast – ishte një shprehje që i rrëshqiti mbi fytyrë aq shpejt saqë Raviku mund të pandehte se qe gabuar. Por ai e dinte fort mirë se nuk ishte gabuar.

Deti përplasej me uturimë mbi shkëmbinjtë pranë urës së vogël me dërrasa. Uji i shkumëzuar kërcente përpjetë dhe era rrëmbente me vete një turmë stërkalash të ndritshme dhe ua sillte gjer atje sipër. Raviku i ndjeu mbi lëkurë, thua se po i kalonin mornica.

– Është vala jote, – tha Xhoana. – Ajo vala e përrallës që më rrëfeve në Paris.

– E paske mbajtur mend?

– Po. Por ti nuk je shkëmb. Je bllok betoni.

Ajo zbriti gjer poshtë tek ura dhe mbi supet e saj të bukura qëndronte i gjithë qielli. Dukej sikur ajo po e bartte. Shfajësimin për çdo veprim e kishte marrë me vete.

Pas pak ajo do të rrijë në atë barkën e bardhë, flokët do t'i valëviten nëpër erë, kurse unë jam hajvan që nuk shkova me ta, mendonte Raviku. Por, për një rol të tillë, nuk jam pjekur akoma. Edhe këtë do të kisha mangët – një krenari prej budallai kohërash të shkuara, një sjellje donkishoteske. Por, fundja, ç'na mbetet përveç kësaj? Pemë fiku të lulëzuara netëve me hënë, filozofia e Senekës dhe e Sokratit, një koncert violine i Shumanit dhe vetia për ta kuptuar humbjen përpara të tjerëve.

Atij i zuri veshi zërin e Xhoanës nga poshtë. Pastaj dëgjoi brumbullimën e mbytur të motorit. U ngrit ndenjur. Tani ajo do të zinte vend në kiçin e barkës. Diku tutje në det ndodhej një ishull me një manastir të vjetër. Nganjëherë dëgjoheshin që andej këngët e gjelave... Ç'dritë të kuqe derdhte dielli mbi qepalla! Lëndinat e buta të fëmijërisë, të skuqura nga lulet e gjakut plot dëshirim dhe pritje. Ninulla e lashtë e detit. Kambanat e *Vinetës*. Lumturia magjike e të mosmenduarit...

Shpejt e zuri gjumi.

*

* *

Pasdreke shkoi e nxori automobilin nga garazhi. Ishte një veturë e markës *Talbo*, të cilën Marozovi e pati marrë me qira për të në Paris. Me atë veturë kishte ardhur me Xhoanën gjer këtu.

Raviku mori rrugën e bregdetit. Dita ishte shumë e kthjellët dhe qielli i qëruar nga të katër anët. Ai udhëtoi nëpër *Kornishë*[1] për në Nisë dhe Montekarlo, dhe pastaj për në Vijë-Fransh. I pëlqente shumë ajo moloja e vjetër dhe e vogël e këtij qytetthi dhe ndenji një copë herë të gjatë përpara një bari atje në breg. Pastaj brodhi ca nëpër lulishtet përpara kazinosë së Montekarlos dhe vizitoi "Varrezat e vetëvrasësve", që shtriheshin lart mbi det; zgjodhi një varr dhe qëndroi mjaft kohë përpara tij, duke qeshur me vete. U fut në rrugët e ngushta të Nisës së vjetër, kapërceu sheshet e monumenteve dhe doli në pjesën e re të qytetit; sakaq u kthye në Kanë dhe nga Kana mori rrugën për andej, ku shkëmbinjtë fillonin e bëheshin të kuqërremtë dhe fshatrat e peshkatarëve mbanin emra biblikë.

Ai e harroi Xhoanën. Harroi edhe vetveten. Iu hap i tëri ditës së kthjellët, kësaj trinie të përbërë prej dielli, deti dhe toke, që e lulëzonte atë shirit bregdetar, ndërsa rrugët dhe qafat malore përmbi të ishin akoma të praruara nga dëbora. Mbi Francë nderej shiu, mbi Evropë gjëmonte shtrëngata – por kjo pjesë e ngushtë bregdeti dukej sikur s'dinte asgjë nga këto; dukej sikur e kishin harruar; jeta këtu rrihte akoma me një tjetër puls; dhe, ndërsa vendin pas këtij bregu e kishte veshur mjegulla e murrme e mjerimit, e parandjenjës së ligë dhe e rrezikut, këtu shkëlqente akoma dielli, dhe ishte një diell gazmor, dhe në ndriçimin e tij mblidhej e fundmja shkumë e një bote që po vdiste.

1. *Corniche*: Rrugë me bukuri të rrallë e rivierës franceze, që shtrihet përgjatë bregdetit ligurian, nga Nisa deri në Gjenovë.

Erjonixx

Pakëz valle fluturash dhe mushkonjash rreth qiririt të fundit – e parëndësishme, si çdo valle e tillë; e lehtë, si muzika që dëgjohej nga kafenetë... Një botë që ishte bërë e tepërt... Si fluturat në tetor, me ngricën të futur në zemrat e tyre të vockla verore – kjo botë po valëzonte, dërdëlliste, bënte flirte, dashuronte, mashtronte dhe e luante pjesën e vet pakëz, përpara se t'i nënshtrohej kosës së madhe dhe erërave të stuhishme...

Raviku e ktheu veturën në rrugën për në Shën Rafael. Limani i vogël katërkëndësh ishte plot me varka me vela dhe me motobarka. Përpara kafeneve në breg ishin nxjerrë çadra të larme dielli. Gra të nxira nga rrezet e Jugut rrinin pranë tryezave. Si i rikujtohen njeriut të gjitha këto! mendonte Raviku. Shëmbëllimi i lehtë dhe i ëmbël i jetës. Tundimi gazmor, kapërthimi, lodrimi... Si i rikujtohen njeriut të gjitha këto, sado kohë që të ketë kaluar!... E kam jetuar edhe unë dikur këtë ekzistencë insekti dhe kam pandehur se ishte e mjaftueshme...

Vetura doli nga kthesa me rrapëllimë dhe fluturoi mbi xhadenë e gjerë, drejt perëndimit të përcëlluar të diellit.

*

* *

Ai mbërriti në hotel dhe gjeti një lajm nga Xhoana. Ajo kishte marrë në telefon dhe i kishte lënë fjalë se nuk do të vinte për darkë. Ai shkoi në restorantin *Eden Rok*. Kishte shumë pak njerëz që po hanin darkë aty. Më të shumtët shkonin zakonisht në Zhuan le Pëns dhe në Kanë. Ai zuri një tryezë pranë parmakut të tarracës, e cila qëndërtuar mbi shkëmb në trajtën e një kuverte vapori. Përposh shkumëzonte deti. Valët afroheshin që nga larg, sikur dilnin andej nga perëndonte dielli, dhe kishin ngjyrë manushaqe, blu dhe të blertë; pastaj e ndërronin ngjyrën në të kuqe të artë dhe portokall, e ngarkonin mugëtirën mbi kurrizet e tyre të hajthme dhe e përplasnin mbi shkëmbinjtë në formë shkume ngjyrash të papërcaktuara.

Raviku ndenji gjatë atje lart në tarracë. Ndiente se e kishte zemrën akull dhe se ishte shumë i vetmuar. E kishte mendjen të kthjellët dhe, pa as më të voglin emocion, e parashikonte atë që do të ndodhte. Ai e dinte se do të ishte në gjendje ta pengonte edhe për pak kohë; për këso rastesh ekzistonin ca si marifete dhe ca si lëvizje shahu. I dinte ato, por njëkohësisht ishte i sigurt që nuk do t'i vinte në veprim. Kishte shkuar tepër larg, saqë të mund t'i përdorte tani.

Marifetet vlenin për aventura të vogla; kurse këtu kishte mbetur vetëm një zgjidhje: të qëndroje e ta kaloje si burrat, ta kaloje me ndershmëri, pa e gënjyer veten dhe pa i bërë bisht...

Raviku ngriti gotën me atë verën e kulluar të lehtë të Provansës, dhe e mbajti në drejtim të dritës... Një natë e freskët, një tarracë e qarkuar nga shushurima e detit, një qiell që shungullon nga të qeshurat e diellit që po na lë lamtumirën dhe nga zilkat e largëta që lajmërojnë ardhjen e yjeve – mendoi ai... Dhe, thellë brenda meje, i ftohtë e verbues, një projektor, i cili depërton në muajt e heshtur të së ardhmes, rrëshqet mbi to dhe i lë përsëri të kredhur në errësirë... Dhe unë e di – dhe kjo dije akoma nuk më dhemb, por do të më dhembë nesër – unë e di se jeta ime po më qëndron edhe kësaj radhe si një gotë në dorë, si një gotë e tejdukshme, e mbushur me verë të huaj, e cila nuk mund të mbetej në të, sepse do të thartohej... do të shndërrohej në uthull të thartë lumturie të prishur...

Nuk do të mbetej!... Në atë jetën e asaj tjetrës çdo gjë ishte akoma vetëm fillim – prandaj edhe nuk mund të mbetej... E pafajme dhe e lehtë, porsi një bimë ndaj dritës, ajo po kthehej ndaj tundimit dhe larmisë joshëse të një jete me më pak andralla. Ajo dëshironte një të ardhme – kurse gjithçka që mund t'i dhuronte ai, ishte vetëm kjo pakëz e tanishme varfanjake... Akoma nuk kishte ndodhur gjë. Por nuk ishte as nevoja që të ndodhte qysh tani. Gjithmonë çdo gjë përcaktohej e vendosej shumë kohë më parë. Por njeriu nuk e dinte këtë dhe, vetëm kur vinte fundi zhurmëmadh, pandehte se ishte ai vendimi i fatthënës, i cili, në të vërtetë, ishte dhënë qëkur, muaj më parë, pa bujë e potere.

Raviku i nxori fundin gotës. Vera e lehtë tani i dukej sikur po i shijonte më ndryshe se qëparë. E mbushi gotën edhe një herë dhe vazhdoi të pinte. Vera kishte përsëri atë shijen e vjetër brusko.

U ngrit, i hipi veturës dhe u nis për në Kanë, drejt e në kazino.

*
* *

Ai luante i qetë dhe me shuma të vogla. Akoma e kishte zemrën akull dhe e dinte që do të fitonte vetëm përderisa ta ndiente atë farë ftohtësie në vetvete. Luajti me dymbëdhjetën e fundit, në katrorin e njëzeteshtatës dhe me njëzeteshtatën. Pas një ore kishte fituar tri mijë franga. I dyfishoi shumat në katror dhe luajti edhe me katrën.

Kur hyri Xhoana në sallë, ai e vuri re. Kishte ndërruar fustan dhe, me sa dukej, duhej të ishte kthyer në hotel fill pasi kishte ikur

Erjonixx

ai. Të dy burrat që patën ardhur ta merrnin me motobarkë, e shoqë-ronin edhe tani. Ai i njihte vetëm me emër – Lëklerk, një belg, dhe Naxhent, një amerikan. Xhoana dukej shumë e bukur. Kishte veshur një fustan mbrëmjeje, të bardhë me lule të mëdha gri. Atë ia pati blerë ai, një ditë përpara se të niseshin për pushime. Ajo pati lëshuar një klithmë gëzimi dhe ishte derdhur mbi të. "Si është e mundur që ti di t'i zgjedhësh kaq mirë fustanet e mbrëmjes?" e pati pyetur. "Është shumë më i bukur sesa imi." Dhe, pasi i kishte hedhur edhe një vështrim të dytë fustanit: "Është edhe shumë më i shtrenjtë!"

Zog, mendoi Raviku. Akoma ndodhesh mbi degët e mia, por flatrat i ke nderë gati për fluturim...

Krupjeri i vuri përpara një grumbull fishash. Katrori kishte fituar. Ai e mori fitimin dhe e la potin në vend. Xhoana iu afrua tryezave të *bakarasë*[1]. Ai s'ishte i sigurt nëse e pati vënë re ose jo. Disa njerëz që nuk merrnin pjesë në lojë, ia mbërthyen sytë Xhoanës duke e vështruar nga pas. Ajo ecte gjithmonë sikur ecte kundër një ere të lehtë dhe sikur drejtohej për diku, nuk ndodhej asgjë. Xhoana ktheu kokën dhe seç i tha Naxhentit – dhe Ravikut iu duk befas sikur i hanin duart për t'i flakur tutje fishat; ndjeu një dëshirë të papërmbajtshme për ta braktisur tryezën e gjelbër, për të brofur në këmbë dhe për ta hequr Xhoanën që andej: të çante me nxit përmes njerëzve dhe dyerve dhe të ikte në një ishull, ndoshta në atë ishullin që nxinte tutje në horizontin e Antibës; të arratisej larg, larg të gjithave, për ta kyçur Xhoanën dhe për ta mbajtur vetëm për vete.

Ai u fut përsëri në lojë. Kishte dalë shtata. Ishujt nuk izolonin dot. Dhe shqetësimit të zemrës nuk mund t'i viheshin kufij; njeriu e humbiste gjithmonë më lehtë atë që mbante ndër krahë – dhe kurrë atë që braktiste... Zari i rrumbullakët filloi të rrokullisej ngadalë. Dymbëdhjeta! Ai vuri përsëri një shumë.

Kur ngriti kokën, sytë iu mbërthyen në vështrimin e Xhoanës. Ajo po qëndronte nga ana tjetër e tryezës dhe po e vëzhgonte. Ai e përshëndeti me krye dhe i buzëqeshi. Ajo s'po ia shqiste sytë. Ai i rrëfeu me shenja *ruletën*[2] dhe ngriti supet. Tani doli nëntëmbëdhjeta.

Raviku vazhdoi lojën dhe pas pak e ngriti përsëri kokën. Xhoana s'ishte më atje. Ai e zotëroi veten dhe qëndroi ulur, atje ku ishte; nga paketa që kishte pranë, nxori një cigare. Njëri nga shërbyesit ia ndezi. Ishte një burrë tullac, pak barkalec, veshur me uniformën e kazinosë.

1. *Bakkarat*: një lloj loje bixhozi.
2. *Roulette*: disk rrotullues i lodrës së fatit (në kazino).

– Kanë ndryshuar kohët tani, – ia bëri ai.
– Po, – tha Raviku. Ai nuk e njihte atë burrin.
– Në njëzetenëntën ishte ndryshe...
– Po...

Raviku nuk e mbante mend në kishte qenë në Kanë më 1929; ndoshta ai mashkulli po ia fuste në tym. Sakaq vuri re që kishte dalë katra dhe ai s'e kishte parë me kohë; u mundua të përqendrohej më tepër në lojë. Por përnjëherësh iu duk budallallëk që po luante me ca franga vetëm e vetëm për të mundur të qëndronte edhe pak ditë më tepër në këto anë. E pse të qëndronte, vallë? Ç'iu desh që erdhi fare? Pati qenë vetëm një dobësi e mallkuar, dhe asgjë tjetër. Jepeshe pas asaj dobësie, i dorëzoheshe, dhe këtë e vije re vetëm pasi thyheshe: Marozovi kishte pasur të drejtë: Rruga më e mirë për të humbur një grua, ishte që t'i tregoje asaj një jetë, të cilën mund t'ia siguroje vetëm për ca ditë. Ajo do të përpiqej pastaj ta rifitonte atë jetë – por me dikë tjetër, i cili do të ishte i zoti t'ia siguronte vazhdimisht... Do t'i them që kjo puna jonë duhet të marrë fund, mendoi ai. Në Paris do të ndahem prej saj përpara se të jetë vonë.

*
* *

Ai po mendohej në ta vazhdonte lojën në ndonjë tryezë tjetër, por e ndjeu se i kishte ikur qejfi. Nuk duhej të merreshe me gjëra të vogla, kur ishe mësuar me gjëra të mëdha. Hodhi sytë përqark. Xhoana nuk dukej gjëkundi. Shkoi në bar dhe rrëkëlleu një konjak. Pastaj doli për të marrë veturën te vendi i parkimit dhe për të bredhur nja një orë vërdallë. Tek po e ndizte makinën, e pa Xhoanën që po rendte drejt tij. Ai zbriti. Ajo iu afrua me një frymë.

– Deshe të ktheheshe në hotel pa mua? – e pyeti ajo.

– Desha të shëtisja një orë në periferi të qytetit e të kthehesha prapë.

– Gënjen! Nuk deshe të ktheheshe prapë! Deshe të më lije këtu me ata idiotët!

– Xhoanë, – tha Raviku. – Tani do të fillosh të më thuash se e kam fajin unë që u bashkove me ata idiotët.

– Po, ti e ke fajin! Unë hipa në barkë vetëm nga marazi! Pse s'ishe në hotel kur u ktheva?

– Po ti sikur kishe lënë takim me ata idiotët, për të ngrënë darkë së bashku?

Erjonixx

Ajo ngurroi për një çast.

– Këtë e bëra vetëm e vetëm sepse s'të gjeta në hotel kur u kthe-va.

– Mirë, Xhoanë, – tha Raviku. – Le ta lëmë tani këtë muhabet. A bëre qejf?

– Jo.

Ajo qëndronte atje përpara tij, në errësirën blu të natës së butë duke marrë frymë me rrëmbim, gjithë emocion dhe inat; hëna pre-hej mbi flokët e saj dhe buzët në fytyrën e zbehtë e guximtare kishin një ngjyrë aq të kuqe të mbyllur, saqë dukeshin të zeza fare. Ishte shkurti i 1939-s dhe në Paris do të ndodhte e pashmangshmja – ajo do të avitej ngadalë e duke u zvarritur tinëzisht, me të gjitha gën-jeshtrat e vogla dhe fyerjet dhe zënkat; ai donte të ndahej prej saj, përpara se të fillonte ajo gjendje... Por tani ndodheshin akoma këtu dhe nuk u mbeteshin veçse pak ditë.

– Ku do të shkosh? – e pyeti ajo.

– S'kam ndonjë cak. Dua vetëm të bredh pak.

– Po vij me ty.

– Po idiotët e tu ç'do të mendojnë?

– Asgjë. Jam përshëndetur me ta. U thashë se më prisje ti.

– Jo keq, – tha Raviku. – Je një fëmijë me mend. Prit, sa të ngre mbulesën e automobilit.

– Lëre hapur. Manteli më mban mjaft ngrohtë. Dhe mos e nga shpejt makinën. Na ço andej përpara kafeneve të shumta, ku rrinë njerëz që s'kanë asnjë punë tjetër, veçse të jenë të lumtur e pa zënka.

Ajo u ul në ndenjësen pranë tij dhe e puthi:

– Është hera e parë që vij në Rivierë, Ravik, – i tha. – Ki mëshi-rë! Është hera e parë që po rri bashkë me ty ashtu siç duhet, dhe netët nuk janë më të ftohta, dhe unë jam e lumtur.

Ai e nxori veturën nga shtjella e qarkullimit të dendur, kaloi për-para hotel *Karltonit* dhe mori drejtim për në Zhuan le Pëns.

– Është hera e parë, – përsëriti ajo. – Hera e parë, Ravik. Dhe unë i di të gjitha që mund të m'i thoshe si përgjigje, por asgjë s'ka të bëjë me të vërtetën. – Ajo u ngjesh pas tij dhe i mbështeti kokën në sup. – Harroje atë që ndodhi sot! As mos e mendo më fare! A e di që e nget makinën për bukuri? Edhe ata idiotët ma thanë këtë. Dje e panë sesi di ta manovrosh automobilin. Ti je i tmerrshëm. Je njeri pa të kaluar. Asgjë s'dihet për ty. Unë di njëqind herë më shumë gjëra nga jeta e atyre idiotëve sesa nga jotja. A thua do të gjejmë diku ndonjë gotë *Kalvados*? Pas gjithë atyre shqetësimeve të sotme, ia ndiej nevo-

jën një gote. Është e vështirë të jetohet me ty.

Vetura shkiste mbi rrugë si një zog që fluturon ultas.

– Mos jam me shpejtësi? – pyeti Raviku.

– Jo. Ngaje më shpejt. Ngaje që të duket sikur fishkëllen era mes degëve të një peme. Sikur nata gjëmon nga stuhia. Jam e zhbiruar e tëra nga dashuria. Dashuria po më bën që ta shoh veten tejpërtej. Të dashuroj aq fort, saqë zemra po më shpaloset ashtu siç shpaloset një grua në një arë gruri përpara një mashkulli që e vështron. Zemra ime kërkon të shtrihet përtokë. Mbi një lëndinë. Ajo çmendet për ty kur nget makinën. Le të mos kthehemi kurrë më në Paris. Eja të vjedhim një valixhe me xhevahire ose një kasafortë banke dhe këtë veturë e të mos kthehemi kurrë më.

Raviku ndaloi përpara një bari të vogël. Hungërima e motorit erdhi e u shua dhe, e butë dhe shumë e largët, u dëgjua përnjëherësh dihatja e thellë e detit.

– Eja, – tha ai. – Këtu do të gjejmë një gotë *Kalvados* për ty. Sa ke pirë gjer tani?

– Shumë. Për fajin tënd. Por edhe gjepurat e atyre idiotëve m'u mërzitën nuk munda t'i duroja më.

– Po pse nuk erdhe atëherë tek unë?

– Unë erdha.

– Po, kur pandehe se po ikja. Ke ngrënë gjë, të paktën?

– Jo shumë. Kam uri. A fitove gjë në kazino?

– Po.

– Atëherë na ço në restorantin më të shtrenjtë. Të hamë havjar e të pimë shampanjë dhe ta ndiejmë veten ashtu si prindërit tanë përpara gjithë këtyre luftërave, ashtu pa telashe dhe sentimentalë, pa frikë, pa druajtje, me shije të keqe sa s'ka, me lot, hënë, trëndafila, violina, det dhe dashuri! Dhe unë do t'ia mbush mendjen vetes sikur do të kemi fëmijë dhe një shtëpi me kopsht dhe ti do të kesh një pasaportë të rregullt dhe një të ardhme të sigurt, dhe sikur për hatrin tënd kam hequr dorë nga një karrierë e shkëlqyer, dhe sikur duhemi çmendurisht edhe pas njëzet vjet dashurie dhe jemi xhelozë për njëri-tjetrin, dhe sikur ti më thua akoma që jam shumë e bukur, dhe mua s'më zë gjumi po të mungosh një natë nga shtëpia, dhe...

Ai vuri re se si i rrëshqisnin lotët përmbi mollëza. Ajo buzëqeshi:

– Të gjitha këto nevojiten, i dashur... Bëjnë pjesë në shijen e keqe.

– Eja, – i tha ai. – Shkojmë në *Shato Madrid*. Ndodhet lart në mal; atje ka një orkestër cigane, dhe do të të jap ç'të dëshirosh.

Erjonixx

*
* *

Ishte mëngjes herët. Poshtë, në thellësi, deti shtrihej gri dhe pa tallaze. Qielli s'kishte as re dhe as ngjyrë. Tej në horizont shquhej një shirit i ngushtë dhe i argjendtë, që ngrihej mbi ujë. Ishte aq qetësi, saqë ata dëgjonin frymëmarrjen e tyre. Nga të gjithë klientët vetëm ata të dy kishin mbetur të fundit. Edhe ciganët qenë varur para tyre tatëpjetë qafës së malit hipur mbi një *Ford* të vjetër. Kamerierët kishin ikur me automobila *Sitroen*, kurse kuzhinieri ishte nisur për të bërë harxhet me një makinë gjashtëvendëshe të markës *Dalahaj*, prodhim i vitit 1929.

– Po agon dita, – tha Raviku. – Diku, në anën tjetër të rruzullit, është akoma natë. Do të vijë një kohë kur do të ketë aeroplanë, me të cilët mund të arrihet nata fluturim. Ata do të kenë po atë shpejtësi, me të cilën rrotullohet toka. Kur të më përkëdhelësh pastaj në orën katër; i biem tokës përqark bashkë me kohën, dhe ora mbetet në vend.

Xhoana u mbështet pas tij.

– S'di si t'ia bëj, s'e kam veten në dorë. Janë çaste të bukura! Janë çaste aq të bukura, saqë mund të të pëlcasë zemra. Ty ndoshta të vjen për të qeshur...

– Po, Xhoanë. Janë çaste të bukura.

Ajo ia nguli sytë.

– Ku është ai aeroplani që përmende? Kur të shpiket ai, ne do të jemi plakur, i dashur. Kurse unë s'dua të plakem. Po ti?

– Po.

– Vërtet?

– Dua të bëhem sa më plak që të jetë e mundur.

– Pse?

– Kam qejf të shoh, se si do t'i vejë halli këtij planetit tonë.

– Unë s'dua të plakem.

– Ti s'do të plakesh. Jeta do të rrëshqasë mbi fytyrën tënde dhe s'do të lërë asnjë gjurmë, dhe ti do të bëhesh edhe më e bukur. Njeriu plaket vetëm kur nuk ndien më.

– Jo, kur nuk dashuron më.

Raviku nuk iu përgjigj. Të të braktisja! mendoi ai. Të të lija ty! Si mundi të më shkonte ndër mend një gjë e tillë ca orë më parë, atje në Kanë?...

Ajo lëvizi në krahët e tij.

Erjonixx

– Tani festa mori fund, dhe unë po kthehem me ty në shtëpi, dhe atje do të flemë bashkë. Sa bukur është e gjitha kjo! Sa bukur është, kur njeriu jeton i tëri dhe jo vetëm me një pjesëzë të tij! Kur është i mbushur gjer në buzë dhe i qetë, sepse s'ekziston më asgjë që mund ta mbushë më tepër! Eja, na ço në shtëpi, në shtëpinë tonë të huajtur, në atë hotelin e bardhë që duket si shtëpizë në mes të një kopshti.

Automobili rrëshqiti tatëpjetë gjarpërushes dhe Raviku nuk e shkeli pothuajse fare pedalin e gazit. Pak e nga pak qielli u çel i tëri. Toka kundërmonte vesë. Raviku i shoi projektorët. Tek po kalonin përgjatë *Kornishës*, u dolën përpara karroca me lule e me perime, që kishin marrë rrugën për në Nisë. Pak më vonë hasën në një kompani *spahinjsh*[1] dhe i lanë pas. Nëpërmes gumëzhitjes së motorit dalluan trokun e kuajve të tyre. Trokëllima e patkonjve dëgjohej qartë dhe dukej disi artificiale mbi atë rrugë të gjerë e të asfaltuar. Fytyrat e kalorësve nxinin nën *burnuset*[2].

Raviku i hodhi një vështrim Xhoanës. Ajo i buzëqeshi. Fytyrën e kishte të zbehtë nga pagjumësia dhe më të brishtë se zakonisht. Ajo fytyrë, me atë hije të ëmbël kapitjeje, iu duk më e bukur se kurdoherë, këtë mëngjes magjik, të qetë dhe akoma të mugët, para të cilit e djeshmja ishte fundosur diku larg, dhe të cilin nuk mund ta matje akoma me orë; ai nderej në hapësirë dhe ishte i pakohë; ishte i shtruar dhe pa frikë dhe pa pyetje...

Përpara tyre doli gjiri i madh i Antibës. Qielli po fekste gjithnjë e më fort. Kundruall ditës së kaltëryer ngriheshin hijet e murrme e të çelikta të katër luftanijeve; tri torpediniera dhe një kryqëzor. Duhej se kishin hyrë në port atë natë. Të ulëta, kanosëse dhe të nemitura, qëndronin përposh qiellit që çelej vazhdimisht. Raviku ktheu kokën nga Xhoana. Atë e kishte zënë gjumi me kokën mbështetur në supin e tij.

1. *Spahi*: ushtarë vendas të kolonive franceze.
2. *Burnuss*: një lloj gune me kapuç, që përdorin fiset nomade të shkretëtirave të Afrikës, Arabisë dhe të Azisë Perëndimore.

Erjonixx

17

Raviku ishte nisur për në klinikë. Kishte plot një javë që qe kthyer nga Riviera. Befas e ndali hapin. Ajo që pa ato çaste, shëmbëllente me një lodër fëmijësh: një godinë në ndërtim e sipër shkëlqente në diell a thua se qe ngritur prej modelesh nga ato të kutive me lodra për fëmijë; skelat ngriheshin drejt qiellit si fije filigrani – dhe kur njëra prej tyre u shkëput dhe një tra bashkë me një figurë filloi të lëshohej dalëngadalë tatëpjetë, u duk sikur po lëshohej përtokë një fije shkrepëseje me një mizë të ngjitur mbi të. U gremis e u gremis, e dukej sikur kjo gremisje s'do të merrte fund kurrë – figura u shkëput nga trari dhe tani kishte trajtën e një kukulle të vogël, që shtrinte krahët dhe mundohej të fluturonte në hapësirë. U duk sikur bota kishte ngrirë për një çast dhe një heshtje varri mbulonte gjithçka. Asgjë nuk pipëtinte – nuk ndihej as erë, as frymëmarrje, as zë – vetëm kukulla e vogël dhe trari i ngrirë gremiseshin e gremiseshin tatëpjetë...

Pastaj, përnjëherësh plasi një potere dhe u shkaktua një katrahurë e madhe. Raviku e kuptoi që edhe ai e pati mbajtur frymën. U shkund dhe ia dha vrapit.

Njeriu që kishte pësuar aksident, qe shtrirë sa gjerë gjatë mbi kalldrëm. Vetëm disa çaste më parë ajo rrugë pati qenë pothuajse fare e shkretë. Tani gumëzhinte e gëlonte nga njerëzit. Ata po sulesheshin nga të katër anët, thua se kishte rënë ndonjë kambanë alarmi. Raviku çau përpara duke i hapur rrugë vetes me bërryla. Vuri re se si dy punëtorë po përpiqeshin ta ngrinin të gremisurin.

– Mos e ngrini! Lëreni shtrirë! – u thirri.

Njerëzit përreth i hapën vend. Të dy punëtorët sapo e kishin

ngritur pak pezull të aksidentuarin.
– Lëshojeni ngadalë. Me kujdes! Ngadalë!
– Çfarë jeni ju? Mjek? – e pyeti njëri nga punëtorët.
– Po.
– Mirë.
Punëtorët e lëshuan të gremisurin mbi kalldrëm. Raviku u gjunjëzua pranë tij dhe nisi ta kontrollonte. Ia shkopsiti me kujdes bluzën tërë djersë, i vuri veshin mbi gjoks dhe ia kaloi duart nëpër trup. Pastaj u ngrit përsëri në këmbë.
– Çfarë ka? – e pyeti ai punëtori që e pati pyetur edhe qëparë. – Ka humbur ndjenjat, ë?
Raviku tundi kokën.
– Çfarë ka? – përsëriti punëtori.
– Ka vdekur, – tha Raviku.
– Ka vdekur?
– Po.
– Por... – belbëzoi punëtori krejt i hutuar, – ne sapo hëngrëm drekë bashkë...
– A ndodhet ndonjë mjek këtu? – pyeti dikush tej rrethit të njerëzve të shastisur që bënin sehir.
– Ç'ka ngjarë? – pyeti Raviku.
– A ndodhet ndonjë mjek këtu? Shpejt!
– Si është puna? – pyeti Raviku
– Ajo gruaja...
– Cila grua?
– E goditi trari! I ka plasur gjaku!
Raviku çau përsëri turmën. Një grua thatime, me një përparëse të madhe bojëqielli, qe shtrirë mbi një grumbull rëre, pranë një grope gëlqereje. Fytyrën tërë rrudha e kishte shumë të zbehtë dhe në të dallohesin një palë sy të palëvizshëm, si dy thëngjij të shuar. Nga qafa i kërcente përpjetë gjaku, si një curril i vogël e i pjerrët shatërvani. Nën kokën e gruas dukej një njollë e madhe dhe e zezë gjaku që rëra e thithte vazhdimisht.
Raviku ia shtypi damarin me gisht. Nga çanta e vogël sanitare që mbante përherë me vete, nxori një top bandazhi.
– Mbajeni pak, – i tha njeriut që kishte më afër.
Katër duar u zgjatën në të njëjtën kohë drejt çantës. Ajo ra mbi rërë dhe u hap. Raviku nxori me nxit një gërshërë dhe preu bandazhin.
Gruaja nuk lëshonte zë fare. As sytë nuk i lëvizte. Ishte krejt e ngrirë dhe çdo muskul të trupit e kishte të tendosur.

Erjonixx

– Gjithçka në rregull, nënoke, – i tha Raviku. – Gjithçka në rregull.

Trari e kishte zënë në shpatull dhe në qafë. Shpatulla i qe copëtuar. Krahu do t'i mbetej i paralizuar.

– Është krahu i majtë, – tha Raviku dhe i kontrolloi zverkun e pastaj këmbët.

Njëra këmbë ishte përdredhur... Çorape gri, të arnuara shpesh, por jo të grisura, të mbajtura me llastika të zeza poshtë gjurit... Sa herë kishte parë të njëjtat gjëra!... Këpucë të zeza me qafa, të arnuara edhe ato, me maja të riparuara dhe me lidhëse të lidhura si fjongo...

– Telefonoi njeri për ndonjë ambulancë? – pyeti ai.

Askush nuk iu përgjigj.

– Më duket se telefonoi polici, – ia bëri dikush pas pak.

Raviku ngriti kokën.

– Polici? Ku është?

– Matanë... tek i vdekuri.

Raviku u ngrit.

– Atëherë qenka çdo gjë në rregull.

Ai u mat të largohej. Atë çast polici çau mes njerëzve dhe iu afrua. Ishte i ri dhe mbante në dorë një bllok shënimesh. Në gojë kishte futur një bisht lapsi dhe po e brente me dhëmbë, i shqetësuar.

– Një minutë, – tha ai dhe filloi të shkruante.

– Këtu është çdo gjë në rregull, – tha Raviku.

– Një minutë, zotëri!

– E kam punën me ngut. Kam një rast urgjent.

– Zotëri, një minutë, ju lutem! Ju jeni mjeku?

– Unë i lidha plagën. Kjo është e gjitha. Tani mbetet vetëm të prisni sa të vijë autoambulanca.

– Vetëm një minutë, zotëri! Më duhet t'jua marr shënim emrin. Ka rëndësi që të jeni dëshmitar. Gruaja mund të vdesë.

– Nuk do të vdesë.

– Kjo s'dihet. Pastaj kemi edhe atë çështjen e dëmshpërblimit.

– Telefonuat të vijë ndonjë ambulancë?

– Me këtë po merret kolegu im. Dhe tani mos më ndërprisni, përndryshe do të humbasim më tepër kohë. Gruaja është gjysmë e vdekur dhe ju dashkeni të ikni, – iu drejtua me qortim Ravikut njëri nga punëtorët.

– Gruaja do të kishte vdekur, po të mos ndodhesha unë këtu.

– E pra, – tha punëtori pa ndonjë lidhje logjike. – E shikoni që duhet të rrini këtu!?

Erjonixx

U dëgjua shkrepja e një aparati fotografik. Një burrë që mbante një kapele me strehë të ngritur nga përpara, zbardhi dhëmbët:

– A mund të pozoni pak e të bëni edhe njëherë sikur po i lidhni plagën? – e pyeti ai Ravikun.

– Jo.

– Jam fotoreporter i shtypit, – tha burri. – Do ta botojmë fotografinë tuaj, me adresë dhe tekst: që ia shpëtuat jetën kësaj gruaje të moshuar. Do të jetë goxha reklamë për ju! Vendosuni këtu, ju lutem... bie drita më mirë...

– Shkoni në djall! – i tha Raviku. – Gruaja duhet çuar urgjent në një spital. Nuk i mjafton vetëm bandazhi. Interesohuni më mirë të vijnë e ta marrin.

– Çdo gjë sipas radhës, zotëri, – shpalli polici. – Më duhet të përpiloj më parë protokollin.

– A të tha i vdekuri si e quajnë? – e pyeti një çunak policin me qesëndi.

– Ti mos llap shumë! – Polici i hodhi një alamet gëlbaze mu përpara këmbëve.

– Fotografojeni edhe një herë nga ky pozicion, – i tha dikush fotoreporterit.

– Pse?

– Që të duket mirë se gruaja ndodhej në trotuarin e rrethuar. Kjo pjesë rruge ishte e mbyllur. Pa shikoni atje? – Ai i rrëfeu me gisht një tabelë të shtrembër me mbishkrimin: *Vini re! Ndalim kalimi!* – Fotografojeni vendin në të tillë mënyrë që të dalë edhe tabela. Kjo na hyn shumë në punë. Për dëmshpërblim as që mund të bëhet fjalë fare në këtë rast!

– Unë jam i shtypit, – tha fotoreporteri duke tundur kokën në shenjë kundërshtimi. – Fotografoj vetëm atë që më duket interesante.

– Po a ka gjë më interesante se kjo? Ja... pamja e vendit të ngjarjes me tabelën në sfond!

– Tabela nuk është interesante. Interesant është vetëm aksioni.

– Atëherë këtë që të thashë, shënojeni ju në protokoll. – Burri i trokiti me gisht në sup policit, thua se po i binte një dere.

– Po ju kush jeni? – e pyeti ky i fundit me inat.

– Jam përfaqësuesi i sipërmarrjes së ndërtimit.

– Bukur fort, – tha polici. – Rrini edhe ju këtu e mos u largoni! – Pastaj iu drejtua gruas: – Si quheni? Besoj se e mbani mend emrin tuaj!

Gruaja lëvizi buzët. Qepallat filluan t'i rrihnin. Si flutura të

Erjonixx

murrme, të kapitura për vdekje, mendoi Raviku, dhe po atë çast tha me vete: Ç'idiot që jam! Duhet t'ia mbath sa më parë që këtej!

– Ta marrë e mira! – ia bëri polici. – Ndoshta e ka lënë mendja fare. Eh, ç'do të na hapë punë! Kurse mua orari i shërbimit më mba-ron më tre.

– Marsel, – belbëzoi gruaja.

– Si? Edhe njëherë, si? – Polici u përkul përsëri mbi të plagosurën.

Por gruaja heshtte.

– Si? – Polici qëndroi në pritje. – Edhe njëherë! Thomani edhe njëherë!

Gruaja heshtte.

– Ju e keni fajin! Ju që më çatë veshët me llafe! – iu hakërrye polici përfaqësuesit të sipërmarrjes së ndërtimit. – As protokollin s'po na lini ta përfundojmë rehat!

Atë çast u dëgjua sërishmi shkrepja e aparatit fotografik.

– Falemnderit, – tha fotoreporteri. – Ishte një pozë shumë e gjallë.

– A e morët edhe tabelën tonë? – e pyeti përfaqësuesi i sipërmarrjes, pa u bërë merak fare për fjalët e policit. – Më lani gjashtë copë fotografi. Po jua paguaj në dorë!

– Jo! – ia preu fotoreporteri. – Unë jam socialist dhe ma ka qejfi t'i tundni ato paratë e sigurimeve shoqërore. A morët vesh, zagar i zgjebosur milionerësh!

U dëgjua ulërima e çjerrë e një sirene. Po vinte autoambulanca. Ky është çasti më i volitshëm, mendoi Raviku. Me kujdes hodhi hapin e parë për të ikur, por polici e mbërtheu për krahu.

– Duhet të vini me ne në rajon të policisë, zotëri. Më vjen keq, por procesverbali duhet të përpilohet në rregull.

Polici i dytë i qëndroi tani në krahun tjetër. Nuk kishte nga t'ia mbante. Më daltë për mbarë, tha me vete Raviku dhe u nis bashkë me ta.

*

* *

Oficeri në rajonin e policisë e dëgjoi në heshtje policin që u mor me përpilimin e protokollit. Tani ai iu drejtua Ravikut:

– Ju nuk jeni francez, – i tha. Kjo nuk ishte pyetje, por konstatim.

– Jo, – tha Raviku.

– Çfarë jeni?

– Çek.

Erjonix

– Si shpjegohet që jeni mjek në Francë? Si i huaj nuk mund ta ushtroni profesionin këtu, po s'patët nënshtetësi franceze.

Raviku buzëqeshi.

– Unë nuk e ushtroj profesionin. Kam ardhur këtu si turist. Për qejfin tim.

– E keni pasaportën me vete?

– A na duhet medoemos pasaporta e tij, Fernan? – e pyeti një oficer tjetër, që ndodhej i pranishëm. – Zotëria e ndihmoi atë gruan dhe ne ia kemi marrë adresën. Besoj se kjo mjafton. Pastaj, ka edhe dëshmitarë të tjerë...

– Më intereson ta di... E keni pasaportën ose letërnjoftimin me vete?

– Natyrisht që jo, – tha Raviku. – Kush rri e mban gjithnjë pasaportën me vete?

– Ku e keni?

– Në konsullatë. E çova përpara një jave për të zgjatur vizën.

Raviku e dinte që, po të thoshte se e kishte pasaportën në hotel, do t'i jepnin një polic me vete e do ta çonin për ta marrë; kështu gënjeshtra do të dilte në shesh menjëherë. Ndërsa, duke përmendur konsullatën, shanset ishin më të mira për të.

– Në cilën konsullatë? – pyeti Fernani.

– Në atë çeken. E ku gjetkë?

– Ne mund ta marrim tani në telefon e të pyesim. – Fernani ia nguli sytë Ravikut.

– Natyrisht që mund ta bëni këtë gjë.

Një copëherë Fernani nuk foli fare.

– Në rregull, – ia bëri pastaj. – Pa të telefonojmë njëherë.

Ai u ngrit nga karrigia dhe u fut në dhomën ngjitur. Shoku i vet filloi ta ndiente veten keq.

– Të na falni, zotëri, – i tha ai Ravikut. – Natyrisht që e gjithë kjo s'ishte aspak e nevojshme. Por do të sqarohet menjëherë. Ju jemi shumë mirënjohës për ndihmën tuaj.

Do të sqarohet, mendoi Raviku... Teksa po nxirrte një cigare nga paketa, vështroi i qetë rreth e qark. Polici qëndronte pranë derës. Por kjo ishte vetëm një rastësi. Gjer tani askush s'e kishte parë me sy vërtet të dyshimtë. Ai mund t'i jepte një të shtyrë policit dhe t'ia mbathte – por në dhomë ndodheshin edhe ai përfaqësuesi i sipërmarrjes së ndërtimit dhe dy punëtorë. Ai hoqi dorë. Ishte vështirë të shpëtonte; me siguri përjashta do të kishte edhe policë të tjerë.

Fernani u kthye.

– Në konsullatë nuk ndodhet ndonjë pasaportë me emrin tuaj.
– Ka mundësi, – ia priti Raviku thatë.
– Si paska mundësi?!
– Një nëpunës që ju doli në telefon, nuk mund t'i dijë të gjitha. Atje ka një gjysmë duzine njerëz që merren me këto punë.
– Ai që foli me mua e dinte punën mirë.
Raviku nuk i dha përgjigje.
– Ju nuk jeni çek, – tha Fernani.
– Dëgjo këtu, Fernan... – ia nisi shoku i tij.
– Gjuhën nuk e flisni me theks çek, – tha Fernani.
– Ka mundësi.
– Ju jeni gjerman, – deklaroi Fernani me ton ngadhënjimtar. – Dhe nuk keni pasaportë fare!
– Jo, – ia priti Raviku. – Jam maroken dhe kam gjithë pasaportat franceze të botës.
– Zotëri! – ulëriti Fernani. – Si guxoni? Po fyeni Perandorinë koloniale franceze!
– Punë muti! – murmuriti njëri nga punëtorët. Përfaqësuesi i sipërmarrjes së ndërtimit bëri një grimasë, sikur do të brofte në çast më këmbë e do të salutonte.
– Fernan, mos e zgjat tani...
– Ju gënjeni! Nuk jeni aspak çek! Keni apo s'keni pasaportë? Përgjigjuni!
Ja, kur te njeriu ngre kokë instinkti i miut të gjirizit, mendoi Raviku. Miu i fëlliqur që s'mund të mbytet kurrë në shpirtin e njeriut! Ç'i duhej këtij maskarai në kam apo s'kam pasaportë? Por miu nuhat diçka dhe përnjëherësh sulet dhe del nga vrima...
– Përgjigjuni, po ju them! – hungëroi Fernani.
Një copë letër! E ke apo s'e ke? Kjo krijesë e pështirë do të të kërkonte ndjesë e do të të bënte dy-tri temenara, po t'ia paraqisje atë copëzë letër. S'do të kishte rëndësi pastaj në kishte vrarë një familje të tërë apo në kishte grabitur një bankë – ai, megjithatë, do të të salutonte! Por edhe vetë Krishti, po ta kishin kapur këta pa pasaportë, do të kalbej në burg. Do ta kishin vrarë shumë kohë përpara se të mbushte të tridhjetë e tre vjetët e tij...
– Ju do të qëndroni këtu derisa të zgjidhet kjo çështje, – tha Fernani. – Dhe unë do ta zgjidh se s'bën!
– Bukur fort, – tha Raviku.
Fernani doli nga dhoma i ngrefosur. Shoku i tij i zyrës filloi të gërmonte nëpër shkresurina.

– Zotëri, – i tha pastaj Ravikut. – Më vjen vërtet shumë keq. Por ai në këso punësh është i tmerrshëm.

– S'prish punë.

– Po me ne a mbaruat? – pyeti njëri nga punëtorët.

– Po.

– Mirë. – Punëtori iu kthye Ravikut: – Kur të shpërthejë revolucioni botëror, s'do t'ju nevojitet më pasaporta.

– Duhet të dini një gjë, zotëri, – ia nisi përsëri nëpunësi tjetër i policisë. – Fernanit i është vrarë i ati në Luftën Botërore. Prandaj i urren gjermanët dhe bën të tilla marifete. – Ai e vështroi Ravikun me druajtje. – Më vjen jashtëzakonisht keq, zotëri. Po të kisha qenë vetëm...

– S'ka gjë. – Raviku vështroi përreth. – A mund të telefonoj njëherë, përpara se të na kthehet ky Fernani?

– Patjetër. Ja tek e keni telefonin. Shpejtoni!

Raviku mori Marozovin. Ia shpjegoi gjermanisht, çfarë i kishte ndodhur dhe i tha të lajmëronte Veberin.

– Po Xhoanën? – pyeti Marozovi.

Raviku ngurroi.

– Jo, mos i trego hëpërhë atë që më pret. I thuaj vetëm se më kanë mbajtur këtu, por për dy ose tri ditë do të rregullohet gjithçka. Kujdesu për të.

– Mirë, – tha Marozovi, por zëri i tij s'ishte aspak entuziast. – Mirë, Voçek i dashur.

Raviku e lëshoi receptorin në çastin kur po kthehej Fernani.

– Në ç'gjuhë po flisnit ashtu, çekisht? – e pyeti ky duke u zgërdhirë.

– Esperanto, – ia priti Raviku.

*

* *

Veberi i erdhi të nesërmen paradreke.

– Ç'furrik i poshtër, – tha duke vështruar rretheqark.

– Burgjet francezë kanë mbetur akoma burgje të sakta, – iu përgjigj Raviku. – S'ka filluar t'u bjerë sëmundja e humanizmit. Kutërbon ndyrësia e shekullit XVIII.

– Punë dreqi, – tha Veberi. – Punë dreqi që ratë brenda ashtu kotsëkoti.

– Dihet se po të bësh mirë, gjen keq. Duhej ta kisha lënë atë grua të vdiste. S'ke ç'i bën, Veber. Jetojmë në një epokë të hekurt.

– Në një epokë gize. A i ranë në të ata birçet e policisë që jetoni ilegalisht këtu?

– S'do mend.

– E zbuluan edhe adresën?

– Natyrisht që jo. S'kam aspak ndër mend t'i bëj keq *Internacionalit* plak! Hotelieres do t'i këpusnin një gjobë të mirë, pse mban klientë të paregjistruar. Dhe policia do të bënte një bastisje dhe do të shtinte në dorë me siguri të paktën një duzinë refugjatë. Këtë radhë u dhashë si adresë hotelin *Lankastër*. Një hotel i vogël, por luksoz dhe me nam shumë të mirë. Kam banuar dikur në të, kur bëja, si të thuash, jetën time të mëparshme.

– Dhe tani quheni Voçek?

– Vladimir Voçek. – Raviku u skërmit. – Është i katërti emër që i kam ngjitur vetes.

– Punë dreqi! – ia bëri Veberi përsëri. – Ç'mund të bëj për ju, Ravik?

– S'mund të bëni pothuajse asgjë, Veber. Kryesorja është që ata të mos e marrin vesh se kam qenë dhe kam jetuar edhe disa herë të tjera në Paris. Ndryshe do të ha nja gjashtë muaj burg.

– Punë dreqi!

– E po ç't'i bësh, kështu kanë ardhur kohët. Bota po na bëhet dita-ditës e më njerëzore. Jeto me rreziqe! ka thënë një filozof dikur. Dhe emigrantët atë po bëjnë... vetëm se e bëjnë nga zori.

– Po sikur të mos e zbulojnë?

– Atëherë do të më mbajnë brenda të shumtën dy javë. Pastaj, sipas zakonit, do të më dëbojnë jashtë Francës.

– E pastaj?

– Pastaj do të kthehem përsëri.

– Gjersa t'ju zënë prapë!

– Tamam. Bile këtë radhë zgjati ca si shumë. Dy vjet. Një jetë e tërë!

– Duhet të bëjmë medoemos diçka. Kështu nuk vazhdohet.

– Vazhdohet edhe kështu. E ç'mund të bëni?

Veberi u mendua.

– Dyrani! – u hodh pastaj përnjëherësh. – Patjetër që duhet t'ia them Dyranit! Ai njeh gjithë ata njerëz dhe i shkon fjala... – Veberi i ra ballit me dorë. – O zot, tani po kujtohem! Po ju vetë operuat një-rin prej atyre bosëve! Atë me mëshikëzën e tëmthit.

– Jo unë, Dyrani.

Veberi qeshi.

– Natyrisht që s'mund t'ia përmend troç këtë fakt plakut. Por do t'i bëj thirrje shpirtit të tij.

– S'ma ha mendja të arrini gjë. S'ka shumë kohë që i zhvata Dyranit dy mijë franga. Dhe një tip si ai s'ta harron kollaj këtë gjë.

– Do ta harrojë, – tha Veberi që kishte filluar të bëhej në qejf. – Do t'i hyjë frika se mos ia nxirrni në shesh punën e operacioneve kontrabandë. Ju keni bërë me dhjetëra operacione për të. Nga ana tjetër, jua ka nevojën shumë!

– S'do ta ketë vështirë të gjejë ndonjë tjetër. Binonë ose ndonjë kirurg refugjat. Ka sa të duash nga ata.

Veberi fërkoi mustaqet.

– Një si ju nuk gjen dot. Sidoqoftë, ta provojmë njëherë. Do t'i futem kësaj pune qysh sot. Po këtu me se mund t'ju ndihmoj? Ushqimi si është?

– Për faqe të zezë. Por më lejojnë të porosis edhe nga jashtë.

– Me cigare si jeni?

– Kam mjaft. Atë që më duhet vërtet, ju s'ma rregulloni dot: një banjë!

*

* *

Raviku jetoi plot dy javë në një qeli me një montator hebre, me një shkrimtar gjysmëhebre dhe me një polak. Montatorin e kishte pushtuar një mall i madh për Berlinin; shkrimtari e urrente tani atë qytet; kurse polaku s'e çante kokën për asgjë. Raviku kishte marrë përsipër furnizimin me cigare. Shkrimtari rrëfente anekdota të kripura çifute. Montatori ishte usta në zhdukjen e erërave të këqija.

Pas dy javësh Ravikun erdhën dhe e morën. Në fillim e çuan te një inspektor policie, i cili e pyeti në kishte para me vete.

– Po, kam.

– Mirë. Atëherë mund të merrni një taksi.

Një nëpunës e shoqëroi. Rruga ishte gjithë dritë e diell. Sa mirë kur njeriu ndodhej përsëri në ajër të pastër! Në trotuar, pranë hyrjes, një plak shiste tullumbace. Raviku s'po e gjente dot me mend pse e bënte këtë mu përpara burgut. Nëpunësi i bëri shenjë një taksie.

– Ku do të shkojmë? – e pyeti Raviku.

– Te shefi.

Raviku nuk e dinte se çfarë shefi na ishte ky. Por as nuk ishte fort kureshtar, përderisa nuk qe shefi i ndonjë kampi përqendrimi

gjerman. Në botë ekzistonte vetëm një lloj tmerri i vërtetë: kur njeriu ndodhej i tërë nën mëshirën e një terrori brutal dhe pa asnjë mundësi të mbrohej. Kurse kjo këtu ishte punë pa zarar.

Taksia kishte një radio. Raviku e ndezi. Stacioni po jepte njoftime mbi tregun e zarzavateve; pastaj dhe lajme politike. Nëpunësi i policisë gogësiu. Raviku rrotulloi butonin më tej. Muzikë e lehtë. Nëpunësi u çel në fytyrë.

– Këndon Sharl Trëneja, – tha ai. – *Mënilmontan.*[1] Kryevepër!

Taksia ndaloi. Raviku pagoi. E çuan në një sallë pritjeje, e cila, si të gjitha sallat e tilla në botë, binte erë pasigurie, djerse dhe pluhuri.

Ndenji atje një gjysmë ore duke shfletuar një numër të vjetër të revistës *La vi parizienë*, që e kishte lënë dikush tjetër atje. Ngaqë kishte dy javë pa lexuar gjë prej gjëje, ajo iu duk si letërsi klasike. Pastaj e thirrën te shefi.

Iu desh ca kohë, gjersa iu kujtua ku e kishte parë këtë burrë të shkurtër e topolak. Zakonisht, kur operonte, nuk u kushtonte vëmendje fytyrave të pacientëve. Ato i bënin po aq pak përshtypje sa edhe numrat. Ajo që i interesonte, ishte vetëm pjesa e sëmurë. Por këtë fytyrë ai e pati parë me kureshtje. Ja tek po i rrinte përballë Lëvali, dora vetë, shëndoshë e mirë, me barkun majuc përsëri të rritur, pa mëshikëz tëmthi. Ravikut i kishte dalë nga mendja që Veberi do t'i drejtohej Dyranit për hallin e tij, dhe as që e priste se do ta çonin te Lëvali personalisht.

Lëvali e mati njëherë nga lart poshtë. Kjo soditje zgjati mjaft kohë.

– Natyrisht që ju s'e keni emrin Voçek, – hungëroi pastaj.

– Jo.

– Po si quheni?

– Nojman. – Raviku kishte rënë në ujdi me Veberin për këtë. Dhe ky ia kishte thënë Dyranit. Emri Voçek tingëllonte si tepër i stisur.

– Jeni gjerman, apo jo?

– Po.

– Refugjat?

– Po.

– Kjo s'dihet kurrë. S'më dukeni si i tillë.

– Jo të gjithë refugjatët janë hebrenj, – ia priti Raviku thatë.

– Pse gënjyet për punën e emrit?

Raviku ngriti supet.

---

1. *Menilmontant*: një lagje e jashtme e Parisit.

– Ç'të bëjmë tjetër? Ne gënjejmë sa më pak që të jetë e mundur. E bëjmë nga zori, jo nga qejfi.

Lëvali erdhi e u fry si gjel.

– Mos pandehni vallë që ne na e ka qejfi të merremi vazhdimisht me ju?

Në atë kohë ai kishte marrë i tëri ngjyrën gri, iu kujtua Ravikut. Fytyra i ishte zbardhur si çarçaf, sytë i kishte të buhavitur e me qeska mavi, gjuha i varej jashtë... Në ato çaste ti nuk flisje fare; ishte vetëm një pirg mishi i ënjtur, me një mëshikëz tëmthi të kalbur...

– Ku banoni? Edhe adresën e kishit dhënë gabim!

– Kam banuar ku kam mundur. Herë këtu e herë atje.

– Sa kohë keni në Paris?

– Tri javë. Para tri javësh erdha nga Zvicra. Më dëbuan jashtë kufirit. Ju e dini që ne, si ilegalë dhe pa dokumente, s'kemi të drejtë të jetojmë në asnjë vend, por ja që shumica s'po vendosim dot akoma të vrasim veten. Kjo është arsyeja pse ju nxjerrim telashe.

– Të kishit qëndruar atje ku ishit, në Gjermani, – hungëroi Lëvali. – Atje s'është edhe aq keq sa ç'e bëjnë. Bota i zmadhojnë gjërat.

Të ta kisha bërë prerjen pak më ndryshe, mendoi Raviku, dhe ti s'do të rrije tani këtu, në kolltukun tënd, duke llapur kështu në tym. Krimbat do të kishin hyrë në kufirin tënd pa dokumente dhe ti do të ishe shndërruar në një grusht hiri brenda një urne të shëmtuar...

– Ku banonit këtu? – pyeti Lëvali.

Ta ka qejfi ta marrësh vesh, ë? tha me vete Raviku. Që të kapësh edhe të tjerët!

– Ndër hotele të mira, – iu përgjigj. – Regjistrohesha me emra të ndryshëm dhe rrija vetëm pak ditë në një vend.

– Kjo s'është e vërtetë.

– Pse më pyesni kur e ditkeni më mirë, – i tha Raviku, të cilit dalëngadalë po i mbushej kupa.

Lëvali, tërë inat, përplasi shuplakën mbi tryezë.

– Mos e teproni!

Pastaj ngriti dorën me rrëmbim dhe e pa me vërejtje pëllëmbën.

– U pretë, sepse i ratë gërshërës, – i tha Raviku.

Lëvali futi dorën në xhep.

– A e kuptoni që jeni një njeri mjaft arrogant? – iu drejtua ai befas Ravikut me qetësinë e atij që s'e ka për gjë ta përmbajë veten, kur e di që tjetrin e ka krejtësisht në dorë.

– Arrogant? – Raviku e vështroi me habi. – Arrogancë i thoni kësaj? Këtu ne s'jemi as në shkollë dhe as në ndonjë azil për keqbë-

rës të penduar! Unë veproj nga e keqja dhe mbrohem si të mundem; kurse ju dashkeni që ta ndiej veten si ndonjë maskara i regjur, që i përgjërohet gjykatësit për mëshirë! Dhe kjo vetëm e vetëm sepse nuk jam nazist e prandaj nuk kam as dokumente?! Që ne nuk e konsiderojmë veten ende si kriminelë, megjithëse i kemi njohur burgjet, torturat, Gestapon dhe të gjitha llojet e poshtërimeve, vetëm e vetëm sepse donim të mbeteshim gjallë – kjo është e vetmja gjë që na mban akoma!... Nuk arrikeni ta kuptoni dot këtë? Mendoj se kjo mund të jetë çdo gjë, por kurrsesi arrogancë!

Lëvali nuk i dha asnjë përgjigje, por e pyeti:

– E keni ushtruar profesionin në Paris?

– Jo.

Tani shenjën e plagës duhet ta ketë më të vogël, mendoi Raviku. I pata bërë një qepje të shkëlqyer, megjithëse unë e di ç'hoqa me gjithë atë dhjamë! Por ndërkohë na paska vënë përsëri bark, zotëria e tij. Qenka zhdëpur së ngrëni e së piri...

– Ja ku qëndron rreziku më i madh, – ia nisi Lëvali nga leksioni. – Pa diplomë e pa kontroll ju bridhni këtu poshtë e lart. Dhe kushedi qysh kur keni ardhur! Mos t'ju gënjejë mendja që ju besova kur më thatë se keni vetëm tri javë në Paris! Kush mund ta dijë se ku e në ç'punë të fëlliqura i keni futur ato duart tuaja?!

Në atë kacekun tënd, me ata damarët e fortë, me atë mëlçinë e fryrë e me atë tëmthin e kalbur, mendoi Raviku. Dhe po të mos i kisha futur unë duart aty, ai miku yt Dyrani do të të kishte degdisur në atë botë, dhe bile do të kishte marrë më shumë famë si kirurg e do t'i kishte ngritur pastaj edhe çmimet e tij...

– Këtu qëndron pra rreziku më i madh, – përsëriti Lëvali. – Duke mos pasur leje të ushtroni profesionin, ju i futeni çdo gjëje që ju del përpara. Kjo është më se e qartë! E kam biseduar këtë çështje me njërin prej autoriteteve tona në këtë fushë. Dhe ai ishte plotësisht i një mendjeje me mua. Në paçi sadopak haber nga shkenca e mjekësisë, duhet ta keni dëgjuar emrin e tij...

Mos, o zot! mendoi Raviku. Mos e lejo që të ma përmendë tani emrin e Dyranit! Kjo s'ka si të jetë e vërtetë! Jeta s'para bën të tilla shakara pa kripë!...

– Është profesor Dyrani, – tha Lëvali tërë dinjitet. – Ai ma shpjegoi si qëndron çështja: Infermierë, studentë, masazhatorë, asistentë... e gjithë kjo kope na shiten këtu sikur janë doktorë të mëdhenj të ikur nga Gjermania. E kush mund ta kontrollojë dot tërë këtë lukuni?! Ndërhyrje kirurgjike të palejuara, aborte, bashkëpunime

me mamira, me kodoshe... Një zot e di se ç'bëhet! Dhe ne s'kemi mundësi që të tregohemi vigjilentë sa ç'duhet!

Dyrani! mendoi Raviku. Ja dhe hakmarrja e tij për ato dy mijë frangat e qelbura! Po kush ia bën vallë tani operacionet? Sigurisht Binoi. Do të jenë pajtuar përsëri...

Ai e kuptoi që s'po ua vinte më veshin dërdëllitjeve të Lëvalit. Vetëm kur u përmend emri i Veberit, i hapi veshët mirë.

– Njëfarë doktor Veber ndërmjetësoi për ju. E njihni?

– Shumë pak.

– Ai erdhi këtu. – Për disa çaste Lëvali i nguli sytë si i përhumbur në një pikë. Pastaj teshtiti me potere, nxori një shami nga xhepi, pastroi hundët mirë e mirë, vështroi atë që nxori nga hundët, palosi shaminë dhe e futi prapë në xhep. – Nuk kam si t'ju ndihmoj. Na duhet të tregohemi rigorozë. Do të nxirreni jashtë kufirit.

– E di.

– A keni qenë herë tjetër në Francë?

– Jo.

– Gjashtë muaj burg, po të ktheheni prapë! E dini këtë?

– Po.

– Do të interesohem që t'ju nxjerrin sa më shpejt jashtë kufirit. Kjo është e gjitha që mund të bëj për ju. Keni të holla?

– Kam.

– Në rregull. Atëherë duhet të paguani udhëtimin gjer në kufi për vete dhe për policin që do t'ju shoqërojë. – Lëvali bëri një shenjë me kokë. – Mund të shkoni.

*
* *

– Mos duhet të kthehemi në ndonjë orë të caktuar? – e pyeti Raviku nëpunësin që po e shoqëronte përsëri për në burg.

– Jo. Varet. Pse pyesni?

– M'u tek të pi një aperitiv.

Nëpunësi i policisë e vështroi nga lart-poshtë.

– Nuk ju iki, – i tha Raviku, nxori një kartëmonedhë njëzetfrangëshe dhe filloi ta përdridhte nëpër gishtërinj.

– Mirë. Disa minuta nuk prishin punë.

Ata e ndaluan taksinë para barit më të afërt. Përjashta, në trotuar, ishin nxjerrë ca tryeza. Bënte mjaft fresk, por kishte diell.

– Ç'dëshironi të merrni? – e pyeti Raviku.

– Një *Amer Pikon*. Në këtë kohë nuk fus gjë tjetër në gojë.

Raviku iu drejtua kamerierit:

– Kurse mua më sillni një gotë të madhe me konjak, pa ujë!

Ai rrinte i qetë dhe mbushte gjoksin me frymë. Ajër... Sa i shtrenjtë e i dashur mund të bëhej ky ajri! Degët e pemëve buzë trotuarit kishin çelur bulëza të shndritshme ngjyrëkafe. Ndihej aromë buke të freskët dhe vere të re. Kamerieri solli gotat.

– Ku ndodhet telefoni? – e pyeti Raviku.

– Brenda në lokal. Djathtas, pranë WC-së.

– Por... – ndërhyri nëpunësi.

Raviku ia la në dorë njëzetfrangëshin.

– Mund ta merrni me mend vetë se kujt dua t'i telefonoj. Ju thashë që s'kam ndër mend t'ia mbath. Në daçi, më shoqëroni. Ejani.

Nëpunësi nuk ngurroi shumë.

– Mirë, – tha dhe u ngrit. – Fundja, njerëz jemi.

* * *

– Xhoanë...

– Ravik! O zot i madh! Nga flet? Të liruan? Thuajmë, ku je...

– Në një bar.

– Lëri shakatë. Thuajmë, ku ndodhesh?

– Ndodhem në një bar.

– Qysh? Nuk qenke më në burg! Ku ishte tërë këto ditë? Ai Marozovi i djallit...

– ... të ka thënë aq sa duhej të të thoshte.

– Ai s'më tregoi as se ku të çuan. Do të kisha ardhur menjëherë...

– Prandaj nuk ta tregoi, Xhoanë. Ishte më mirë ashtu.

– Pse më telefonon nga një bar? Pse nuk vjen këtu?

– Nuk mund të vij. Kam pak minuta kohë. Mezi ia mbusha mendjen nëpunësit të policisë të ndalonim ca këtu... Xhoanë, pas dy-tri ditësh do të më përcjellin për në Zvicër, por... – Raviku hodhi sytë nga xhami i kabinës telefonike. Nëpunësi ishte mbështetur pas banakut dhe bënte muhabet. – ...Por do të kthehem shumë shpejt. – Raviku heshti dhe priti që të fliste ajo.– Xhoanë!...

– Po vij. Po vij menjëherë te ti. Ku ndodhesh?

– Nuk ke si vjen! Ndodhem gjysmë ore larg teje dhe kam vetëm pak minuta kohë.

– Prishja mendjen atij policit të djallit! Jepi para! Të sjell unë para!

– Xhoanë, – tha Raviku. – Nuk bën. Është më thjesht kështu. Është më mirë. – Ai dëgjoi frymëmarrjen e saj të vrullshme.

– Nuk dashke të më shohësh? – ia bëri ajo pastaj.

E kam shumë vështirë me të, nuk duhej t'i kisha telefonuar fare, mendoi Raviku. Si mund t'ia shpjegoje tjetrit diçka, pa mundur ta shikoje në sy!

– E vetmja dëshirë që kam është të të shoh ty, Xhoanë!

– Atëherë eja! Le të vijë edhe ai burri me ty!

– Punë që s'bëhet. Nuk flas dot më gjatë. Po tregomë shpejt, ç'je duke bërë?

– Qysh? Ç'do të thuash? S'po të kuptoj?

– Çfarë ke veshur? Ku je?

– Në dhomën time. Jam në shtrat. Mbrëmë rashë shumë vonë. Por për dy minuta mund të vesh diçka e të vij shpejt.

Mbrëmë... Shumë vonë... Realiteti! Gjithçka vazhdonte rrjedhën e vet, edhe pse tjetri hynte në burg. Kjo harrohej. Në shtrat... gjysmë e përgjumur... tufa e flokëve e ngatërruar mbi jastëk... nëpër karrige hedhur pa kujdes çorape, ndërresa, një fustan mbrëmjeje... Atij po i faniteshin të gjitha këto dhe filluan t'i merreshin mendtë. Vështroi xhamin e kabinës telefonike, të veshur nga fryma e tij e nxehtë; dalloi atje tej edhe kokën e nëpunësit të policisë, që dukej sikur notonte në një akuarium... U shkund dhe e mblodhi veten:

– Më duhet të iki tani, Xhoanë. Nuk flas dot më gjatë.

Dëgjoi zërin e saj të drithëruar, zërin e një njeriu krejtësisht të shushatur:

– Po kjo është e pamundur! Si mund të ikësh kështu, xhanëm? Dhe unë s'di asgjë, s'di se ku, s'di...

Tani ajo duhet të jetë e mbështetur mbi bërryla, atje në shtrat, jastëkët flakur mënjanë – mendoi Raviku. Telefonin të shtrënguar në dorë si një armë, drejtuar kundër dikujt, kundër një armiku të padukshëm, të panjohur... sytë shkreptimtarë nga emocioni... ose të errësuar nga marazi...

– Po unë s'po shkoj në luftë! Ja, zëre sikur më duhet të bëj një udhëtim deri në Zvicër. Do të kthehem, shpejt. Ose zëre sikur jam një afarist që do t'i shesë Lidhjes së Kombeve një kontigjent mitralozësh..

– Dhe kur të kthehesh, po kjo histori nga e para! S'do të jetoj dot nga frika!

– Thuaje edhe njëherë këtë të fundit.

– Pse, a s'është e vërtetë! – Zëri i dridhej nga inati. – Unë jam e fundit që marr vesh diçka! Veberi ardhka e të vizitoka, kurse unë jo!

Marozovit i telefonoke menjëherë, kurse mua jo! Dhe tani po ikën...
– O zot! – tha Raviku. – Pse u dashka të zihemi tani, Xhoanë?
– Unë nuk po zihem. Po të them vetëm atë që është.
– Mirë. Më duhet të shkoj tani. Mbetsh me shëndet, Xhoanë!
– Ravik! – thirri ajo. – Ravik!
– Fol...
– Eja prapë! Kthehu! Pa ty jam e humbur!
– Do të kthehem!
– Premtoma...
– Mbetsh me shëndet, Xhoanë! Do të shihemi shpejt.

Ai qëndroi disa çaste në kabinën e ngrohtë, ku ajri ishte i rëndë e mbytës. Pastaj vuri re se po shtrëngonte akoma receptorin në dorë. Hapi derën. Nëpunësi i policisë ngriti sytë dhe i buzëqeshi me mirëdashje.
– Mbaruat?
– Po.

Ata u kthyen te tryeza e tyre, përjashta. Raviku e zbrazi gotën. Nuk duhej t'i kisha telefonuar, mendoi. Qëpari isha i qetë. Tani jam çakërdisur fare. Duhej të më kishte shkuar ndër mend që një bisedë telefonike këtë pasojë do të kishte – si për mua ashtu edhe për atë... E pushtoi tundimi të kthehej sërish e ta merrte prapë në telefon, për t'ia thënë të gjitha që kishte pasur ndër mend t'i thoshte në të vërtetë. T'ia shpjegonte pse nuk kishte mundësi ta takonte: që ai nuk donte që ajo ta shihte si ishte katandisur – kështu të pistë e nën mbikëqyrje... një i burgosur!
– Më duket se erdhi koha të nisemi, – i tha nëpunësi.
– Po...

Raviku i bëri me shenjë kamerierit.
– Sillmëni dy shishe të vogla konjaku, të gjitha gazetat që keni dhe një duzinë paketa cigaresh *Kaporal*. Edhe llogarinë! – Ai i hodhi një vështrim nëpunësit. – Gjithçka në rregull, apo jo?
– Njerëz jemi, – tha nëpunësi.

Kamerieri solli shishet, gazetat dhe cigaret.
– M'i hiqni tapat qysh tani, – i tha Raviku, ndërsa po i mbushte gjithë xhepat me paketat e cigareve. I rrasi përsëri tapat në grykat e shisheve, në mënyrë që të mund t'i hapte pastaj me lehtësi dhe i futi në xhepat e brendshëm të palltos.
– Qenkeni usta, – i tha nëpunësi.
– Çështje përvoje, – tha Raviku. – Kur isha i vogël s'më kishte shkuar kurrë ndër mend se në këtë moshë do të më duhej të luaja përsëri mbyllasyzash.

Erjonixx

*
* *

Polaku dhe shkrimtari u gëzuan pa masë për konjakun. Montatori s'para i kishte qejf pijet e forta. I pëlqente vetëm birra dhe vazhdimisht llomotiste se sa e mirë ishte birra në Berlin. Raviku u shtri mbi shtratin prej dërrase dhe zuri t'i lexonte gazetat një për një. Polaku nuk lexonte; ai s'merrte erë kurrkund nga frëngjishtja. Pinte vetëm cigare dhe ishte i lumtur. Natën vonë montatori zuri të qante. Raviku ishte akoma zgjuar. Përgjonte dënesat e mbytura dhe sodiste dritaren e vogël, pas së cilës farfurinte qielli i zbehtë. Nuk kishte gjumë. Nuk e zuri as më vonë, kur montatori shfreu sa shfreu dhe u qetësua. Ka jetuar shumë më mirë nga ç'duhet, mendoi Raviku. Ka njohur tepër, e tani i dhemb, sepse nuk i ka më...

18

Raviku po vinte nga stacioni i trenit. Ishte i kapitur dhe i ndotur. Kishte udhëtuar trembëdhjetë orë në një tren të nxehtë furrë, mes njerëzish që qelbeshin erë hudhër, gjahtarësh me zagarët e tyre me vete, grash me shporta pulash e pëllumbash në prehër. Dhe përpara kësaj – ishte sorollatur plot tre muaj kufirit...

Në mugëtirë seç vezullonte dhe atij iu vranë sytë. Vezullonte e llamburiste a thua se rretheqark *Ron Puenit*[1] ishin vendosur piramida pasqyrash, që hidhnin e pritnin dritën e murrme të kësaj dite nga të fundmet e majit.

Ai ndali çapin dhe vështroi me vëmendje në atë drejtim. Ishin vërtet piramida pasqyrash, të vendosura kudo pas shtretërve të mbjellë me tulipanë, si fantazma të frikshme, të vëna në radhë.

– Ç'janë këto? – e pyeti kopshtarin, i cili, aty pranë tij, po sheshonte dheun e një shtrati.

– Pasqyra, – iu përgjigj kopshtari, pa ngritur sytë fare.

– E shoh që janë pasqyra. Por kur isha herën e fundit këtu, nuk m'i kishte zënë syri.

– Keni kohë pa kaluar këtej?

– Tre muaj.

– Ah, tre muaj! Këto i kanë rregulluar tani shpejt, dy javët e fundit. Për mbretin e Anglisë. Do të na urdhërojë për vizitë. Pastaj mund ta shohë mirë surratin e vet në to.

– Ç'marrëzi! – ia bëri Raviku.

– S'do mend, – tha kopshtari, pa u habitur aspak.

1. *Rond Point:* Shesh i rrumbullakët ku zënë fill shumë rrugë.

Erjonixx

Raviku vazhdoi rrugën. Tre muaj... tre vjet... tri ditë... E ç'ishte koha? Asgjë dhe gjithçka. Që gështenjat po lulëzonin – ndërsa atëherë s'kishin pasur asnjë gjethe, që Gjermania kishte shkelur përsëri me të dyja këmbët njërën prej marrëveshjeve të saj dhe kishte pushtuar krejt Çekosllovakinë, që në Gjenevë emigranti Jozef Blumental, duke shpërthyer papritmas në një gajasje histerike, ia kishte hequr vetes me plumb ballit mu përpara Pallatit të Lidhjes së Kombeve, që diku në gjoksin e tij i therte akoma mushkëria nga një kongjestion polmonar që pati marrë në Belfort nën emrin e rremë Gynter, dhe që tani ndodhej përsëri këtu, në këtë mbrëmje të butë si një gji gruaje – të gjitha këto sikur s'po e habisnin fare. Në shumicën e rasteve njeriu duhet t'i merrte gjërat me gjakftohtësinë fataliste, e cila ishte e vetmja armë e pafuqisë. Qielli kudo mbetej po ai që ishte, gjithmonë i njëjtë – mbi vrasjet e mbi urrejtjen, mbi sakrificat e mbi dashurinë... Pemët çdo vit bulëzonin sërishmi, të pafajme dhe pa ditur asgjë nga kjo botë... Mugëtira vjeshtake ngjyrëkumbulle ndërronte e vinte e shkonte, pa u sëkëlldisur për pasaporta, për tradhti, për trishtim e për shpresë. Sa mirë të ndodheshe përsëri në Paris! Sa mirë të ecje, të bridhje ngadalë përgjatë kësaj rruge të kredhur në dritë të argjendtë, pa e vrarë mendjen për asgjë; sa mirë ta jetoje këtë orë, akoma të patrazuar, të mbushur me ndjenjën e butë të harrimit... këtë orë buzë atij kufiri si kufi horizonti, ku trishtimi i largët përzihej me lumturinë që të ngjallte të shpëtuarit nga diçka, të qenët akoma në jetë... orën e parë pas mbërritjes, përpara se të të goditnin përsëri thikat e shigjetat... Sa mirë ta jetoje këtë ndjenjë të papërsëritshme të krijesës, këtë frymë që tretej larg e vinte së largu, këtë fllad akoma shumë të lehtë mbi këtë shteg të zemrës, duke lënë mënjanë zjarret e turbullta të fakteve, kryqet me gozhda të së kaluarës dhe telat me gjemba të së ardhmes...

*

* *

Marozovi po rrinte në dhomën e palmës të *Internacionalit*. Përpara kishte një brokë me verë.

– Ej, Boris, a je burrë i fortë! – i thirri Raviku. – Më duket se më dashka vjehrra fort. Atë verën mos e ke të markës *Vuvrej?*

– S'do mend! E vitit tridhjetë e katër. Është pak e ëmbël këtë radhë. Mirë që na u ktheve përsëri. U bënë nja tre muaj, apo jo?

– Po, më gjatë se herët e tjera.

Erjonixx

Marozovi vuri në veprim një zilkë të vjetër tryeze. Ajo lëshoi një tingëllimë si zile meshtari në një famulli fshati. *Katakomba* kishte vetëm dritë elektrike, por zile elektrike s'kishte. Nuk e vlente barra qiranë t'i montoje; emigrantët tuteshin t'i binin ziles, siç tuteshin nga çdo lloj zhurmë.

– Po tani si quhesh? – pyeti Marozovi.

– Akoma Ravik. Këtë emër nuk e përmenda në polici. Për ata quhesha Voçek, Nojman, Gynter. Punë kapriçoje. Nuk desha të ndahesha nga emri Ravik. Më pëlqen shumë.

– Ata s'e zbuluan dot që ti banoje këtu, ë?

– Natyrisht që jo.

– E qartë. Ndryshe do të kishin bërë me siguri ndonjë alamet bastisjeje... Pra, ti mund të banosh përsëri këtu. Më duket se dhomën tënde e ke të lirë.

– Po plaka a e di çfarë ndodhi?

– Jo. Askush s'e di. U kam thënë se ke shkuar për ca kohë në Ruën. Plaçkat i ke në dhomën time.

Ndihmëskamerierja erdhi me një tabaka në dorë.

– Klarisë, sillni një gotë për zotin Ravik, – tha Marozovi.

– Ah, zoti Raviku! – Vajza zbardhi dhëmbët. – Qenkeni kthyer? U bë një gjysmë viti që keni ikur.

– Vetëm tre muaj, Klarisë.

– E pamundur! Kisha përshtypjen se u mbush një gjysmë viti.

Ajo u largua duke hequr këmbët zvarrë. Pas pak, i çrregullt e i ngathët si gjithmonë, ia behu kamerieri i dhjamur i *Katakombës*, me një gotë vere në dorë. Ai s'e përdorte tabakanë; kishte shumë kohë që punonte në atë hotel dhe i lejohej të mos e prishte rehatin e vet. Marozovi e dinte fort mirë, çfarë do të thoshte kamerieri dhe i doli përpara:

– Mirë, Zhan, na thuaj tani, sa kohë mungoi zoti Raviku. A mund të na e thuash me saktësi?

– Aman edhe ju, zoti Marozov! S'do mend që e di me saktësi! Bile, mund t'jua them edhe me ditë. Ka plot... – Ai bëri një pauzë të shkurtër prej artisti, buzëqeshi dhe tha: – Plot katër javë e gjysmë.

– Tamam, – tha Raviku, përpara se të mund të përgjigjej Marozovi.

– Tamam, - ia bëri edhe Marozovi pastaj.

– Natyrisht. Unë s'gaboj kurrë! – Zhani u zhduk.

– Nuk desha ta zhgënjej, Boris.

– As unë. Desha vetëm të të tregoj si zhvleftësohet koha, kur nis

Scanned with CamScanner

e i përket së kaluarës. Koha që shkoi të ngushëllon, të tremb dhe të bën mospërfillës. – Marovozi rrëmbeu brokën dhe mbushi gotat. – Sidoqoftë, këtu ty po të njohin akoma. Dhe kjo i ngjall njeriut njëfarë ndjenje atdheu, apo e kam gabim?

Raviku piu. Vera ishte e lehtë dhe e ftohtë.

– Kohët e fundit më rastisi t'i afrohesha fare pranë kufirit gjerman, – tha ai. – Arrita deri poshtë, në Bazel. Njëra anë e rrugës ishte zvicerane, tjetra gjermane. Unë qëndroja në anën zvicerane dhe haja qershi. Bërthamat mund t'i pështyja tutje, në Gjermani.

– Mos të ngjallte edhe kjo ndjenjën e atdheut?

– Jo, përkundrazi. Më dukej se ndodhesha më larg se kurrë prej tij.

– Po në përgjithësi, si e çove ndër ato anë?

– Si gjithmonë. Vetëm se çdo gjë sa vjen e po bëhet më e vështirë. Ata po i ruajnë tani kufijtë më me rigorozitet. Më zunë një herë në Zvicër dhe një herë tjetër në Francë.

– Pse nuk u bëre i gjallë ndonjëherë? Një lajm, një letër...

– Nuk e dija se ç'kishte ndërmarrë policia këtu te ju. Nganjëherë seç i kapin ca kriza të çmendura energjie. Ishte më mirë të mos rrezikoja njeri. Fundja, alibitë tona s'kanë qenë kurrë të shkëlqyera. Është një rregull i vjetër ushtarak: shtrihu, mos u ndiej dhe zhduku... Mos prisje gjë tjetër prej meje?

– Unë, për vete, jo.

Raviku i hodhi një shikim.

– Letra... – ia bëri pastaj. – E ç'janë letrat? Letrat s'të ndihmojnë kurrë.

– Ashtu është.

Raviku nxori nga xhepi një paketë cigaresh.

– Çudi se si të duket, kur ke qenë ca kohë larg!

– Mos e gënje veten, – ia priti Marozovi.

– As që më shkon ndër mend.

– Kur je larg, ndihesh ndryshe. Kur kthehesh, ndihesh prapë ndryshe. Pastaj gjithçka fillon përsëri nga e para.

– Ndoshta. Por ndoshta edhe jo.

– Na qenke bërë ca misterioz kohët e fundit. Mirë që paske filluar ta marrësh jetën kështu. A bëjmë ndonjë lojë shah? Profesori na vdiq. Ishte i vetmi kundërshtar i denjë. Levi iku në Brazil. Gjeti një punë si kamerier. Jeta shket çuditërisht shpejt në ditët tona. Më mirë që njeriu të mos e mësojë veten me asgjë.

– Po, më mirë është.

Erjonixx

Marozovi i hodhi Ravikut një shikim të vëmendshëm.

– Nuk e thashë në atë kuptim.

– As unë. Por, si thua, a s'dalim pak nga kjo varrezë e mykur palmash? Tre muaj s'kam qenë këtu; e, megjithatë, kutërbon si gjithmonë: erë kuzhine, pluhuri dhe frike. Kur e fillon punën sonte?

– Sonte s'kam punë fare. Kam pushimin e javës.

– Ah, po! – Raviku nënqeshi. – Ke mbrëmjen e elegancës dhe të gotave të mëdha.

– A s'vjen me mua?

– Jo. Sonte jo. Jam i këputur. Këto netët e fundit kam bërë vetëm nga një sy gjumë. Eja të shkojmë e të rrimë diku jashtë; vetëm një orë. Kam kohë që s'e kam bërë këtë.

*

* *

Ata po rrinin përpara kafenesë *Kolize*, në trotuar.

– Pse porosite verë? – pyeti Marozovi. – Akoma s'është bërë natë. Tani është ora e vodkës.

– Megjithatë dua verë. Më mjafton.

– Ç'të paska ndodhur? Pi të paktën një konjak!

Raviku tundi kokën.

– Kur njeriu mbërrin diku, duhet të bëhet tapë natën e parë, vëllaçko, – deklaroi Marozovi. – Është heroizëm i kotë të zgurdullosh sytë pas hijeve të së kaluarës pa alkool në bark.

– Nuk po zgurdulloj sytë, Boris. Po i gëzohem jetës, duke ndenjur urtë e butë.

Raviku e kuptoi që Marozovi s'po i besonte dhe s'bëri asnjë përpjekje që ta bindte. Rrinte në tryezë, i qetë e i shkujdesur, në rreshtin e parë anës trotuarit, pinte verë dhe sodiste turmën e shëtitësve që shtyheshin në rrugë atë buzëmbrëmje. Për sa kohë kishte qenë larg Parisit, i kishte pasur nervat të tendosura, mendjen të kthjellët dhe vështrimin të mprehtë. Kurse tani gjithçka i dukej e mbështjellë nga një mjegull, herë e murrme e herë e larme, që as të kënaqte e as të turbullonte; i shëmbëllente vetja me dikë, që kishte zbritur me vrik nga mali dhe që zhurmën, poshtë në luginë, e dëgjonte sikur t'i kishte veshët të zëna me pambuk.

– A shkove gjëkundi, përpara se të vije në hotel? – e pyeti Marozovi.

– Jo.

– Veberi pyeti disa herë për ty.

– Do ta marr në telefon.

– Sikur s'po të shoh mirë. Tregomë, çfarë të ka ndodhur andej?

– Asgjë me rëndësi. Kufirin në Gjenevë e ruanin ca si shumë. Në fillim u përpoqa të hidhesha këtej nga ajo anë; pastaj e provova edhe njëherë në Bazel. Por edhe atje ishte shumë e vështirë. Së fundi ia dola mbanë. Mora një të ftohur. Kisha kaluar disa net përjashta, nëpër fusha, në shi e në dëborë. Nuk munda të mjekohesha dot vetë. M'u bë kongjestion polmonar. Një mjek në Belfort më futi në një spital. Kontrabandë hyra, kontrabandë dola. Pastaj ai më mbajti nja dhjetë ditë në shtëpinë e vet. Duhet t'ia çoj paratë që ka shpenzuar...

– Po tani a e more veten?

– Pothuajse.

– Prandaj nuk vë alkool në gojë?

Raviku buzëqeshi.

– Ç'po llomotisim kot edhe ne! Ndihem pak i kapitur dhe dua të mësohem dalëngadalë. Kjo është e gjitha. Çudi, sa shumë e vret njeriu mendjen kur ndodhet në udhëtim dhe sa pak kur mbërrin në vend! Marozovi bëri një shenjë mospërfillëse me dorë.

– Ravik, – ia nisi ai me tonin e një prindi, – je duke folur me babanë tënd Borisin, njohësin e shpirtit njerëzor. Mos i bjer anës e anës, por nxirre atë të shkretë pyetje, që ta heqim qafe!

– Epo mirë. Ç'bëhet Xhoana?

– Nuk di ç'të të them. Ka disa javë që s'kam marrë vesh gjë për të. S'ma ka zënë as syri kohët e fundit.

– Po më parë?

– Më parë vinte e pyeste vazhdimisht për ty. Pastaj nuk u duk më.

– Nuk punon më në *Sheherezade*?

– Jo. Ka nja pesë javë që është larguar nga puna. U duk andej dhe dy-tri herë, pastaj s'u pa më.

– Nuk ndodhet më në Paris?

– S'ma merr mendja. Të paktën kështu duket. Ndryshe do ta kisha parë ndonjëherë andej nga *Sheherezadja*.

– Mos e di, me se u mor pasi u largua nga ju?

– Më duket se me një punë filmi. Të paktën kështu i tha gardërobieres. Ti e di vetë si janë këto punë. Do ta ketë thënë sa për justifikim.

– Justifikim?

– Po, justifikim! – tha Marozovi duke shtrënguar nofullat. – Pse,

ç'pandehe ti, Ravik? Mos prisje gjë tjetër?

– Po.

Marozovi heshti.

– Të presësh diçka dhe të marrësh vesh diçka, janë dy gjëra të ndryshme, – tha Raviku.

– Vetëm për ca romantikë si puna jote, që u kanë fluturuar mendtë. Hajt, pi diçka për të qenë... dhe ma hiq këtë limonadë nga tryeza, se nuk e shoh dot me sy! Do një *Kalvados?*...

– *Kalvados* jo. Por një konjak po e marr, sa për të ta bërë qejfin. Ose, fundja, edhe një *Kalvados.*

– Eh, më në fund! – ia bëri Marozovi.

*

* *

Dritaret. Silueta blu e çative. Kanapeja e kuqe, vende-vende e rrjepur. Shtrati. Raviku e kishte të qartë se do t'i duhej të mbaronte punë vetë me gjendjen e tij të vështirë shpirtërore. Rrinte ulur në kanape dhe pinte cigare. Marozovi ia pati sjellë plaçkat dhe i pati treguar se ku mund ta gjente në rast nevoje.

Ai e pati flakur nga trupi kostumin e vjetër. Pati bërë një banjë shumë të nxehtë duke harxhuar një okë sapun. Pati shpëlarë nga vetja tre muaj jetë, duke u kruar e fërkuar mirë e mirë. Pastaj ishte rruar, kishte veshur ndërresa të pastra dhe një kostum tjetër dhe me kënaqësi do të kishte shkuar edhe në ndonjë hamam turk, po të mos kishte vajtur kaq vonë. I pati bërë të gjitha këto dhe e pati ndier veten mjaft mirë. Do të kishte pasur dëshirë të bënte edhe më tepër, sepse tani, përnjëherësh, teksa po rrinte atje pranë dritares, zbrazëtia e frikshme filloi të zvarritej drejt tij nga të gjitha qoshet...

Mbushi një gotë me *Kalvados.* Mes plaçkave të tij kishte qenë edhe një shishe e mbushur as përgjysmë. Iu kujtua nata kur kishte pirë bashkë me Xhoanën nga ajo shishe; por ajo që ndjeu nga ky rikujtim s'ishte kushedi se çë. Vuri re vetëm që ishte *Kalvados* i mirë dhe i vjetër.

Hëna zuri të ngjitej dalëngadalë mbi çatitë. Oborri i pistë përkundrejt erdhi e u shndërrua në një pallat tërë hije dhe argjend. Me një çikëz fantazi gjithçka mund të kthehej nga pisllëku në argjend. Një aromë lulesh depërtoi që nga dritarja në dhomë. Kundërmimi i fortë që lëshonin karafilat natën. Raviku nxori kokën jashtë dritares dhe vështroi poshtë. Mbi parvazin përposh tij ndodhej një arkëz gja-

toshe me lule. Ato ishin të emigrantit Vizenhof, po qe se banonte akoma në atë dhomë. Raviku i pati bërë dikur një lavazh. Për krishtlindje, përpara një viti...

Shishja ishte boshatisur. Ai e flaku mbi shtrat, dhe ajo mbeti atje, si shëmbëlltyra e një embrioni të zi. Raviku u ngrit. Ç'po ia ngulte ashtu sytë shtratit, si i shastisur? Kur njeriu s'kishte grua, duhej të shkonte e të gjente ndonjë. Në Paris kjo ishte një gjë fort e thjeshtë.

U nis rrugëve të ngushta, drejt *Etualit*. Jeta e ngrohtë e qytetit mbrëmjesor arrinte deri atje larg, që nga *Shanz-Elizeja*. Ai ktheu rrugë, duke ecur më të shpejtë, pastaj më me avash, derisa arriti te hotel *Milani*.

– Si e çoni? – e pyeti portierin.

– Ah, zotëri! – Portieri u ngrit më këmbë. – Zotëria ka kohë që s'na ka ardhur këtej.

– Po, ka ca kohë. S'kam qenë në Paris.

Portieri e kundroi me ata sytë e tij të veckël e të shkathët.

– Zonja nuk banon më këtu.

– E di. Ka kohë që ka ikur.

Portieri ishte një portier i mirë. E dinte, çfarë kërkonin prej tij, pa qenë nevoja ta pyesnin.

– Po, u bënë katër javë që ka ikur nga ne.

Raviku nxori një cigare nga paketa.

– Zonja nuk është më në Paris? – e pyeti portieri.

– Është në Kanë.

Portieri shkoi mbi fytyrë pëllëmbën e dorës së tij të madhe.

– Ah, Kana! – psherëtiu ai. – S'do të ma besoni, zotëri, që para tetëmbëdhjetë vjetësh kam qenë portier në hotelin *Ruhl* në Nisë.

– Pse mos t'ju besoj?

– Ah, ç'kohë që ishin atëherë! Ç'bakshishe! Periudha e mrekullueshme e pasluftës! Kurse sot...

Raviku ishte një klient i mirë. Ai e kuptonte personelin e një hoteli, edhe kur nuk fliste troç. Nxori një kartëmonedhë pesëfrangëshe dhe e vuri mbi banak.

– Falemnderit, zotëri. Ju uroj gjithë të mirat! Dukeni mirë me shëndet, bile dukeni si i rinuar.

– Jo vetëm dukem, por edhe ndihem. Natën e mirë!

Raviku doli në rrugë. Pse kishte ardhur gjer në këtë hotel? Tani s'i mbetej veç të shkonte edhe në *Sheherezade* e të rrumbullosej mirë e mirë.

Ia mbërtheu sytë qiellit të kthjellët plot yje. Duhej të ishte i lumtur

që kishte ndodhur kështu. I kursente vetes një mori grindjesh të kota. Ai e kishte pasë ditur që kjo punë këtë rrugë do të merrte – edhe Xhoana e kishte pasë ditur. Të paktën në fund. Ajo s'kishte si të vepronte më drejt nga ç'kishte vepruar: Pa shpjegime. Shpjegimet janë gjëra të dorës së dytë. Ndjenja nuk njeh shpjegime. Vetëm vepri-me. Shumë mirë që në këtë mes s'doli nevoja të përdorej vajniku i moralit. Shumë mirë që Xhoana s'para e çante kokën fort për kësi marifetesh. Ajo kishte vepruar. Mbaroi. Fund. Llafet e shumta janë fukarallëk. Edhe ai kishte vepruar. E pse po qëndronte, pra, akoma aty, si hu gardhi? Ndoshta e kishte fajin atmosfera. Kjo pëlhurë deli-kate, e qëndisur me maj e me mbrëmje Parisi. Natyrisht që do ta kishte fajin nata. Natën njeriu ishte gjithmonë ndryshe nga ditën.

Ai u fut përsëri në hotel.

– A mund të telefonoj pak?

– Posi jo, zotëri! Vetëm se këtu s'kemi kabinë telefoni. Është vetëm ky aparati këtu.

– Më mjafton.

Raviku i hodhi një sy orës. Kishte shumë mundësi që Veberi të ndodhej akoma në klinikë. Ishte ora e vizitave të fundit të natës.

– Desha doktor Veberin, – i tha infermieres që i doli në telefon. Ai nuk e njihte atë zë. Duhej të ishte ndonjë e re.

– Me doktor Veberin s'mund të flisni.

– Nuk është atje?

– Është, por tani ndodhet i zënë.

– Dëgjoni këtu, – i tha Raviku. – Shkoni e i thoni se e kërkon Raviku në telefon. Ia thoni tani. Ka rëndësi puna. Po pres në telefon.

– Mirë, – tha infermierja me një theks ngurrimi në zë. – Do t'ia them, por s'ka për të ardhur.

– Do ta shohim.

Veberi doli menjëherë në telefon:

– Ravik! Ku ndodheni?

– Në Paris. Mbërrita sot. Mos keni ndonjë operacion në dorë.

– Po. Do të operoj pas njëzet minutash. Punë apendiciti. Ku mund të takohemi më vonë?

– Mund të kaloj vetë andej.

– Në rregull fare! Kur?

– Tani.

– Mirë. Po ju pres.

*

* *

– Urdhëroni një konjak të mirë, – i tha Veberi. – Ja tek keni edhe gazeta dhe ca revista profesionale. Mos u mërzitni sa të mbaroj punë.

– Një konjak e pranoj. Por dua edhe një grykëse dhe dorezat.

Veberi e vështroi Ravikun me habi.

– Është një apendicit krejt i thjeshtë. Nuk duhet të begeniseni të merreni me të. Do ta bëj shpejt e shpejt me infermieret. Me siguri që jeni mjaft i lodhur…

– Veber, ma bëni këtë nder dhe lërmani mua operacionin. Nuk jam aspak i lodhur dhe jam krejt në rregull.

Veberi qeshi.

– Mezi ç'po pritkeni t'i futeni prapë zanatit. Mirë. Si të doni. Fundja, edhe ju kuptoj.

Raviku lau duart dhe njëra nga infermieret ia veshi grykësen dhe dorezat prej llastiku. Salla e operacionit. Ai thithi thellë erën e kloroformit. Ëzhenia qëndronte në krye të tryezës së operacionit dhe po bënte narkozën. Një infermiere tjetër, e re dhe shumë e bukur, po rendiste instrumentet.

– Mirëmbrëma, motër Ëzheni! – tha Raviku.

Asaj mend i shpëtoi nga dora pikuesja e narkozës.

– Mirëmbrëma, doktor Ravik! – iu përgjigj.

Veberi zuri të skërmitej. Ishte hera e parë që Ëzhenia i drejtohej Ravikut në këtë mënyrë. Raviku u përkul mbi pacientin. Llamba e fuqishme mbi tryezën e operacionit ndriste e bardhë dhe intensive. Dukej sikur e mbyllte me kyç botën përreth. I mbyllte edhe mendimet në një qark hermetik. Ishte një dritë e paepur, e ftohtë, e pamëshirshme dhe e mirë. Raviku mori bisturinë që ia zgjati infermierja e bukur. Nën dorezat e holla ndjeu çelikun e akullt. Sa mirë ta ndieje atë çelik. Sa mirë të ktheheshe sërish nga pasiguria e lëkundshme në precizionin e qartë. Ai bëri prerjen. Gjaku, një vijëz e ngushtë e kuqe, rendte pas bisturisë. Gjithçka po bëhej përnjëherësh e thjeshtë, shumë e thjeshtë. Për herë të parë, që kur ishte kthyer, po ndihej zot i vetes. Drita që fliste pa zë. U ktheva prapë në shtëpinë time! mendoi ai. Më së fundi!

19

-Ke këtu, – tha Marozovi.

– Kë?

Marozovi rregulloi uniformën e tij xixëlluese.

– Mos m'u shit sikur nuk e di. Mos u zemëro babanë tënd Borisin këtu, mu në mes të rrugës. Kujton ti që unë nuk e ditkam, pse brenda dy javësh e ke sjellë kokën tri herë në *Sheherezade*? Një herë erdhe me një mrekulli me sy bojëqielli dhe me flokë të zinj, kurse dy herë ishe fill i vetëm! Njeriu është i dobët... ndryshe do të ishte gjë pa lezet.

– Shko në djall! – i tha Raviku. – Mos më fyej pikërisht kur më duhet të mbledh forcat, portier llafazan!

– Domethënë, do të të pëlqente mos të ta thosha fare?

– Natyrisht.

Marozovi bëri mënjanë për t'u hapur rrugë dy amerikanëve që hynin në lokal.

– Atëherë qëromu këtej dhe eja ndonjë mbrëmje tjetër, – i tha Ravikut.

– Vetëm ka ardhur?

– Vetëm ne s'i lëmë të futen këtu as mbretëreshat që qeverisin shtete! Kaq gjë duhet ta dije. Atij Zigmund Frojdit do t'i pëlqente kjo pyetje që më bëre.

– Ku ke haber ti nga Zigmund Frojdi! Je dehur e je bërë kaike, dhe unë do të ankohem për ty te drejtori yt.

– Pa shko e provoje njëherë, biri im!

– Mirë. Lërmë të kaloj.

– Ravik! – Marozovi ia vuri mbi supe dy putrat e veta prej ariu.

– Mos u bëj gomar! Shko e i telefono asaj mrekullisë me sy bojëqielli, me të cilën erdhe një natë, dhe kthehu bashkë me të, meqë dashke medoemos. Është një këshillë e thjeshtë që ta jep një plak me përvojë. Është një këshillë fort e rëndomtë, por që ka gjithmonë efekt.

– Jo, Boris. – Raviku i hodhi një shikim të gjatë. – Truket s'kanë kuptim në këtë rast. Dhe unë s'kam as qejf t'i përdor.

– Atëherë kthehu në hotel, – tha Marozovi.

– Ku të mbytem? Në Dhomën e Palmës, ku bie era myk? Apo në furrikun tim të pështirë?

Marozovi e la Ravikun dhe i doli përpara një çifti që kërkonte taksi. Raviku e priti derisa mbaroi punë.

– Qenke më i arsyeshëm nga ç'pandehja, – i tha Marozovi. – Ndryshe do të ishe futur brenda në lokal.

Ai shtyu në zverk kapën e vet tërë qëndisma ari. Përpara se të mund të vazhdonte ligjëratën, në prag ia behu një djalosh i dehur, veshur me smoking të bardhë.

– Zoti kolonel! Shpejt, më gjeni një automobil kursi!

Marozovi i bëri shenjë taksisë që kishte radhën dhe rrasi në të klientin, të cilit i merreshin këmbët goxha.

– Nuk po qeshni fare?! – dërdëlliti i dehuri. – Ju thirra kolonel... a s'ju pëlqeu shakaja?

– Ishte alamet shakaje. Por më tepër më pëlqeu automobili i kursit.

– E shoshita edhe njëherë atë meselenë tënde, – tha Marozovi, pasi u kthye. – Futu brenda më mirë. Mos e çaj kokën për të tjerat. Edhe unë ashtu do të veproja. Fundja, është një punë që duhet bërë dikur; atëherë pse të mos bëhet menjëherë? Çoje gjer në fund... o kështu, o ashtu. Në çastin kur s'do të jemi më foshnjarakë, ta dish se jemi plakur.

– Edhe unë e shoshita këtë punë. Po ia mbath për diku gjetkë.

Marozovi dukej sikur po eglendisej pa masë.

– Bukur fort! – tha. – Atëherë do të të shihkam përsëri këtu pas nja një gjysmë ore.

– Ndoshta edhe s'do të më shohësh.

– Mirë, atëherë pas një ore.

Dy orë më vonë Raviku ishte ulur në një tryezë në *Klosh d'Or*. Poshtë, te banaku gjatosh, rrinin disa prostituta si papagallët mbi shkop dhe dërdëllitnin papushim. Kishte edhe ca matrapazë kokaine, që prisnin të peshkonin ndonjë turist. Sipër ndodheshin disa çifte që hanin supë qepësh. Mbi një kanape, përballë Ravikut, ishin

shtruar dy lesbike; ato seç çuçurisnin vesh më vesh dhe herë pas here ngrinin gotat me *Sherriband*. Njëra syresh, e veshur me kostum burrash e me kravatë, mbante një monokël; tjetra ishte një flokëkuqe e bëshme me një fustan dekolte, që i lëshonte xixa.

Punë idioti! mendoi Raviku. Pse nuk shkova në *Sheherezade*? Nga se trembem? E pse iki e largohem? E di fort mirë që ajo dashuri më është shtuar. Këta tre muaj nuk arritën dot ta thyejnë; përkundrazi, e kanë bërë më të fuqishme. S'ka asnjë kuptim që ta gënjej veten kësisoj. Ishte pothuaj e vetmja gjë që më mbeti e më shoqëroi ndër tërë ato zvarritje e bredhje rrugëve të huaja, në tërë atë pritje plot ankth dhomave të fshehta, në tërë atë vetmi torturuese gjer në çmenduri netëve të huaja e pa yje. Largimi e ka ushqyer këtë ndjenjë më tepër nga ç'do të kishte mundur ta ushqente ajo vetë... Kurse tani...

Një klithmë e mbytur e shkundi nga këto mendime. Ndërkohë kishin ardhur edhe disa gra. Njëra që dukej si zezake me lëkurë të bardhë, mjaft e dehur, me një kapele tërë lule që i kishte shkarë mënjanë, flaku tej një thikë restoranti dhe zbriti shkallët ngadalë e ngadalë. Askush nuk e ndaloi. Një kamerier i ngjiti shkallët me turr. Një grua tjetër i zuri rrugën.

– S'ka ndodhur gjë, – tha ajo. – S'ka ndodhur asgjë!

Kamerieri ngriti supet dhe u kthye. Raviku vuri re sesi ajo gruaja flokëkuqe u ngrit nga kanapeja. Në të njëjtën kohë gruaja që pati penguar kamerierin, u sul me vrap poshtë te banaku. Flokëkuqja qëndroi pa lëvizur, me njërën dorë të puthisur pas gjoksit të saj të plotë. Ajo hapi me kujdes dy gishtërinj të dorës dhe vështroi tatëpjetë. Fustani ishte çjerrë disa centimetra dhe nën të dallohej plaga e hapur. Nuk dukej lëkurë fare, por vetëm plaga e hapur, aty poshtë fustanit ngjyrëjeshil të mbrëmjes. Gruaja flokëkuqe e shikonte e shastisur atë goxha plagë, sikur s'donte t'u besonte syve.

Raviku kishte bërë një lëvizje të pavetëdijshme. Por, aty për aty, u mbështet përsëri në karrige. Belaja e fundit me policinë i kishte dalë e tepruar. Nuk ia kishte aspak qejfi të ngatërrohej edhe njëherë tjetër. Ai pa sesi gruaja me kostum e kravatë e tërhoqi flokëkuqen mbi kanape. Po atë çast gruaja që pati zbritur te banaku, u kthye duke mbajtur në dorë një gotë pije. Gruaja me kostum u gjunjëzua para kanapesë, ia zuri gojën flokëkuqes me njërën dorë dhe me tjetrën ia hoqi krahun me forcë nga plaga. Gruaja e dytë ia hodhi plagës të gjithë gotën e alkoolit. Mënyrë primitive dezinfektimi, mendoi Raviku. Flokëkuqja rënkonte e përpëlitej, por ajo tjetra e mbante

Erjonixx

mbërthyer si me darë. Dy gra të tjera ishin ngulur tani aty, duke formuar një paravan të gjallë ndaj vështrimeve kureshtarë të klientëve të tjerë. E gjitha kjo u zhvillua jashtëzakonisht shpejt e me marifet. Shumica nuk kuptoi gjë prej gjëje. Një minutë më vonë, sikur t'i kishte sjellë ndokush me magji, në lokal vërshoi një trumbë lesbikesh dhe homoseksualësh. Ata e qarkuan tryezën atje te kanapeja, e ngritën flokëkuqen duke e mbajtur për krahësh, kurse disa të tjerë i bënë njëfarë gardhi grupit dhe, duke qeshur e duke llapur papushim, dolën të gjithë bashkë nga lokali, a thua se s'kishte ndodhur asgjë.

– Shumë bukur e luajtën pjesën, apo jo? – ia bëri dikush prapa Ravikut. Ishte kamerieri.

Raviku bëri një shenjë pohimi me kokë.

– Po ç'ishte shkaku?

– Xhelozi. Këta perversët janë një bandë gjaknxehtë.

– Po ata të tjerët qysh ia behën aq shpejt?! Kjo ishte tamam si punë telepatie!

– Ata i nuhatin këto punë, zotëri, – tha kamerieri.

– Ndoshta ka telefonuar ndonjëra. Sidoqoftë, organizimi qe i shkëlqyer.

– Kanë nuhatje të zhvilluar. Por kanë edhe një solidaritet të hatashëm. Nuk e kallëzojnë kurrë njëra-tjetrën. Vetëm policia të mos u vijë!... Kaq duan dhe asgjë më shumë. Të tjerat i rregullojnë midis tyre.

Kamerieri hoqi nga tryeza gotën e Ravikut.

– Dëshironi edhe një tjetër? Ç'po pinit?

– *Kalvados*.

– Pra, edhe një *Kalvados*.

Ai u largua. Raviku ngriti sytë dhe pa Xhoanën, ulur disa tryeza më tej. Ajo kishte ardhur në kohën kur ai po fliste me kamerierin; prandaj nuk e kishte parë kur hyri. Bashkë me të ishin edhe dy burra në tryezë. Në çastin kur e pikasi ai, e pa edhe ajo. Xhoana erdhi e u zbeh – ishte një zbehtësi që dallohej mirë, megjithëse lëkura e fytyrës i qe nxirë nga dielli. Për disa sekonda ajo qëndroi e qetë, pa ia shkëputur sytë. Pastaj, me një lëvizje të rrëmbyer, shtyu mënjanë tryezën e vogël, brofi më këmbë dhe u drejtua nga ai. Teksa ecte, i ndërroi fytyra. Dukej sikur po i shkrihej e po i humbiste trajtat; vetëm sytë i mbetën të ngrirë dhe të tejpashëm si kristale. Ravikut iu dukën më të kthjellët se kurrëndonjëherë tjetër. Ata sy shprehnin një forcë inatçore, akoma të ndrydhur.

– Qenke kthyer? – ia bëri ajo me zë të ulët dhe pothuajse pa frymë.

E.N

Kishte qëndruar fare pranë tij. Për një çast bëri një lëvizje sikur donte ta përqafonte. Por nuk e përqafoi. As dorën nuk ia dha.

– Qenke kthyer? – përsëriti.

Raviku nuk i dha përgjigje.

– Që kur je kthyer? – e pyeti ajo pastaj me po atë zë të ulët.

– Ka dy javë.

– Dy javë... dhe unë nuk... Ti as që...

– Askush nuk e dinte se ku ndodheshe. As ata të hotelit tënd dhe as ata të *Sheherezades*.

– Në *Sheherezade*... po unë... – Ajo e preu fjalën në mes. – Pse nuk më shkrove as edhe njëherë?

– Nuk kisha mundësi.

– Gënjen.

– Mirë. Nuk doja. Nuk e dija në do të kthehesha prapë.

– Prapë gënjen. Kjo nuk është arsye.

– Është. Mund të ndodhte që të kthehesha dhe mund të ndodhte që të mos vija kurrë më. Kaq gjë nuk kupton?

– Jo, por unë kuptoj që t'u bënë dy javë në Paris dhe që s'ke luajtur as gishtin më të vogël për të më...

– Xhoanë, – i tha Raviku qetë e qetë. – Këto supe të nxira s'i ke nga Parisi.

Kamerieri rrëshqiti si rastësisht andej pari. Ai i hodhi një shikim Xhoanës dhe Ravikut. Bashkë me një pjatë ai hoqi me marifet edhe dy thika dhe dy pirunj nga tryeza.

– Çdo gjë në rregull, – tha kamerieri.

– Çfarë është në rregull? – pyeti Xhoana.

– Hiç. Ashtu kishim një muhabet qëparë.

Ajo ia nguli sytë e mëdhenj.

– Mos pret ndonjë grua këtu?

– O zot i madh... jo! Ca njerëz na bënë një skenë këtu në lokal. Dikush u gjakos. Por këtë radhë nuk u përzjeva.

– Nuk u përzjeve? – Ajo u kujtua menjëherë. Shprehja e fytyrës i ndërroi. – Ç'bën këtu ti? Do të të arrestojnë përsëri! Tani unë i di të gjitha. Po të zunë, do të hash gjashtë muaj burg. Duhet të ikësh. Nuk e dija që je në Paris! Pandeha se s'do të vije kurrë më.

Raviku nuk iu përgjigj.

– Pandeha se s'do të vije kurrë më, – përsëriti ajo.

Raviku e vështroi me ngulm.

– Xhoanë...

– Jo! Të gjitha këto s'janë të vërteta! Asgjë s'është e vërtetë!

E.N

Asgjë!

– Xhoanë, – i tha Raviku urtë e butë, – kthehu në tryezën tënde.

Përnjëherësh sytë e saj u mbushën me lot.

– Kthehu në tryezën tënde, – përsëriti ai.

– Ti e ke fajin! – klithi ajo ndrydhurazi. – Ti! Vetëm ti!

Ajo i ktheu kurrizin me rrëmbim dhe shkoi te vendi i vet. Raviku u ul. Vështroi gotën me *Kalvados* dhe bëri një lëvizje për ta çuar te buzët. Por u pendua dhe nuk e preku me dorë. Teksa fliste me Xhoanën, kishte qenë krejt i qetë. Kurse tani filloi ta ndiente emocion. Çudi, mendoi ai. Muskujt e gjoksit, nën lëkurë, i dridheshin. Pse pikërisht këta? Ngriti gotën dhe soditi dorën e vet. Dora nuk i dridhej fare. Kamerieri kaloi andej.

– Më sillni cigare, – i tha Raviku. – Të markës *Kaporal*.

Ai ndezi një cigare dhe piu atë që kishte mbetur në gotë. Përsëri e ndjeu shikimin e Xhoanës. Ç'pret ajo, vallë? mendoi. Mos pandeh se do të rrumbullosem mu përpara syve të saj nga dëshpërimi? I bëri shenjë kamerierit dhe pagoi. Në çastin kur u ngrit nga vendi, Xhoana filloi t'i fliste me gjallëri të shtirur njërit prej kavalierëve të vet. Ajo nuk i ktheu sytë fare kur i kaloi pranë tryezës. Fytyra i kishte marrë një shprehje të vrazhdë, të ftohtë e mospërfillëse dhe buzëqeshjen e kishte krejt artificiale.

*

* *

Raviku mori rrugët dhe, pa e ditur as vetë se si, u ndodh përsëri përpara *Sheherezades*. Fytyra e Marozovit u çel.

– Të lumtë, ushtar. Për pak do të të kisha hequr vizë. Njeriu gëzohet gjithmonë kur i del fjala.

– Mos u gëzo para kohe.

– As ti, ama! Ke ardhur tepër vonë.

– E di. E takova.

– Si the?

– Po, në *Klosh d'Or*.

– Po kësaj ç'i thua...?! – ia bëri Marozovi i shushatur. – Nëna Jetë përdor gjithnjë ca marifete të reja.

– Kur e lë punën ti, Boris?

– Për dhjetë minuta më ke gati. Klientët ikën të gjithë. Futu brenda, sa të ndërrohem. Pi një vodkë... për llogari të pronarit.

– Jo. Po të pres këtu.

Erjonixx

Marozovi e shikoi me vërejtje.

– Si e ndien veten?

– Për faqe të zezë.

– Mos prisje diçka tjetër?

– Po. Njeriu gjithmonë pret diçka tjetër. Shko e ndërrohu tani.

Raviku u mbështet pas murit. Aty, pranë tij, luleshitësja plakë po rregullonte shportën për të ikur. Ajo nuk e pyeti nëse donte të blinte ndonjë buqetë. Mendimi që i erdhi ato çaste iu duk budallallëk, por do të kishte pasur qejf sikur plaka t'i ofronte lule. Kurse kështu dukej sikur ajo e dinte që atij nuk i duheshin lule, sepse nuk kishte kujt t'ia çonte... Hodhi sytë nga radha e gjatë e banesave. Disa dritare ishin akoma të ndriçuara. Taksitë rrëshqisnin ngadalë e pa zhurmë nëpër rrugë. E ç'kishte pritur? E dinte fort mirë se ç'kishte pritur. Por këtë s'e kishte pritur – që Xhoana do ta merrte iniciativën e para. E, fund-ja, pse jo? E drejta ishte gjithmonë me atë që sulmonte!

Kamerierët dolën nga lokali e u nisën për në shtëpitë e tyre. Tërë natën kishin qenë kaukazianë dhe çerkezë, me xhaketa të kuqe e me çizme. Kurse tani ishin civilë të rraskapitur. Me ato kostume të zakonshme dukeshin si njerëz të çuditshëm. I fundit doli Marozovi.

– Nga do t'ia mbathim? – pyeti ai.

– Unë, për vete, nga s'kam qenë sonte!

– Atëherë po shkojmë në hotel e po bëjmë një lojë shah.

– Si the?

– Shah. Është një lojë me figurina druri, që edhe të çlodh, edhe të përqendron.

– Mirë, – tha Raviku. – Pse jo?

*

* *

Ai u zgjua dhe e kuptoi menjëherë që në dhomë ndodhej Xhoana. Ishte akoma errësirë dhe nuk mund ta dallonte, por ishte i bindur që ajo ndodhej aty. Dhoma ishte ndryshe, dritarja ishte ndryshe, ajri ishte ndryshe e edhe ai vetë ndryshe.

– Lëri marrëzitë! – tha ai. – Ndize dritën dhe eja këtu!

Ajo nuk lëvizi. Raviku s'ia dëgjonte as frymëmarrjen.

– Xhoanë, – i tha, – s'kemi nge të lozim mbyllasyza.

– Jo, – pëshpëriti ajo.

– Atëherë eja këtu!

– E dije që do të vija?

– Jo.
– Por derën e kishe lënë hapur!
– Dera ime rri pothuajse gjithmonë hapur.
Ajo heshti një hop.
– Pandeha se s'kishe ardhur akoma, – tha pastaj. – Desha vetëm... pandeha... se ishe diku duke pirë...
– Atë kisha ndër mend të bëja. Por, në vend të gotës, luajta shah.
– Si?
– Shah. Me Marozovin. Poshtë, në atë furrikun tonë, që duket si akuarium pa ujë.
– Shah! – Ajo doli nga qoshja ku kishte qëndruar. – Shah!... Po kjo... Një njeri që mund të luajë shah kur...
– As unë s'e besoja, por ja që bëhej. Bukur fort, bile. Arrita të fitoja një lojë.
– Ti je njeriu më i akullt, më i pashpirt...
– Xhoanë, – tha Raviku, – mos na bëj skena tani. Mua më pëlqejnë vetëm skenat e bukura. Por sot s'i dua as ato.
– S'po të bëj skena. Jam e mërzitur për vdekje.
– Shumë bukur. Atëherë t'i lëmë këto. Skenat janë me vend vetëm kur njeriu është mesatarisht i mërzitur. Kam njohur një njeri, i cili, që nga çasti kur i vdiq e shoqja e deri sa u varros, shkoi e u mbyll në dhomë dhe u mor me zgjidhje problemesh shahu. Bota e quajtën mizor, por unë e di se ai e pati dashur të shoqen si asnjë tjetër në botë. Por ja që nuk diti nga t'ia mbante dhe u mor ditë e natë me shah që ta hiqte mendjen nga mynxyra e vet.
Xhoana ish avitur ndërkohë gjer në mes të dhomës.
– Për këtë arsye e bëre edhe ti, Ravik?
– Jo. Të thashë që është fjala për një njeri tjetër, që e pata njohur dikur. Unë flija kur erdhe ti.
– Po, ia kishe këputur gjumit! Ti je i zoti edhe fle!
Raviku u ngrit ndenjur në shtrat.
– Kam njohur edhe një burrë tjetër, të cilit gjithashtu i kishte vdekur gruaja. Ai u fut në shtrat dhe fjeti dy ditë e dy net rresht. E vjehrra vuri duart në kokë dhe u shastis fare nga ky farë dhëndri. Nuk arrinte ta kuptonte dot se njeriu mund të bëjë shumë gjëra kontradiktore dhe njëkohësisht të jetë i dëshpëruar e i pikëlluar në kulm. Është e çuditshme se ç'etiketë na është formuar pikërisht për fatkeqësinë! Po të më kishe gjetur të rrumbullosur, gjithçka do të ishte në rregull, sipas stilit e modës. Por që unë luajta shah dhe fjeta, kjo nuk dëshmon aspak se qenkam njeri i vrazhdë dhe pa ndjenja. Shumë e

thjeshtë, apo jo?

Diçka kërciti dhe u bë copë e çikë. Xhoana kishte rrëmbyer një vazo dhe e kishte flakur përtokë.

– Mirë bëre, – i tha Raviku. – S'e kisha aspak qejf atë rrangallë. Veç ki kujdes se mos të të hyjë ndonjë gastare në këmbë.

Ajo i shtyu mënjanë copërat e vazos.

– Ravik, – i tha, – pse sillesh kështu?

– Hë, pra, pse? – iu përgjigj ai. – Po i jap zemër vetes. Kaq gjë s'kupton, Xhoanë?

Ajo u kthye rrëmbimthi me fytyrë nga ai.

– Kështu më duket edhe mua. Por ty s'të kupton dot njeriu kurrë.

Ajo kapërceu me kujdes gastaret dhe erdhi e u ul buzë shtratit. Tani, në mugëtirën e mëngjesit, ai mundi t'ia dallonte fytyrën shumë qartë. U habit që ajo fytyrë nuk rrëfente shenja lodhjeje; dukej e re, e kthjellët, e çlirët. Xhoana mbante një mantel të lehtë, të cilin ai s'ia kishte parë ndonjëherë, dhe një fustan tjetër e jo atë që kishte pasur në *Klosh d'Or*.

– Pandehja se s'do të vije kurrë më, Ravik, – tha ajo.

– Zgjati ca si shumë kësaj radhe. Nuk munda të vija më parë.

– Pse nuk më shkrove asnjëherë?

– Mos do të bënte ndonjë dobi po të të shkruaja?

Ajo vështroi mënjanë.

– Do të qe më mirë.

– Do të qe më mirë të mos isha kthyer fare. Por për mua s'ekziston më vend tjetër dhe qytet tjetër. Zvicra është tepër e vogël. Dhe gjetkë janë kudo fashistët.

– Po këtu... Policia...

– Këtu policia ka po aq shumë dhe po aq pak shanse të më kapë sa edhe më parë. Ajo që më ndodhi herën e fundit ishte një rast ters. Për të s'duhet menduar më.

Ai zgjati dorën dhe mori një paketë cigaresh. Ajo ndodhej mbi tryezën pranë shtratit. Ishte një tryezë komode, me madhësi mesatare, mbushur me libra, paketa cigaresh dhe vogëlsira të tjera. Raviku e kishte inat atë orendi me mermer artificial, që zakonisht vendosej pranë shtretërve dhe që quhej komodinë.

– Më jep edhe mua një cigare, – tha Xhoana.

– Dëshiron të pish diçka? – e pyeti ai.

– Po. Rri, se e marr vetë.

Ajo shkoi e mori shishen dhe mbushi dy gota plot. Njërën ia dha

atij dhe tjetrën e mori për vete dhe e piu me fund. Ndërsa pinte, i shkau manteli nga supet. Tani Raviku ia njohu fustanin. Ishte po ai që ia pati dhuruar kur u nisën për në Antibë. Pse e kishte veshur, vallë? Ishte i vetmi fustan që i pati blerë. Ai nuk u jepte rëndësi këtyre gjërave dhe as mendonte ndonjëherë për këto lloj peshqeshesh.

– Kur të pashë... ashtu papritmas... Ravik... – ia nisi ajo, – nuk isha e zonja të mendoja asgjë. Asgjë. Dhe kur ike andej... pandeha se s'do të të shihja kurrë më. Por këtë nuk e mendova aty për aty. Prisja të ktheheshe në *Klosh d'Or*. Kisha bindjen se do të ktheheshe. Pse nuk u ktheve?

– E pse të kthehesha?

– Do të kisha ardhur me ty.

Raviku e dinte fort mirë që kjo s'ishte e vërtetë. Por nuk donte ta vriste mendjen për këtë. Ashtu, befas, e pushtoi dëshira të mos e vriste mendjen për asgjë. Nuk e kishte besuar që vetëm kjo ardhja e saj do t'i mjaftonte. Ai nuk e dinte pse kishte ardhur Xhoana atje dhe ç'kërkonte në të vërtetë – por ja që, në një mënyrë çuditërisht të thellë e qetësuese, kjo ardhje po i mjaftonte tani plotësisht. Ç'të jetë kjo, vallë? mendoi. Mos është ai kalimi përtej kontrollit të vetvetes? Atje, ku fillon mbretëria e errësirës, trazimi i gjakut, forca e fantazisë dhe kërcënimi i padukshëm...?

– Pandeha se kërkoje të më braktisje, – tha Xhoana. – Dhe vërtet atë kërkoje, apo jo? Thuajmë të drejtën!

Raviku nuk i dha përgjigje.

Ajo e vështroi në sy.

– E dija! E dija! – përsëriti me bindje të plotë.

– Më jep edhe një *Kalvados*!

– Pse, *Kalvados* ishte ky?

– Po. Nuk e paske kuptuar?

– Jo.

Ajo ia mbushi gotën. Dhe, teksa mbante shishen, ia mbështeti njërin krah në gjoks. Ai e ndjeu këtë prekje gjer në brinjët. Xhoana mori gotën e vet dhe e piu.

– Po, *Kalvados* qenka. – Pastaj e vështroi përsëri në sy. – Mirë bëra që erdha. E dija që do të bëja mirë të vija.

Dita po zbardhëllonte gjithnjë e më shumë. Dritaret filluan të kërcisnin lehtë. Kishte nisur të frynte era e mëngjesit.

– A bëra mirë që erdha? – pyeti ajo.

– Nuk e di, Xhoanë.

Ajo u përkul mbi të.

– Ti e di, duhet ta dish.

Fytyra e saj i ndodhej aq pranë, saqë flokët ia mbuluan supet. Ishte një peizazh që ai e njihte – shumë i afërt, por edhe i huaj, gjithmonë i njëjtë dhe kurrë po ai. Vuri re që lëkura në ballë po i rripej; vuri re që të kuqtë e buzëve i rrinte peta-peta mbi buzën e sipërme; vuri re që tualetin nuk e kishte bërë siç duhej... Të gjitha këto i vuri re në atë fytyrë, e cila tani i qe avitur aq pranë, saqë ia mbulonte gjithë botën tjetër përreth... I shihte këto dhe e dinte që vetëm fantazia e tij ia hidhte kësaj fytyre tisin e fshehtësisë; e dinte që ekzistonin fytyra më të bukura, më të mençura, më të pastra – por gjithashtu e dinte se vetëm kjo fytyrë ushtronte mbi të një pushtet si asnjë tjetër. Dhe këtë pushtet ai ia kishte dhënë vetë.

– Po, – tha ai. – Bëre mirë.

– Nuk do ta kisha duruar dot, Ravik.

– Çfarë?

– Që të kishe ikur. Për fare.

– Po ti sikur the që pandehe se s'do të kthehesha kurrë më?

– S'është njëlloj. Sikur të jetoje në një vend tjetër, atëherë ndryshonte puna. Do të ishim vetëm të ndarë. Mund të vija te ti dikur. Ose, të paktën, do të kisha mundësi të shpresoja gjithmonë se do të takoheshim prapë... Por këtu, në të njëjtin qytet... si s'e kupton?!

– E kuptoj.

Ajo drejtoi trupin dhe me gishtërinjtë e saj të gjatë rregulloi flokët.

– Ti s'mund të më lësh vetëm. Ke përgjegjësi për mua.

– Pse, vetëm je ti?

– Ke përgjegjësi për mua, – tha ajo dhe buzëqeshi.

Atë çast atë e pushtoi një valë e nxehtë urrejtjeje ndaj saj... urrejtje për atë buzëqeshje dhe për mënyrën se si i tha ato fjalë.

– Mos fol marrëzira, Xhoanë.

– Është ashtu si them unë. Ti mban përgjegjësi për mua. Që atëherë... tek ura. Pa ty, unë...

– Mirë, mirë. Unë mbaj përgjegjësi edhe për pushtimin e Çekoslovakisë. Dhe tani mjaft me këto! U bë ditë. Duhet të shkosh.

– Si? – Ajo e vështroi e shastisur. – Nuk dashke që të rri këtu?

– Jo.

– Ashtu... – pëshpëriti ajo me zë të ulët dhe befas shumë e zemëruar. – Kështu na qenka puna? Ti s'më do më!

– O zot i madh, – tha Raviku, – edhe këtë kisha mangët! Me ç'idiotë na ke ndenjur këta muajt e fundit?

– Ata s'ishin idiotë. E ç'të bëja sipas teje? Të rrija kyçur në hotel
Milan, t'ua zgurdulloja sytë mureve e të çmendesha?
Raviku u ngrit prapë ndenjur në shtrat:
– Të lutem, pa rrëfime! – i tha. – Nuk të kërkova të më rrëfehesh.
Desha vetëm ta ngrija bisedën tonë në një nivel pak më të lartë.
Ajo e shikoi me inat. Buzët i kishte të shtrënguara dhe sytë të
picërruar.
– Pse më qorton gjithmonë? Të tjerët nuk më qortojnë. Ti çdo gjë
e bën menjëherë problem të madh!
– Ke hak. – Raviku piu ca gllënjka *Kalvados* dhe u shtri prapë.
– Ashtu është, – tha ajo. – Njeriu nuk e di kurrë qysh të sillet me
ty. Ti e detyron tjetrin të thotë gjëra që s'ka qejf t'i thotë. E pastaj nis
e sulmon e të batërdis fare... I tillë je ti.
Raviku mori frymë thellë. Ç'mendime i ishin sorollatur në kokë qëparë? Errësirë e dashurisë, forcë fantazie... Sa shpejt korrigjohes-hin këto të gjitha! Korrigjoheshin vetë, gjithmonë e vazhdimisht vetë. Ato ishin shkatërrueset më të zellshme të ëndrrave. E fundja, ç'faj kishin? Ç'mund të bënin ato... të bukurat, të treturat, të shtyrat...? Një magnet vigan, diku thellë nën tokë... dhe, sipër tij, figurinat e larme, që pandehnin se kishin vullnetin e tyre dhe fatin e tyre... A s'ishte edhe ai vetë një nga ato figurina? Akoma i mbushur me dyshime, akoma duke u kacavjerrë e mbajtur me zor pas një çikëz kujdesi dhe pas një çikëz sarkazme të rëndomtë – kurse në të vërtetë e kishte të qartë se ç'do të ndodhte tani, në mënyrë të pash-mangshme...
Xhoana rrinte mbledhur kruspull te këmbët e shtratit. Dukej si një rrobalarëse bukuroshe e inatosur dhe njëkohësisht si një krijesë e rënë nga hëna e që s'po ambientohej dot. Mugëtira qe kthyer në agim të kuqërremtë – dhe kjo ngjyrë fantastike rrezatohej mbi të. Dita e re po e hukaste që nga larg frymëmarrjen e vet të pastër mbi oborret e pista dhe çatitë e tymosura – dhe nga dritarja po depër-tonte brenda aromë pylli dhe jete.
– Xhoanë, – tha Raviku. – Pse erdhe?
– Pse po më pyet?
– Po, vërtet... pse po të pyes?
– Pse më pyet gjithmonë? Më ke këtu... A s'të mjafton kjo?
– Po, Xhoanë, ke të drejtë. Më mjafton.
Ajo ngriti kokën.
– Eh, më në fund! Por ti e ke zakon që, në fillim, ia prish tjetrit gjithë gëzimin.

Gëzim! Gëzim e quante kjo këtë! Të jesh i shtyrë, i rrëmbyer, i përplasur nga helikat, nga pasioni dëshirues për të ripasur, që të lë pa frymë? Gëzim?! Atje përjashta, po – atje ishte një çast gëzimi: vesa para dritareve, ato dhjetë minuta qetësie, përpara se dita të nxirrte kthetrat e saj... Por, djalli ta marrë, ç'hynin këtu të gjitha këto mendime? A s'kishte të drejtë ajo? A s'kishte të drejtë, ashtu siç kishin të drejtë vesa dhe harabelat dhe era dhe gjaku? Pse e pyeste kaq shumë? Ç'kërkonte të nxirrte prej saj?... Ajo ndodhej atje, e ardhur fluturimthi, e lehtë si një flutur nate, e shpejtë, e shkathët... kurse ai rrinte në shtrat dhe numëronte piklat dhe rrembëzimet e holla në flatrat e kësaj fluture dhe vështronte si tutkun pushin vende-vende të shkërmoqur. Ajo erdhi, dhe unë po shes mend si budallai vetëm e vetëm sepse erdhi e para, mendoi ai. Po të mos kishte ardhur, atëherë do të rrija këtu si qyq e do të vrisja mendjen e do të përpiqesha ta gënjeja veten me heroizëm dhe, në të njëjtën kohë, s'do të dëshiroja gjë tjetër veçse të vinte sa më parë...

Ai flaku mënjanë mbulesat, kërceu nga shtrati dhe filloi të vishte një palë tuta.

– Ç'po bën? – e pyeti Xhoana e habitur. – Mos ke ndër mend të më nxjerrësh jashtë?

– Jo, dua të të puth. Këtë duhej ta kisha bërë me kohë, por ja që jam idiot, Xhoanë. Fola gjithë ato gjepura. Kjo ardhja jote është vërtet një mrekulli e tërë!

Sytë e saj shndritën.

– Për të më puthur, s'ishte nevoja të ngriheshe fare; mirë ishe atje, – tha ajo.

*

* *

Agimi i purpurt nderej lart, pas shtëpive dhe, akoma më lart, qielli kaltërosh fekste i zbehtë. Në të notonin ca re, si lejlekë të përgjumur.

– Vështro çfarë dite, Xhoanë! Të kujtohet si binte shi atëherë?

– Po, vazhdimisht binte shi, i dashur. Moti ishte gri nga gjithë ai shi.

– Edhe ditën që u nisa, binte shi. Ty të pllakosi dëshpërimi nën gjithë atë shi. Kurse tani...

– Po, – tha ajo. – Kurse tani...

Ajo qe shtrirë ngjitur me të.

– Tani i kemi të gjitha, – tha ai. – Kemi bile edhe një kopsht: ata karafilat përposh, te dritarja e emigrantit Vizenhof. Dhe zogj te gështenja atje në oborr.

Ai vuri re që ajo po qante.

– Pse s'po më pyet, Ravik? – i tha.

– Të kam pyetur tepër. A nuk e the edhe vetë qëparë?

– Tani është ndryshe.

– S'ka asgjë për të pyetur.

– Ja... për atë që ka ndodhur gjatë kësaj kohe...

– Nuk ka ndodhur asgjë.

Ajo tundi kokën.

– Ç'më pandeh ti mua, Xhoanë? – tha ai. – Pa shiko njëherë andej përjashta. Atë të kuqërremtën, të artën dhe të kaltrën! Mos pyesin ato në ka rënë dje shi? Në kishte luftë në Kinë apo në Spanjë? Nëse këtë çast vdesin një mijë njerëz apo lindin një mijë të tjerë? Ato janë këtu, ngrihen përpjetë... dhe kjo është e gjitha! Kurse ti kërkon që të të pyes? Nën këtë dritë supet e tua janë bronz... dhe unë të të pyes? Sytë e tu, nën këtë refleks të kuq, janë si deti i grekëve, ngjyrëvjollce e ngjyrëvere... dhe unë të kërkoj të mësoj diçka që vate e shkoi? Ti je këtu... dhe unë të bëhem aq budalla e të rrëmoj nëpër gjethurinat e vyshkura të së kaluarës? Ç'më pandeh ti mua, Xhoanë?

Ajo kishte pushuar së qari.

– Ka kohë që s'i kam dëgjuar më këto, – tha ajo.

– Atëherë paske ndenjur me zogj gomarësh! Gratë duhet t'i adhurosh ose t'i braktisësh. Rrugë të mesme s'ka.

Xhoanën e zuri gjumi, shtrënguar fort pas tij, sikur s'donte ta lëshonte kurrë më. Ajo bënte një gjumë të thellë, dhe Raviku e ndiente frymëmarrjen e saj të lehtë e të rregullt mbi gjoksin e tij. Ai ndenji edhe një copë herë zgjuar. Në hotel filluan zhurmat e mëngjesit. Hapeshin rubineta, përplaseshin dyer, dhe poshtë emigranti Vizenhof lajmëronte zgjimin e vet duke u kollitur para dritares. Raviku ndiente supet e Xhoanës në krahun e tij, ndiente lëkurën e saj të ngrohtë e të lëmuar dhe, kur e kthente kokën, mund t'ia shikonte edhe fytyrën krejt të qetë, që ishte aq e pastër si pafajësia vetë... T'i adhurosh ose t'i braktisësh, mendoi ai. Fjalë të mëdha. E kush ishte ai trim që e bënte dot! Le që kush ishte ai që dëshironte ta bënte vërtet?

Erjonixx

20

Raviku u zgjua. Xhoana nuk ndodhej më pranë tij. Ai dëgjoi ujin që shushërinte në banjë dhe u ngrit ndenjur në shtrat. Gjumi i pat dalë menjëherë. Muajt e fundit kjo mënyrë zgjimi i ishte bërë përsëri zakon. Kujt i dilte gjumi aty për aty, kishte mundësi të arratisej shpejt. I hodhi një sy orës. Ishte dhjetë e ca. Fustani i Xhoanës bashkë me mantelin qenë flakur në dysheme. Këpucët lustrafin ishin te dritarja, njëra këpucë qe përmbys.

– Xhoanë! – thirri ai. – Ç'po bën aty nën dush mu në mes të natës?

Ajo hapi derën e banjës.

– Më vjen keq që të paskam zgjuar.

– S'prish punë. Kam se kur ta vë në vend gjumin. Po ti, pse u ngrite kaq shpejt?

Ajo kishte ngjeshur në kokë një kapuç gome nga ata të plazhit dhe pikonte e tëra ujë. Supet ngjyrëkafe i shndrisnin. Dukej posi një amazonë me helmetë të ngjitur pas kokës.

– Nuk jam më zog nate, Ravik. Nuk punoj më në *Sheherezade*.

– E di.

– Kush ta tha?

– Marozovi.

Për disa çaste ajo e mati me një shikim hetues.

– Marozovi, – ia bëri. – Ai llafazani plak. Po tjetër ç'të ka treguar?

– Asgjë. Pse, ka ndonjë gjë tjetër për të treguar?

– Asgjë që mund të të tregonte një portier nate. Ata janë tamam

E.N

si gratë e garderobës, zanatçinj për thashetheme.

– Marozovit mos i bjer në qafë. Portierët e natës dhe mjekët janë pesimistë zanatçinj. Jetojnë pas kulisave të jetës. Por nuk merren me thashetheme. Janë të detyruar të ruajnë sekretet.

– Pas kulisave të jetës! – tha Xhoana. – E kush ka qejf të jetojë ashtu?

– Askush. Por shumica ashtu jetojnë... Dhe mos harro se Marozovi ta rregulloi atë vendin në *Sheherezade*.

– Po ti, mos kërkon tani që për këtë ta falënderoj tërë jetën me lot ndër sy? Fundja nuk u dola kallp. Për paratë që më jepnin, ua bëja punën; ndryshe s'do të më kishin mbajtur. Përveç kësaj, ai këtë e bëri për ty e jo për mua!

Raviku mori një cigare.

– A s'më thua, pse e ke kaq zët? Ç'të ka bërë?

– Asgjë. Nuk e kam qejf. Se si e ka atë vështrim... Unë s'do të kisha kurrë besim tek ai. As ti s'duhet të kesh...

– Si?

– S'duhet t'i zësh shumë besë. Ti e di që në Francë të gjithë portierët janë spiunë të policisë.

– Ke gjë tjetër për të thënë? – e pyeti Raviku me zë të qetë.

– Natyrisht që ti s'më beson. Por në *Sheherezade* të gjithë e dinin. Dhe ku i dihet nëse...

– Xhoanë! – Ai hodhi mbulesën mënjanë dhe u ngrit nga shtrati. – Mos fol marrëzira! Ku e ke hallin?

– Pse? Ku ta kem hallin? Unë s'e honeps dot... kjo është e gjitha. Ai ndikon për të keq. Dhe ti gjithë kohën rri me të.

– Aha! – ia bëri Raviku. – Prandaj?

Ajo qeshi si e lehtësuar.

– Po, prandaj.

Raviku e ndjeu se kjo ishte një "prandaj" nga zori dhe se kishte edhe diçka tjetër në këtë mes.

– Ç'dëshiron të hash për mëngjes? – e pyeti Xhoanën.

– U zemërove? – ia ktheu pyetjen ajo.

– Jo.

Ajo doli nga banja dhe ia hodhi krahët rreth qafës. Nëpërmes pëlhurës së hollë të pizhameve ai ndjeu lagështirën e lëkurës së saj. E ndjeu atë trup gruaje dhe ndjeu gjakun e vet.

– U zemërove pse jam xheloze për shokët e tu? – e pyeti ajo.

Ai tundi kokën. Një helmetë. Një amazonë. Një najadë e dalë nga oqeani, me aromën e ujit e të rinisë akoma mbi lëkurën e lëmuar.

Scanned with CamScanner

– Lëshomë! – tha ai.

Ajo nuk i dha përgjigje. Vija nga mollëzat e kërcyera të faqeve deri te mjekra. Goja. Qepallat e rënda, gjysmë të perënduara, gjinjtë që shtyheshin drejt lëkurës së tij nën pizhamet e shkopsitura.

– Lëshomë, ose...

– Ose çfarë? – pyeti ajo.

* * *

Një bletë gumëzhinte përpara dritares së hapur. Raviku e ndiqte me sy. Siç dukej, e kishin joshur karafilat e Vizenhofit dhe tani kërkonte lule të tjera. Ajo fluturoi ca nëpër dhomë dhe zuri vend mbi një gotë të përdorur *Kalvadosi*, që ndodhej te parvazi.

– E ke ndier mungesën time? – pyeti Xhoana.

– Po.

– Shumë?

– Po.

Bleta u ngrit përsëri fluturim. I ra disa herë gotës rrotull, e pastaj doli prapë jashtë dritares, në diell e drejt karafilave të emigrantit Vizenhof.

Raviku rrinte shtrirë pranë Xhoanës. Verë, mendonte ai. Verë, lëndina në agim, flokë me aromën e barit të thatë dhe lëkura si tërfil... gjaku mirënjohës që rridhte pa u ndier, si një gurrë që ngrihej e njomte pa pasion brigjet me rërë... një sipërfaqe e sheshtë, mbi të cilën pasqyrohej një fytyrë e qeshur. Për disa çaste asgjë s'ishte më e thatë dhe e vdekur... Blire dhe plepa, heshtje dhe ajo murmuritje e ngadaltë, që vinte si një oshtimë nga qiej të largët e të tretur dhe trokiste nëpër damarë...

– Dua të rri këtu, – tha Xhoana, me kokën mbështetur në supin e tij.

– Rri. Dhe lërna të flemë. Kemi fjetur pak.

– Nuk mundem. Më duhet të shkoj.

– Me fustanin e mbrëmjes s'ke ku shkon tani.

– Kam sjellë një fustan tjetër me vete.

– Ku e ke?

– E kisha nën mantel. Edhe këpucë po ashtu. Duhet t'i kem hedhur diku atje te plaçkat e mia. I kam të gjitha me vete.

Ajo nuk tha se ku duhej të shkonte. Dhe as përse. Dhe Raviku nuk e pyeti fare.

Bleta u duk përsëri. Ajo nuk erdhi më rrotull duke gumëzhitur pa cak e pa qëllim, por fluturoi drejt e te gota dhe u ul mbi buzët e saj. Dukej sikur kishte haber nga *Kalvadosi*.

– Domethënë, kaq e sigurt ishe që do të rrije këtu, me mua?

– Po, – tha Xhoana, pa lëvizur.

*

* *

Rolanda solli një tabaka me shishe e me gota.

– S'dua alkool, – i tha Raviku.

– S'do të pish një vodkë? Është e markës *Subrovka*.

– Sot s'dua. Mund të më japësh një kafe. Të fortë.

– Mirë.

Ai e hoqi mikroskopin mënjanë. Pastaj ndezi një cigare dhe iu afrua dritares. Lisat jashtë ishin veshur me gjethe të reja. Kur pati ardhur herën e fundit këtu, ata ishin akoma të zhveshur.

Rolanda i solli kafenë.

– Sikur keni më shumë vajza tani, – tha Raviku.

– Janë shtuar njëzet.

– Kaq mirë po shkoka puna? Tani, në qershor?

Rolanda erdhi e u ul pranë tij.

– Puna po vete aq mirë, saqë as vetë s'po e marrim vesh. Duket sikur njerëzve u janë liruar burgjitë. Fillojnë e na vijnë që pasdreke herët. Por në mbrëmje, ama...

– Ndoshta e kanë prej motit.

– S'është puna te moti. Unë e di si punojmë zakonisht në maj e në qershor. Por tani kemi të bëjmë me një lloj çmendurie. S'e ke idenë, çfarë xhiroje bën bari ynë. A mund ta marrësh me mend që francezët të porosisin shampanjë këtu te ne?

– Jo.

– Mirë se të huajt. Për këto punë i kemi. Po francezët! Bile vetë parisianët! Shampanjë! Në vend të *Dybonesë*, birrës ose konjakut? A të besohet?

– Do ta besoj po ta shoh me sy.

Rolanda i shtiu kafenë.

– Pastaj gjithë kjo punë e gjithë kjo lëvizje, – vazhdoi ajo. – Të shurdhohen veshët. Do ta shikosh vetë kur të zbresësh poshtë. Fillojnë që në këtë orë! Dhe s'janë më ata profesionistët e kujdesshëm, që prisnin më parë vizitat e tua. Është një bandë e tërë, që rri e

pret atje! Ç'djall u ka hyrë në bark këtyre njerëzve, Ravik?

Raviku ngriti supet:

– Është si ajo historia e transatlantikut që po mbytet.

– Por te ne s'po mbytet gjë! Puna po lulëzon sa s'ka ku të vejë më!

Dera u hap. Nineta, njëzet e një vjeçe, truphollë si lastar, veshur me një palë breçka të shkurtra mëndafshi rozë, u fut në dhomë. Ajo kishte fytyrën e një shenjtoreje dhe ishte njëra prej prostitutave më të mira të bordelit. Tani po mbante në dorë një tabaka me bukë, gjalpë dhe një kavanoz marmelate.

– Madamës i ra në vesh që doktori po pi kafe, – ia bëri ajo me një zë të ngjirur basi. – Po ju dërgon pak marmelatë, sa për ta provuar. E ka bërë vetë! – Nineta u zgërdhi pa ndonjë arsye të dukshme. Fytyra prej engjëlli u shndërrua në një surrat rrugaçi. Ajo e la tabakanë mbi tryezë dhe iku duke u përdredhur si balerinë.

– E shikon, sa të gjatë e kanë llapën! – psherëtiu Rolanda. – E dinë që ua kemi nevojën, prandaj bëjnë kështu.

– Mirë e kanë, – tha Raviku. – Po kjo marmelatë ç'na qenka?

– Krenaria e Madamës! Ajo e përgatit vetë, atje në pronën e saj që ka në rivierë. Është vërtet marmelatë e mirë. Ke qejf ta provosh?

– Unë e urrej marmelatën. Sidomos kur e bëjnë milionerët.

Rolanda zhvidhosi kapakun e kavanozit, nxori ca lugë plot me marmelatë, i hodhi në një letër të trashë, futi atje edhe pak gjalpë dhe dy feta bukë, i mbështolli të tëra mirë e mirë dhe ia zgjati Ravikut.

– Hidhi pastaj diku, – i tha. – Taksirat e ke që t'i marrësh me vete. Sa për t'i bërë qejfin. Ajo shkon e kontrollon pastaj, në ke ngrënë në apo s'ke ngrënë nga marmelata e saj. E fundmja krenari e një gruaje që po plaket dhe që s'ka iluzione. Bëje për xhentilesë.

– Mirë. – Raviku u ngrit dhe hapi derën. – Gjullurdi e madhe, – tha. Nga poshtë dëgjoheshin zëra, muzikë, të qeshura dhe klithje. – Të gjithë francezë janë ata që kanë ardhur?

– Jo, këta janë shumica të huaj.

– Amerikanë?

– Jo, dhe kjo është çudia. Pjesa më e madhe janë gjermanë. S'kemi pasur kurrë kaq shumë gjermanë këtu.

– S'është aspak çudi.

– Më të shumtët e flasin mjaft mirë frëngjishten. Nuk ngjasojnë fare me gjermanët e para disa viteve.

– E marr me mend. Po nga asqerët a ju vijnë shumë? Rekrutë dhe ushtarë të kolonive?

– Ata i kemi mysafirë të përhershëm.

Raviku tundi kokën.

– Dhe gjermanët, sigurisht, tregohen kavalierë të mëdhenj, apo jo?

Rolanda qeshi.

– Janë vërtet. Ftojnë dhe e qerasin këdo që ka qejf të pijë një gotë. – Sidomos ushtarakë, ma ha mendja. Kurse Gjermania s'lejon të nxirren jashtë markat dhe kufijtë janë të mbyllur! Për të dalë jashtë shtetit, duhet të kesh lejë të posaçme. Dhe s'mund të marrësh me vete më tepër se dhjetë marka... Çudi vërtet, këta gjermanët qejflinj me kaq shumë para në xhep dhe që e flitkan bile edhe frëngjishten aq mirë! Si thua ti, Rolandë?

Rolanda ngriti supet.

– Unë s'e vras fort mendjen për këtë... Mjafton që paratë të mos i kenë false...

*

* *

Ai u kthye në hotel në orën tetë.

– Më kërkoi njeri në telefon? – e pyeti portierin.

– Jo.

– As pasdreke?

– Jo. Tërë ditën.

– Erdhi njeri të pyesë për mua?

Portieri tundi kokën:

– Asnjeri.

Raviku ngjiti shkallët. Në katin e parë dëgjoi çiftin Goldberg tek grindej. Në katin e dytë çirrej një fëmijë. Ishte nënshtetasi francez Lysien Zilbermani. Një vjeç e dy muaj. Për prindërit e tij, tregtarin e kafesë Zigfrid Zilbermanin dhe të shoqen, Nelin, nga Frankfurti, kjo fëmijë ishte njëkohësisht edhe si punë thesari edhe objekt spekulimi: Lysieni kishte lindur në Francë dhe ata shpresonin që, nëpërmjet tij, do t'ua jepnin pasaportat franceze dy vjet para afatit. Dukej sikur Lysieni, me zgjuarsinë e njëvjeçarit, e kishte nuhatur këtë, dhe na ishte bërë një tiran i vërtetë i familjes. Në katin e tretë blegërinte një gramafon. Ishte gramafoni i refugjatit Volmajer, që kishte ikur nga kampi i përqendrimit Oranienburg; tani ai e vriste kohën duke vënë njëri pas tjetrit disqe me muzikë popullore gjermane. Korridori binte erë lulelakre dhe mugëtire.

Raviku u fut në dhomën e vet që të lexonte. Kishte blerë dikur

disa vëllime të "Historisë Botërore", dhe tani i nxori andej ku i pati varrosur mes librash të tjerë. Nuk ishte fort argëtues leximi i kësaj historie. E vetmja ndjenjë që të pushtonte, ishte njëfarë kënaqësie e trishtë se asgjë që po ndodhte sot nuk ishte e re. Të gjitha kishin ndodhur me dhjetëra herë më parë. Mashtrimet, pabesitë, vrasjet, netët e Shën Bartolemeut, korrupsioni, etja për pushtet, vargu i pasosur i luftërave – historia e njerëzimit ishte shkruar me gjak e lot dhe, midis mijëra përmendoreve plot njolla gjaku të së kaluarës, vetëm rrallë e tek shkëlqente ndonjëra, e larë me argjendin e mirësisë. Demagogët, palaçot, vrasësit e baballarëve dhe të shokëve, egoistët e regjur, profetët fanatikë që predikonin dashurinë me anë të shpatës – ishte gjithmonë e njëjta mesele, dhe gjithmonë gjendeshin popuj të durueshëm për t'u futur në valle, për t'u ndërsyer kundër njëri-tjetrit, për t'u vrarë e prerë kot së koti për hatër perandorësh, besimesh dhe të krisurish... Dhe kjo valle s'kishte fund kurrë.

Ai i la mënjanë librat. Nga dritarja e hapur përposh dhomës së tij dëgjoheshin zëra. I njohu – ishte Vizenhofi dhe zonja Goldberg:

– Jo tani, – i thoshte Ruth Goldbergu. – Ai do të kthehet shpejt. Pas një ore.

– Po i thonë një orë kohë!

– Ndoshta kthehet më shpejt.

– Ku shkoi?

– Në legatën amerikane. Çdo mbrëmje atje shkon. Rri përpara saj si hu gardhi dhe e sodit. Gjë tjetër s'bën. E pastaj kthehet.

Vizenhofi seç tha diçka, që Raviku s'e mori dot vesh.

– Natyrisht, – ia priti Ruth Goldbergu me inat. – E kush nuk është i çmendur sot? Edhe që është plak, e di vetë; s'është nevoja të ma tregosh zotrote!

– Lëri këto, – ia bëri ajo përsëri pas pak. – S'ma ka qejfi tani. S'jam në formë.

Vizenhofi iu përgjigj diçka.

– E ke kollaj të flasësh, je kaluar, – i tha ajo. – Por paratë i ka ai. Unë s'kam asnjë dyshkë. Kurse ti...

Raviku u ngrit nga vendi, vështroi telefonin dhe futi duart ndër xhepa. Ora po shkonte dhjetë. Nga Xhoana s'kishte marrë asnjë lajm qëkur iku në mëngjes. As që e kishte pyetur në do të vinte në mbrëmje. Pati qenë i sigurt që do të vinte. Tani s'ishte më i sigurt.

– Të thashë që ti e ke kollaj. Shikon vetëm qejfin tënd dhe asgjë tjetër, – tha zonja Goldberg.

Raviku u nis për te Marozovi, por e gjeti dhomën të kyçur. Zbriti

shkallët dhe u drejtua për në *Katakombë*.

– Po të më telefonojë njeri, jam poshtë, – i tha portierit.

Marozovi ndodhej atje. Po luante shah me një burrë qimekuq. Nëpër qoshet e sallës rrinin ca gra. Bënin triko ose lexonin me fytyra të pikëlluara.

Raviku e ndoqi një copë herë lojën. Qimekuqi ishte usta. Luante shpejt e me gjakftohtësi, dhe Marozovi po humbiste.

– Më mori lumi sonte, – ia bëri Marozovi. Raviku ngriti supet. Burri qimekuq ia qepi sytë. – Ky është zoti Finkenshtajn, – tha Marozovi. – Ka ardhur fresk nga Gjermania.

Raviku tundi kokën në shenjë përshëndetjeje.

– Si duken punët andej? – pyeti pa interes, vetëm sa për të thënë diçka.

Finkenshtajni ngriti supet dhe nuk tha asgjë. As Raviku s'kishte pritur ndonjë përgjigje. Koha e përgjigjeve kishte kaluar bashkë me vitet e para: atëherë kishte pyetje të ethshme, pritje, ankth, përgjim se mos përmbysej pushteti atje matanë... Kurse tani çdokush e dinte se vetëm lufta mund ta sillte këtë. Dhe çdo njeri, me sadopak tru në kokë, e dinte gjithashtu se, për një qeveri e cila problemin e papunësisë e zgjidhte nëpërmjet industrisë së armatimeve, ekzistonin vetëm dy mundësi: ose lufta ose katastrofa e brendshme. Domethënë, prapë luftë.

– Shah mat! – tha Finkenshtajni pa pikën e entuziazmit dhe u ngrit nga tryeza. Ai vështroi Ravikun. – Ç'duhet të bëjë njeriu që ta zërë gjumi? Unë s'po fle dot këtu. Sapo mbyll sytë, zgjohem menjëherë.

– Pini, – i tha Marozovi. – Pini verë burgonje ose birrë. Pini shumë.

– Unë s'jam i pijes. Kam bredhur me orë të tëra nëpër rrugë, derisa më ranë këmbët dhe thashë se u lodha për vdekje. Por s'më bëri dobi. Nuk fle dot.

– Do t'ju jap ca hape, – i tha Raviku. – Ejani me mua lart.

– Kthehu prapë, Ravik! – i thirri Marozovi nga pas. – Mos më lër këtu vetëm, vëllaçko!

Disa nga gratë ngritën kokën. Pastaj vazhduan të luanin shtizat ose të lexonin, thua se nga kjo punë varej e gjithë jeta e tyre. Raviku u ngjit me Finkenshtajnin në dhomën e vet. Kur hapi derën, era e natës e goditi nga dritarja posi një dallgë e ftohtë, e errët. Mori frymë thellë, ndezi dritën dhe i hodhi një vështrim të shpejtë dhomës. Askush nuk ndodhej aty. Ai i dha Finkenshtajnit ca hape për gjumë.

– Falemnderit, – i tha Finkenshtajni dhe asnjë muskul i fytyrës

nuk i lëvizi. Si hije doli përsëri nga dhoma.

Raviku e kuptoi përnjëherësh që Xhoana nuk do të vinte. E dinte gjithashtu se këtë bindje e kishte pasur qysh në mëngjes – vetëm se nuk i kishte pëlqyer ta besonte. Ktheu kokën, a thua se prapa tij kishte folur dikush. Tani gjithçka i dukej krejt e qartë dhe krejt e thjeshtë. Ajo pati arritur me të ç'kishte dashur – dhe tani e linte pezull e nuk ngutej aspak. E ç'kishte pritur tjetër ai? Që ajo të flakte gjithçka për hatër të tij? Që të kthehej sërish, ashtu si përpara?... Ç'marrëzi! S'donte shumë mend për t'u kuptuar se në këtë mes ekzistonte dikush tjetër, dhe jo vetëm një burrë tjetër, por edhe një jetë krejt tjetër, të cilën ajo s'donte ta humbiste!

Ai zbriti përsëri poshtë. E ndiente veten shumë keq.

– Telefonoi njeri? – pyeti.

Portieri i turnit të natës, i cili sapo kishte ardhur, tundi kokën, me gojën plot me sallam.

– Pres një telefonatë. Mund të më gjeni poshtë.

Ai u kthye te Marozovi.

*

* *

Ata bënë një lojë shah. Marozovi fitoi dhe vështroi i kënaqur përreth. Gratë ishin zhdukur ndërkohë pa zhurmë. Marozovi tundi zilen e meshtarit:

– Klarisë, një brokë verë nga ajo e kuqja!

Pas pak ia pati gjithë mllef:

– Ai Finkenshtajni luan sikur të ishte makinë qepëse! Të vjen të pëlcasësh! Na qenka matematikan! Unë e urrej perfeksionin. Nuk është njerëzor... – Ai ia nguli sytë Ravikut. – Po ty ç'të gjeti që më rri kyçur këtu, në një natë të tillë?

– Pres një telefonatë.

– Mos ke përsëri në plan të dërgosh ndokënd në atë botë në mënyrë shkencore?

– Dje ia nxora stomakun dikujt.

Marozovi i mbushi gotat deri në buzë.

– Më rri këtu e më pi, – tha ai, – kurse jo fort larg që këtej viktima jote dergjet në kllapi. Edhe në këtë mes ka diçka që s'është njerëzore. Duhej të të dhimbte të paktën stomaku edhe ty!

– Tamam, – ia priti Raviku. – Këtu qëndron mjerimi i botës, Boris; ne s'e ndiejmë kurrë atë që katranosim! Po ti pse kërkon ta zbatosh

reformën tënde pikërisht te mjekët? Politikanët dhe gjeneralët do të ishin më të përshtatshëm. Do të kishim pastaj paqe botërore.

Marozovi u mbështet në karrige dhe e soditi Ravikun me vëmendje.

– Mjekët s'duhet t'i njohësh kurrë personalisht, – deklaroi ai. – Sikur e humbet një çikëz besimin pastaj. Unë jam rrumbullosur kushedi sa herë bashkë me ty... e si mund të të lejoj pastaj të më operosh? Unë mund ta di, për shembull, që ti je një kirurg më i zoti se ndonjë tjetër, të cilin s'e njoh fare... por, megjithatë, do të shkoja tek ai tjetri. Kësaj i thonë: të kesh besim tek e panjohura... një veti njerëzore me rrënjë të thella, biri im! Mjekët duhet të banojnë nëpër spitale dhe s'duhen lejuar kurrë të dalin jashtë e të bien në kontakt me profanen. Paraardhësit tuaj, shtrigat, magjistarët dhe xherahët, e dinin këtë gjë. Në u operofsha unë, kam qejf të besoj në mbinjerëzoren.

– As unë s'kisha për të të operuar, Boris.

– Pse jo?

– Asnjë mjek nuk e operon me qejf vëllanë e vet.

– Mos ki merak. As unë nuk bie në dorën tënde. Do të vdes nga zemra, mu në gjumë. Jam duke punuar me zell të madh për këtë. – Marozovi ia picërroi sytë Ravikut, si një çapkën i vogël gazmor. Pastaj u ngrit. – Më duhet të nisem. Të hap e të mbyll dyert në qendrën e kulturës *Monmartrë*. A s'më thua, pse jeton vallë njeriu?

– Që ta vrasë mendjen për këtë. Ke ndonjë pyetje tjetër?

– Po. Atëherë pse, pasi e ka bërë këtë që thua ti dhe pasi i kanë ardhur disi mendtë, vdes e shkon në atë botë?

– Disa njerëz vdesin edhe pa u ardhur mendtë fare.

– Mos më bëj dredha. E mos fillo të më dërdëllitësh tani për shtegtime shpirtrash.

– Dua të të pyes më parë për diçka tjetër. Luanët mbysin kaprojtë; merimangat mbysin mizat; dhelprat mbysin pulat... Cila është e vetmja racë në botë që ia nxjerr sytë vetes, që lufton e vret e pret vazhdimisht vetveten?

– Këto janë pyetje për kalamaj. Kurora e Gjithësisë, s'do mend! Njeriu, i cili ka shpikur fjalët: dashuri, mirësi dhe mëshirë!

– E saktë! Të lumtë! Dhe cila është e vetmja qenie e natyrës që mund të bëjë dhe bën vetëvrasje?

– Përsëri njeriu, i cili ka shpikur përjetësinë, zotin dhe ringjalljen!

– Mrekulli, – tha Raviku. – Ti e shikon vetë se nga sa shumë kontradikta jemi të përbërë ne. E ç'pyet atëherë, pse vdiskemi?

Marozovi e vështroi me habi. Pastaj rrëkëlleu ca verë në gurmaz.

– Sofist! – i thirri Ravikut. – Hileqar!

Raviku qeshi. Pastaj, aty për aty, i shkoi mendja te Xhoana. Po sikur ajo të vinte tani atje, të hynte nga ajo derë xhami të palarë!

– Gabimi ynë, i dashur Boris, ishte që filluam të mendoheshim. Po të ishim mjaftuar vetëm me lumturinë e fekondimit dhe të të ngrënit, të gjitha këto nuk do të ndodhnin. Dikush eksperimenton me ne... por, me sa duket, nuk e ka gjetur akoma zgjidhjen. Megjithatë, nuk duhet të ankohemi. Edhe kafshët eksperimentale duhet të kenë njëfarë krenarie profesionale.

– Këtë e thonë kasapët, jo lopët. E thonë shkencëtarët, por kurrë kaviet. E thonë mjekët, por kurrë minjtë e bardhë!

– Shumë e drejtë. Rroftë ligji i shkakut të mjaftueshëm! Eja, Boris, ta ngremë një gotë për Bukurinë, të përjetshmen e qashtër që na përket vetëm për një çast! Dhe a e di ti atë gjënë që mund të bëjë njeriu edhe kur është vetëm fare? Të qeshë e të qajë.

– Dhe të dehet. Me konjak, verë, filozofi dhe gra dhe shpresë dhe dëshpërim. Po atë gjënë tjetër, që vetëm njeriu e di, a e di ti? Që i duhet të vdesë! Si kundërhelm për këtë të vërtetë, i kanë dhënë fantazinë. Guri është real. Edhe bima. Edhe kafsha gjithashtu. Ata e kanë punën në vijë. Nuk e dinë që duhet të vdesin. Kurse njeriu e di. Çohu, shpirt! Fluturo! Mos shpërthe në dënesa, o vrasës legal!... A s'ishte një himn për njerëzimin ky që sapo kënduam tani?

Marozovi e shkundi aq fort palmën e murrme, saqë u ngrit një okë pluhur përpjetë.

– Oh, ti simbol i urtë e prekës shprese jugore! Bimë ëndërrimtare e një hoteliereje franceze, mbetsh me shëndet! Edhe ti mbetsh me shëndet, o njeri pa atdhe, dredhkë pa tokë, hajdut xhepash i vdekjes! Duhet të jesh krenar që ke mbetur akoma romantik!

Ai iu ngërdhesh Ravikut.

Raviku nuk ia ktheu ngërdheshjen. Ai shikonte nga dera. Atë sapo e hapi portieri i natës që u drejtua nga tryeza e tyre. Telefoni! mendoi Raviku. Më në fund! Ai nuk u ngrit nga vendi. Qëndroi në pritje dhe ndjeu se si po tendosej i tëri.

– Urdhëroni cigaret, zoti Marozov, – tha portieri. – Tani sapo i solli djaloshi ynë.

– Falemnderit. – Marozovi rrasi në xhep paketën e cigareve. – Mirupafshim, Ravik. A do të shihemi më vonë?

– Ndoshta. Mirupafshim, Boris.

*

* *

Burri pa stomak e vështronte Ravikun mu në dritë të syrit. I përzihej, por nuk villte dot. S'kishte me seç të villte. Kjo ishte njëlloj, sikur një njeriu me këmbë të prera t'i dhembnin këmbët.

Ai ishte shumë i shqetësuar. Raviku i bëri një gjilpërë. Shpresa që të mbetej gjallë ishte fort e pakët. Zemrën s'para e kishte fort në rregull dhe njëra prej mushkërive ishte plot me kaverna të kalcifikuara. S'mund të thuhej që kishte gëzuar shumë shëndet gjatë tridhjetë e pesë vjetëve të jetës së tij. Ulcer në stomak që prej kohësh, tuberkuloz mezi të shëruar dhe, tani së fundi, kancer. Nga të dhënat që kishte klinika dilte se kishte qenë katër vjet i martuar; gruaja i pati vdekur gjatë lindjes, kurse fëmija tre vjet më vonë, nga tuberkulozi. S'kishte asnjë të afërm. Dhe ja, ky shuk njeriu rrinte tani atje shtrirë, dhe e vështronte në sy, dhe s'donte të vdiste dhe ishte i durueshëm e plot guxim, pa e ditur se, këtej e tutje, do të ushqehej nëpërmjet zorrës dhe se nuk do ta lejonin të hante nga ato pak gjëra që përbëzin një prej gëzimeve të rralla të jetës së tij – kastraveca me mustardë dhe mish lope të zier. Ai rrinte shtrirë atje dhe merrte frymë dhe kishte kaluar nën thikë, por i kishte mbetur akoma diçka që ia vinte sytë në lëvizje e që quhej shpirt... Duhet të jesh krenar që ke mbetur akoma romantik!... Himn për njerëzimin!...

Raviku e vuri në vend tabelën me grafikun e temperaturës dhe me të dhënat e pulsit. Infermierja u ngrit nga vendi dhe qëndroi në pritje. Pranë vetes, në karrige, kishte lënë një triko të porsafilluar. Shtizat ishin në të dhe një top leshi kishte rënë në dysheme. Fija e hollë e leshit që varej poshtë nga karrigia, ngjante me një curril të hollë gjaku, thua se nga trikoja rridhte gjak.

Ky po dergjet këtu, mendoi Raviku. Edhe me këtë gjilpërë që i bëra, prapëseprapë do të kalojë një natë të poshtër, me dhimbje, vështirësi frymëmarrjeje dhe ëndrra të tmerrshme kllapie... Kurse unë pres një grua dhe mendoj se, po të mos më vijë ajo, do të kaloj një natë të vështirë. E di sa qesharake është kjo, po ta krahasosh me këtë njeri këtu, i cili pothuajse është i vdekur, po ta krahasosh me Gaston Perrienë në dhomën ngjitur, të cilit ia premë të tërë krahun, po ta krahasosh me mijëra të tjerë, po ta krahasosh me të gjitha ato që ndodhin këtë natë në botë – e, megjithatë, kjo dije mua s'më bën asnjë dobi. S'më bën asnjë dobi, s'më ndihmon, s'ndryshon asgjë, mbetet po ajo që është. Si më tha Marozovi? Duhej të të dhimbte të

paktën stomaku edhe ty! E pra, pse s'më dhemb?

– Më telefononi, po të ndodhë gjë, – i tha infermieres. Ishte po ajo, së cilës Keti Hegshtrëmi i pati dhuruar gramafonin.

– Zotëria është njeri shumë i shtruar, – i tha ajo.

– Çfarë është ai? – e pyeti Raviku me habi.

– Shumë i shtruar. Një pacient i urtë.

Raviku vështroi përreth. S'kishte aty asgjë që mund t'i bëhej peshqesh kësaj dadoje. Shumë i shtruar – çfarë shprehjesh gjenin nganjëherë këto infermieret! Ky i gjorë po luftonte me të gjitha armatat e qelizave të veta të gjakut e të nervave kundër vdekjes – ai s'ishte as edhe një grimë i shtruar.

Ai u nis për në hotel. Përpara portës takoi Goldbergun. Një burrë plak me një mjekër thinjoshe e me një qostek të artë sahati në jelek.

– Natë e bukur, – ia bëri Goldbergu.

– Po. – Ravikut i shkoi mendja te gruaja në dhomën e Vizenhofit. – Nuk doni të shëtisni edhe pak? – e pyeti.

– Shëtita. Shkova gjer në *Konkordë* dhe u ktheva.

Gjer në *Konkordë*... Atje ndodhej legata amerikane. E bardhë nën dritën e yjeve, e qetë dhe e zbrazët, e paarritshme, një lloj arkë e Noes, ku ndodheshin vulat e vizave për pasaporta. Goldbergu kish'e qëndruar përpara saj, përjashta, dhe e kishte soc'tur me sy të ngrirë kushedi për sa kohë hyrjen dhe dritaret e errëta të godinës, thua se po këqyrte ndonjë tablo të Rembrandtit ose diamantin *Kohinoor*.[1]

– A s'bëjmë edhe një shëtitje të vogël bashkë? Deri te Harku? – e pyeti Raviku plakun, ndërsa me vete mendonte: në i shpëtofsha ata të dy atje sipër, Xhoana do të ketë ardhur ose do të vijë ndërkohë në dhomën time...

Goldbergu tundi kokën:

– Duhet të ngjitem lart tek ime shoqe. Ajo më pret. U bënë më se dy orë që kam dalë.

Raviku vështroi orën. Po shkonte dymbëdhjetë e gjysmë. Ai s'kishte nevojë të shpëtonte askënd. Zonja Goldberg do të qe kthyer me kohë në dhomën e saj. E ndoqi me sy plakun tek ngjitte shkallët avash-avash. Pastaj shkoi te portieri.

– A më telefonoi njeri?

– Jo.

Në dhomë gjeti ndezur dritën e madhe. Iu kujtua se kështu e pati lënë kur iku. Fleta e bardhë ndriste sikur të ishte dëborë e rënë

1. *Kohinoor*: Diamant shumë i madh, 108,93 karat; ndodhet në Thesarin e Kurorës Britanike dhe është marrë nga India, kur kjo ishte koloni e saj.

nga tavani. E mori nga tryeza atë fletë, që e kishte lënë përpara se të ikte e ku kishte shënuar se do të kthehej pas gjysmë ore, dhe e grisi çika-çika. Kërkoi diçka për të pirë, por s'gjeti asgjë. Zbriti përsëri poshtë. Portierit nuk i ndodhej ndonjë shishe *Kalvados*. Kishte vetëm konjak. Raviku bleu tek ai një shishe konjak të markës *Henesi* dhe një shishe *Vuvrej;* pastaj bëri edhe ca muhabet me të. Portieri u përpoq t'ia mbushte mendjen se Luluja II kishte shanset më të mira për të dalë i pari në garën e ardhshme të kuajve dyvjeçarë, që do të zhvillohej në *Sen-Klu*. Spanjolli Alvares kaloi përpara portinerisë. Raviku vuri re se Alvaresi çalonte pakëz. Më në fund ai bleu nga portieri edhe një gazetë dhe u ngjit në dhomë. Sa e gjatë të dukej një natë e tillë! Kush nuk u beson çudirave në dashuri, është i humbur – kështu pati thënë avokati Arensen më 1933 në Berlin. Tri javë më vonë e rrasën në një kamp përqendrimi, sepse e denoncoi dashnorja e vet... Raviku hapi shishen e *Vuvrejit* dhe mori nga tryeza një vëllim të Platonit. Si e lexoi disa minuta, e mbylli librin dhe shkoi e u ul pranë dritares.

Ia mbërtheu sytë telefonit. Ky aparat i zi i mallkuar! Ai nuk mund t'i telefononte Xhoanës. Nuk ia dinte numrin. Nuk dinte bile as ku rrinte me shtëpi. Nuk e kishte pyetur dhe ajo nuk ia kishte thënë. Me sa dukej, nuk ia pati treguar qëllimisht. Kështu që gjithmonë do të mund të gjente një shkak për t'u shfajësuar.

Piu një gotë nga vera e lehtë. Marrëzi, mendoi. Po rri e pres një grua, të cilën sot në mëngjes e kisha këtu. S'e kisha parë tre muaj e gjysmë dhe s'ia ndjeva mungesën sa tani që s'më erdhi vetëm një ditë. Do të kishte qenë më e thjeshtë sikur të mos e kisha parë më kurrë. Të paktën, ashtu isha i parapërgatitur, kurse tani...

U ngrit nga vendi. Jo, s'ishte as kjo. Ishte pasiguria që e brente dhe e gërryente. Ishte dyshimi që i kishte hyrë ngadalë e ngadalë e që s'po e linte të qetë, duke u shtuar ora-orës.

Ia afrua derës. E dinte që nuk e pati kyçur, por, megjithatë, e kontrolloi edhe njëherë. Pastaj filloi të lexonte gazetën; por shkronjat i dukeshin si të kredhura në mjegull. Incidente në Poloni. Shkëmbimet e pashmangshme të zjarrit. Pretendimi për korridorin e Dancigut. Aleanca e Anglisë dhe e Francës me Poloninë. Lufta që po afrohej gjithnjë e më shumë. Ai e la gazetën t'i shkiste përtokë dhe fiku dritën e vogël. Rrinte shtrirë atje në errësirë dhe priste. Gjumi s'po e zinte dot. Shishja e *Henesit* ndodhej mbi tryezë. Ai nuk e hapi. Përsëri e ndezi dritën. U ngrit dhe u ul prapë pranë dritares. Nata ishte e freskët dhe plot yje. Disa mace mjaullinin nëpër oborret fqinje.

Në ballkonin përballë kishte dalë një burrë në të mbathura dhe po kruhej; gogësiti njëherë mirë e mirë e pastaj u fut në dhomën e tij të ndriçuar. Raviku vështroi shtratin. E dinte që s'do të mund të flinte. As leximi s'do t'i bënte dobi. As që e mbante mend ç'kishte lexuar qëparë. Të dilte... kjo do të qe zgjidhja më e mirë. Po ku të shkonte? Kudo ishte njëlloj. Dhe ai as që donte të merrte rrugët në këtë orë. Donte të merrte vesh diçka. Ta marrë djalli!... Shtrëngoi në dorë grykën e shishes së konjakut dhe e vuri prapë në vend. Sakaq shkoi e nxori nga çanta hape gjumi. Ishin nga ato që ia pati dhënë qime-kuqit Finkenshtajn. Ai sigurisht po flinte tani. Raviku e kapërdiu një hape; por nuk iu mbush mendja se do ta zinte gjumi me aq. Mori edhe një tjetër. Po të vinte Xhoana, do të zgjohej gjithsesi.

Ajo nuk erdhi. Nuk erdhi as të nesërmen mbrëma.

21

Ëzhenia futi kokën në dhomën ku dergjej burri pa stomak.

– Zoti Ravik, në telefon!

– Kush më kërkon?

– Nuk e di. Nuk pyeta. Telefonistja ma tha në korridor.

Në fillim Raviku nuk e njohu zërin e Xhoanës. Vinte i mbytur dhe shumë i largët.

– Xhoanë, – tha ai, – ku je?

Zëri dukej sikur vinte nga jashtë Parisit. Ai priste që ajo t'i përmendte ndonjë vend në Rivierë. Kurrë ndonjëherë nuk e kishte marrë në telefon në klinikë.

– Jam në shtëpinë time, – i tha ajo.

– Këtu, në Paris?

– Natyrisht. Ku gjetkë?

– Mos je sëmurë?

– Jo. Pse?

– Sepse po më telefonon në klinikë.

– Të telefonova edhe në hotel. Por ti kishe dalë. Prandaj të mora në klinikë.

– Ka ndodhur gjë?

– Jo. Çfarë të ketë ndodhur? Desha të di si je.

Tani zëri sikur i vinte më qartë. Raviku nxori një cigare dhe një kuti shkrepëse nga xhepi; e shtrëngoi kutinë nën sqetull dhe e ndezi shkrepësen me njërën dorë.

– Këtu në klinikë, Xhoanë, – i tha, – ne presim gjithmonë thirrje telefonike për aksidente dhe sëmundje.

E.N

– Unë s'jam e sëmurë. Jam në shtrat, por nuk jam e sëmurë.

– Mirë.

Raviku nisi të luante me kutinë e shkrepëses, duke e vërvitur sa andej-këtej mbi mushamanë e bardhë të tryezës. Po priste të dëgjonte më tej.

Edhe Xhoana po priste. Ai ia dëgjonte frymëmarrjen. Kërkonte që të fliste ai i pari. Kjo ishte më e thjeshtë për të.

– Xhoanë, – tha ai. – Nuk mund të qëndroj gjatë në telefon. Jam duke lidhur një plagë dhe më duhet të kthehem.

Ajo heshti një copë herë.

– Pse s'je bërë i gjallë? – e pyeti pastaj.

– S'jam bërë i gjallë, sepse s'ta di as numrin e telefonit dhe as adresën.

– Po unë ta kam treguar!

– Jo, Xhoanë.

– Posi jo! Ta kam thënë. – Tani ajo notonte në ujërat e saj. – Jam e sigurt që ta kam thënë. Vetëm se ti do ta kesh harruar prapë.

– Mirë. E paskam harruar. Thuajma edhe njëherë. Kam një laps me vete.

Ajo ia dha adresën dhe numrin e telefonit.

– Jam e bindur që ta kam thënë, Ravik. Me siguri!

– Mirë, Xhoanë. Po shkoj tani. A do të hamë darkë bashkë sonte?

Ajo nuk u përgjigj menjëherë.

– Po ti pse nuk vjen të më vizitosh? – e pyeti pastaj.

– Mirë. Edhe këtë mund ta bëj. Sonte, në orën tetë?

– Pse nuk vjen tani?

– Tani jam në punë.

– Edhe sa punë ke?

– Edhe nja një orë.

– Eja pastaj.

Ah, kështu na qenka puna! Mbrëmjeve s'paske kohë! mendoi ai dhe e pyeti:

– Po pse jo në mbrëmje?

– Ravik, – tha ajo. – Nganjëherë ti s'i kupton as gjërat më të thjeshta. Të vish, sepse kam dëshirë që të vish tani. Nuk dua të pres gjer në mbrëmje. Ndryshe, pse do të të telefonoja në klinikë në këtë orë?

– Mirë. Po vij sapo të mbaroj punë këtu.

Ai e palosi mendueshëm pusullën dhe u kthye tek i sëmuri.

Scanned with CamScanner

*

* *

Ishte një shtëpi në qoshen e rrugës *Paskal*. Xhoana banonte në katin e fundit. Ajo ia hapi derën.

– Eja, – i tha. – Sa mirë që erdhe! Futu brenda.

Kishte veshur një robdëshambrë të zi e të thjeshtë, prerë si për burra. Ishte një nga vetitë e saj që Raviku ia pëlqente: ajo nuk vishej kurrë me aso rrangullash tyli ose mëndafshi. Fytyrën e kishte më të zbehtë se zakonisht dhe i rrëfente njëfarë shqetësimi.

– Eja, – i tha ajo. – Të kam pritur, të shikosh si e kam shtëpinë.

Ajo i priu përpara. Raviku vuri buzën në gaz. Është e shkathët, s'ke ç'i thua. Po m'i del përpara çdo pyetjeje... Ia nguli sytë supeve të saj të bukura e të drejta... Drita i derdhej mbi flokë. Atë çast iu duk sikur iu mor fryma nga një valë dashurie e çmendur.

Xhoana e çoi në një dhomë të madhe. Ishte një studio e kredhur krejt në dritë. Një dritare e lartë dhe e gjerë shikonte nga parqet mes *avënysë Rafael* dhe *avënysë Prudon*. Nga e djathta syri arrinte deri te *Portë dë la Myetë*, pas së cilës dalloheshin ngjyrat e arta e të blerta të një pjesëze të *Pyllit të Bulonjës*.

Dhoma ishte e mobiluar me një shije gjysmëmoderne. Një kanape e madhe me mbulesë të kaltër; disa kolltukë që dukeshin më të rehatshëm nga ç'ishin në të vërtetë; nja dy tryeza tepër të ulëta; një pemë artificiale, një gramafon dhe, në një qoshe, njëra nga valixhet e Xhoanës. Asgjë që nuk shkonte; por megjithatë Ravikut nuk i pëlqeu edhe aq. Ai i donte sendet ose shumë të mira ose shumë të këqija – gjysmaket nuk ia mbushnin syrin. Dhe, sidomos kur shihte pemë artificiale, i vinte për të vjellë.

Ai e ndjeu që Xhoana po e vërente. Dukej sheshit që nuk ishte fort e sigurt ç'përshtypje do t'i bënte atij e gjitha kjo; por, sidoqoftë, aq siguri e kishte pasur, sa t'i futej kësaj valleje e ta ftonte aty.

– Bukur, – tha ai. – E madhe dhe e bukur.

Ai ngriti kapakun e gramafonit. Ishte një aparat i madh, me një mekanizëm që i ndërronte disqet automatikisht. Mbi një tryezë aty pranë ndodhej një turrë disqesh. Xhoana mori disa dhe i vendosi.

– E di si përdoret?

Ai e dinte.

– Jo, – i tha.

Ajo shtypi një buton.

– Është i hatashëm. Punon orë të tëra. S'është nevoja të ngrihesh

nga vendi të ndërrosh disqet dhe xhirot. Mund të rrish shtirë, të dëgjosh e të vështrosh përjashta si ngryset e të ëndërrosh sa të duash.

Aparati ishte vërtet i mrekullueshëm. Raviku e njihte atë markë dhe e dinte që kushtonte afërsisht njëzet mijë franga. Dhoma u mbush me muzikë të ëmbël, të butë – me këngët sentimentale të Parisit. *"Zh'atondre..."*.[1]

Xhoana rrinte kërrusur dhe përgjonte.

– A të pëlqen? – e pyeti.

Raviku pohoi me krye. Ai nuk vështronte aparatin. Vështronte Xhoanën. Kundronte fytyrën e saj, krejt të dhënë e të bjerrur pas muzikës. Sa të lehtë e kishte ajo këtë – dhe sa shumë e pati dashur ai për këtë lehtësi që atij vetë i mungonte!... Kaloi edhe kjo! mendoi ai, pa dhimbje, me një ndjenjë si të një njeriu që largohet nga Italia dhe kthehet në Veriun gjithë mjegull...

Ajo u ngrit dhe i buzëqeshi.

– Eja... s'ma ke parë akoma dhomën e gjumit.

– Duhet ta shoh medoemos?

Ajo i hodhi një shikim të shpejtë hetues.

– Nuk ke qejf ta shohësh? Pse?

– Hë pra, pse? – tha ai. – Natyrisht që do ta shoh.

Ajo ia ledhatoi fytyrën rrëmbimthi dhe e puthi, dhe ai e dinte shkakun.

– Eja, – i tha ajo dhe e mori për krahu.

*

* *

Dhoma e gjumit ishte mobiluar sipas shijes franceze. Shtrati – i madh, i stilit të kohës së Luigjit XVI dhe i mbingarkuar me soj-soj zbukurimesh; e po këtij lloji ishte edhe tryeza e tualetit në formë veshke; një pasqyrë imitim stili barok; një qilim modern nga ana të Obysonit;[2] karrige, kolltukë – të gjitha të kujtonin një skenë filmi të rëndomtë. Dhe midis këtyre orendive spikaste një sënduk fiorentin i shekullit XVI, i bukur e tërë vizatime, që s'shkonte fare me atë ambient dhe që të kujtonte një princeshë midis ca fëmijëve portierësh të pasuruar papritmas. Sënduku ishte rrasur pa kujdes në një qoshe. Një kapelë me vjollca dhe një palë këpucë varaku ishin lënë

1. *J'attendrai*: Të pres...
2. *Aubusson*: Qytet në qendër të Francës, i përmendur për prodhime qilimash.

mbi kapakun e kushtueshëm.

Shtrati ishte i pandrequr. Raviku mund ta dallonte vendin ku kishte qenë shtrirë Xhoana. Një numër shishkash parfumi ndodhesin mbi tryezën e tualetit. Kanatet e dollapit të futur brenda në mur qenë të hapur. Në të ishin varur një mori fustanesh. Shumë më tepër nga ç'kishte pasur Xhoana më parë. Ajo nuk ia kishte lëshuar krahun Ravikut; tani u mbështet krejt pas tij.

– A të pëlqen?

– Bukur. E përshtatshme për ty.

Ajo tundi kokën në shenjë pohimi. Ai e ndjeu krahun dhe gjoksin e saj dhe, pa u menduar, e tërhoqi më fort pranë vetes. Ajo e la dhe nuk kundërshtoi. Supet e saj prekën supet e tij. Fytyrën e kishte të qetë; në të nuk dallohej as hija më e vogël e turbullimit të qëparshëm. Ishte një fytyrë që shprehte siguri të plotë, dhe Ravikut iu bë sikur ato tipare rrëfenin diçka më tepër sesa vetëm kënaqësi të ndrydhur – ndër to dallohej një hije e largët, pothuaj e padukshme triumfi.

Çudi sa fort u shkojnë poshtërsitë këtyre grave, mendoi ai. Domethënë, kjo paska ndër mend të më bëjë një lloj dashnori rezervë dhe, për më tepër, me një paturpësi naive më rrëfeka edhe folenë që dashnori numër një ia ka rregulluar mirë e bukur... E, ç'është më e keqja, në këto çaste më shëmbëlleka me Nikën e Samotrakës.[1]

– Sa keq që s'ke mundësi të kesh edhe ti një shtëpi, – i tha ajo. – Me shtëpi njeriu e ndien veten krejt ndryshe. Krejt ndryshe se në ato dhoma të trishtuara hotelesh.

– Ke të drejtë. Bëra mirë që e pashë se ku banon. Tani po shkoj, Xhoanë...

– Po shkon? Kaq shpejt? Po ti sapo erdhe!

Ai ia mori duart ndër të tijat.

– Po shkoj, Xhoanë. Po iki përgjithmonë. Ti jeton me dikë tjetër. Dhe unë, gratë që dashuroj, nuk i ndaj me burra të tjerë.

Ajo u shkëput me rrëmbim prej tij.

– Si? Çfarë po thua ashtu? Unë... Kush t'i ka rrëfyer këto përralla? Çfarë s'të dëgjojnë veshët në këtë botë! – Ajo e vështroi me sy të zgurdulluar. – E marr me mend se kush ta ka mbushur kokën! Ai Marozovi, natyrisht, ai...

– Lëre Marozovin! Ai s'hyn fare këtu. S'është nevoja të më rrëfejë njeri gjë. Fshati që duket s'do kallauz.

1. *Nika*: Perëndesha e Fitores, sipas mitologjisë greke.

Befas tiparet e saj u shfytyruan nga një inat i papërmbajtur. Kishte qenë krejt e sigurt, kurse tani ja tek po i dështonin të gjitha.

– E di pse ma thua këtë, e di! Sepse kam një shtëpi timen dhe s'punoj më në *Sheherezade!* E prandaj, sipas teje, paskam dikë që më mbaka! Natyrisht! Ndryshe s'ka si të bëhet!

– Unë nuk thashë që të mban ndokush.

– Njësoj është! Kam aq mend sa ta kuptoj! Sefte të fusin në atë farë klub nate, pastaj të lënë vetëm... Dhe kur pastaj këmben dy llafe me dikë, ose kur dikush interesohet pak për ty, atëherë ta ngjitin menjëherë vulën nga pas e të thonë që të mbajnë me para!... E ç'mund të presësh nga një portier, si ai miku yt, përveç fantazisë së ndyrë! Por që vlen vetë diçka, që mund të punosh e të arrish diçka, këtë, natyrisht, që s'mund ta kuptojë dot një tru bakshishesh, si ai truri i tij!... Dhe ti, pikërisht ti, vjen e m'i thua këto fjalë! Si s'të vjen turp!

Raviku u kthye nga ajo, e përfshiu për krahësh dhe e hodhi drejt e në shtrat.

– Kështu! – tha ai. – Dhe tani lëri këto gjepura.

Ajo u shastis aq shumë, saqë mbeti aty ku ndodhej.

– Mos do edhe të më rrahësh? – e pyeti pastaj.

– Jo. Dua vetëm që të pushosh së dërdëllituri.

– Nuk do të çuditesha edhe sikur të më rrihje, – tha ajo me zë të ulët, të ndrydhur. – Aspak nuk do të çuditesha.

Ajo rrinte shtrirë, e palëvizur. Fytyrën e kishte pa asnjë shprehje e të bardhë si çarçaf; nga buzët i kishte ikur gjaku dhe sytë i shkëlqenin pa gjallëri, si xham. Gjoksin e kishte gjysmë të zbuluar dhe njëra këmbë i varej lakuriq nga buza e shtratit.

– Vete e të marr në telefon... – vazhdoi ajo pastaj. – Nuk e di fare se ç'lakra ke në kokë, jam e gëzuar dhe dua të rri ca çaste me ty... e pastaj na del kjo që doli! Kjo që doli! – përsëriti ajo me përbuzje. – Kurse unë, budallaçka, pandehja se ti ishe ndryshe nga të tjerët!

Raviku qëndronte te dera e dhomës së gjumit. Shikonte atë dhomë dhe mobilimin e saj fals, shikonte Xhoanën të shtrirë atje në shtrat dhe e kuptoi sa mirë përputheshin këto me njëra-tjetrën. I erdhi inat që e kishte hapur gojën. Më mirë do të qe, sikur të kishte ikur pa thënë asnjë gjysmë fjale – dhe me kaq, fund! Por atëherë do të kishte ardhur ajo tek ai, dhe prapë njëlloj do të ishte...

– Nuk e prisja kurrë prej teje. Pandehja se ti ishe ndryshe nga të tjerët, – përsëriti ajo.

Ai nuk i dha përgjigje. E gjithë kjo tablo ishte aq bajate, saqë nuk durohej dot. Tani s'po mund ta kuptonte dot si kishte qenë e mun-

Erjonixx

dur që, tri ditë me radhë, pati kujtuar se s'do ta zinte më gjumi po të mos i vinte ajo! E ç'i interesonin akoma të gjitha këto? Nxori një cigare dhe e ndezi. Gojën e kishte të tharë. Dëgjoi gramafonin që lozte akoma. Përsëriste pllakën e parë: "Të pres..." Shkoi në dhomën tjetër dhe e mbylli.

Kur u kthye, Xhoanën e gjeti në po atë qëndrim. Dukej sikur s'kishte lëvizur fare, po robdëshambri ishte pak më i hapur se qëparë.

– Xhoanë, – i tha ai, – sa më pak që të flasim për këtë, aq më mirë do të jetë...

– Nuk isha unë ajo që e ndezi sherrin!

Atë çast ai do t'i kishte hedhur me shumë kënaqësi ndonjë shishe parfumi kokës.

– E di, – i tha. – Unë fillova dhe unë po pushoj.

I ktheu kurrizin dhe u nis për të dalë. Por pa arritur akoma te dera e studios, ajo i mbiu përpara dhe ia zuri rrugën; përplasi derën dhe e zuri me trup, duke u mbështetur me kurriz, me krahë e me duar pas saj.

– Ashtu! – ia bëri ajo. – Po pushoke! Po pushoke dhe po ia mbathke! Shumë gjë e thjeshtë, apo jo? Por kam unë akoma për të të thënë diçka! Kam shumë për të të thënë, bile! Ti, vetë ti, më pe në *Klosh d'Or*! Më pe se me kë isha; dhe kur erdha natën tek ti, nuk t'u bë vonë fare, por fjete me mua; dhe në mëngjes prapë s'po të bëhej vonë fare, s'ishe ngopur mirë dhe përsëri re në shtrat me mua; dhe unë të dashurova, sepse ishe i mrekullueshëm dhe sepse s'kërkoje të dije asgjë... dhe prandaj të dashurova si kurrë më parë!... E dija se ti duhej të ishe i tillë dhe jo ndryshe! Qava kur ti po flije dhe të mbulova me puthje, dhe isha e lumtur, dhe u ktheva në shtëpi dhe përgjërohesha për ty e të adhuroja... Kurse tani!? Tani më vjen këtu e ma përplas fytyrës atë që, kur t'u tek të flije me mua, e shtyve aq mad hërisht mënjanë dhe e harrove; tani ma nxjerr përsëri dhe ma mban përpara syve dhe më rri këtu, si një rojtar virtytesh i fyer sa s'ka ku të vejë më dhe duke më bërë ca skena, sikur të ishe ndonjë bashkëshort xheloz! E, fundja, ç'kërkon nga unë? Ç'të drejtë ke?

– Asnjë të drejtë, – tha Raviku.

– Ashtu! Mirë që e kuptoke, të paktën. E pse më vjen atëherë këtu e ma thua sot? Pse s'ma përplase kur të erdha atë natë në dhomë? Natyrisht, atë natë...

– Xhoanë... – tha Raviku.

Ajo e preu fjalën. Merrte frymë me rrëmbim dhe e vështronte çakërritur sysh.

Erjonixx

– Xhoanë, – i tha ai. – Atë natë që erdhe tek unë, kujtova se po kthe-heshe. Dhe kjo më mjaftonte. Por u gabova. Ti nuk u ktheve tek unë.

– Nuk qenkam kthyer tek ti? Po ç'paskam bërë tjetër? Mos vallë ishte ndonjë fantazmë ajo që të erdhi?

– Ti erdhe tek unë. Por nuk u ktheve tek unë.

– S'po të ndjek dot; e kam trurin tepër të vogël për të të kuptuar. Dua të di vetëm se ç'ndryshim ka në këtë mes?

– Ti e di ndryshimin. Atë natë unë s'e dija. Kurse sot e di. Ti jeton me dikë tjetër.

– Ashtu...? Jetokam me dikë tjetër! Ja tek na doli prapë! Po të kem ca miq, do të thotë që jetokam me dikë tjetër! Mos vallë duhet të rri tërë ditën kyçur e të mos flas me asnjeri, vetëm që të mos të thonë se jetoj me dikë tjetër?

– Xhoanë, – tha Raviku. – Mos u bëj qesharake.

– Qesharake? Kush është qesharake? Ti po bëhesh qesharak!

– Mirë, ashtu po e lemë. Tani, mos ke qejf të të shkul me zor nga ajo derë?

Ajo nuk lëvizi.

– Edhe në paça shkuar me dikë, ty ç'të duhet? Ti vetë më ke thënë që s'do ta dish.

– Mirë. Është e vërtetë që s'doja ta dija. Kujtoja se kishte marrë fund. Të shkuara, të harruara; s'më duhej gjë. Por ja që e kisha pasur gabim. U tregova pa mend. Ka mundësi që kërkoja të gënjeja veten me dashje. Le ta zëmë se ishte një dobësi nga ana ime... por, megji-thatë, kjo nuk ndryshon asgjë.

– Qysh nuk ndryshoka asgjë? Po të bindesh që s'ke të drejtë...

– Këtu s'është puna për të drejtë apo të padrejtë. Ti jo vetëm që ke qenë me një tjetër, por edhe je akoma me të. Dhe do të qëndrosh me të. Këtë unë s'kisha si ta dija atë natë.

– Mos gënje! – e ndërpreu ajo befas krejt e qetë. – Ti e ke ditur gjithmonë. Edhe atë natë e ke ditur.

Ajo e vështroi drejt e në sy.

– Mirë, – tha ai. – E zëmë se e dija. Por ja që atëherë s'doja ta dija. E dija dhe nuk e besoja. Ti s'e kupton dot këtë. Një gruaje nuk i ndodh kështu. E megjithatë, kjo s'ka të bëjë me këtë çështje.

Mbi fytyrën e saj u nder papritmas hija e rëndë e një frike dhe e një ankthi të papërshkrueshëm.

– Por unë nuk kam se si ta flak jashtë, ashtu si pa të keq, një njeri që s'më ka bërë asnjë të keqe, vetëm e vetëm sepse ti mbive prapë këtu, pa pritur e pa kujtuar! A e kupton këtë?

– Po, – tha Raviku.

Ajo qëndronte atje si një mace e zënë ngushtë në një qoshe, së cilës, ndërsa matet të hidhet, ia heqin dyshemenë poshtë këmbëve.

– Po? – ia bëri ajo me habi. Tendosja u zhduk nga sytë e saj dhe vari lehtas supet. – Atëherë pse më torturon, kur e kuptoke? – e pyeti me zë të lodhur.

– Hiqmu nga dera. – Raviku u ul në njërin prej kolltukëve që ishin më të parehatshëm nga ç'dukeshin. Xhoana ngurronte. – Hiqu andej, – i tha ai. – Nuk do të të iki.

Ajo u afrua ngadalë dhe u lëshua mbi kanape. Të jepte përshtypjen sikur qe shumë e kapitur, por Raviku e kuptoi që s'ishte.

– Më jep të pi diçka, – tha ajo.

Ai e mori vesh që donte të fitonte kohë. Por kjo nuk i bëri përshtypje aspak.

– Ku janë shishet? – e pyeti.

– Atje në dollap.

Raviku hapi dollapin e vogël. Ishte i mbushur me shishe. Më të shumtat ishin me krem menteje. I vështroi me neveri dhe i shtyu mënjanë. Në një qoshe gjeti një shishe të markës *Martel* të mbushur përgjysmë dhe një shishe *Kalvadosi*. Shishja e *Kalvadosit* nuk ishte e hapur. E la edhe atë mënjanë dhe mori konjakun.

– Mos e ke kthyer tani me mente? – e pyeti Xhoanën pa ngritur kokën.

– Jo, – iu përgjigj ajo që nga kanapeja.

– Mirë. Atëherë po të sjell konjakun.

– Ka edhe *Kalvados* atje, – tha ajo. – Na e hap shishen e *Kalvadosit*.

– Konjaku mjafton.

– Hape *Kalvadosin*.

– Herë tjetër.

– Nuk dua konjak. Dua *Kalvados*. Të lutem, hape shishen.

Raviku hodhi përsëri sytë në dollap. Ja, atje nga e djathta, ishte shishja e mentes për atë tjetrin – kurse nga e majta, *Kalvadosi* për të. Ky rregull prej amviseje gati sa s'të mallëngjente... Ai nxori shishen e *Kalvadosit* dhe ia hoqi tapën. E pse jo? Ah, ky simbol i urtë i pijes së preferuar! Ca njolla ngjyrash sentimentale, të hedhura mbi një tablo të lerosur, që paraqiste një ndarje... Ai mori dy gota dhe shkoi te tryeza. Xhoana e shikonte me vëmendje teksa mbushte gotat.

Pasdrekja nderej e madhe dhe e artë përpara dritares. Drita kishte marrë ngjyra të gjalla dhe qielli qe kthjelluar. Raviku i hodhi një sy orës. Kishte kaluar pak nga treshi. Ai vështroi akrepin e sekondave,

sepse pandehu që ora i kishte mbetur. Por akrepi po i çukiste me radhë vizat e holla të fushës, sikur të ishte një sqep i vockël prej florriri. Pra, ishte e vërtetë – ai s'kishte më shumë se një gjysmë ore në këtë apartament. Krem menteje! mendoi. Çfarë shije!...

Xhoana qe mbledhur kruspull atje mbi kanapenë bojëqielli.

– Ravik, – ia nisi ajo me zë të butë, të kapitur dhe gjithë kujdes. – Mos përdore përsëri ndonjë nga ato marifetet e tua qëparë, apo më kuptove vërtet?

– Nuk ishte marifet. Ishte e vërtetë.

– Domethënë, ti e kupton?

– Po.

– E dija. – Ajo i dhuroi një buzëqeshje. – E dija, Ravik.

– Është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar.

Ajo pohoi me krye.

– Më duhet njëfarë kohe. Nuk mund të shkëputem menjëherë. Ai është një njeri që s'më ka bërë asnjë të keqe. Vetëm të mira. E ku mund ta dija që ti do të ktheheshe përsëri? S'kam sesi t'ia them ashtu menjëherë.

Raviku e rrëkëlleu të gjithë gotën në gurmaz.

– Ç'na duhen hollësirat?

– Është mirë që ta dish, që ta kuptosh. Është puna... Më duhet njëfarë kohe. Ai do të... Nuk e di se ç'do të bënte ai pastaj. Ai më dashuron. Ka nevojë për mua. E ç'faj ka ai në këtë mes!

– Natyrisht që s'ka faj. Mos u ngut fare, Xhoanë. Ke kohë sa të duash.

– Jo. Më duhet vetëm pak kohë. Menjëherë nuk mundem. – Ajo u mbështet në jastëkët e kanapesë. – Dhe puna e këtij apartamenti, Ravik... nuk është ashtu siç mund të pandehësh ti. Unë fitoj vetë tani. Më shumë se më parë. Ai më ka përkrahur. Është aktor. Kam marrë role të vogla nëpër filma. Ai m'i ka rregulluar.

– E mora me mend.

Ajo bëri sikur s'e dëgjoi.

– Nuk kam shumë talent, – vazhdoi. – Këtë e kam të qartë dhe as që dua ta gënjej veten. Por desha të shpëtoja nga klubet e natës. Atje njeriu s'çan dot përpara. Kurse këtu ku jam tani, mund të ngrihem... edhe pa shumë talent. Dua të bëhem e pavarur. Ti, ndoshta, i quan qesharake të gjitha këto...

– Jo, – tha Raviku. – Është punë me mend.

Ajo i hodhi një shikim.

– A nuk erdhe në Paris pikërisht për këtë qëllim... atëherë, në fillim fare? – e pyeti ai në përgjigje të atij shikimi.

– Po.

Ja tek po më rri atje, mendonte Raviku. Si një krijesë e pafajshme që ankohet me zë të ulët dhe e përvuajtur, ngaqë jeta dhe unë i paskemi dhënë goditje të rënda. Tani ajo është qetësuar, sulmi i parë u zmbraps; do të shtiret sikur do të më falë dhe, po të mos ia mbath sa më parë, do të fillojë të më rrëfejë me të gjitha hollësitë historinë e muajve të fundit... kjo orkide prej çeliku, tek e cila erdha për t'i dhënë fund njëherë e mirë kësaj meseleje dhe që tani më solli gjer në atë pikë, sa të detyrohem t'i jap edhe të drejtë...

– Mirë, Xhoanë, – i tha. – Tani ia arrite qëllimit. Ke për të ecur përpara.

Ajo lëvizi nga vendi.

– A thua?

– Me siguri.

– Vërtet, Ravik?

Ai u ngrit. Edhe tri minuta dhe ajo do ta ngatërronte me siguri në ndonjë bisedë profesionale mbi filmat. Me gratë nuk duhej diskutuar, mendoi ai. Del gjithmonë i humbur. Në duart e tyre logjika kthehet në dyllë dhe përpunohet sipas qejfit. Duhej vetëm veprim – dhe pikë!

– Kaq thellë mos më fut, – i tha ai. – Për këso punësh pyet më mirë atë specialistin tënd.

– Do të ikësh? Kaq shpejt? – e pyeti ajo.

– Duhet.

– Pse nuk rri edhe ca?

– Duhet të kthehem në klinikë.

Ajo ia mori dorën në duart e veta dhe ngriti sytë drejt tij.

– Në telefon më the se, kur të vije tek unë, do t'i kishe kryer të gjitha punët në klinikë.

Ai u mendua një hop në t'ia thoshte copë që s'do të vinte kurrë më. Por për sot duhej lënë me kaq. Ishte mjaft. Mjaft edhe për të, edhe për vete. Sidoqoftë, ajo ia kishte dalë mbanë ta shmangte fjalën e fundit. Por fundi do të vinte vetvetiu.

– Rri edhe pak, Ravik, – tha ajo.

– Nuk mundem.

Ajo u ngrit më këmbë dhe u mbështet fort pas tij. Edhe kjo mungonte! mendoi ai. Loja e lashtë. E lirë dhe e sprovuar. Ajo s'po lë asgjë mangët. Po kush është ai që mund të kërkojë nga një mace të pijë uthull?...

Ai u shkëput prej saj.

– Më duhet të shkoj. Në klinikë është shtruar një burrë që po vdes.

– Mjekët gjejnë gjithmonë arsye të forta, – tha ajo me ngadalë dhe e vështroi drejt e në sy.

– Njëlloj si gratë, Xhoanë. Ne administrojmë vdekjen, kurse ju dashurinë! Të dyja kanë gjithë arsyet dhe gjithë të drejtat e botës.

Ajo nuk i dha përgjigje.

– Po ne kemi edhe stomak të fortë, – tha Raviku. – Duhet ta kemi medoemos të tillë. Ndryshe s'do t'ia dilnim dot. Atëherë kur të tjerëve u bie të fikët, ne fillojmë e gjallërohemi... Lamtumirë, Xhoanë!

– Kur do të vish prapë, Ravik?

– Mos e vrit mendjen për këtë. The se kishe nevojë për kohë. Ke kohë sa të duash. Do ta gjesh vetë zgjidhjen.

Ai u drejtua me nxit nga dera dhe nuk e ktheu më kokën. Ajo nuk e ndoqi pas. Por ai e dinte që po e ndiqte me sy. E ndiente veten çuditërisht të shurdhër – sikur po ecte nën ujë.

E.N

22

Ulërima erdhi nga dritarja e familjes Goldberg. Raviku mbajti vesh. Iu duk si e pamundur që plaku Goldberg t'i kishte hedhur së shoqes ndonjë gjë kokës ose ta kishte rrahur. Paskëtaj nuk u dëgjua ulërimë tjetër. Vetëm hapa që rendnin, pastaj një bashkëbisedim i shqetësuar në dhomën e emigrantit Vizenhof dhe të përplasura dyersh.

Një çast më vonë trokitën në derën e tij dhe pronarja e hotelit u sul në dhomë:

– Shpejt... shpejt... Zoti Goldberg.

– Çfarë ka?

– Ka varur veten. Në dritare. Nxitoni!...

Raviku flaku mënjanë librin që po lexonte.

– Ka ardhur gjë policia?

– Natyrisht që jo. Ndryshe s'do t'ju kisha thirrur! E shoqja tani sapo e gjeti.

Raviku u turr bashkë me të tatëpjetë shkallëve.

– A e prenë litarin?

– Akoma jo. Po e mbajnë...

Në dhomën e mugët shquhej një grup i errët, i grumbulluar pranë dritares: Ruth Goldbergu, emigranti Vizenhof dhe dikush tjetër. Raviku ndezi dritën. Vizenhofi dhe Ruth Goldbergu e mbanin plakun Goldberg ndër krahë ashtu siç mbahet një kukull, ndërsa njeriu i tretë po rrekej me nervozizëm të zgjidhte nyjën e një kravate, që ishte lidhur në dorezën e kanatave të dritares.

– Priteni!

– Nuk na ndodhet asnjë thikë! – thirri Ruth Goldbergu.

Raviku nxori një gërshërë nga çanta e vet e vogël, që e kishte marrë nxitimthi me vete, dhe filloi të priste. Kravata ishte prej mëndafshi të trashë e të lëmuar, dhe u deshën disa sekonda derisa u pre. Gjatë kësaj pune Raviku e kishte fytyrën e Goldbergut shumë pranë... Ata sy të kërcyer, atë gojë të hapur, mjekrën e thinjur me qime të rralla, gjuhën e nxjerrë, kravatën jeshile me pikla të bardha, e cila ishte futur thellë në lëkurën e rrudhur e të ënjtur të qafës... Trupi luhatej lehtas në krahët e Vizenhofit dhe të Ruth Goldbergut, thua se përkundej sa andej-këtej, me atë fytyrë të ngërdheshur nga një skërmitje e tmerrshme që i kishte ngrirë mbi buzë.

Fytyra e Ruth Goldbergut ishte skuqur dhe qullur nga lotët dhe, pranë saj, Vizenhofi po kullonte djersë nga pesha e atij trupi, që tani ishte më i rëndë se kurrë ndonjëherë. Dy fytyra të qullura, të llahtarisura, dy njerëz që gulçonin dhe, sipër tyre, koka që varej pa fuqi dhe i zgërdhihej së Përtejshmes; dhe kur Raviku arriti ta priste kravatën, ajo kokë u kapit e u përplas pas gjoksit të Ruth Goldbergut, e cila klithi me të madhe dhe u zmbraps e llahtarisur, duke ngritur duart përpjetë; trupi i të vdekurit rrëshqiti mënjanë dhe u duk sikur po e ndiqte me një lëvizje groteske prej klouni. Raviku e priti dhe, me ndihmën e Vizenhofit, e shtriu mbi dysheme. Ia hoqi lakun e kravatës dhe zuri ta kontrollonte.

– Në kinema... – filloi të dërdëlliste Ruth Goldbergu. – Në kinema më dërgoi... Ruth, të keqen, më tha, ti s'ke asnjëfarë argëtimi, moj e gjorë! Pse nuk shkon njëherë në kinema *Kurselë*? Atje ka dalë një film me Greta Garbon, "Mbretëresha Kristinë". Shko shikoje! Zër një vend të mirë, kolltuk në plate; ose zër një lozhë, po të duash. Shko shikoje atë film. I thonë të shpëtosh dy orë nga kjo mizerje; dy orë janë goxha!... Ai më foli krejt i qetë dhe butë e butë; më ledhatoi edhe faqet... E pastaj shko e ha edhe një akullore me vanilje ose me çokollatë tek ajo pastiçeria pranë *Park Monsosë*, më tha. Shko e kënaqu njëherë e dashur... Dhe unë shkova, e kur u ktheva pastaj, atëherë...

Raviku u ngrit. Ruth Goldbergu e preu ligjëratën.

– Duhet ta ketë bërë menjëherë sapo ikët ju, – tha ai.

Ajo i mblodhi duart grusht dhe i çoi te goja:

– Domethënë, ai ka...

– Do të provojmë edhe diçka. Frymëmarrjen artificiale. Ju, a keni haber nga kjo punë? – e pyeti Raviku Vizenhofin.

– Jo. Jo shumë. Diçka.

– Shikoni këtu!

Raviku zuri krahët e Goldbergut dhe i shtriu anash sa takuan

dyshemenë; pastaj i shpuri përsëri gjer në gjoks, duke ia shtypur mushkëritë me forcë; pastaj përsëri anash e përsëri përpara. Gurmazi i Goldbergut filloi të regëtinte.

– Jeton! – klithi e shoqja.

– Jo. Kjo është trakeja e shtypur.

Raviku i demonstroi edhe disa herë ato lëvizje.

– Provojeni ju tani, – i tha Vizenhofit.

Vizenhofi u gjunjëzua me ngurrim pranë kokës së Goldbergut.

– Filloni! – i tha Raviku me padurim. – Zëreni nga kyçet e duarve ose më mirë nga krahët.

Vizenhofit i plasën djersët.

– Më fort! – tha Raviku. – Nxirrjani të gjithë frymën nga mushkëritë.

Ai u kthye nga pronarja e hotelit. Ndërkohë në dhomë kishin ardhur edhe njerëz të tjerë. I bëri shenjë pronares që ta ndiqte pas.

– Plaku ka vdekur, – i tha jashtë në korridor. – Ajo që po bëhet atje brenda, është marrëzi. Një ritual që duhet bërë, dhe asgjë tjetër. Do të ndodhte një mrekulli, po të bënte dobi.

– E ç'duhet të bëjmë tani?

– Të zakonshmen.

– Të thërrasim Ndihmën e Shpejtë? Dhe dhjetë minuta më vonë policinë?

– Policinë duhet ta thërrisni se s'bën. A kanë dokumente Goldbergët?

– Po. Të mira fort, bile. Edhe pasaporta edhe letërnjoftime.

– Po Vizenhofi?

– Ka një leje qëndrimi. Vizë të zgjatur.

– Mirë. Atëherë puna qenka në rregull për ju. U thoni atyre të dyve që mua të mos më zënë në gojë fare. U thoni që ajo u kthye në shtëpi, e gjeti në atë gjendje, ia dha ulërimës, Vizenhofi preu kravatën dhe u mundua t'i bënte derman, derisa mbërriti ambulanca... A mund ta sajoni kështu?

Pronarja e vështroi me ata sytë e saj prej zogu.

– Natyrisht. Unë gjithsesi s'do të luaj nga dhoma, derisa të vijë policia. Do ta kem kujdes vetë.

– Në rregull.

Ata u kthyen në dhomë. Vizenhofi qe përkulur mbi Goldbergun dhe vazhdonte punën. Për një çast të krijohej përshtypja sikur të dy po bënin ushtrime gjimnastikore në dysheme. Pronarja qëndroi te pragu.

– Zonja dhe zotërinj! – ia nisi ajo. – Më duhet të thërras Ndihmën e Shpejtë. Sanitari ose mjeku që do të vijë, do të lajmërojë pastaj policinë. Të shumtën pas një gjysmë ore atë do ta kemi këtu. Kush nga ju s'ka dokumente, është më mirë të mbledhë polaçkat, ose të paktën ato rraqe që ka hedhur nëpër dhomë, dhe t'i çojë në *Katakombë*, duke qëndruar edhe vetë atje poshtë. Ka mundësi që policia të kontrollojë dhomat ose të kërkojë dëshmitarë.

Dhoma u boshatis menjëherë. Pronarja i bëri një shenjë me kokë Ravikut, që deshi të thoshte se ajo do t'u jepte udhëzimet përkatëse Ruth Goldbergut dhe Vizenhofit. Raviku mori çantën dhe gërshërën e tij që ndodheshin në dysheme, pranë kravatës së prerë. Në një çip të kravatës dallohej firma e prodhuesit: *S. Ferder, Berlin*. Ishte një kravatë që kishte kushtuar të paktën dhjetë marka. Goldbergu do ta kishte blerë në kohët e tij të mirëqenies. Raviku e njihte atë firmë. Kishte qenë vetë klient i saj dikur... Ai i mblodhi plaçkat e veta në dy valixhe dhe i degdisi në dhomën e Marozovit. Ishte vetëm një masë sigurimi. Ndoshta policia nuk do të interesohej për asgjë. Por, megjithatë, kështu ishte më mirë. Raviku e kishte akoma tepër të gjallë në kujtesë surratin e atij Fernanit. Ai zbriti në *Katakombë*.

Disa njerëz po rendnin atje lart e poshtë, të shqetësuar. Ishin emigrantët që nuk posedonin dokumente. Brigada ilegale. Klarisa, kamerierja, dhe Zhani, kamerieri, i dirigjonin valixhet në një kthinë si punë qilari, mu pranë *Katakombës*. Kurse brenda në *Katakombë* ishte përgatitur darka. Tryezat ishin shtruar, tani po sillnin shportat me bukë, dhe nga kuzhina vinte erë salloje dhe peshku.

– Keni kohë boll për të ngrënë, mos e prishni gjakun, – u thoshte Zhani emigrantëve nervozë. – Policia i merr punët shtruar.

Por emigrantët i kishin punët me ngut. Ata s'ishin mësuar të përkëdheleshin nga fati. Nxitonin të futeshin në atë qilar sa më shpejt, duke mbajtur ndër duar ato pak rraqe që kishin. Në mes tyre ndodhej edhe spanjolli Alvares. Hotelierja kishte çuar lajm në gjithë hotelin se do të vinte policia. Alvaresi i buzëqeshi Ravikut nga tryeza e vet në një mënyrë të tillë, sikur po i kërkonte ndjesë për diçka. Raviku s'e mori vesh ku e kishte hallin.

Një burrë thatim po afrohej qetë e qetë. Ishte Ernest Zajdenbaumi, doktor në filologji dhe filozofi.

– Manovër? – iu drejtua ai Ravikut. – Provë gjenerale. Do të qëndroni në *Katakombë*?

– Jo.

Zajdenbaumi, veteran qysh prej gjashtë vjetësh, ngriti supet:

– Unë po qëndroj. S'kam aspak qejf t'ia mbath. S'ma ha mendja që ata të policisë të futen në hollësira të tjera, përveç ekspertizës. E kush do të interesohet për një çifut gjerman, plak e të vdekur?

– Për atë jo. Por mund të interesohen për refugjatë të gjallë, ilegalë.

Zajdenbaumi rregulloi monoklin.

– Aq më bën! E dini se ç'bëra gjatë bastisjes së fundit? Njëfarë rreshteri na u mundua bile gjer këtu poshtë, në *Katakombë*. Këtu e dy vjet të shkuara. Unë vesha njërën nga xhaketat e bardha të Zhanit dhe fillova të shërbeja. Konjak për policinë.

– Ide e mirë.

Zajdenbaumi tundi kokën.

– Vjen një kohë kur njeriu fillon e mërzitet edhe nga të ikurit. – Ai u drejtua i qetë për në kuzhinë; kishte dëshirë të inspektonte ç'përmbanin tenxheret.

Raviku doli nga dera e pasme e *Katakombës* që të shpinte në oborr. Një mace iu ngatërrua nëpër këmbë. Përpara tij po ecnin varg të tjerët. Ata u shpërndanë me nxit nëpër rrugë. Alvaresi çalonte pakëz. Ndoshta mund t'i rregullohej këmba me një operacion të vogël, i shkoi mendja Ravikut ashtu kot...

Po rrinte në një restorant në *Plas dë Ternë* dhe befas e pushtoi një parandjenjë që atë natë do t'i vinte Xhoana. Nuk ishte i zoti ta shpjegonte këtë ide fikse – vetëm se ashtu i qe mbushur mendja.

Pagoi darkën që hëngri dhe u nis me ngadalë për në hotel. Ishte një natë e ngrohtë dhe tabelat e hoteleve që bënin punën e bordeleve, duke lëshuar dhoma vetëm për një orë, feksnin të kuqe nëpër rrugët e ngushta. Përmes perdeve të dritareve depërtonte drita e mekur. Një grup marinarësh u ishte qepur pas disa prostitutave. Ishin të gjithë të rinj e të zhurmshëm e të ndezur nga alkooli dhe nga stina e verës – dhe, ashtu siç ishin, u futën në njërin prej hoteleve. Nga diku u dëgjuan akordet e një fizarmonike. Një mendim shpërtheu posi fishekzjarr në trurin e Ravikut, u shpërnda në mijëra stërkala drite dhe ndriçoi një pamje të fshehur diku në errësirë: iu fanit Xhoana tek e priste në hotelin e tij, për t'i thënë se i kishte braktisur e kapërcyer të gjitha dhe se po kthehej sërish... Xhoana tek po e mbulonte e po e përmbyte me ngrohtësi e afsh dashurie të çmendur...

Ai ndali hapin. Ç'kam kështu? mendoi. Ç'po rri këtu, dhe duart e mia po e ndiejnë ajrin sikur të ishte një qafë gruaje dhe një tufë flokësh të artë? Tepër vonë! Asgjë nuk mund të rimerret. Askush nuk kthehet më. Po ashtu siç nuk kthehet kurrë më një orë e jetuar...

Ai vazhdoi rrugën për në hotel; kaloi oborrin dhe, nga dera e pasme, u fut në prapë *Katakombë*. Që nga pragu i dalloi njerëzit që ishin ulur nëpër tryeza. Midis tyre ndodhej edhe Zajdenbaumi. Jo si kamerier, por si klient. Me sa dukej, rreziku kishte kaluar. Raviku hyri në sallë.

Marozovi ndodhej në dhomën e vet.

– Sapo desha të dilja, – i tha ai Ravikut. – Kur pashë valixhet e tua, pandeha se ia kishte mbathur përsëri andej nga Zvicra.

– Vajti çdo gjë në rregull?

– Po. Policia nuk vjen më. Bile e lëshoi menjëherë lejen e varrimit. Rast i qartë. I vdekuri është lart. Po e përgatitin.

– Mirë fort. Domethënë, mund të futem prapë në furrikun tim.

Marozovi filloi të qeshte.

– Veç ta kishe parë Zajdenbaumin tonë! – tha ai. – U fut në valle dhe s'u tund gjatë gjithë kohës. Mbante në dorë një çantë dosjesh me ca si biçim dokumentesh dhe u sillej atyre të policisë nëpër këmbë me gjithë monoklin e vet. U shtir si avokat dhe përfaqësues i sigurimeve shoqërore. U hëngër edhe me fjalë me ata të policisë. Ua hoqi duarsh pasaportën e plakut Goldberg. Nguli këmbë se i nevojitej për çështje zyrtare dhe se policia kishte të drejtë të merrte vetëm letërnjoftimin, por jo pasaportën. Dhe ua hodhi vërtet... Po ai vetë a ka dokumente?

– As edhe një!

– Shumë mirë, – ia bëri Marozovi. – Atë pasaportë ta peshojnë me flori. Skadon pas një viti, pra ndokush mund të jetojë me të. Ndoshta jo pikërisht në Paris, po nuk qe aq kokëkrisur sa Zajdenbaumi. Fotografia mund të zëvendësohet kollaj. Ndërsa për ndërrimin e datëlindjes, në rast se Aron Goldbergu i dytë qëllon të jetë tepër i ri, ka ustallarë që s'kërkojnë shumë. Mënyrë moderne e shtegtimit të shpirtrave: një pasaportë për shumë jetë njerëzore.

– Shkurt hesapi, që sot e tutje Zajdenbaumi na u quajtka Goldberg?

– Zajdenbaumi jo. Kundërshtoi t'i hynte kësaj pune, sepse i ulej dinjiteti. Zajdenbaumin e kemi Don Kishotin e qytetarëve të nëndheshëm si puna jonë. Ka një kureshtje fataliste tepër të zhvilluar për të marrë vesh se ç'do të ndodhë me tipin e tij, saqë të falsifikojë veten me një pasaportë të dikujt tjetër. Po sikur ta shtije ti në dorë atë pasaportë? Si thua?

– S'ma ka qejfi. – Raviku tundi kokën. – Për këtë çështje jam në një mendje me Zajdenbaumin.

Ai mori valixhet e veta dhe iu ngjit shkallëve përpjetë. Tek po i afrohej dhomës së Goldbergëve, i kaloi pranë me çap të nxituar një plak çifut, me kaftan të zi e me mjekër; fytyra i shëmbëllente me atë të një patriarku biblik. Plaku shkelte pa zhurmë me ato këpucët e tij prej gome dhe dukej sikur nderej i ngrysur e i zbehtë në hapësirën e korridorit të mugët. Ai hapi derën e Goldbergëve. Një dritë e kuqërremtë, si dritë qirinjsh, depërtoi për një çast gjer jashtë, dhe Ravikut i zuri veshi një kujë monotone, gjysmë të mbytur e gjysmë të egër, pothuajse melankolike. Mos janë vajtorë? i shkrepi në mendje. A është e mundur të ushtrohet akoma një gjë e tillë?! Apo mos ishte vetëm Ruth Goldbergu që qante ashtu?

*

* *

Ai hapi derën e dhomës së vet dhe pikasi Xhoanën ulur te dritarja. Ajo u hodh përpjetë.

– Erdhe? Ç'ka ndodhur? Ç'i ke ato valixhe? Mos duhet të ikësh përsëri?

Raviku i lëshoi valixhet pranë shtratit.

– Asgjë s'ka ndodhur. Ishte vetëm një masë sigurimi. Dikush na vdiq dhe duhet të vinte pollicia. Tani gjithçka është përsëri në rregull.

– Të mora ne telefon. Më doli dikush e më tha se nuk banoje më këtu.

– Do të ketë qenë hotelierja jonë. E kujdesshme dhe e mençur si përherë.

– Pastaj renda për te ti. Dhoma ishte e hapur dhe e zbrazët. Plaçkat s'i kishe këtu. Më shkoi mendja... Ravik! – Zëri i saj dridhej.

Raviku buzëqeshi me zor:

– Ti po e shikon vetë... jam një krijesë e paqëndrueshme. Askush s'mund të mbështetet tek unë, dhe bën mirë të mos mbështetet.

Trokiti dera. Në prag u shfaq Marozovi.

– Ravik, ke harruar municionin.

Ai pa Xhoanën tek rrinte në errësirë atje pranë dritares dhe bëri sikur s'e vuri re. Raviku nuk ishte i sigurt në e njohu ose jo. Marozovi ia la shishet në dorë dhe u largua pa hyrë fare në dhomë.

Raviku i vuri shishet e *Kalvadosit* dhe të *Vuvrejit* mbi tryezë. Nga dritarja e hapur i erdhi në vesh zëri që pati dëgjuar qëparë në korridor. Vaji i përmortshëm. Kuja ngrihej si baticë deti, ulej si zbaticë dhe ia niste sërishmi nga e para. Me sa dukej, dritaret e Goldbergëve

ishin lënë hapur atë natë të butë, në të cilën trupi i ngrirë i plakut Aron po fillonte të dekompozohej ngadalë në atë dhomë të mbushur plot orendi prej druri të kuq.

– Ravik, – ia nisi Xhoana. – Jam e trishtuar. As vetë nuk e di sepse. Kam tërë ditën në këtë gjendje. Lërmë të rri këtu.

Ai nuk iu përgjigj menjëherë. E ndjeu veten si të zënë në befasi. Këtë gjë e kishte pritur ndryshe, jo në mënyrë kaq të drejtpërdrejtë.

– Për sa kohë? – e pyeti pastaj.

– Deri nesër.

– Nuk qenka dhe aq gjatë sa ç'duhet të jetë.

Ajo u ul mbi shtrat:

– A s'mund ta harronim njëherë këtë mesele?

– Jo, Xhoanë.

– Unë s'po të kërkoj gjë. Dua vetëm të fle pranë teje. Ose lermë të fle në kanape.

– Punë që s'bëhet. Më duhet të dal përsëri. Do të shkoj në klinikë.

– S'ka gjë. Do të të pres. Këtë e kam bërë edhe herë të tjera.

Ai nuk i dha përgjigje. Habitej që e ndiente veten kaq të qetë. Afshi dhe emocioni që pati ndier qëparë në rrugë, ishin zhdukur.

– Unë e di që edhe në klinikë s'ke ndonjë punë. Vetëm se e shpike kot, – tha Xhoana.

Ai heshti një copë herë. E dinte që do të ishte i humbur po të flinte me të. Ishte njëlloj sikur të nënshkruante një kambial që s'ishte i mbuluar me asnjë dyshkë në bankë. Ajo do të vazhdonte t'i vinte përsëri e përsëri, duke ia përmendur vazhdimisht atë që kishte arritur dhe, çdo radhë, do t'i kërkonte diçka, pa hequr dorë nga asgjë, gjersa ai të ndodhej krejt në duart e saj dhe ajo ta braktiste më në fund, e mërzitur dhe e neveritur, duke e lënë vetëm e të thyer, viktimë të dobësisë dhe të pasionit të tij të shurdhër... Sigurisht që ajo s'e kishte vënë në plan një gjë të tillë; bile as që i shkonte ndër mend; por një ditë prej ditësh kështu do të vinte puna. Ishte shumë e thjeshtë të mendoje se, fundja, një natë nuk mund të sillte ndonjë ndryshim; por çdo radhë të shpëtonte nga duart një copëz qëndrese dhe një copëz e asaj që s'duhej korruptuar kurrë në jetë. "Mëkat ndaj shpirtit" e quante këtë katekizmi katolik me një frikë çuditërisht të ndjeshme dhe, në kundërshtim të hapur me të gjithë doktrinën e vet, shtonte në mënyrë të ngatërruar e të pashpjegueshme se ky lloj mëkati nuk falej as në këtë dhe as në atë botë...

– Është e vërtetë, – tha Raviku. – As në klinikë s'kam ndonjë punë. Por nuk dua që ti të qëndrosh këtu.

Ai priste ndonjë shpërthim. Por ajo ia priti, krejt e qetë:

– Pse nuk do?

A të përpiqej t'ia shpjegonte? Dhe a ishte vërtet në gjendje ta bënte këtë?...

– Ti nuk e ke më vendin këtu, – i tha.

– Këtu e kam vendin!

– Jo!

– Pse jo?

Ai heshti. Sa e shkathët që është! mendoi. Me pyetje të thjeshta po e detyronte të jepte shpjegime. Dhe kush niste e shpjegohej, kalonte pothuajse në mbrojtje.

– Ti e di, – tha ai. – Mos bëj pyetje të marra.

– Ti s'më do më?

– Jo, – u përgjigj ai dhe, kundër vullnetit të vet, shtoi: – Jo në këtë mënyrë.

Nga dritarja depërtonte vaji i vazhdueshëm dhe i njëllojtë që dilte nga dhoma e Goldbergëve. Kuja për të vdekurin. Jazi i hebrenjve të lashtë në një rrugë anësore të Parisit.

– Ravik, – tha Xhoana. – Duhet të më ndihmosh.

– Ndihma më e mirë është të të lë vetëm. Edhe ti mua gjithashtu.

Ajo vazhdoi me të sajën:

– Ti duhet të më ndihmosh. Mund të të gënjeja, por s'dua të të gënjej më. Është e vërtetë që kam të bëj me dikë. Por me ty është ndryshe. Po të ishte njëlloj, s'do të ndodhesha këtu.

Raviku nxori një cigare nga xhepi. E ndjeu midis gishtërinjve letrën e hollë e të thatë. Pra, kështu qenka puna. Tani e mori vesh mirë. Ishte si një thikë e ftohtë që s'të dhimbte kur të futej në mish. Siguria s'të dhimbte kurrë – vetëm e mëparshmja dhe e mëvonshmja.

– Këto punë s'janë kurrë njëlloj, – tha ai, – e prapëseprapë gjithmonë njëlloj janë. – Ndërsa, me vete, mendonte: Ç'po flas gjepura kot. Paradokse gazetash. Sa trashanike mund të duken të vërtetat, kur i nxjerr nga goja!...

Xhoana u ngrit nga vendi.

– Ravik, – tha ajo, – ti e di që s'është ashtu. Ti e di që njeriu mund të dashurojë vetëm një njeri. Ka njerëz që veprojnë vetëm kështu... dhe janë të lumtur. Dhe ka të tjerë që përplasen sa andej-këtej e s'gjejnë rehat. Ti e di këtë.

Ai e ndezi cigaren. Pa i hedhur sytë fare nga ajo, e dinte fort mirë se si dukej Xhoana në ato çaste: e zbehtë, me sy të veshur, e qetë, e përqendruar, me një shprehje pothuajse lutëse, e brishtë – por

e pathyeshme. Po këtë pamje kishte marrë atë pasdreke kur ai i pati shkuar në shtëpi – si një engjëll fatsjellës, që të mbushte me besim e me bindje dhe që shtirej sikur donte të të shpëtonte, ndërsa përpiqej të të mbërthente dalë e ngadalë në kryq, që të mos i shpëtoje kurrë më nga duart...

– Po, – ia bëri ai. – Kjo që thua ti, është një nga mënyrat, me të cilat duam t'ia mbushim mendjen vetes. Është një justifikim.

– Nuk është justifikim. Njeriu nuk ndien ndonjë lumturi kur është krijuar i tillë. Futet në vorbull e s'mund të shpëtojë më. Është diçka e errët, një lëmsh i ngatërruar; është si ngërçi që të zë e s'të lëshon... diçka që duhet ta kapërcesh, por s'e kapërcen dot. Të ndjek e të arrin edhe kur ti s'do. Por ja që është më e fuqishme!...

– Pse e vret mendjen për këtë? Pse nuk e ndjek pas, meqë është më e fuqishme?

– Atë po bëj. E di që rrugë tjetër s'ka për mua. Por... – Zëri i ndërroi. – S'dua të të humbas, Ravik!

Raviku heshtte. Tymoste, por cigaren nuk e ndiente. Ti s'do që të më humbasësh, mendonte. Por as atë tjetrin s'do që ta humbasësh. Kjo është çështja. Dhe meqë ti je e zonja ta bësh këtë – prandaj duhet të largohem tejet! Nuk është puna se ke të bësh me një njeri – kjo do të ishte harruar shpejt. Do t'i kishe të gjitha llojet e shfajësimeve në anën tënde. Por puna është se të ka zënë aq keq qymyri, sa që s'po shkëputesh dot. Këtu qëndron meseleja! Megjithatë, do të vijë dita që do të shkëputesh. Por do të të ndodhë përsëri. E ke në gjak. Ca kohë më parë kështu veproja edhe unë, dhe e kisha kollaj. Por me ty s'mund të veproj kështu. Prandaj dua të shkëputem, duhet të shkëputem prej teje. Tani, sa jam akoma në gjendje. Më vonë nuk i dihet...

– Ti pandeh se ke të bësh me një gjendje të jashtëzakonshme, – i tha ai. – Jo. Është më e rëndomta dhe më e përditshmja gjë në botë: ajo e bashkëshortit dhe e dashnorit.

– Kjo s'është e vërtetë!

– Është. Vetëm se ka shumë variante. Njëri prej tyre është varianti yt.

– Si ta zë goja të thuash diçka të tillë! – Ajo mori zjarr. – Ti për mua mund të kesh qenë gjithçka, por s'ke qenë, s'je dhe s'do të jesh kurrë i tillë. Kurse ai tjetri është më tepër si një... – Ajo e preu fjalën.

– Jo, as kështu s'është. S'di si ta shpjegoj...

– Le të themi: siguria dhe aventura. Kështu sikur tingëllon më bukur. Por është e njëjta gjë. Duam njërën, por nuk e lëshojmë as tjetrën.

Ajo tundi kokën.

– Ravik, – u dëgjua zëri i saj, thellë që nga mugëtira, një zë që atij ia drithëronte zemrën. – Për këtë gjë mund të gjenden fjalë të bukura dhe fjalë të shëmtuara. Por kjo nuk ndryshon asgjë. Unë të dashuroj dhe do të të dashuroj derisa të mos kem më jetë. Këtë e di dhe e kam të qartë në vetvete. Ti je horizonti, dhe të gjitha mendimet përfundojnë e mbyllen te ti. Mund të ndodhë ç'të dojë, por të gjitha do t'i përmbyllë gjithmonë horizonti yt. Kjo që po bëj unë nuk është mashtrim. Ty asgjë nuk të rrëmbehet. Dhe është pikërisht kjo arsyeja që unë vij gjithmonë tek ti, që nuk pendohem dhe që nuk mund ta ndiej veten fajtore.

– Në ndjenjat nuk ekziston faji, Xhoanë. Pse flet kështu?

– Jam menduar. E kam vrarë mendjen shumë, Ravik. Për mua dhe për ty. Ti kurrë s'ke dashur të më kesh të tërën. Ndoshta këtë ti nuk e di as vetë. Gjithnjë ekzistonte diçka në këtë mes, që mbetej e kyçur për mua. Dhe unë s'mund të futesha kurrë e tëra brenda. E dëshiroja! Ah, sa e dëshiroja këtë! Por gjithmonë dukej sikur ti do të më ikje nga çasti në çast. Kurrë nuk kam qenë e sigurt. Mund të ndodhte që të të dëbonte policia, mund të ndodhte që duhej të zhdukeshe shpejt... ose mund të rastiste edhe krejt ndryshe... që ti, një ditë prej ditësh, të zhdukeshe me dashje, mos të të kisha më këtu, të ikje diku, ku ta di unë se ku...

Raviku ia kishte ngulitur sytë asaj fytyre që i fliste që andej nga mugëtira e papërcaktuar. Kishte disa të vërteta në ato që po thoshte Xhoana.

– Kështu ka qenë gjithmonë, – vazhdoi ajo. – Gjithmonë. Dhe pastaj erdhi dikush që më donte, që më donte vetëm mua, të tërën dhe përgjithnjë, thjesht dhe pa asnjë problem. Unë qeshja, nuk doja, argëtohesha... Dukej aq e parrezikshme dhe aq e lehtë për t'u shtyrë përsëri mënjanë kjo gjë... Por pastaj, papritur e pa kujtuar, ishte bërë diçka më tepër, një si detyrim, diçka që e doja edhe unë thellë në vetëdijen time... Nisa të mbrohesha kundër kësaj ndjenje, por s'bëntë dobi; e dija që s'më kishte pushtuar të tërën, por vetëm një pjesë... dhe fillova të shkisja... Ishte si puna e një tërmeti të lehtë, të cilin në fillim e merr me shaka, por, papritur, s'ke ku të mbështetesh më dhe s'mund të mbrohesh më... Por kjo botë e re është e huaj për mua. Unë nuk e kam vendin atje, Ravik. E kam vendin te ti.

Ai e flaku bishtin e cigares tej dritares. Dukej sikur një xixëllonjë po fluturonte drejt oborrit.

– Çfarë u bë, u bë, Xhoanë, – tha ai. – Ne s'mund ta ndryshojmë më.

– Unë s'dua të ndryshoj gjë. Do të kalojë. Unë të përkas ty. Pse vij gjithmonë tek ti? Pse rri para derës sate? Pse të pres këtu dhe ti më nxjerr jashtë dhe unë vij përsëri? E di që nuk më beson dhe pandeh se kam arsye të tjera. Po ç'arsye? Po të ma mbushte zbrazëtirën ajo ndjenja tjetër, unë s'do të kthehesha më tek ti. Do të të kisha harruar. Ti thua se ajo që kërkoj te ti qenka siguria. Por kjo s'është e vërtetë. Është dashuria.

Fjalë! mendonte Raviku. Fjalë të ëmbla. Balsam i butë, mashtrues. Ndihmë, dashuri, afërsi, rikthim... fjalë, fjalë të bukura. Vetëm fjalë. Sa fjalë që kishte për këtë tërheqje të thjeshtë, të egër e mizore midis dy trupave! Ç'ylber fantazie, gënjeshtrash, ndjenjash dhe vetëmashtrimesh nderej sipër saj!... Ja tek po rrinte ai në këtë natë lamtumire, po rrinte i qetë atje në mugëtirë, nën rizimin e këtij shiu fjalësh të ëmbla që nuk thoshin asgjë, përveçse: lamtumirë, lamtumirë, lamtumirë! Po të filloje e të flisje për dashurinë, ajo humbiste menjëherë, tretej, zhdukej fare. Perëndia e dashurisë e kishte ballin me njolla gjaku. Ai nuk merrte vesh nga fjalët...

– Duhet të shkosh tani, Xhoanë.

Ajo u ngrit.

– Dua të rri këtu. Lërmë të qëndroj këtu. Vetëm një natë!

Ai tundi kokën.

– Ç'më pandeh ti mua? Unë s'jam automat.

Ajo erdhi dhe u mbështet pas tij. Ai ndjeu si dridhej e tëra.

– Aq më bën. Lërmë të rri këtu.

Ai e largoi me ngadalë nga vetja.

– Nuk duhet të fillosh ta tradhtosh atë tjetrin pikërisht me mua. Atë, edhe pa këtë, e presin taksirate të mëdha prej teje.

– Nuk mund të shkoj vetëm në shtëpi në këtë orë.

– Nuk ke për të qëndruar gjatë vetëm.

– Jo, jam vetëm. Që prej ditësh. Ai ka ikur. S'është në Paris.

– Ashtu! – ia bëri Raviku i qetë dhe e vështroi në sy. – Sidoqoftë të paktën je e sinqertë dhe e bën tjetrin të dijë se ku ndodhet.

– Nuk ishte kjo arsyeja që erdha.

– Natyrisht që jo.

– S'kisha nevojë as të ta thosha.

– Shumë e drejtë.

– Ravik, nuk dua të shkoj vetëm në shtëpi.

– Atëherë po të përcjell unë.

Ajo bëri me ngadalë një hap prapa.

– Ti nuk më do më... – tha me zë të ulët, pothuajse kanosës.

– Mos erdhe për ta marrë vesh këtë?

– Po... edhe për këtë erdha. Jo pikërisht... por edhe kjo ishte një arsye.

– O perëndi, Xhoanë! – ia bëri Raviku me padurim. – Atëherë mos e harro se sapo dëgjove një nga pohimet më të hapura të dashurisë.

Ajo nuk iu përgjigj. Vetëm e vështroi me vëmendje.

– Pandeh ti se, po të ishte ndryshe, do ta kisha aq të vështirë të të mbaja këtu, pavarësisht se me kë jeton? – vazhdoi ai.

Ajo filloi ta vinte buzën në gaz. S'ishte tamam buzëqeshje – ishte si një shkëlqim që dilte së thelli, sikur dikush i kishte ndezur një llambë përbrenda dhe ndriçimi po i ngjitej ngadalë deri te sytë.

– Falemnderit, Ravik, – tha ajo. Dhe pas një çikëze, me kujdes e duke mos ia shqitur sytë: – Ti s'ke për të më braktisur?

– Pse ma bën këtë pyetje?

– Do të presësh? Nuk do të më braktisësh?

– Besoj se s'ka shumë rrezik për këtë... po të nisem nga përvoja që kam me ty.

– Falemnderit.

Ajo kishte ndryshuar e tëra. Sa shpejt u ngushëllua! mendoi ai. E pse jo? Kujton se e arriti atë që dëshironte, edhe pa qëndruar këtu...

Ajo e puthi.

– E dija që ti ishe i tillë, Ravik. Duhej të ishe i tillë. Po iki tani. S'është nevoja të më përcjellësh. Tani mund të shkoj edhe vetëm në shtëpi.

Ajo u ndal te dera.

– Mos eja më, – i tha ai. – Dhe mos e vrit mendjen. Ti s'je nga ato që humbasin.

– Jo. Natën e mirë, Ravik.

– Natën e mirë, Xhoanë.

Ai iu afrua murit dhe ndezi dritën e madhe. Duhej të ishe i tillë! më tha. Ai u shkund. Ato janë të mbrujtura prej balte e prej floriri, mendoi ai. Prej gënjeshtre dhe tronditjeje. Prej mashtrimi dhe të vërtete të paturpshme... Ai shkoi e u ul te dritarja. Nga poshtë vinte akoma vaji i ngadaltë e monoton. Një grua që e kishte tradhtuar të shoqin e që tani po e qante, sepse kishte vdekur. Por ndoshta edhe sepse kështu e kërkonte feja e saj. Raviku habitej pse nuk po e ndiente veten edhe më fatkeq.

Erjonixx

23

-Ë shikoni që u ktheva, Ravik, – tha Keti Hegshtrëmi.

Ajo po rrinte në dhomën e vet në hotel *Lankastër*. Ishte bërë edhe më e imët nga ç'kishte qenë. Mishi nën lëkurë i qe ulur, thua se ia kishin gërryer nga përbrenda me instrumente shumë të holla. Linjat i kishin dalë edhe më në pah dhe lëkura i shëmbëllente me mëndafsh që mund të grisej lehtë.

– Ju dija në Firence... ose në Kanë... ose në Amerikë, – i tha Raviku.

– Qëndrova tërë kohën në Firence. Në Fiezole. Derisa nuk munda të duroja më. Ju kujtohet sesi përpiqesha t'jua mbushja mendjen të vinit me mua?... Libra, një zjarr në vatër, mbrëmje të qeta, paqe...? Libra kishte... edhe zjarri në vatër ishte... po paqja! Ravik, edhe ai qytet i qetë kulture është bërë i zhurmshëm. Tërë rrëmujë e shqetësime, si gjithçka atje matanë. Edhe në rrugët e sheshet e Firences marshojnë tani kolona me uniformë dhe dehen me ngrefosje, llafe dhe urrejtje të pamatë.

– Kështu ka qenë gjithmonë, Keti.

– Jo kështu. Përpara disa vjetësh administratori i shtëpisë sime ishte akoma një burrë i urtë e i sjellshëm, me kilota kadifeje dhe këpucë cohe. Kurse tani na është shndërruar në hero me çizme të gjata, me këmishë të zezë të zbukuruar me sëpata liktori dhe rri duke mbajtur fjalime – Mesdheu duhet t'i përkasë Italisë, Anglia duhet të zhduket nga faqja e dheut, dhe Nisa, Korsika e Savoja duhet t'i kthehen Italisë... Ravik, ky komb i urtë e i dashur, që s'ka fituar luftëra qysh prej kohësh që s'mbahen mend, ka lajthitur që kur e lanë

të fitonte në Abisini e në Spanjë. Të njohur të mi, të cilët para tre vjetësh ishin akoma me mend në kokë, sot e besojnë seriozisht që janë në gjendje ta mundin Anglinë brenda tre muajsh. Vendi po zien. Ç'po ndodh kështu, vallë? Ika nga Vjena prej brutalitetit të këmishëve të murrme... tani braktisa Italinë prej çmendurisë së këmishëzinjve... Mos vallë botën e ka përfshirë këmishomania?

– Ka mundësi. Por, me sa duket, kjo gjë do të ndryshojë shumë shpejt. Ngjyra e vetme do të jetë e kuqja.

– E kuqja?

– Po, e kuqja e gjakut.

Keti Hegshtrëmi vështroi poshtë, nga oborri. Drita e pasdrekes së vonë depërtonte atje, e butë dhe si e gjelbër, përmes gjetheve të gështenjave.

– Sikur s'të besohet... – tha ajo. – Dy luftëra brenda njëzet vjetësh! Është ca si tepër. Jemi akoma të rraskapitur nga e para.

– Vetëm fitimtarët janë të rraskapitur. Jo të mundurit. Fitorja të bën të shkujdesur.

– Po, ndoshta. – Ajo e vështroi në sy. – Pra, s'do të na mbetet edhe shumë kohë, si thoni?

– Edhe unë ashtu kam frikë. Jo edhe shumë.

– Si mendoni ju, a do të më mjaftojë mua kjo kohë?

– Pse jo? – Raviku ngriti kokën. Ajo nuk iu largua vështrimit të tij.

– E takuat Fiolën? – e pyeti ai.

– Po, nja dy herë. Ishte një nga të paktët që s'e kishte zënë murtaja e zezë.

Raviku nuk i dha përgjigje. Qëndronte në pritje.

Keti Hegshtrëmi mori nga tryeza një gjerdan perlash dhe filloi t'i kalonte nëpër gishtërinj. Midis atyre gishtërinjve të gjatë e të hollë ato shëmbëllenin me një rruzare tepër të kushtueshme.

– Më duket vetja si Çifuti Shëtitës[1] tek bredh për të gjetur paqe, – tha ajo. – Por paskam filluar në një kohë terse. Paqe s'ka gjëkundi. Vetëm këtu... këtu paska mbetur edhe pak.

Raviku soditi perlat. Molusqe gri dhe amorfe i kishin krijuar, të ngacmuar nga një trup i huaj, nga një kokërr rërë midis dy guaskave të tyre. Dhe nga ky ngacmim i rastit ishte formuar një bukuri e tillë, me këtë shkëlqim kaq magjik e të butë. Kjo duhet mbajtur mend! tha ai me vete.

– Po ju sikur donit të ktheheshit në Amerikë, Keti? Kush mund

1. Personazh i romanit – fejton antiklerikal *Le Juif errant* ("Çifuti Shëtitës") të shkrimtarit francez Ëzhen Sy (1804–1857), autor gjithashtu i romanit "Misteret e Parisit".

të ikë nga Evropa, s'duhet ta humbasë rastin. Për çdo gjë tjetër është tepër vonë tani.

– Doni të më degdisni?

– Jo. Po a nuk më thatë vetë radhën e fundit se do të rregullonit punët tuaja e do të niseshit për në Amerikë?

– Po. Por tani s'dua të shkoj. Akoma jo. Dua të qëndroj edhe ca këtu.

– Parisi është i nxehtë dhe i mërzitshëm në verë.

Ajo i vuri perlat mënjanë.

– Por jo kur është vera e fundit, Ravik.

– E fundit?

– Po, e fundit, para se të nisem.

Raviku heshti. Çfarë di ajo? mendoi. Çfarë do t'i ketë thënë doktor Fiola?

– Ç'bën *Sheherezadja?* – pyeti ajo.

– Ka kohë që s'kam qenë andej. Marozovi thotë se për çdo natë është e mbushur plot e përplot. Ashtu si gjithë klubet e tjera të natës.

– Tani, në verë?

– Po, në verë, kur më parë gjithë lokalet mbylleshin në këtë kohë. Habiteni?

– Aspak. Çdokush kërkon të përfitojë sa të mundet, përpara se të vijë fundi.

– Po, – tha Raviku.

– A do të më çoni ndonjë natë atje?

– Posi jo, Keti. Kur të doni. Kujtoja se s'kishit më dëshirë të shkonit atje.

– Kështu kujtoja edhe unë. Por kam ndërruar mendje. Edhe unë dua të përfitoj sa të mundem.

Ai i hodhi përsëri një shikim.

– Mirë, Keti, – i tha. – Kur të dëshironi.

Ai u ngrit për të ikur. Ajo e përcolli gjer te dera. U mbështet te korniza, ashtu e imët, me atë lëkurë të mëndafshtë që dukej sikur do të fëshfërinte, po ta prekje. Sytë i kishte shumë të kthjellët dhe më të mëdhenj se përpara. Ajo i dha dorën. E kishte të nxehtë e të thatë.

– Pse nuk më treguat çfarë kisha? – e pyeti ajo, ashtu thjesht, sikur po e pyeste për motin.

Ai e vështroi si i shastisur dhe nuk i dha përgjigje.

– Do ta kisha duruar, – tha ajo, dhe diçka si rrezatim i një nënqeshjeje të dhembshur ironike, pa hijen e zemëratës, i rrëshqiti mbi fytyrë.

– Mirëmbetshi, Ravik!

Erjonixx

*
* *

Burri pa stomak kishte vdekur. Tri ditë me radhë kishte rënkuar e gulçuar dhe morfina s'i bënte më dobi. Raviku dhe Veberi e dinin që do të vdiste. Ata mund t'ia kishin kursyer ato tri ditë. Por këtë nuk e bënë, sepse ekzistonte një fe, e cila predikonte dashurinë për të afërmin dhe ta ndalonte t'ia shkurtoje vuajtjet. Dhe kishte edhe një ligj që e mbronte këtë farë feje.

– I telegrafuat farefisit? – pyeti Raviku.

– Nuk ka, – tha Veberi.

– Ose ndonjë njeriu të afërm?

– Nuk ka njeri.

– Asnjeri?

– Asnjeri. Portierja e shtëpisë ku banonte, erdhi këtu. Tha se atij kurrë nuk i vinin letra, me përjashtim të katalogëve për sende shtëpiake dhe broshurave kundër alkoolizmit, kundër tuberkulozit, sëmundjeve veneriane e të tilla sende. Vizitorë nuk i vinin kurrë. Operacionin dhe katër javë qëndrim në klinikë i kishte parapaguar. Kishte paguar për dy javë më shumë. Portierja ngulte këmbë se ai i pati premtuar t'i linte çdo gjë që kishte, meqë ajo qenkej kujdesur shumë për të; kërkonte medoemos t'ia kthenim asaj paratë e dy javëve që ishin paguar tepër. Thoshte që, për të sëmurin, kishte qenë si një nënë e vërtetë... Veç ta kishit parë atë farë nëne. Pretendonte se kishte bërë shumë shpenzime për të; i kishte paguar gjoja edhe qiranë e shtëpisë. I thashë se ai kishte parapaguar te ne, prandaj s'kishte asnjë arsye pse të mos e kishte shlyer edhe qiranë që më parë. Fundja, kjo e tëra ishte një çështje që i përkiste policisë. Kur ia thashë këtë, më mbyti me mallkime.

– Paraja, – tha Raviku. – Sa shpikës të bën kjo paraja e shkretë!

Veberi qeshi.

– Do t'i njoftojmë organet kompetente. Ata do të kujdesen për këtë punë. Gjithashtu edhe për varrimin.

Raviku i hodhi një shikim burrit pa stomak e pa farefis. Ai rrinte shtrirë atje dhe, në këtë orë, fytyra po i ndërronte siç nuk i kishte ndërruar kurrë gjatë tridhjetë e pesë vjetëve të jetës së tij. Nga ngërçi i ngrirë i regëtimës së fundit po formohej ngadalë fytyra e rreptë e vdekjes. E rastësishmja po shkrihej, shenjat e luftës me vdekjen po shuheshin dhe, në atë fytyrë të rëndomtë e të shtrembëruar, nisi të marrë trajtat e saj të heshtura e të madhërishme maska hijerëndë.

Erjonixx

Pas një ore vetëm ajo do të mbetej.

Raviku doli nga dhoma. Në korridor takoi infermieren e rojës së natës. Ajo sapo kishte ardhur.

– Zotëria i dhomës dymbëdhjetë vdiq, – i tha ai. – Ka një gjysmë ore. S'është nevoja të bëni më rojë. – Dhe, kur pa fytyrën e saj, shtoi: – Ju ka lënë gjësend?

Ajo ngurroi.

– Jo. Ishte një zotëri shumë i ftohtë. Ditët e fundit nuk fliste pothuajse fare.

– Ashtu është, nuk fliste vërtet.

Infermierja i hodhi Ravikut një shikim prej amviseje.

– Kishte një takëm shumë të bukur tualeti; prej sermi. Në të vërtetë ishte diçka tepër fine për një burrë. I shkonte më shumë një gruaje.

– A ia thatë këtë?

– Po, ra fjala njëherë. Natën e së martës; ishte një çikëz më i qetë atë natë. Por më tha se sermi u shkonte edhe burrave. Furçat ishin shumë të mira. Nuk gjenden më të tilla në kohën tonë... Po zakonisht ai fliste shumë pak.

– Takëmi do t'u dorëzohet tani organeve kompetente. Pacienti ynë nuk kishte të afërm.

Infermierja pohoi me kokë, si për të thënë se i kuptonte të gjitha.

– Sa keq! Do të nxihet. Dhe furçat, po s'qenë të reja dhe po s'u përdorën, do të prishen. Do të ishte mirë të laheshin më parë.

– Po, shumë keq! – tha Raviku. – Më mirë t'i kishit marrë ju. Kështu, të paktën, do t'u gëzohej dikush.

Infermierja i fali një buzëqeshje mirënjohëse.

– S'ka gajle. S'prisja gjë. Kush është për të vdekur, rrallëherë të dhuron diçka. Vetëm ata që shërohen. Kush është për të vdekur, nuk do ta besojë që do të vdesë. Prandaj nuk bën dhurata. Ka edhe ca që s'të falin gjë vetëm nga zemërligësia. S'mund ta merrni me mend, zoti doktor, sa të ligj bëhen ca, kur e dinë se do të vdesin me sot e me nesër! Veç t'i dëgjonit se ç'llafe nxjerrin ndonjëherë nga goja!

Fytyrën buçko si prej fëmije e kishte të çiltër. As që e çante kokën se ç'ndodhte rretheqark, po të mos kishte të bënte me atë botën e saj të vockël. Të sëmurët për vdekje ishin për të ose fëmijë të pasjellshëm ose fëmijë që kishin nevojë për përkrahje. Duhej kujdesur për ta derisa të vdisnin, pastaj vinin të tjerë; disa shëroheshin dhe të ishin mirënjohës; disa as nuk shëroheshin dhe as ta dinin për nder. S'kishte ç't'i bëje – kjo punë kështu e kishte. Po gjakun s'duhej ta

prishje kurrë. Shumë më tepër kishte rëndësi nëse në *Bomarshe* do të uleshin çmimet njëzet e pesë për qind, apo nëse kushëriri Zhan do të martohej me Anë Kutyrjenë...

Dhe vërtet, këto kishin më shumë rëndësi, mendoi Raviku. Rrethi i vogël e i ngushtë, që të mbronte nga kaosi... Ndryshe si do t'ia dilnim dot...?

*

* *

Raviku po rrinte në *Kafe Triomfë*, jashtë në trotuar. Nata ishte e zbehtë dhe me re. Bënte zagushi dhe diku dridheshin vetëtima të heshtura. Ndër trotuaret jeta zvarritej më e ngjeshur. Një grua me kapelë atlasi blu erdhi e iu ul në tryezë.

– Do të më qerasësh me një vermut? – e pyeti ajo.

– Po. Por lërmë vetëm se pres dikë.

– Mund ta presim bashkë.

– Më mirë jo. Pres një mundëse nga Pallati i Sportit.

Gruaja qeshi. Ishte aq fort e lyer dhe e zhgërryer, saqë qeshja i dallohej vetëm ndër buzë. E gjithë pjesa tjetër e fytyrës shëmbëllente me një maskë të bardhë.

– Eja me mua, – i tha ajo. – Kam një shtëpi të lezetshme dhe jam e mirkë.

Raviku tundi kokën. Pastaj nxori një pesëfrangësh dhe ia la mbi tryezë.

– Merre. Adio. Të uroj gjithë të mirat!

Gruaja e përlau kartëmonedhën, e palosi dhe e futi nën llastikun e çorapes.

– Ju pëlqeka të hiqeni si shenjtor, ë? – e pyeti ajo.

– Jo.

– Unë kam një nuhatje shumë të zhvilluar për këso punësh. Por kam edhe një shoqe shumë të këndshme, llokum fare! Është e re, – shtoi ajo pas pak. – I ka gjinjtë si Kulla e Ejfelit.

– E lëmë për herë tjetër.

– Në rregull. – Gruaja u ngrit dhe u ul ca tryeza më tutje. I hodhi sytë edhe disa herë nga ai, pastaj bleu një gazetë sporti dhe nisi të lexonte lajme sportive.

Raviku sodiste rrymën e njerëzve që shtyheshin pa pushim në trotuarin përpara tryezave. Orkestra brenda në kafene po luante valse vjeneze. Vetëtimat sa vinin e shpeshoheshin. Një grup të rinjsh

homoseksualë, si një trumbë papagajsh të potershëm, erdhën e u ulën në një tryezë pranë Ravikut. Mbanin favorite – modë e fundit – dhe xhaketat i kishin prerë shumë të gjera në supe e shumë të ngushta në bel.

Një vajzë e re u ndal përpara tryezës së Ravikut dhe e vështroi në sy. Atij iu bë sikur e kishte parë diku – por vajza ai njihte shumë. Ajo dukej nga lloji i atyre prostitutave që ishin ca si delikate, të shushatura e që nuk dinin nga t'ia mbanin.

– S'po më njihni më? – e pyeti ajo.

– Posi jo, – i tha Raviku. Kurse në të vërtetë s'po i binte hiç ndër mend. – Si jeni?

– Mirë. Por ju s'po më njihkeni më.

– I harroj emrat shpejt. Por natyrisht që ju mbaj mend. Qysh kur jemi parë radhën e fundit, ka kaluar shumë kohë.

– Po, Bobos i kallët datën atëherë. – Ajo vuri buzën në gaz. – Kurse mua më shpëtuat jetën, e tani s'po më njihni më...

Boboja. Një jetë e shpëtuar. Mamia. Raviku u kujtua.

– Ju jeni Lysiena, – tha ai. – Po, po. Atëherë ishit shumë e sëmurë. Kurse tani qenkeni shëndoshë e mirë. Kjo është! Prandaj nuk ju njoha menjëherë.

Lysienës i shkëlqeu fytyra.

– Vërtet më mbakeni mend! Shumë falemnderit për të njëqind frangat që ia morët përsëri mamisë.

– Ato... ah, po... – Pas disfatës që pësoi te zonja Busher, ai i pati dërguar vajzës njëqind franga nga xhepi i vet. – Mjerisht s'ia nxora dot të gjitha.

– Për mua ishin mjaft. I quaja të humbura.

– Mirë. Dëshironi të pini gjësend me mua, Lysienë?

Ajo pohoi me krye dhe, me kujdes, u ul pranë tij.

– Një *Çinxano* me sifon.

– Si e çoni, me se merreni, Lysienë?

– Jam shumë mirë.

– Akoma me Bobon jeni?

– Po, natyrisht. Por ai tani ka ndryshuar, është bërë më i mirë.

– Atëherë qenka çdo gjë në rregull.

S'ishte nevoja të bëje shumë pyetje. Rrobaqepësja e vogël ishte bërë një kurvicë e vogël. Dhe për këtë kishte kontribuar edhe ai – duke e shpëtuar e duke e qepur! Boboja kishte kontribuar për restin. Ajo s'kishte pse të frikësohej se mos mbetej me barrë. Dhe kjo ishte një arsye më tepër që të zgjidhte atë zanat. Akoma nuk i ishte futur

mirë asaj rruge; ndodhej në fillim. Ajo çikëz pamje fëmijërore që i kishte mbetur, e bënte tërheqëse për qejflinjtë e zanatit – një copëzë porcelani, së cilës akoma nuk i kishte dalë balta nga përdorimi i shumtë... Ajo pinte me kujdes dhe avash-avash, posi një zogth, por sytë i rrotullonte sa andej-këtej. E gjithë pamja e saj s'të ngjallte ndonjë ndjenjë gazmore – por s'të ngjallte as ndonjë keqardhje të thellë. Ishte një grimëz jete që rrëshqiste në rrugën e vet...

– A je e kënaqur? – e pyeti ai.

Ajo tundi kokën në shenjë pohimi. Edhe ai e shihte që vërtet ishte e kënaqur. Asaj gjithçka i dukej krejt në rregull. Në këtë mes s'kishe ç'të dramatizoje.

– Vetëm jeni? – e pyeti ajo.

– Po, Lysienë.

– Në një mbrëmje të tillë?

– Po.

Ajo e vështroi si me druajtje dhe i buzëqeshi.

– Kam pak kohë të lirë, – i tha.

Ç'po ndodh kështu me mua? mendoi Raviku. Kaq i uritur dukem vallë, saqë çdo prostitutë po më ofron një copëz dashurie që blihet?

– Për të shkuar deri në shtëpinë tënde është tepër larg, Lysienë. Nuk kam aq kohë.

– S'mund të shkojmë tek unë. Boboja s'duhet ta marrë vesh.

Raviku e shikoi me vërejtje.

– Pse Boboja nuk i merrka vesh kurrë këto gjëra?

– Posi jo. Për të tjerët e di. Më kontrollon, bile. – Lysiena vuri buzën në gaz. – Është akoma tepër i ri. Pandeh se, po të mos më kontrollojë, unë s'do t'ia dorëzoj paratë. Por prej jush nuk dua para.

– Prandaj s'duhet ta merrka vesh Boboja?

– Jo për këtë arsye. Por do të bëhej xheloz. E pastaj fillon e egërsohet.

– Për të gjithë bëhet xheloz?

Lysiena e pa me habi.

– Natyrisht që jo. Rastet e tjera hyjnë në zanat.

– Domethënë, u egërsoka vetëm kur s'del paraja?

Lysiena ngurroi. Pastaj erdhi e u skuq.

– Jo, s'është kështu. Kjo ndodh vetëm kur ai dyshon se në këtë mes mund të ketë edhe diçka tjetër. – Ajo ngurroi përsëri. – Kur dyshon se unë mund të ndiej diçka për dikë...

Lysiena i tha ato fjalë syulur. Edhe kur mbaroi vazhdoi t'i mban-

te përdhe. Raviku ia mori dorën që i rrinte ashtu si e harruar mbi tryezë.

– Lysienë, – i tha. – Më vjen mirë që u kujtove për mua dhe që deshe të vish me mua. Ti je e lezetshme dhe do të të merrja tani me vete. Por unë nuk mund të bie në shtrat me një njeri që kam operuar. A më kupton?

Ajo ngriti ata qerpikët e saj të gjatë e të zinj dhe tundi kokën disa herë në shenjë pohimi:

– Po, – tha dhe u ngrit nga vendi. – Atëherë po shkoj tani.

– Lamtumirë, Lysienë. Mbetsh me shëndet. Dhe ki kujdes se mos sëmuresh.

– Po.

Raviku shënoi diçka mbi një copëz letre.

– Shko e blije këtë, në qoftë se nuk e ke marrë akoma. Është më e mira e të gjithave. Dhe mos ia dorëzo të tëra paratë Bobos!

Ajo buzëqeshi dhe tundi kokën. Të dy e dinin fort mirë se ajo mesele ashtu do të vazhdonte. Raviku e ndoqi me sy, derisa u zhduk në mes të turmës. Pastaj i bëri shenjë kamerierit.

Gruaja me kapelën blu i kaloi përsëri pranë. Ajo e kishte ndjekur të gjithë skenën. I bënte fresk vetes me gazetën e palosur dhe iu zgërdhi duke zbardhur dhëmbët e vënë:

– Ti, i dashur, ose je impotent, ose je homoseksual, – i tha miqësisht, në kalim e sipër. – Paç fat dhe falemnderit shumë!

Raviku filloi të bredhë nëpër natën e ngrohtë. Vetëtimat dukej sikur po valëviteshin përmbi çatitë. Nuk frynte as edhe një çikëz erë. Kur arriti pranë *Luvrit*, pa dritë në hyrje. Portat ishin të hapura. Ai u fut brenda.

Ishte një nga periudhat kur muzeu i *Luvrit* mund të vizitohej edhe natën. Një pjesë e sallave ishte e ndriçuar. Ai kaloi nëpër pavijonin egjiptian që dukej si një varr i stërmadh, i kredhur në dritë. Të ngurosur, ulur ose më këmbë, rrinin atje faraonë të këtu e tre mijë vjetësh të shkuara dhe kundronin me sy të palëvizshëm prej graniti grupet e studentëve, gratë me kapela të modës së vjetshme dhe burrat pleq e të mërzitur, që vërtiteshin sa andej-këtej përpara tyre. Binte erë pluhuri, ajri të pandërruar dhe pavdekësie.

Në pavijonin grek, përpara Venusit të Milosit, po çuçurisnin vesh më vesh disa vajza, të cilat nuk i ngjanin në asgjë asaj statuje. Raviku u ndal. Pas granitit dhe *sienitit*[1] të blertë të egjiptianëve, mermeri grek dukej pothuajse i rëndomtë dhe i butë. Venusi, me traj-

1. *Syenit*: Gur i ngjashëm me granitin, por pa përmbajtje kuarci; i quajtur kështu sipas qytetit të lashtë egjiptian Syene (sot Assuan).

Erjonixx

tat e saj butësisht të rrumbullakosura, kishte diçka që i shëmbëllente një gruaje shtëpiake të kënaqur tek lahej: e bukur dhe pa mendime. Apoloni, vrasësi i hardhucave, dukej si një homoseksual që duhej të bënte ca më tepër gjimnastikë. Por ata qëndronin ndër këto salla të mbyllura – dhe kjo i vriste. Egjiptianët nuk i vriste, sepse ata ishin krijuar për varre dhe tempuj. Kurse grekët kishin nevojë për diell, ajër dhe kolona, nëpërmes të cilave shndriste drita e artë e Athinës.

Raviku eci më tutje. Përpara i doli, e ftohtë, salla e madhe me shkallinat. Dhe befas, atje lart, sipër të gjithave, iu shfaq Nika e Samotrakës.

Kishte kaluar goxha kohë që kur e pati parë për të fundit herë. Radhën e fundit kishte qenë një ditë e vrenjtur gri, mermeri s'ia kishte mbushur aspak syrin dhe, në dritën e murrme dimërore të muzeumit, Perëndesha e Fitores rrëqethej e mërdhinte. Por tani ajo nderej atje lart përmbi shkallinat, e vendosur mbi piedestalin e saj të dalë, e përshëndritur nga projektorët, shkëlqimtare, me flatra të hapura tej e tej, me rrobën e puthisur fort pas trupit nga era, rrezatore dhe e gatshme për t'u ngritur fluturim. Pas saj dukej sikur shushurinte deti ngjyrëvere i Salaminës[1], përposh një qielli të mëndafshtë, që rrëfente vetëm pritje dhe ankth.

Ajo nuk dinte gjë për moralin. Nuk i njihte problemet. Ajo nuk i njihte stuhitë dhe honet e errëta të gjakut. Ajo njihte vetëm fitoren dhe disfatën, dhe të dyja ishin pothuajse njëlloj. Nuk ishte tundim, por moskokëçarje. Ajo nuk kishte asnjë të fshehtë – e, megjithatë ta turbullonte gjakun më fort se Venusi, e cila e mbulonte turpin e saj e, me këtë, e nxirrte më tepër në pah. Ajo ishte e afërt me zogjtë e me anijet... me erën, me tallazet e me horizontin. Ajo nuk kishte atdhe...

Ajo nuk kishte atdhe, mendoi Raviku. Por as që kishte nevojë për të. Atdheun ajo e gjente mbi çdo anije. Kudo ku kishte guxim e luftë, ajo ndodhej si në shtëpi të vet – bile edhe atje ku kishte disfatë, mjaft të qe një disfatë pa dëshpërim, ajo e gjente atdheun e vet. Ajo s'ishte vetëm Perëndeshë e Fitores, por edhe perëndeshë e të gjitha aventurave dhe Perëndeshë e Emigrantëve – përderisa ata të mos ligështoheshin e të mos i ngrinin duart përpjetë...

Ai vështroi përreth. Në sallë nuk ndodhej më asnjeri. Studentët dhe vizitorët e tjerë me katalogët e muzeumit nëpër duar, kishin ikur për në shtëpi. Për në shtëpi... Ç'shtëpi tjetër mund të kishte për një njeri që s'e kishte vendin asgjëkundi, përveçse në shtrëngatën e

1. *Salamina*: Ishull në gjirin Saronik (Greqi).

zemrës së një krijese tjetër e, edhe në këtë, vetëm për një thërrime kohe?... A s'ishte ky shkaku që dashuria, kur ndizej në zemrat e njerëzve pa atdhe, i trondiste aq fort dhe i pushtonte shpirt e trupsepse ata nuk zotëronin asgjë tjetër të tyren?... A s'pati qenë ky shkaku që ai ishte përpjekur t'i bënte bisht dashurisë? Dhe a s'e kishte ndjekur ajo nga pas dhe e kishte arritur dhe vënë përfund?... Ishte shumë më e vështirë të ngriheshe përsëri më këmbë mbi akullin rrëshqitës të truallit të huaj, sesa mbi kokën e njohur të së zakonshmes...

Befas i zuri syri diçka. Diçka të vockël, të bardhë, që rrihte flatrat. Ishte një flutur që duhej të qe futur atje nga porta kryesore e hapur. Kishte ardhur nga diku, nga shtretërit e vlagët të *Tyilërive*[1], e trembur ndoshta prej dy dashnorësh, që e kishin zgjuar nga gjumi i saj mbi shtrojat e aromave, e verbuar pastaj nga dritat e forta që, për të, ishin diej të panjohur, të shumtë e marramendës – dhe kishte marrë kështu arratinë drejt asaj hyrjeje, drejt errësirës mbrojtëse që dhuronin ato porta të mëdha... Dhe tani endej fluturim, e përhumbur, por guximtare, nëpër atë sallë të madhe, ku do të vdiste... Më parë do të kapitej, do të dremiste mbi ndonjë ornament muri, mbi ndonjë parvaz dritareje ose mbi supin e asaj perëndeshe shkëlqimtare që nderej atje lart; në mëngjes flutura do të kërkonte lulet dhe jetën dhe nektarin e kulluar – dhe s'do t'i gjente, e pastaj do ta kaplonte përsëri gjumi mbi mermerin mijëravjeçar, tanimë e dobësuar dhe e kapitur, derisa shtrëngimi i këmbëzave të brishta, por gjer atëherë të sigurta, do të lirohej dhe ajo do të rrëzohej tatëpjetë – një gjethëz e hollë vjeshte të parakohshme...

Sentimentalizëm! mendoi Raviku. Perëndesha e Fitores dhe refugjati-flutur. Simboli i rëndomtë. Po çfarë mund të të prekte më tepër, përveçse gjërat e rëndomta, simbolet e rëndomta, ndjenjat e rëndomta, sentimentalizmi i rëndomtë? Ç'i kishte bërë, vallë, aq të rëndomta? Vërtetësia e tyre më se e qartë? Snobizmi zhdukej, kur ta viņin thikën në grykë... Flutura kishte humbur në mugëtirën e kubesë. Raviku doli përjashta. Ajri i ngrohtë e goditi në fytyrë, si uji i vakët i një banje. Ai ndali hapat. Ndjenja të rëndomta, të lira. A nuk ndodhej ai vetë në duart e më të rëndomtës, e më pak të kushtueshmes ndjenjë nga të tëra? Vështroi parkun e madh të *Luvrit*, ku rrinin strukur hijet e shekujve, dhe iu duk sikur po e goditnin befas mijëra grushte. Iu bë sikur nga çasti në çast do të rrëzohej nga kjo valë e

1. *Palais des Tuileries*: pallati rezidencial i mbretërve të Francës në bregun e djathtë të lumit Senë në Paris.

padukshme goditjesh. Akoma i fanitej përpara sysh Nika bardhoshe, e gatshme për t'u nisur fluturim me krahë të ndera – por pas saj u ngrit nga hijet një fytyrë tjetër, një fytyrë sa e rëndomtë aq edhe e shtrenjtë, në të cilën fantazia e tij kishte ngecur dhe ishte ngatërruar si një vello indiane në një degë trëndafilash plot gjemba. Ai e tërhiqte vellon, por gjembat ishin të paepur; ata i mbanin fort fijet e mëndafshta e të arta, që ishin mpleksur aq fort me to, saqë syri nuk e dallonte dot më, ku ishte dega me gjemba dhe ku ishin fijet e vellos vezulluese.

Një fytyrë! Një fytyrë! Kush pyeste në ishte e rëndomtë apo e shtrenjtë? Në ishte e papërsëritshme apo në kishte me mijëra si ajo? Njeriu mund të bënte një mori pyetjesh në fillim – por kur binte pastaj në leqe, s'e kuptonte më as vetë. Atëherë bije në grackën e dashurisë – e jo të një njeriu të veçantë, i cili rastësisht e mbante emrin e dashurisë. Kush ishte më në gjendje të jepte gjykime, i verbuar nga flakët e fantazisë? Dashuria nuk njihte gjykime dhe vlerësime...

Qielli dukej sikur kishte zbritur më pranë tokës. Vetëtimat e heshtura i shkëpusnin natës për disa çaste copëza të squfurta. Zagushia, një përbindësh i paformë, me mijëra sy të verbër, rrinte shtrirë përmbi çatitë. Raviku mori rrugën *Rivoli*. Në rruginat me qemerë ndriçonin vitrinat. Para tyre shtyhej një lumë njerëzish. Automobilat dukeshin si një zinxhir i pakëputur refleksesh. Ja tek po bredh, mendoi ai. Një ndër mijëra të tjerë që bredhin me nge e pa nge pranë këtyre vitrinave plot me xhingla-mingla vezulluese e me sende të vyera... Po endem me duar ndër xhepa, një shëtitës mbrëmjesor... Dhe brenda meje zien gjaku dhe, në brazdat e murrme e të bardha të asaj mase që është sa dy grushte dhe që quhet tru, zhvillohet një luftë e padukshme, e cila të vërtetën e paraqet gënjeshtër dhe gënjeshtrën të vërtetë. Ndiej krahë që më shtyjnë, trupa që më prekin, sy që më kundrojnë; dëgjoj automobila, zëra, gumëzhitjen e realitetit të prekshëm; ndodhem mu në mes të kësaj të vërtete e, megjithatë, jam më larg saj nga ç'është vetë hëna... mbi një planet përtej logjikës dhe fakteve; diçka përbrenda meje klith e thërret një emër, që duhet të jetë e, megjithatë, ajo diçka vazhdon ta thërrasë atë emër, dhe unë e di që s'është ai emër, vazhdon ta kërkojë nëpër heshtjen e pamatë, që ka ekzistuar gjithmonë dhe në të cilën gjer tani kanë humbur shumë klithje, pa ardhur që andej asnjë përgjigje; ajo e di këtë, por prapë vazhdon ta nxjerrë klithjen e natës së dashurisë dhe natës së vdekjes, klithjen e ekstazës dhe të vetëdijes që shembet, klithjen e xhunglës dhe të shkretëtirës – dhe unë mund të di mijëra

përgjigje, por përgjigjen e kësaj klithjeje nuk e di, ajo ndodhet jashtë meje dhe kurrë s'do të jem i zoti ta di, kurrë...

Dashuri! Sa gjëra duhej të mbulonte ky emër! Që nga përkëdhelitë më të ëmbla të lëkurës e gjer te lajthitja më e egër e mendjes, që nga dëshira më e thjeshtë për të krijuar familje e gjer te tronditja vdekjeprurëse, që nga kapërthimi i dy trupave e gjer te dyluftimi i Jakobit me Engjëllin... Ja tek po bredh, mendonte Raviku, një goxha burrë mbi të dyzetat, i mësuar nëpër shumë shkolla, i gremisur përtokë dhe i ngritur sërish më këmbë, i situr në shoshën e viteve, i rrahur nga jeta, i bërë më i ashpër, më kritik, më i ftohtë – nuk e desha dhe nuk e besoja dhe as nuk më shkonte ndër mend që do të më zinte edhe njëherë kaq fort... Por ja që më zuri, dhe e gjithë përvoja, e gjithë dija ime nuk po më vlejnë më, por vetëm sa po e ndezin më shumë këtë zjarr... Dhe çfarë digjet më mirë mbi zjarrin e ndjenjave sesa cinizmi i thatë dhe ajo turrë drush, që përfaqëson vitet më kritike të jetës së një njeriu?...

*

* *

Ai ecte dhe ecte dhe nata ishte e pamatë dhe oshtinte ngado; ai bridhte e bridhte, pa vënë re se nga po e çonin këmbët; nuk e dinte në ishin orë apo minuta ato që po kalonin, prandaj as që u habit shumë kur u ndodh përsëri te lulishtet pas *avënysë Rafael*.

Shtëpia në rrugën *Paskal* . Katet cip mbi cip – dhe lart fare studiot, disa akoma të ndriçuara. Ai i gjeti me sy dritaret e studios së Xhoanës. Kishin dritë. Pra, ajo ndodhej në shtëpi. Por ndoshta nuk ndodhej aty dhe i kishte lënë dritat ndezur. Asaj nuk i pëlqente që, kur të vinte, të futej në dhoma të errëta. Njëlloj si atij. Raviku iu avit trotuarit. Disa vetura qëndronin përpara shtëpisë. Midis tyre edhe një *Rëudstër*[1] i verdhë, i ngjashëm me një automobil kursi. Kjo mund të ishte makina e atij tjetrit. Makinë artisti. Ndenjëse të kuqe, një armaturë si e një aeroplani, me një mori instrumentesh të panevojshme – natyrisht, kjo veturë duhej të ishte e tij!... Mos jam xheloz? mendoi ai i habitur. Xheloz për atë objekt të rastit, mbi të cilin ajo kishte hedhur çengelin? Xheloz për diçka që nuk më intereson? Njeriu mund të bëhej xheloz për një dashuri që i ka kthyer krahët – por jo për atë, drejt të cilit ajo është kthyer.

1. *Roadster*: automobil i hapur; zakonisht dyvendësh.

Ai u drejtua përsëri nga lulishtet. Nga errësira vinte aromë lulesh, e ëmbël, e përzier me kundërmimin e tokës e të gjelbërimit të ftohur. Kishin aromë të fortë, si zakonisht përpara shtrëngatës. Ai gjeti një stol dhe shkoi e u ul në të. Nuk jam unë ky! tha me vete. Nuk ka se si të jem unë ky dashnor i vonë, që po rri këtu mbi një stol përpara shtëpisë së gruas që e ka braktisur, duke vështruar dritaret e saj! Nuk jam unë ky njeri, i drithëruar nga një dëshirim, të cilin ai di ta analizojë shumë saktë e, megjithatë, nuk është në gjendje ta mposhtë dot! Nuk jam unë ky hajvan këtu, që do të falte disa vite të jetës së tij, sikur të mund ta kthente kohën mbrapsht dhe ta rifitonte sërish një copë biondine, e cila do t'i dërdëlliste në vesh të njëjtat gjepura që po i dërdëllit tani atij tjetrit atje lart! Nuk jam unë ky, i cili – t'i marrë djalli të gjitha justifikimet – po rri këtu dhe është xheloz dhe i thyer dhe i mjerë që, me qejf të madh, do t'ia kishte vënë zjarrin atij automobilit buzë trotuarit!

Ai peshkoi nga diku një cigare. Prushi i heshtur. Tymi i paduksshëm. Rruga e shkurtër prej komete e shkrepëses. Pse nuk ngjitej lart në studio? E ç'mund të ndodhte? Nuk ishte shumë vonë. Drita nuk qe shuar. Ai do të dinte qysh të bëhej zot i situatës. Pse nuk e nxirrte që andej? Tani që i dinte të gjitha? Ta nxirrte që andej dhe ta merrte me vete dhe të mos e lëshonte kurrë më!

Ia nguli sytë errësirës si i shastisur. Ç'dobi do të kishte? E ç'do të ndodhte? Ai s'mund ta nxirrte jashtë atë tjetrin. Njeriu s'mund të nxirrte asgjë dhe askënd nga zemra e një tjetri. A s'do të kishte mundur ta merrte atë grua kur i erdhi në dhomë? Pse nuk e bëri?

Ai e flaku cigaren tutje. Sepse nuk ishte mjaft. Po, kjo qe! Sepse ai kërkonte më tepër. Dhe nuk do të ishte mjaft as sikur ajo të vinte, as sikur të rikthehej tek ai dhe gjithçka të harrohej e të varrosej – kurrë nuk do të mjaftonte... në një mënyrë çuditërisht të tmerrshme nuk do të mjaftonte kurrë më! Diçka kishte shkarë... Kishte ardhur një çast dhe rrezja e fantazisë s'kishte mundur ta godiste më pasqyrën, e cila, zakonisht e priste, dhe e rikthente akoma më të zjarrtë në gjirin e vetvetes... Dhe tani kjo rreze kishte shkarë anës pasqyrës, e verbër e me dëshirë të paplotësuar – dhe asgjë nuk mund ta kthente më, as një pasqyrë dhe as mijëra pasqyra... Ato mund të rroknin ndoshta vetëm një pjesëzë të asaj rrezeje, por nuk do të mund ta rikthenin kurrë më të tërën; rrezja endej e tretur qëkur qiejve të zbrazët të dashurisë dhe e mbushte vetëm me mjegull të ndritshme, që s'kishte më formë dhe që kurrë më s'do të krijonte dot një ylber rreth një koke të dashur. Rrethi magjik ishte çarë, ankimi mbetej, por

shpresa qe thyer në copë e grimë...

Dikush doli nga shtëpia. Një burrë. Raviku lëvizi nga vendi. Pas burrit doli edhe një grua. Të dy zunë të qeshnin. Nuk ishin ata. Njëra nga veturat u ndez dhe u nis. Raviku peshkoi një cigare tjetër nga xhepi. A do të mund t'i kishte ndaluar? A do të mund t'i kishte penguar, po të ishin ata? E ç'mund të mbante dot i ziu njeri? Vetëm ndonjë iluzion – ose pak më shumë. Dhe një iluzion, a nuk ishte mjaft? A mund të arrihej më shumë se aq? Kush ishte ai që mund të kishte haber nga vorbulla e zezë e jetës, që rridhte e paemër nën shtresat e çuditshme të shqisave, të cilat e kthenin atë vorbull nga rrotullimi i kotë i gjërave në tryezë e në llambë e në atdhe e në "ti" e në dashuri? Ajo, deri ku mund të arrinte njeriu, ishte vetëm një parandjenjë dhe një dritë e dyzuar që të rrëqethte. A nuk mjaftonte kjo?

Jo, nuk mjaftonte. Mund të mjaftonte vetëm atëherë, po të besoje në të. Po të kriste një herë kristali nën çekanin e dyshimit, atë vetëm se mund ta ngjitje – por jo më shumë. Të ngjitje diçka të krisur, të gënjeje dhe të kundroje një dritë të thyer, që dikur kishte qenë shkëlqim i bardhë!... Asgjë nuk rikthehej më. Asgjë nuk riformohej. Asgjë. Edhe sikur Xhoana të kthehej përsëri – asgjë nuk do të ishte ashtu siç pati qenë. Kristal i ngjitur. Ora që iku e shkoi. Asgjë nuk mund ta rikthente më atë orë...

Ai ndjeu një si therje të mprehtë, një dhimbje të padurueshme. Dukej sikur brenda tij u këput diçka, u këput fare. O perëndi! mendoi, si është e mundur që jam në gjendje të vuaj kaq shumë. Të vuaj për këtë gjë! E vështroj, e gjykoj veten – dhe s'mund të ndryshoj asgjë, asnjë thërrime. E di se, po ta shtie në dorë atë që dëshiroj, do ta lëshoja përsëri – e, megjithatë, kjo nuk ma shuan dëshirimin tim. Ia bëj autopsinë këtij dëshirimi, sikur të ishte një trup i vdekur në morg – por ky trup i vdekur bëhet një mijë herë më i gjallë. E di që do të vijë dikur një ditë e do të shpëtoj nga kjo e, megjithatë, as kjo s'më ndihmon e s'më lehtëson aspak... Ai ia nguli sytë e tij të mjegulluar dritares atje lart, dhe iu duk vetja tmerrësisht qesharak – por as kjo nuk ndryshoi gjë prej gjëje...

Një bubullimë shurdhuese u rrokullis befas përmbi qytet. Pika shiu filluan të përplaseshin pas gjetheve të luleve. Vuri re se si rruga zuri të pikëlohej me argjend të zi. Shiu erdhi duke u shtuar. Pikat e rënda e goditën në fytyrë. Dhe përnjëherësh ai s'po e merrte më vesh në ishte qesharak po i mjerë, në vuante apo nuk vuante – dinte vetëm që po jetonte. Po jetonte! Ai ekzistonte, jeta e kishte pushtuar

sërish, po e shkundte, dhe ai nuk ishte më spektator, nuk qëndronte
më jashtë saj; shkëlqimi i fortë i ndjenjës së pakontrollueshme vërs-
honte përsëri nëpër damarët e tij, si zjarri nëpër oxhakë furrnaltash;
dhe nuk kishte pothuajse pikë rëndësie në ishte i lumtur apo fatkeq;
ai jetonte dhe e ndiente fort që po jetonte – dhe kjo ishte mjaft!

Vazhdonte të rrinte nën shiun që vërshonte mbi të porsi nje
breshëri qiellore mitralozësh. Rrinte atje dhe ishte shi e shtrëngatë e
ujë e tokë njëherësh; rrufetë e horizonteve kryqëzoheshin brenda tij;
ai ishte edhe krijesë edhe element i natyrës; asgjë s'kishte më emër –
dhe kështu të gjitha dukeshin si të vetmuara e si të braktisura; të gji-
tha ishin njëlloj – edhe dashuria, edhe uji që derdhej tatëpjetë, edhe
ato ndriçimet e zbehta mbi çatitë, edhe toka që dukej sikur po gufo-
hej; s'ekzistonin më kufij, dhe ai vetë ishte pjesë përbërëse e të gjitha
këtyre, e lumturia e fatkeqësia mbeteshin vetëm gëzhoja boshe, të
flakura tutje nga ndjenja e gjithpushtetshme se po jetonte dhe që po
e ndiente se po jetonte. "O ti atje lart!" foli ai, duke iu drejtuar drita-
res së ndriçuar, dhe qeshi, dhe nuk e kuptoi që po qeshte. "Ti dritëz
e vogël, ti vegim i një zane, ti fytyrë që ushtron një pushtet të çudits-
hëm mbi mua, këtu mbi këtë planet, ku ka me qindra mijëra fytyra
të tjera, më të mira, më të bukura, më të mençura, më të çiltra, më
besnike, më të afrueshme – o ti rastësi që m'u ngatërrove një natë
nëpër këmbë atje në rrugë e që hyre në jetën time, ti ndjenjë e për-
plasur brigjeve, pa mendim, por robëruese, dhe që rrëshqite nën
lëkurën time një natë gjumi, ti, që s'di për mua pothuajse asgjë tjetër
përveç asaj që të rezistova, dhe që prandaj m'u hodhe ndër krahë,
derisa nuk të rezistova më, ti, që deshe të vazhdoje pastaj rrugën
tënde e të mërgoheshe prej meje – të përshëndes, të përshëndes! Ja
tek po qëndroj këtu dhe s'ma merr mendja se do të qëndroj edhe
ndonjëherë tjetër kështu. Shiu më depërton nën këmishë dhe është
më i ngrohtë e më i ftohtë e më i butë se duart e tua dhe lëkura jote;
po qëndroj këtu, i mjerë dhe me kthetrat e xhelozisë në bark, duke të
të kërkuar, përbuzur, admiruar e adhuruar, sepse ke hedhur rrufenë
që ndezi, rrufenë që dremit në çdo gji, shkëndijën e jetës, zjarrin e zi.
Po qëndroj këtu, jo më si një i vdekur me leje, me pak cinizëm, sar-
kazëm e me një çikëz guxim, jo më i ftohtë; jam përsëri i gjallë, qoftë
edhe duke vuajtur – por sërish i prekshëm nga stuhitë e jetës, i rilin-
dur e i rikthyer në pushtetin e saj të thjeshtë! Qofsh bekuar, ti mado-
në me atë zemrën tënde shtegtare, ti Nikë me atë aksentin tënd latin!
Ëndërr dhe mashtrim, pasqyrë e thyer e një perëndie të ngrysur, o ti
që s'di asgjë – të falënderoj! Kurrë s'kam për të ta thënë, se ti do të

nxirrje pastaj përfitimet e tua nga kjo – por ti ma ke rikthyer atë që s'do të ma jepte dot kurrë as Platoni dhe as krizantemat, as e gjithë poezia dhe as e gjithë mëshira, as dëshpërimi dhe as më e forta dhe më e durueshmja shpresë: jetën e thjeshtë, të fuqishme, të mirëfilltë, që më dukej si një krim në këto kohëra midis njërës katastrofë dhe tjetrës! Të përshëndes! Të falënderoj! Duhej të të humbisja, që ta merrja vesh këtë! Mbetsh me shëndet!"

Shiu ishte bërë si një napë e sermtë, vezulluese. Lulet, bari, i gjithë gjelbërimi, filluan të lëshonin kundërmim. Toka dihaste me një aromë të fortë, të këndshme, mirënjohëse. Dikush u sul me vrap në rrugë nga godina përkarshi dhe ngriti mbulesën e *Rëudstërit* të verdhë. S'kishte pikë rëndësie. Asgjë s'kishte pikë rëndësie. Nata ishte këtu apo po derdhte shiun nga yjet, dhe shiu vërshonte përmbi qytetin e gurtë me parqet dhe kopshtet e tij, duke pllenuar miliona lule që drejtonin kurorat e larme nga ai dhe e prisnin; dhe ai hidhej në miliona krahë të hapur pemësh të bulëzuara dhe kapërthehej në gjirin e tokës, duke u bashkuar i etshëm me miliona rrënjë, që gjithashtu e prisnin ethetretur. Shiu, nata, natyra, lulëzimi, rritja – ja tek ishin këtu, pa u merakosur për shkatërrimin, vdekjen, për kriminelët, shenjtorët e rremë, për fitoren apo disfatën; ja tek ishin këtu, ashtu si për mot – dhe këtë natë ai ishte një pjesëz e tyre... një lëvozhgë veze e hapur, jetë, jetë, jetë që lëvrinte, që gëlonte... jetë për t'u përshëndetur e për t'u bekuar!

Ai eci me nxit përmes lulishteve dhe rrugëve. Nuk e ktheu kokën pas; ecte dhe ecte, dhe kurorat e pemëve të Pyllit të Bulonjës i gumëzhinin në vesh si një koshere e stërmadhe bletësh; mbi to vërshonte shiu, ato luhateshin e tundeshin e i përgjigjeshin – dhe Ravikut iu duk sikur ishte përsëri djalosh i ri e po shkonte për të parën herë te një femër...

24

-Çfarë t'ju sjell? – e pyeti kamerieri Ravikun.

– Më sillni një…

– Çfarë?

Raviku nuk i dha përgjigje.

– Nuk ju kuptova mirë, zotëri, – tha kamerieri.

– Sillmëni diçka. Çfarë të doni.

– Një *Perno*?

– Mirë…

Raviku mbylli sytë. Pastaj i hapi prapë, me ngadalë. Ai burri po rrinte akoma në vendin e vet. Dhe këtë herë përjashtohej çdo gabim. Hakeja rrinte te tryeza pranë derës. Ishte vetëm dhe po hante. Mbi tryezë ndodhej një pjatancë me dy gjysma karavidheje dhe një shishe shampanjë e vënë në akull. Pranë tryezës qëndronte një kamerier dhe po përgatiste një sallatë mikste. Të gjitha këto Raviku i pa shumë qartë, sikur po i nguliteshin pas syve si një reliev në dyll. Ai pa një unazë të trashë me emër dhe emblemë të skalitur, kur Hakeja nxori shishen nga akulli. E njohu menjëherë atë unazë dhe atë dorë të bardhë e të tultë. Atë dorë leshtake e kishte parë nga shumë afër, në atë vorbull çmendurie metodike, kur ndodhej i shtrirë mbi tryezën e torturave dhe kur e shkundnin nga alivani me projektorë verbues – dhe Hakeja qëndronte përpara tij, i tërhequr pak mënjanë, gjithë kujdes se mos i ndotej uniforma elegante nga uji që i hidhnin Ravikut. Atë dorë të tultë e tepër të bardhë e mbante shtrirë drejt tij dhe i fliste me zë të butë: "Ky ishte vetëm fillimi. S'ishte asgjë. Do të na i tregoni tani ata emrat? Apo të vazhdojmë? Ne dimë

edhe plot marifete të tjera. Me sa po shoh, thonjtë i paskeni akoma sagllam..."

Hakeja ngriti kokën. Ai e vështroi Ravikun drejt e në sy. Ravikut iu desh të mblidhte të gjitha fuqitë për të mos kërcyer nga vendi. Mori gotën me *Perno*, piu një gllënjkë dhe u përpoq ta drejtonte shikimin mbi pjatën e sallatës, sikur po interesohej për gatitjen e saj. Nuk ishte i sigurt në e kishte njohur ose jo Hakeja. Ndjeu se si brenda një sekonde kurrizi i qe qullur krejt.

Pas ca kohe i hodhi përsëri një shikim rrëshqitas tryezës së Hakes. Ai i ishte përveshur karavidheve dhe drita i pasqyrohej mbi kokën tullace. Raviku vështroi përreth. Lokali ishte i mbushur deng. Qe e pamundur të ndërmerrje ndonjë gjë. Armë s'kishte me vete dhe, po t'i vërsulej Hakes, për dy sekonda do të ndërhynin e do ta mbërthenin dhjetë veta. Dhe dy minuta më vonë do t'ia behte policia. S'i mbetej gjë tjetër veçse të priste e ta ndiqte Haken nga pas. Të zbulonte se ku banonte.

U detyrua të ndizte një cigare e ta pinte me zor deri në, e vetëm pastaj i hodhi sytë përsëri nga Hakeja. Me ngadalë, sikur po kërkonte njeri, vështroi rretheqark. Hakeja sapo u kishte dhënë fund karavidheve. Kishte marrë pecetën dhe po fshinte buzët. Këtë nuk e bënte me njërën, por me të dyja duart. E mbante pecetën pak të tendosur dhe e kalonte lehtë përmbi buzë – në fillim mbi njërën e pastaj mbi tjetrën, si një grua që fshin të kuqtë. Dhe, gjatë këtij veprimi, e vështronte Ravikun mu në dritë të syrit.

Raviku vazhdoi të shikonte përreth. E ndiente që Hakeja s'po ia shqiste sytë. I bëri shenjë kamerierit dhe porositi edhe një *Perno*. Një tjetër kamerier po pastronte tani tryezën e Hakes; hoqi mbeturinat e karavidheve, ia mbushi përsëri me shampanjë gotën e zbrazur dhe i vuri përpara një pjatë me djathë.

Raviku ndezi një cigare tjetër. Pas pak, duke vështruar me bisht të syrit, e ndjeu prapë shikimin e Hakes. Kjo s'ishte më rastësi. Ndjeu se si po i kalonin mornica nëpër trup. Po sikur Hakeja ta kishte njohur...? Ai e ndali kamerierin, kur po i kalonte pranë.

– A mund të më sillni një *Perno* tjetër përjashta? Dëshiroj të rri në tarracë. Bën më fresk atje.

Kamerieri ngurroi për një çast.

– Do të ishte më mirë sikur të paguanit këtu. Jashtë shërben kamerier tjetër. *Pernonë* jua sjell unë pastaj përjashta.

Raviku tundi kokën dhe nxori një kartëmonedhë.

– Mund ta pi edhe këtu, jashtë po porosis një tjetër. Kështu s'do

të ketë ngatërresa.

– Si të urdhëroni, zotëri. Falemnderit, zotëri.

Raviku e piu gotën pa u nxituar. Hakeja e kishte dëgjuar muhabetin – për këtë ishte i sigurt. Teksa Raviku fliste, ai e pati ndërprerë të ngrënët. Tani u hyri përsëri atyre që kishte përpara. Raviku qëndroi edhe një copë herë i qetë. Në qoftë se Hakeja e kishte njohur, i mbetej vetëm një rrugë: të shtirej sikur ai, nga ana e vet, nuk e pati njohur fare dhe kështu përpiqej ta mbante nën mbikëqyrje nga larg.

Pas ca minutash u ngrit e doli jashtë në tarracë. Atje pothuajse të gjitha tryezat ishin të zëna. Raviku kërkoi me sy, derisa gjeti një vend të përshtatshëm, nga ku mund të dallonte një pjesë të tryezës së Hakes brenda në restorant. Haken vetë nuk mund ta shihte dot; por do ta shihte kur të ngrihej për të dalë. Porositi edhe një *Perno* dhe e pagoi menjëherë, për të qenë i gatshëm për ndjekje.

*
* *

– Ravik… – i foli dikush nga afër.

Ai u drodh, sikur ta kishte goditur njeri. Pranë tij qëndronte Xhoana. Ai e vështroi si i shastisur.

– Ravik… – përsëriti ajo. – S'po më njihke më?

– Posi jo… – Sytë e tij i ishin qepur tryezës së Hakes. Atje kishte ardhur kamerieri dhe po i servirte kafenë. Ai mori frymë i lehtësuar. Pra, kishte akoma kohë.

– Xhoanë, – tha ai me mundim. – Nga mbive këtu?

– Ama, ç'pyetje! Çdo njeri kalon një herë në ditë këtej nga lokali i *Fukesë*.

– Vetëm je?

– Po.

Ai u kujtua që ajo po qëndronte akoma në këmbë, ndërsa ai rrinte në karrige. U ngrit, por duke mos e humbur nga sytë tryezën e Hakes.

– Kam një punë këtu, Xhoanë, – i tha me nxit, pa e vështruar fare. – Nuk ta shpjegoj dot se ç'punë është. Por ti më pengon në këtë mes. Duhet të më lësh vetëm.

– Do të pres. – Xhoana u ul. – Dua të shoh, si duket ajo gruaja.

– Ç'grua? – e pyeti Raviku me habi.

– Gruaja që po pret.

– Nuk është grua.

– Po ç'na qenka atëherë?

Ai i hodhi një shikim të gjatë.

– Në fillim s'më njohe fare, – ia nisi ajo. – Tani po kërkon të më heqësh qafe, je i shqetësuar... Unë e di që është punë gruaje në këtë mes. Dhe dua të shoh, cila është.

Pesë minuta, mendonte Raviku. Ndoshta edhe dhjetë ose pesëmbëdhjetë sa për të pirë kafenë. Pas kafesë Hakeja mund të ndizte edhe një puro. Ndoshta vetëm një cigare. Duhet të përpiqej që, gjer atëherë, të shpëtonte nga Xhoana.

– Mirë, – i tha ai. – S'mund të të ndaloj. Por shko e ulu gjetkë.

Ajo nuk iu përgjigj. Sytë filluan t'i ndritnin dhe fytyra iu tendos.

– Nuk është grua, – tha ai. – Dhe, djalli ta marrë, edhe sikur të ishte... ty ç'të duhet? Mos u bëj qesharake me xhelozinë tënde, ndërsa më harlisesh me atë aktorin që ke!

Xhoana nuk bëri zëri. Ajo u kthye andej nga vëzhgonin sytë e tij dhe u mundua t'i binte në të se kë vështronte.

– Lëre këtë marifet tani! – i tha ai.

– Mos është ulur me ndonjë burrë?

Raviku u lëshua në karrigen e vet. Hakeja e pati dëgjuar qëparë se kishte ndër mend të rrinte jashtë në tarracë. Në e pastë njohur, do t'i lindte dyshimi e do të vinte të hetonte ku ndodhej. Prandaj ishte më e natyrshme dhe më pa zarar që ta gjente ulur me një grua.

– Mirë, – i tha Xhoanës. – Rri, meqë dashke të rrish medoemos. Ajo që mendon ti, është marrëzi. Ndoshta, pas pak, unë do të ngrihem për të ikur. Ti do të më shoqërosh deri te një taksi, por s'do të vish me mua. Do ta bësh këtë?

– Ç'janë gjithë këto mistere?

– S'kam ndër mend të bëhem misterioz me ty. Këtu ndodhet një burrë, të cilin ka kohë që nuk e kam parë. Dhe dua të di se ku banon. Kjo është e gjitha.

– Nuk qenka grua?

– Jo. Është burrë, dhe më tepër se kaq s'mund të të them.

Kamerieri iu afrua tryezës së tyre.

– Ç'dëshiron të pish? – e pyeti Raviku Xhoanën.

– *Kalvados.*

– Një *Kalvados!*

Kamerieri u largua.

– Po ti s'po e pi një?

– Jo, unë po pi këtë që kam përpara.

Xhoana ndenji dhe e kundroi një copë herë.

– S'mund ta marrësh me mend se sa të urrej nganjëherë!

– Gjëra që ndodhin. – Raviku i hodhi një shikim të shpejtë tryezës së Hakes. Xham, mendonte ai. Xham që dridhet, që rrëshqet, që vezullon. Rruga, tryezat, njerëzit... të gjitha të kredhura në një pelte xhami të dridhshëm...

– Ti je i ftohtë, egoist...

– Xhoanë, – tha Raviku, – këto gjëra mund t'i bisedojmë një herë tjetër.

Xhoana nuk e hapi gojën, sepse kamerieri po ia vinte gotën përpara. Raviku pagoi aty për aty.

– Ti e ke fajin, ti më ke futur në këto ngatërresa... – ia bëri ajo pastaj, me këmbënguljen e një njeriu që kërkon sherr medoemos.

– E di... – Ai pa për një çast dorën e bardhë e të tultë të Hakes tek zgjatej për të marrë sheqer.

– Ti! Ti dhe askush tjetër! Ti s'më ke dashur kurrë, vetëm se je tallur me mua; e ke kuptuar që të dashuroja, dhe as të është bërë vonë fare!

– Është e vërtetë.

– Çfarë?

– Kjo është e vërtetë, – tha Raviku pa e vështruar. – Por pastaj erdhi puna ndryshe.

– Ah, pastaj! Pastaj! Atëherë u ngatërruan të gjitha. Pastaj ishte tepër vonë. Ti e ke fajin!

– E di.

– Mua mos më fol kështu! – Fytyra e saj erdhi e u zbardh nga inati. – Ti as që po dëgjon fare, çfarë po të them!

– Posi jo! – Ai e shikoi në sy. Duhej llapur diçka, duhej dërdëllitur, pavarësisht se çfarë.

– Mos je shamatuar gjë me atë artistin tënd?

– Po.

– Do të kalojë.

Tym i kaltër atje ku rrinte Hakeja. Kamerieri po ia mbushte përsëri filxhanin me kafe. Me sa dukej, Hakeja e kishte marrë me nge.

– Mund të të thosha edhe të kundërtën, – ia nisi sërish Xhoana. – Mund të të thosha se kalova rastësisht këtej. Por s'është ashtu. Po të kërkoja. Dua të iki prej za atij.

– Këtë njeriu e do gjithmonë, se ashtu e do edhe pjesa.

– Më ka kallur tmerrin. Më kërcënon. Kërkon të më vrasë.

– Si? – Raviku ngriti kokën me rrëmbim. – Çfarë the ashtu?

– Më thotë se do të më vrasë.

– Kush? – Ai e pati dëgjuar vetëm me gjysmë veshi. Por pastaj e kuptoi. – Ah, ashtu! Por s'ma ha mendja që ti e beson këtë?

– Ai është inatçi i tmerrshëm.

– Gjepura! Ai që thotë se do të të vrasë, nuk të vret kurrë. Aq më pak një aktor.

Ç'po llomotis kështu? mendonte Raviku. Ç'janë të gjitha këto që po të them? Ç'dua unë këtu? Një zë, një fytyrë dhe veshët që më buçasin. Ç'më interesojnë këto punë?...

– Ç'do që m'i tregon të gjitha këto? – e pyeti Xhoanën.

– Dua të iki prej atij. Dua të kthehem te ti.

Sikur Hakeja të marrë taksi, mua do të më duhen të paktën disa sekonda derisa të ndaloj një tjetër, mendonte Raviku. Dhe, sa të vihet në lëvizje pastaj taksia ime, mund të jetë tepër vonë. Ai u ngrit nga vendi.

– Pritmë këtu, se tani kthehem.

– Pse... çfarë...?

Ai nuk i dha përgjigje. Me nxit kaloi trotuarin dhe ndali një taksi.

– Ja tek keni dhjetë franga. A mund të më prisni nja pesë minuta? Kam edhe pak punë në lokal.

Shoferi vështroi dhjetëfrangëshin. Pastaj vështroi Ravikun. Raviku i shkeli syrin. Shoferi po ashtu.

– Këtë e keni ekstra, – i tha Raviku. – E kuptoni vetë si është puna...

– Kuptoj. – Shoferi u zgërdhi. – Mirë, po ju pres këtu.

– Parkojeni makinën ashtu, që të mund t'ia shkelni menjëherë.

– Në rregull, shef!

Raviku i hapi rrugë vetes përmes turmës atje në trotuar dhe u kthye me ngut në lokal. Tek po afrohej, ndjeu se si iu tha pështyma: te pragu i restorantit po qëndronte Hakeja, gati për të dalë. Ai s'ia vuri veshin fare asaj që nisi t'i thoshte Xhoana.

– Prit këtu, – i tha. – Prit! Vetëm dy sekonda!

– Jo! – Ajo brofi në këmbë. – Do të pendohesh! – Gati sa s'po ia plaste vajit.

Ai bëri një stërmundim dhe i buzëqeshi. I shtrëngoi edhe dorën. Hakeja qëndronte akoma te pragu.

– Ulu, – i tha Raviku Xhoanës. – Vetëm dy sekonda!

– Jo!

Dora e saj përpiqej të shkëputej nga shtrëngimi i tij. Ai e lëshoi. Nuk donte që njerëzia të kthenin kokën. Ajo u largua me nxitim,

duke çarë përmes tryezave e duke dalë nga dera e xhamllëkut të tarracës. Hakeja ia qepi sytë Xhoanës derisa u zhduk. Pastaj e ktheu vështrimin me ngadalë dhe e shikoi Ravikun vjedhurazi. Dhe prapë shikoi andej nga kishte ikur Xhoana. Raviku u ul në tryezën e vet. Têmthat iu frynë nga gjaku që i buçiste me furi. Nxori kuletën dhe bëri sikur po kërkonte diçka. Ndërkohë vuri re se si Hakeja po kalonte me nge midis tryezave të tarracës. Me një mospërfillje të shtirur, që mund t'i bënte nder edhe një artisti, Raviku filloi t'i kulloste sytë në anën e kundërt. Dikur vështrimi i Hakes duhej të kryqëzohej me të tijin.

Ai qëndroi në pritje. Dukej sikur koha s'po ecte fare. Befas e pushtoi një ankth i fortë. Po sikur Hakeja të ishte kthyer në restorant e të kishte ikur nga dera tjetër? Ai vështroi në drejtim të daljes. Hakeja s'ishte më në tarracë. S'ishte më atje! Atij filloi t'i vinte mendja rrotull.

– Më lejoni? – pyeti dikush fare pranë tij.

Raviku nuk e dëgjoi. Vazhdonte të vështronte daljen. Të ngrihem? mendoi ai. T'i qepem pas, të mundohem se mos e arrij diku?... Pas kurrizit të tij u dëgjua përsëri zëri i qëparshëm. Ai ktheu kokën dhe zgurdulloi sytë. Hakeja kishte qenë pas kurrizit të tij dhe tani i qëndronte përbri. Ai rrëfeu me dorë karrigen ku pati qenë ulur Xhoana:

– Më lejoni të ulem? S'ka asnjë tryezë bosh.

Raviku bëri një shenjë pohimi me kokë. S'ishte i zoti të nxirrte asnjë fjalë nga goja. Gjaku filloi t'i bubulonte nëpër damarë. Rridhte e rridhte, a thua se po derdhej përposh karriges dhe po ia linte trupin të zbrazur si një thes. Ai mbështeti kurrizin fort pas karriges. Gotën e kishte akoma përpara. Lëngu qumështor. E ngriti dhe piu. Ajo lëvizje i kushtoi goxha mundim. Vështroi gotën. Ajo i rrinte në dorë pa u dridhur. Dridhjen e kishte vetëm nëpër damarë.

Hakeja porositi një konjak. Një konjak nga ata të shtrenjtët fare. E fliste frëngjishten me një theks të fortë gjerman. Raviku i bëri shenjë një gazetashitësi të vogël:

– Një *Pari-Suar!*

Djali i hodhi sytë me frikë nga hyrja. E dinte se atje rrinte vazhdimisht gruaja plakë, që kishte lejë të shiste gazeta në këtë vend. Ai ia zgjati Ravikut gazetën, të palosur, përlau monedhën dhe u zhduk me vrap.

Duhet të më ketë njohur, mendoi Raviku. Ndryshe, pse të vinte e të ulej tek unë?... Këtë gjë s'e pati llogaritur. Tani i mbetej vetëm të

rrinte aty dhe të merrte vesh se ku e kishte hallin Hakeja; pastaj mund të vepronte sipas rastit.

Ai hapi gazetën, lexoi titujt dhe e vuri përsëri mbi tryezë. Hakeja e vështroi në sy.

– Mbrëmje e bukur, – i tha në gjermanisht.

Raviku pohoi me krye.

Hakeja i buzëqeshi.

– Kam sy të fortë, si thoni?

– Ashtu duket.

– Ju vura re që brenda.

Raviku bëri përsëri një lëvizje koke, si një njeri që tregon vëmendje, por, njëkohësisht, edhe njëfarë mospërfillje. Nervat i kishte të tendosura sa s'thuhet. Nuk arrinte ta kuptonte, çfarë kishte ndër mend të bënte Hakeja. Që Raviku ndodhej ilegalisht në Francë, këtë ai s'kishte si ta dinte. Por ndoshta Gestapoja i dinte edhe këto punë. Sidoqoftë, këtë do ta tregonte muhabeti.

– Ju njoha menjëherë, – i tha Hakeja.

Raviku e vështroi.

– Kjo blanë plage, – vazhdoi Hakeja dhe rrëfeu ballin e Ravikut, - mund të ishte vetëm e një studenti të shoqatave tona të famshme luftarake. Pra, ju dukej të ishit gjerman ose duhej të kishit studiuar në Gjermani!

Ai qeshi. Raviku s'ia kishte shqitur akoma sytë. Kjo ishte e pamundur! Ishte vërtet tepër qesharake. Ai mori frymë thellë dhe u çlirua krejtësisht nga ankthi. Pra, Hakeja as që e kishte idenë se kush ndodhej përballë tij. Shenjën e plagës në ballin e tij ai e kishte pandehur për një plagë të marrë në ndonjë nga ato përleshjet midis studentëve! Raviku qeshi. Ia plasi gazit bashkë me Haken. Iu desh të kallte thonjtë në mollëzat e duarve, që t'i pushonte gazi.

– A s'është kështu? – e pyeti Hakeja me një krenari prej babaxhani.

– I keni rënë pikës.

Blana në ballin e tij! Atë plagë ia kishin hapur mu përpara syve të Hakes, në qilarin e Gestapos. Gjaku i pati vërshuar në sy e në gojë. Kurse po ky Hakeja, që kishte tani përkarshi, na e pandehte për një plagë përleshjeje fisnike, dhe ishte bile krenar që i kishte rënë në të!...

Kamerieri ia solli Hakes konjakun. Këtij filluan t'i hapeshin flegrat e hundës nga lezeti.

– Këta francezët atë që e kanë, e kanë, – deklaroi ai. – Pije të mira! Sa për të tjerat... – Ai ia picërroi sytë Ravikut. – Kalbësirë gjithandej.

Një popull pensionistësh. Duan vetëm siguri dhe jetë të rehatshme. Me ne i kanë pikët e humbura.

Për një çast Raviku pati përshtypjen sikur i qe lidhur gjuha. Kishte frikë se, po të fillonte të fliste, do të rrëmbente gotën e do ta përplaste pas tryezës që të thyhej copë e çikë, dhe gastaret e mprehta do t'ia fuste Hakes mu në sy. E mori gotën e vet me kujdes e me stërmundim, e ktheu me fund dhe e la përsëri me qetësi të plotë në tryezë.

– Ç'po pini ashtu? – e pyeti Hakeja.

– *Perno.* Zëvendëson absintën.

– Ah, absinta! Ajo pija që i bën francezët impotentë, apo jo? – Hakeja u ngërdhesh. – Më ndjeni! Nuk e thashë në adresën tuaj.

– Absinta është e ndaluar, – tha Raviku. – Kjo pije këtu është vetëm një zëvendëse pa zarar e saj. Absinta thonë se të bën steril, jo impotent. Prandaj e kanë ndaluar. Kjo këtu është uzo.

Po ecka, mendoi ai. Muhabeti po ecka, bile pa asnjë shqetësim. Thellë brenda vetes ndiente një si vorbull, marramendëse dhe të tmerrshme – por sipërfaqja ishte e qetë...

– Këtu jetoni? – pyeti Hakeja.

– Po.

– Keni kohë?

– Gjithnjë.

– Kuptoj, – tha Hakeja. – Rridhni nga një familje gjermanësh të emigruar. Keni lindur këtu, apo jo?

Raviku pohoi me krye.

Hakeja vazhdoi të shijonte konjakun e vet.

– Disa prej më të mirëve nga tanët janë gjermanë të jashtështetit. Zëvendësi i *Fyrerit* tonë ka lindur në Egjipt. Rozenbergu në Rusi. Darreja ka ardhur nga Argjentina. Ideja është ajo që na bashkon, si thoni?

– Vetëm ajo, – iu përgjigj Raviku.

– Pra, nuk qenkam gabuar! – E tërë fytyra e Hakes rrezatonte kënaqësi. Pastaj bëri një përkulje të lehtë sipër tryezës, dhe dukej sikur në të njëjtën kohë po përplaste edhe thembrat poshtë saj.

– Harrova t'ju paraqitem... fon Hake.

Raviku e përsëriti ceremoninë:

– Horn. – Ky ishte një nga pseudonimet e tij të mëparshme.

– Fon Horn? – pyeti Hakeja.

– Po.

Hakeja filloi të bëhej më i afrueshëm. Kishte takuar një njeri të sërës së vet.

– Sigurisht duhet ta njihni mirë Parisin, apo jo?

– E njoh ca.

– S'e kam fjalën për muzeumet. – Hakeja u skërmit si një njeri që ka parë botën me sy.

– E kuptoj se ku e keni fjalën.

Me sa duket, njeriu-zot me gjak ariani na dashka të mëkatojë pakëz, por nuk i ditka mirë vendet, mendoi Raviku. Sikur të mund ta tërhiqte diku, në ndonjë qoshe të humbur, në ndonjë pijetore të vetmuar, në ndonjë qymez prostitutash që s'binte shumë në sy... Atij filloi t'i punonte mendja me nxit. Diku, ku s'do t'i ndërhynin e s'do t'i prishnin punë...

– Këtu duhet të ketë mjaft vende interesante, apo jo? – pyeti Hakeja.

– Sa kohë keni në Paris?

– Vij çdo dy javë dhe rri dy a tri ditë. Bëj njëfarë kontrolli. Punë me shumë rëndësi. Vitin e fundit ne kemi organizuar këtu gjithë ato gjëra. Dhe gjithçka na shkon si sahat. Por nuk më lejohet të them hollësira... Vetëm se... – Hakeja qeshi – me para këtu mund të blesh pothuajse çdo gjë. Kemi të bëjmë me një bandë të korruptuar kokë e këmbë. Ne i dimë pothuajse të gjitha që duam të dimë. Bile s'kemi nevojë as të lodhemi shumë për të kërkuar. Na i sjellin vetë. Këta frëngjtë e ushtrojnë tradhtinë ndaj atdheut si një biçim patriotizmi. Është pasojë e sistemit të shumë partive. Secila parti tradhton tjetrën dhe vendin e vet, që të përfitojë sa më shumë për vete. Dhe kjo është në favorin tonë. Kemi këtu një numër të madh shokësh ideali. I kemi në sferat e larta, me influencë. – Ai ngriti gotën e vet, e pa me vëmendje, e gjeti bosh dhe e vuri prapë në vend. – Këta këtu as që po armatosen fare. Pandehin se ne s'do t'u biem në qafë, po të jenë të paarmatosur. Sikur ta dinit numrin e aeroplanëve dhe të tankeve që kanë, do të vdisnit gazit me këta kandidatë për vetëvrasje!

Raviku e dëgjonte. E dëgjonte shumë i përqendruar e, megjithatë, të gjitha gjërat i silleshin vërdallë, si në një ëndërr përpara zgjimit: tryezat, kamerierët, gumëzhitja e këndshme mbrëmjesore e jetës, radhët e automobilave që rrëshqitnin njëri pas tjetrit, hëna përmbi shtëpitë, reklamat e larme në fasadat e ndërtesave... dhe vrasësi i shumëfishtë e llafazan, që i rrinte përballë e që ia kishte shkatërruar jetën.

Dy gra me kostume të prera ngushtë pas trupit kaluan pranë tryezës së tyre. Ato i dhuruan Ravikut nga një buzëqeshje. Ishin Iveta dhe Marta nga *Osirisi*. Sot kishin ditën e pushimit.

– Alamet copash! – ia bëri Hakeja.

Një rrugë anësore, mendonte Raviku. Një rrugëzë e ngushtë, e shkretë, anësore... Ah, sikur të mund ta tërhiqja në një vend të tillë. Ose në pyll...

– Këto janë dy dama që hanë bukë me zanatin e dashurisë, – tha ai.

Hakeja i ndoqi me sy.

– Qenkan me gjithë mend të mira. Ju sigurisht keni mjaft haber nga këto punë, apo jo? – Ai porositi një konjak tjetër. – A mund t'ju ofroj edhe juve një gotë?

– Jo, falemnderit. Nuk kam qejf ta ndërroj pijen.

– Thonë se këtu gjen ca vende të tilla të mrekullueshme. Lokale të hatashme, bile edhe me programe shfaqjesh. – Sytë e Hakes shkreptinin. Shkreptinin si atëherë, para vitesh, nën dritën verbuese të qilarit të Gestapos.

S'duhet të më rrijë mendja aty! thoshte Raviku me vete. Tani jo!

– S'keni qenë kurrë në ndonjë lokal të tillë? – e pyeti.

– Në disa edhe kam qenë. Për qëllime studimi, kuptohet. Desha të shihja se sa poshtë mund të bjerë një popull. Por sigurisht s'kam shkuar në më të mirat. Duhet të tregohem i kujdesshëm. Ndryshe mund të lindin keqkuptime.

Raviku pohoi me kokë.

– Për këtë mos u bëni merak. Ka disa vende, ku nuk shkel kurrë këmbë turisti.

– I dini ju ato vende?

– Natyrisht. Fort mirë, bile.

Hakeja po i jepte fund gotës së dytë. Erdhi e u bë më fjalaman. Ndrydhja, që mund të kishte pasur në të njëjtat rrethana në Gjermani, iu zhduk. Raviku e kuptoi që ai nuk dinte gjë prej gjëje.

– Pikërisht sonte e kisha bërë me mend të bridhja ca, – i tha ai Hakes.

– Vërtet?

– Po. Kështu veproj herë pas here. Njeriu duhet të njohë çdo gjë që ka mundësi të njohë.

– Tamam! Shumë e drejtë!

Hakeja ia mbërtheu sytë për një çast. Ishte një vështrim i ngrirë. Ta deh, mendoi Raviku. Po të mos më mbetet rrugë tjetër, duhet ta rrumbullos, ta marr me vete e ta fus në ndonjë qoshe...

Fytyra e Hakes ndërroi shprehje. Ai s'ishte i pirë; kishte ndjekur vetëm fillin e mendimeve të veta.

Erjonixx

– Sa keq, – tha më në fund. – Do të kisha shumë qejf të vija me ju.

Raviku nuk i dha përgjigje. Duhej t'i shmangej çdo gjëje që mund t'i ngjallte dyshime Hakes.

– Sonte natën duhet të kthehem në Berlin. – Hakeja vështroi orën. – Pas një ore e gjysmë.

Raviku rrinte krejt i qetë. Duhet t'i qepem pas, mendoi. Sigurisht banon në ndonjë hotel. S'ma ha mendja të ketë ndonjë shtëpi private. Duhet të shkoj me të gjer në dhomë dhe atje t'i jap fund...

– Jam duke pritur dy miq të mi, – vazhdoi Hakeja. – Duhet të vijnë nga çasti në çast. Do të udhëtojnë bashkë me mua. Plaçkat i kam shpënë me kohë në stacionin e trenit. Prej këtu do të shkojmë drejt e në stacion.

Më iku edhe ky rast! mendoi Raviku. Pse s'kam një revolver me vete? Pse, unë idioti, kam menduar gjatë muajve të fundit se isha gabuar, kur e pashë për herë të parë këtej rrotull? Mund ta vrisja në rrugë e të përpiqesha t'ia mbathja nga metroja...

– Sa keq, – tha Hakeja përsëri. – Por ndoshta mund ta rregullojmë radhën tjetër. Pas dy javësh më keni prapë këtu.

Raviku mori frymë përsëri.

– Mirë, – i tha.

– Ku banoni? – e pyeti Hakeja. – Mund t'ju marr në telefon kur të vi.

– Në hotelin *Prëns dë Gal*. Jo larg që këtej, atje matanë rrugës.

Hakeja nxori nga xhepi një bllok shënimesh dhe shkroi adresën. Raviku e kundroi atë bllok të vogël të lidhur me lëkurë të butë, të kuqe. Lapsi që mbante në dorë Hakeja, ishte i hollë dhe i larë me flori. Ç'shënime duhet të ketë atje brenda? mendoi ai. Informata, me sa duket. Informata që të shpinin në tortura e në vdekje.

Hakeja e futi në xhep bllokun e shënimeve.

– E lezetshme ajo gruaja, me të cilën po flisnit qëparë, – ia bëri ai.

Raviku u mendua një hop.

– Ah, ajo... Po, mjaft e lezetshme.

– Mos merret me filma?

– Aty afër.

– E keni të njohurën tuaj?

– Po, vetëm të njohur.

Hakeja kapsalliti sytë dhe u tret në mendime. Pastaj tha:

– Këtu qëndron vështirësia në këtë qytet... të njihesh me ndonjë femër për të qenë. Koha s'të del dhe s'di si t'i shfrytëzosh rastet...
– Punë që rregullohet, – tha Raviku.
– Vërtet? Ju s'qenkeni fare i interesuar, domethënë...?
– Për çfarë?
Hakeja buzëqeshi si me druajtje.
– Për atë damën, për shembull, me të cilën po flisnit qëparë.
– S'jam aspak i interesuar.
– Hata fare! S'do të ishte keq! Franceze është?
– Më duket se italiane. E përzier edhe me disa raca të tjera, bile.
Hakeja zbardhi dhëmbët.
– Bukur fort. Andej nga ne nuk na i lejojnë këto gjëra. Por këtu jam, si të thuash, inkonjito.
– Ashtu jeni? – e pyeti Raviku.
Hakeja sikur u topit pak. Pastaj e vuri buzën në gaz.
– Për njerëzit e besuar natyrisht që jo... Por për të tjerët duhet të mbetem shumë i fshehtë... Ah, meqë ra fjala, tani m'u kujtua se desha t'ju pyesja diçka: A keni ndonjë farë lidhjeje me refugjatët?
– Shumë pak, – iu përgjigj Raviku me kujdes.
– Gjynah! Do të na hynin shumë në punë disa... ju e kuptoni... disa informata... Bile edhe paguajmë për këtë punë... – Hakeja ngriti dorën:. – Natyrisht s'e kam fjalën për ju! Megjithatë, njoftimi më i vogël do të na vlente mjaft...
Raviku e ndjeu vështrimin vrojtues të Hakes.
– Po të vijë rasti, pse jo, – i tha. – Çdo gjë mund të ndodhë...
Hakeja e afroi ca karrigen e vet.
– Që ta dini ju, kjo është njëra nga detyrat e mia: të krijoj lidhje nga brenda me jashtë shtetit. Nganjëherë e kam shumë të vështirë. Por njerëzit këtu i kemi të mirë. – Ai ngriti vetullat në mënyrë kuptimplote. – Kurse midis nesh, gjermanëve, puna qëndron ndryshe. Është çështje nderi. Patriotizëm, me një fjalë!
– Natyrisht.
Hakeja ktheu kokën me rrëmbim.
– Ja tek më erdhën miqtë që prisja. – Ai la disa kartëmonedha mbi pjatën prej porcelani, pasi e kishte mbledhur më parë shumën. – Gjë e mirë kjo, që çmimet t'i sjellin qysh më parë në pjatë. Mund ta praktikonim edhe te ne. – Ai u ngrit nga vendi dhe i zgjati dorën Ravikut. – Mirupafshim, zoti fon Horn. U gëzova pa masë. Do t'ju marr në telefon pas dy javësh. – Ai buzëqeshi. – Besoj se do të dini t'i ruani të fshehtat.

– Patjetër. Edhe ju mos harroni.

– Unë nuk harroj asgjë. Asnjë fytyrë dhe asnjë takim. Ndryshe do humbisja shumë. S'ma lejon as zanati.

Raviku qëndronte më këmbë përpara tij. I dukej sikur ishte i detyruar ta fuste krahun brenda një muri prej betoni. Pastaj ndjeu dorën e Hakes në të vetën. Ishte një dorë e vogël dhe çuditërisht e butë.

Ai qëndroi edhe disa çaste si i shushatur, duke ndjekur Hakën me sy. Pastaj u ul përsëri. Ndjeu se kishte filluar të dridhej si purtekë. Pas pak pagoi dhe u ngrit. Ndoqi drejtimin që pati marrë Hakeja, por u kujtua menjëherë se e kishte parë të hipte në një taksi bashkë me ata dy të tjerët. Pra, s'do të kishte pikë kuptimi që ta ndiqte. Në hotel Hakeja s'kishte më punë. Po ta pikaste rastësisht në ndonjë vend, do t'i lindte patjetër dyshimi. Raviku bëri mbrapsht dhe u nis për në *Internacional*.

*

* *

– Ke vepruar me mend, – i tha Marozovi. Të dy po rrinin në një kafene, në *Ron Puë*.

Raviku sodiste dorën e djathtë. E pati larë disa herë me alkool. I qe dukur vetja budalla kur e bëri këtë gjë, por nuk i rrihej. Tani lëkura i ishte tharë si pergamenë.

– Do të kishe qenë i çmendur po të kishe ndërmarrë ndonjë gjë, – vazhdoi Marozovi. – Mirë që s'të ndodhej armë me vete.

– Po, – iu përgjigj Raviku, por në zërin e tij mungonte bindja.

Marozovi i hodhi një shikim.

– S'ma ha mendja që të jesh aq hajvan, sa të ta ketë qejfi të dalësh në gjyq për vrasje ose tentativë vrasjeje!

Raviku nuk i dha përgjigje.

– Ravik!... – Marozovi përplasi shishen fort mbi tryezë. – Mos u jep pas fantazive!

– Nuk po jepem pas fantazive. Por duhet të më kuptosh se s'po gjej rehat, duke menduar që më iku një rast nga duart! Ta kisha takuar dy orë më parë, mund ta merrja me vete diku... ose të bëja diçka tjetër...

Marozovi mbushi dy gota.

– Pije! Është vodkë. Ai do të të bjerë prapë në dorë.

– Ndoshta edhe s'më bie.

– Do të të bjerë. Ai do të vijë. Kjo soj race vjen gjithmonë për këso punësh. I ke hedhur një grep të mirë. Gëzuar!

Raviku e ktheu gotën me fund.

– Kam kohë akoma të sulem gjer në stacion, në *Garë dy Nord*. Të shoh në do të niset vërtet.

– Natyrisht që ke kohë. Bile mund të bësh edhe një provë se mos e vret atje... Do të hash të paktën njëzet vjet burg me punë të detyruar. Mos ke edhe ca ide të tjera si kjo?

– Po. E ç'të keqe ka, po të shoh në do të niset vërtet?

– Që të të shohë edhe ai pastaj, dhe ta prishësh gjithë punën!

– Duhej ta kisha pyetur në ç'hotel zbret kur vjen në Paris.

– Që t'i ngjallje dyshime! – Marozovi i mbushi sërish gotat gjer në buzë. – Dëgjo këtu, Ravik. Unë e di se ti më rri tani këtu dhe pandeh se i ke bërë të gjitha së prapthi. Hiqe mendjen nga kjo, po ta them! Merr e thyej diçka, po të duash! Diçka e madhe, por që të mos jetë e shtrenjtë. Për shembull, atë palmën tonë në *Internacional*.

– S'do të bënte dobi.

– Atëherë fillo të llapësh. Dërdëllit për këtë mesele, derisa të të thahet pështyma e të mos kesh më takat. Dërdëllit, që ta nxjerrësh jashtë gjithë atë duf që ke përbrenda. Llap, derisa të biesh rehat.

Raviku u shkund.

– Boris, – ia nisi ai. – Unë di vetëm një gjë: Minjtë e gjirizeve duhet t'i shfarosësh e jo të rrish e të kafshohesh me ta. Tani nuk jam në gjendje të flas për këtë çështje. Por, në vend që të flas, do të mendohem gjatë. Do të vras mendjen, si ta bëj. Do ta përgatis, ashtu siç përgatitet një operacion. Do të mësohem me këtë gjendje. Kam katërmbëdhjetë ditë kohë. Dhe kjo është një gjë e mirë. Fort e mirë, bile. Gjatë kësaj kohe do të mësohem të jem i qetë dhe shumë gjakftohtë. Ti ke të drejtë. Njeriu mund të flasë e të flasë për t'u qetësuar e për të fituar epërsi. Por njeriut mund t'i punojë edhe mendja më shumë nga ç'duhet, e të arrijë po të njëjtën gjë: urrejtjen. Ta mendojë me gjakftohtësi, ta mendojë si qëllim në vetvete. Unë do të vras aq herë me mendje, sa të më bëhet si diçka e zakonshme, kur ai të vijë përsëri këtu. Herën e njëmijtë njeriu është më i pjekur dhe më i qetë se herën e parë... Dhe tani eja të dërdëllitim. Por për diçka tjetër. Për ata trëndafilat e bardhë atje matanë, po të duash! Vështroji! Duken si dëborë në këtë natë zagushie. Si shkumë mbi tallazet e trazuara të natës. A je i kënaqur tani?

– Jo, – tha Marozovi.

– Mirë. Pa sodite ca këtë verë. Verën e 1939-s. Bie erë squfuri.

Trëndafilat kanë nisur të shëmbëllejnë me dëborën që do të bjerë dimrin e ardhshëm mbi një varr të përbashkët ushtarësh. Kurse, përpara kësaj gjendjeje, ky soji ynë e ka punën në vijë dhe bën kokrrën e qejfit, apo jo? Rroftë shekulli i mospërzierjes! Shekulli i ngurosjes së përgjegjësisë morale! Këtë natë po vrasin njerëz, Boris! Çdo natë po vrasin njerëz. Shumë njerëz. Digjen e shkrumbohen qytete, diku ulërijnë hebrenj, ndër pyje ngordhin çekë, me gazolinë japoneze, përcëllohen kinezë, nëpër kampet e përqendrimit endet ogurzezë vdekja në trajtën e kërbaçit... dhe ne t'u bëkemi gra sentimentale, kur vjen puna për të zhdukur një vrasës?! Do ta shtiem në dorë e do ta dërgojmë në atë botë, kjo punë ka marrë fund! Fundja, a s'kemi qenë të detyruar ta bëjmë këtë shpesh herë me njerëz krejt të pafajshëm, të cilët ndryshonin prej nesh vetëm nga uniforma!...

– Bukur, – tha Marozovi. – Po më pëlqen. Të paktën, je më në rregull se qëparë! A ke mësuar ndonjë herë se ç'mund të bëjë njeriu me një thikë? Thika nuk lëshon krisma.

– Sonte më lër rehat! Erdhi koha të bëj edhe unë një sy gjumë. Djalli e di në do të jem në gjendje të fle, megjithëse po shtirem sikur jam shumë i qetë. A më kupton?

– Po.

– Këtë natë do të vras e do të vras. Pas dy javësh duhet të jem kthyer në një automat. Është puna të vras edhe kohën gjer atëherë. Gjer atëherë, kur do të mund të fle rehat më në fund! Rrumbullosja nuk bën dobi. As shiringa e morfinës. Duhet të më zërë gjumi nga lodhja. Atëherë i thonë gjumë tamam dhe të nesërmen ngrihesh qiqër. A më kupton?

Marozovi qëndroi një copë herë pa nxjerrë zë.

– Shko e gjej një grua e fli me të, – ia bëri pastaj.

– E ç'do të dilte nga kjo?

– Diçka do të dilte. Është gjithmonë e mirë, po të biesh në shtrat me një grua. Telefonoji Xhoanës. Ke për të parë që do të të vijë.

Xhoana. Ah, vërtet! Ajo i kishte ardhur qëparë ta takonte. Seç i kishte dërdëllitur diçka. Dhe ai tani nuk mbante mend asgjë.

– Unë s'jam rus, – tha Raviku. – Mos ke gjë propozime të tjera? I dua të thjeshta. Sa më të thjeshta që të jetë e mundur.

– O zot i madh! Pse bëhesh kaq i komplikuar? Mënyra më e thjeshtë për të hequr qafe një grua, është të flesh prapë me të. Me raste. Dhe fantazinë të mos e vësh fare në veprim. Kush është ai idiot që kërkon të dramatizojë një akt të natyrës?

– Po, – tha Raviku. – Kush është ai?

– Atëherë lejomë të shkoj e të telefonoj. Do të të porosis një femër me telefon. S'jam më kot portier nate.

– Rri këtu! Gjithçka është në rregull. Lërna të pimë e të sodisim trëndafilat. Kaq të bardha si ato mund të jenë edhe fytyrat e të vrarëve, nën ndriçimin e hënës pas një breshërie mitralozësh. Kam parë dikur një skenë të tillë në Spanjë. Qielli është vetëm një shpikje e fashistëve! më thoshte metalurgu Pablo Nonas atëherë. Kishte mbetur vetëm me një këmbë, i shkreti. Më mbante edhe pak mëri, pse nuk ia kisha konservuar këmbën e humbur në alkool. I dukej vetja sikur ia kishin varrosur çerekun e trupit. Ai nuk e dinte se këmbën e prerë ia kishin rrëmbyer dhe ngrënë qentë...

25

Veberi erdhi në dhomën e bandazhit. I bëri shenjë Ravikut dhe të dy dolën përjashta në korridor.

– Kam në telefon Dyranin. Kërkon që të shkoni menjëherë tek ai. Seç më llomotiti për një rast të veçantë dhe për rrethana të jashtëzakonshme.

Raviku i hodhi një shikim të gjatë.

– Kjo do të thotë se ka operuar dikë që tani ka rrezik t'i mbetet në dorë dhe kërkon të ma rrasë mua. Apo e kam gabim?

– S'e besoj. Ishte i shqetësuar. Ka të ngjarë që s'di nga t'ia mbajë.

Raviku tundi kokën. Veberi heshtte.

– Po nga e paska marrë vesh që jam kthyer? – pyeti Raviku.

Veberi ngriti supet:

– S'e kam idenë. Ndoshta nga ndonjë infermiere.

– Pse nuk i telefonon Binosë? Binoja është mjaft i aftë.

– Këtë i thashë edhe unë. Por m'u përgjigj se ky ishte një rast shumë i ngatërruar. Pikërisht i specialitetit tuaj.

– Gjepura! Në Paris ka për çdo specialitet mjekë shumë të z Pse nuk thërret Martelin? Është një nga kirurgët më të mirë në bo

– S'e merrkeni dot me mend psenë?

– Natyrisht. Nuk do që të turpërohet përpara kolegëve të vet. Kurse në rastin e një mjeku refugjat, që punon kontrabandë, mesele- ja qëndron ndryshe. Ky duhet ta mbajë gojën.

Veberi e vështroi.

– Puna nuk pret. Do të shkoni?

Raviku zgjidhi rripat e përparëses.

– S'do mend, – ia bëri gjithë inat. – Ç'më mbetet tjetër? Por do të

shkoj vetëm po të vini edhe ju me mua.

– Mirë. Nisemi me veturën time.

Të dy zbritën shkallët. Përpara klinikës makina e Veberit shkëlqente në diell. Ata hipën në të.

– Do t'i futem asaj pune, vetëm po të qëndroni edhe ju atje, – tha Raviku. – Një zot e di nëse ai vëllaçkoja s'ma bën gropën, po të jem vetëm.

– S'e besoj që në këtë rast t'i shkojë mendja për prapësira.

Makina u vu në lëvizje.

– Këta sytë e mi kanë parë shumë, – tha Raviku. – Në Berlin pata njohur dikur një asistent të ri, që i kishte gjithë të dhënat për t'u bërë një kirurg i mirë. Profesori i tij iu fut një operacioni gjysmë i rrumbullosur, i shkau thika, nuk foli gjysmë fjale dhe ia la asistentit ta vazhdonte punën; asistenti i gjorë nuk kuptoi asgjë... Një gjysmë ore më vonë profesori na bëri një gurgule të madhe dhe ia ngarkoi fajin djaloshit. Pacienti vdiq gjatë operacionit. Një ditë më vonë vdiq edhe asistenti. Vrau veten. Kurse profesori vazhdoi të operonte dhe të pinte.

Në *avënynë Marso* u detyruan të ndalonin; një autokolonë uturonte përgjatë rrugës *Galilea*. Dielli digjte përmes xhamave të veturës. Veberi shtypi një sustë në armaturë. Mbulesa e makinës filloi të rrëshqasë ngadalë nga pas. Ai i hodhi Ravikut një shikim krenar:

– S'ka shumë kohë që ma instaluan këtë marifet. Gjë e bukur fort! Punon me korrent. Çfarë nuk sajojnë njerëzit, ë?

Era zuri t'i flladiste nga mbulesa e hapur. Raviku pohoi me kokë:

– Shumë gjë praktike, vërtet! Shpikja e fundit e njerëzve na qenkan minat magnetike dhe siluret. Se ku e lexova dje në një gazetë. Po të mos e zënë objektivin, bëjnë një xhiro mbrapsht gjersa ta gjejnë e ta godasin. Vërtet që jemi një racë e zgjuar konstruktorësh!

Veberi ktheu nga ai fytyrën e vet kuqaloshe prej babaxhani:

– Ah, Ravik, po te lufta ju rri mendja! Ne jemi aq larg prej saj, sa s'jemi larg nga hëna. Të gjitha llafet që qarkullojnë për të, janë vetëm presione politike e asgjë tjetër, besomëni!

*

* *

Lëkura i ngjante sedefit të kaltër, kurse fytyra – hirit. Përqark asaj fytyre, nën dritën qumështore të llambave të sallës së operacionit,

flakëronte një tufë e dendur flokësh të artë. Ishte një flakërim që binte tepër në sy nga kontrasti me fytyrën ngjyrëhiri. Ajo tufë flokësh ishte e vetmja gjë që jetonte, shkëlqimtare dhe klithëse, thuajse jeta e kishte braktisur tanimë atë trup dhe varej vetëm pas atyre flokëve të gjatë.

Ajo gruaja e re që shtrihej atje, ishte shumë e bukur. E brishtë, trupgjatë, me një fytyrë, të cilën edhe hijet e alivanit më të thellë s'mund ta prishnin dot – një grua e lindur për luks dhe dashuri.

Gruaja kishte vetëm pak hemorragji. Më pak nga ç'duhej.

– Ia keni hapur mitrën? – iu drejtua Raviku Dyranit.

– Po.

– Dhe?

Dyrani nuk i dha përgjigje. Raviku ngriti sytë. Dyrani e vështronte si i shastisur.

– Mirë, – tha Raviku. – Për infermieret tani për tani, s'kemi nevojë. Jemi tre mjekë, dhe kjo mjafton.

Dyrani bëri një lëvizje dhe pohoi me kokë. Infermieret dhe asistenti u larguan.

– Dhe ç'ndodhi pastaj? – pyeti tani Raviku rishtas.

– Këtë e shikoni vetë.

– Jo, nuk e shikoj.

Raviku e shikonte fort mirë, por donte që Dyrani ta pohonte përpara Veberit. Kjo ishte më e sigurt.

– Një barrë në muajin e tretë. Hemorragji. Pastrim i domosdoshëm. Kyretazh. Me sa duket, dëmtim i mureve të brendshme.

– Vetëm kaq? – vazhdoi të pyeste Raviku.

Ai e vështroi Dyranin mu në dritë të syrit. Fytyra e profesorit ishte jeshiluar nga inati. Ky do të më urrejë gjersa të vdes, mendonte Raviku. Qoftë edhe vetëm e vetëm sepse është i pranishëm Veberi.

– Perforacion, – tha Dyrani.

– Me kyreter?

– Natyrisht, – tha Dyrani pas një ngurrimi të shkurtër. – Me çfarë tjetër?

Ndërkohë hemorragjia kishte pushuar krejt. Raviku vazhdoi kontrollin në heshtje. Pastaj drejtoi trupin.

– Keni perforuar, por s'e vutë re dhe tërhoqët një zorrë brenda në mitër. S'e kuptuat çfarë ndodhi. Me sa duket, e pandehët për membranë të fetusit. E keni gërvishtur dhe plagosur. A është kështu?

Balli i Dyranit qe mbushur përnjëherësh plot bulëza djerse.

Mjekra nën maskë i punonte, sikur po përtypte një kafshatë të madhe.
– Ka mundësi.
– Sa kohë punuat?
– Derisa erdhët ju, gjithsej treçerek ore.
– Hemorragji e brendshme. Zorra e hollë. Rrezik infeksioni të rëndë. Zorra duhet qepur, mitra duhet hequr. Tani, pa vonesë!
– Si? – pyeti Dyrani.
– Ju e dini vetë se si qëndron puna, – i tha Raviku.
Sytë e Dyranin shkreptinin.
– Po, e di. Por s'ju kam thirrur për këtë!
– Kjo është e gjitha që mund t'ju them. I thërrisni prapë njerëzit tuaj dhe vazhdoni punën. Do t'ju këshilloja ta bënit sa më shpejt.
Dyrani përtypej.
– Kam shumë emocione. A do ta bënit operacionin në vendin tim?
– Jo. Unë, siç e dini edhe vetë, jetoj ilegalisht në Francë dhe s'kam të drejtë të operoj.
– Ju... – ia nisi Dyrani, por e qepi përsëri gojën.
Infermierë, studentë që s'i kanë kryer studimet, masazhatorë, asistentë... e gjithë kjo kope na shiten këtu sikur janë doktorë të mëdhenj, të ikur nga Gjermania... Raviku nuk e kishte harruar çfarë i pati thënë Dyrani Lëvalit.
– Zoti Lëval pati nderin të më sqaronte lidhur me këtë, – tha ai. – Përpara se të më nxirrte jashtë kufirit.
Ai vuri re sesi Veberi ngriti kokën me rrëmbim. Dyrani nuk u ndie fare.
– Operacionin mund t'jua bëjë doktor Veberi, – tha Raviku.
– Por ju keni operuar kushedi sa herë për mua. Në rast se pagesa...
– Pagesa nuk luan rol. Qëkur jam kthyer, nuk operoj më. E sidomos nuk operoj pacientë, të cilët nuk kanë dhënë pëlqimin për një operacion të tillë.
Dyrani zgurdulloi sytë.
– Po ne s'mund ta zgjojmë tani pacienten nga narkoza, për ta pyetur!
– Posi s'mundeni? Vetëm se mbetet rreziku i infeksionit të rëndë.
Fytyra e Dyranit ishte bërë qull. Veberi i hodhi një shikim Ravikut. Raviku bëri një lëvizje me kokë.
– I keni të besueshme infermieret? – e pyeti Veberi Dyranin.
– Po...

– Për asistentin s'kemi nevojë, – i tha Veberi Ravikut. – Bëhemi tre mjekë dhe dy infermiere.

– Raviku... – Dyrani e preu fjalën në mes.

– Duhej të kishit thirrur Binonë, – tha Raviku. – Ose Majonë, ose Martelin. Janë kirurgë të klasës së parë.

Dyrani nuk iu përgjigj.

– A dëshironi të deklaroni këtu, përpara doktor Veberit, se keni bërë një perforacion në mitër dhe keni lënduar një zorrë që e pandehët për membranë të fetusit?

Gjersa erdhi përgjigja, kaloi shumë kohë.

– Po, – ia bëri pastaj Dyrani me zë të ngjirur.

– A dëshironi të deklaroni gjithashtu se iu lutët doktor Veberit që, bashkë me mua, si asistent i ndodhur rastësisht i pranishëm, të bëjë një histerektomi, një reseksion kotiledoni dhe një anastomozë?

– Po.

– A do të mbani përgjegjësi të plotë për operacionin, për përfundimin e tij dhe për faktin që pacientja nuk është e informuar dhe nuk ka dhënë pëlqimin e saj?

– Po, natyrisht që po, – krakariti Dyrani.

– Mirë. Thërrisni infermieret. Asistentin jo. Ia shpjegoni se na keni lejuar, mua dhe Veberin, që të asistojmë në një rast të veçantë e të ndërlikuar. I thoni që është një premtim i vjetër ose sajoni diçka tjetër. Anestezinë mund ta vazhdoni përsëri vetë. A duhet të sterilizohen rishtazi infermieret?

– S'është nevoja. S'kanë prekur gjë.

– Aq më mirë.

*

* *

Barku ishte i hapur. Raviku tërhoqi me kujdes jashtëzakonisht të madh zorrën nga e çara në mitër dhe e mbështolli pjesë-pjesë në garzë sterile, për të shmangur infeksionin, derisa doli pjesa e plagosur. Pastaj e mbuloi mitrën me pece.

– Barrë jashtë mitre, – i murmuriti Veberit. – Vështroni këtu... gjysmë në mitër e gjysmë në tub. S'ke edhe si t'i vësh faj të madh atij... Me të vërtetë rast i veçantë. Por, megjithatë...

– Çfarë? – pyeti Dyrani që nga kreu i tryezës së operacionit. – Çfarë thatë?

– Asgjë.

Raviku ia vuri klemat zorrës dhe bëri reseksionin. Pastaj filloi t'i mbyllte shpejt fundet e hapura dhe bëri një anastomozë anësore.

Intensiteti i operacionit e kishte rrëmbyer të tërin. E harroi Dyranin. Lidhi tubin me enët e gjakut dhe preu fundin e tubit. Pastaj filloi të priste uterusin. Pse një gjë e tillë nuk gjakoset më shumë se zemra? mendoi ai. Pse nuk derdhet gjaku çurg, kur pritet mrekullia e jetës dhe aftësia për ta rifalur?...

Kjo krijesë e bukur që rrinte shtrirë atje, ishte e vdekur. Ajo mund të vazhdonte të jetonte, por ishte e vdekur. Një degë e vdekur në trungun e brezave. E lulëzuar, por e zhveshur nga misteri i frutit. Majmunët viganë dolën nga xhunglat dhe, nëpërmes mijëra brezash, erdhën e u zhvilluan në njerëz; egjiptianët ndërtuan tempuj; Greqia e lashtë lulëzoi; gjaku rrodhi e rrodhi në mënyrë të mistershme, derisa erdhi e u formua edhe ky njeri, që tani i ngjante një kalliri kallp dhe gjakun e vet nuk do ta përçonte dot më tej, ndër dámarët e një biri a të një bije. Zinxhiri ishte këputur nga dora e vrazhdë e Dyranit. Por a s'kishin punuar edhe për këtë Dyran mijëra breza, a s'kishin lulëzuar edhe për të Greqia e lashtë dhe Rilindja, për të nxjerrë më së fundi në dritë atë mjekër të poshtër majuce?!...

- Punë dreqi! – ia bëri Raviku.

- Çfarë? – pyeti Veberi.

- Seç m'u kujtuan ca gjëra...

Raviku drejtoi trupin.

- Mbarova. – Ai vështroi atë fytyrë të hequr e të lezetshme, me flokët shkëlqimtarë. Vështroi edhe enën ku, e ndotur dhe e përgjaktë, ishte hedhur ajo që e pati bërë atë fytyrë aq të bukur. Pastaj vështroi Dyranin. – Mbarova, – tha edhe njëherë.

Dyrani i dha fund anestezisë. Ravikun nuk e shikonte fare në sy. Priti gjersa infermieret e nxorën jashtë tryezën e operacionit dhe pastaj i ndoqi pas, pa thënë gjysmë fjale.

- Nesër do t'i kërkojë pesë mijë franga më tepër për operacionin, - i tha Raviku Veberit. – Dhe do t'i mbushë mendjen që i ka shpëtuar jetën.

- Hëpërhë s'më duket sikur e ka mendjen te paraja.

- Një ditë është goxha kohë, kurse pendesa zgjat shumë pak e, sidomos, kur ke mundësi ta kthesh në tregti.

Raviku filloi të lahej. Nëpërmes xhameve pranë lavamanit të bardhë dalloi në dritaren përkundrejt disa lulemullaga të kuqe që kishin çelur. Një mace e murrme shtriqej pranë saksive.

*
* *

Në orën një pas mesnate ai mori në telefon klinikën e Dyranit. Telefonoi nga *Sheherezadja*. Infermierja e rojës i tha që gruaja po flinte. Përpara dy orësh kishte qenë ca e shqetësuar. Por Veberi ndodhej atje dhe i pati dhënë një qetësues. Dukej se çdo gjë ishte në rregull.

Raviku hapi derën e kabinës telefonike. Një aromë e fortë parfumi e goditi në fytyrë. Një grua me flokë të zverdhur me oksigjen i parakaloi gjithë krenari dhe u fut në WC-në e grave. Flokët e gruas në klinikë kishin qenë biondë natyralë, të verdhë në të kuqërremtë, flokë që të lëbyrnin me shkëlqimin e tyre. Ai ndezi një cigare dhe u kthye në lokal. Kori i përjetshëm rus ia kishte marrë avazit të përjetshëm të këngës *"Sytë e zinj"*. Qysh prej njëzet vjetësh e këndonin rusët këtë këngë nëpër botë. Tragjikja, po ta zgjatje njëzet vjet rresht, kishte rrezik të kthehej në qesharake, mendoi Raviku. Tragjikja duhej ta kishte jetën sa më të shkurtër.

– Më falni, – i tha ai Keti Hegshtrëmit. – M'u desh të telefonoja.

– A është çdo gjë në rregull?

– Gjer tani, po.

Përse po ma bën këtë pyetje? mendoi ai i hutuar. Ajo vetë s'është aspak në rregull.

– A i keni të gjitha që dëshironi? – ai rrëfeu brokën me vodkë.

– Jo.

– Jo?

Keti Hegshtrëmi tundi kokën.

– E ka fajin vera. Në verë njeriu s'duhet të rrijë nëpër klube nate. Në verë duhet ndenjur në ndonjë tarracë. Qoftë edhe pranë një peme tuberkuloze, të qarkuar me parmak hekuri.

Raviku heshti dhe ngriti kokën. Një çast sytë iu ndeshën me sytë e Xhoanës. Ajo duhej të kishte ardhur në kohën që ai po telefononte. Më parë nuk ndodhej atje, në qoshkun përkundrejt.

– Keni qejf të shkojmë gjetkë? – e pyeti ai Keti Hegshtrëmin.

Ajo tundi kokën.

– Jo. Po ju? Pranë ndonjë peme tuberkuloze?

– Ah, atje edhe vodkat janë në më të shumtën e rasteve tuberkuloze. Kurse kjo jona këtu është e mirë.

Kori pushoi së kënduari dhe muzika ndërroi. Orkestra nisi të luante një *bluz*. Xhoana u ngrit dhe u drejtua për nga pista e vallëzi-

mit. Raviku nuk mundte ta dallonte mirë. Dhe as me kë kërcente. Vetëm kur projektori rrëshqiti me zbehtësinë e tij të kaltër mbi pistë, ajo shfaqej çdoherë në dritë dhe pastaj kridhej sërish në gjysmerrësirë.

– Keni operuar sot? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

– Po.

– Pas një pune të tillë, si e ndieni veten pastaj, kur shkoni e rrini në një klub nate? Mos është njëlloj sikur kthehesh nga beteja në qytet? Apo nga sëmundja në jetë?

– Jo gjithmonë. Nganjëherë nuk ndien asgjë përveç zbrazëtirës.

Sytë e Xhoanës ishin të tejdukshëm në tufën e rrezeve të zbehta të projektorit. Ajo vështronte nga ai. Nuk është zemra ajo që po tronditet, mendoi Raviku. Është stomaku. Një goditje në pleksusin solar. Për këtë janë shkruar me mijëra vjersha. Dhe tronditja nuk shkaktohet prej teje, o ti copë mishi e bukur që vallëzon atje tej, e lehtë si pendë dhe pak e djersitur… Ajo vjen nga dhomëzat e errëta të trurit tim... Është një kontakt i lehtë dhe është diçka e rastit, që unë e ndiej më të fortë, kur ti rrëshqet e përshkënditur nga ajo tufë drite…

– A s'është kjo ajo gruaja që këndonte dikur këtu? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

– Po.

– Nuk këndoka më?

– Më duket se jo.

– Është një femër e bukur.

– Ashtu?

– Po. Është bile më tepër se e bukur. Ka një fytyrë ku jeta lexohet açik.

– Ndoshta.

Keti Hegshtrëmi e soditi Ravikun me sy të picërruar. Ajo buzëqeshi. Ishte një buzëqeshje që mund të përfundonte edhe në lot.

– Më jepni edhe një vodkë dhe pastaj të ikim, – i tha ajo.

Tek po ngrihej, Raviku ndjeu shikimin e Xhoanës. Ai i shkoi krahun Ketit. Kjo s'ishte fort e nevojshme; ajo mund të ecte fare mirë edhe vetëm; por atij i shkrepi se Xhoanës s'do t'i bënte keq po ta shikonte këtë gjë.

– A do të më bëni një nder? – pyeti Keti Hegshtrëmi, kur u ndodhën në dhomën e saj, në hotel *Lankastër.*

– Patjetër. Po ta kem në dorë.

– A do të vinit me mua në ballon e Monforëve?

– Ç'është kjo ballo, Keti? S'e kam dëgjuar kurrë.

Ajo u ul në kolltuk. Kolltuku ishte tepër i madh për të. Tek rrinte ashtu, dukej tepër e thyeshme – si një figurinë porcelani e një vallta-reje kineze.

– Balloja e Monforëve është ngjarja më e shënuar e verës në sho-qërinë parisiane, – tha ajo. – Bëhet të premten që vjen në shtëpinë dhe në kopshtin e Lui Monforit. S'keni dëgjuar ndonjëherë të bëhet fjalë për të?

– Jo.

– A do të më shoqëroni?

– Po a më pranojnë?

– Do t'ju rregulloj një ftesë.

Raviku e vështroi.

– Pse, Keti?

– Sepse kam dëshirë të jem atje. Por s'dua të shkoj vetëm.

– Domethënë, po të mos isha unë, duhej të shkonit vetëm?

– Jo se duhej, por do të shkoja vetëm. Nuk dua të shkoj me ndonjë njeri nga ata të mëparshmit. Nuk do të duroja dot. A më kup-toni?

– Po.

– Është më e bukura dhe e fundmja festë që bëhet këtë verë në kopsht të hapur, në Paris. Katër vjetët e fundit nuk kam munguar asnjëherë. A do të ma bëni këtë nder?

Raviku e dinte pse Keti donte të shkonte bashkë me të. Do të ndihej më e sigurt. Ai nuk mund t'ia prishte kurrsesi.

– Mirë, Keti, – i tha. – S'është nevoja të më siguroni ftesë të posaçme. Po të jenë në dijeni që do të sillni dikë me vete, besoj se kjo mjafton.

Ajo bëri një shenjë pohimi.

– Patjetër. Falemnderit, Ravik. Do t'i telefonoj menjëherë Sofie Monforit.

Ai u ngrit për të ikur.

– Atëherë, të premten po vij t'ju marr. Çfarë do të vishni?

Ajo i ngriti sytë drejt tij. Drita hidhte një refleks të fortë mbi flo-këT e saj të shtirë nga prapa. Një kokë si e hardhucës, mendoi ai. Eleganca e ngushtë, e thatë dhe e ashpër e përsosmërisë pa mish, të cilën shëndeti kurrë nuk do të mund të arrinte ta jepte.

– Ja, kjo është ajo për të cilën nuk ju kam folur akoma, – tha Keti pas një ngurrimi të shkurtër. – Është një festë kostumesh, Ravik. Një mbrëmje në kopsht, si ato që bëheshin qëmoti në oborrin e Luigjit XIV.

– O zot i madh! – Raviku u ul përsëri.

Keti Hegshtrëmi qeshi. Ishte një e qeshur e lirshme, fëmijërore.

– Kam një konjak të mirë, të vjetër, – i tha ajo. – Mos keni nevojë të merrni pak fuqi?

Raviku tundi kokën.

– Çfarë nuk sajojnë njerëzit!

– Çdo vit bëhet diçka e ngjashme.

– Domethënë, do të më duhet...

– Do të kujdesem unë për të gjitha, – e ndërpreu ajo me nxit. – S'keni pse bëheni merak për asgjë. Kostumin do ta gjej unë. Diçka të thjeshtë. S'do të keni nevojë as ta provoni. Më jepni vetëm masën.

– Më duket se u bëra vërtet për një konjak, – tha Raviku.

Keti Hegshtrëmi ia afroi shishen.

– Se mos më bëni ndonjë punë tani në fund e më thoni jo!

Ai e piu konjakun. Dymbëdhjetë ditë! tha me vete. Dymbëdhjetë ditë, derisa Hakeja të kthehej përsëri në Paris. Dymbëdhjetë ditë që duheshin kaluar disi. Dymbëdhjetë ditë... E gjithë jeta e tij përmblidhej vetëm në ato dymbëdhjetë ditë, dhe prej tyre ai s'ishte në gjendje të mendonte asgjë. Dymbëdhjetë ditë... pas tyre gogësinte një humnerë. S'kishte rëndësi se si do ta kalonte kohën deri atëherë. Një festë kostumesh e maskash – në këto dy javë që do të rridhnin si një përrua i turbullt, asgjë nuk mund të quhej groteske!

– Mirë, Keti.

*

* *

Ai shkoi edhe njëherë në klinikën e Dyranit. Gruaja me flokët biondë po flinte. Bulëza të mëdha djerse i kishin dalë në ballë. Fytyra i kishte marrë ngjyrë dhe gojën e mbante paksa të hapur.

– Ka pasur temperaturë? – e pyeti ai infermieren.

– Tridhjetë e shtatë e tetë.

– Mirë.

Ai u përkul thellë mbi fytyrën e qullur për të ndier frymëmarrjen. Në frymën e pacientes nuk dallohej më kloroformi. Ishte një frymë e freskët, si lule lavande... Lavanda! u kujtua ai. Një lëndinë në Shvarcvald... ai vetë, herë duke vrapuar e herë duke u hequr zvarrë nën rrezet përvëluese të diellit... Diku larg thirrjet e ndjekësve – dhe aroma dehëse e lavandës. Çudi se si harrohen të gjitha, me përjashtim të erërave, mendoi ai. Lavanda – edhe pas njëzet vjetësh

aroma e saj do t'i sillte ndër mend atë ditën e arratisjes në Shvarcvald, do ta shkulte nga brazdat e pluhurosura të kujtesës, sikur të kishte ndodhur dje. Jo pas njëzet vjetësh, tha me vete, por pas dymbëdhjetë ditësh!...

Mori rrugët nëpër qytetin e ngrohtë, për t'u kthyer në hotel. Po shkonte ora tre. Iu ngjit shkallëve përpjetë. Poshtë derës gjeti një zarf të bardhë. E mori. Zarfi kishte emrin e tij, por s'kishte as pullë poste as vulë. Xhoana! i shkoi në mendje dhe e hapi. Nga zarfi ra një çek. Ishte i Dyranit. Raviku i hodhi një sy mospërfillës shifrës. Por pastaj e shikoi edhe njëherë me vëmendje. Nuk po u besonte syve. Nuk ishin dyqind frangat e zakonshme. Ishin dy mijë. Kësaj radhe duhet t'i ketë hyrë frika në palcë, mendoi ai. Dy mijë franga nga dora e Dyranit dhe, për më tepër, vullnetarisht – kjo ishte çudia e tetë e botës!

E futi çekun në kuletë dhe afroi një turrë librash mbi tryezën pranë shtratit. I pati blerë përpara dy ditësh që të lexonte kur të mos kishte gjumë. Kjo puna e librave, ishte vërtet çudi – ata po bëheshin për të gjithnjë e më të rëndësishëm. Vërtet që s'mund t'i zëvendësonin gjithçka, por i plotësonin diçka që asgjë tjetër nuk arrinte ta mbushte dot. Iu kujtua se vitet e para nuk kishte prekur libër me dorë; i dukeshin shumë të zbehtë ndaj asaj që kishte ndodhur. Kurse tani ishin bërë si mur fortese – edhe po të mos mbronin gjë, të paktën mund të mbështeteshe pas tyre. Vërtet që nuk ndihmonin shumë, por të shpëtonin nga dëshpërimi i plotë në një kohë që po kthehej me turr drejt errësirës. Dhe kaq mjaftonte. Dikur njerëzit kishin menduar gjëra që sot po përbuzeshin e po përqesheshin; po ato ishin menduar dhe do të mbeteshin – dhe kjo mjaftonte.

Po pa filluar të lexonte, tringëlloi zilja e telefonit. Ai nuk e ngriti dorezën fare. Zilja tringëlloi gjatë. Disa minuta më vonë, kur pllakosi qetësia, ai e ngriti dorezën dhe pyeti portierin kush i kishte telefonuar.

– Nuk ma tha emrin, – iu përgjigj portieri. Ravikut i zuri veshi disa të mbllaçitura dhe e kuptoi që portieri po hante.

– Grua ishte?

– Po.

– Fliste me akcent?

– Këtë s'e di. – Portieri vazhdoi të përtypej.

Raviku mori në telefon klinikën e Veberit. Që andej nuk i kishte telefonuar njeri. As nga spitali i Dyranit. Ai telefonoi edhe në hotel *Lankaster*. Centralistja i tha se andej nuk e kishte kërkuar njeri numrin e tij. Pra, duhej të kishte qenë Xhoana. Me sa dukej, do t'i kishte

telefonuar nga *Sheherezadja*.

Pas një ore telefoni ra përsëri. Raviku e la librin mënjanë, u ngrit dhe shkoi te dritarja. Mbështeti bërrylat mbi parvaz dhe priti. Flladi i lehtë sillte gjer tek ai aromën e zambakëve. Emigrani Vizenhof i kishte zëvendësuar karafilat e vyshkur në dritaren e tij me zambakë. Netëve të ngrohta i gjithë hoteli binte erë varrezë ose oborr manastiri. Raviku nuk e dinte nëse Vizenhofi e kishte bërë këtë nga dhimbsuria për plakun Goldberg apo vetëm e vetëm sepse zambakët rriteshin mirë ndër arkëza druri. Telefoni heshti. Ndoshta këtë natë do të bëj një sy gjumë, mendoi ai dhe shkoi e ra përsëri në shtrat.

Xhoana erdhi ndërsa ai po flinte. Ajo ndezi menjëherë dritën e madhe dhe qëndroi te pragu. Ai hapi sytë.

– Vetëm je? – e pyeti ajo.

– Jo. Shuaje dritën dhe ik!

Ajo ngurroi për një çast. Pastaj shkoi e hapi derën e banjës.

– Gënjeshtar, – tha dhe qeshi.

– Shko në djall! Jam i lodhur.

– I lodhur? Nga se?

– I lodhur. Lamtumirë!

Ajo i erdhi pranë.

– Ti sapo duhet të jesh kthyer. Kam telefonuar krye çdo dhjetë minutash.

Ajo e soditi me vëmendje. Ai nuk i tha që po gënjente. Kishte ndërruar fustan. Ka fjetur me atë bandillin, e ka degdisur pastaj për në shtëpi dhe ka ardhur tani për të më zënë në flagrancë dhe për t'i treguar Keti Hegshtrëmit, të cilën e pandehte këtu, se ç'kurvar i poshtër jam unë, tek i cili gratë vijnë e ikin natën pa teklif dhe të cilit mjerë ato që i zënë besë, mendoi ai. Kundër vullnetit të vet iu dëgjesh të buzëqeshte. Një aksion i përsosur i ngjallte, mjerisht, gjithmonë admirim – qoftë edhe kur drejtohej kundër tij.

– Ç'ke që më zbardh dhëmbët? – iu hakërrye Xhoana.

– Më qeshet. Kjo është e gjitha. Dhe tani shuaje atë dritë. Dukesh e tmerrshme në dritë. Dhe hiqmu këtej!

Ajo s'ia vari fare.

– Kush ishte ajo prostitutka me të cilën shoqëroheshe?

Raviku u ngrit ndenjur në krevat.

– Shporru, po të them, ndryshe të hodha ndonjë send kokës!

– Ah, kështu qenka puna... – Ajo ia nguli sytë. – Kështu na qenka! Gjer këtu paska arritur puna!

Raviku mori një cigare.

– Mos u bëj qesharake. Edhe jeton me një burrë tjetër, edhe më vjen këtu e më bën skena xhelozie! Kthehu tek ai aktori yt dhe lërmë rehat!

– Puna ime është krejt ndryshe! – tha ajo.

– Natyrisht!

– Natyrisht që është krejt ndryshe! – Ajo shpërtheu përnjëherësh. – Ti e di fort mirë që është krejt ndryshe. Është diçka që s'kam ç't'i bëj. Mos kujto se jam e lumtur. Erdhi ashtu, as vetë nuk e di se si...

– Gjithmonë ashtu vjen, e kurrë nuk e dimë se si...

Ajo ia shkreptiu sytë.

– Ti... Ti ishe gjithmonë aq i sigurt! Ishe aq i sigurt, sa më vinte të shkalloja! Asgjë s'mund të të shkundte nga ajo siguri! E urreja atë epërsinë tënde! Sa herë jam pushtuar nga urrejtja për të!... Unë kam nevojë për entuziazëm! Kam nevojë për një njeri që të çmendet pas meje, të lajthitë bashkë me mua! Më duhet një njeri që s'bën dot pa mua! Kurse ti mund të jetosh edhe pa mua! Gjithmonë ke mundur! S'ma ke nevojën! Je i ftohtë! Je i zbrazët! Ku di ti ç'është dashuria! Kurrë s'ke qenë për mua ai që duhej të ishe!... Të pata gënjyer atëherë kur të thashë që kjo punë ndodhi kështu sepse mungove dy muaj. Kështu do të ndodhte edhe sikur të kishe mbetur këtu. Mos m'i zbardh dhëmbët! Unë jam e zonja t'i dalloj ndryshimet, i di të gjitha; e di që ai tjetri nuk është i zgjuar dhe nuk është kështu si ti, por ai bën çmos për mua, ngordh për mua, për të s'ekziston asgjë përveç meje; ai e ka mendjen vetëm tek unë, nuk do njeri tjetër përveç meje, nuk njeh tjetër përveç pushtetit im... Ja, për këtë kam nevojë unë!

Ajo kishte qëndruar përpara shtratit të tij, me gjoksin plot gulçime të mbytura.

Raviku zgjati dorën dhe mori një shishe *Kalvadosi* nga tryeza.

– Atëherë, pse ke ardhur këtu? – e pyeti.

Ajo nuk iu përgjigj aty për aty.

– Ti e di, – i tha pastaj me zë të mekur. – Pse më pyet?

Ai mbushi një gotë gjer në buzë dhe ia zgjati.

– Nuk dua të pi! – ia bëri ajo. – Cila ishte ajo gruaja?

– Një paciente. – Ravikut s'ia kishte qejfi të gënjente. – Një grua që është e sëmurë rëndë.

– Kjo s'është e vërtetë. Mëso të gënjesh më mirë. Një grua e sëmurë rri në spital dhe jo nëpër klube nate.

Raviku e la gotën mbi tryezë. Shpeshherë e vërteta dukej krejtësisht e pabesueshme.

– Është shumë e vërtetë, – tha ai.

– E dashuron?

– Ç'të duhet ty?

– E dashuron?

– Pa më thuaj, Xhoanë, ç'të duhet ty?

– Më duhet, dhe shumë, bile! Përderisa të mos dashurosh njeri tjetër... – Ajo e preu fjalën.

– Qëparë ti e quajte atë grua prostitutë. E si mund t'u bëka fjalë për dashuri në këtë mes?

– E thashë vetëm ashtu kot. E vura re menjëherë që ajo s'ishte e tillë. Prandaj e thashë. Për një prostitutë s'do të vija gjer këtu. E dashuron?

– Shuaje dritën dhe ik!

Ajo iu avit shtratit edhe më shumë.

– E dija. E kuptova menjëherë...

– Shko në djall! – i tha Raviku. – Jam i lodhur. Shko në djall me gjithë gjepurat e tua bajate, që m'i kujton si të pashoqe në këtë jetë... Njërin na e mbake për t'u dehur ekstaze, për dashuri praktike ose për karrierë... kurse tjetrin, që i thua se e dashuroke më fort e më ndryshe, e mbake si liman për kohën e lirë, në qoftë se ai gomari e ha këtë tek! Shko në djall! Mënyrat e dashurisë që ditke ti, po më duken ca si shumë.

– Kjo s'është e vërtetë! Nuk është ashtu siç e paraqet ti. Është ndryshe. Nuk është e vërtetë, po të them! Dua të kthehem te ti! Dhe do të kthehem!

Raviku e mbushi sërish gotën e vet.

– Ka të ngjarë që edhe dëshiron të kthehesh. Por ky është vetëm një iluzion. Një iluzion që ia ushqen vetes. Mjerisht. Një iluzion, me të cilin gënjehesh për të gjetur një rrugëdalje. Ti kurrë s'ke për t'u kthyer tek unë.

– Po!

– Jo. Edhe në qoftë se kthehesh, këtë do ta bësh vetëm për një kohë të shkurtër. Pastaj do të vijë përsëri dikush tjetër, që s'do të dojë asgjë përveç teje, për të cilin s'do të ekzistojë asgjë tjetër në botë përveç teje dhe kjo mesele kështu do të vazhdojë. Vërtet një e ardhme shumë e ndritur për mua, s'ke ç'i thua!...

– Jo, jo! Unë do të qëndroj te ti.

Raviku qeshi.

– E ëmbla ime, – tha ai me një zë pothuajse përkëdhelës. – Ti nuk ke për të qëndruar tek unë. Erën nuk mund ta burgosësh. As ujin. Po ta bësh këtë, ata myken. Era e mbyllur bëhet ajër i ndjenjur. Ti s'je

krijuar për të qëndruar në një vend.

– As ti.

– Unë? – Raviku zbrazi gotën e vet. Ajo biondina e mëngjesit, ajo e operuara, mendoi ai... Pastaj Keti Hegshtrëmi me vdekjen në bark dhe lëkurën si mëndafshi i djegur... dhe tani kjo këtu, pa skrupuj, gjithë epsh dhe e ndezur për jetën; akoma e huaj ndaj vetvetes e, megjithatë, më e afërt ndaj unit të vet sesa një burrë me dy para mend; naive dhe e dhënë; besnike në mënyrën e saj të çuditshme dhe e pabesë si mëma e vet Natyrë; shtyrëse dhe e shtyrë, që edhe kërkon të të mbajë, edhe të braktis...

– Unë? – përsëriti Raviku. – Ç'di ti për mua? Ku e kupton dot ti, kur në një jetë, ku gjithçka është kthyer në pikëpyetje, vjen e hyn dashuria? Ç'është dehja jote e rëndomtë në krahasim me të? Kur gjatë gremisjes së pandërprerë drejt tatëpjetës gjen befas një mbështetje, kur "pseja" e pareshtur vjen e kthehet më së fundi në një "ti" të sigurt, kur mbi shkretëtirën e heshtjes të fanitet papritmas ndjenja si një vegim mrekullie, ndjenja që lind, formohet dhe që, pa e kuptuar as ti vetë, i shndërron të gjitha në një panoramë tmerrësisht të bukur, në krahasim me të cilën gjithë ëndrrat të duken të zbehta e meskine? Një panoramë prej argjendi, një qytet prej filigrani dhe trëndafilash, një panoramë shkëlqimtare si vezullimi më i ndritshëm i gjakut të prushtë... Ku i kupton ti këto? Mos pandeh ti se njeriu, një të shkelur sustën e mund të flasë menjëherë për të gjitha këto? Mos pandeh ti se një gjuhë e mprehtë mund t'i fiksojë aty për aty mbi klishenë e fjalëve, domethënë të ndjenjave? Ku e di ti çfarë do të thotë, kur hapen varret dhe kur qëndron me ankth përpara të perënduarve të djeshëm... Por varret hapen dhe në to s'ka më skelete; ka vetëm dhé në to. Dhé, farë e frytshme... dhe gjelbërimi i parë... Ku di ti nga këto? Ti dashuron ekstazën, përhumbjen e plotë, "unin" e huaj që kërkon të fundoset te ti, por që nuk do të fundoset kurrë... Ti dashuron mashtrimin e stuhishëm të gjakut, por zemra jote do të mbetet e zbrazët, sepse njeriu s'mban asgjë përveç asaj që rritet brenda tij. Dhe, gjatë një stuhie, s'para rriten shumë gjëra. Gjërat rriten netëve të zbrazëta të vetmisë dhe vetëm atëherë kur njeriu s'i humbet të gjitha shpresat dhe s'i ngre duart përpjetë... Po ku mund t'i dish ti këto?

Ai kishte folur shumë avash dhe pa e vështruar fare Xhoanën, a thua se e kishte harruar praninë e saj. Tani ngriti sytë dhe e pa.

– Ç'po dërdëllis kështu? – tha. – Gjëra të vjetra, marrëzira. Kam pirë shumë. Eja, pi edhe ti diçka dhe ik.

Ajo u ul pranë tij, buzë shtratit, dhe mori gotën në dorë.

– E kuptova, – tha ajo. Fytyra i kishte ndërruar. Është si një pasqyrë, mendoi ai. Gjithmonë e kthen atë që i kundërvihet. Ajo fytyrë ishte tani e bukur dhe e vëmendshme. – E kuptova, – përsëriti Xhoana. – Dhe nganjëherë edhe e kam ndier. Por ti, Ravik, në rrugën tënde të dashurisë drejt dashurisë dhe drejt jetës mua më ke harruar shpesh. Unë isha, ndoshta, vetëm një shkas… dhe pastaj ti arratiseshe e humbisje në qytetet e tua të argjendta dhe për mua kujtoheshe shumë rrallë…

Ai i hodhi një vështrim shumë të gjatë.

– Ndoshta, – i tha.

– Ti ishe aq i zënë me vetveten, ti zbuloje aq shumë sende brenda vetes, saqë unë mbetesha disi mënjanë jetës sate.

– Ndoshta. Por ti nuk je nga ato, te të cilat mund të mbështetet ndokush, Xhoanë. Ti këtë e di edhe vetë.

– Po ti a ke dashur të mbështeteshe?

– Jo, – tha Raviku, pasi u mendua një grimë. Pastaj vuri buzën në gaz. – Po kur je i mërguar gjithçkaje që dikur ishte e qëndrueshme, bie nganjëherë në situata të çuditshme dhe bën gjëra të çuditshme. Natyrisht që nuk kisha ndër mend të mbështetesha te ti. Por kur ke vetëm një shqerrkë, kërkon të bësh gjithë ato gjëra me të…

Nata ishte mbushur përnjëherësh me një paqe të thellë. Ishte përsëri si një nga ato netët e kohërave që s'mbaheshin më mend, kur Xhoana rrinte shtrirë pranë tij. Qyteti ishte larg, shumë larg; prej tij kishte mbetur vetëm një zukatje e butë diku tej në horizont; zinxhiri i orëve ishte këputur dhe koha ishte e heshtur dhe dukej sikur kishte qëndruar në vend. Më e thjeshta dhe më e pakuptueshmja gjë në botë kishte ndodhur sërish: dy njerëz po flisnin me njëri-tjetrin, secili për hesap të vet; dhe tingujt, që quheshin fjalë, formonin te të dy po ato figura dhe ndjenja në atë masën e dridhshme nën kafkë – dhe nga vibracione të pakuptimta kordash vokale dhe reagime në brazdat e hirta të trurit lindnin përsëri, ashtu papritmas, qiej, ndër të cilët pasqyroheshin re, përrenj, koha e shkuar, lulëzimi, venitja dhe dija e thellë…

– Ti më dashuron, Ravik, – i tha Xhoana, dhe ishte më tepër konstatim sesa pyetje.

– Po. Por jam duke bërë çmos që të shpëtoj prej teje.

Ai e tha këtë qetë, si diçka që u interesonte fort pak të dyve.

Ajo bëri sikur s'e dëgjoi.

– Nuk mund ta marr dot me mend që ne s'do të jemi kurrë më

bashkë. Për disa kohë, mbase. Por jo përgjithmonë. Përgjithmonë, jo kurrë! – përsëriti ajo dhe mornica i kaluan nëpër trup. – Fjala *kurrë* është fjalë e tmerrshme, Ravik. Nuk mund ta përfytyroj dot që s'do të jemi kurrë më bashkë!

Raviku nuk i dha përgjigje.

– Më lër të qëndroj këtu, – i tha ajo. – S'dua të iki kurrë më, kurrë!

– Që nesër do të ikje. Ti e di këtë.

– Kur jam këtu, s'e mendoj dot që të mos qëndroj këtu.

– Është po e njëjta gjë. Edhe këtë ti e di.

Boshllëku midis dy kohëve. Dhoma e vogël, e ndriçuar, po ajo që kishte qenë – ja atje përsëri edhe njeriu që dashuroje; ishte aty, por, në një mënyrë fort të çuditshme, edhe nuk ishte; mund ta prekje, mjafton të shtrije duart – e përsëri nuk mund ta arrije dot...

Raviku e la gotën mbi tryezë.

– Ti e di që do të ikje prapë... nesër, pasnesër, një ditë prej ditësh...

Xhoana uli kokën.

– Po.

– Edhe po të kthehesh prapë tek unë, ti e di që prapë e gjithmonë do të ikje.

– Po.

Ajo ngriti kokën. Fytyrën e kishte qull në lot.

– Si shpjegohet kjo, Ravik, si?

– As unë nuk e di. – Ai buzëqeshi lehtë. – Dashuria s'është edhe aq gazmore nganjëherë, si thua?

– Jo, s'është. – Ajo e vështroi. – Ç'është kjo punë me ne kështu, Ravik?

Ai ngriti supet.

– As unë nuk e di, Xhoanë. Ndoshta sepse nuk na ka mbetur më asgjë tjetër ku të mbahemi. Më parë njeriu kishte plot gjëra... siguri në, mbështetjen, besimin në diçka, qëllimet... gjithë këta parmakë të bukur, pas të cilëve mund të mbaheshe, kur të shkundte e të tundte dashuria. Kurse sot s'ke asgjë... të shumtën pakëz dëshpërim, pakëz guxim dhe, sa për të tjerat, s'ke ç'i do fare, sepse janë të huaja, gjithmonë të huaja. Prandaj, kur të braktis dashuria, është sikur i vë pishën e ndezur një mullari bari. Kur s'ke asgjë tjetër përveç dashurisë, atëherë ajo bëhet ndryshe, bëhet më e egër, më e rëndësishme, më shkatërrimtare. – Ai e mbushi përsëri gotën gjer në buzë. – Nuk duhet vrarë mendja për këtë. Në gjendjen që jemi, ne s'mund të men-

dohemi shumë. Përndryshe do të shkatërroheshim. Dhe ne nuk duam të shkatërrohemi, si thua?

Xhoana tundi kokën.

– Jo. Pa më thuaj, Ravik, cila ishte ajo gruaja?

– Një paciente. Kam qenë edhe një herë tjetër me të në *Sheherezade*. Në atë kohë kur ti këndoje akoma. Këtu e njëqind vjet më parë. Po tani a merresh me ndonjë punë?

– Kam ca role të vogla. Por më duket se s'jam gjë si aktore. Sidoqoftë fitoj aq sa për të qenë e pavarur. Dua që të kem mundësi të iki kur të më shkrepet. Nuk kam ambicie.

Tani sytë e saj ishin shterur lotësh. E piu gotën e *Kalvadosit* dhe u ngrit. Dukej e kapitur.

– Ç'i kemi gjithë këto trazime në shpirt, Ravik? Pse? Duhet të ketë ndonjë arsye, apo jo? Ndryshe s'do të bënim kaq pyetje!

Ai buzëqeshi turbull.

– Kjo është më e lashta pyetje e njerëzimit, Xhoanë. *Pse?* Para kësaj pyetjeje ka thyer kokën deri më sot e gjithë logjika, e gjithë filozofia, e gjithë shkenca.

Ajo po ikte. Po ikte. Po i afrohej derës. Diçka përbrenda Ravikut u ngrit peshë. Ajo po ikte. Po ikte. Ai u ngrit përgjysmë në shtrat. Befas kjo iu duk e pamundur; vetëm një natë, edhe një natë; edhe njëherë atë fytyrë të përgjumur, mbështetur në supin e tij; nesër ishte ditë e re dhe mund të luftoje sërish; edhe njëherë atë frymëmarrje pranë vetes; edhe njëherë, gjatë gremisjes, iluzionin e këndshëm, mashtrimin e ëmbël... Mos ik, mos ik! Ne vdesim me dhimbje dhe jetojmë me dhimbje... Mos ik, mos ik! Çfarë më mbetet mua, vallë? Ç'e dua guximin tim varfanjak? Ku po na shtyn rryma? Vetëm ti je e vërtetë! Ëndrra më shkëlqimtare!... Fushë badërshtruar e harrimit!... Edhe një herë të vetme! Edhe një herë të vetme atë shkëndijë përjetësie! Për kë po e kursej veten? Për cilin trishtim të pakuptimtë? Për cilën vagulli të zymtë? I varrosur, i humbur... Edhe dymbëdhjetë të ditë zgjat jeta ime; dymbëdhjetë ditë dhe, pas tyre, nuk ka më asgjë. Dymbëdhjetë ditë dhe kjo natë! O ti lëkurë e bardhë vezullueshe, pse më ke ardhur pikërisht këtë natë, e cila, shkëputur yjesh, lundron mjegulluar ëndrrash të vjetra? Pse e shkallmove fortesën e kësaj nate, ku nuk rron askush tjetër veç nesh? A nuk po vërshon një valë që po na përmbyt?...

– Xhoanë! – thirri ai.

Ajo u kthye. Fytyra iu përshndrit përnjëherësh nga një shkëlqim i egër, marramendës. Flaku rrobat përtokë dhe u sul drejt tij...

Erjonixx

26

Makina frenoi në qoshen e rrugës *Vozhirar*.

– Ç'ka ndodhur? – pyeti Raviku.

– Demonstratë. – Shoferi nuk e ktheu kokën. – Këtë radhë janë komunistët.

Raviku hodhi sytë nga Keti Hegshtrëmi. Ajo rrinte në qoshen e saj, e imët dhe delikate, veshur me kostumin e një dame oborri të kohës së Luigjit XIV. Fytyrës i kishte vënë mjaft pudër e, megjithatë, tregonte shumë e zbehtë. Te tëmthat e te mollëzat i kishin dalë kockat.

– Bukur fort, – tha ai. – Korrik 1939, bota zien dhe ne s'kemi punë tjetër, veçse të vishemi me kostumet e shekullit të madh XVII. Bukur fort, Keti!

Ajo vuri buzën në gaz.

Raviku uli sytë dhe vështroi kilotat dhe këpucët e tij me tokëza të mëdha. Ironia e situatës ishte e fortë. Edhe pa atë farë veshje, çdo polici mund t'i shkrepej ta arrestonte në vend.

– A t'i biem nga një rrugë tjetër? – pyeti shoferi i Keti Hegshtrëmit.

– Nuk mund të kthehemi më, – tha Raviku. – Kemi shumë makina prapa.

Demonstruesit vazhduan të kalonin të qetë nëpër rrugë. Ndër duar mbanin flamuj dhe pankarta. Askush nuk këndonte. Një mori policësh e shoqëronin vargun e gjatë. Në këndin e rrugës *Vozhirar* qëndronte një grup tjetër policësh. Ata kishin edhe biçikleta me vete. Njëri syresh patrullonte përgjatë rrugës. Ai futi kokën në automobilin

Erjonixx

e Keti Hegshtrëmit. Me fytyrë të pandryshuar dhe pa thënë gjysmë fjale, vazhdoi rrugën.

Keti Hegshtrëmi e pikasi shikimin e Ravikut.

– Ai nuk u habit fare, – tha ajo. – Është në dijeni. Policia i di të gjitha. Balloja te Monforët është ngjarja më e shënuar e verës. Shtëpia dhe kopshti do të jenë të rrethuar nga policia.

– Kjo më qetëson jashtëzakonisht.

Keti Hegshtrëmi qeshi. Ajo nuk ia dinte hallin Ravikut.

– Kaq xhevahire sa sonte, nuk para mblidhen shpesh në Paris. Kostume origjinale dhe xhevahire origjinale. Në të tilla raste policia nuk mund të rrijë pa marrë masa. Midis të ftuarve do të jenë patjetër edhe disa detektivë.

– Me kostume?

– Ka mundësi. Pse pyesni?

– Mirë që e mora vesh. Kisha ndër mend të vidhja smeraldet e Rotshildëve.

Keti Hegshtrëmi uli xhamin e makinës.

– E di që mërziteni. Por këtë radhë ju zuri, s'keni nga t'ia mbani.

– Nuk mërzitem. Përkundrazi. Nuk do të dija me se ta vrisja kohën. A do të ketë mjaft për të pirë?

– Besoj se po. Por unë mund t'i bëj edhe një shenjë mazhordomit. E njoh mjaft mirë.

Mbi asfalt trokëllinin hapat e demonstruesve.

– Ravik, në ç'shekull do të dëshironit të jetonit, sikur të kishit mundësi ta zgjidhnit vetë?

– Në këtë. Ndryshe do të isha i vdekur tani dhe ndonjë idiot do të shkonte në këtë mbrëmje i veshur me kostumin tim.

– E kisha fjalën gjetkë. Desha të them, në ç'shekull do të dëshironit ta jetonit jetën tuaj edhe njëherë?

Raviku vështroi mëngët e mëndafshta të kostumit të vet.

- Prapë po ju them: në këtë. Nuk kam ç't'i bëj. Vërtet që është shekulli më i poshtër, më gjakatar, më i korruptuar, më i pafytyrë, më burracak dhe më i ndyrë, por megjithatë...

– Kurse unë jo. – Keti Hegshtrëmi bashkoi duart, sikur t'i kishte hyrë të ftohtët. Dantellat e buta i ranë mbi kyçet e holla. – Jo në këtë, – tha ajo. – Në të shtatëmbëdhjetin ose në ndonjë të mëparshëm. Në çdo shekull tjetër, por jo në tonin. Kjo m'u kujtua përpara disa muajsh. Më parë s'e kisha menduar kurrë. – Ajo e uli xhamin deri në fund. – Sa vapë që bën! Dhe sa zagushi! A vazhdon vargu i demonstruesve?

– Ja, tani po kalojnë të fundit.

Një e shtënë arme u dëgjua tutje nga rruga *Kambronë*. Një sekondë më vonë policët e qoshes u ndodhën majë biçikletave të tyre. Një grua seç thirri diçka. Një murmuritje e fuqishme u ngrit nga turma. Njerëz filluan të rendnin. Policët ia shkelën pedaleve dhe u futën mes turmës, duke vringëlluar shkopinjtë e tyre.

– Po kjo ç'ishte? – pyeti Keti Hegshtrëmi e trembur.

– Asgjë. Do të jetë shpuar ndonjë gomë makine.

Shoferi ktheu kokën. Fytyra i kishte ndërruar shprehje.

– Këta...

– Shkeljani! – e ndërpreu Raviku. – Tani mund të kaloni.

Udhëkryqi ishte boshatisur, thua se e kishte fshirë një erë e fortë.

– Jepini! – tha Raviku.

Nga rruga *Kambronë* u dëgjuan ulërima. Një krismë e dytë shungulloi e fortë. Shoferi shkeli pedalin e gazit.

*
* *

Ata po rrinin në tarracën që vështronte nga kopshti. Ngado kishte kostume. Në mugëtirën e thellë të pemëve lulëzonin trëndafilat. Qirinj brenda fanarëve rrezatonin një dritë të ngrohtë flakëruese. Futur në një pavijon, një orkestër e vogël po luante një minuet. E gjitha kjo shëmbëllente me një tablo të gjallëruar të Vatosë.

– Ju pëlqen? – pyeti Keti Hegshtrëmi.

– Po.

– Vërtet?

– Po, Keti. Të paktën kështu, së largu.

– Ejani; të bëjmë një shëtitje nëpër kopsht.

Nën pemët e larta, të lashta shpalosej një pamje e pavërtetë. Drita e dridhshme e qirinjve të shumtë vezullonte mbi brokatet e argjendta e të arta, mbi kadifet e kaltra, rozë e të gjelbra; ajo hidhte vezullime të buta mbi paruka të bardha dhe mbi supe të zhveshura, të pudrosura – dhe të gjitha këto i mbështillnin e i qarkonin jonet e ëmbla të violinave; çifte dhe grupe njerëzish endeshin me çap të matur poshtë e përpjetë; doreza shpatash vezullonin; një shatërvan shushurinte dhe bosketat e krasitura krijonin një sfond të errët e të bukur.

Raviku vuri re që edhe vetë shërbëtorët ishin veshur me kostume. I shkoi mendja se edhe detektivët duhej të ishin të maskuar. S'do të ishte keq, mendoi ai, sikur të të arrestonte një Molier ose një Rasin.

Ose, sa për variacion, ndonjë hokatar xhuxhmaxhuxh oborri.

Ai ngriti sytë. Mbi dorë i kishte rënë një pikë e rëndë, e vakët. Qielli, qëparë i kuqërremtë, tani ishte ngrysur sterrë.

– Do të kemi shi, Keti, – tha ai.

– Ah, e pamundur! Mendoni, gjithë këto përgatitje në kopsht...

– Do të bjerë shi, ju them. Ejani shpejt!

Ai i shkoi krahun dhe e shoqëroi gjer në tarracë. S'kishin arritur akoma mirë, kur shiu nisi të binte me rrëshekë. Ishte një vërshim i vërtetë uji. Qirinjtë brenda fanarëve u shuan, dekoret dhe mbulesat e tryezave u kthyen pas disa sekondash në lecka të qullura e të shpëlara dhe nga të katër anët shpërtheu paniku. Markeza, dukesha dhe dama oborri u sulën me fustanet e brokatit ngritur gjer mbi gju në drejtim të tarracës; kontë, shkëlqesi dhe feldmareshalë përpiqeshin të mbanin parukat dhe shpërndaheshin si pula të tromaksura. Shiu derdhej me furi mbi kordele, jaka dhe dekoltera, fshinte pudrën dhe të kuqtë; një vetëtimë e zbehtë e krodhi kopshtin në një dritë të shpëlarë dhe bubullima të rënda filluan të rrokulliseshin njëra mbi tjetrën.

Keti Hegshtrëmi rrinte pa lëvizur nën tendën e tarracës, tulatur fort pas Ravikut.

– Kjo s'ka ndodhur kurrë, – tha ajo krejt e hutuar. – Kam marrë pjesë shpesh herë në këtë festë. Por kështu s'na ka ndodhur kurrë. Asnjë vit.

– Rast fort i mirë për të grabitur smeralde.

– Ah, o zot!...

Shërbëtorë me mushama e me çadra vraponin nëpër kopsht. Kilotat e tyre të mëndafshta dukeshin shumë qesharake nën mushamatë. Ata shoqëronin për në tarracë damat e fundit që kishin humbur rrugën e ishin qullur gjer në palcë, e pastaj shkonin të kërkonin plaçkat dhe sendet që u kishin humbur. Njëri solli një palë këpucë të arta. Ishin tepër delikate dhe ai i mbante me shumë kujdes në duart e tij të mëdha. Uji vërshonte mbi tryezat e boshatisura. Dukej sikur bubullimat po binin mu sipër tendës, sikur vetë qielli, me shkopinj kristali, i binte daulles për një kushtrim të panjohur.

– Ejani, të futemi brenda, – tha Keti Hegshtrëmi.

*

* *

Dhomat e shtëpisë ishin tepër të vogla për gjithë atë mori të ftuarish. Me sa dukej, askush s'e kishte marrë në sy se mund të prishej

moti. Zagushia e ditës nderej akoma e rëndë dhe shtypëse nëpër dhoma. Rrëmuja dhe gjithë ajo turmë njerëzish e shtonin akoma më tepër vapën. Kostumet e gjera të grave po zhubraviteshin, mëndafshi grisej nën këmbët që e shkelnin. Mezi lëvizje gjysmë hapi.

Raviku dhe Keti Hegshtrëmi kishin zënë vend pranë derës. Ngjitur me Ravikun dihaste një konteshë e vërtetë, por e veshur si markeza Dë Montespan, me flokët e qullur që i binin fije-fije mbi ballë. Një gjerdan me diamante në trajtë dardhe i qarkonte gushën që i kishte poret fort të hapura. Tani ajo shëmbëllente me një shitëse zarzavatesh që e ka zënë shiu në një kremtim karnavalesh. Pranë saj kollitej një burrë tullac që thuajse s'kishte mjekër fare. Raviku e njohu. Ishte Blansheja i Ministrisë së Jashtme, veshur me kostumin e Kolberit. Përkundrejt i rrinin dy dama oborri, të bukura e truphedhura; një baron rrondokop, fjalaman, me një kapelë të stolisur me xhevahire, ua ledhatonte gjithë kënaqësi supet. Disa amerikanojugorë, të veshur si pazhë, e soditnin me vëmendje e me habi. Në mes tyre qëndronte kontesha Belën, e shndërruar në La Valierë, me një fytyrë engjëlli të sakrifikuar dhe e ngarkuar me rubinë; Ravikut iu kujtua se para një viti ia pati operuar vezoret – në bazë të një diagnoze të Dyranit. Përgjithësisht ky ambient këtu ishte fushë veprimi e Dyranit. Disa hapa më tej ai njohu baroneshën e re dhe shumë të pasur Ramplar. Ajo ishte martuar me një anglez, por s'kishte më mitër. Raviku ia kishte hequr. Për faj të një diagnoze të gabuar të Dyranit. Dyrani kishte futur në xhep pesëdhjetë mijë franga honorar. Këtë ia pati treguar sekretarja e tij. Kurse Raviku ishte përcjellë vetëm me dyqind franga; gruaja kishte humbur dhjetë vjet jetë dhe mundësinë për të bërë fëmijë.

Era e shiut, zagushia e ndenjur mbytëse, që përziheshin me aromën e parfumit, të lëkurës dhe të flokëve të lagur. Fytyrat, të shpëlara nga shiu, dukeshin më lakuriqe tani nën paruka sesa më parë, kur s'i kishin veshur fare këto kostume. Raviku hodhi sytë përqark; rreth tij pa shumë bukuri; pikasi edhe mendje të mprehta dhe zgjuarsi skeptike; por syri i tij ishte stërvitur edhe për të dalluar shenjat e lehta të sëmundjeve, dhe ai s'para gënjehej dot kollaj nga një sipërfaqe e përsosur. E dinte që një shoqëri e caktuar në çdo shekull, qoftë ky i madh apo i vogël, ishte gjithnjë e njëjta – por ai e dinte gjithashtu se ç'ishin ethja dhe dekompozimi dhe ua njihte simptomat: dashuriçka të rastësishme; lëshime ndaj dobësive; sport sa për t'u dukur; batuta mendjemprehta pa takt; shaka për hir të shakasë; gjak i lodhur, gjak i kthyer në shkëndijëza ironie, në aventura të vockla,

në neps të ulët, në fatalizëm të latuar, në kotësi të kapitur... Nga këta nuk do t'i vijë shpëtimi botës, mendoi ai. Po nga kush?...

Vështroi Keti Hegshtrëmin.

– Mbetët pa pirë gjë, – i tha ajo. – Shërbëtorët s'po çajnë dot.

– S'ka gjë.

Avash-avash dhe pa e kuptuar as vetë u shtynë deri në dhomën tjetër. Anës mureve ishin vendosur tryeza me shishe shampanje. Diku ishin ndezur disa shandanë. Drita e tyre e butë përpëlitej prej vetëtimave nga jashtë dhe, për disa çaste, fytyrat e njerëzve kridheshin në një shkëlqim të zbehtë fantazmash – duke marrë hijen e vdekjes. Pastaj bubullimat rrokulliseshin me rrapëllima të tmerrshme, i përmbytnin zërat dhe sundonin mbi to kërcënueshëm – derisa drita e butë kthehej rishtazi dhe, bashkë me të, edhe jeta dhe zagushia.

Raviku rrëfeu me kokë tryezat me shampanjë.

– A t'ju sjell diçka për të pirë?

– Jo. Bën shumë vapë. – Keti Hegshtrëmi ia qepi sytë. – Kaq e pati edhe festa ime!

– Ndoshta pushon shiu tani.

– Jo. Po edhe sikur... Festa u prish. E dini çfarë dëshiroj? Të iki.

– Mirë. Edhe unë gjithashtu. E gjitha kjo më jep përshtypjen sikur ndodhemi në prag të Revolucionit Francez. Sikur çdo çast pritet të vijnë *sankylotët*.

U desh shumë kohë derisa arritën te porta e daljes. Kostumi i Keti Hegshtrëmit dukej sikur ajo të kishte fjetur me të disa orë. Jashtë shiu binte i dendur dhe vertikal. Shtëpitë përkundruall të jepnin përshtypjen sikur ndodheshin pas xhamave të veshur të një dyqani lulesh.

Vetura u afrua.

– Ku dëshironi të shkoni? – pyeti Raviku. – Të kthehemi në hotel?

– Akoma jo. Por me këto kostume as që mund të shkojmë gjetkë. Ejani të bredhim edhe ca me makinë.

– Mirë.

*
* *

Vetura rrëshqiste ngadalë nëpër Parisin mbrëmjesor. Shiu trokiste mbi mbulesë dhe i mbyste pothuajse të gjitha zhurmat e tjera. Harku i Triumfit shfaqej i murrmë mes shiut të argjendtë dhe humbiste

përsëri. *Shanz-Elizeja*, me atë mori dritaresh dhe vitrinash të ndriçuara, po mbetej pas. *Ron-Puëja* shpërndante aromë lulesh dhe freski – një copëz vend i larmë mes gjithë atij tymi. I pamatë, si një det i gjerë e i mistershëm, po u afrohej Sheshi i *Konkordës*. Pastaj kaluan rrugën *Rivoli* me rruginat e saj me qemerë – si një vegim Venediku shkëlqimtar, për t'iu afruar *Luvrit* të murrmë e të përjetshëm, me atë oborrin e tij të pakufishëm e me gjithë dritaret të ndriçuara. Vetura filloi të ecte brigjeve të Senës, kaloi urat e bukura me harqe, vegime ëndërrimtare, që dukeshin si të pavërteta nën pikat e shiut. Barka. Një maunë me një fanar që të ngjallte një ndjenjë ngrohtësie, a thua se fshihte në gjirin e saj një mijë atdhe. Sena. Bulevardet me omnibusët, zhurmën, njerëzit dhe dyqanet. Kangjellat e hekurta të Pallatit të Luksemburgut me parkun nga pas, si një poezi e Rilkes. Varreza e Monparnasit, e heshtur, e braktisur. Rrugica të vjetra, të ngushta; shtëpi cip mbi cip; sheshe të qeta, që të dilnin befas para sysh, me pemë, fasada të shtrembëruara, kisha, monumente të gërvishtura nga stuhitë e kohës, fanarë që luhateshin nga era e shiut; pisuarë që mbinin nga toka si bunkerë të vegjël; rrugicat e hoteleve që jepnin dhoma me orë dhe, midis tyre, rrugët e së kaluarës, në të cilat të buzëqeshnin fasadat e shtëpive të stilit rokoko e barok dhe portat e lashta, si në romanet e Prustit...

Keti Hegshtrëmi rrinte në qoshen e saj dhe heshtte. Raviku pinte cigare. e shihte prushin e cigares, por tymin nuk e ndiente. I dukej sikur në errësirën e veturës po tymoste një cigare... të rreme dhe, dalëngadalë, filluan t'i dukeshin të rreme edhe gjithë gjërat e tjera – ky udhëtim, kjo makinë e heshtur në mes të shiut, rrugët që i rrëshqitnin përpara syve, ajo gruaja e nemitur atje në këndin tjetër, me kostumin e saj, mbi të cilin binin e zhdukeshin vezullimet e dritave, ato duar, të cilave vdekja ua kishte vënë qysh tani vulën e vet dhe që rrinin të palëvizura në prehër, a thua se s'kishin për t'u ngritur kurrë më... Ishte një udhëtim fantazmagorik përmes një Parisi fantazmagorik, çuditërisht i tejpërshkuar nga një mendim plot ankth i lënë pezull dhe nga një lamtumirë e pashprehur...

Ai e çoi mendjen te Hakeja. U përpoq të vendoste si do të vepronte. Por nuk mundte; çdo gjë i shkrihej në shi. Kujtoi gruan me flokët e verdhë në të kuqërremtë, që pati operuar tani së fundi. Kujtoi një mbrëmje me shi në Rotenburg, që e kishte kaluar me një grua tanimë të harruar; kujtoi hotelin *Ajzenhut* dhe një violinë që shpërndante tingujt e saj nga një dritare e huaj. I ra ndër mend Rombergu, vrarë në një fushë lulekuqesh, në Holandë më 1917, në

mes të një shtrëngate, një shtrëngatë që kishte vërshuar çuditërisht e tmerrshme mu në mes të predhave të topave, a thua se perëndia ishte mërzitur fort me njerëzit dhe kishte filluar ta qëllonte tokën me breshëri. Iu kujtua një fizarmonikë, ankuese dhe e stonuar, por plot mall të papërmbajtur, së cilës i binte një ushtar i batalionit të marinës në Huthulst. Roma në shi i rrëshqiti nëpër kujtesë; një udhë fshati plot pellgje uji pranë Ruënit; shiu i pandërprerë i nëntorit mbi çatitë e barakave të kampit të përqendrimit; fshatarë spanjollë të vdekur, gojët e mbetura hapur mbushur plot ujë; fytyra e çiltër dhe e qullur e Klarës; rruga plot jargavanë kundërmues që të çonte për në Universitetin e Hajdelbergut – të gjitha këto i faniteshin përpara syve si një fanar magjik i asaj që kishte qenë dikur, si një kortezh i pafund pamjesh të së kaluarës, rrëshqitëse si këto rrugë jashtë kësaj veture... Helm dhe ngushëllim...

Ai shoi cigaren dhe drejtoi trupin. Mjaft tani! Kush vështronte shumë nga prapa, shumë lehtë mund të përplasej ose të vithisej gjëkundi.

Makina po ngjitej tani përpjetë rrugëve të Monmartrës. Shiu pushoi së rëni. Re dyndeshin përmes qiellit, të lara me argjend, të rënda, gjithë nxitim, si nëna shtatzëna që donin të lindnin pakëz hënë. Keti Hegshtrëmi i tha shoferit ta ndalonte veturën. Ata zbritën dhe ecën edhe disa hapa më këmbë përpjetë rrugës, derisa arritën te një qoshk.

Poshtë tyre u shfaq befas Parisi. I pamatë, vezullues, i lagësht – Parisi. Me rrugë, sheshe, natë, re dhe hënë – Parisi. Kurora e bulevardeve, rrezatimi i zbehtë i kodrinave, kulla, çati, errësirë, kunduall dritës – Parisi. Erë nga horizontet, shkëlqim lëndinash, ura prej dritëhijesh, rizim i fundmë shiu që po davaritej përmbi Senë, projektorë të panumërt makinash – Parisi. Moskokëçarës ndaj natës, koshere vigane bletësh, jetë zukatëse, e ngritur mbi miliona kanale, gjirize, një lule drite e çelur mbi duhmën e keqe nën kokë, kancer dhe Mona Liza – Parisi...

– Një minutë, Keti – tha Raviku. – Po shkoj të marr diçka për ne.

Ai u fut në një pijetore aty pranë. Një aromë e ngrohtë suxhuksësh të freskët ia gudulisi hundën sapo hyri brenda. Askujt s'i bëri përshtypje paraqitja e tij me atë kostum të çuditshëm. Mori një shishe konjak dhe dy gota. Ustai në banak ia hapi shishen dhe ia vuri përsëri tapën grykës, në mënyrë që të hiqej kollaj.

Keti Hegshtrëmin e gjeti po ashtu siç e pati lënë. Qëndronte atje në rrugë, trupvogël, me atë kostumin e saj, me sytë ngritur drejt qiellit

të trazuar – dhe të linte përshtypjen sikur kishte mbetur aty e harruar prej një shekulli tjetër e jo sikur qe një amerikane nga Bostoni, me prejardhje suedeze.

– Ja, Keti. Ilaç më i mirë kundër të ftohtit, shiut dhe zhurmës së padurueshme që shkakton nganjëherë qetësia shumë e thellë. Le ta pimë këtë për qytetin atje poshtë!

– Po. – Ajo ia mori gotën nga dora. – Bëmë mirë që erdhëm këtu lart, Ravik. Këtu jemi më mirë se në çdo festë të botës.

Ajo e zbrazi gotën. Hëna i binte mbi supe e mbi fustan e mbi fytyrë.

– Konjak, – tha ajo. – I mirë fort, bile.

– Tamam. Përderisa arrini ta dalloni, është gjithçka në rregull.

– Mbushmani edhe njëherë dhe pastaj le të kthehemi, dhe unë do të shkoj të ndërrohem, dhe ju po ashtu; dhe le të kalojmë pastaj edhe ca orë në *Sheherezade*. Dhe unë do të zhytem në një orgji sentimentalizmi, dhe do të mundohem të ndiej keqardhje për veten, dhe do t'u them lamtumirë gjithë atyre gjërave mrekullisht të sipërfaqshme të jetës, dhe që nesër e tutje do të merrem vetëm me lexime filozofësh e me hartime testamentesh, dhe do të sillem denjësisht duke i bërë nder gjendjes sime.

*

* *

Tek po ngjitej për në dhomë, Raviku takoi te shkallët të zonjën e hotelit.

– A keni një minutë kohë? – e pyeti ajo.

– Natyrisht.

Ajo e çoi në katin e dytë dhe me një çelës kopil hapi derën e një dhome. Raviku vuri re se dhoma ishte akoma e paliruar.

– Ç'do të thotë kjo? – e pyeti. – Pse po hyni këtu në këtë mënyrë?

– Kjo është dhoma e Rozenfeldit, – i tha ajo. – Ai do që ta lirojë dhomën.

– Unë s'kam qejf ta ndërroj kotecin tim.

– Ai do të ikë dhe tre muajt e fundit nuk m'i ka paguar akoma.

– Por plaçkat i paska lënë këtu. Mund t'ia konfiskoni.

Hotelierja i futi me përbuzje një shkelm një valixheje shkatarrake që ishte lënë hapur pranë shtratit.

– E ç'do të nxirrja nga kjo? Punë boshe! Valixhja është prej fibre. Këmishët janë të ngrëna. Kostumin e shikoni vetë se si është katandisur.

Gjithsej dy ka. Një veshur dhe këtë këtu. As njëqind franga s'bëjnë të gjitha.

Raviku ngriti supet.

– Ju ka lajmëruar që do t'jua lirojë dhomën?

– Jo. Por kjo është një gjë që duket. Ia hapa vetë muhabetin dhe ia thashë troç. Edhe ai e pohoi. I thashë që deri nesër duhej të më tundte paratë. Kështu s'më del hesapi... gjithmonë me klientë që s'më paguajnë!

– Në rregull. Po unë ç'hyj në këtë mes?

– Ju thirra për pikturat. Edhe ato janë të tijat. Më tha që qenkan shumë të vyera dhe me to mund të paguaka jo vetëm qiranë, por edhe ku ta di unë se çë tjetër... Pa shikojini njëherë vetë!

Raviku nuk u pati kushtuar vëmendje mureve. Ai ngriti sytë. Përpara tij, mbi shtrat, qe varur një peizazh i Arlit nga Van Gogu, një nga punimet e tij më të mira. Ai i bëri dy hapa drejt murit. S'kishte pikë dyshimi. Peizazhi ishte origjinal.

– E shpifur, ë? – ia bëri hotelierja. – Këto viza të shtrembëra këtu na qenkan gjoja pemë! Pa vështrojeni edhe atë tjetrën!

Ajo tjetra qe vendosur mbi lavaman dhe ishte një portret nga dora e Gogenit. Një vendase nudo e ishujve të Paqësorit, me natyrën tropike në sfond.

– Ama, ç'këmbë! – tha hotelierja. – Si kokalla elefanti. Pale ç'surrat prej torollakeje që më paska! Pa shikojeni, aman se si rri!... Ka edhe një tjetër pikturë këtu, që ustai s'paska marrë mundimin t'i japë as dorën e fundit!

Ajo, së cilës ustai s'kishte marrë mundimin t'i jepte as dorën e fundit, ishte një portret i zonjës Sezan, pikturuar nga Sezani.

– Shikojeni, aman, se si ma ka atë gojë! Të shtrembër për ibret! Dhe në faqe i mungoka boja!... Me këto kërkon të ma hedhë ai mua!? Ju i keni parë tablotë e mia. Atyre u thonë piktura! Janë krejt sipas natyrës, dhe janë origjinale e të sakta! Si ai peizazhi i dëborës, me kaprojtë që e kam të varur në sallën e ngrënies, për shembull... Kurse ky mall kallp... Duket sikur i ka katranosur ai vetë të gjitha. Si mendoni?

– Afërsisht kështu, siç mendoni edhe ju.

– Ja, pikërisht këtë desha të dija! Ju jeni njeri me kulturë dhe keni haber nga këto gjëra. As korniza s'kanë këto piktura!

Të tria pikturat qenë varur nëpër mure pa korniza. Mbi tapicerinë e ndotur ndritnin si dritare të një bote tjetër.

– Sikur të kishin, të paktën, ca korniza varaku për të qenë!

Atëherë mund t'i hiqja e t'i përdorja gjetkë. Po kështu!? U pa puna, do të më duhet t'i mbaj këto fundërrina dhe të digjem edhe një herë tjetër. Kështu e pëson shpirtmiri!

– Nuk ma ha mendja se do të detyroheni t'i merrni me zor këto piktura, – tha Raviku.

– Po ç'të bëj tjetër?

– Rozenfeldi do t'i gjejë paratë e qirasë. Me siguri.

– Si kështu? – Ajo i hodhi një shikim të shpejtë. Fytyra i ndërroi shprehje. – Mos kanë ndonjëfarë vlere këto? Vërtet, nganjëherë të tilla paçavure na dalin me vlerë të madhe! – Pas ballit të saj verdhacuk lëvrinin mendimet. – Unë mund të bëja edhe një gjë tjetër, pa frikë fare, bile. Mund t'ia konfiskoja njërën prej tyre, të paktën për qiranë e muajit të fundit. Cilën thoni ju? Atë të madhen përmbi shtrat?

– Asnjërën. Prisni sa të kthehet Rozenfeldi. Jam i bindur që do të kthehet me para në xhep.

– Kurse unë jo. Unë jam pronare hoteli.

– Po pse paskeni pritur kaq kohë? Ju s'para e keni për zakon këtë?

– Ma prishën mendjen fjalët e bukura! Çfarë s'më ka dërdëllitur ai! Ju e dini vetë se si e ka kjo puna jonë.

Rozenfeldi u shfaq befas te pragu i derës. I heshtur, i vockël dhe i qetë. Përpara se hotelierja të mund të thoshte gjysmë fjale, ai nxori paratë nga xhepi.

– Urdhëroni. Dhe këtu keni llogarinë time. Do të ma nënshkruani, ju lutem, këtë dëftesë?

Hotelierja vështroi kartëmonedhat me sy të çapëlyer. Pastaj hodhi shikimin nga pikturat. Pastaj vështroi përsëri paratë. Kishte shumë fjalë në majë të gjuhës, por nuk nxori dot asnjë.

– Kam për t'ju kthyer reston, – tha ajo së fundi.

– E di. A mund të ma jepni tani?

– Po. Por nuk i kam me vete të hollat. Arka është poshtë. Po shkoj t'i thyej.

Ajo iku si ta kishin fyer rëndë. Rozenfeldi vështroi Ravikun.

– Duhet t'ju kërkoj ndjesë, – i tha Raviku. – Plaka më solli në dhomën tuaj. As që e kisha idenë ç'kërkonte. Donte të merrte vesh prej meje se ç'vlerë kishin pikturat.

– A ia thatë?

– Jo.

– Mirë. – Rozenfeldi e vështroi Ravikun me një buzëqeshje të çuditshme.

– Si mund të mbani të tilla vepra, varur në këto mure? – e pyeti Raviku. – Ai i keni të siguruara?

– Jo. Por pikturat s'para i vjedh njeri. Kjo mund të ndodhë vetëm një herë në njëzet vjet në ndonjë muze.

– Kjo godinë mund të marrë edhe flakë ndonjë ditë.

Rozenfeldi ngriti supet.

– Rrezikun s'mund ta përjashtosh kurrë. Për t'i siguruar s'kam para, kushton tepër shtrenjtë.

Raviku soditi van Gogun. Vlente të paktën një milion franga. Rozenfeldi ndoqi vështrimin e tij.

– E di çfarë po mendoni. Ai që i ka këto piktura, duhet të ketë edhe të holla për t'i siguruar. Por unë nuk i kam. Unë ha bukë me pikturat e mia. I shes dalëngadalë, dhe nuk i shes aspak me qejf.

Përposh Sezanit qëndronte një furnelë vajguri mbi një tryezë. Një kuti kafe, një bukë, një kavanoz me gjalpë dhe disa qese prej letre. Dhoma ishte varfanjake dhe e vogël. Por nëpër mure shkëlqente mrekullia e botës.

– Ju kuptoj, – tha Raviku.

– Kujtoja se do t'ia dilja, – tha Rozenfeldi. – Gjer tani munda t'i paguaja të gjitha. Biletën e trenit, biletën e vaporit, të gjitha... vetëm këto tre muaj qira jo. Nuk haja pothuajse fare kohët e fundit, por nuk arrita dot. Gjersa m'u dha viza, u desh shumë kohë. Sonte u detyrova të shes një Mone. Ishte peizazhi i Vetëjit... Kisha kujtuar se do të mund ta merrja me vete.

– Po edhe gjetkë do të ishit detyruar ta shisnit!

– Po, por me dollarë. Vlera do të qe e dyfishtë.

– Po shkoni për në Amerikë?

Rozenfeldi pohoi me krye.

– Erdhi koha për t'u zhdukur që këtej.

Raviku ia nguli sytë.

– Edhe Kukuvajka po ia mbath, – tha Rozenfeldi.

– Ç'është kjo Kukuvajkë?

– Ah, po, ju s'e dini. Është Markus Mejeri. Ne i themi Kukuvajkë. Ai e nuhat, kur është puna për të ikur nga një vend.

– Mejeri? – ia bëri Raviku. – Mos është ai tullaci i shkurtër, që i bie herë pas here pianos në *Katakombë*?

– Po. Që kur ishte në Pragë, i mbeti kjo nofkë.

– Nofkë e bukur!

– Gjithmonë i ka rënë në të! Dy muaj përpara se të hipte Hitleri në fuqi, iku nga Gjermania. Nga Vjena ia mbathi tre muaj përpara se

të vinin nazistët. Gjashtë javë përpara marshimit mbi Pragë u avullua edhe që andej. Unë i isha ngjitur gjithmonë nga pas. I isha bërë pullë poste. Ai i nuhaste të gjitha. Vetëm kështu arrita t'i shpëtoja pikturat. Paratë s'na linin t'i nxirrnim në ato kohë nga Gjermania. Marka s'dilte jashtë. Kisha një milion e gjysmë të depozituara. U mundova t'i tërhiqja, por ishte tepër vonë. Mejeri doli më i zgjuar. Nxori kontrabandë një pjesë të të hollave të veta. Kurse mua nuk ma mbajti. Tani ai po niset për në Amerikë. Edhe unë me të. Më vjen keq për Monenë që shita.

– Po paratë që ju mbetën, mund t'i merrni me vete. Këtej frangu mund të nxirret jashtë pa kufizim.

– Po. Por po ta kisha shitur matanë, do të mund të jetoja më gjatë me ato të holla. Kurse kështu, me sa duken punët, do të jem i detyruar ta sakrifikoj së shpejti edhe Gogenin. – Rozenfeldi filloi të merrej me furnelën e vet. – Janë të fundit, – tha ai. – Vetëm këto të tria më kanë mbetur. Me to duhet të jetoj. Punë s'kam për të gjetur kurrë, i kam vënë vizë, se ndryshe do të ishte një çudi e vërtetë. Vetëm këto të trija më kanë mbetur. Një më pak, do të thotë një copëz jete më pak. – Ai qëndronte ashtu i imët dhe i veshur keq atje përpara valixhes së vjetër. – Në Vjenë jetova pesë vjet; dhe në ato kohëra jeta s'ishte akoma aq e shtrenjtë, mund të rroje me shumë pak; por megjithatë më kushtoi dy Rënuar dhe një pastel të Degait. Në Pragë kam paguar qiranë dhe restorantin me një Sislej dhe pesë skica. Askush s'donte të të jepte një grosh për skicat... dhe ishin dy të Degait, një me karbon e Rënuarit dhe dy me bojë kine të Dëlakruas. Në Amerikë do të kisha jetuar me to edhe një vit më tepër. E shikoni, – tha ai, mjaft i pikëlluar, – tani më kanë mbetur vetëm këto të tria. Dje ishin akoma katër. Kjo vizë pasaporte më kushtoi dy vjet jetë, në mos tre!

– Ka shumë njerëz që nuk zotërojnë piktura për të siguruar jetën me to.

Rozenfeldi ngriti supet e ngushta.

– Ky s'është ngushëllim.

– Jo, – tha Raviku. – Keni të drejtë.

– Me to më duhet të kaloj luftën. Dhe lufta do të zgjatë shumë.

Raviku nuk iu përgjigj.

– Kështu e parashikon Kukuvajka, – tha Rozenfeldi. – Dhe, përveç kësaj, mendon që edhe Amerika s'i dihet a do të shpëtojë dot pa u futur në luftë.

– Po ku ka ndër mend të shkojë Mejeri pastaj? – pyeti Raviku. – Sikur nuk mbeten shumë vende në botë!

– Akoma s'e ka vendosur përfundimisht. Ka në mendje Haitin. Nuk beson që një republikë zezake do të hyjë në luftë. – Rozenfeldi fliste shumë seriozisht. – Ose Hondurasin, një republikë e vogël jugamerikane. San Salvadorin. Ndoshta edhe Zelandën e Re.

– Zelanda e Re! Sikur është pak si larg, apo jo?

– Larg! – ia bëri Rozenfeldi duke buzëqeshur turbull. – Prej nga është larg?

27

Një det. Një det errësire uturuese, që të përplasej me rrapëllimë ndër veshë. Pastaj një tringëllimë e mprehtë zileje nëpër korridore... Një vapor që po fundosej me potere shurdhuese... Natë... Një dritare që po merrte trajtat e saj, ndërsa gjumi po arratisej sysh... Përsëri tringëllima e ziles... Ishte telefoni që binte pareshtur...

Raviku ngriti dorezën.

– Alo!...

– Ravik!...

– Ç'ka ndodhur? Kush është?

– Unë. S'po më njeh?

– Tani po. Ç'ka ndodhur?

– Duhet të vish! Sa më shpejt! Tani!

– Ç'ka ndodhur?

– Eja, Ravik! Ka ndodhur diçka!

– Po çfarë?

– Ka ndodhur diçka, po të them! Kam frikë! Eja menjëherë! Më ndihmo!

Telefoni kërciti. Raviku priti. Por Xhoana e kishte mbyllur, sepse dëgjohej sinjali i ndërprerë. Ai e vuri dorezën në vend dhe vështroi si i shastisur natën e zbehtë. Pas ballit i nderej akoma i rëndë gjumi i trazuar. Në fillim kishte pandehur se po i telefononte Hakeja; ashtu nëpër gjumë pati qenë krejtësisht i bindur për këtë – derisa arriti të shquante pastaj dritaren e dhomës dhe të kuptonte se ndodhej në *Internacional* e jo në *Prens dë Gal*. I hodhi një sy orës. Akrepat prej fosfori tregonin orën katër e njëzet. Përnjëherësh ai brofi nga shtrati.

Atë ditë që takoi Haken, Xhoana i pati folur diçka për punë rreziku... frike... Po sikur...? Çdo gjë mund të ndodhte! Atij i kishte rastisur të shihte marrëzira edhe më të mëdha. Futi me nxit në çantë gjërat më të nevojshme dhe u vesh.

Në qoshen më të afërt gjeti një taksi. Shoferi kishte me vete një kone të vogël, që i rrinte mbi supe si një jakë peliçeje. Kur anohej makina, anohej edhe qeni. Ravikut iu ngritën nervat. I hanin duart ta rrëmbente konen e ta flakte mbi ndenjëse. Por ai ua dinte kokën taksistëve parisianë.

Makina hungëronte nëpër natën e ngrohtë të korrikut. Një aromë bimësie që merrte frymë lehtazi. Gjelbërim. Diku disa blire. Hije. Një qiell ngjyrëjasemini me yje; në mes tyre një aeroplan me drita jeshile e të kuqe sinjali, si një buburrec kanosës midis xixëllonjave. Rrugë të murrme. Zbrazëtirë. Kënga e dy të dehurve. Tingujt e një fizarmonike nga një qilar – dhe, befas, frenimi i taksisë dhe frika dhe një ndjenjë e tmerrshme nxitimi... Pasiguria... Tepër vonë, ndoshta...

Godina. Errësirë gjumashe. Ashensori që zvarritej tatëpjetë. Zvarritej, si një insekt i ngadalshëm, i ndritshëm. Raviku kishte ngjitur disa shkallë, kur iu ndërrua mendja dhe zbriti prapë poshtë. Sado i ngadalshëm, ashensori ishte prapë më i shpejtë.

Këta ashensorët e Parisit, si lodra kalamajsh! Qeli rrëshqitëse, kërcitëse, kollitëse, të hapura lart, të hapura anash, vetëm me një dysheme dhe ca shufra hekuri, me një llambë elektrike të dobët dhe me një tjetër gjysmë të zhvidhosur në portallombë... Dhe ja edhe kati i fundit! Ai hapi derën prej rrjete teli të ashensorit, i ra ziles.

Në prag u dha Xhoana. Ai ia mbërtheu sytë. Nuk pa gjurma gjaku. Fytyra normale. Asgjë e veçantë.

– Ç'ka ndodhur? – pyeti ai. – Ku është...

– Ravik, erdhe!

– Ku është...? Ç'të ka ndodhur?

Ajo u tërhoq në dhomë. Ai bëri ca hapa përpara. Vështroi rretheqark. S'kishte asnjeri.

– Ku është? Në dhomën e gjumit?

– Jo. Pse?

Ai e vështroi.

– Si mund të kem njeri këtu, kur vjen ti! – i tha Xhoana.

Ai s'po ia shqiste sytë akoma. Ajo rrinte atje, shëndoshë e mirë dhe i buzëqeshte.

– Ku të vete mendja? – Buzëqeshja e saj u bë më e ëmbël. –

Ravik, – ia nisi ajo, dhe atij iu duk sikur po e godiste breshëri në fytyrë, sepse Xhoana pandehte që ishte bërë xheloz dhe po e shijonte këtë gjë. Çanta me instrumentet po i peshonte sa një kuintal në dorë.

– Zuskë e dreqit! – tha ai.

– Si? Çfarë ke kështu?

– Zuskë e dreqit! – përsëriti ai. – Dhe unë, gomari, rashë brenda!

Ai shtrëngoi çantën dhe u kthye për të ikur. Ajo i doli menjëherë përpara.

– Ç'kërkon të bësh? Mos ik! S'duhet të më lësh vetëm! Nuk e di ç'mund të ndodhë, po të më lësh vetëm!

– Gënjeshtare! – tha ai. – Gënjeshtare e ulët! S'ka gjë pse gënjen, por që po e bën kaq pa të keq, kjo është se ç'është! Me gjëra të tilla nuk bëhet shaka!

Ajo e shtyu tutje derës.

– Pa shiko njëherë përreth! Ka ndodhur diçka! Mund ta shikosh vetë! Shih, ç'ka punuar, si është tërbuar! Dhe unë kam frikë se mos kthehet prapë. Ti s'e di çfarë është në gjendje të bëjë ai.

Një karrige ishte përmbysur mbi dysheme. Një abazhur. Disa qelqurina të thyera.

– Vish këpucët, kur të bredhësh nëpër dhomë, – tha Raviku. - Se mos pritesh. Kjo është e vetmja këshillë që mund të të jap.

Në mes qelqurinave ndodhej një fotografi. Ai i shtyu gastaret me këmbë dhe mori fotografinë.

– Na! – i tha, duke ia hedhur mbi tryezë. – Dhe tani më lër rehat!

Ajo qëndronte përpara tij. E vështronte në dritë të syrit. Fytyra i kishte ndërruar shprehje.

– Ravik... – ia nisi me zë të ulët, të mbytur. – Unë s'para e çaj kokën shumë se si më quan ti. Kam gënjyer shpesh. Dhe do të të gënjej përsëri. Ju burrat kështu e doni. – Ajo e flaku fotografinë nga tryeza. Fotografia ra përtokë në një mënyrë të tillë që Raviku të mund ta shihte. Nuk ishte fotografia e atij burrit me të cilin e kishte parë Xhoanën në *Klosh d'Or*. – Të gjithë kështu e duan, – vazhdoi ajo gjithë mllef e përbuzje. – Mos më gënje! Mos më gënje! Thuajmë vetëm të vërtetën! Dhe kur ua thua pastaj të vërtetën, s'e durojnë dot. Asnjëri s'e duron dot! Por ty nuk të kam gënjyer shpesh. Ty jo. Nuk desha...

– Në rregull, – tha Raviku. – S'është nevoja t'u futemi diskutimeve tani.

Ai e ndjeu veten përnjëherësh të mallëngjyer, të prekur në një

mënyrë të çuditshme. Diçka e kishte goditur. Filloi të inatosej me vetveten. Nuk donte të mallëngjehej më.

– Jo. Ty s'kisha nevojë të të gënjeja, – tha ajo dhe e vështroi pothuajse me përgjërim.

– Xhoanë...

– Dhe as tani s'po të gënjej, Ravik. Të mora në telefon, sepse kisha frikë. Mezi arrita ta nxirrja jashtë derës dhe të kyçesha brenda. E para gjë që më shkoi në mendje, ishte të të telefonoja. Mos është ndonjë gabim kaq i madh ky?

– Kur erdha unë, ti ishte e qetë sa s'ka ku të vejë më dhe pa pikën e frikës.

– Sepse ai e kishte thyer qafën. Dhe sepse mendoja që ti do të vije e do të më ndihmoje.

– Bukur fort. Atëherë çdo gjë qenka në rregull dhe unë mund të shkoj.

– Ai do të vijë përsëri. Ulëriti gjer në kupë të qiellit dhe më tha se do të kthehej prapë. Tani do të jetë ulur gjëkundi duke rrëkëllyer ca gota. Këtë e di mirë. Dhe kur të bëhet xurxull dhe të kthehet sërish, ai nuk sillet si ti... sepse nuk di ta mbajë pijen.

– Mjaft tani! – tha Raviku. – Lëri këto. Shumë marrëzira po na dërdëllit. Derën e ke të fortë. Dhe tjetër herë mos e përsërit këtë që bëre.

Ajo iu afrua fare pranë.

– Po si të bëj ndryshe? – klithi me gulçim.

– Mos bëj asgjë.

– Të marr në telefon... tri herë, katër herë... ti s'më përgjigjesh. Dhe kur denjon të më përgjigjesh, më thua të të lë rehat. Si e mendon këtë gjë?

– Pikërisht ashtu.

– Pikërisht ashtu? Si pikërisht ashtu? Mos jemi automatë që mund të ndizen e të shuhen? Një natë është çdo gjë e mrekullueshme e plot dashuri, e pastaj, përnjëherësh...

Ajo heshti, kur pa fytyrën e Ravikut.

– E dija se do ta nxirrje këtu, – tha ai me zë të ulët. – E pata menduar se do të përpiqeshe ta shfrytëzoje këtë! Kështu je ti! E dije fort mirë se ajo natë ishte hera e fundit, dhe do të kishe bërë mirë ta kishte lënë me aq. Ti erdhe tek unë, dhe pse ishte hera e fundit, ishte ashtu siç ishte, dhe gjithçka ishte shumë e bukur, dhe ishte një lamtumirë, dhe ne ishim plot e përplot me njëri–tjetrin, dhe kështu duhej të kishim mbetur në kujtimet tona... Kurse ti nuk dite të bëje

gjë tjetër veçse ta shfrytëzoje këtë si një bakall, ta ktheje në një kërkesë të re dhe atë që është e papërsëritshme, që ikën e fluturon, ta bëje një vazhdim zvarritës! Dhe, meqë unë nuk doja kurrsesi, ti përdore tani një truk të poshtër, duke na detyruar të merremi me ripërtypje, në një kohë kur vetë kjo bisedë është diçka e turpshme.

– Unë...

– Ti e dije, – e ndërpreu ai. – Mos fillo përsëri nga gënjeshtrat! Nuk kam fort qejf të ta përsëris atë që ke thënë. S'më është bërë akoma zanat kjo punë! Ne që të dy e dinim mirë. Ti nuk kishe ndër mend të vijë kurrë më.

– Unë nuk erdha më.

Raviku e vështroi me sy të zgurdulluar. Me zor të madh e përmbajti veten.

– Mirë. Por ti më telefonove.

– Të telefonova sepse kisha frikë!

– O zot, – tha Raviku. – Ky muhabet po më duket fare idiot! Dorëzohem.

Ajo filloi t'i buzëqeshte.

– Edhe unë, Ravik. A s'po e kupton se e vetmja dëshirë që kam, është që ti të rrish këtu?

– Është pikërisht ajo që s'kam qejf unë.

– Pse? – ajo po i buzëqeshte akoma.

Ravikut i dukej vetja sikur e kishin rrahur me dru. Ajo s'donte që s'donte ta kuptonte e, po t'ia niste ai tani nga shpjegimet, kushedi se ku do të përfundonte.

– Ky është një lloj korrupsioni i poshtër, – i tha ai më në fund. – Ti s'mund ta kuptosh dot.

– Posi jo, – ia priti ajo me druajte. – Ndoshta edhe e kuptoj. Po pse na qenka ndryshe tani e ndryshe përpara një jave?

– S'ishte ndryshe. Ishte njëlloj.

Ajo nuk foli dhe e vështroi në sy.

– Unë s'bëhem merak për emra, – i tha pastaj. Ai nuk i dha përgjigje. E ndiente se s'ia dilte dot. – Ravik, – tha ajo dhe iu afrua përsëri. – Është e vërtetë që të pata thënë se çdo gjë mori fund. Të thashë që nuk do të më shikoje më. Dhe këtë ta thashë sepse ashtu doje ti. Por që, megjithatë, nuk po veproj ashtu... këtë ti duhet ta kuptosh!

Ajo s'ia shqiste sytë.

– Jo, – tha ai me vrazhdësi. – E vetmja gjë që po kuptoj është se ti kërkon të flesh me dy burra!

Ajo nuk lëvizi nga vendi.

– Nuk është ashtu, – tha pastaj. – Por edhe sikur të ishte ashtu, ç'të duhet ty?

Ai ia çakërriti sytë.

– Ç'të duhet ty? – përsëriti ajo. – Unë të dashuroj. A s'të mjafton kjo?

– Jo.

– S'ke pse të bëhesh xheloz. Je i vetmi që s'duhet të bëhesh xheloz. Le që s'ke qenë ndonjëherë i tillë...

– Ashtu?

– Po, ashtu. Ti as që e di se si është xhelozia.

– Natyrisht që jo. Sepse unë s'kam dhënë shfaqje teatri, si ky bandilli yt këtu...

Ajo buzëqeshi.

– Ravik, – tha, – xhelozia fillon që tek ajri me të cilin mbush gjoksin ai tjetri.

Ai nuk iu përgjigj. Ajo qëndronte përpara tij dhe e vështronte. E vështronte dhe heshtte. Ajri, korridori i ngushtë, drita e mekur – të gjitha ishin mbushur befas me praninë e saj. Mbushur me një pritje, me një tërheqje të butë, si tërheqja e tokës kur përkuleshe mendjemarrë nga ndonjë kullë e lartë dhe vështroje përposh.

Raviku e ndjeu rrezikun. Por nuk donte të binte në grackë. Tani s'kishte më ndër mend të ikte. Po të ikte, të gjitha këto këtu do ta ndiqnin nga pas. Dhe ai nuk donte të ndiqej nga pas. Donte t'i jepte fund. Dhe fundi duhej të ishte i qartë. Nesër i nevojitej një mendje e kthjellët.

– A të ndodhet ndonjë pije? – pyeti ai.

– Po. Çfarë do? *Kalvados*?

– Konjak, po të kesh. Ose edhe *Kalvados*, fundja. S'prish punë.

Ajo iu afrua raftit të vogël. Ai e ndoqi me sy. Atmosfera e magjishme, rrezatimi i padukshëm i joshjes, lodra mashtruese, e lashtë dhe e përjetshme – por kur ka vazhduar ndonjëherë paqja e gjakut më shumë se sa një natë!

Xhelozia. A e njihte ai vallë? Por ai dinte diçka mbi papërsosmërinë e dashurisë! A s'ishte kjo një dhimbje më e lashtë, më e passhuar sesa ai pakëz mjerim personal, i ngushtë: Xhelozia? A nuk filonte kjo dhimbje qysh me idenë se njëri do të vdiste i pari?

Xhoana nuk solli *Kalvados*, por një shishe konjak. Mirë, mendoi ai. Nganjëherë kjo edhe i kupton disa gjëra. Fotografia që kishte përfunduar përsëri mbi tryezë e pengonte për të vendosur gotën. Ai e shtyu mënjanë. Por pastaj e mori në dorë dhe e soditi. Gjëja më e

thjeshtë për të thyer efektin, ishte ta sodisje pasardhësin tënd...

– Çudi, sa kujtesë të dobët që kam, – tha ai. – Pandehja se ai miku yt kishte një surrat krejt tjetër.

Ajo vuri shishen mbi tryezë.

– Por s'është ky.

– Ah, ashtu...? Paske peshkuar një tjetër përsëri!

– Po. Prandaj u bë gjithë ajo gurgule.

Raviku piu një gllënjkë të madhe konjaku.

– Duhej ta dije që fotografitë e burrave nuk lihen poshtë e lart, kur të vjen dashnori i mëparshëm. Kjo s'ka lezet fare.

– Nuk e kisha lënë poshtë e lart. Ai e gjeti. E kërkoi dhe e gjeti. Dhe fotografitë njeriu i mban. Ti nuk e kupton këtë. Kurse një grua e kupton. Nuk doja që ai ta shihte.

– Dhe prandaj plasi shamata. Je e varur gjë nga ai?

– Jo. Kam kontratën time. Për dy vjet.

– Ai ta ka rregulluar?

– Po. E pse jo? – Ajo u tregua vërtet e habitur. – Ç'të keqe ka këtu?

– S'ka asgjë të keqe. Por ka njerëz që ta marrin për ters dhe ta përmendin tërë jetën.

Ajo ngriti supet. Ai e vuri re atë lëvizje të lehtë. Një kujtim. Një nostalgji. Supe, që dikur, shtrënguar pas tij, ishin ngritur sipas frymëmarrjes, ngadalë, në mënyrë të rregullt, në gjumë. Një trumbë shtegtare zogjsh të përshndritur nga qielli i kuqërremtë i muzgut. Diku larg? Sa larg, vallë? Fol, o ti i padukshëm, që mban llogaritë e jetës? Vërtet janë varrosur të gjitha këto, apo po lëshonin reflekset e fundit jetë–shkurtër? Po kush mund ta dinte këtë?...

Dritaret ishin hapur krejt. Diçka fluturoi brenda dhomës, një copëzë e errët, e shushatur, që rrihte flatrat e pasigurt, duke u mbajtur pas abazhurit të llambës – një vegim purpuri dhe kaltërsie, një dekoratë e natës, e flakur në atë dhomë, e mbërthyer pas abazhurit të mëndafshtë – një flutur e larme. Flatrat e kadifenjta dridheshin ngadalë nga frymëmarrja, ngadalë, ashtu si ai gjoksi përkundrejt tij, që ulej e ngrihej në stofën e hollë të fustanit... Kur i ishte shfaqur e njëjta pamje edhe një herë tjetër?... Shumë kohë më parë... Këtu e njëqind vjet të shkuara...

Luvri. Nika. Jo, shumë e shumë kohë më parë! Duhej kthyer në mugëtirën e stërlashtë prej pluhuri dhe ari. Në kohërat kur temjani ngrihej nga altarët e Budës; kur buçima e vullkaneve ishte më shurdhuese, perdja e verbimit, e epshit dhe e gjakut – më e errët, varka e

dijes – më e vogël, vorbulla e jetës – më e rrëmbyer, lava, me gishtërinjtë e saj të gjatë e të prushtë, duke shkarë tatëpjetë e duke përmbytur e gllabëruar jetë – më e zjarrtë... dhe mbi të gjitha këto – buzëqeshja e përjetshme e Meduzës, përpara hieroglifeve të zverdhura në rërën e kohërave: Mendimi!...

Flutura u shkëput, rrëshqiti nën abazhur dhe filloi të rrihte flatrat me rrëmbim pas llambës së nxehtë elektrike. Pudër ngjyrëvjollce. Raviku e mori fluturën, e çoi te dritarja dhe e lëshoi në natën e pamatë.

– Do të vijë përsëri, – tha Xhoana.

– Ndoshta edhe nuk vjen.

– Ato vijnë përnatë. Vijnë nga parqet. Janë po ato flutura. Përpara disa javësh ishin ngjyrëlimoni. Kurse tani janë në këtë ngjyrë.

– Po. Janë po ato. Dhe gjithmonë të ndryshme. Dhe gjithmonë të ndryshme dhe gjithmonë po ato.

Ç'po fliste ashtu? Nuk ishte ai që po fliste, por diçka prapa tij. Një rezonancë, një oshtimë që vinte së largu, pas një shprese të fundme. Po çfarë kishte shpresuar ai, vallë? Ç'po e godiste ashtu befas në këtë orë dobësie, ç'po ia priste mishin, si një bisturi, diku thellë, ku kishte pandehur se ndodheshin muskuj të fortë? Mos vallë ajo prit-ja, ai ankthi, që kishin mbetur gjallë dhe që ai ishte munduar t'i mashtronte, rrinin akoma të fshehur, të tkurrur, si larva që bënin gjumin e dimrit?...

Ai e pa edhe njëherë fotografinë. Një fytyrë dokudo. Një fytyrë midis milionash.

– Qysh kur je ngatërruar me këtë? – e pyeti Xhoanën.

– Nuk ka shumë. Punojmë bashkë. Ndodhi përpara disa ditësh. Kur të takova te *Fukeja* dhe më ike...

Ai ngriti dorën:

– Mirë, mirë! E di ç'do më thuash! Sikur atë natë unë të mos të të kisha braktisur... e të tjera, e të tjera... Por ti e di që kjo nuk është e vërtetë.

Ajo ngurroi.

– S'është ashtu...

– Ti e di fort mirë! Mos gënje! Ti i bie punës shumë shkurt. Gjërat e rëndësishme nuk vdesin dot kaq lehtë.

Çfarë kishte dëshirë të dëgjonte prej saj? Pse po ia thoshte këto? A s'ia kishte qejfi të dëgjonte sërish një gënjeshtër mëshirëplotë?...

– Është e vërtetë dhe s'është e vërtetë, – tha ajo. – S'kam si t'ia

bëj ndryshe, Ravik. Më shtyn rrjedha. Më duket sikur do të humbas diçka. Shtrij duart, e rrok, dua ta rrëmbej medoemos e, megjithatë, s'më bën dobi. Dhe përsëri dua të rrok diçka të re. E di qysh më parë se do të përfundojë njëlloj si të tjerat, por nuk mund të heq dorë. Shtyhem, përplasem diku, mbushem për një kohë, shkëputem dhe mbetem përsëri bosh. Është si puna e urisë. E pastaj më zë përsëri...

E humba, mendoi Raviku. Tani e humba me gjithë mend dhe përfundimisht. Në këtë mes s'kishte më asnjë gabim, asnjë hutim, zgjim apo kthim. Ishte mirë që njeriu ta dinte këtë, kur avujt e fantazisë të fillonin t'i turbullonin sërish thjerrat e së vërtetës.

Ah, kjo kimia e saktë, e paepur dhe trishtimndjellëse! Gjaku, që kishte buçitur dhe ishte përzier njëherë, nuk e bënte dot këtë gjë përsëri po me atë forcë. Ajo që e mbante Xhoanën akoma dhe e rikthente dhe e rishtynte herë pas here tek ai, ishte vetëm një copëzë e tij e mbetur, në të cilën ajo s'kishte mundur të depërtonte ende. Po të depërtonte edhe atje, do të ikte përgjithmonë. E kush ishte ai që do të rrinte duke pritur për kaq gjë? Kush do të kënaqej e do të sakrifikohej për kaq?

– Do të doja të isha kaq e fortë sa ti, Ravik.

Ai qeshi. Edhe këtë kishte mangët tani!...

– Ti je shumë më e fortë se unë.

– Jo. Ti po e shikon vetë se si po rend pas teje.

– Pikërisht kjo e tregon që je e fortë. Ti je e zonja ta bësh, kurse unë jo.

Ajo e vështroi për një çast me vëmendje. Pastaj fytyra, që i ishte çelur, e humbi përnjëherësh shkëlqimin.

– Ti nuk mund të dashurosh, – tha ajo. – Ti nuk i dorëzohesh kurrë njeriu.

– Kurse ti gjithmonë. Prandaj del gjithmonë e shpëtuar.

– A s'mund të bisedosh njëherë seriozisht me mua?

– Seriozisht po bisedoj.

– Kur dilkam gjithmonë e shpëtuar, atëherë pse nuk u shkëputkam dot prej teje?

– Ti je e zonja të shkëputesh shumë kollaj prej meje.

– Lëre këtë! Ti e di që kjo s'ka të bëjë fare me punën tonë. Po të shkëputesha prej teje, s'do të të ndiqja këmba-këmbës. Të tjerët i kam harruar. Ty jo. E pse?

Raviku piu pakëz nga gota e vet.

– Kjo vjen ndoshta sepse s'ke arritur të më vësh dot përfund.

Ajo u hutua për një çast. Pastaj tundi kokën.

– Unë s'i kam vënë të gjithë përfund. siç e quan ti. Disa bile aspak. Dhe i kam harruar. Ndihesha fatkeqe, por i harrova.

– Edhe mua do të më harrosh.

– Jo. Ti më shqetëson shumë. Kurrë, kurrë s'kam për të të harruar!

– Njeriu as që e di sa shumë mund të harrojë, – tha Raviku. – Dhe ky është një bekim i madh e njëkohësisht edhe një mjerim i mallkuar.

– Ti akoma s'më je përgjigjur, pse ndodh kështu me ne?

– Ne të dy s'mund ta shpjegojmë dot këtë. Mund të flasim sa të duam, por vetëm se do ta ngatërrojmë punën më keq. Ka disa gjëra që nuk shpjegohen dot. Dhe disa të tjera që nuk kuptohen dot. Qoftë bekuar ajo pak xhungël që ka mbetur brenda nesh! Po shkoj tani.

Ajo u ngrit me rrëmbim.

– S'duhet të më lësh vetëm!

– Ke qejf të biesh me mua në shtrat?

Ajo ia qepi sytë dhe s'bëri zë.

– Shpresoj që jo, – tha ai.

– Pse po më pyet?

– Sa për t'u eglendisur. Shko e fli tani. Jashtë po zbardh dita. S'është koha për tragjedira tani.

– Nuk do të rrish?

– Jo. Dhe as që do të vij më.

Ajo ndenji një copë herë në heshtje.

– Kurrë?

– Kurrë. Dhe as ti nuk do të vish kurrë më tek unë.

Ajo tundi kokën me ngadalë. Pastaj tregoi me sy tryezën ku ndodhej fotografia.

– Kjo është arsyeja?

– Jo.

– S'po të kuptoj. Por ne mund të mbeteshim...

– Jo! – ia preu ai me nxit. – Mos fillo edhe me këto tani! Formula e miqësisë. Kopshti i vogël me zarzavate mbi lavën e ndjenjave të shuara... Jo, ne s'mund ta bëjmë këtë. Ne jo. Kjo mund të bëhet me dashuriçka të vogla. Bile edhe atëherë është një punë e ndyrë. Dashuria nuk duhet të përlyhet me miqësi. Fundi është fund.

– Po pse pikërisht tani?

– Ke të drejtë. Duhej të ishte bërë më parë. Pasi u ktheva nga Zvicra. Por askush nuk është i gjithëditur. Dhe nganjëherë njeriu as që do t'i dijë të gjitha. Kjo ishte... – ai e preu fjalën në mes.

– Çfarë ishte? – Ajo qëndronte përpara tij, sikur s'po kuptonte diçka, të cilën duhej ta merrte vesh shpejt dhe medoemos. Ishte zbehur dhe sytë i kishte të tejpashëm. – Çfarë ishte kjo puna jonë, Ravik? – pëshpëriti ajo.

Pas flokëve të saj zgjatej korridori, gjysmë i ndriçuar, sikur të çonte në një galeri, në fund të së cilës agonte një premtim, i përgjumur nën vesën e shumë brezave, nën vesën e shpresave gjithnjë e më të reja.

– Dashuri! – tha ai.

– Dashuri?

– Dashuri. Dhe prandaj ky duhet të jetë fundi!

Ai tërhoqi derën pas vetes. Ashensori. Shtypi sustën, por nuk priti gjersa ashensori të ngjitej lart. Trembej se mos Xhoana e ndiqte pas. I zbriti me nxit shkallët. U habit që nuk dëgjoi derën të hapej. Një kat më poshtë qëndroi dhe vuri veshin. Asgjë nuk pipëtinte. Askush nuk po vinte.

*

* *

Taksia qëndronte akoma përpara shtëpisë. Ai e pati harruar fare. Shoferi preku me gisht strehën e kasketës dhe iu skërmit duke i shkelur syrin.

– Sa? – e pyeti Raviku.

– Shtatëmbëdhjetë e gjysmë.

Raviku pagoi.

– Nuk dashkeni të ktheheni me mua? – e pyeti shoferi me habi.

– Jo. Kam qejf ta bëj rrugën në këmbë.

– Mban shumë larg, zotëri.

– E di.

– Po atëherë pse më latë t'ju prisja? Harxhuat njëmbëdhjetë franga kot fare!

– S'prish punë.

Shoferi u mundua të ndizte një bisht cigareje të nxirë, që i ishte ngjitur pas buzës së sipërme.

– Të paktën a e vlejti për aq?

– Vlejti më tepër!

Parqet shtriheshin nën mugëtirën e ftohtë mëngjesore. Ajri ishte ngrohur ca, por drita të fuste dridhmat. Tufa jargavanësh, të veshura me një shtresë të hollë pluhuri. Stola. Mbi njërin syresh po ia këpu-

ste gjumit një burrë, me fytyrën mbuluar me një gazetë *Pari Suar*. Ishte po ai stol në të cilin pati qenë ulur Raviku atë natën me shi.

Ai e kundroi burrin që flinte. Gazeta i ngrihej e i ulej mbi fytyrën e mbuluar me ritmin e frymëmarrjes, a thua se ajo paçavure kishte shpirt ose ishte një flutur që po matej të nisej fluturim drejt qiellit për t'i çuar lajme të rëndësishme. Raviku lexoi një titull lajmi me shkronja të mëdha e të zeza: *Hitleri deklaron se, përveç Korridorit Polak, nuk ka pretendime të tjera territoriale!* Dhe, poshtë këtij lajmi, dridheshin shkronjat e një lajmi tjetër: *Një rrobalarëse vret të shoqin me hekur të skuqur!* Aty dallohej edhe fotografia e një gruaje me gjoks të madh, veshur me fustanin e së dielës. Dhe pranë saj ishte edhe një fotografi tjetër, që paraqiste një si nëpunës banke me çadër e me një surrat prej deleje të lumtur: *Çambërleni e quan akoma të mundshme ruajtjen e paqes!* Poshtë fotografisë së Çambërlenit me çadër ishte një shënim me shkronja shumë të vogla, që mezi binte në sy: *Qindra hebrenj të vrarë në kufi!*

Burri, që e kishte mbrojtur veten me këtë gazetë nga bryma dhe drita e mëngjesit, vazhdonte të flinte për shtatë palë qejfe. Ai kishte veshur një palë këpucë atlete të hapura në shumë vende, pantallona të leshta ngjyrëkafe dhe një xhaketë të grisur. Të gjitha ato gjëra atij nuk i interesonin fare. Ai kishte rënë aq poshtë, saqë nuk merakosej më për asgjë – ishte si puna e një peshku që jeton gjithmonë në thellësi dhe që nuk ndien asgjë nga stuhitë e oqeanit.

Raviku u kthye në *Internacional*. E ndiente veten të kthjellët e të çliruar. Nuk linte gjë pas. Edhe po ta linte, nuk do t'i hynte më në punë. Asgjë, që mund ta hutonte akoma, nuk i hynte më në punë. Që sonte do të zinte një dhomë në hotelin *Prëns dë Gal*. Dy ditë përpara afatit. Por ishte më mirë ta priste Haken më herët sesa më vonë!

www.booksinsta.com

28

Kur Raviku zbriti poshtë, e gjeti hollin e *Prëns dë Galit* pa asnjë klient. Nga një radio dore mbi banakun e portinerisë dëgjohej muzikë e lehtë. Nëpër qoshet e hollit disa pastruese po merrnin pluhurat. Raviku kaloi me hap të shpejtë dhe pa rënë në sy. Vështroi orën e murit përkundrejt hyrjes. Po shkonte pesë e mëngjesit.

Mori përpjetë *avënysë Zhorzh V* dhe shkoi te *Fukeja*. Në kafene s'kishte njeri. Restoranti qe mbyllur qëkur. Ai qëndroi një copë herë atje, i pavendosur, pastaj ndali një taksi dhe u nis për në *Sheherezade*.

Marozovi qëndronte përpara hyrjes.

– Asgjë, – tha Raviku.

– E mora me mend. As që pritej të vinte qysh sot.

– Sot po. Mbushen plot dy javë.

– Një ditë nuk quhet. A qëndrove tërë kohën në hotel?

– Po.

– Ka për të telefonuar nesër, – tha Marozovi. – Ndoshta sot i ka dalë ndonjë punë, ose është nisur një ditë më vonë.

– Nesër paradreke kam një operacion për të bërë.

– Aq herët s'ka për të të marrë në telefon.

Raviku nuk i dha përgjigje. Ai po vështronte një taksi, nga e cila zbriti një *zhigolo*[1] me smoking të bardhë. Pas tij zbriti edhe një grua e zbehtë me një palë dhëmbë të mëdhenj. Marazovi u hapi derën. Rruga u mbush menjëherë me një erë të rëndë parfumi. Gruaja çalonte pakëz. *Zhigoloja*, pasi pagoi taksinë, e ndoqi pas me një përtesë të dukshme. Gruaja e priti te dera. Nën dritat e llambave, sytë e

1. *Gigolo*: dashnor me para.

saj dukeshin të blertë.

– Në këtë kohë ai me siguri nuk do të të telefonojë, – i tha Marozovi, pasi u kthye.

Raviku nuk iu përgjigj.

– Po të më japësh çelësin, mund të shkoj në dhomën tënde në orën tetë, – vazhdoi Marozovi. – Mund të pres atje, derisa të kthehesh.

– Ti ke nevojë për gjumë.

– Gjepura! Mund të bie në shtratin tënd, po të kem gjumë. Jam i bindur që s'ka për të të telefonuar njeri; por këtë mund ta bëj sa për të të qetësuar ty.

– Deri më njëmbëdhjetë jam në operacion.

– Mirë. Nëma çelësin. Nuk do të më pëlqente që, nga emocioni, t'ia qepje vezoret pas stomakut ndonjë dame të lartë nga ato të lagjes *Foburg Sen–Zhermen*. Se mund të ndodhë që, pas nëntë muajsh, ajo të na vjellë ndonjë kalama nga goja. E ke çelësin?

– Po. Merre.

Marozovi e futi çelësin në xhep. Pastaj nxori një kuti me mente dhe ia zgjati Ravikut. Raviku tundi kokën. Marozovi mori disa kokrra dhe i rrasi të gjitha përnjëherësh në gojë. Ato u zhdukën pas mjekrës së tij, si zogj të vegjël të bardhë në një pyll të dendur.

– Të freskojnë, – ia bëri ai.

– A të ka rastisur të rrish duke pritur një ditë të tërë në një furrik të veshur nga të katër anët me kadife? – e pyeti Raviku.

– Edhe më shumë se një ditë. Besoj se edhe ty?

– Po. Por duke pritur diçka tjetër.

– Pse nuk more ndonjë gjë për të lexuar?

– Mora mjaft. Por nuk më lexohej. Edhe sa kohë ke punë këtu?

Marozovi hapi derën e një taksie. Ishte plot me amerikanë. Ai i shoqëroi brenda.

– Të paktën edhe dy orë, – tha, pasi u kthye. – Ti e shikon vetë se ç'po bëhet këtu. Është vera më e çmendur qysh prej vitesh... Edhe Xhoanën e ke brenda.

– Ashtu?

– Po. Këtë radhë me një tjetër, në qoftë se të intereson.

– Nuk më intereson, – tha Raviku dhe u nis për të ikur. – Atëherë takohemi nesër.

– Ravik! – i thirri Marozovi nga pas.

Raviku u kthye. Marozovi nxori çelësin nga xhepi.

– Merre! Si do të hysh në dhomën tënde në *Prëns dë Gal*, kur s'do

të takohemi përpara së nesërmes? Lëre derën hapur, kur të dalësh.

– Unë nuk fle në *Prëns dë Gal*, – Raviku e mori çelësin. – Fle në *Internacional*. Sa më pak të ma shohin surratin atje, aq më mirë është.

– Por ti duhet të flesh pikërisht atje! Njeriu nuk banon nëpër hotele, në të cilat nuk fle! Më mirë të jesh klient i rregullt, po ndodhi që policia të kërkojë informata në portineri.

– Kjo është e vërtetë. Por është edhe më mirë që, në rast hetimesh, të mund të vërtetoj se kam banuar tërë kohën në *Internacional*. Në *Prëns dë Gal* i kam marrë të gjitha masat. Shtratin e kam bërë lesh e li; lavamanin, peshqirët, banjën dhe të tjerat i kam përdorur aq shumë, saqë duket sikur jam ngritur herët dhe kam dalë.

– Bukur fort. Atëherë ma jep prapë atë çelës!

Raviku tundi kokën.

– Më mirë të mos biesh edhe ti në sy andej.

– S'prish punë.

– Prish, Boris. Pse të bëhemi idiotë kot? Mjekra që më ke ti, s'është mjekër e zakonshme. Nga ana tjetër, ti ke të drejtë: duhet të jetoj e të veproj sikur s'ka ndodhur asgjë e veçantë. Në më telefonoftë Hakeja nesër në mëngjes, do të më telefonojë edhe pasdreke. Po s'e mendova kështu, do të më shkatërrohen nervat brenda një dite, do të bëhem për t'u flakur në kosh.

– Nga do t'ia mbash tani?

– Po shkoj të fle. S'ma ha mendja që ai do të më telefonojë në këtë kohë.

– Po deshe, takohemi më vonë gjëkundi.

– Jo, Boris. Kam shpresë se do të më ketë zënë gjumi gjersa ti të lirohesh nga puna. Në orën nëntë kam operacion.

Marozovi e vështroi me mosbesim.

– Mirë. Atëherë po kaloj nesër pasdreke nga ti në *Prëns dë Gal*. Në ndodhtë ndonjë gjë më parë, telefonomë në hotelin tonë.

– Mirë.

*

* *

Rrugët. Qyteti. Qielli i kuqërremtë. Rrezatime të kuqe, të bardha, të kaltra, që rrëshqisnin mbi fasadat e shtëpive. Era që lodronte nëpër qoshet e *bistrove* si një mace nazike. Njerëz. Ajër që të përtërinte pas një dite të kaluar në pritje në një dhomë mbytëse hoteli... Raviku ecte përgjatë *avënysë* që shtrihej pas *Sheherezades*. Pemët, qarkuar

me parmakë hekuri, dihatnin me ngurrim kujtime të gjelbra pyjesh para agimit. Befas ai filloi ta ndiente veten aq të zbrazët e të kapitur, saqë i dukej se nga çasti në çast do të rrëzohej mu në mes të rrugës. Po sikur të heq dorë – filloi të mendonte diçka brenda tij, – po sikur ta lë fare këtë punë, ta harroj, ta flak tutje, siç flak gjarpri lëkurën e vjetruar! Ç'më intereson tanimë kjo dramë e një të kaluare pothuajse të harruar? Ç'më intereson akoma ky njeri, kjo vegël e vogël, e rastësishme, kjo vegë e parëndësishme në një copëzë mesjete të errët, në një eklips të Evropës Qendrore?

Ç'i interesonte akoma?... Një prostitutë u përpoq ta joshte në një portë. Në errësirë ajo hapi fustanin, i cili ishte rregulluar në të tillë mënyrë që, po të liroje një rrip, shpalosej i tëri si robdëshambrë. Mishi i qullët zbardhëllonte i paformë. Çorape të gjata të zeza; kombinezon i zi; gropëza të zeza sysh me një hije aq të dendur, saqë sytë nuk dalloheshin më fare; mish që po dekompozohej e po bëhej fosforeshent.

Një kodosh, me cigaren ngjitur pas buzës së sipërme, qe mbështetur te një pemë dhe ia kishte ngulur sytë Ravikut. Disa karroca zarzavatesh kaluan andej pari. Kuaj, duke tundur kokën ritmikisht, me muskuj të tendosur nën lëkurë, tërhiqnin ngarkesën e tyre. Erë gudulisëse lakrash, lulelakrash që ngjanin me tru të ngurosur midis gjethesh të blerta. E kuqja e domateve, shportat me mashurka, qepë, qershi, sallatë...

Ç'i interesonte akoma ajo punë? Një më shumë apo një më pak. Një më shumë apo një më pak ndër qindra mijëra që ishin po aq të ligj ose edhe më të ligj akoma! Një më pak!... Ai u ndal në vend. Kjo ishte! Ai u shkund menjëherë nga gjendja që e pati pushtuar. Kjo ishte çështja! Kjo i kishte bërë ata të pushtetshëm, i kishte lënë të rriteshin – kjo lodhje, ky harrim, ky mendim: "Ç'më intereson mua?" Kjo ishte! Një më pak! Po, një më pak – kjo nuk ishte asgjë, por ishte edhe gjithçkaja! Gjithçkaja!...

Ai nxori me ngadalë një cigare nga xhepi dhe po aq ngadalë e ndezi. Dhe befas, teksa flaka e verdhë e shkrepëses ia ndriçonte shuplakat e duarve, që dukeshin si një shpellë plasaritur yjash të thella, ai u bind tërësisht se asgjë nuk do të mund ta ndalonte të vriste Haken. Iu bë sikur gjithçka varej tani vetëm e vetëm nga kjo vrasje. Përnjëherësh kjo çështje ishte për të shumë më tepër sesa një hakmarrje personale. Iu duk se, po të mos e kryente, do ta ngarkonte veten me një krim të tmerrshëm: po të mos vepronte, diçka në botë do të humbiste përgjithmonë. Por njëkohësisht ishte i bindur se nuk

ishte ashtu – e, megjithatë, tej çdo shpjegimi e logjike, në gjakun e tij gumëzhinte bindja se duhej ta kryente medoemos atë vepër – a thua se nga kjo do të çliroheshin disa valë të padukshme dhe gjëra shumë më të mëdha do të ndodhnin paskëtaj. Ai e dinte se Hakeja ishte vetëm një nëpunës i vogël i tmerrit e i dhunës dhe se nuk vlente shumë; por njëkohësisht iu krijua edhe bindja që vrasja e tij ishte jashtëzakonisht e rëndësishme.

Drita në shpellën e duarve të tij u shua. Ai e flaku shkrepësen tutje. Mugëtira nderej mbi pemë, një tis argjendi, i mbajtur nga picikatoja e harabelave. Ai vështroi me habi përreth. Diçka kishte ndodhur me të. Një gjyq i padukshëm ishte zhvilluar dhe një vendim ishte dhënë. Me një qartësi të jashtëzakonshme po i tiposeshin në kujtesë pemët, muri i verdhë i një shtëpie, ngjyra e murrme e disa kangjellave pranë tij dhe rruga mes avujsh të kaltër; kishte përshtypjen se nuk do t'i harronte kurrë këto pamje. Dhe në këtë çast u bind vërtet se do ta vriste Haken dhe se kjo nuk ishte më një çështje e tij e vogël personale, por diçka shumë më e madhe. Një fillim.

Ai kaloi përpara hyrjes së *Osirisit*. Disa të dehur po dilnin që andej duke u lëkundur. Sytë i kishin të qelqtë, fytyrat prush të kuqe. Në rrugë s'kishte asnjë taksi. Ata ia këputën ca të sharave dhe vazhduan rrugën më këmbë, me çap të rëndë e duke folur me zë të lartë. Flisnin gjermanisht.

Raviku ishte nisur për në hotelin e vet. Por tani ndërroi mendje. Iu kujtua se Rolanda i pati thënë që këto muajt e fundit në *Osiris* vinin shpesh turistë gjermanë. Ai u fut brenda.

Rolanda rrinte në banak, veshur me fustanin e zi të governantes, duke kundruar me sy të ftohtë lokalin. Tingujt e automatit të muzikës përplaseshin pas mureve në stil egjiptian dhe ktheheshin me oshtimë.

– Rolandë! – tha Raviku.

Ajo u kthye nga ai.

– Ravik! Ke kohë që s'na ke dalë më këndej. Mirë bëre që erdhe.

– Pse?

Ai iu afrua banakut dhe i hodhi një sy gjithë lokalit. Nuk kishin mbetur shumë klientë. Rrinin veç e veç në disa tryeza dhe dukeshin të përgjumur.

– Po i jap fund punës këtu, – tha Rolanda. – Pas një jave nisem.

– Përgjithmonë?

Ajo pohoi me krye dhe nxori një telegram nga gryka e fustanit.

– Ja!

Raviku e lexoi dhe ia ktheu.

– Tetoja jote? Paska vdekur më së fundi?

– Po. Do të kthehem. E njoftova madamën. M'u zemërua, por megjithatë e kuptoi gjendjen time. Do të më zëvendësojë Zhaneta. Do ta ndihmoj ca, sa t'ia marrë dorën. – Rolanda qeshi. – E gjora madamë! Këtë vit ishte mprehur të shkëlqente në Kanë. Vila e saj është mbushur që tani me mysafirë. Përpara një viti u bë konteshë. U martua me një karafil nga Tuluza. I paguan pesë mijë franga në muaj, me kusht që të mos luajë këmbë nga Tuluza. Por tani iu prishën planet dhe s'mund të shkojë në Kanë, duhet të qëndrojë këtu.

– A do ta hapësh kafenenë tënde së shpejti?

– Po. Kam ditë që bredh për t'i porositur të gjitha që më duhen. Në Paris i gjen sendet më lirë. Si të duket kjo copa për perde?

Ajo nxori përsëri nga gryka e fustanit një copë damasku të zhubrosur. Lule mbi sfond të verdhë.

– E mrekullueshme! – tha Raviku

– Ma japin me tridhjetë për qind zbritje. – Sytë e Rolandës rrezatonin një shkëlqim të ngrohtë e të ëmbël. – Kursej treqind e shtatëdhjetë franga. Mirë, apo jo?

– Hata fare! A do të martohesh?

– Po.

– Pse do të martohesh! Pse nuk pret edhe ca, sa t'i vësh në vijë të gjitha punët?

Rolanda qeshi.

– Ti s'ke haber nga ai zanat, Ravik. Pa burrë s'bën dot asgjë. Burri duhet medoemos. Unë di çfarë bëj.

Ajo qëndronte atje, e qetë, e sigurt. Të gjitha i kishte menduar e shoshitur. Burri e kishte vendin në dyqan.

– Mos ia lër të gjitha paratë në dorë, – tha Raviku. – Prit një herë, si do t'i vejë filli punës.

Ajo qeshi përsëri.

– E di si do ti vejë filli. Ne jemi njerëz me mend në kokë. Do t'ia kemi nevojën shoqishoqit në punë. Burri s'është burrë, po t'i mbajë paratë e shoqja. Unë s'dua të kem një qull pranë. Dua të kem respekt për tim shoq. Dhe këtë respekt nuk mund ta kem, po të mos vijë ai orë e çast për të më kërkuar para. A s'të mbushet mendja për këtë?

– Po, – tha Raviku, pa iu mbushur mendja fare.

– Mirë. – Ajo tundi kokën e kënaqur. – Ke qejf të pish diçka?

– Jo, asgjë. Më duhet të shkoj tani. Kalova ashtu kot. Kam punë paradreke.

Ajo e mati me një shikim të gjatë.

– Më dukesh krejt esëll. Mos do ndonjë nga çupat?

– Jo.

Me një lëvizje të lehtë dore, Rolanda dirigjoi dy nga vajzat te një burrë që rrinte e dremiste në një poltronë. Vajzat e tjera harliseshin nëpër sallë. Vetëm disa rrinin mbi pufet e vendosura në dy radhë përgjatë korridorit kryesor. Të tjerat rrëshqisnin mbi pllakat e lëmuara, si fëmijët dimrit mbi akull. Vajzat, dy e nga dy, tërhiqnin rrëshqanthi një të tretë, ulur galuc. Flokët e lëshuar fluturonin, gjinjtë hovnin përpjetë, supet zbardhëllonin, mëndafshi i pakët nuk mbulonte pothuajse asgjë, vajzat këlthitnin nga kënaqësia dhe *Osirisi* qe shndërruar befas në një skenë idilike pafajnie klasike.

– Është verë, – tha Rolanda. – duhet t'u lëmë pak liri në mëngjes. – Ajo i hodhi një shikim Ravikut. – Të enjten mbrëma do t'u lë lamtumirën. Madama do të shtrojë një darkë për mua. A do të vish?

– Të enjten?

– Po.

Të enjten, mendoi Raviku. Pas shtatë ditësh. Shtatë ditë. Janë njëlloj si shtatë vjet. Të enjten... gjer atëherë duhet të ketë marrë fund gjithçka... Kush mund ta dinte se ç'do të ndodhte gjer të enjten?...

– Natyrisht që do të vi, – tha ai. – Ku?

– Këtu. Në orën gjashtë.

– Mirë. Do të jem këtu. Mirupafshim, Rolandë.

– Mirupafshim Ravik.

*

* *

E zuri tek po vinte në veprim retraktorin. Iu duk sikur një afsh i valë po ia shtrëngonte grykën. Ai ngurroi për një çast. Shpella e kuqe e hapur. Avulli i hollë i peceve të nxehta e të lagështa që mbanin zorrët. Gjaku që rridhte nga vena të holla... Sytë iu ndeshën me vështrimin pyetës të Ëzhenisë. Pastaj pa fytyrën e Veberit, të zmadhuar tej mase, me të gjitha poret dhe qimet e mustaqeve nën dritën e fortë metalike – sakaq e mblodhi veten dhe vazhdoi punën i qetë.

Po qepte plagën. I qepnin vetëm duart. Plaga sa vinte e po mbyllej. Ndjeu se si po i rridhte djersa nga sqetullat tatëpjetë trupit.

– A mund ta përfundoni ju qepjen? – e pyeti Veberin.

– Po. Ç'ju ka ndodhur?

– Asgjë. Vapa. Nuk jam ngopur me gjumë.

Veberi pikasi shikimin e Ëzhenisë.

– Gjëra që ndodhin, Ëzheni, – tha ai. – Bile edhe te njerëzit e drejtë.

Salla i erdhi rrotull për një çast. Një ndjenjë e tmerrshme kapitjeje. Veberi vazhdonte të qepte. Raviku e ndihmonte automatikisht. Gjuhën e kishte të trashur. Qiellzën të thatë si pambuk. Merrte frymë shumë avash. Lulëkuqe, i shkoi mendja. Lulëkuqe në Flandër. Bark i hapur, i kuq. I kuq, si një lulëkuqe e hapur, mister i paturp, jetë aq afër dorës me bisturi. Përpëlitje, paralizë duarsh, kontakt magnetik, i ardhur nga larg, ndoshta nga një vdekje shumë, shumë e largët... Nuk mund të operoj më pa e kryer atë që kam ndër mend të kryej, mendoi ai.

Veberi i futi një të lyer me tampon plagës së qepur gjer në fund.

– Mbaroi dhe kjo punë!

Ëzhenia lëvizi mekanizmin që mbante lart këmbët e së operuarës. Tryeza e operacionit u nxor jashtë mbi rrotat e saj të buta.

– Doni një cigare? – e pyeti Veberi Ravikun.

– Jo. Më duhet të iki. Kam një punë për të kryer. Nuk besoj të keni më nevojë për mua.

– Jo. – Veberi e pa me habi. – Pse e paskeni kaq me ngut? Nuk dëshironi të pini ndonjë vermut me sifon ose diçka të ftohtë?

– Jo, asgjë. Duhet të shkoj. Nuk e dija që qenka bërë kaq vonë! Mirëmbetshi, Veber!

Ai doli me nxit përjashta. Taksi, mendoi. Ku ta gjej shpejt një taksi? Dalloi një *Sitroen* që po vinte nga larg dhe i doli përpara.

– Në hotelin *Prëns dë Gal*! Shpejt!

Duhet t'i them Veberit që të bëjë si të bëjë disa ditë pa mua, mendoi ai. Kështu nuk vazhdohet. Do të shkalloj nga trutë, po të më shkojë mendja gjatë çdo operacioni se Hakeja mund të më ketë telefonuar pikërisht në ato çaste!

Pagoi taksinë dhe hyri në hollin e hotelit. Iu duk një shekull, derisa zbriti ashensori. Pastaj vrapoi nëpër korridor dhe hapi dhomën e vet. Telefoni! Ngriti dorezën, a thua se po ngrinte një goxha peshë.

– Jam von Horni. Mos më ka telefonuar njeri?

– Një minutë, zotëri!

Raviku priti. Zëri i centralistes i erdhi përsëri në vesh:

– Jo. S'ka pasur asnjë telefonatë për ju.

Falemnderit.

*
* *

Marozovi i erdhi pasdreke.

– Ke ngrënë gjë? – e pyeti.

– Jo. Të prita ty. Mund të hamë bashkë këtu.

– Nuk bën. Do të binte në sy. Në Paris askush nuk ha në dhomën e gjumit, vetëm në rast se është sëmurë. Shko e ha ti, se po rri unë këtu. Në këtë kohë nuk telefonon askush. Të gjithë hanë bukë. Zakon i shenjtë. Edhe në qoftë se ai telefonon, unë do të jem pazhi yt, do t'ia marr numrin e do t'i them se do të kthehesh pas një gjysmë ore.

Raviku mbeti mëdyshas.

– Mirë, – ia bëri pastaj. – Për njëzet minuta më ke këtu.

– Merre me avash. Ke pritur gjithë atë kohë. S'ka lezet të bëhesh nevrik tani. Te *Fukeja* do të hash?

– Po.

– Merr verë *Vuvrej* të 1937–s, nga ajo e hapura. Tani sapo piva. Është e hatashme.

Mirë.

Raviku zbriti poshtë. Kapërceu me nxitim rrugën dhe kaloi nëpër tarracën e *Fukesë*, duke vështruar sa djathtas–majtas. Pastaj u fut në restorant. Hakeja s'ishte aty. Zuri vend në një tryezë që shikonte nga *avënyja Zhorzh V* dhe porositi një rosto viçi me sallatë, djathë të bardhë dhe një brokë *Vuvrej*.

Teksa hante, mundohej ta zotëronte veten, përpiqej ta shijonte verën e lehtë e pak të gazuar. Hante ngadalë dhe shikonte rrethqark; vështroi qiellin që dukej si një flamur prej mëndafshi të kaltër i nderur mbi Harkun e Triumfit; porositi një kafe dhe ndjeu shijen e saj të hidhur; ndezi një cigare dhe filloi të tymoste ngadalë; nuk donte kurrsesi të ngutej. Qëndroi ashtu edhe një copë herë të gjatë, duke soditur kalimtarët. Pastaj u ngrit dhe u kthye në *Prëns dë Gal* dhe i harroi të gjitha.

*
* *

– Si ishtë *Vuvreji*? – e pyeti Marozovi.

– E mirë.

Marozovi nxori diku nga xhepi një kuti të vogël shahu.

– A bëjmë një lojë?

– Bëjmë.

Ata i vendosën gurët në vrimat e vogla të fushës së shahut. Marozovi u ul në një karrige, Raviku zuri vend në kanape.

– S'ma ha mendja se do të mund të qëndroj këtu më shumë se tri ditë pa pasaportë, – tha Raviku.

– Ta kërkuan në portineri?

– Akoma jo. Nganjëherë të kërkojnë pasaportë me vizë. Prandaj, kur kërkova dhomë, erdha natën. Portieri i natës s'e zgjati shumë. I thashë se më duhej një dhomë vetëm për pesë ditë.

– Në hotelet e shtrenjta s'para janë fort të rreptë në këso punësh.

– Po të vijnë e të më kërkojnë pasaportë, do ta kem pisk.

– Tani për tani nuk do të vijnë. As në *Zhorzh V* dhe as në *Ric* s'para pyesin shumë. A u regjistrove si amerikan?

– Jo, si holandez nga Utrehti. Emri gjerman sikur nuk shkonte, prandaj e ndërrova pak: van Horn dhe jo fon Horn. Tingëllon njëlloj, po të pyesë Hakeja në telefon.

– Në rregull. Mendoj se s'do të kesh telashe. Fundja, ke zënë një nga dhomat më të shtrenjta. s'besoj se do të të bezdisin.

– Le të shpresojmë.

– Sa keq që je regjistruar me emrin Horn. Kam një letërnjoftim fort të mirë që skadon pas një viti. Ka qenë e një miku tim që vdiq përpara shtatë muajsh. Para se ta varrosnim, u thamë autoriteteve se ishte refugjat gjerman pa dokumente. Kështu e shpëtuam letërnjoftimin e tij. Nuk besoj se i prishet puna që është varrosur diku me emrin Jozef Vajs. Kurse këtu jetuan dy emigrantë me dokumentet e tij. Ivan Kluge quhej. S'është emër rus. Fotografia, në profil, s'është fort e qartë, e pavulosur, kollaj për t'u zëvendësuar.

– Le ta lëmë më mirë kështu siç është, – tha Raviku. – Kur të dal nga ky hotel, s'do të ketë më as Horn dhe as dokumente.

– Do të ishte më i sigurt nga policia. Por ajo nuk ka për të ardhur. Policia nuk vjen ndër hotele ku paguhen më shumë se njëqind franga për një apartament. Njoh një refugjat që ka pesë vjet që jeton në hotel *Ric* pa dokumente fare. I vetmi që e di këtë, është portieri i natës. A e ke menduar çfarë do të bësh, sikur, megjithatë, ata vëllezërit e policisë të pyesin për ty?

– Natyrisht. Do t'u them që pasaportën e kam dërguar në ambasadën argjentinase për vizë. Dhe do t'u premtoj se do të shkoj ta marr të nesërmen. Pastaj do ta lë valixhen dhe s'do të dukem më. E kam marrë parasysh. Dhe e di se pyetjen e parë do të ma bëjnë ata të

drejtorisë së hotelit dhe jo të policisë. Vetëm se po të vijë puna gjer atje, mori fund plani im.

– Hajt, se mbarë ka për të vajtur.

Ata luajtën shah deri nga ora tetë e gjysmë.

– Shko tani të hash darkë, – tha Marozovi. – Do të të pres këtu. Pastaj më duhet të shkoj në punë.

– Jo, do të ha më vonë, këtu në hotel.

– Lëri budallallëqet! Shko e ha një darkë për të qenë. Po të telefonoi ai miku, atëherë dihet se ke për të shkuar të pish me të. Prandaj është më mirë ta kesh plëncin plot... E ke menduar se ku do ta çosh?

– Po.

– Ta kam fjalën, po deshi të shohë ndonjë kuriozitet ose të pijë?

– Po. Di mjaft vende, ku gjithkush sheh punën e vet.

– Mirë. Nisu tani. Mos fut pije në gojë. Ha gjëra të rënda, me dhjamë.

– Mirë.

Raviku shkoi përsëri te *Fukeja* përballë. Kishte përshtypjen se të gjitha këto ishin të paqena. I dukej sikur po i lexonte në një libër a po i shikonte në një film melodramatik a po i faniteshin në ëndërr. Përsëri e hetoi me sy lokalin mbarë e prapë. Tarraca ishte plot me njerëz. Nuk la tryezë pa shikuar – por Hakeja nuk dukej gjëkundi.

Zuri vend te një tryezë e vogël pranë hyrjes, në mënyrë që të mund të vërente derën dhe rrugën. Pranë tij, dy gra bënin muhabet për dyqanet e modës të Skiaparelit dhe të Mëboshesë; një burrë me një mjekër të rrallë rrinte me to dhe nuk nxirrte zë nga goja. Në anën tjetër, ca francezë flisnin për politikë...

Teksa pinte, Raviku vështronte rrugën. Nuk ishte aq dritëshkurtër, sa të mos u besonte rastësive. Vetëm në letërsinë serioze nuk kishte rastësi – ndërsa jeta e përditshme ishte plot me rastësi nga më të çmendurat. Ndenji atje një gjysmë ore. E pati më të lehtë se në drekë. U ngrit, hetoi edhe njëherë anën e lokalit që binte nga *Shanz–Elizeja* dhe pastaj u kthye në hotel.

– Ja tek e ke çelësin e veturës, – i tha Marozovi. – E ndërrova. Tani të kam rregulluar një *Talbo* blu me ndenjëse lëkure. Ajo makina tjetër i kishte prej stofe. Lëkura lahet kollaj. Është veturë me mbulesë; mund ta mbash hapur ose mbyllur. Po qe se detyrohesh të shtiesh me mbulesë të mbyllur, ki kujdes që dritaret e pasme t'i lësh hapur, në mënyrë që plumbi të mos lërë gjurmë në automobil. *Talbonë* ta mora me qira për dy javë. Pasi të mbarosh punë, mos e kthe në asnjë mënyrë menjëherë në garazh. Parkoje në një nga rrugët anësore që

janë gjithmonë plot me makina. Lëre të ajroset ca. Tani e ke në rrugën *Dë Berri*, përkundrejt hotelit *Lankastër*.

– Mirë, – i tha Raviku dhe e vuri çelësin pranë telefonit.

– Merri edhe dokumentet e makinës. Vetëm patentë s'të gjeta dot. Nuk desha të hapesha si vaji në lakra.

– S'më nevojitet patenta. Në Antibë udhëtova tërë kohën pa të.

Raviku i vuri edhe dokumentet pranë çelësit.

– Automobilin parkoje sonte në një rrugë tjetër, – i tha Marozovi.

Melodramë, mendoi Raviku. Melodramë bajate.

– Mirë, Boris. Ashtu do të bëj. Të falemnderit.

– Do të desha të kisha mundësi të vija me ty.

– Kurse unë s'do të desha. Gjëra të tilla bëhen vetëm.

– Mirë. Ki mendjen të mos i lësh asnjë shteg. Qëroje dhe pikë!

Raviku vuri buzën në gaz.

– Këtë ma ke thënë nja dhjetë herë.

– Sa më shpesh ta dëgjosh, aq më mirë. S'e ke idenë ç'budallallëqe të lindin në kokë në çaste kritike!... A të dalin cigaret?

– Kam njëqind. Dhe mund të telefonoj nga dhoma të më sjellin çdo gjë që të më duhet.

– Eja në hotelin tonë e më zgjo, po s'më gjete më *Sheherezade*.

– Do të vij patjetër. Pavarësisht nëse ndodh gjë ose jo.

– Në rregull. Mirupafshim, Ravik!

– Mirupafshim, Boris!

Raviku e mbylli derën pas Marozovit. Dhoma iu duk përnjëherësh fort e heshtur. U ul në një cep të kanapesë. Vështroi muret. Ishin veshur me cohë të kaltër dhe qarkuar me listela. Brenda dy ditësh i kishte njohur më mirë sesa shumë të tjera, pranë të cilave kishte jetuar me vite. I njihte pasqyrat, e njihte linoleumin gri të dyshemesë me njollën e errët pranë dritares; njihte çdo vijë të tryezës, të shtratit; njihte mbulesat e poltronave – i njihte aq mirë, saqë i vinte për të vjellë... Vetëm telefonin nuk e njihte.

29

Vetura e markës *Talbo* qëndronte në rrugë *Dë Basano*, midis një *Rënoje* dhe një *Mercedes–Benci*. *Mercedesi* ishte i ri dhe kishte targë italiane. Raviku e nxori *Talbonë* nga vendi i parkimit. Ishte aq i padurueshëm, saqë nuk tregoi kujdesin e duhur; parakolpoja e pasme e makinës së tij takoi parafangon e majtë të *Mercedesit* dhe e gërvishti. Ai nuk u bë merak fare. Me shpejtësi e drejtoi veturën tatëpjetë bulevardit *Hosman*.

E ngiste shumë shpejt. Ishte mirë, kur kishe një timon në dorë. I binte mirë zhgënjimit të zymtë që i rëndonte si çimento në stomak.

Ishte ora katër e mëngjesit. Duhej të kishte pritur edhe ca. Por befas gjithçka kishte filluar t'i dukej pa kuptim. Ndoshta Hakeja e kishte harruar me kohë atë episodin e vogël. Ndoshta edhe nuk ishte kthyer më fare në Paris. Ata, atje matanë, kishin halle të tjera tani.

Marozovi qëndronte përpara hyrjes së *Sheherezades*. Raviku e la makinën në qoshen më të afërt dhe u kthye më këmbë. Marozovi i doli përpara.

– E more njoftimin tim?

– Jo. Pse?

– Të telefonova para pak kohe. Na kanë ardhur ca gjermanë në lokal. Njëri duket si...

– Ku janë?

– Pranë orkestrës. Është e vetmja tryezë me katër burra. Mund t'i dallosh që nga dera.

– Mirë.

– Ulu në tryezën e vogël pranë derës. E kam rezervuar për ty.

– Mirë, mirë, Boris!

Raviku u ndal te pragu. Lokali ishte errësuar. Drita e projektorit binte e tëra mbi pistën e vallëzimit. Një këngëtare, veshur me fustan argjendi, qëndronte atje në këmbë. Tufa e ngushtë e dritës ishte aq e fortë, saqë jashtë saj nuk dallohej asgjë. Raviku vështroi me ngulm nga tryeza pranë orkestrës, por nuk e shihte dot. Rrezet intensive e të dridhshme e pengonin.

Ai zuri vend në tryezën pranë derës. Një kamerier i solli një brokë me vodkë. Orkestra dukej sikur po zvarritej. Mjegulla e melodive të sheqerosura nuk kishte ndër mend të davaritej. *Zh'atondre* – Të pres...

Këngëtarja përshëndeti. Shpërthyen duartrokitje. Raviku u përkul përpara. Priste të shuhej projektori. Këngëtarja u kthye nga orkestra. Cigani i bëri një shenjë me kokë dhe ngriti harkun e violinës. Çembaloja nxori disa tinguj të mbytur. Filloi kënga tjetër. Raviku mbylli sytë. Pritja po bëhej e padurueshme.

Mjaft kohë përpara se të mbaronte kënga, ai drejtoi shtatin sërish. Projektori u shua. Llambat nëpër tryeza flakëruan. Në çastet e para nuk mundi të dallonte gjë tjetër përveç disa ravijëzimeve të paqarta. E kishte vështruar shumë gjatë projektorin. I mbylli njëherë sytë dhe i hapi përsëri. Tryezën e gjeti menjëherë. Me ngadalë u mbështet në karrige. Asnjëri nga ata burrat nuk ishte Hakeja. Qëndroi mjaft kohë ashtu pa lëvizur. E ndiente veten tmerrësisht të kapitur. Sytë i dhembnin dhe diçka e shponte në kokë. Baticë dhe zbaticë dhimbjeje. Muzika, zërat, zhurma e mbytur, të gjitha këto e shushatnin tani, pas qetësisë së dhomës së hotelit, ku kishte kaluar gjithë atë kohë, dhe pas këtij zhgënjimi të ri. Një hipnozë e lehtë ia kishte kapluar qelizat e lodhura të trurit.

Dikur, midis sferës së dritës, në të cilën rrotulloheshin vallëzuesit, ai dalloi Xhoanën. Fytyra e saj e zhveshur, e etur, vështronte lart; kokën e mbante ngjitur pas supit të një burri. Ai nuk ndjeu ndonjë gjë të veçantë. Askush s'të bëhej aq i huaj sa njeriu që e ke pasë dashur dikur, mendoi ai, ashtu i lodhur siç ishte. Kur kordoni misterioz që lidhte fantazinë me objektin këputej, mund të mbetej ndonjë vetëtimë që shkonte e vinte midis syresh, mund të mbetej ndonjë fluoreshencë si ajo e yjeve fantazmagorike; por ishte një dritë e vdekur. Të shqetësonte, por nuk të ndizte më – asgjë nuk rridhte më as këtej dhe as andej... Ai mbështeti kokën pas shpinës së karriges. Ato pak gjëra të afërta e të njohura, varur buzë greminash. Misteri i sekseve me gjithë ata emrat e tij të ëmbël. Lule ylli përmbi një det në të cilin fundoseshe, po të doje t'i mblidhje...

Ai drejtoi trupin. Duhej të ikte që këtej, përpara se t'i rëndohes-hin qepallat. I bëri shenjë kamerierit.

– Të paguaj!

– S'keni ç'të paguani, – i tha kamerieri.

– Pse?

– Sepse s'keni pirë gjë.

– Ah, po!

Ai i la një bakshish në tryezë dhe doli.

– Nuk ishte? – e pyeti Marozovi jashtë.

– Jo, – iu përgjigj Raviku.

Marozovi e vështroi.

– Po e lë fare këtë punë, – tha Raviku. – Është një lojë mbyllasy-zash, e poshtër dhe qesharake. Kam pesë ditë që po pres. Hakeja më pati thënë se nuk qëndronte më tepër se dy, tri ditë në Paris. Kështu që tani duhet të ketë ikur përsëri. Natyrisht, po të ketë qenë këtu këtë radhë...

– Shko fli, – i tha Marozovi.

– Nuk kam gjumë. Po nisem tani për në *Prens dë Gal*, po marr valixhen dhe po liroj dhomën.

– Mirë, – tha Marozovi. – Atëherë takohemi nesër në drekë atje.

– Ku?

– Në *Prens dë Gal*.

Raviku i hodhi një shikim.

– Po, natyrisht... Po flas marrëzira. Por ka të ngjarë që edhe s'ke për të më gjetur atje.

– Unë them të presësh gjer nesër mbrëma.

– Mirë. Si ta shoh. Natën e mirë, Boris.

– Natën e mirë, Ravik.

*

* *

Raviku kaloi para *Osirisit*. Prapë e la veturën në qoshen e rrugës. I vinte tmerr të kthehej në dhomën e vet në *Internacional*. Ndoshta mund të bënte një sy gjumë këtu. Ishte e hënë, ditë qetësie për shtë-pitë publike. Portieri nuk ndodhej në vendin e vet. Me sa dukej, s'kishte asnjë klient brenda.

Rolanda rrinte pranë derës, me sytë drejtuar nga salla e madhe. Automati i muzikës të çirrte veshët.

– S'paskeni shumë punë sot, – i tha Raviku.

– Hiç fare. Kam vetëm atë njeriun e bezdisshëm që është ulur atje. I pangopur si majmuni, por s'do të shkojë lart në dhomë për kiamet. Ti i njeh këta tipa. Qejfi ua ka që ç'ke me të, por kanë frikë. Edhe ky është gjerman. Sidoqoftë, ka paguar; s'ma merr mendja se do të rrijë edhe shumë.

Raviku vështroi me mospërfillje nga tryeza. Ai burri i kishte kthyer shpinën. Ishte bashkë me dy vajza. Kur u përkul drejt njërës dhe ia mori gjinjtë ndër duar, Raviku ia dalloi fytyrën. Ishte Hakeja.

Dëgjonte Rolandën që vazhdonte t'i fliste si në një vorbull uji dhe nuk i merrte vesh asnjë fjalë. Kuptoi vetëm se ishte zmbrapsur disa hapa dhe se tani ndodhej mu pranë derës, në një pozicion të tillë që shikonte vetëm njërin cep të tryezës, ndërsa vetë nuk dallohej fare.

– Do një konjak? – dëgjoi më së fundi zërin e Rolandës përmes vorbullës.

Mjaullima shurdhuese e muzikës. Turbullimi i thellë. Ngërçi në stomak. Raviku nguli thonjtë në mollëzat e duarve. Hakeja s'duhej ta shikonte këtu. Dhe Rolanda s'duhej ta kuptonte që ai e njihte atë.

– Jo, – dëgjoi vetveten duke u përgjigjur. – Kam pirë mjaft... Gjerman qenka, the? A e njeh?

– Aspak. – Rolanda ngriti supet. – Këta një turi kanë të gjithë. Por më duket se ky s'ka shkelur kurrë këtu. Vërtet s'ke qejf të pish një gotë?

– Jo. Kalova këtej dhe thashë të shoh njëherë ç'bëhet...

Ai e ndjeu shikimin hetues të Rolandës dhe u mundua të tregohej sa më i qetë.

– Në të vërtetë, desha të të pyes edhe një herë, kur bëhet ajo mbrëmja për ty, – tha ai. – Ishte caktuar për të enjten apo për të premten?

– Të enjten, Ravik. Më dhe fjalën që do të vish!

– Patjetër. Desha vetëm të sigurohesha.

– Të enjten, në orën gjashtë.

– Mirë. Do të jem i përpiktë. Kjo ishte e gjitha. Tani më duhet të shkoj. Natën e mirë, Rolandë.

– Natën e mirë, Ravik.

Nata e bardhë që filloi të uturonte përnjëherësh.

Rretheqark tij s'kishte më asnjë shtëpi – vetëm masë gurësh, xhungël dritaresh. Ishte përsëri luftë. Patrullë e strukur në llogore. Dhe llogorja ishte vetura. Kërrusur pas timonit, mbështjellë nga zukatja e motorit të ndezur, në përgjim të armikut...

Ta qëllonte sapo të dilte?... Raviku i hodhi një sy rrugës. Disa makina. Drita të verdha. Disa mace. Nën një fanar, atje larg, diçka që dukej si një polic... Targa e automobilit të vet... krisma e revolverit... Rolanda që sapo e kishte takuar... Ai dëgjoi zërin e Marozovit: "Mos rreziko asgjë, dëgjon! Nuk e vlen barra qiranë për një qelbësirë të tillë..."

Portier s'kishte aty. As taksi s'kishte. Shumë mirë! Të hënave në këtë orë s'para kishte klientë që kërkonin taksi. Në çastin tek po i mendonte të gjitha këto, dëgjoi rrapëllimën e një *Sitroeni*, që erdhi dhe ndaloi mu përpara hyrjes së *Osirisit*. Shoferi ndezi një cigare dhe gogësiti. Ravikut i kaluan mornica nëpër trup. Priti.

I shkoi në mendje të zbriste e t'i thoshte shoferit që në lokal s'kishte njeri. Por kjo ishte e pamundur. Ta paguante e ta degdiste me ndonjë porosi – te Marozovi, për shembull?... Këputi me nxit një fletë nga blloku i vet, shkroi disa rreshta, e grisi, këputi një fletë tjetër – Marozovi të mos e priste sonte në *Sheherezade*... Shkarraviti një emër përposh...

Në këtë kohë dëgjoi që motori i taksisë u ndez dhe ajo u nis. Ngriti kokën, por nuk mundi të dallonte gjë. Nuk e dinte nëse Hakeja kishte hipur në atë taksi gjatë kohës që ai po i shkruante pusullën Marozovit. Futi me të shpejtë marshin e parë. *Talboja* u sul drejt kthesës dhe iu qep taksisë.

Nëpërmes xhamit të pasmë nuk pa njeri. Por Hakeja mund të ishte strukur në qoshe. Me ngadalë e parakaloi taksinë. Në brendinë e saj të errët nuk dalloi gjë. E ngadalësoi shpejtësinë dhe pastaj e arriti përsëri makinën tjetër, duke iu avitur sa më pranë. Shoferi iu kthye me të shara:

– Ore idiot! Mos ke qejf të më përplasësh në trotuar!

– Ke një shokun tim në makinë!

– Kokëtul i rrumbullosur! – i ulëriti shoferi. – Të kanë plasur sytë që s'e shikon se nuk kam njeri brenda?

Atë çast Raviku e kishte vënë re që taksimetri nuk ishte i ndezur. E ktheu timonin menjëherë dhe bëri mbrapsht, duke ia shkelur si i çmendur.

Hakeja qëndronte buzë trotuarit. Ngriti dorën dhe thirri.

– Ej, taksi!

Raviku iu afrua dhe frenoi.

– Taksi? – pyeti Hakeja.

– Jo. – Raviku nxori kokën nga dritarja. – Ej! – tha.

Hakeja e vështroi duke picërruar sytë.

– Si thatë?

– Më duket sikur njihemi, – i foli Raviku gjermanisht.

Hakeja përkuli pak trupi nga përpara. Dyshimi iu zhduk nga tiparet.

– Ah, o perëndi!... Zoti fon... fon...

– Horn.

– Tamam! Tamam! Zoti fon Horn! Natyrisht! Ç'rastësi! Po ku dreqin ishit futur tërë këto ditë?

– Në Paris kam qenë. Ejani hipni. Nuk e dija që ishit kthyer.

– Ju kam telefonuar disa herë. Mos keni ndërruar gjë hotel?

– Jo, aspak. Jam akoma në *Prens dë Gal*. – Raviku ia hapi derën e veturës. – Hipni. Po ju marr me vete. Në këtë orë s'keni për të gjetur kollaj taksi.

Hakeja vuri njërën këmbë mbi mbajtësen e parafangos. Fryma e tij e goditi në fytyrë Ravikun. Fytyra e skuqur dhe e dërsirë iu afrua fare pranë.

– *Prens dë Gal*! – ia bëri Hakeja. – Po, ta marrë e mira, ky ishte emri i hotelit tuaj! Kurse unë telefonoja vazhdimisht në *Zhorzh V*! – Ai qeshi me të madhe. – Atje s'ju njihte njeri. Tani po e kuptoj. Kam ngatërruar hotelet. S'e kisha marrë me vete bllokun tim të vjetër të shënimeve. U bazova demek te kujtesa!

Raviku kontrollonte hyrjen e *Osirisit*. Do të kalonte edhe një farë kohe, para se të dilte njeri që andej. Vajzat duhej të visheshin më parë. Megjithatë, duhej ta rraste Haken sa më shpejt në makinë.

– Mos kishit ndër mend të futeshit këtu? – e pyeti Hakeja duke u zgërdhirë.

– Po, ashtu kisha ndër mend. Por tani duhet të jetë tepër vonë.

Hakeja shfryu me potere nga hundët.

– Ashtu është, i dashur. Unë isha i fundit. S'ka njeri më në këtë qymez.

– S'prish punë. Ai përgjithësisht është një vend i mërzitshëm. Ejani të shkojmë gjetkë.

– Pse, dini ndonjë vend tjetër në këtë orë?

– Natyrisht. Lokalet për të qenë tani hapen. Ky këtu është vetëm për turistët.

– Vërtet? Kurse unë pandehja... Sidoqoftë, ky këtu ishte alamet lokali!

– Asgjë s'është. Ka shumë më të mirë. Ky është vetëm një bordel i rëndomtë.

Raviku shkeli disa herë pedalin e gazit. Motori uturoi dhe erdhi

e u shua përsëri. E kishte bërë llogarinë në rregull. Hakeja nuk e zgjati dhe, duke turfulluar, zuri vend në ndenjësen pranë tij.

– Sa mirë që ju takova përsëri, – tha ai. – U gëzova vërtet!

Raviku zgjati dorën dhe tërhoqi derën.

– Edhe unë u gëzova së tepërmi!

– Shumë vend interesant ishte ky këtu! Gjithë ato vajza lakuriq! Çudi se si e lejoka policia! Sigurisht që më të shumtat janë të sëmura, si thoni ju?

– Ka mundësi. Në të tilla vende s'ke si të jesh kurrë i sigurt.

Raviku e nisi makinën.

– Do të ketë vallë ndonjë vend, ku mund të shkosh krejt i qetë? – Hakeja këputi me dhëmbë majën e një puroje. – S'ma ka qejfi të marr ndonjë frëngjyzë. Nga ana tjetër, ama: një herë jeton njeriu!

– Ashtu është, – tha Raviku dhe i zgjati Hakes ndezësin elektrik.

– Ku do të shkojmë?

– Keni dëshirë ta fillojmë me një *Mezo dë randë–vu?*

– Ç'na qenka kjo?

– Një shtëpi ku gra të shoqërisë së lartë vijnë për të bërë ndonjë aventurë.

– Me gjithë mend e keni? Vërtet gra të shoqërisë së lartë?

– Po. Gra që i kanë burrat pleq. Gra që kanë burra tepër të mërzitshëm. Gra, burrat e të cilëve nuk fitojnë mjaft para.

– Po si kështu... Kaq e thjeshtë qenka kjo... Si veprojnë?

– Gratë vijnë atje për një orë ose për disa orë. Njëlloj si për një koktej ose për një mbrëmje. Bile disa vijnë, pasi i ftojnë me telefon. Natyrisht ato shtëpi nuk janë si këto të Monmartës. Di një godinë të tillë shumë të këndshme mu në mes të Pyllit të Bulonjës. Pronarja të jep përshtypjen e një dukeshe. Gjithçka bie erë aristokraci, fshehtësi dhe elegancë.

Raviku fliste ngadalë dhe krejt i qetë. Dëgjonte veten tek dërdëlliste si një ciceron turistësh, por nuk donte ta ndërpriste rrjedhën e fjalëve, vetëm e vetëm që të qetësohej. Ndër krahë i dridheshin damarët. E rroku timonin fort me të dyja duart, për ta mposhtur emocionin.

– Do të habiteni, kur t'i shikoni dhomat, – vazhdoi ai. – Orenditë janë të gjitha origjinale, qilimat dhe perdet e lashta, vera është e zgjedhur, shërbimi i përkryer, dhe me ato lloj grash s'do mend që jeni absolutisht i sigurt.

Hakeja shfryu tymin e puros dhe iu kthye Ravikut:

– Dëgjoni, i dashur zoti fon Horn, të gjitha këto tingëllojnë fort

bukur. Por çështja është se, me siguri, do të jetë një sport i shtrenjtë.

– Nuk është absolutisht shtrenjtë!

Hakeja qeshi pak me druajtje.

– Varet si ta kuptosh. Ne gjermanët, me atë çikëz valutë që na japin...

Raviku tundi kokën.

– Pronaren e njoh shumë mirë. Ajo ka ca detyrime ndaj meje dhe do të na trajtojë si mysafirë të veçantë. Po erdhët, do të vini si miku im, dhe ka shumë mundësi që të mos ju lejojnë fare të paguani. Të shumtën ca bakshishe... dhe ato do të jenë më pak nga ç'paguhet për një shishe *Osiris*.

– Vërtet thoni?

– Do ta shikoni vetë.

Hakeja u rehatua në ndenjësen e vet.

– Qenka feja vetë! – Ai iu skërmit Ravikut. – Duket se i ditkeni punët shumë mirë! Duhet t'i keni bërë ndonjë nder të madh asaj zonjës.

Raviku i hodhi një shikim. E vështroi drejt e në dritë të syrit.

– Shtëpive të tilla u dalin nganjëherë ngatërresa me organet shtetërore. Prova të lehta presioni për të zhvatur ndonjë shumë parash... E kuptoni vetë se ku e kam fjalën.

– E kuptoj që ç'ke me të! – Për disa çaste Hakeja mori një pamje të menduar. – Kaq influencë paskeni këtu?

– Jo edhe aq. Por kam disa miq në poste të rëndësishme.

– Kjo s'është pak! Dhe neve mund të na hyjë shumë në punë. Sikur të bisedonim një herë rreth kësaj teme?

– Patjetër. Edhe sa kohë do të qëndroni në Paris?

Hakeja qeshi.

– Me sa duket, ne u takokemi gjithmonë kur unë jam në të ikur e sipër. Në orën e shtatë e gjysmë të mëngjesit nisem. – Ai vështroi orën e veturës. – Për dy orë e gjysmë. Sapo desha t'jua thosha. Pastaj duhet të ndodhem në stacionin e trenit, në *Gar dy Nord*. A ia dalim dot me gjithë këto plane që kemi?

– Shumë kollaj. Është nevoja të kthehemi më në hotelin tuaj?

– Jo. Plaçkat i kam çuar në stacion. Dhomën e lirova qysh pasdreke, sepse kështu më takonte të paguaja një natë më pak. Ç't'i bësh? Me atë pak valutë që na bie në dorë... – Ai zbardhi përsëri dhëmbët.

Befas Raviku vuri re se po qeshte edhe vetë. I shtrëngoi duart fort pas timonit. S'është e mundur! mendonte. S'është e mundur! Me siguri ka për të ndodhur diçka që do të më prishë punë. Një rastësi e tillë s'ka si të ndodhë!...

*
* *

Nga ajri i freskët Hakes i ra pija në kokë. Zëri erdhi e iu bë më i ngadaltë dhe më i rëndë. U rregullua mirë aty në qoshen e vet dhe zuri të dremiste. Mjekra iu kapit mbi gjoks dhe sytë iu mbyllën. Makina mori një kthesë dhe u fut në errësirën e heshtur të Pyllit të Bulonjës.

Projektorët rendnin përpara veturës si fantazma të nemitura, çanin errësirën dhe shkulnin nga gjiri i saj pemë që shëmbëllenin me xhinde. Aromë akaciesh depërtonte brenda dritareve të hapura. Fërkimi i gomave mbi asfalt – i butë e i njëtrajtshëm, sikur s'kishte ndër mend të pushonte kurrë. Motori – zukatës, si një i njohur i vjetër, uturonte ngadalë e së thelli dhe zhurma e tij davaritej në ajrin e lagësht të natës. Vezullimi i një gjoli të vogël, përvijimet e lëndinave, që shquheshin me ngjyrën e tyre të çelët nga ngjyra më e errët e ahishteve. Bari i mbuluar me një tis vese, si sedef i zbehtë. Rruga *Madrid*, rruga e Portës së *Shën Xhejmsit*, rruga e *Nëjisë*. Një shtëpi që dremiste buzë rrugës. Era që dëshmonte praninë e ujit. Lumi i Senës.

Raviku e futi makinën në bulevardin e *Senës*. Mbi ujin e përshëndritur nga hëna lundronin, në distancë, dy mauna të zeza. Nga mauna e dytë vinte lehja e një qeni. Dëgjoheshin edhe zëra njerëzish. Në kiçin e maunës së parë flakëronte një dritë. Raviku nuk e ndali makinën. E ngiste me ritëm të njëllojtë që të mos e zgjonte Haken, dhe vazhdoi rrugën përgjatë Senës. Kishte pasur ndër mend të ndalonte diku këtu. Por ishte e pamundur. Maunat lundronin shumë afër bregut. Ai e ktheu timonin dhe u fut në rrugën *Dë la Fermë*, iu largua lumit dhe hyri në bulevardin *Longshan*. Kaloi edhe bulevardin *Mbretëresha Margeritë* dhe mori drejt bulevardeve më të ngushta.

Kur ktheu kokën nga Hakeja, vuri re se ky i kishte hapur sytë. Hakeja e vështronte me ngulm. Kokërdhokët i shkëlqenin si rruaza qelqi blu nën dritën e dobët të armaturës. Ravikut iu bë sikur e zuri korrenti.

– U zgjuat? – e pyeti me një ton të shkujdesur.

Hakeja nuk i dha përgjigje. Vazhdonte të mos ia shqiste sytë Ravikut. Nuk lëvizte fare. As sytë nuk i lëvizte.

– Ku ndodhemi? – pyeti më në fund.

– Në *Bua dë Bulonjë*. Jo larg restorantit *Dë Kaskadë*.

– Sa kemi që po udhëtojmë?

– Dhjetë minuta.

– Kemi më tepër.

– Nuk besoj.

– Përpara se të më zinte gjumi, pashë orën. Kemi më shumë se gjysmë ore që po udhëtojmë.

– Vërtet? – ia bëri Raviku. – Kurse unë pandehja se kishim më pak. Së shpejti do të arrijmë.

Hakeja nuk ia kishte ndarë sytë.

– Ku?

– Në *Mezo dë randë-vu*, në Shtëpinë e Takimeve.

Hakeja lëvizi nga vendi.

– Kthehuni mbrapsht, – tha ai.

– Tani?

– Po.

Ai nuk ishte më i pirë. Ishte esëll fare dhe me të tërë shqisat në përgjim. Fytyra i kishte ndërruar shprehje. Mënyra e sjelljes prej babaxhani ishte zhdukur. Për herë të parë Raviku dalloi tani po atë fytyrë që e njihte aq mirë, fytyrën që ishte tiposur përgjithmonë në tru atje, në qilarin e tmerrshëm të torturave të Gestapos. Dhe përnjëherësh iu zhduk shqetësimi që kishte ndier gjatë gjithë këtyre kohëve të fundit – ndjenja që donte të vriste një njeri të huaj, i cili në të vërtetë s'duhej t'i interesonte fare. Në veturën e vet kishte pasur gjer në atë çast një qejfli të urtë vere, dhe më kot ishte rrekur të zbulonte në fytyrën e atij njeriu shkaqet – ato shkaqe që ekzistonin në plan të parë në trurin e tij dhe që e shtynin në çdo veprim, pavarësisht se çfarë përpiqej të mendonte. Kurse tani kishte përballë po ata sy, të cilat e kishin pasë zhbiruar kur ishte përmendur nga alivani dhe nga agonia e dhimbjeve. Ishin po ata sy të akullt, ishte po ai zë i akullt, i ulët, që të hynte gjer në palcë...

Diçka e shkundi gjer në thellësi të shpirtit. Ishte si një rrymë elektrike që ndërronte polet. Tensioni mbeti po ai; por rryma flakëruese, nervoze, alternative erdh e u fut tani në një rrymë të vazhdueshme, e cila kishte vetëm një qëllim dhe asgjë tjetër jashtë këtij qëllimi! Vite u shembën e u bënë pluhur e hi, dhe përsëri i dolën përpara syve ai qilari i torturave me muret gri, ata projektorët e fuqishëm pa abazhurë; përsëri ndjeu duhmën e gjakut, të lëkurës, të djersës, përsëri përjetoi ndjenjën e mundimit, të ankthit e të llahtarit...

– Po pse? – e pyeti.

– Duhet të kthehem. Më presin në hotel, – ia priti Hakeja.

– Po ju sikur thatë që plaçkat i keni çuar në stacion!

– Ashtu është. Por kam edhe një punë për të kryer. Më kishte dalë nga mendja. Kthehuni!

– Mirë.

Përpara një jave Raviku i kishte rënë Pyllit të Bulonjës me dhjetëra herë kryq e tërthor; ditën dhe natën. Ai e dinte fort mirë se në ç'vend ndodhej tani. I duheshin edhe disa minuta. Ktheu timonin dhe u fut në një shëtitore të ngushtë majtas.

– Po kthehemi?

– Po.

Era e rëndë e ajrit përposh pemëve, ku nuk depërtonte dot drita e diellit ditën. Errësira e dendur që çahej nga projektorët e automobilit. Raviku pikasi në pasqyrë se si dora e majtë e Hakes, ngadalë e me kujdes, po tërhiqej nga dritarja e hapur ku qe mbështetur. Timoni ndodhet nga e djathta! i shkoi në mendje Ravikut. Sa mirë që kjo *Talboja* e ka timonin nga e djathta! Ai mori një kthesë, e mbajti timonin vetëm me dorën e majtë, bëri sikur do të futej tërësisht në kthesë, shkeli gazin deri në fund dhe e stercoi përsëri timonin drejt shëtitores së drejtë që kishte përpara; makina fluturoi me sa i hante motori dhe, disa sekonda më vonë, Raviku e frenoi në vend.

Talboja qëndroi duke u përpëlitur. Frenat vërshëllyen. Raviku mbajti drejtpeshimin, duke mbështetur fort njërën këmbë mbi pedalin e gazit dhe tjetrën mbi armaturën e motorit. Hakeja, këmbët e të cilit s'kishin mbështetje dhe që s'e priste gjithë atë frenim, ra me trup nga përpara. Nuk arriti ta nxirrte me kohë dorën nga xhepi dhe u përplas me ballë pas pjesës së dalë, që ndante xhamin e përparmë nga armatura. Po atë çast Raviku e goditi në zverk, mu poshtë kafkës, me çelësin e rëndë anglez që e kishte nxjerrë nga xhepi i djathtë i xhaketës.

Hakeja nuk u ngrit më. Trupi i rrëshqiti anash. Supi i djathtë e pengoi rënien dhe trupi i mbeti pezull, i rrasur pas armaturës.

Raviku vazhdoi menjëherë udhëtimin. I fiku projektorët dhe përgjoi jashtë xhamit, se mos ndodhej njeri afër që mund ta kishte dëgjuar vërshëllimën e frenave. E bëri me mend që, po t'i afrohej njeri, ta fshihte Haken diku pas kaçubave. Më në fund e ndali makinën pranë një kryqëzimi, kërceu në tokë, ngriti kapakun e motorit, hapi derën nga ana e Hakes dhe qëndroi në përgjim. Po të afrohej njeri, ai do të mund ta dallonte e ta dëgjonte nga larg. Do t'i dilte koha pastaj ta zvarriste Haken diku pas gjelbërimit të dendur e të shtirej sikur po rregullonte një defekt motori.

Qetësia ishte njëlloj si zhurmë. Dhe zhurma pllakosi aq e beftë dhe e tmerrshme, saqë filloi të oshtinte nga të katër anët. Raviku

shtrëngoi duart grusht, sa filluan t'i dhembnin. E dinte që gjithë atë zhurmë ia shkaktonte gjaku që i buçiste ndër veshë. Zuri të merrte frymë thellë dhe ngadalë.

Oshëtima erdh e u kthye në shushurimë. Nëpërmes shushurimës filloi të dëgjohej një zukatje që sa vinte e rritej. Raviku vuri veshin. Zukatja erdh e u afrua, më e fortë, më metalike – dhe përnjëherësh ai e kuptoi se ishin bulktha, dhe se shushurima qe zhdukur. Dëgjohej vetëm zukatja e bulkthave në atë mëngjes që po agonte mbi një copëz të ngushtë lëndine përkundrejt tij.

Copëza e lëndinës shtrihej në mugëtirë. Raviku uli kapakun e motorit. Koha nuk priste. Duhej të kryente punë përpara se të bëhej ditë. Vështroi përqark. Vendi aty nuk ishte i përshtatshëm. Asnjë vend në këtë pyll nuk ishte i përshtatshëm. Që të shkonte tani gjer buzë Senës, kishte tepër dritë. Ai nuk e pati llogaritur se do të vonohej kaq shumë. E ktheu trupin me rrëmbim. I kishin zënë veshët një gërvishtje dhe pastaj një rënkim të mbytur. Njëra nga duart e Hakes u zgjat nga dera e hapur e veturës dhe zuri të gërvishte mbajtësen e parafangos. Raviku vuri re që akoma po e mbante në dorë çelësin anglez. Ai e zuri Haken nga jaka e xhaketës, e tërhoqi deri sa iu var koka jashtë dhe e goditi dy herë rresht në zverk. Rënkimet pushuan.

Diçka trokëlliti. Raviku mbajti frymën. Pastaj e pa që ishte një revolver, që kishte shkarë nga ndenjësja dhe kishte rënë mbi mbajtësen e parafangos. Dukej që Hakeja e kishte pasur në dorë, përpara se të frenonte makina. Raviku e flaku revolverin brenda në veturë.

Përsëri vuri veshin. Bulkthat. Lëndina. Qielli që po kthjellohej dhe largohej. Edhe pak e do të lindte dielli. Raviku e nxori trupin e Hakes nga makina, tërhoqi nga para ndenjësen e përparme që ishte e lëvizshme dhe u përpoq ta rraste Haken në fundin e veturës, midis ndenjëseve të përparme dhe të pasmeve. Punë që s'bëhej. Vendi ishte tepër i ngushtë. Ai u sul nga pas dhe hapi vendin e bagazhit. Me nxit i nxori të gjitha sendet që ndodheshin brenda. Pastaj e tërhoqi përsëri Haken përjashta dhe e zvarriti deri në pjesën e pasme të makinës. Hakeja nuk kishte vdekur akoma. Ravikut i kullonte djersa mbi fytyrë. Arriti ta fuste trupin te bagazhi. E rrasi brenda me zor, si një embrion të kruspullosur, me gjunjët mbledhur.

Mori veglat, një lopatë dhe krikun, nga rruga dhe i vuri përpara në makinë. Një zog zuri të cicëronte në një nga pemët aty afër. Ai u trondit. Kjo cicërimë iu duk më e fortë se gjithçka që kishte dëgjuar ndonjëherë. Hodhi sytë nga lëndina. Ajo ishte ndriçuar edhe një nuancë më tepër.

Nuk mund ta rrezikonte veten në asnjë mënyrë. U kthye përsëri dhe ngriti përgjysmë kapakun e bagazhit. Vuri këmbën e djathtë mbi prapakolpin dhe me gjurin e tij e mbajti kapakun hapur vetëm sa të mund të fuste duart brenda. Po të vinte ndokush, do të dukej sikur po merrej me diçka dhe mund ta mbyllte menjëherë kapakun. Kishte një rrugë të gjatë për të bërë. Dhe Hakes duhej t'i jepte fund tani.

Koka e Hakes ndodhej mu pranë qoshes së djathtë. Ai e dallonte mirë. Qafa ishte e butë; damarët pulsonin akoma. Raviku ia shtrëngoi duart në fyt dhe ia shtypi fort gurmazin.

Dukej sikur kjo punë s'do të merrte fund kurrë. Koka lëvizi pak. Shumë pak. Trupi u përpoq të tendosej dhe të jepte përshtypjen sikur qe i kapur nga rrobat si ndër leqe. Goja e Hakes u hap dhe mbeti ashtu. Zogu filloi të cicëronte sërish çjerrazi. Pastaj Hakes iu var gjuha jashtë, e trashë, e verdhë, e veshur. Dhe befas ai hapi njërin sy. Dukej sikur kokërdhoku po i kërcente jashtë, po merrte dritë e pamje, po shkëputej e po i avitej Ravikut – dhe pastaj trupi u përpëlit për të fundit herë dhe tendosja u zhduk. Raviku e mbajti edhe një copë herë të mbërthyer për fyti. Kishte marrë fund.

Kapaku u mbyll. Raviku bëri disa hapa. Sakaq ndjeu se po i dridheshin gjunjët. U mbajt pas një peme dhe volli. I bëhej sikur po nxirrte gjithë zorrët. U mundua ta përmbante veten, por ishte e kotë.

Kur ngriti sytë, pa një burrë që po afrohej tutje nga lëndina. Burri vështroi nga ai. Raviku nuk lëvizi nga vendi. Burri po i afrohej. Ecte me hap të ngadaltë, të shkujdesur. Nga veshja dukej si kopshtar a punëtor. Përsëri hodhi sytë nga Raviku. Raviku përshtyu dhe nxori nga xhepi paketën e cigareve. E ndezi një dhe e thithi tymin fort. Tymi ia gërrici fytin. Burri i ra mes për mes shëtitores. Vështroi vendin ku kishte vjellë Raviku, pastaj vështroi veturën dhe pastaj Ravikun. Nuk tha asgjë, dhe as në fytyrën e tij Raviku nuk mundi të dallonte gjë. Burri u zhduk pas kryqëzimit me hap të ngadaltë.

Raviku priti edhe disa sekonda. Pastaj mbylli me çelës kapakun e bagazhit dhe ndezi motorin. Këtu në pyll nuk kishte mundësi të bënte më asgjë. Dita kishte zbardhur krejt. Duhej të nisej për në *Sen–Zhërmen*. I njihte pyjet e atjeshme.

30

Undal pas një ore përpara një restoranti të vogël. Ishte shumë i uritur dhe kokën e kishte të rëndë. E la makinën përpara lokalit, ku ishin nxjerrë përjashta dy tryeza dhe disa karrige. Porositi kafe me qifle dhe shkoi të lahej. WC-ja binte erë. Kërkoi një gotë dhe shpëlau gojën. Pastaj lau duart dhe u kthye.

Mëngjesin ia kishin lënë mbi tryezë. Kafja kundërmonte, siç kundërmojnë të gjitha kafet e botës. Dallëndyshe fluturonin rreth çative, dielli nderte fasadave të shtëpive pëlhurat e tij të para të florinjta. Njerëz nxitonin për në punë, dhe brenda në restorant një pastruese me fustan të ngritur lante pllakat. Një mëngjes kaq të paqtë Raviku s'e kishte parë prej kohësh.

Ai piu kafen e nxehtë. Por po nuk vendoste dot të hante. Nuk donte të prekte asgjë me dorë. U hodhi një sy duarve të veta. Marrëzi! mendoi. Po filloj të bëhem vesveseli. Duhet të ha medoemos diçka. Piu edhe një filxhan tjetër me kafe. Nxori një cigare dhe u kujdes që të mos e fuste në gojë fundin e saj që kishte prekur me dorë. Kjo s'mund të vazhdojë kështu! tha me vete. Por, megjithatë, nuk shtiu gjë në gojë. Më parë duhej t'i jap fund gjithë kësaj meseleje! Vendosi dhe u ngrit për të paguar.

Një kope lopësh. Flutura. Diell mbi arat. Diell mbi xhamin e përparmë të veturës. Diell mbi mbulesën e saj. Diell mbi metalin e ndritshëm të kapakut të bagazhit, nën të cilin ndodhej Hakeja – i vdekur, pa e marrë vesh pse dhe kush e vrau. Duhej të kishte ndodhur ndryshe. Krejt ndryshe...

"A më njeh, Hake? A e di kush jam?"

Fytyra e kuqe iu fanit dhe i erdhi fare pranë.

"Jo, nuk e di. Cili jeni? Mos jemi takuar edhe herë tjetër?"

" Po."

"Kur? Mos kemi qenë bashkë në shkollën e kadetëve?... Nuk po më kujtoheni."

"Nuk të kujtohem, Hake. Jo në shkollën e kadetëve. Shumë më vonë."

"Më vonë?! Po ju keni jetuar jashtë shtetit! Unë s'kam dalë kurrë jashtë Gjermanisë. Vetëm këto dy vitet e fundit kam ardhur këtu, në Paris. Mos vallë kemi pirë ndonjëherë bashkë...?"

"Jo, s'kemi pirë. Dhe as këtu nuk jemi takuar. Ka ndodhur në Gjermani, Hake!"

Një postobllok. Shina hekurudhore. Një bahçe e vogël, mbushur tërë trëndafila dhe luledielli. Pritje. Një tren i zi, duke vjellë avull mëngjesit të murrmë. Mbi xhamin e përparmë të veturës pasqyroheshin e dilnin përsëri si të gjallë sytë, të cilët në të vërtetë, të qullëta e pa jetë, po mbusheshin tani me pluhurin e rrugës, që futej nga të çarat, atje në vendin e bagazheve.

"Në Gjermani? Ah, kuptova! Në ndonjërin prej kongreseve të partisë. Më duket sikur po më bie ndër mend. Mos ka qenë në Nyrenberg?"

"Jo, Hake, i foli Raviku me ngadalë xhamit të përparmë të veturës dhe ndjeu se si po kthehej dhe po e pushtonte sërish vala e rëndë e viteve të shkuara.*"Jo në Nyrenberg, por në Berlin."*

"Në Berlin?" Fytyra e përtejvarrit, drithëruar refleksesh, mori një shprehje padurimi, por pa e humbur nuancën e mirësjelljes.*"Epo, nxirreni tani të shkretën! Mos e zgjatni kaq shumë e mos më torturoni! Ku ka ndodhur?"*

Vala e viteve të shkuara, duke u ngritur nga dheu, po ia mpinte tani krahët Ravikut.

"Mos t'ju torturoj, Hake? Pikërisht atje e kam fjalën! Atje ka ndodhur, atje u bë njohja jonë – gjatë torturave!"

Një buzëqeshje, e pasigurt, e kujdesshme:

"Lërini këto shakara!"

"Gjatë torturave, Hake! A e more vesh tani se kush jam?"

Buzëqeshja erdh e u bë më e pasigurt, më e kujdesshme kanosëse:

"Si mund ta marr vesh? Unë kam të bëj me mijëra njerëz. S'mund t'i mbaj mend të gjithë. Në qoftë se e keni fjalën për Policinë Sekrete Shtetërore..."

"Po, Hake. Për Gestapon e kam fjalën."

Ngritje supesh. Përgjim.

"Në paçi qenë marrë ndonjëherë në pyetje atje..."
"Po. A të kujtohet?"
Përsëri ngritje supesh.
"Qysh të më kujtohet?! Ne kemi marrë në pyetje me mijëra veta!..."
"Keni marrë në pyetje?! Keni torturuar, thuaj, rrahur gjer në çmenduri; keni shtypur veshka, thyer kocka; i keni hedhur njerëzit si të ishin thasë në qilar e i keni marrë përsëri; keni çjerrë fytyra copë-copë, keni shkatërruar herdhe – dhe kësaj i thoni "marrje në pyetje"! Rënkimit të llahtarisur, por të shurdhër të atyre që nuk mund të këlthisnin më – i thoni "marrje në pyetje"! Regëtimës midis një alivanosjeje dhe tjetrës, shkelmave barkut, bastuneve prej gome, kërbaçëve – të gjitha këtyre u thoni me pafajninë më të madhe "marrje në pyetje"!"

Raviku vazhdonte të mos ia shqiste sytë fytyrës së padukshme atje mbi xhamin e përparmë të veturës, nëpërmjet të cilit po rrëshqiste panorama e nemitur me fusha gruri, lulëkuqe dhe manaferra. Ia kishte qepur sytë egërsisht asaj fytyre dhe po ia thoshte gjithçka kishte dashur t'ia thoshte dhe që duhej t'ia thoshte njëherë e mirë:

"Uli duart ose ta hoqa me plumb kokës! A të kujtohet Maks Rozenbergu i vogël, ai që dergjej pranë meje në birucë me trupin bërë fërtele dhe që u përpoq ta thyente kokën pas murit prej betoni, që ju të mos e merrni më "në pyetje"? Dhe pse e merrnit në pyetje? Sepse ishte demokrat! Po Vilmani a të bie ndër mend? Ai që nxirrte gjak në vend të urinës, që s'i kishte mbetur asnjë dhëmb në gojë dhe që e kishit lënë vetëm me një sy, pasi e patët marrë nja dy orë "në pyetje"? Dhe pse e merrnit në pyetje? Sepse nuk besonte që Hitleri juaj na qenkësh Shpëtimtari! Po Rizenfeldi, që ia kishit bërë kokën dhe kurrizin mish të gjallë dhe që na përgjërohej t'ia çanim me dhëmbë damarët, sepse atij vetë s'i kishte mbetur as dhëmb e as dhëmballë në gojë, pasi e pate "marrë në pyetje" ti? Dhe pse e more në pyetje? Sepse ishte kundër luftës dhe nuk i mbushej mendja që kultura mund ta gjente shprehjen e vet më të përsosur nëpërmjet bombave dhe flakëhedhësve! Marrje në pyetje!... Me mijëra keni "marrë në pyetje" ju!... Hiqi duart që andej, qen bir qeni!... Dhe tani të futa në dorë më në fund, dhe ne po udhëtojmë jashtë qytetit, dhe unë di një shtëpi me mure të trasha dhe krejt të vetmuar, dhe atje kam për të të "marrë në pyetje" – ashtu avash-avash, ditë me radhë, duke të të bërë kurën Rozenberg, kurën Vilman dhe kurën Rizenfeld, ashtu siç na e keni mësuar ju të Gestapos! Dhe pastaj... në fund fare..."

Befas Raviku vuri re se vetura po fluturonte me sa i hante motori. Ai e hoqi këmbën nga pedali i gazit. Shtëpi. Një fshat. Qen. Pula. Kuaj në një fushë, duke ecur revan, me qafat shtrirë përpara, figura pagane plot jetë e gjallëri. Një grua e qeshur me një kanistër plot

rroba të lara. Mbi litarët rroba të larme që valëviteshin, flamuj lumturie të paqtë. Përpara portave luanin disa fëmijë. Të gjitha këto i dukeshin sikur ishin të ndara nga një mur prej xhami, shumë afër dhe jashtëzakonisht larg, plot bukuri e paqe e pafajni, plot intensitet jete që të shkaktonte dhimbje, të ndara prej tij dhe të paarritshme për jetë të jetëve. Po nuk i vinte keq... Kështu ishte – dhe pikë.

Duhej të udhëtonte ngadalë. I vetmi shkas që mund t'u jepte të tjerëve për ta ndaluar, ishte po t'ia shkelte fort nëpër fshatra. Vështroi orën. Kishte plot dy orë që po udhëtonte. Si ishte e mundur? S'e kishte vënë re fare kohën. Kishte parë vetëm atë fytyrë, së cilës i fliste...

Sen-Zhërmeni. Parku. Parmakë të zinj që ngriheshin drejt qiellit blu, e pastaj pemë, pemë. Rrugina të tëra me pemë. Një park pemësh, aq të shumëpritura, aq shumë të dëshiruara dhe, përnjëherësh, pylli i madh!

Makina nuk uturonte më. Pylli ngrihej përpjetë, si tallaz i gjelbër e i lartë, hidhej sa djathtas-majtas, përmbyste horizontin dhe i përfshinte të gjitha – edhe atë insekt të shpejtë metalik, që fluturonte me zigzage mes për mes tij.

Vendi që zgjodhi ishte i butë dhe i mbuluar me bar e me shkurre. Ndodhej mjaft larg rrugës. Raviku e la veturën disa qindra metra më tutje, por në mënyrë që ta shihte. Pastaj mori lopatën dhe filloi të hapte gropën. S'ishte punë e zorshme. Po të vinte njeri dhe shikonte veturën, ai mund ta fshihte lopatën dhe të kthehej te makina si një shëtitës i patëkeq.

Gropën e bëri të thellë, që të kishte mjaft dhé për t'ia hedhur kufomës përsipër. Pastaj shkoi e mori veturën dhe e solli aty. Një trup i vdekur ishte i rëndë. Megjithatë, veturën e afroi vetëm gjer atje ku toka ishte e fortë dhe nuk linte gjurmë rrotash.

Trupi s'kishte ngrirë akoma. Ai e tërhoqi zvarrë gjer pranë gropës dhe filloi t'ia hiqte rrobat e t'i bënte grumbull. Ishte më e lehtë nga ç'e kishte menduar. E la trupin lakuriq atje, mori rrobat, i futi në vendin e bagazhit dhe e çoi veturën përsëri atje ku e pati lënë qëparë. Mbylli dyert dhe vendin e bagazhit dhe mori një çekiç me vete. Duhej ta bënte hesap që trupin mund ta gjenin rastësisht, dhe ai donte të shmangte çdo identifikim.

Për një çast e pati shumë të rëndë të kthehej. Ndjeu një shtytje të fuqishme, ta linte kufomën atje ku ishte, të hipte në makinë e të bëhej erë. U ndal në vend dhe vështroi përqark. Mbi një trung ahu, disa metra më tutje, dy ketra ndiqnin njëri-tjetrin. Gëzofët e tyre të kuq

ndritnin në diell. Ai vazhdoi rrugën.

E buhavitur. E mavijosur. I vuri asaj fytyre një copë leckë të leshtë, të njomur me vaj, përsipër dhe zuri t'i binte me çekiç. Pas goditjes së parë, qëndroi. Goditja kumboi e shurdhër. Sakaq vazhdoi t'i binte me furi. Pas një copëhere e hoqi copën e leshtë. Fytyra ishte shndërruar në një masë amorfe, plot me gjak të zi. Si koka e Rizenfeldit, mendoi Raviku. E ndjeu se dhëmbët i kishte të shtrënguar fort. Jo si koka e Rizenfeldit, i shkoi sërish në mendje. Koka e Rizenfeldit ishte më keq, sepse ai jetonte akoma, kur e patën katandisur në atë ditë.

Unaza në dorën e djathtë. Ai ia hoqi nga gishti dhe e shtyu trupin në gropë. Gropa ishte pak e vogël për nga gjatësia. Ia ngriti gjunjët kufomës. Pastaj e mbushi gropën me dhé. Mbaroi punë shpejt. E rrasi dheun mirë e mirë me këmbë dhe i vuri përsipër disa plisa, që i pati prerë qysh më parë. Plisat zunë vend mirë. Vetëm po të përkuleshe e t'i vështroje me vëmendje, mund të dalloje se ishin plisa të sapovendosur. Së fundi rregulloi edhe shkurret përreth.

Çekiçi. Lopata. Lecka e leshtë. I vuri të gjitha, bashkë me rrobat, prapa te bagazhi. Pastaj u kthye edhe njëherë, ngadalë e duke kërkuar gjurmë. Nuk gjeti pothuaj asnjë. Një shi dhe bari i ri, që do të mugëllonte pas disa ditësh, do ta bënin punën e tyre.

Çudi: këpucët e një njeriu të vdekur. Çorapet, ndërresat. Kostumi nuk të bënte edhe aq përshtypje. Çorapet, këmisha, ndërresat – dukeshin që tani si të venitura, si të bashkëvdekura me kufomën. Të vinte ndot t'i zije me dorë e të kërkoje monograme dhe etiketa rrobaqepësie.

Raviku e bëri shpejt atë që kishte për të bërë. I preu të gjitha etiketat. Pastaj bëri njëfarë hejbe me plaçkat dhe i groposi të tëra. Tani ndodhej shumë kilometra larg vendit, ku kishte varrosur kufomën – mjaft larg, sa për të shmangur rrezikun që të zbuloheshin të dyja në të njëjtën kohë, si kufoma ashtu edhe hejbja.

Ai vazhdoi udhëtimin, derisa arriti buzë një përroi. Nxori etiketat e prera dhe i mbështolli në një letër. Pastaj grisi bllokun e shënimeve të Hakes në copa të vogla dhe kontrolloi kuletën. Ajo përmbante dy kartëmonedha nga një mijë franga, biletën e trenit për në Berlin, dhjetë marka, disa pusulla me adresa dhe pasaportën e Hakes. Raviku futi në xhep paratë franceze. Në njërin xhep të Hakes kishte gjetur edhe disa pesëfrangëshe.

Biletën e udhëtimit e soditi një copë herë. Për në Berlin – i vinte çudi tek e lexonte: për në Berlin. E grisi dhe e vuri bashkë me të tjerat.

Pasaportën e vështroi mjaft gjatë. Skadonte pas tre vjetësh. Pati një tundim ta mbante e të jetonte me të. I përshtatej shumë gjithë mënyrës së jetesës që bënte. S'do të ishte menduar gjatë, sikur të mos qe një punë me shumë zarar.

E grisi pasaportën. Po ashtu edhe dhjetëmarkëshin. Çelësat e Hakes, revolverin dhe dëftesën për valixhen i mbajti. Do të mendohej se mos mund ta tërhiqte valixhen nga stacioni i trenit, në mënyrë që të zhdukte çdo gjurmë në Paris. Dëftesën e hotelit e kishte gjetur dhe grisur.

I dogji të gjitha. Iu desh më tepër kohë, nga ç'kishte menduar, por përdori edhe një letër gazete për të djegur copat e stofës. Hirin e shpërndau në përrua. Pastaj kontrolloi veturën se mos gjente gjurma gjaku. Nuk gjeti gjë. E lau çekiçin dhe çelësin anglez me kujdes dhe i vuri përsëri të gjitha veglat në vendin e bagazheve. I lau duart aq sa mund të laheshin, nxori një cigare dhe u ul një copë herë për të tymosur në qetësi.

Dielli binte pjerrtazi përmes aheve të larta. Raviku rrinte ulur dhe pinte cigare. E ndiente veten të zbrazët dhe nuk mendonte asgjë.

*

* *

Vetëm kur mori përsëri kthesën dhe u fut në rrugën që të çonte për në kështjellë, filloi të mendonte për Sibilën. Kështjella ngrihej e bardhë atij mëngjesi të kthjellët vere, nën qiellin e përjetshëm të shekullit të tetëmbëdhjetë. Sibila i erdhi në mendje ashtu papritur e pa kujtuar dhe, për herë të parë që nga ajo kohë, nuk u përpoq të rezistonte, ta shtynte mënjanë e ta mposhtte atë kujtim. Në kujtimet e tij s'kishte arritur kurrë më larg se deri në ditën kur Hakeja urdhëroi ta thërrisnin Sibilën për ta marrë në pyetje përpara tij. S'kishte arritur kurrë më larg se deri te llahtaria dhe tmerri i parrëfyer e i marrosur që kishte parë në fytyrën e saj. Të gjitha të tjerat ishin shuar përpara këtij kujtimi të fundmë. Dhe ai s'kishte arritur kurrë më larg se deri te lajmi që i bënte të ditur se ajo kishte varur veten në kampin e përqendrimit. Nuk kishte dashur ta besonte kurrë. Kishte mundësi – por kush mund ta dinte ç'i pati ndodhur përpara se të varte veten? Ai s'kishte qenë kurrë në gjendje të mendonte për të pa e ndier në tru atë shtrëngimin e tmerrshëm, që ia shndërronte duart në kthetra, që ia shkallmonte gjoksin dhe që, ditë me radhë, e bënte të paaftë t'i shpëtonte mjegullës së kuqe të shpresës së kotë për hakmarrje...

Tani ja ku po e kujtonte Sibilën, dhe kthetrat dhe shtrëngimi dhe mjegulla ishin zhdukur papritmas. Diçka brenda tij ishte çliruar, një barrikadë ishte hequr; pamja e ngrirë e llahtarit kishte filluar të lëvizte, nuk ishte më si kallkan, nuk ishte më ashtu si gjatë gjithë këtyre viteve të fundit. Goja e shtrembëruar filloi të mbyllej, sytë e humbën zgurdullimin rrëqethës dhe gjaku u kthye ngadalë në fytyrën e bardhë si gëlqere. S'ishte më ajo maska e ngrirë e tmerrit – ishte përsëri ajo Sibila që pati njohur ai, me të cilën pati jetuar, gjinjtë e këndshëm të së cilës i pati ndier e ledhatuar dhe e cila gjatë dy vjetëve të jetës së tij kishte qenë për të si flladi i një mbrëmjeje qershori.

Ditë u ngritën nga pluhuri i harresës... net... si një shpërthim fishekzjarresh, që lartohej befas tej në horizont. Një portë e gozhduar fort e plot njolla gjaku të mpiksur u hap papritmas në të kaluarën e tij, ngadalë e pa zhurmë, dhe pas saj u shfaq përsëri një kopsht dhe jo më një birucë Gestapoje...

Raviku kishte më shumë se një orë që po udhëtonte. Nuk po kthehej për në Paris. Ai ndaloi mbi urën e Senës pas *Sen-Zhermenit* dhe hodhi çelësat dhe revolverin e Hakes në lumë. Pastaj hapi mbulesën e veturës dhe vazhdoi rrugën.

Po udhëtonte duke shijuar një mëngjes të bukur France. Nata qe harruar pothuajse fare dhe kishte mbetur me dhjetëra vite pas tij. Ajo që pati ndodhur përpara disa orësh, ishte bërë qysh tani e turbullt – por ajo që pati qenë fundosur vite me radhë, po ngrihej e po shfaqej në një mënyrë të çuditshme, po i avitej, dhe prej saj nuk po e ndante më asnjë hendek i thellë.

Raviku s'po e merrte vesh se ç'po ndodhte me të. Kishte pandehur se do ta ndiente veten bosh, kishte pritur ta pushtonte një ndjenjë neverie, kishte kujtuar se do të fillonte ta justifikonte veten heshturazi, se do t'i lindte dëshira për t'u dhënë pas pijes, për të harruar – por këtë gjendjen e tanishme s'e kishte pritur kurrsesi. Nuk kishte pandehur se do ta ndiente veten kaq të lehtë e të çliruar, a thua se një dry i rëndë dhe ogurzi, që e pati mbajtur të kyçur të kaluarën e tij, të ishte shkallmuar përnjëherësh. Ai vështroi rretheqark. Peizazhi po i rrëshqiste përpara syve, procesione plepash ngrinin drejt kupës së qiellit harenë e tyre të gjelbër, fusha lulekuqesh dhe ara me grurë shpaloseshin, nga furrat e fshatrave të vogla vinte kundërmimi i bukës së freskët dhe nga një shkollë dëgjoheshin zëra fëmijësh, të shoqëruar nga një violinë.

Ç'kishte menduar qëparë, kur kalonte këtej? Qëparë, përpara

disa orësh, që i dukeshin sa një jetë e tërë. Ku mbeti ai mur prej xhami, ku shkoi ai izolim? Davaritur si mjegull nga dielli që ngrihej. Përsëri i pa fëmijët tek luanin te shkallët e praqeve, pa macet dhe qentë që shtriqeshin në diell, pa rrobat e ndera që i gufonte era, kuajt në lëndinë, dhe prapë ajo gruaja që po nderte radhë të tëra këmishash atje në fushë. I pa dhe e ndjeu që edhe ai bënte pjesë ndër to, tani më tepër se shumë vjet më parë. Diçka përbrenda tij erdhi e u shkri, diçka e butë dhe e lagësht e mbushi shpirt e trup; një arë e zhuritur filloi të gjelbëronte sërish, dhe atij iu duk sikur po e rifitonte ngadalë drejtpeshimin e humbur.

Po rrinte shumë i qetë atje në makinë, i strukur pas timonit; nuk guxonte të bënte pothuajse asnjë lëvizje, nga frika se mos e humbiste atë mori ndjenjash që e kishin kapluar, që po ia gufonin gjoksin, të cilave akoma s'po u besonte, por ua ndiente praninë me të gjitha shqisat... Kishte pandehur se hija e Hakes do të rrinte pranë tij, duke e vështruar syzgurdulluar – kurse ja tek po i rrinte pranë vetëm jeta e tij, që ishte kthyer sërish; po i rrinte pranë dhe po e vështronte. Dy sy, që gjatë shumë vjetësh kishin mbetur të çakërritur dhe që në heshtje kishin kërkuar dhe akuzuar me ngulm; po mbylleshin tani; një gojë po fitonte paqen e dëshiruar dhe dy krahë të kapërthyer nga llahtari po lëshoheshin më së fundi poshtë. Vdekja e Hakes e kishte fshirë vdekjen nga fytyra e Sibilës – tiparet e saj u gjallëruan për disa çaste dhe pastaj filluan të bëheshin të paqarta, të vagëlluara. Ajo fytyrë mundi të gjente më në fund prehjen e kërkuar e të binte në paqe; nuk do të kthehej kurrë më, nuk do t'i fanitej kurrë më; plepat dhe blirët do ta varrosnin me butësi përposh tyre dhe do ta nanurisnin përjetë...

Ai po kundronte tani vetëm verën, po dëgjonte gumëzhitjen e bletëve dhe po e ndiente tek po e pushtonte një kapitje e fortë, e thellë, a thua se nuk kishte fjetur shumë net me radhë, a thua se tani o do të binte në një gjumë të gjatë o nuk do të flinte kurrë më.

*

* *

Talbonë e la në rrugën *Ponsële*. Në çastin kur u shua motori dhe ai zbriti nga makina, e kuptoi se sa i lodhur ishte. Nuk ishte më ajo lodhja e qëparshme e udhëtimit, por një kapitje e bezdisshme, që të ndillte vetëm gjumë. Ai u nis për në *Internacional*, dhe e kishte fort vështirë të ecte. Dielli i peshonte mbi zverk si një tra. Iu kujtua se

duhej ta lironte apartamentin që pati zënë në *Prëns dë Gal*. Kjo punë i kishte dalë fare nga mendja. Ndihej aq i lodhur, saqë u mendua për një hop në ta linte këtë gjë për më vonë. Por pastaj e mblodhi veten dhe u nis me një taksi për në *Prëns dë Gal*. Pasi pagoi faturën, mend harroi të kërkonte që t'ia zbrisnin valixhen poshtë.

Qëndroi atje në hollin e freskët dhe priti. Nga e djathta, në bar, po rrinin ca klientë e po pinin *Martini*. Derisa zbriti fakinoja, Ravikun gati sa s'e kishte zënë gjumi në këmbë. I dha një bakshish dhe kërkoi një taksi.

– Në stacionin e trenin, në *Garë d'Est*, – i tha shoferit. E tha me zë aq të lartë, sa të mund ta dëgjonin mirë si portieri ashtu edhe fakinoja.

Në qoshen e rrugës *Dë la Boeti* e ndali taksinë.

– Kam ngatërruar kohën – i tha shoferit. – Jam një orë përpara. Ndalojeni këtu, përpara bufesë!

Pagoi, mori valixhen, u drejtua nga bufeja dhe ndoqi me sy taksinë derisa u zhduk. Pastaj ndaloi një taksi tjetër dhe u nis për në *Internacional*.

Në portineri ishte vetëm një djalosh që po flinte. Ora kishte kaluar nga dymbëdhjeta. Ishte koha kur padronia shtronte drekën. Raviku e çoi valixhen sipër në dhomë. U zhvesh dhe hapi dushin. Qëndroi gjatë nën të dhe u la mirë. Pastaj u fërkua me alkool. Kjo e freskoi ca. Nxori plaçkat nga valixhja dhe i vuri në vendin e tyre. Veshi ndërresa të pastra dhe një kostum tjetër dhe zbriti poshtë te Marozovi.

– Sa po matesha të vija te ti, – i tha Marozovi. – Sot kam ditën e pushimit. Mund të shkonim në *Prëns dë Gal*... – ai e preu fjalën dhe vështroi Ravikun me vëmendje.

– S'është më nevoja.

Marozovi ia qepi sytë fort.

– Mori fund, – tha Raviku. – Sot në mëngjes. Mos më pyet tani. Dua të fle.

– Ke nevojë për gjësend?

– Jo. U rregullua gjithçka. Pata fat.

– Makinën ku e le?

– Në rrugën *Ponsële*. Në rregull fare.

– Ka mbetur ndonjë gjë tjetër për të bërë?

– Asgjë. Kam vetëm dhimbje koke që po më çmend. Dua të fle. Do të zbres poshtë më vonë.

– Mirë. Domethënë, u kryen të gjitha?

– Të gjitha, – tha Raviku. – S' ka mbetur asgjë, Boris. E pata shumë të thjeshtë.

– E di mirë që s'ke harruar gjë?

– S'ma merr mendja. Jo. S'dua t'i rikujtoj të gjitha edhe njëherë tani. Kam nevojë për gjumë. Flasim më vonë. Këtu do të jesh ti?

– Natyrisht! – tha Marozovi.

– Mirë. Atëherë do të zbres poshtë pastaj.

Raviku u kthye në dhomën e vet. Koka i dhimbte jashtëzakonisht. Qëndroi një copë herë në dritare. Poshtë tij zbardhëllonin zambakët e emigrantit Vizenhof. Përkarshi shikonte murin e murrmë me dritaret pa perde. Gjithçka kishte marrë fund. Ishte me vend, ishte mirë, dhe kështu duhej të ndodhte, por ja që kishte marrë fund tani, dhe më tej nuk ecej dot. S'ekzistonte më asgjë. Asgjë e tij. Që nesër emri i tij do të ishte pa kuptim. Përpara dritares binte pjerrtazi dita e re.

U zhvesh dhe u la edhe një herë. Duart i futi në alkool, i mbajti gjatë në të dhe pastaj i la t'i thaheshin në ajër. Lëkura iu tendos mbi kyçet dhe gishtërinjtë. Kokën e kishte shumë të rëndë dhe i dukej sikur truri po i rrokullisej në të si diçka e shkëputur. Nxori një shiringë dhe e zjeu në një furnelë të vogël elektrike. Uji gurgulloi një copë herë. Ai i kujtoi përroin e mëngjesit. Vetëm përroin dhe asgjë tjetër. Ua këputi kokat dy ampulave dhe e thithi lëngun e bardhë në tubin e shiringës. Ia bëri vetes injeksionin dhe u shtri në shtrat. Pas pak u ngrit, mori robdëshambrin e tij të vjetër dhe u mbulua me të. Iu duk vetja sikur ishte dymbëdhjetë vjeç, i lodhur e i braktisur në atë vetminë e çuditshme të rritjes dhe të rinisë.

*

* *

I doli gjumi tek kishte filluar të ngrysej. Një ngjyrë e zbehtë rozë nderej përmbi çatitë e shtëpive. Nga poshtë vinin zërat e Vizenhovit dhe të zonjës Goldberg. Ai nuk e kuptonte dot për çfarë po flisnin. Dhe as nuk donte ta merrte vesh. E ndiente veten si një njeri që kishte fjetur pasdreke, por që nuk ishte mësuar me këtë lloj gjumi – i shkëputur nga gjithë lidhjet me jetën dhe i gatshëm për një vetëvrasje të shpejtë e të pakuptimtë... Ah, të kisha të operoja tani! mendoi ai. Ndonjë rast të rëndë, pothuajse të pashpresë. Sakaq iu kujtua se s'kishte futur gjë në gojë gjatë gjithë ditës. Filloi ta gërryente uria. Dhimbja e kokës i kishte kaluar. U vesh dhe zbriti poshtë.

Marozovi rrinte në dhomën e vet përpara tryezës dhe po zgjidhte një problem shahu. Mëngët e këmishës i kishte përveshur gjer lart. Dhoma ishte pothuajse fare e zhveshur. Në një qoshe ishte vendosur një ikonë me një kandil. Në një qoshe tjetër ndodhej një tryezë e vogël me një samovar përsipër, dhe në qoshen e tretë ishte një frigorifer modern – luksi i vetëm dhe krenaria e Marozovit. Në të ai mbante vodkë, ushqime dhe birrë. Një sixhade turke qe shtrirë te këmbët e shtratit.

Marozovi u ngrit pa thënë gjysmë fjale dhe shkoi e mori dy gota dhe një shishe vodkë. Gotat i mbushi gjer në buzë.

– Marka *Subovka*, – tha ai.

Raviku zuri vend në tryezë.

– Nuk dua të pi, Boris. Kam vetëm shumë uri.

– Mirë. Eja të hamë bukë. Ndërkaq... – Marozovi nxori nga frigoriferi një copë bukë të zezë, turshi kastravecësh dhe një kavanoz të vogël me havjar – ... merr e ha nga këto! Havjari është një peshqesh i shefit të kuzhinës së *Sheherezades*. Është i mirë fort.

– Boris, – tha Raviku. – Të mos luajmë shumë teatër. Atë mikun e takova mu përpara *Osirisit*, e vrava në Pyllin e Bulonjës, dhe e varrosa në *Sen Zhërmen*.

– A të pa njeri?

– Jo. As përpara *Osirisit* s'kishte frymë njeriu.

– Asgjëkundi?

– Në pyll më kaloi afër një njeri, por kur kisha kryer punë. Atë e kisha në makinë brenda. Nuk mund të dallohej asgjë përveç makinës dhe meje, që po villja. Mund të mendohej që isha i dehur ose që më vinte të përzier. Asgjë e jashtëzakonshme.

– Po me plaçkat e tij ç'bëre?

– I groposa. Ia hoqa etiketat dhe monogramet rrobave dhe i dogja bashkë me dokumentet e tij. Mbajta vetëm paratë dhe një dëftesë për valixhen e tij që ndodhet në stacionin e trenit, në *Garë dy Nord*. Dhomën e hotelit e pati dorëzuar dhe kishte ndër mend të nisej sot në mëngjes.

– Këtij i thonë fat! Po shenjat e gjakut?

– Nuk pati shumë gjak. E lirova dhomën që kisha në *Prëns dë Gal*. Plaçkat i kam këtu. Ka shumë mundësi që njerëzit, me të cilët ai kishte pasur punë këtu, të mendojnë se është nisur. Po të tërhiqej edhe bagazhi nga stacioni, s'do të mbetej asnjë gjurmë e tij në Paris.

– Në Berlin do ta marrin vesh menjëherë që ai s'është kthyer dhe do të pyesin në Paris.

– Po të mos ndodhet bagazhi këtu, askush nuk do ta dijë në ç'drejtim është nisur.

– Do të dalë në shesh. Ai s'e ka përdorur biletën e vet të vagonit të fjetjes. A e dogje?

– Po.

– Atëherë digje edhe dëftesën e valixhes.

– Mund t'ia dërgonim zyrës së bagazheve, që ta nisë valixhen në Berlin ose diku gjetkë.

– Njëlloj është. Më mirë të digjet dëftesa. Po të tregohesh më finok nga ç'duhet, atëherë do të fillojnë të dyshojnë më shumë se tani. Kurse kështu ai mbetet thjesht i zhdukur. Në Paris ndodhin këso punësh. Do të bëjnë hetime dhe, në paçin fat, do ta gjejnë se ku është parë për herë të fundit. Në *Osiris*. Po ti a u fute brenda në lokal?

– Po. Vetëm për një minutë. E pashë të ulur atje. Por ai nuk më vuri re. Pastaj e prita jashtë. As jashtë nuk na pa njeri.

– Mund të pyesin se kush ndodhej në *Osiris* në të njëjtën kohë. Rolandës do t'i kujtohej që ke qenë ti.

– Unë shkoj shpesh atje. Kjo s'do të thotë gjë.

– E mira është që të mos të të pyesin fare. Je emigrant dhe s'ke asnjë dokument. A ta di Rolanda adresën?

– Ajo nuk e di që banoj këtu, por di adresën e Veberit. Ai është mjeku zyrtar, jo unë. Sidoqoftë, Rolanda largohet pas disa ditësh nga ajo punë.

– Do të dinë ku ta gjejnë. – Marozovi mbushi një gotë për vete. – Ravik, mendoj se është më mirë që të zhdukesh për disa javë.

Raviku e vështroi.

– Një fjalë goje, Boris. Po ku të mbytem?

– Shko diku ku ka shumë njerëz. Shko në Kanë ose në Dovil. Atje ka shumë rrëmujë tani dhe ti mund të jetosh ca kohë pa rënë në sy. Ose shko në Antibë. Atë vend ti e njeh mirë dhe atje s'të pyet kush për pasaportë. Kurse unë mund ta marr vesh në çdo kohë nga Veberi ose nga Rolanda nëse policia ka bërë hetime tek ata dhe nëse të ka kërkuar për dëshmitar.

Raviku tundi kokën.

– Më mirë të qëndrosh aty ku je dhe të jetosh sikur të mos ketë ndodhur asgjë.

– Jo. Këtë radhë s'është ashtu.

Raviku ia nguli sytë Marozovit.

– Nuk kam ndër mend t'ia mbath. Do të qëndroj këtu. Edhe kjo

hyn në kuadrin e jetës sime. A më kupton?

Marozovi nuk i ktheu përgjigje.

– Më parë digje atë dëftesën e valixhes së tij, – i tha Ravikut.

Raviku nxori dëftesën nga xhepi, i vuri flakën dhe e la të digjej mbi tavllën e duhanit. Marozovi e mori tavllën e bakërt dhe e hodhi hirin e imtë jashtë dritares.

– Mori fund edhe kjo. Ke gjëra të tjera të tijat me vete?

– Para.

– Pa t'i shoh.

Ai i pa mbarë e prapë kartëmonedhat. S'kishin shenja të veçanta.

– Këtyre u gjendet vendi kollaj. Ç'do t'i bësh?

– Mund t'i postoj në llogari të Fondit të Refugjatëve. Në mënyrë anonime.

– Shko e thyeji nesër dhe dërgoji pas dy javësh.

– Mirë.

Raviku i futi kartëmonedhat përsëri në xhep. Në kohën që i palosi, iu kujtua befas që kishte ngrënë me ato duar. U hodhi një shikim rrëshqitas duarve të veta. Çudi, ç'mendime i ishin vërtitur nëpër kokë sot në mëngjes! Mori një rriskë tjetër nga ajo buka e zezë dhe e freskët.

– Ku do të hamë darkë? – pyeti Marozovi.

– Kudo qoftë.

Marozovi e pa njëherë. Raviku buzëqeshi. Ishte hera e parë që po vinte buzën në gaz.

– Boris, – i tha. – Mos më shiko ashtu si një infermiere që merakoset se mos pacienti po i pëson krizë nervash. Unë zhduka një bishë, që meritonte një dënim mijëra e mijëra herë më të tmerrshëm. Gjatë jetës sime kam vrarë me dhjetëra njerëz, me të cilët s'më lidhte asgjë, e për këtë edhe më kanë dekoruar. Dhe unë i kam vrarë ata jo në një dyluftim të ndershëm, porse i kam përgjuar, u kam zënë pritë, i kam qëruar pas shpine, kur nuk e prisnin fare – dhe, meqë ishte luftë, ky veprim quhej nder e lavdi. E vetmja gjë që më mbeti peng për disa minuta, ishte që s'arrita dot t'ia përplasja atij maskarai në surrat dufin dhe mllefin tim të ndrydhur, përpara se ta vrisja; natyrisht që kjo ishte një dëshirë prej idioti. Ai mori fund tani dhe nuk ka për të torturuar më njerëz, dhe unë ia këputa një gjumi pas gjithë kësaj meseleje, dhe e tëra kjo ka mbetur tani aq prapa meje, saqë po më duket sikur e kam lexuar në gazetë.

– Në rregull. – Marozovi mbërtheu xhaketën. – Atëherë eja të

dalim. – Më ka hipur qejfi të pi.

Raviku ngriti sytë.

– Ty kështu?

– Po, mua! – tha Marozovi. Ai ngurroi për një sekondë. – Sot është hera e parë që po e ndiej veten të plakur.

31

Festa e organizuar me rastin e largimit të Rolandës filloi në orën gjashtë fiks dhe zgjati vetëm një orë. Në orën shtatë fillonte puna e përnatshme.

Tryeza ishte shtruar në njërën prej sallave anësore. Të gjitha prostitutat ishin të veshura. Më të shumtat me fustane të zeza mëndafshi. Raviku, që ishte mësuar t'i shihte gjithmonë lakuriq ose vetëm me ndonjë tyl të hollë përsipër, hoqi zor t'i njihte disa prej tyre. Vetëm nja një gjysmë duzine syresh ishin lënë në sallën e madhe, si repart rezervë për rast nevoje. Ato do të ndërroheshin në orën shtatë dhe do t'u shtrohej darka veçan. Asnjëra s'do të paraqitej me veshje profesionale. Ky nuk ishte ndonjë udhëzim i padrones – vetë vajzat e deshën kështu. Raviku as që kishte pritur të ndodhte ndryshe. Ai e njihte etiketën e prostitutave; ajo ishte më e rreptë sesa etiketa e shoqërisë së lartë.

Vajzat kishin shtënë para dhe i kishin blerë Rolandës gjashtë karrige kashte për restorantin e saj. Padronia i kishte dhuruar një makinë automatike për arkëtimin e të hollave, kurse Raviku dy tryeza mermeri, që shkonin me karriget e kashtës. Ai ishte i vetmi i ftuar i jashtëm në këtë festë dhe i vetmi mashkull.

Darka filloi të shërbehej pesë minuta pas orës gjashtë. Madama, padronia, rrinte në krye të tryezës. Nga e djathta e saj kishte zënë vend Rolanda dhe nga e majta, Raviku. Pastaj vinin guvernantja e re, ndihmësja e saj dhe çupat me radhë.

Antipastat ishin të hatashme. Mëlçi pate alla Strasburg, pate shtëpie shoqëruar me *Sherribrand* të vjetër. Ravikut i vunë përpara një shishe vodkë. Nga *Sherribrandi* i vinte neveri. Pastaj sollën karavidhe.

Dhe pastaj peshk shojzë me verë *Mërso* të vitit 1933. Peshku ishte po aq i shijshëm sa edhe në restorantet më të shtrenjta. Vera ishte e lehtë dhe e vjetruar jo më shumë se ç'duhej. Erdhën asparagët e hollë, të gjelbër. Pastaj zogj pule të pjekur në hell që të shkriheshin në gojë, një sallatë e zgjedhur me pak hudhër dhe verë *Shato St. Emilion*. Në krye të tryezës plasi tapa e një shisheje *Romane Konti* e vitit 1921, që u pi me një frymë.

– Çupat nuk dinë ta shijojnë këtë, – shpalli Madama. Kurse Raviku dinte ta shijonte. Atij i vunë një shishe të dytë përpara. Për këtë ai hoqi dorë nga shampanja dhe nga krem-çokollata. _Bashkë me Madamën iu përvesh një djathi të shkrirë, që shkonte shumë mirë me atë farë vere e me pak bukë të bardhë të freskët.

Të dëgjoje muhabetin rreth tryezës, do të thoshe se ishe në një internat vajzash. Karriget e kashtës qenë stolisur me kordele. Arka automatike shkëlqente. Tryezat prej mermeri llamburisnin. Mallëngjimi në atë sallë ishte pothuajse i prekshëm. Madama qe veshur krejt në të zeza. Kishte vënë brilante. Jo shumë. Vetëm një broshë dhe një unazë. Gurë të zgjedhur të një bardhësie të kaltër. Në kokë nuk kishte vënë ndonjë diademë, megjithëse qe bërë konteshë. Nuk mund të thoshe se ishte një grua pa shije. Madama parapëlqente vetëm brilantet. Ajo thoshte se rubinët dhe smeraldët ishin punë me zarar, kurse diamantet – gjithmonë të sigurt. Kuvendonte me Rolandën e me Ravikun. Kishte lexuar shumë libra gjatë jetës së saj. Muhabetin e kishte tërheqës, të rrjedhshëm dhe gjithë espri. Citonte Montenjin, Shatobrianin dhe Volterin. Fytyrën, me ato tiparet e mençura dhe ironike, ia qarkonin flokët e thinjur e pak të ngjyrosur në të kaltëremë.

Në orën shtatë, pasi u servir edhe kafeja, vajzat u ngritën nga tryeza si nxënëse të dëgjueshme internati. Ato e falënderuan me mirësjellje Madamën dhe u përshëndetën me Rolandën. Madama qëndroi edhe një copë herë. Porositi t'i sillnin një shishe *Armanjak*. Konjak aq të mirë Raviku s'kishte pirë kurrë në jetën e vet. Reparti rezervë, që kishte qenë në shërbim, erdhi në sallë, larë e rregulluar, lyer me të kuq buzësh e pudër më pak sesa gjatë punës dhe veshur me fustane mbrëmjeje. Madama priti gjersa vajzat zunë vend dhe filluan nga antipasta. Ajo shkëmbeu me secilën nja dy tri llafe dhe i falënderoi që kishin sakrifikuar një orë për të qenë në punë. Pastaj u nda prej të pranishmëve gjithë hir e nur.

– Do të shihemi, Rolandë, përpara se të shkoni?

– Patjetër, madamë!

– A mund t'jua lë këtu *Armanjakun*? – e pyeti ajo Ravikun.

Raviku e falënderoi. Madama u largua, nga majë e kokës e gjer te thembra e këmbës zonjë e madhe.

Raviku e zuri shishen prej gryke dhe shkoi e u ul pranë Rolandës.

– Kur do të nisesh? – e pyeti.

– Nesër pasdreke në orën katër e shtatë minuta.

– Do të vij në stacion.

– Jo, Ravik. Nuk bën. I fejuari im mbërrin sonte në darkë. Do të nisemi bashkë nesër. Ti e kupton, pra, që nuk bën të vish. Ai do të habitej.

– Natyrisht.

– Nesër paradreke duam të blejmë edhe ca gjëra e t'i nisim përpara se të ikim vetë. Sonte do të largohem që këtej dhe do të zë një dhomë në hotelin *Belfor*. Është hotel i mirë, i lirë dhe i pastër.

– Edhe ai në atë hotel do të rrijë?

– Natyrisht që jo, – tha Rolanda duke treguar habi të madhe. – Ne akoma s'jemi martuar.

– Shumë e drejtë.

Raviku ishte i bindur se këto nuk ishin llafe boshe, sa për t'u shtirur. Rolanda ishte një borgjeze, që kishte pasur një vend pune. Në kishte punuar në një internat vajzash apo në një bordel, kjo ishte njëlloj. Ajo kishte përmbushur detyrën e saj dhe tani kjo punë kishte marrë fund, dhe ajo po kthehej përsëri në ambientin e saj borgjez pa pasur mbi vete as gjurmën më të vogël të ambientit të mëparshëm. Po kështu ndodhte edhe me shumicën e prostitutave. Disa syresh bëheshin bashkëshorte shembullore. Të ishe prostitutë, ishte për ato një zanat serioz, jo mëkat dhe as ves. Nganjëherë gjëja më e sigurt, për të mos mbetur pa punë e pa bukë.

Rolanda mori shishen e *Armanjakut* dhe i mbushi Ravikut një gotë tjetër. Pastaj nxori një copë letër nga çanta.

– Në qoftë se të mbushet mendja ndonjëherë të ikësh nga Parisi, ja tek i ke adresat tona. Mund të vish kur të duash.

Raviku i hodhi një sy letrës.

– Janë dy adresa, – tha ajo. – Njërën e ke për dy javët e para. Është e imja. Pastaj do të të duhet adresa e të fejuarit tim.

Raviku e futi letrën në xhep.

– Falemnderit, Rolandë. Hëpërhë do të rri në Paris. Po, përveç kësaj, i fejuari yt do të mbetej me siguri i habitur, po t'i mbija unë ashtu pa pritur e pa kujtuar përpara sysh.

– Këtë ma thua, sepse nuk desha që të vish në stacion nesër? Por kjo është një çështje krejt tjetër. Adresat po t'i jap që t'i kesh për çdo rast, në u detyrofsh të largohesh nga Parisi. Domethënë të largohesh shpejt e shpejt. Prandaj po t'i jap.

Ai ngriti sytë.

– Po pse kështu?

– Ravik, – i tha ajo. – Ti je refugjat. Dhe refugjatëve u dalin nganjëherë telashe. Prandaj është mirë kur njeriu e di se ku mund të fusë kokën, pa u ngatërruar fare me policinë.

– Nga e di ti që jam refugjat?

– E di. Por nuk ia kam thënë askujt. Këtë nuk ka pse ta dijë kush këtu te ne. Ruaji adresat që të dhashë. Dhe, po t'u deshën ndonjëherë, eja pa frikë. Te ne s'të pyet njeri, kush je, nga vjen e ku shkon.

– Mirë. Falemnderit, Rolandë.

– Përpara dy ditësh erdhi një i policisë këtu te ne. U interesua për një gjerman. Donte të dinte në kishte qenë në lokalin tonë.

– Ashtu? – ia bëri Raviku, i tëri vesh.

– Po. Radhën e fundit që kalove ti këtej, ishte edhe ai këtu. Ndoshta ty s'të kujtohet fare. Ishte një trashaluq tullac. Qe ulur matanë, me Ivonën dhe me Klerin. Policia pyeti në kishte qenë këtu dhe kush tjetër ndodhej në lokal, përveç tij.

– S'më bie ndër mend fare, – tha Raviku.

– Me siguri që as që e ke vënë re. Natyrisht unë nuk e bëra fjalë fare me atë të policisë që atë natë ishe edhe ti këtu, qoftë edhe për dy minuta.

Raviku tundi kokën në shenjë pohimi.

– Më mirë kështu, apo jo? – tha Rolanda. – Në këtë mënyrë nuk u jepet rasti atyre polove që të pyesin njerëz të pafajshëm në kanë apo s'kanë pasaportë.

– Natyrisht. Të tha gjë, pse interesohej për atë mikun?

Rolanda ngriti supet.

– Jo. Edhe neve as që na duhen këto punë. I thashë vetëm që këtu nuk ka qenë njeri. Ky është një rregull i vjetër te ne. Kurrë nuk dimë gjë. Është më mirë kështu. Por as ai s'para dukej si shumë i interesuar.

– Vërtet?

Rolanda vuri buzën në gaz.

– Ravik, ka shumë francezë që nuk e çajnë kokën se ç'bëhet me një turist gjerman. Na mjaftojnë andrallat tona. – Ajo u ngrit nga karrigia. – Më duhet të shkoj tani. Mirëmbetsh, Ravik!

– Mirëmbetsh, Rolandë! Pa ty do të jetë krejt ndryshe këtu.

Ajo qeshi:

– Vetëm për pak kohë, ndoshta. Pastaj jo më.

Ajo shkoi për t'u përshëndetur me vajzat. Në ecje e sipër u hodhi edhe një sy arkës automatike, karrigeve dhe tryezave. Ishin dhurata praktike. Ajo qysh tani po i përfytyronte sesi do të dukeshin në kafenenë e saj. Sidomos ajo makina automatike për arkëtimin e të hollave. Ajo simbolizonte të ardhura, siguri, vatër familjare dhe mirëqenie. Rolanda ngurroi për një çast; por pastaj nuk mundi t'i bënte më ballë tundimit. Nxori disa monedha metalike nga çanta e vet, i vuri pranë makinës që xixëllonte dhe filloi t'u binte tastierave. Makina gumëzhiti, regjistroi tetë franga e pesëdhjetë, sirtari i vogël u hap me rrëmbim dhe Rolanda arkëtoi paratë e veta me një buzëqeshje të lumtur fëmijërore në fytyrë.

Vajzat iu afruan me kureshtje makinës dhe e qarkuan. Rolanda arkëtoi një shumë tjetër – këtë radhë një frangë e shtatëdhjetë e pesë.

– Ç'mund të marrësh te ju me një frangë e shtatëdhjetë e pesë? – e pyeti Margerita, të cilën zakonisht e thërrisnin Pela.

Rolanda u mendua pak.

– Një *Dybone* ose dy *Perno*.

– Sa kushton një birrë?

– Shtatëdhjetë qindarka. – Rolanda lëvizi dorezën e aparatit.

– Lirë, – tha Pela.

– Duhet të jemi më të lirë se këtu në Paris, – deklaroi Rolanda.

Vajzat vendosën karriget e kashtës rreth tryezave prej mermeri dhe u ulën në to me kujdes. Rregulluan fustanet e tyre të mbrëmjes dhe u shndërruan përnjëherësh në klientë të kafenesë së ardhshme të Rolandës...

– Madamë Rolandë, dëshirojmë tre çaj me biskota angleze! – tha Dejzi, një biondinë delikate, të cilën e pëlqenin veçanërisht burrat e martuar.

– Shtatë franga e tetëdhjetë. – Rolanda vuri në veprim makinën llogaritëse. – Më vjen keq, por biskotat angleze janë shumë të shtrenjta!

Margerita, Pela, në tryezën aty pranë, ngriti kokën dhe balli i rrudhur rrëfente që po e vriste mendjen shumë.

– Dy shishe *Pomeri*! – porositi ajo më në fund. Margerita e donte shumë Rolandën dhe këtë deshi ta manifestonte disi.

– Nëntëdhjetë franga. Është shampanjë fort e mirë!

– Edhe katër konjakë! – hingëlliti Pela. – Sot kam ditëlindjen.

– Katër franga e dyzet. – Aparati tringëlloi.

– Edhe katër kafe me ajkë!

– Tre franga e tridhjetë.

Pela, e entuziazmuar, ia zgurdulloi sytë Rolandës. Nuk dinte ç'të porosiste më.

Vajzat u ngritën dhe filluan të shtyheshin rreth makinës.

– Sa bëjnë të gjitha këto, madamë Rolandë?

Rolanda u rrëfeu shiritin e letrës me shifrat e regjistruara.

– Njëqind e pesë franga e tetëdhjetë.

– Dhe sa keni fitim nga këto?

– Nja tridhjetë franga. Shampanja ngre peshë. Prej saj nxirret shumë fitim.

– Bukur! – briti Pela. – Bukur fort! Kështu fitofshi gjithmonë!

Rolanda u kthye te Raviku. Sytë i ndritnin, ashtu siç mund të ndrisin sytë vetëm nga dashuria ose nga tregtia.

– Mirëmbetsh, Ravik! Mos e harro atë që të thashë.

– Jo. Mirëmbetsh, Rolandë!

Ajo u largua me hap të fortë e trupin drejt – për të e ardhmja ishte e thjeshtë dhe jeta e bukur.

*

* *

Raviku po rrinte me Marozovin në lokalin *Foket'sit*. Ishte ora nëntë e mbrëmjes. Tarraca ishte plot e përplot me njerëz. Tutje, përtej Harkut, llamburitnin dy fanarë me një dritë të bardhë, shumë të ftohtë.

– Minjtë po ikin nga Parisi, – tha Marozovi. – Në *Internacional* u boshatisën tri dhoma përnjëherësh. Qysh nga viti 1933 s'ka ndodhur më një gjë e tillë.

– Do të vijnë të tjerë emigrantë e do t'i zënë.

– Çfarë emigrantësh? Ne kemi pasur këtu rusë, italianë, polakë, spanjollë, gjermanë...

– Francezë, – tha Raviku. – Do të vijnë nga kufiri. Refugjatë. Njëlloj si gjatë luftës së kaluar.

Marozovi ngriti gotën dhe vuri re që ishte e zbrazur. Ai i bëri shenjë kamerierit:

– Edhe një brokë *Puji*!

Pas pak iu drejtua Ravikut:

– Po ti, si e ke hallin, Ravik?

– E ke fjalën, në rolin tim të miut?

– Po.

– Sot edhe minjve u nevojiten pasaporta dhe viza.

Marozovi e vështroi me qortim.

– Mos ke pasur gjer tani dokumente? E megjithatë ke qenë në Vjenë, Zyrih, Spanjë dhe Paris. Tani ka ardhur koha që të avullohesh që këtej.

– Ku të shkoj? – pyeti Raviku. Ai mori brokën që solli kamerieri. Qelqi ishte i ftohtë dhe i veshur. I mbushi të dyja gotat me atë verë të lehtë. – Në Itali? Atje Gestapoja të pret mu në kufi. Në Spanjë? Atje të presin frankistët.

– Në Zvicër.

– Zvicra është tepër e vogël. Në Zvicër kam qenë tri herë. Dhe çdo herë, pas një jave, më ka zënë policia e më ka kthyer në Francë.

– Në Angli. Hidhu matanë kontrabandë që nga Belgjika.

– E pamundur. Të kapin në port e të nisin përsëri fishek për në Belgjikë. Dhe Belgjika nuk është vend për emigrantë.

– Në Amerikë nuk ke mundësi të shkosh. Po në Meksikë?

– Meksika është mbushur deng me njerëz të kallëpit tonë. Por edhe atje të kërkojnë, të paktën, njëfarë dokumenti.

– Ti s'ke asnjë?

– Kisha disa certifikata lirimi, që m'i patën lëshuar nëpër burgjet, ku qëndrova me emra të ndryshëm për kalim kufiri ilegalisht. Por këso dokumentesh nuk të bëjnë punë. Unë i grisja të gjitha, sapo dilja.

Marozovi heshti.

– Edhe arratisja mori fund, Boris plaku, – tha Raviku. – Dikur merr fund edhe ajo.

– Ti e ke të qartë se çfarë do të ndodhë këtu, po të shpërthejë lufta?

– S'do mend! Kamp përqendrimi francez. S'do të jetë i mirë, sepse nuk kanë përgatitur asgjë.

– E pastaj?

Raviku ngriti supet.

– Nuk duhet vrarë mendja shumë se ç'do të ndodhë në të ardhmen.

– Mirë. Po a e di ti se ç'mund të ndodhë, po të bëhet këtu ndonjë katrahurë dhe ti të gjendesh brenda në kamp të përqendrimit? Mund të të zënë gjermanët!

– Mua dhe shumë të tjerë. Ndoshta. Por ndoshta edhe na lëshojnë në kohën e duhur. E kush mund ta dijë?

– E pastaj?

Raviku nxori nga xhepi një cigare.

– Le ta lemë këtë muhabet, Boris. Unë s'mund të dal jashtë Francës. Kudo gjetkë është rrezik ose e pamundur. Pastaj, as unë vetë s'kam qejf të shkoj më gjëkundi.

– Nuk paske qejf të shkosh më gjëkundi?

– Jo. Jam menduar gjatë për këtë. Por s'kam si të ta shpjegoj. As që mund të shpjegohet. S'dua të shkoj më gjëkundi.

Marozovi nuk foli dhe vështroi mizërinë e njerëzve.

– Qenka edhe Xhoana këtu, – tha ai.

Ajo qe ulur me një burrë, mjaft larg prej tyre, në një tryezë nga ana e *anënysë Zhorzh V.*

– A e njeh atë mashkull? – e pyeti Marozovi Ravikun.

Raviku vështroi në drejtimin e rrëfyer.

– Jo.

– Duket se i ndërroka shumë shpejt.

– Ajo ndjek jetën, – tha Raviku me mospërfillje. – Ashtu si më të shumtët nga ne. Rend dhe mezi mbushet me frymë, se mos i shpëtojë gjë.

– Mund ta quash edhe ndryshe.

– Posi jo. Por mbetet po ajo gjë. Shqetësim i përhershëm, plakushi im. Sëmundja e këtyre njëzet e pesë vjetëve të fundit. Askush nuk e beson më se do të mund të plaket në paqe me atë që ka kursyer. Çdokush e nuhat erën e shkrumbit dhe përpiqet të gllabërojë ç'të mundet. Kurse ti jo. Ti je filozof zbavitjesh të thjeshta.

Marozovi nuk i dha përgjigje.

– Ajo nuk ka haber fare nga kapelat, – tha Raviku. – Vështro se ç'ka vënë në kokë! Përgjithësisht nuk ka shije. Dhe këtu qëndron forca e saj. Kultura të dobëson. Në fund të fundit, njeriu arrin prapë vetëm tek instinkti lakuriq i jetës. Ti vetë je një shembull i shkëlqyer për këtë që po të them.

Marozovi u zgërdhi.

– Lërmi gëzimet e mia të ulëta, ti shtegtar lartësish! Ai që ka një shije të thjeshtë, atij i pëlqejnë shumë gjëra në botë. Duarbosh nuk mbetet kurrë. Ai që i ka të gjashtëdhjetat mbi kurriz dhe rend pas dashurisë, është një idiot që kërkon të fitojë me zor, kur të tjerët luajnë bixhoz me kartëra të shenjëzuara. Një bordel i mirë i fal paqe shpirtit. Shtëpia që frekuentoj unë, ka gjashtëmbëdhjetë gra të reja. Me pak para unë e ndiej veten atje si pasha. Përkëdhelitë që më dhurohen, janë më të vërteta se ato, pas të cilave jargaviten shumë sklle-

vër të dashurisë. Dëgjon? Skllevër të dashurisë, po të them!

– E kuptova, Boris.

– Në rregull. Atëherë na lër t'i japim fund kësaj vere të ftohtë e të lehtë. Dhe na lër të mbushemi me ajrin e sermtë të Parisit, përderisa nuk na e kanë prishur akoma.

– Ashtu do të bëjmë. E ke vënë re që gështenjat po lulëzojnë këtë vit për të dytën herë?

Marozovi pohoi me krye. Ai rrëfeu me dorë qiellin ku, i kuqërremtë dhe i madh, vezullonte përmbi çatitë e errëta ylli Mars.

– Po. Dhe thonë se ai ylli atje ka shumë kohë që nuk ndodhet kaq pranë Tokës sa sivjet. – Ai qeshi. – Së shpejti do të lexojmë ndër gazeta se diku ka lindur një fëmijë me një nishan si shpatë. Dhe se në një vend tjetër ka rënë shi gjaku. Tani mungon vetëm Kometa e mesjetës, që të plotësohen të gjitha profecitë!

– Kometën e kemi këtu. – Raviku tregoi shkronjat prej drite përmbi godinën e gazetës, që dukeshin sikur ndiqnin papushim njëra-tjetrën, dhe turmën që qëndronte e heshtur përpara saj, me kokat ngritur përpjetë.

Ata ndenjën ca kohë pa folur. Një djalosh me fizarmonikë u ngul buzë trotuarit dhe ekzekutoi *La Palomën*. Qilimashitësit me *keshanët* e lirë mbi supe ia behën aty, dhe një çunak zuri të shiste fëstekë midis radhëve të tryezave. Gjithçka ishte ashtu siç kishte qenë gjithmonë – gjersa erdhën me nxit gazetashitësit me botimet e fundit. Gazetat ua përlanë menjëherë nga duart dhe, disa sekonda më vonë, tarraca, me gjithë ato gazeta të shpalosura, dukej sikur qe varrosur nën një mori tenjash vigane, të bardha e pa gjak, që, duke rrahur flatrat, ishin kapërthyer me epsh pas viktimave të tyre.

– Ja tek po ikën Xhoana, – tha Marozovi.

– Ku është?

– Atje përkarshi.

Xhoana po i binte rrugës tërthor, drejt një veture të zbuluar ngjyrëjeshile, që ishte parkuar nga ana e *Shans-Elizesë*. Ajo nuk e pa Ravikun. Burri që e shoqëronte, i ra qark veturës dhe u ul në timon. Ai nuk mbante kapelë dhe ishte mjaft i ri. E manovroi makinën me kujdes dhe e nxori jashtë të tjerave. Ishte një veturë e markës *Dëlahaj*.

– Makinë e bukur, – tha Raviku.

– Goma të mira, – ia priti Marozovi dhe turfulloi. – Ravik i urtë prej çeliku! – shtoi me inat. – I nxjerrë jashtë ringut dhe me tabiate prej evropiani qendror!... Makinë e bukur! Të kishe thënë "zuskë e mallkuar", këtë po do ta kisha kuptuar!

Raviku vuri buzën në gaz.

– Ç'punë prish kjo? Zuskë apo shenjtore... Çështja është se ç'formë i japim ne këtij brumi. Ti, o njeri me gjashtëmbëdhjetë gra, mysafir paqësor bordeli, nuk e kupton dot këtë!... Dashuria nuk është bakall, që kërkon t'ia kthesh mbeturinat. Dhe fantazisë i nevojiten vetëm disa gozhdë, që të varë vellot e saj në to. Asaj nuk i prish punë një janë gozhdë prej floriri, teneqeje apo të ndryshkura. Atje ku plekset, plekset. Ferrat dhe trëndafilat... po t'u bjerë përsipër velloja prej rrezesh hëne e sedefi, kthehen që të dyja në përralla nga ato të një mijë e një netëve.

Marozovi piu një gllënjkë verë.

– Po flet ca si shumë, – tha ai. – Përveç kësaj, të gjitha këto nuk janë të vërteta.

– E di. Por në errësirën e plotë edhe një dritë e rreme është dritë, Boris.

Freskia po afrohej mbi këmbka të sermta tej nga Sheshi i Yllit. Raviku vuri dorën mbi qelqin e veshur të gotës së verës. Ajo ishte e ftohtë nën dorën e tij. Jeta ishte e ftohtë nën zemrën e tij. Dihatja e thellë e natës ia përshkonte zemrën dhe, bashkë me të, vinte edhe ajo mospërfillja e thellë ndaj fatit. Ndaj fatit dhe ndaj së ardhmes. Kur e pati provuar edhe një herë tjetër një ndjenjë të tillë? Ah, po, në Antibë! Atëherë kur e kuptoi që Xhoana do ta braktiste. Ishte një mospërfillje që kthehej në një shkujdesje të plotë. Njëlloj si vendimi për të mos u arratisur, për të mos ikur më. Që të dyja këto ndjenja shkonin bashkë. Ai kishte provuar hakmarrjen dhe dashurinë. Dhe kjo ishte mjaft. Nuk ishte gjithçka, por ishte aq sa ç'mund të kërkonte një burrë. Për të dyja ai i kishte pasë humbur shpresat. Haken e kishte vrarë dhe nga Parisi nuk kishte ikur. Dhe as që do të ikte. Kush shfrytëzonte një shans, edhe mund të humbiste një shans. Kjo nuk kishte të bënte me dorëzimin ndaj fatit; dëshmonte më tepër për qetësinë që të falte një vendim, i marrë jashtë logjikës. Lëkundja kthehej në mbështetje. Diçka ishte rregulluar. Njeriu priste, mblidhte veten dhe vështronte përreth. Ishte si një besim mistik, një pauzë në ekzistencë. Asgjë nuk kishte më rëndësi. Të gjithë lumenjtë pushonin së vërshuari. Një liqen ngrinte pasqyrën e vet drejt natës, dhe mëngjesi do ta tregonte se ku do të derdhej...

– Më duhet të ngrihem tani, – tha Marozovi dhe vështroi orën.

– Mirë. Unë po rri edhe pak, Boris.

– Kërkon të marrësh me vete mbrëmjet e fundit përpara se të prishet bota, ë?

– Tamam. Të gjitha këto nuk do të kthehen më.

– Kaq keq po të ardhka?

– Jo. As ne nuk kthehemi më. E djeshmja vate e shkoi, dhe as lotët e as përgjërimet nuk mund ta kthejnë dot më.

– Je duke llapur shumë. – Marozovi u ngrit nga karrigia. – Duhet të jesh mirënjohës që po përjeton fundin e një shekulli. S'ishte aspak shekull i bukur.

– Por ishte shekulli ynë, ama! Je duke llapur pak, Boris.

Marozovi e rrëkëlleu fundin e gotës së vet në gurmaz, ashtu në këmbë siç ishte. Pastaj e vuri me aq kujdes në vend, sikur të ishte prej dinamiti, dhe fshiu mjekrën me pëllëmbë. Ishte veshur civil dhe qëndronte madhështor e vigan përpara Ravikut.

– Mos kujto që unë s'e kuptoj, pse s'do që të largohesh nga Parisi, – ia bëri ai, duke i theksuar fjalët me avash. – E marr vesh shumë mirë, pse s'ke qejf të shkosh më gjëkundi, mor saldator kokallash, mor fatalist!

*

* *

Raviku u kthye herët në hotel. Në paradhomë i zunë sytë një krijesë të vogël e të humbur që rrinte ulur atje dhe që, me ta parë, kërceu nga kanapeja me një lëvizje të çuditshme të të dyja duarve dhe gjithë emocion. Ai vuri re se njëri pantallon s'kishte këmbë brenda. Një cung druri, i pistë dhe i ngrënë, dallohej përposh pantallonit në vend të këmbës.

– Doktor!... Doktor!...

Raviku e vështroi më me vëmendje. Në dritën e turbullt të paradhomës dalloi fytyrën e një djaloshi, një fytyrë që i qeshte me buzët vesh më vesh.

– Zhanoi! – ia bëri Raviku me habi. – Zhanoi dora vetë!

– Tamam! Kokë e këmbë unë! Kam tërë mbrëmjen që po rri e po ju pres këtu. Sot pasdreke arrita ta marr vesh më në fund adresën tuaj. Isha përpjekur disa herë me radhë t'ia nxirrja asaj shtrigës plakë, kryeinfermieres së klinikës. Por gjithmonë ajo më përcillte, duke më thënë se nuk ndodheshit më në Paris.

– Për një kohë të gjatë s'kam qenë vërtet këtu.

– Kurse sot pasdreke begenisi të ma tregojë që banonit këtu. Atëherë erdha menjëherë t'ju takoja. – Zhanoit i ndriste e tërë fytyra.

– Mos ke dhimbje në këmbën e operuar? – e pyeti Raviku.

– Aspak! – Zhanoi i ra cungut prej druri, si t'i përkëdhelte kurrizin një qeni besnik. – Aspak! Çdo gjë në rregull.

Raviku vështroi cungun.

– Po shoh se e paske marrë atë që deshe. Po me sigurimet shoqërore si dole?

– Jo keq. Ata më aprovuan një këmbë mekanike. Paratë për të i mora nga dyqani që i shiste dhe i futa në xhep me pesëmbëdhjetë për qind zbritje. Çdo gjë në rregull!

– Po ajo puna e bulmetores sate si u bë?

– Prandaj kam ardhur. Ne e hapën dyqanin tonë. Vërtet është ca i vogël, por punën e bën dhe ne ia dalim mbanë. Nëna shet, kurse unë merrem me furnizimin e me llogarinë. Kam gjetur baza të mira. Furnizohem drejtpërdrejt nga fshati.

Zhanoi u kthye duke çaluar te kanapeja e vjetruar dhe mori që andej një pako me letër ngjyrëkafe, të lidhur mirë.

– Urdhëroni, doktor! Është për ju. Jua solla dhuratë. Nuk është kushedi se çë. Por rëndësi ka që janë të gjitha nga bulmetorja jonë... buka, gjalpi, djathi, vezët. Kur njeriu s'ka qejf të dalë ndonjëherë nga shtëpia, mund të rregullojë me to një darkë shumë të mirë, apo jo? – Zhanoi hetoi me ngulm në sytë e Ravikut.

– Kjo që thua ti, nuk është ndonjëherë, por përherë një darkë e mirë, – i tha Raviku.

Zhanoi tundi kokën i kënaqur.

– Shpresoj se do ta pëlqeni djathin. Është nga llojet *Bri* dhe *Po l'Evek*.

– Këta i kam nga më të preferuarit!

– Hata fare! – Nga kënaqësia Zhanoi i ra me forcë pjesës që i kishte mbetur nga këmba e prerë. – Për *Po l'Evekun* i vajti mendja nënës. Kurse unë mendoja se *Brinë* do ta pëlqenit më shumë. Ai është tamana djathë për burra!

– Të dy llojet janë të mrekullueshme. Më mirë s'kishit si të zgjidhnit. – Raviku ia mori pakon. – Falemnderit, Zhano! Nuk ndodh shpesh që pacientët të kujtohen për mjekun e tyre. Në më të shumtën e rasteve ata vijnë vetëm për të bërë ndonjë pazarllëk në lidhje me llogarinë.

– Të pasurit, po! – Zhanoi tundi kokën, si një burrë i madh i rrahur me vaj e me uthull. – Kurse ne jo. Fundja, për gjithçka jua dimë për nder juve. Sikur këmba të më kishte mbetur vetëm e paralizuar, s'do të na paguanin pothuajse asgjë.

Raviku ia nguli sytë. Mos pandeh ky, se ia paskam prerë këm-

bën për t'i bërë një nder? mendoi ai.

– S'kishim rrugë tjetër, Zhano. Duhej të ta operonim medoemos, – i tha djaloshit.

– Sigurisht. – Zhanoi ia shkeli syrin. – E qartë. – Ai ngjeshi kasketën, duke e ulur strehën gjer mbi sy. – Atëherë, unë po ia mbath tani. Nëna po më pret. U vonova shumë. Dua të takoj edhe një njeri për një porosi të re. Mirupafshim, doktor! Shpresoj se do t'ju shijojnë.

– Mirupafshim, Zhano! Falemnderit dhe paç fat!

– Fatin e kemi në xhep.

Djaloshi i imët doli, duke luajtur sa me duar e me këmbë e me cung.

*

* *

Sa hyri në dhomën e vet, Raviku e çmbështolli pakon. Kërkoi dhe gjeti një furnelë të vjetër që punonte me alkool dhe që nuk e kishte përdorur prej vitesh. Diku gjeti edhe një tigan të vogël. E ndezi furnelën. Flaka e ngushtë blu lodroi përpjetë. Ai hodhi një copë gjalpë në tigan, theu dy kokrra vezë dhe i trazoi me gjalpë. Pastaj preu disa rriska nga buka e bardhë e freskët, shtroi disa gazeta mbi tryezë dhe vuri mbi to tiganin; hapi pakon e djathit *Bri*, mori edhe një shishe *Vuvrej* dhe u shtrua të hante. Kishte kohë që nuk e kishte bërë këtë marifet. Vendosi që qysh nesër të blinte disa pako me shpirto të thatë. Furnelën mund ta merrte shumë kollaj me vete, po të vinte puna që ta degdisnin në ndonjë kamp përqendrimi. Ishte një furnelë e çmontueshme.

Raviku hëngri ngadalë. E provoi edhe djathin tjetër. Zhanoi kishte pasur të drejtë – ishte një darkë shumë e mirë.

32

-Ikja nga Egjipti! – tha doktori i filologjisë e i filozofisë, Zajdenbaumi, duke iu drejtuar Ravikut dhe Marozovit. – Por pa Moisiun, ama!

Ai qëndronte ashtu i gjatë, i hollë e verdhacuk pranë portës së *Internacionalit*. Përjashta, familjet Shtern dhe Vagner si edhe beqari Shtolc, po ngarkonin plaçkat e tyre. Ata kishin marrë bashkërisht një kamion me qira.

Atë pasdreke të kthjellët gushti ishin nxjerrë në rrugë disa orendi. Një divan me pjesët e drunjta të lyera me varak, disa kolltukë, gjithashtu të lyer me varak, dhe një qilim i ri, nga ata që prodhoheshin në Obyson. Këto të gjitha ishin pronë e familjes Shtern. Një tryezë e madhe prej mogani po bartej në atë kohë. Selma Shterni, një grua me fytyrë të vyshkur e me ca sy si prej kadifeje, po kujdesej për të si klloçka për zogjtë e saj.

– Kujdes pllakën! Mos e gërvishtni! Kujdes! Kujdes!

Pllaka e tryezës ishte e lustruar si pasqyrë. Ajo ishte një nga ato gjërat e shenjta, për të cilat amvisat rrezikojnë edhe jetën. Selma Shterni sillej e përdridhej rretheqark tryezës dhe dy hamejve, që po e bartnin krejtësisht mospërfillës dhe që, më në fund, e lëshuan jashtë në rrugë.

Dielli binte mbi pllakën. Selma u përkul dhe i ra me një leckë përsipër. Pllaka, si një pasqyrë e errët, ia reflektonte fytyrën e zbehtë, dhe dukej sikur një paraardhëse mijëvjeçare e saj po e shikonte me vështrim pyetës që nga Pasqyra e Kohës.

Hamejtë u dukën përsëri në prag të portës, ngarkuar me një bufe po prej mogani. Edhe ajo ishte po ashtu e lustruar. Njëri nga

hamejtë e mori kthesën më parë nga ç'duhej dhe njëra qoshe e bufesë u përplas pas portës së hotel *Internacionalit* dhe u gërvisht.

Selma Shterni nuk ia dha ulërimës. Ajo mbeti si e ngurosur, me dorën, në të cilën mbante leckën, të ngritur përpjetë dhe me gojën gjysmë të hapur, a thua se kishte ngrirë në çastin kur deshi të rraste leckën në gojë.

Jozef Shterni, i shoqi, trupvogël, me syza dhe me buzën e poshtme të varur, i erdhi pranë.

– E, Selmkë...

Ajo nuk ia hodhi sytë fare. Shikonte e zgurdulluar diku në hapësirë.

– Bufeja...

– Mos u shqetëso kaq shumë, Selmkë... Tani që e kemi edhe vizën në xhep...

– Bufeja që më ka lënë mamaja... që e kam trashëguar nga prindërit...

– Epo mirë tani! Ç'u bë se u gërvisht pakëz? Kryesorja është që na dhanë vizën...

– Do t'i mbetet shenjë! Nuk rregullohet kurrë më!

– Madamë, – tha njëri nga hamejtë, që s'e kuptonte gjuhën, por që e merrte vesh fort mirë përse ishte llafi. – Ngarkojini vetë rraqet tuaja, po të doni! Se mos e kam bërë unë portën kaq të ngushtë?

– Nemse pisa! – shau hamalli tjetër.

– Jozef Shterni erdhi e u gjallërua.

– Ne s'jemi nemse, – tha ai. – Jemi emigrantë.

– Emigrantë pisa! – tha hamalli.

– E shikon ç'na bëre, Selmkë! – tha Jozef Shterni. – Si do të vejë halli tani? Sa telashe na ke hapur me ato orenditë e tua! Në Koblencë na u desh ta shtynim nisjen katër muaj, sepse nuk doje të ndaheshe prej tyre. Tetëmbëdhjetë mijë marka taksë më tepër na morën gjermanët! Ja dhe tani ku ngelëm këtu në mes të rrugës, dhe vapori s'ka nge të na presë ne!

Ai mënjanoi pakëz kokën dhe vështroi në hall të madh Marozovin.

– Ç'të bëjmë? – tha. – Nemse pisa! Refugjatë pisa! Po t'i them tani që jemi hebrenj, do të ma presë: Çifutë pisa! Dhe pastaj e mori lumi fare këtë punë...

– Jepini ca para, – i tha Marozovi.

– Para?! Të m'i përplasë surratit!

– E pamundur! – tha Raviku. – Kush shan kështu, është gjithmonë i korruptueshëm.

– Kjo është në kundërshtim me karakterin tim. Hem të më fyejnë, hem t'u jap para për këtë!

– Fyerjet e vërteta fillojnë atëherë kur bëhen personale, – shpalli Marozovi. – Kjo ishte një fyerje e përgjithshme. Fyejeni edhe ju, duke i dhënë një bakshish.

Në sytë e Shternit u duk një shkëlqim tallës.

– Shumë mirë! – i tha Marozovit. – Bukur fort!

Ai nxori disa kartëmonedha dhe ua dha hamejve. Të dy i morën me përbuzje. Edhe Shterni me përbuzje e futi kuletën përsëri në xhep. Hamejtë vështruan njëherë rretheqark. Pastaj filluan të ngarkonin kolltukët. Bufenë, për parim e lanë për në fund fare. Tek po e ngarkonin edhe atë, i dhanë një të rrotulluar dhe qoshja e djathtë u përplas pas kamionit. Selma Shterni u drodh e tëra, por nuk bëri as gëk as mëk. I shoqi as që e vuri re atë që ndodhi. Në atë kohë po merrej me rishqyrtimin e dokumenteve dhe pasaportave që kishte nxjerrë nga xhepi.

– S'ka gjë më të trishtueshme sesa mobiliet mes të rrugës, – tha Marozovi.

Tani u erdhi radha plaçkave të familjes Vagner. Disa karrige, një shtrat, që të jepte një përshtypje mjerimi, por edhe paturpësie, tek qëndronte ashtu i braktisur në mes të rrugës. Dy valixhe me etiketa – Viarexhio, *Grand Hotel Gordone*; Berlin *Hotel Adlon*. Një pasqyrë rrotulluese me kornizë të praruar, në të cilën pasqyrohej e gjithë rruga. Enë kuzhine – djalli e merrte vesh, pse duheshin marrë gjithë këto rrangulla me vete në Amerikë.

– Farefisi... – tha Leonia Vagneri. – Farefisi që kemi në Çikago na ndihmuan jashtëzakonisht. Na dërguan të holla dhe na nxorën vizën e hyrjes. Vetëm sa për një qëndrim vizite. Pastaj duhet të shkojmë në Meksikë... Farefisi...

Ajo dukej e turpëruar. E ndiente veten si dezertore, përderisa e shikonin sytë e atyre që mbeteshin këtu. Prandaj donte të ikte një orë e më parë. Po ndihmonte dhe vetë për ngarkimin e plaçkave në kamion. Do të merrte frymë lirisht vetëm kur të kalonte kthesën e parë të rrugës. Dhe pastaj do ta pushtonte sërish ndjenja e frikës: A do të nisej vërtet vapori?... A do t'i lejonin të zbrisnin atje në Amerikë?... Mos vallë i kthenin mbrapsht?... Sa zhdukej një frikë, lindte një tjetër. Dhe kështu po ndodhte që prej vitesh.

Beqari Shtolc s'kishte pothuajse asgjë përveç librave. Një valixhe me rroba dhe bibliotekën e tij. Libra të vjetër, libra të fundit. Ishte një njeri pak rakitik, qimekuq e i mbyllur në vetvete.

Disa nga klientët e hotelit u mblodhën përpara portës dhe në rrugë. Më të shumtët nuk flisnin fare. Vështronin vetëm plaçkat dhe kamionin.

– Epo, mirupafshim! – tha Leonia Vagneri me nervozizëm të dukshëm. Të gjitha plaçkat ishin ngarkuar ndërkohë. – Ose *gud bai!* – ajo qeshi e acaruar. – Ose *adio!* Sot nuk i dihet qysh do të vejë puna. – Ajo filloi t'u shtrëngonte duart disave. – Farefisi që kemi atje... – përsëriti ajo. – Ne vetë as që do të ishim në gjendje...

Por pushoi shpejt. Doktori Ernest Zajdenbaum i ra shpatullave.

– S'ka gjë. Disa kanë fat, disa nuk kanë.

– Shumica nuk ka, – tha emigranti Vizenhof. – S'ka gjë. Rrugë të mbarë!

Jozef Shterni u përshëndet me Ravikun e me Marozovin dhe me disa të tjerë. Ai buzëqeshte si dikush, që kishte bërë një falsifikim bankar. – Kushedi si vjen puna. Ndoshta do të na marrë malli përsëri për *Internacionalin*...

Selma Shterni kishte hipur me kohë në kamion. Beqari Shtolc nuk u përshëndosh me të tjerët. Ai nuk po nisej për në Amerikë. Kishte dokumente vetëm deri në Portugali. Dhe këtë ai s'e quante aq të rëndësishme sa për të bërë një skenë lamtumire. Ua bëri vetëm paksa me dorë, kur u nis kamioni.

Ata që mbetën, rrinin atje si pula të lagura në shi.

– Eja, – i tha Marozovi Ravikut. – Të zbresim në *Katakombë!* Vdiqëm për një *Kalvados!*

Nuk ishin ulur akoma mirë, kur u futën dhe të tjerët brenda. Dukeshin si gjethe pemësh që i kishte marrë era përpara. Dy rabinë, të zbehtë e me mjekër qimerrallë, Vizenhofi, Ruth Goldbergu, automati i shahut Finkenshtajn, fatalisti Zajdenbaum, një grumbull bashkëshortësh, një gjysmë duzine fëmijësh, Rozenfeldi, pronari i impresionistëve, që s'kishte ikur akoma, disa të rinj dhe disa që ishin shumë pleq.

Ishte akoma herët për të ngrënë darkë; por dukej se askush nga ata nuk donte të ngjitej sipër, për t'u tërhequr në vetminë e dhomave. Rrinin të gjithë bashkë grumbull. Nuk bëzanin fare dhe dukeshin si shumë të devotshëm. Të gjithë kishin pasur mjaft fatkeqësi në jetë; tani nuk u bënte më përshtypje pothuajse asgjë.

– Aristokracia na la shëndenë, – tha Zajdenbaumi. – Këtu po mbahet tani mbledhja e të dënuarve me burgim të përjetshëm ose me vdekje. Populli i zgjedhur! Të preferuarit e Jehovajt! Posaçërisht të përshtatshëm për pogrome! Rroftë jeta!

– Sidoqoftë, na ka mbetur akoma, Spanja, – tha Finkenshtajni. Ai kishte vënë përpara fushën e shahut dhe po studionte një problem shahu të botuar në gazetën *Maten*.

– Spanja?! Fashistët i puthin hebrenjtë në të dyja faqet, sapo kalojnë kufirin!

Kamerierja e bëshme dhe e zhdërvjellët solli *Kalvadosin*. Zajdenbaumi vuri monoklin në sy.

– Më të shumtët nga ne as nga kjo s'marrin vesh! – ia bëri ai. – Të rrumbullosen mirë. Të shpëtojnë nga një natë e mjerueshme! As këtë nuk dinë ta bëjnë. Dhe i thonë vetes pasardhës së Ahasverit![1] Edhe ai vetë po të ishte, shtegtari i stërlashtë, do t'i kishte ardhur shpirti në majë të hundës; pa dokumente s'do të dinte as ai nga t'ia mbante.

– Dëshironi të pini një gotë me ne? – e pyeti Marozovi. – *Kalvadosi* është i mirë. Por hotelierja jonë nuk e di akoma këtë, lavdi zotit! Ndryshe do ta kishte ngritur çmimin qëkur.

Zajdenbaumi tundi kokën.

– Unë nuk pi.

Ravikut i zuri syri një burrë, që ishte mjaft i parruar dhe që çdo minutë nxirrte një pasqyrë, vështrohej në të dhe, pas një copë here, fillonte prapë nga i njëjti marifet.

– Cili është ky? – pyeti Raviku Zajdenbaumin. – S'e kam parë kurrë këtu.

Zajdenbaumi mblodhi buzët.

– Ky është Aron Goldbergu i ri.

– Si kështu? Kaq shpejt u martua vejusha?

– Jo. Ajo ia shiti këtij pasaportën e Goldbergut të vdekur. Për dy mijë franga. Plaku Goldberg kishte një mjekër të thinjur; prandaj edhe ky Goldbergu i ri po e lë mjekrën që t'i rritet. E ka hallin te fotografia e pasaportës. Pa shikojeni si i nduk qimet vazhdimisht. S'ia mban ta përdorë pasaportën, përpara se t'i rritet një mjekër e ngjashme. Po bën garë me kohën.

Raviku e soditi atë mashkull që tërhiqte me nervozitet qimet e veta, duke u krahasuar me fotografinë e pasaportës.

– Fundja mund të thotë se i është djegur mjekra!

– Ide e mirë! Do t'ia them. – Zajdenbaumi hoqi monoklin dhe zuri ta tundte nëpër duar. – Punë makabre, – qeshi ai. – Para dy

1. *Ahasver:* Figurë legjendare biblike, "Çifuti shëtitës", i dënuar për të shtegtuar pa pushim.

javësh ishte thjesht një çështje tregtie. Kurse tani Vizenhofi na është bërë xheloz dhe Ruth Goldbergu konfuze. Lojë demoniake e letrës! Në bazë të një cope letre, ai është burri i saj.

Ai u ngrit dhe shkoi tek Aron Goldbergu i ri.

– Lojë demoniake e letrës! Bukur fort e tha. – Marozovi iu kthye Ravikut: – Ç'plane ke për sonte, zotrote?

– Keti Hegshtrëmi niset në mbrëmje me vaporin *Normandia*. Do ta përcjell deri në Sherburg. Ka veturën e saj. Pastaj do të kthehem me gjithë veturë e do ta dorëzoj në garazh. Ajo ia ka shitur pronarit të garazhit.

– A është në gjendje të udhëtojë?

– Natyrisht. S'ka rëndësi se ç'bën. Vapori ka një mjek shumë të mirë. Kurse në Nju-Jork... – Ai ngriti supet dhe e ktheu gotën me fund.

Ajri në *Katakombë* ishte i rëndë dhe i vdekur. Salla nuk kishte dritare fare. Nën palmën e pluhurosur artificiale rrinte një çift plak. Ata ishin zhytur krejtësisht në një trishtim të tillë, që i qarkonte si një mur dhe i veçonte nga të tjerët. Rrinin pa lëvizur, të zënë për dore, dhe dukej sikur s'do të ishin më në gjendje të ngriheshin që andej.

Ravikut iu bë përnjëherësh sikur e gjithë fatkeqësia dhe i gjithë mjerimi i botës ishin mbyllur në këtë dhomë të nëntokës, së cilës i mungonte drita. Llambat elektrike, të sëmura, vareshin të verdha e si të vyshkura nga tavani dhe e bënin ambientin edhe më të trishtueshëm. Heshtja, pëshpëritjet, shfletimi i dokumenteve të kaluara qindra herë nëpër duar, numërimi i parave, ndjenja e nemitur mbi karrige, pritja apatike e fundit, guximi i pakët dhe pothuajse i shtirur, jeta mijëra herë e poshtëruar, e cila tani ishte ndrydhur në një qoshe, e tmerruar, duke mos ditur nga t'ia mbante më – të gjitha këto ai i ndjeu përnjëherësh sikur të ishin të prekshme; i dukej sikur po e nuhaste frikën, të fundmin, të pamaturin, të heshturin ankth; po e nuhaste dhe e dinte ku e kishte nuhatur edhe më parë: në kampin e përqendrimit, ku njerëzit i kishin rrasur duke i marrë nga rruga, duke i nxjerrë nga shtretërit, dhe ku rrinin pastaj strukur nëpër baraka, duke pritur se ç'do të ndodhte me ta...

Në tryezën pranë tij rrinte një çift tjetër. Një grua, me flokët të ndarë në mes, dhe i shoqi. Përpara tyre qëndronte në këmbë një djalë nja tetë vjeç. Ai ishte sorollatur mes tryezave të tjera, duke përgjuar bisedat, dhe tani ishte kthyer te prindërit.

– Pse jemi çifutë ne? – e pyeti të ëmën.

Gruaja nuk i dha përgjigje.

Raviku vështroi Marozovin.

– Më duhet të shkoj, – i tha. – Në klinikë.

– Edhe unë duhet të ngrihem.

Ata iu ngjitën shkallëve.

– Kur teprohet, teprohet! – tha Marozovi. – Dhe këtë po ta them unë, që dikur kam qenë antisemit.

*

* *

Në krahasim me *Katakombën*, klinika të dukej mjaft optimiste. Edhe këtu kishte vuajtje, sëmundje, mjerim – por këtu këto gjëra kishin të paktën njëfarë logjike dhe kuptimi. Njeriu e dinte pse qëndronin punët kështu dhe e dinte, çfarë duhej e çfarë nuk duhej bërë. Kishe të bëje me fakte; ato mund të shiheshin me sy dhe çdokush mund të përpiqej të bënte diçka kundër tyre.

Veberi po rrinte në dhomën e vizitave e po lexonte një gazetë. Raviku i hodhi një sy gazetës pas kurrizit të Veberit.

– Po ndodhin gjithfarësoj gjërash, apo jo? – tha ai.

Veberi e flaku gazetën përtokë.

– Ç'bandë e korruptuar! Do të ishte mirë që pesëdhjetë për qind e politikanëve tanë t'i shpinin në litar!

– Jo, nëntëdhjetë për qind më mirë! – tha Raviku. – Keni marrë ndonjë lajm nga ajo gruaja që ndodhet shtruar në klinikën e Dyranit?

– Ajo është në rregull. – Veberi nxori me nervozitet një puro. – Për ju kjo punë është e thjeshtë, Ravik. Por unë jam francez.

– Unë s'jam asgjë. Por do të kisha dëshirë që edhe Gjermania të ishte kaq e korruptuar sa Franca.

Veberi ngriti sytë.

– Po flas marrëzira. Më falni. – Ai harroi ta ndizte puron. – Nuk mund të ketë luftë, Ravik! Nuk ka se si të ketë! Këto janë vetëm lehje dhe kërcënime. Në minutën e fundit do të rregullohen të gjitha!

Ai heshti një copë herë. E gjithë siguria e tij e mëparshme ishte zhdukur.

– Fundja, ne kemi akoma vijën *Mazhino*, – ia bëri pastaj pothuaj me një ton lutës.

– Natyrisht, – iu përgjigj Raviku sa për të thënë diçka. Këtë gjë e kishte dëgjuar me mijëra herë. Muhabetet me francezët përfundonin pothuajse gjithmonë me vijën e fortifikuar *Mazhino*.

Veberi fshiu ballin.

– Dyrani e nisi pasurinë e vet për në Amerikë. Ma tha sekretarja e tij.

– Tipike për të.

Veberi e vështroi Ravikun me sy të ndezur.

– Ai s'është i vetmi që vepron kështu. Kunati im këmbeu aksionet e veta franceze me amerikane. Gaston Nereja i ka bërë të gjitha paratë dollarë dhe i mban kyçur në kasafortë. Edhe Dyponi ka groposur disa qese me florinj në kopshtin e vet. Kështu thonë, të paktën. – Ai u ngrit nga vendi. – Nuk më bëhet të flas për këto gjëra. Ndiej si një lëmsh në grykë. Është e pamundur. Është e pamundur që ta shesin Francën e të bëjnë pazarllëqe në kurriz të saj. Po të vijë rreziku, do të bashkohen të gjithë. Të gjithë!

– Të gjithë, – tha Raviku pa vënë buzën në gaz. – Edhe industrialistët dhe politikanët, që po bëjnë qysh tani pazarllëqe me Gjermaninë.

Veberi e zotëroi veten.

– Ravik... ne... Le të hapim më mirë një muhabet tjetër.

– Mirë. Unë do të përcjell Keti Hegshtrëmin deri në Sherburg. Në mesnatë kthehem.

– Në rregull. – Veberi merrte frymë me gulç. – Por për vete ç'keni menduar, ç'masa keni marrë, Ravik?

– Asgjë. Do të më fusin në ndonjë kamp përqendrimi francez. Do të jetë më i mirë sesa një gjerman.

– E pamundur! Franca nuk do t'i burgosë refugjatët!

– Kemi për ta parë. Kjo është diçka e natyrshme dhe kundër kësaj s'ke as ç'thua.

– Ravik...

– Mirë. Do ta shohim. Le të shpresojmë që të keni të drejtë ju. A e dini që po e boshatisin *Luvrin?* Kuadrot më të mira po i dërgojnë në Francën Qendrore.

– Jo, nuk e di. Po ju ku e morët vesh?

– Kalova sot pasdreke andej. Edhe dritaret blu të katedrales së Shartrës janë paketuar. Dje isha edhe atje. Bëra një shëtitje sentimentale. Desha t'i shihja edhe një herë sot. Por ja që i kishin hequr. Aeroporti ndodhet shumë afër katedrales. I kishin vënë xhama të tjerë. Ashtu si edhe vitin e kaluar, në kohën e Konferencës së Mynihut!

– E shikoni! – Veberi u kap menjëherë pas kësaj. – Edhe atëherë nuk ndodhi gjë prej gjëje. Vetëm sa u shqetësuan njerëzia kot. Dhe pastaj erdhi Çamberleni me ombrellën e paqes.

– Po. Por ombrella e paqes ndodhet akoma në Londër, kurse Perëndesha e Fitores qëndron akoma në *Luvër*, por pa kokë. Trupi i saj do të mbetej atje. Është tepër i rëndë për t'u transportuar... Po shkoj tani. Më pret Keti Hegshtrëmi.

*

* *

Normandia qëndronte në skelë, e bardhë nga shkëlqimi i mijëra dritave. Era frynte që nga deti, e ftohtë dhe e kripur. Keti Hegshtrëmi u mbështoll më fort me mantelin e vet. Ishte tretur shumë. Në fytyrë i dukeshin pothuajse vetëm kockat, mbi të cilat nderej lëkura dhe, në të, tmerrësisht të mëdhenj, i shkëlqenin sytë, si dy gurra të errëta.

– Do të ishte më mirë të qëndroja këtu, – tha ajo. – Qenka shumë e vështirë të largohesh.

Raviku e pa me habi. Atje qëndronte vapori vigan, shkallët ishin plot me drita; njerëzit dyndeshin brenda, shumë prej tyre me aq nxit, a thua se trembeshin se mos vinin një minutë më vonë; atje qëndronte ai pallat llamburitës dhe nuk quhej më *Normandia*, por *Ikje, Arratisje, Shpëtim*. Për dhjetëra mijëra njerëz në mijëra qytete dhe dhoma dhe hotele të fëlliqura dhe qilare të Evropës, ai vapor ishte një vegim i paarritshëm i jetës; kurse këtu, pranë tij, dikush me vdekjen të kapërthyer pas zorrëve të veta, po i thoshte me zë të hollë e të ëmbël: "Do të ishte më mirë të qëndroja këtu."

Asgjë s'kishte më kuptim. Për emigrantët në *Internacional*, për mijëra *Internacionalët* në Evropë, për të gjithë të ndjekurit, të torturuarit, të arratisurit, të gjurmuarit, ky vapor do të kishte qenë toka e bekuar; ata do të ishin alivanosur nga gëzimi, do të qanin nga mallëngjimi, do t'i mbulonin me puthje shkallët e vaporit dhe do të besonin në çudira, sikur ta kishin atë copë bilete, e cila tundej tani në atë dorë të lodhur atje pranë tij, biletën e një njeriu që shkonte drejt vdekjes, por që njëkohësisht thoshte: "Do të ishte më mirë të qëndroja këtu."

Atyre po u afrohej një grup amerikanësh. Të shkujdesur, të përzemërt, poterexhinj. Dukeshin si njerëzit më me nge të botës. Ambasada e tyre i kishte këshilluar e shtyrë që të niseshin. Tani po diskutonin rreth kësaj. Sa keq, vërtet! Do të ishte *fun* – qejf i madh – të rrinin edhe ca e të bënin sehir, si do t'i vente filli kësaj pune. Fundja, ç'do t'u ndodhte? Ah, ai ambasadori! E harroi, vallë, që ata ishin neutralë?... Sa keq, vërtet!...

Aromë parfumi. Rrëzëllim xhevahiresh. Para ca orësh kishin ngrënë darkë në *Maksims*. Çmimet kishin qenë qesharake, po t'i llogarisje në dollarë... Dhe tani ky vapori këtu s'ishte i keq. Do të rrinin në bar, do ta vrisnin kohën me bixhoz, do të zbraznin ca kupa uiski... ndërsa përpara ambasadave e konsullatave: radhët e gjata e të pashpresa të njerëzve, me erën e ankthit të vdekjes që u rrinte si një re mbi kokë, disa nëpunës të rraskapitur, tryeza e ndonjë sekretaruci që tundte kokën vazhdimisht: "Jo, nuk mund t'ju japim vizë. Është e pamundur!" Dënimi i heshtur i të pafajshmëve të heshtur... Raviku vështronte si i shastisur vaporin, që s'ishte më vapor, që ishte shndërruar befas në një varkë të Noes, në një varkë të lehtë, e cila po përgatitej t'i shpëtonte përmbytjes së botës, atij fundi, nga i cili njerëzia kishin shpëtuar njëherë e një kohë, por që tani po i arrinte e po u kanosej përsëri...

– Erdhi koha që të hipni edhe ju, Keti.

– Erdhi! Mirëmbetshi, Ravik!

– Mirëmbetshi, Keti!

– S'kemi nevojë të gënjejmë njëri-tjetrin, apo jo?

– Jo.

– Mos e zgjatni më dhe nisuni edhe ju sa më shpejt...

– Patjetër, Keti. Sa më shpejt...

– Mirëmbetshi, Ravik. Falemnderit për të gjitha. Po iki tani. Do të ngjitem atje lart mbi kuvertë e do t'ju përshëndes me dorë. Qëndroni këtu gjersa të niset vapori dhe përshëndetmëni edhe ju.

– Mirë, Keti.

Ajo filloi t'u ngjitej shkallëve me ngadalë. Trupi i lëkundej paksa. Ai trupi i saj, më i imët nga gjithë të tjerët që i ecnin pranë, i përkryer për nga trajta, pothuajse pa mish, kishte elegancën e zezë të vdekjes së sigurt. Fytyra e saj ishte energjike, si koka e një maceje egjiptiane prej bronzi – vetëm linjë, frymë dhe sy...

Pasagjerët e fundit. Një hebre, qull në djersë, me një peliçe hedhur në krah, pothuajse histerik, duke rendur e duke thirrur, me dy hamej nga pas. Amerikanët e fundit. Pastaj shkalla tek tërhiqej ngadalë lart. Një ndjenjë e çuditshme: një copë shkallë që tërhiqej lart e nuk lëshohej më në asnjë mënyrë. Fundi. Një rrip i ngushtë uji. Kufiri. Vetëm dy metra ujë – por ishte kufiri midis Evropës dhe Amerikës. Midis shpëtimit dhe fundit.

Raviku kërkoi me sy Ketin. E gjeti shpejt. Kishte qëndruar te parmakët e kuvertës dhe ia bënte me dorë. Edhe ai ngriti dorën dhe e përshëndeti.

Vapori u duk sikur lëvizi. Toka u duk sikur u tërhoq prapa. Shumë pak, sa mezi kuptohej. Dhe përnjëherësh vapori i bardhë u çlirua. Ai rrëshqiste mbi ujin e errët, nën qiellin e errët, i paarritshëm. Keti Hegshtrëmi nuk dallohej më, dhe ata që mbetën pas vështruan njëri-tjetrin të heshtur e të druajtur ose me gaz të shtirur dhe u larguan, disa me nxit, disa me ngurrim.

*

* *

Vetura çante nëpër natë, drejt Parisit. Gardhiqet dhe pemëtoret e Normandisë kalonin fluturimthi. Hëna nderej ovale dhe e madhe në qiellin e mjegulluar. Vapori qe harruar. Mbetej vetëm ky peizazh, kjo aromë kashte dhe mollësh të pjekura, kjo heshtje dhe kjo qetësi e thellë e të Pandryshueshmes.

Makina rrëshqiste pothuajse pa zhurmë. Ajo ecte, a thua se forca e gravitetit nuk kishte pushtet fare mbi të. Shtëpi i kalonin përpara, kisha, fshatra, njolla të ndritshme bujtinash dhe bar-bufesh, një rrjedhë e sermtë lumi, një mulli dhe pastaj përsëri përvijimet false të fushave, mbi të cilat ngrihej kupa e qiellit, si pjesa e brendshme e një guaske vigane, në sedefin qumështor të së cilës farfurinte perla e hënës.

Ishte një fund dhe një përmbushje. Edhe më parë Raviku e kishte provuar disa herë këtë ndjenjë; por tani po e pushtonte të tërin me një forcë shumë të madhe, së cilës s'kishte si t'i shpëtonte; po e përshkonte tej e tej, dhe asgjë s'mund t'i rezistonte më.

Gjithçka nderej në hapësirë dhe ishte pa peshë... E ardhmja dhe e kaluara takoheshin, dhe të dyja ishin pa dëshira e pa dhimbje. Asgjë s'ishte më e fortë dhe më e rëndësishme se të tjerat. Horizontet qëndronin në drejtpeshim dhe, gjatë një çasti të çuditshëm, të dyja pjatat në balancën e Ekzistencës kishin të njëjtin nivel. Fati nuk ishte kurrë më i rëndë se sa guximi mospërfillës që i kundërvihej. Kur gjendja bëhej e padurueshme, mund t'ia hiqje vetes. Ishte gjë e mirë ta dije këtë, por ishte gjë e mirë edhe ta dije se asgjë nuk mund të quhej e humbur, përderisa jetoje akoma.

Raviku e njihte rrezikun. Ai e dinte se ku po shkonte dhe e dinte gjithashtu se nesër do të mbrohej përsëri – porse këtë natë, këtë orë të kthimit nga një *Ararat*[1] i humbur drejt e në duhmën e gjakut të

1. *Ararat*: vargmale vullkanike në Armeni; arrijnë deri në 5156 m. lartësi. Sipas Dhjatës së Vjetër, këtu ka zbarkuar varka e Noes pas përmbytjes.

shkatërrimit të ardhshëm, të gjitha gjërat e kishin humbur përnjëherësh emrin e tyre: rreziku ishte rrezik e, megjithatë, s'ishte rrezik; fati ishte njëherësh therorizim dhe perëndi, së cilës i bëje kurbane; dhe e nesërmja ishte një botë e panjohur.

Gjithçka ishte në rregull; Ajo që pati qenë dhe ajo që do të vinte. Dhe ishte e mjaftueshme. Edhe po të ishte ky fundi, prapë mirë do të ishte. Ai pati dashuruar një njeri dhe e pati humbur. Pati urryer një tjetër dhe e pati vrarë. Që të dy e kishin çliruar tani. Njëri kishte bërë që t'i shpërthenin sërishmi ndjenjat, kurse tjetri ia kishte fshirë të kaluarën. Asgjë nuk kishte mbetur pas e papërmbushur. S'ekzistonte më asnjë dëshirë, asnjë urrejtje dhe asnjë ankim. Në do të kishte ndonjë fillim të ri, atëherë do të ishte ky. Hiri ishte pastruar; qeliza të paralizuara kishin filluar të rijetonin, cinizmi ishte kthyer në forcë. Gjithçka ishte në rregull.

*
* *

Pas Kaenit u dukën kuajt. Kolona të gjata nëpër natë... Kuaj, kuaj, si hije të mëdha nën dritën e hënës. Pastaj kolona katërshe, burra me trasta, kuti kartoni, pako. Fillimi i mobilizimit!

Nuk ndihej pothuajse asnjë zhurmë. Askush nuk këndonte. Askush nuk e hapte gojën. Ecnin të nemitur nëpër natë, kolona hijesh, në të djathtë të rrugës, për t'u hapur vend automjeteve.

Raviku i parakaloi me radhë. Njërën kolonë pas tjetrës. Kuaj, mendoi ai. Kuaj. Njëlloj si më 1914. Jo tanke, por kuaj!

Ai ndaloi përpara një stacioni benzine për ta furnizuar veturën. Në atë qendër të vogël banimi kishte akoma dritare të ndriçuara, por heshtja zotëronte kudo. Një kolonë kaloi andej pari. Vendasit e ndoqën me sy. Askush nuk ngriti dorën për t'i përshëndetur.

– Unë shkoj nesër ushtar, – tha burri që po mbushte serbatorin. Kishte një fytyrë të regjur e të nxirë prej fshatari. – Im atë ra në luftën e fundit. Im gjysh më 1871. Unë nisem nesër. Gjithmonë po ajo mesele. Ka disa qindra vjet që po bëjmë po këtë marifet. Dhe prapë s'bën asnjë dobi. Gjithmonë duhet të nisemi sërish. – Ai përfshiu me një shikim pompën e vjetër, shtëpinë e vogël dhe të shoqen, që i rrinte e heshtur pranë. – Njëzet e tetë franga e tridhjetë bën hesapi, zotëri!

Përsëri peizazhi. Hëna. Lokalitetet Lizië, Evrë... Kolona. Kuaj. Heshtje. Raviku ndaloi përpara një restoranti të vogël. Përjashta

ishin nxjerrë dy tryeza. E zonja e restorantit i tha se gjellët i ishin mbaruar. Darka ishte darkë, akoma, pavarësisht nga të gjitha; dhe një omëletë me djathë nuk konsiderohej si darkë në Francë. Më në fund ai arriti t'ia mbushte mendjen, dhe ajo i nxori edhe një sallatë, kafe dhe një shishe verë të zakonshme.

Raviku rrinte fillikat vetëm aty përpara asaj godine ngjyrëtrëndafili dhe hante. Mbi fushat po nderej mjegulla. Disa bretkosa kuakninin diku. Mbretëronte një qetësi e thellë, dhe vetëm nga kati i sipërm dëgjohej një radio. Një zë fliste, qetësues, i sigurt e, megjithatë, i pashpresë dhe krejt i tepërt. Gjithkush e dëgjonte dhe askush s'e besonte.

Ai nxori paratë për të paguar.

– Parisin po e errësojnë, – tha zonja e restorantit. – Sapo e dëgjuam në radio. Kundër bombardimeve. Sa për siguri. Radioja thotë se çdo gjë bëhet vetëm sa për siguri. Luftë s'do të ketë. Janë duke bërë bisedime. Po ju si thoni?

– Nuk ma merr mendja që do të kemi luftë. – Raviku nuk dinte çfarë t'i thoshte tjetër.

– Ashtu e dhëntë perëndia! Po ç'dobi ka! Gjermanët do të pushtojnë Poloninë. Pastaj do të kërkojnë Alzasë-Lorenën. Pastaj kolonitë. E pastaj ndonjë gjë tjetër. Gjithnjë e më tepër do të kërkojnë, derisa ne të dorëzohemi ose të detyrohemi të bëjmë luftë. Atëherë më mirë të fillojmë qysh tani!

E zonja e restorantit u kthye në godinë. Një kolonë tjetër po vinte tej nga rruga.

Shkëlqimi i kuq i Parisit u shfaq në horizont. Parisi do të errësohej! Ishte e natyrshme, por tingëllonte disi e çuditshme: Parisi do të errësohej! Parisi! Dukej sikur do të errësohej drita e gjithë botës.

Periferia. Sena. Labirinti i rrugëve të vogla. Shëtitorja e gjerë që të nxirrte drejt e te Harku i Triumfit, i cili, në dritën e mjegullt të *Sheshit të Yllit*, ngrihej i zbehtë dhe akoma i ndriçuar – dhe, pas tij, llamburitëse e shkëlqimtare në mijëra drita, *Shanz-Elizeja*.

Raviku mori frymë i lehtësuar. I ra mes për mes shëtitores së gjatë. U fut në zemrën e qytetit, dhe pastaj e vuri re përnjëherësh atë që nuk i besohej: mbi qytet kishte filluar të përhapej errësimi. Si pjesë të zgjebosura mbi një lëkur qimendritur dalloheshin aty-këtu njolla të sëmura errësire. Bukuria e larmishme e reklamave lodruese të dritës ishte prishur në disa vende nga hije të gjata, që strukeshin kërcënuese midis atyre pak dritave të kuqe, të bardha, të kaltra e të

gjelbra të tromaksura. Rrugë të veçanta ishin verbuar fare, a thua se ishin zvarritur përmbi to krimba të zinj viganë dhe kishin shtypur me trupin e tyre të pështirë çdo lloj shkëlqimi. *Avënyja Zhorzh V* s'kishte më drita; në *avënynë Montenjë* dritat po jepnin shpirt; godina, që natën kishin hedhur shatërvanë të tërë drite drejt yjeve, të vështronin tani me fasadat e tyre gri e të pajeta. Gjysma e *avënysë Viktor Emanueli III* ishte e errësuar; gjysma tjetër qëndronte akoma e ndriçuar – si një trup i paralizuar në agoni, gjysmë i vdekur e gjysmë i gjallë. Sëmundja po përparonte kudo dhe kur Raviku arriti në Sheshin *Konkordë*, edhe ky shesh i madh e i rrumbullakët kishte dhënë shpirt.

Ministritë ngriheshin të zbehta e pa ngjyrë, vargjet e dritave ishin zhdukur. *Nereidat*, që vallëzonin dikur të mbuluara me shkumë netëve të bardha, kishin ngrirë tani mbi delfinët e tyre dhe ishin shndërruar në copa të murrme amorfe; shatërvanët të ngjallnin trishtim dhe obelisku, dikur aq i ndritshëm, lartohej tani i plumbtë, si një gisht i madh kanosës i Përjetësisë drejt qiellit që po errësohej gjithnjë e më shumë; dhe projektorët e vegjël të një kaltërsie të zbehtë të reparteve kundërajrore po shfaqeshin ngado si mikrobe dhe po përhapeshin me vezullim të kalbur, porsi një tuberkuloz kozmik mbi qytetin dikur aq zhurmëmadh e tani të përgjumur e të nemitur...

Raviku shkoi e dorëzoi veturën. Pastaj mori një taksi dhe u nis për në hotel *Internacional*. Përpara portës gjeti të hipur majë një shkalle djalin e hotelieres. Ai po vidhoste në portollambë një poç blu. Ndriçimi i hyrjes së hotelit kishte qenë gjithmonë aq i fortë, sa për të dalluar tabelën; kurse tani ajo llambë blu nuk mjaftonte më; gjysma e tabelës mbetej në errësirë – shquhej vetëm fjala *nacional*, edhe ajo me zor.

– Bëtë mirë që erdhët, – i tha hotelierja. – Na lojti mendsh njëra. Ajo e dhomës shtatë. Më mirë do të jetë sikur të ma heqin që këtej. S'më duhen të çmendur në hotel.

– Ndoshta nuk është çmendur. Mund të ketë pësuar vetëm ndonjë krizë nervore.

– Njëlloj është! Të çmendurit e kanë vendin në çmendinë. Ua thashë atyre lart. Natyrisht që nuk pranojnë. Ç'telashe të nxjerrin këta njerëz! Po të mos qetësohet, duhet të dalë që këtej. Kështu s'bën. Klientët e tjerë duan të flenë rehat.

– Para ca kohësh dikush luajti mendsh në hotel *Ric*, – tha Raviku. – Ishte një princ. Pas kësaj, të gjithë amerikanët që ishin atje,

kërkonin apartamentin e tij.

– Kjo është një çështje tjetër. Kësaj i thonë të luash mendsh për sport. Është diçka elegante. Jo të marrosesh nga halli.

Raviku e vështroi.

– Ju e kuptoni mirë jetën, madamë.

– Jam e detyruar ta kuptoj. Jam njeri i mirë. Kam strehuar refugjatë në hotelin tim. Të gjithë. Ju do të thoni se edhe kam fituar nga kjo. Natyrisht, kam fituar me karar. Por një e çmendur që ulërin... kjo është e tepërt. Ajo duhet të dalë nga hoteli im, po të mos qetësohet.

Ishte gruaja, të cilën i biri e pati pyetur: "Pse jemi çifutë?". Rrinte ndenjur mbi shtrat, e strukur në një qoshe, me duart përpara syve. Dhoma ishte e ndriçuar fort. Të gjitha llambat ishin ndezur dhe mbi tryezë ishin vendosur edhe dy shandanë me qirinj.

– Kacabunj! – murmuriste gruaja. – Kacabunj të zinj, të trashë, të ndritshëm! Ja tek rrinë atje nëpër qoshet. Janë me mijëra, nuk numërohen dot! Ndizeni dritën, ndizeni dritën, se po më afrohen! Dritë! Dritë! Po vijnë...

Ajo këlthiste dhe kruspullohej në qoshe, me këmbët mbledhur pas trupit, me duart shtrirë përpara, me sy të qeltë e të zgurdulluar. I shoqi mundohej ta kapte nga duart.

– S'ka asgjë nëpër qoshet, Mame! Asgjë s'ka!

– Dritën! Ndizeni dritën! Po vijnë! Kacabunjtë...

– Dritën e kemi të ndezur, Mame. Ja tek e ke dritën! Shikoje vetë! Edhe qirinj kemi vënë mbi tryezë! – Ai mori një llambë dore me bateri dhe ndriçoi me të qoshet e ndriçuara të dhomës së ndriçuar. – Asgjë s'ka nëpër qoshet! Vështro, ç'dritë po bëj! Asgjë s'ka...

– Kacabunjtë! Kacabunjtë! Po afrohen! E gjithë dhoma nxin nga kacabunjtë! Po zvarriten nga të gjitha qoshet!... Dritë! Dritë! Po zvarriten përpjetë mureve... Po fillojnë të bien nga tavani!

Gruaja gulçonte dhe ngrinte duart sipër kokës.

– Sa kohë ka në këtë gjendje? – e pyeti Raviku të shoqin.

– Që kur u err. Unë kisha dalë. U përpoqa edhe njëherë për të nxjerrë pasaportat. Më patën thënë ta provoja te konsulli i Haitit. Kisha marrë edhe djalin me vete. Por s'doli gjë. Prapë s'doli gjë. Dhe kur u kthyem, ajo po rrinte atje në çip të shtratit dhe po ulërinte...

Raviku e kishte bërë shiringën gati.

– A kishte fjetur më parë?

Burri e vështroi duke ngritur supet.

– Nuk e di... Gjithmonë ka qenë e qetë dhe e shtruar. Ne s'kemi

të holla për klinikë. Dhe ne s'kemi as... dokumentet tona nuk mjaftojnë... Ah, sikur të pushonte!... Mame, qetësohu tani! Të gjithë jemi këtu, pranë teje. Zigfridi, doktori... S'ka asnjë kacabu...

– Kacabunj! – e ndërpreu e shoqja. – Po lëvrijnë në të katër anët! Po vijnë, po afrohen...

Raviku ia bëri gjilpërën.

– A ka pasur ndonjëherë diçka të ngjashme?

– Jo. Nuk e kuptoj. Nuk e di, pse flet pikërisht për...

Raviku ngriti dorën:

– Mos ia shtini përsëri në mendje. Pas disa minutash do të lodhet e do ta zerë gjumi. Ka të ngjarë që t'i ketë parë në ëndërr dhe është trembur në gjumë. Nesër ndoshta do të zgjohet e s'do të mbajë mend asgjë. Mos ia kujtoni fare. Bëni sikur s'ka ndodhur asgjë.

– Kacabunj, – murmuriti gruaja e përgjumur. – Të dhjamur, të trashë...

– A ju duhen gjithë këto drita?

– I ndezëm, meqë ajo kërkonte vazhdimisht dritë.

– Shuajeni dritën e madhe. Të tjerat i shuani pasi ta ketë zënë gjumi mirë. Ajo do të flejë. Doza është mjaft e fortë. Nesër paradreke, më njëmbëdhjetë, do të vij ta shikoj prapë.

– Falemnderit shumë, – i tha burri. – Ju mendoni se...

– Mos u bëni merak. Gjëra të tilla ndodhin shpesh tani. Do pak kujdes këto ditë. Mos ia tregoni të gjitha hallet...

Kollaj për t'u thënë, një llaf goje, mendoi Raviku tek po ngjitej sipër në dhomën e vet. Ndezi dritën. Pranë shtratit ndodheshin librat e tij. Seneka, Shopenhaueri, Platoni, Rilkeja, Lao–Tse, Li Tai–pe, Paskali, Herakliti, një bibël, libra të tjerë – vepra nga më të fortat dhe nga më të butat; shumë prej tyre ishin botime me fletë të holla e me format të vogël, për ata njerëz që ndodheshin vazhdimisht në udhëtim dhe s'kishin mundësi të merrnin shumë gjëra me vete. Ai zgjodhi ato libra, nga të cilat s'kishte ndër mend të ndahej, po të vinin ta merrnin. Pastaj kontrolloi sendet e tjera. S'kishte shumë letra për të grisur. Kishte jetuar gjithmonë i gatshëm për t'u arrestuar. Kuverta e tij e vjetër, palltoja – ato do të ndihmonin si shokë të vërtetë. Helmi në medaljonin e zgavruar, që e kishte pasur me vete qysh në kampin e përqendrimit gjerman... ndjenja që e kishte atë helm dhe që mund ta përdorte çdo çast, ia kishte bërë më të lehtë jetën atje... E futi medaljonin në xhep. Ishte më mirë ta mbante me vete. I falte qetësi. S'dihej kurrë se ç'të priste. Kishte mundësi që Gestapoja ta shtinte prapë në dorë. Mbi tryezë ndodhej akoma një

gjysmë shishe *Kalvados*. Ai mbushi një gotë dhe e piu. Franca! mendoi ai. Pesë vjet jetë të trazuar. Tre muaj burg për qëndrim ilegal, katër herë i dëbuar jashtë kufirit, katër herë i kthyer përsëri. Pesë vjet jetë. S'e kishte kaluar edhe aq keq.

33

Zilja e telefonit tringëlloi. Ai e ngriti dorezën, ashtu i përgjumur siç ishte.

– Ravik... – foli dikush.

– Po...

Ishte Xhoana.

– Eja, – tha ajo. Fliste ngadalë dhe me zë të ulët. – Eja sa më shpejt, Ravik!

– Jo.

– Duhet të vish...

– Jo! Dhe lërmë rehat. Nuk jam vetëm. Nuk dua të vij.

– Ndihmomë...

– Nuk kam si të të ndihmoj...

– Ka ndodhur diçka... zëri i saj vinte si i këputur. – Duhet të vish... menjëherë...

– Xhoanë, – ia preu Raviku me padurim. – S'është më koha për teatër. Njëherë ma ke punuar kështu dhe unë rashë brenda. Tani u mësova me ty. Lërmë rehat. Shko provoje me ndonjë tjetër.

Ai e vuri dorezën në vend, pa pritur përgjigje fare dhe u mundua të flinte përsëri. Por nuk mundi. Telefoni tringëlloi prapë. Ai nuk e mori. Zilja tringëllinte e tringëllinte nëpër natën gri e të shkretuar. Ai rrëmbeu një jastëk dhe ia ngjeshi aparatit përsipër. Tringëllima vazhdoi edhe ca e mbytur dhe pastaj reshti.

Raviku qeshi. Qetësia vazhdoi. Ai u ngrit dhe mori një cigare. Nuk po i shijonte. E hoqi nga buzët dhe e shoi. Shishja e *Kalvadosit* ndodhej akoma mbi tryezë. Piu një gllënjkë dhe e la shishen në vend. Të kisha një kafe, mendoi. Një kafe të nxehtë dhe qifle me gjalpë. Ai

Erjonixx

errësuar. Rrugët s'ekzistonin më – kishte vetëm një hapësirë të pamatë, në të cilën dyndej një mjegull rrëshqitëse dhe llambat blu shfaqeshin me vonesë e si të përhumbura; të bëhej sikur vetura po udhëtonte në fund të detit.

Raviku veshi këpucët dhe rrobat; robdëshambrin me të cilin kishte dalë me vrap jashtë hotelit, e rrasi në një qoshe të ndenjëses. Çorapet dhe kravatën s'i kishte marrë me vete. I shqetësuar vështronte jashtë xhamave të makinës. S'kishte asnjë kuptim t'i bënte ndonjë pyetje burrit që rrinte në timon. Ky e ngiste makinën shumë i përqendruar, shumë shpejt dhe duke pasur kujdes rrugën. S'kishte kohë të fliste. E vetmja gjë që bënte ishte të sterconte timonin, t'i hapte rrugë ndonjë automjeti tjetër, të shmangte ndonjë aksident dhe të kishte mendjen se mos gabonte rrugë në atë errësirë të pazakontë. Pesëmbëdhjetë minuta të humbura, mendoi Raviku. Të paktën pesëmbëdhjetë minuta!

– Ngajeni më shpejt! – i tha atij tjetrit.

– Nuk mundem... Fenerët i kam të shuar... është urdhër...

– Atëherë ndizini ata dreq fenerësh!

Burri i ndezi llambat e fuqishme. Disa policë nëpër qoshet e rrugëve zunë të thërrisnin me të madhe. Një *Rëno*, që u verbua nga dritat e makinës së tyre, mend u përplas me ta.

– Jepini! Më shpejt!

Vetura frenoi me një të kërcyer përpara shtëpisë. Ashensori ndodhej në katin përdhes. Dera e tij ishte e hapur. Dikush i binte ziles me inat në ndonjërin prej kateve. Me sa dukej, burri s'e kishte mbyllur derën kur pati dalë me nxit nga ashensori. Në rregull, mendoi Raviku. Kjo do të na kursejë disa minuta.

Ashensori u zvarrit përpjetë. Edhe një herë tjetër kam ardhur kështu, mendoi Raviku. Por atëherë s'kishte ndodhur gjë. Asgjë s'do të ndodhë edhe këtë radhë! Ashensori ndaloi përnjëherësh. Dikush vështroi brenda kafazit dhe hapi derën.

– Ç'është ky marifet? A mbahet ashensori një sahat poshtë?!

Ishte ai burri që i pati rënë ziles. Raviku i dha një të shtyrë dhe e mbylli përsëri derën.

– Ja, tani mund ta merrni. Por pasi të jemi ngjitur ne njëherë sipër!

Burri, që mbeti përjashta, zuri të shante. Ashensori vazhdoi të ngjitej. Burri në katin e katërt vazhdoi t'i binte ziles me tërbim. Ashensori ndaloi. Raviku hapi me rrëmbim derën, përpara se atij poshtë t'i shkrehej të bënte ndonjë budallallëk e ta zbriste përsëri, me ata të dy brenda.

Xhoana ishte shtrirë mbi krevat. Ishte e veshur. Me një fustan mbrëmjeje të mbyllur gjer sipër në grykë. Mbi fustan dalloheshin njolla të argjendta gjaku. Gjak kishte edhe mbi dysheme. Atje kishte rënë në fillim. E pastaj ky idioti e kishte shtrirë mbi krevat.

– Rri e qetë! – i tha Raviku. – Rri e qetë! Të gjitha do të rregullohen. Nuk ka asgjë për t'u merakosur...

Ai e preu pjesën e përparme të fustanit dhe e tërhoqi me kujdes poshtë. Gjoksi nuk ishte prekur. Ishte qafa. Gurmazin nuk mund ta kishte zënë plumbi; ndryshe ajo s'do të kishte qenë në gjendje t'i telefononte. Damari nuk kishte pësuar gjë.

– Ke dhimbje? – e pyeti.

– Po.

– Shumë?

– Po...

– Do të të kalojë shpejt...

Ai përgatiti shiringën dhe pa sytë e Xhoanës.

– Mos u tremb. Vetëm një injeksion kundër dhimbjeve. Do të të pushojnë menjëherë.

Ai nguli gjilpërën në mish dhe pastaj e nxori.

– Ja, kaq ishte! – Pastaj iu kthye burrit: – Merrni në telefon numrin 27–41 në *Passi*. Porosisni një autoambulancë me dy bartës. Shpejt!

– Çfarë kam? – pyeti Xhoana me zë të mekur.

– *Passi, 27–41,* – përsëriti Raviku. – Shpejt, ju thashë! Merreni atë numër!

– Si është puna... Ravik?

– Asgjë me zarar. Por s'mund të të mjekojmë këtu. Duhet të të çojmë në një klinikë.

Ajo ia nguli sytë. Fytyrën e kishte të lyer e të zhgërryer, rimeli i kishte pikuar nga qerpikët dhe i kuqi i buzëve i ishte përhapur mbi njërën mollëz. Njëra pjesë e fytyrës dukej si ajo e një klouni të rëndomtë cirku, ndërsa tjetra, me ngjyrën e zezë përposh syrit, i ngjante asaj të një prostitute të kapitur e të konsumuar. Dhe sipër asaj fytyre ndriste kurora e artë e flokëve.

– Nuk dua të operohem, – pëshpëriti ajo.

– Do ta shohim. Ndoshta s'do të jetë nevoja fare për operacion.

– Mos më ka... – Ajo e preu fjalën.

– Jo, – tha Raviku. – Gjë pa rëndësi. Vetëm se instrumentet ndodhen në klinikë.

– Instrumentet...?

– Për kontroll... Tani do të të... S'ke për të pasur dhimbje...

Shiringa e bëri efektin e vet. Sytë e saj e humbën shprehjen e frikësuar të angushtisë, teksa Raviku iu përvesh një kontrolli të kujdesshëm.

Burri u kthye në dhomë.

– Autoambulanca është nisur për këtu.

– Tani kërkoni numrin 13–57 në *Otëj*. Është numri i një klinike. Do të flas unë me ta.

Burri u zhduk, i dëgjueshëm.

– Ti do të më ndihmosh, – belbëzoi Xhoana.

– Natyrisht.

– Nuk dua të kem dhimbje.

– Nuk do të kesh.

– Nuk mundem... Dhimbjet nuk i... – Atë po e kaplonte gjumi. Zëri po i këputej. – Nuk i...

Raviku pa me kujdes vendin ku kishte hyrë plumbi. Nuk ishin cenuar shumë enë gjaku. Por ai nuk po e gjente dot vendin e daljes së plumbit. Nuk tha gjë. Plagës i vuri një kompresë. Nuk bëri zë për atë, së cilës ia kishte frikën.

– Kush të shtriu në krevat? – e pyeti. – Vetë u...

– Ai...

– A ishe... a ishe në gjendje të ecje?

Vështrimi i përhumbur e i turbullt i syve të saj erdhi e u qartësua në çast; ishte përsëri një vështrim tërë ankth e frikë.

– Çfarë... më ka ndodhur?... Unë... jo. Nuk mund ta të bëja asnjë hap. Këmba... Çfarë kam, Ravik?

– Asgjë. E mora me mend. Të gjitha do të rregullohen.

Burri u dha përsëri në prag:

– Klinika...

Raviku rendi te telefoni.

– Kush flet? Ëzheni?... Më duhet një dhomë... Po... Dhe telefonojini menjëherë doktor Veberit! – Ai hodhi sytë nga dhoma e Xhoanës dhe uli zërin: – Përgatitini të gjitha! Do të na duhet t'i përvishemi punës menjëherë. Kam porositur një autoambulancë. Një aksident... Po... Ashtu është... Për dhjetë minuta...

Ai e mbylli telefonin dhe qëndroi një çast pa lëvizur. Tryeza. Një shishe me krem menteje, pije e pështirë. Gota. Cigare aromatike. Të vinte për të vjellë, si në një film limonadë. Mbi qilim një revolver. Gjak edhe këtu. Të gjitha këto s'janë të vërteta... Por pse them kështu – të vërteta janë!... Dhe tani iu kujtua edhe kush ishte ai burri që kishte ardhur për ta marrë. Kostumi me supet tepër të drejta, flokët

e lëpirë gjithë brilantinë dhe ajo aromë parfumi që e kishte acaruar gjatë udhëtimit; duart me unaza – ishte ai aktori, me kërcënimet e të cilit ishte tallur aq shumë dikur. Ka marrë nishan të mirë, mendoi Raviku. As që ka marrë nishan fare, mendoi pastaj. Kaq saktë mund të qëlloje vetëm po të mos kishe haber fare nga kjo punë dhe kur doje vetë që plumbi të të shkonte huq.

Raviku u kthye në dhomë. Burri ishte gjunjëzuar përpara krevatit. Gjunjëzuar – s'do mend; ndryshe nuk bëhej. Ai fliste, qahej, dërdëlliste, fjalët rrëkëlleheshin njëra pas tjetrës...

– Çohuni! – i tha Raviku.

Burri u ngrit, i bindur. Automatikisht shkundi pluhurin nga gjunjët e pantallonave. Raviku ia pa fytyrën. Lot! Edhe kjo mungonte!

– Pa dashje, zotëri! Ju betohem që s'desha ta qëlloja! Ndodhi fare pa dashje. Një rastësi e verbër, fatkeqe!

Ravikut iu përzien zorrët. Rastësi e verbër! Tani ky miku do të fillonte t'i fliste edhe me poezi...

– E di, e di. Zbrisni tani poshtë dhe prisni autoambulancën!

Burri u mat të thoshte diçka.

– Nisuni! – i tha Raviku. – Dhe mbajeni gati atë ashensorin e mallkuar! Një djall e di si do ta zbresim barelën deri poshtë.

– Ti do të më ndihmosh, Ravik, – tha Xhoana e përgjumur.

– Po, – tha ai, pa fijen e shpresës.

– Ti ndodhesh pranë meje. Jam gjithmonë e qetë, kur të kam pranë...

Fytyra e përlyer buzëqeshi.

– Bebi, e bëra pa dashje... – tha burri, tutje nga dera.

– Përjashta! – iu hakërrye Raviku. – Nisuni, ju mori djalli!

Xhoana ra një copë herë në qetësi. Pastaj i ngriti qepallat.

– Ai është një idiot, – tha ajo me zë çuditërisht të qartë. – Natyrisht që s'deshi të më qëllonte, i gjori viç... Deshi vetëm të shiste ca mend. – Një shprehje e veçantë ngazëllimi dinak u duk në sytë e saj. – As unë nuk e besoja kurrë... E kam ngacmuar vazhdimisht, kur më kanosej...

– Nuk bën të flasësh.

– E kam ngacmuar dhe nxehur. – Sytë e Xhoanës u ngushtuan. – E tillë jam unë, Ravik... Jeta ime... Nuk deshi të më qëllonte... më qëlloi... dhe...

Sytë iu mbyllën fare. Buzëqeshja iu shua. Raviku përgjoi në drejtim të derës.

*
* *

– Barelën s'kemi si e fusim në ashensor. Është tepër i ngushtë. Mund ta fusim vetëm pjerrtas në këmbë.

– I merrni dot kthesat e shkallëve?

Bartësi doli një herë në korridor.

– Ndoshta. Por duhet ta ngremë shumë lart. E mira është ta lidhim të sëmurën me rripa.

E lidhën. Xhoana dremiste. Nganjëherë rënkonte. Bartësit dolën nga apartamenti.

– A e keni çelësin? – e pyeti Raviku aktorin.

– Unë... jo... pse?

– Për të kyçur derën.

– Nuk kam. Por brenda duhet të ndodhet diku një çelës.

– Atëherë gjejeni dhe mbylleni apartamentin. – Bartësit po mundoheshin te kthesa e parë e shkallëve. – Merreni edhe revolverin me vete. Mund ta hidhni diku jashtë...

– Unë... unë... do të shkoj të dorëzohem në polici... A... a është e rrezikshme plaga?

– Po.

Burrit nisën t'i kullonin djersët. Aq shpejt i plasi uji nga poret, a thua se nën lëkurë nuk kishte gjë tjetër. Ai u kthye në apartament.

Raviku ndoqi dy burrat që mbanin barelën. Shkallët e godinës kishin një ndriçim elektrik që rrinte vetëm tri minuta ndezur e pastaj shuhej. Në çdo kat ndodhej një sustë për ta vënë përsëri në veprim ndriçimin. Bartësit i zbritën gjysmat e shkallëve pa ndonjë zor të madh. Kthesat ishin të vështira. Atyre u duhej ta ngrinin barelën lart mbi kokat e veta, për t'i marrë kthesat e shkallëve. Hijet e tyre dridheshin vigane nëpër mure. Ku kam parë diçka të ngjashme? Më ka ndodhur edhe një herë tjetër kështu, mendoi Raviku, i hutuar. Sakaq u kujtua: i kishte ndodhur me Raçinskin, atëherë, në fillim fare...

Dyer apartamentesh hapeshin, teksa bartësit i thërrisnin njëri–tjetrit dhe barela shkëpuste copëza suvaje nga muret. Fytyra kureshtare shfaqeshin pas dyerve gjysmë të hapura – pizhame, flokë të shpupurishur, fytyra të përgjumura, të buhavitura, robdëshambre purpuri, mavi, me lule e lajle...

Drita u shua përsëri. Bartësit hungëruan në errësirë dhe u ndalën në vend.

– Dritë!

Raviku kërkoi çelësin nëpër errësirë. Dora i zuri një gji të butë gruaje, në fytyrë e goditi duhma e një goje me dhëmbë të prishur dhe diçka iu ngatërrua nëpër këmbë. Drita flakëroi përsëri. Një grua me flokë të verdhë si kashtë e vështroi syzgurdulluar. Fytyrën e kishte tërë pala dhjami; kishte vënë një okë krem dhe me njërën dorë mbante kindin e një robdëshambri prej mëndafshi kinez tërë xhufka e tufka. Dukej si një bushtër bulldoge që e kishin futur në një shtrat me mbulesa dantellash.

– Ka vdekur? – pyeti ajo me sytë xixë.

– Jo. – Raviku vazhdoi rrugën. Diçka mjaulliti e turfulloi. Një mace kërceu mënjanë.

– Fifi!– Gruaja u përkul, me këmbët e majme të hapura anash. – O perëndi! Fifi!... Të shkelën, moj xhane?

Raviku zbriti shkallët. Përposh tij luhatej barela. Ai shikonte kokën e Xhoanës që lëvizte bashkë me lëvizjet e bartësve. Sytë nuk mund t'ia dallonte dot.

Kthesa e fundit e shkallëve. Drita u shua përsëri. Raviku u kthye me nxit nëpër shkallët e fundit për të gjetur çelësin. Në mes të errësirës u dëgjua atë çast një gumëzhitje nga lart dhe, i ndritshëm, a thua se vinte nga qielli, zbriti ashensori. Pas parmakëve të hekurt, të lyer me varak, qëndronte aktori. Ai rrëshqiti heshturazi dhe i pandalshëm tatëpjetë, duke kaluar përpara Ravikut dhe përpara barelës, si një vegim. E kishte gjetur ashensorin sipër, të hapur, dhe e kishte përdorur për t'i arritur ata sa më shpejt. Kjo ishte një punë me mend, por të ngjallte një përshtypje fantazmagorike dhe tmerrësisht qesharake.

*

* *

Raviku ngriti sytë. Të dridhurat i kaluan. Duart nuk i kishte më të dërsira përposh dorezave prej llastiku. Dy herë i kishte ndërruar dorezat.

Veberi i rrinte përkarshi.

– Po të doni, Ravik, thirreni Martonë. Për një çerek ore mund ta keni këtu. Le ta bëjë ai këtë operacion, ju asistoni.

– Jo. Është tepër vonë. Edhe unë s'do të isha në gjendje. S'do të mund të rrija e të bëja sehir.

Raviku e mbushi gjoksin me frymë. Tani e ndiente veten me të qetë dhe filloi nga puna. Lëkura. E bardhë. Një lëkurë si gjithë të tjerat,

tha me vete. Lëkura e Xhoanës. Si gjithë të tjerat.

Gjak. Gjaku i Xhoanës. Gjak si gjithë të tjerët. Tamponi. Muskuli i copëtuar. Tamponi. Kujdes! Më tutje! Një copë kumash i sermtë nga fustani i mbrëmjes. Fije. Më tutje! Kanali i plagës. Cifla plumbi. Më tutje! Kanali që zgjatej e zgjatej...

Raviku ndjeu një boshllëk të madh pas ballit. Drejtoi trupin me ngadalë.

– Shikojeni... vertebra e shtatë...

Veberi u përkul mbi plagën.

– Keq qenka puna.

– Ç'keq! Pa shpresë! S'mund të bëhet më asgjë.

Raviku vështroi duart e veta. Ato lëviznin nën dorezat prej llastiku. Ishin duar të forta, duar të afta; kishin operuar me mijëra herë dhe kishin qepur trupa të shkalafitur; shpesh herë ia kishin dalë mbarë, nganjëherë edhe s'ia kishin dalë; u kishte qëlluar të bënin edhe të pamundurën, duke shfrytëzuar të vetmin shans midis qindrave – por tani, tani që duhej të bënin diçka me çdo kusht, tani s'ishin të zonjat...

Ai s'mund të bënte asgjë. Askush s'mund të gjë. Këtu s'kishe ç'të operoje. Ai rrinte ngulur atje dhe vështronte i shastisur gropëzën e kuqe. Mund ta thërriste Martonë që të vinte. Por edhe Martoja po këtë gjë do të thoshte.

– S'mund të bëhet asgjë? – e pyeti Veberi.

– Asgjë... Ju e shikoni ku ka mbetur plumbi. S'kam as si ta heq.

– Pulsi po rreh shumë... Njëqind e tridhjetë! – tha Ëzhenia pas paravanit.

Plaga erdh e mori një hije më të murrme, a thua se i fryu një avull errësire përsipër. Raviku mori në dorë shiringën me kofeinë.

– Koraminë! Shpejt! Ndërpriteni narkozën! – Ai bëri injeksionin e dytë. – Po tani si duket?

– Njësoj.

Gjaku vazhdonte të kishte shkëlqimin e plumbtë.

– Bëni gati një injeksion adrenaline dhe bombolën me oksigjen!

Gjaku u err. Dukej sikur jashtë po mblidheshin retë dhe hidhnin hijet e tyre – sikur dikush po rrinte përpara dritareve dhe po mbyllte perdet.

– Gjak! – thirri Raviku me dëshpërim. – Na duhet t'i bëjmë transfuzion. Por nuk ia di grupin e gjakut... – Aparati i oksigjenit filloi të punonte përsëri. – Zero? Si duket? S'kemi gjë?

– Pulsi po bie. Njëqind e njëzet.

Jeta po kthehej sërishmi.

– Po tani? Më mirë?

– Njëlloj.

Raviku priti ca.

– Po tani? Më mirë?

– Më mirë. Më i rregullt.

Hijet u davaritën. Konturet e plagës e humbën zbehtësinë e tyre të frikshme. Gjaku u bë përsëri gjak. Aparati vazhdonte të punonte.

– Qepallat përpëliten, – tha Ëzhenia.

– S'ka gjë. Mund të zgjohet. – Raviku bëri bandazhin. – Si është pulsi tani?

– Më i rregullt.

– Për pak do të ishte tepër vonë, – tha Veberi.

Ravikut iu rënduan qepallat. E kishte nga djersa. Sumbulla të trasha djerse i binin mbi sy. Ai drejtoi trupin. Aparati zukaste.

– Vazhdoni t'i jepni edhe ca oksigjen.

Ai kaloi në anën tjetër të tryezës së operacionit dhe qëndroi atje. Nuk mendonte asgjë. Vështronte bombolën e oksigjenit dhe fytyrën e Xhoanës. Muskujt e asaj fytyre dridheshin. Jeta ishte akoma aty.

– Ja tek keni një provë gjaku, – i tha Veberi. – Duhet ta nisim. Ku mund të gjejmë gjak?

– Në Spitalin amerikan.

– Mirë. Le ta provojmë njëherë. Por nuk do të bëjë shumë dobi. Vetëm se do ta zgjasë pak. – Ai vështroi aparatin e oksigjenit. – A duhet të njoftohet policia?

– Po, – tha Veberi. – Duhej ta bëja atë punë. Do të vijnë me siguri dy nga ata dhe do të kërkojnë t'ju marrin në pyetje. A do t'ju pëlqente kjo gjë?

– Jo.

– Mirë. Mund ta bisedojmë edhe një herë në drekë këtë çështje.

– Mjaft, Ëzheni! – tha Raviku.

Tëmthat e Xhoanës kishin marrë përsëri pak ngjyrë. E bardha gri kishte tani një nuancë rozë. Pulsi rrihte rregullisht, dobët dhe qartë.

– Mund ta çojmë në dhomë. Unë do të rri këtu.

*

* *

Xhoana lëvizi. Njëra dorë i lëvizi. Dora e e djathtë. E majta jo.

– Ravik... – tha Xhoana.

– Po...

– Më operove?

– Jo, Xhoanë. Nuk ishte nevoja. Ta pastruam vetëm plagën.

– Do të rrish këtu?

– Po...

Ajo i mbylli sytë dhe ra përsëri në gjumë. Raviku doli te dera e dhomës.

– Sillmëni një kafe, – i tha infermieres së rojës.

– Kafe me panine?

– Jo. Vetëm kafe.

Ai u kthye në dhomë dhe hapi dritaren. Mëngjesi nderej i kthjellët dhe shkëlqimtar përmbi çatitë. Trumcakë çukitnin nëpër ulluqet e shiut. Raviku u ul te pezuli dhe ndezi një cigare. Tymin e nxirrte jashtë dritares.

Infermierja i solli kafenë. Ai e vuri filxhanin pranë vetes; pinte, tymoste dhe vështronte jashtë dritares. Kur e shkëpuste shikimin nga mëngjesi i ndritshëm, dhoma i dukej e errët. U ngrit nga ai vend dhe shkoi të shihte Xhoanën. Ajo po flinte. Fytyra, e larë dhe e pastruar, i dukej shumë e zbehtë. Buzët mezi i dalloheshin.

Ai mori tabakanë me filxhanin e kafesë dhe e nxori jashtë. E la mbi një tryezë në korridor. Jashtë binte erë dyll parketi dhe qelbi. Infermierja i kaloi përpara me një kovë bandazhesh të përdorura. Diku gumëzhinte një fshesë me korrent.

Xhoana filloi të tregonte shenja shqetësimi. Pas pak do të zgjohej prapë. Do të zgjohej me dhimbje. Dhe dhimbjet do t'i shtoheshin. Ajo do të mund të jetonte edhe disa orë ose edhe disa ditë. Dhimbjet do të arrinin atë shkallë, saqë s'do t'i bënte më dobi asnjë injeksion.

Raviku shkoi të merrte një shiringë dhe disa ampula. Kur u kthye, Xhoana hapi sytë. Ai e vështroi.

– Kam dhimbje koke, – belbëzoi ajo.

Ai priti. Ajo u përpoq të lëvizte kokën. Qepallat i kishte shumë të rënduara. Kokërdhokët mezi i luanin.

– Seç më rëndon si plumb... – Asaj i doli gjumi fare. – S'mund ta duroj më...

Ai ia bëri injeksionin.

– Tani do të bëhesh më mirë.

– Qëparë nuk më dhimbte kaq shumë... – Ajo lëvizi kokën. – Ravik, – pëshpëriti, – nuk dua të vuaj. Unë... Premtomë që s'do të më lësh të vuaj... Gjyshja ime... e kam parë... Nuk dua që edhe unë... Asaj

nuk i bëri dobi asgjë... premtomë...

– Ta premtoj, Xhoanë. Nuk do të kesh shumë dhimbje. Pothuajse aspak...

Ajo shtrëngoi dhëmbët.

– A do të më bëjë efekt tani shpejt?

– Po... pas disa minutash...

– Po krahu... çfarë më ka?

– Asgjë. S'e lëviz dot? Do ta lëvizësh pas pak.

– Po këmba... këmba e djathtë...?

Ajo u mundua ta ngrinte. Këmba nuk lëvizi.

– Është si puna e krahut, Xhoanë. Do të rregullohet.

Ajo lëvizi kokën me mundim.

– Sapo desha të filloja... një jetë të re... – pëshpëriti.

Raviku nuk i tha gjë. Kësaj nuk kishte çfarë t'i përgjigjeshe. Ndoshta ishte e vërtetë. Kush ishte ai që nuk donte të fillonte gjithmonë një jetë të re?

Ajo lëvizi përsëri kokën, me shqetësim, nga njëra anë në tjetrën. Zëri monoton e i mundimtë:

– Mirë që erdhe... Ç'do të bëja po të mos ishe ti?

– Po...

E njëjta gjë, mendoi ai, shpresëhumbur. E njëjta gjë. Cilido kirurg kasap do të kishte qenë i zoti për kaq gjë. Çdo hajvan. Dhe të vetmen herë që do të më hynin në punë dijet e mia, më shkoi kot gjithçka që kam mësuar! Çdo doktoruc do të dinte të bënte po kaq sa ç'bëra unë. Hiçgjë!

*

* *

Ajo e mori vesh në drekë. Ai nuk i pati thënë asgjë, por tani, ashtu përnjëherësh, ajo e kishte kuptuar.

– Nuk dua të mbetem uloke, Ravik... Ç'më kanë pësuar këmbët? Të dyja nuk mund t'i...

– S'ke pësuar asgjë. Kur të ngrihesh, do të ecësh përsëri si gjithmonë.

– Kur të ngrihem... Pse më gënjen? S'është nevoja të më gënjesh!

– Nuk të gënjej, Xhoanë.

– Po... Sepse je i detyruar! Vetëm mos më lër shtrirë në këtë hall... Mos më lër të mbetem e gozhduar pas shtratit... një shuk dhimbjesh e asgjë tjetër. Premtoma!

– Ta premtoj.

Scanned with CamScanner

– Po të bëhen të padurueshme dhimbjet, duhet të më japësh diçka. Gjyshja ime... ndenji pesë ditë shtrirë... duke ulëritur. Unë s'dua ta pësoj ashtu, Ravik.

– Nuk do ta pësosh ashtu. Do të kesh shumë pak dhimbje.

– Po të më zënë ashtu fort, duhet të më japësh një dozë të mjaftueshme. Të mjaftueshme përgjithmonë. Duhet ta bësh këtë për mua... Edhe sikur unë të mos dua ose të mos jem më në vete... Mbaje mend kë që të thashë tani!... Ma jep fjalën!

– Ta jap. Por nuk do të jetë nevoja.

Shprehja e frikës u zhduk nga fytyra e saj. Tani rrinte shtrirë atje, krejt e paqtë.

– Ty të lejohet ta bësh, Ravik, – pëshpëriti ajo, – sepse pa ty... unë s'do të isha më gjallë.

– Ç'janë këto marrëzira! Natyrisht që do të ishe gjallë...

– Jo, po të them! Atëherë, kur ti më takove për herë të parë... kur nuk dija nga t'ia mbaja... atëherë kisha vendosur... Ti ishe ai që ma dhurove këtë vit jetë... Ishte kohë e falur. – Me ngadalë ajo e ktheu kokën nga ai. – Pse nuk mbeta te ti?

– Ai ishte faji im, Xhoanë.

– Jo. Ishte... Nuk e di çfarë ishte...

Mesdita nderej e artë përpara dritares. Perdet ishin mbyllur, por drita depërtonte anash. Xhoanën e kishte kapluar dremitja e ilaçeve. Kishte mbetur shumë pak nga ajo që pati qenë dikur. Ato pak orë e kishin ngrënë si kafshime ujqërish. Dukej sikur trupi po i sheshohej nën mbulesën e shtratit. Qëndresa e tij po drobitej, po shkrihej. Ajo po lëkundej midis gjumit dhe zgjimit; herë ishte pothuajse fare pa ndjenja, herë krejt e kthjellët. Dhimbjet erdhën e iu shtuan. Filloi të rënkonte. Raviku i bëri një injeksion.

– Koka, – murmuriti ajo. – Po bëhem më keq.

Pas pak zuri të fliste përsëri:

– Drita... Ka shumë dritë... Më djegin sytë...

Raviku iu afrua dritares. Gjeti kordonin e grilës dhe e uli. Pastaj i tërhoqi perdet edhe më fort. Dhoma u errësua mjaft. Ai shkoi e iu ul pranë shtratit.

Xhoana lëvizi buzët:

– Sa shumë po vonon... Sikur s'po më bën më efekt injeksioni, Ravik.

– Duro edhe ca minuta.

Ajo ndenji e qetë. Duart i shtriheshin si të vdekura mbi kuvertë.

– Më duhet të të them... shumë gjëra...

Erjonixx

– Më vonë, Xhoanë.

– Jo... Tani... S'kam më kohë... Kam shumë... për të të shpjeguar...

– Më duket se më të shumtat i di, Xhoanë...

– I di?

– Më duket se po.

Valët. Raviku ishte në gjendje të dallonte se si valët e dhimbjeve therëse, të dridhurat e ngërçit, kalonin nëpër trupin e saj. Të dyja këmbët i qenë paralizuar tani. Edhe krahët gjithashtu. Gjoksi i ulej e ngrihej akoma.

– Ti, e di... që unë gjithmonë vetëm me ty...

– Po, Xhoanë...

– Të tjerat ishin vetëm... shqetësim...

– Po, e di...

Ajo s'bëri zë një copëherë. Merrte frymë me shumë zor.

– Çudi, – tha pastaj me zë fare të ulët. – Çudi... që njeriu mund të vdesë... kur dashuron...

Raviku u përkul mbi të. Ekzistonte vetëm errësira dhe fytyra e saj.

– Unë nuk të kam... merituar Ravik, – pëshpëriti ajo.

– Ti ke qenë jeta ime.

– Unë s'mundem... unë dua... Oh, duart e mia!... S'mund të të përqafoj... kurrë më...

Ai e pa se si po stërmundohej të ngrinte krahët.

– Ti je ndër krahët e mi, – i tha ai. – Dhe unë ndër të tutë.

Për një çast ajo nuk mori frymë fare. Sytë i dukeshin si dy njolla hijesh. Pastaj i hapi. Bebëzat i kishte jashtëzakonisht të mëdha. Raviku nuk po e kuptonte dot në e shihte ose jo.

– *Ti amo*, – i tha ajo.

Po i fliste në gjuhën e saj të fëmijërisë. Ishte tepër e kapitur për ta lodhur trurin me gjuhën tjetër. Raviku ia mori duart e pajeta ndër duart e veta. Diçka iu këput së brendshmi.

– Ti më ktheve sërish në jetë, Xhoanë, – i foli ai fytyrës me ato sytë e ngrirë. – Ti më bëre të jetoj rishtazi, mua, që isha kthyer në gur. Ti ma ktheve jetën përsëri...

– *Mi ami*?

Ishte pyetja e një foshnjeje që donte gjumë. Ishte e fundmja kapitje pas të gjitha lodhjeve.

– Xhoanë, – tha Raviku. – Fjala dashuri nuk mjafton për këtë ndjenjë. Nuk mjafton. Është vetëm një pjesë e vogël, vetëm një pikë uji në lumë, vetëm një gjethe mbi një pemë. Kurse kjo ndjenjë është aq, aq e madhe...

– *Sono stata... sempre con te...*

Raviku mbante shtrënguar duart e saj që nuk i ndienin më duart e tij.

– Po, ti ke qenë gjithmonë me mua, – i tha dhe nuk e kuptoi që tani po i fliste gjermanisht. – Ti ke qenë gjithmonë me mua... edhe kur të dashuroja, edhe kur të urreja, edhe kur rrëfehesha mospërfillës... Asgjë s'ka ndryshuar ndonjëherë. Ti ke qenë gjithmonë me mua dhe brenda meje...

Ata përherë kishin folur bashkë me një gjuhë të huajtur. Kurse tani, për herë të parë dhe pa e kuptuar as vetë, secili fliste në gjuhën e vet. Pengesat e fjalëve shembeshin dhe ata po merreshin vesh më mirë se kurrë.

– *Baciami...*

Ai i puthi ato buzë të zhuritura e të përthara.

– Ti ke qenë gjithmonë me mua, Xhoanë... gjithmonë...

– *Sono stata... perduta... senza di te...*

– Por unë e kam ndier veten më të braktisur pa ty... Ti ke qenë gjithë drita, gjithë ëmbëlsia dhe gjithë hidhërimi im... Më ke shkundur dhe më je falur dhe më ke falur. Më ke kthyer në jetë!

Xhoana mbeti disa minuta krejt e heshtur. Raviku e vërente. Gjymtyrët ishin të vdekura, të gjitha ishin të vdekura; vetëm sytë dhe goja dhe fryma jetonin akoma, dhe ai e dinte se muskujt e frymëmarrjes do të përfshiheshin tani ngadalë nga paraliza. Ajo pothuajse nuk mund të fliste më; po fillonte të gulçonte, dhëmbët i kërcisnin, tiparet po i shfytyroheshin, ajo po luftonte me vdekjen. Gryka i ishte mbërthyer nga ngërçi; u mundua të fliste edhe një herë, buzët i dridheshin. Regëtima. Regëtimë e thellë, e llahtarshme. Më në fund ulërima çau rrugë:

– Ravik, ndihmomë!... ndihmomë! Tani!... Tani!

Ai e pati përgatitur shiringën. E mori shpejt dhe ia nguli gjilpërën në mish. Ajo nuk duhej të vdiste ngadalë, mes torturash dhe duke u përpëlitur nga mungesa e frymës. Ajo nuk duhet të vuante kot së koti. Do të kishte vetëm dhimbje përpara. Vetëm dhimbje, që ndoshta do t'i zgjatnin edhe disa orë me radhë...

Qepallat iu drodhën në përpëlitje të shpeshta. Pastaj u qetësua. Buzët u çliruan nga shtrëngimi. Frymëmarrja pushoi.

Raviku tërhoqi perdet anash dhe ngriti grilën. Pastaj iu afrua përsëri shtratit. Fytyra e Xhoanës ishte e ngrirë dhe e huaj.

Ai mbylli derën dhe shkoi në zyrë. Ëzhenia rrinte përpara një tryeze dhe po merrej me kartelat e të sëmurëve.

– Pacientja në dhomën dymbëdhjetë vdiq, – tha ai.

Ëzhenia tundi kokën, pa ngritur sytë fare.

– Doktor Veberi në dhomë është?

Më duket se po.

Raviku eci përgjatë korridorit. Disa dyer ishin lënë hapur. Ai vazhdoi rrugën derisa arriti në dhomën e Veberit.

– Numri dymbëdhjetë vdiq, Veber. Mund t'i telefononi policisë.

Veberi seç po lexonte dhe nuk e ngriti kokën.

– Policia ka telashe të tjera tani.

– Ç'telashe?

Veberi i rrëfeu me kokë numrin e posaçëm të gazetës *Matën*. Trupat gjermane kishin hyrë në Poloni.

– Kam lajme drejtpërdrejt nga Ministria. Lufta do të shpallet qysh sot.

Raviku ia ktheu gazetën.

– Ja tek erdhi, Veber.

– Po. Ky është fundi. E gjora Francë!

Raviku u ul dhe ndenji një copë herë pa folur. Gjithçka ishte bosh.

– S'është halli vetëm te Franca, Veber. Është shumë më i madh, – tha pastaj.

Veberi ia nguli sytë.

– Për mua është te Franca. Dhe kjo mjafton.

Raviku nuk iu përgjigj.

– Po ju, çfarë keni ndër mend të bëni? – e pyeti pas pak.

– Nuk e di. Ka mundësi që të shkoj të paraqitem në regjimentin tim. Sa për këtë klinikën... – Ai bëri një lëvizje të papërcaktuar me dorë. – Dikush do të gjendet që ta marrë përsipër.

– Klinikën do ta mbani... Në luftë nevojiten spitalet. Kanë për t'ju lënë këtu.

– Nuk dua të qëndroj këtu.

Raviku vështroi përreth.

– Kjo do të jetë dita ime e fundit këtu. Besoj se çdo gjë është në rregull. Rasti i mitrës është në shërim e sipër; mëshikëza e tëmthit është në rregull tani; ai i kancerit s'ka shpresë, është e kotë t'i futemi një operacioni tjetër. Këto kishim.

– Pse? – pyeti Veberi me zë të lodhur. – Pse qenka kjo dita e fundit për ju?

– Sepse do të na arrestojnë, sapo të shpallet lufta. – Raviku e kuptoi që Veberi u mat të thoshte diçka.– T'i lemë diskutimet tani.

Është diçka e nevojshme dhe do ta bëjnë.

Veberi u ul në kolltukun e vet.

– Nuk di ç'të them më. Ndoshta. Por ndoshta edhe nuk do të luftohet fare. Mund ta dorëzojnë vendin kështu siç është. Nuk i dihet.

Raviku u ngrit.

– Në darkë do të dukem edhe njëherë këtej, në qofsha akoma në Paris. Aty nga ora tetë.

– Mirë.

Raviku iku. Në paradhomë gjeti aktorin. E kishte harruar krejt. Burri kërceu nga vendi.

– Si duket ajo?

– Vdiq.

Burri e vështroi syzgurdulluar.

– Vdiq? – Me një lëvizje tragjike, ai vuri dorën mbi zemër dhe u lëkund.

Komedian i mallkuar! tha Raviku me vete. Me sa dukej, ai do të kishte interpretuar ndonjëherë një skenë të ngjashme dhe tani, që e pësoi vetë, po i rikujtohej roli. Por ndoshta e kishte sinqerisht dhe gjestet e profesionit po ia shoqëronin në mënyrë qesharake pikëllimin e vërtetë.

– A mund ta shoh?

– Pse?

– Duhet ta shoh edhe njëherë! – Burri shtrëngoi të dyja duart pas gjoksit. Ndër duar mbante një kapelë ngjyrëkafe me bordura mëndafshi. – Kuptomëni pra! Duhet...

Ndër sy i vezullonin lot.

– Dëgjoni, – tha Raviku, që po e humbiste durimin. – Më mirë zhdukuni që këtej. Ajo ka vdekur dhe këtë ju nuk e ndryshoni dot më. Hallin tuaj rregullojeni me vetveten. Shkoni në djall! Askush s'ka për ta çarë kokën nëse do të hani një vit burg apo do të merrni pafajësinë në një seancë dramatike. Pas disa vjetësh, me siguri, keni për t'u mburrur me këtë ngjarje e keni për t'u shitur mend grave të tjera, që t'i shtini në dorë. Qërohuni që këtej, idiot!

Ai i dha një të shtyrë drejt derës. Burri ngurroi një çast. Te pragu u kthye edhe një herë:

– Kafshë pa ndjenja! Gjerman pis!

*
* *

Rrugët ishin plot e përplot me njerëz. Si vile rrushi rrinin shtrënguar njëri pas tjetrit përpara reklamave të ndritshme të gazetave dhe lexonin titujt e lajmeve me shkronja drite që ndërroheshin pa puslexonin titujt e lajmeve me shkronja drite që ndërroheshin pa pushim. Raviku shkoi deri te Kopshti *Luksemburg*. Donte të rrinte disa orë vetëm, përpara se ta arrestonin.

Kopshti ishte i braktisur. Ai shtrihej nën dritën e ngrohtë të diellit të asaj pasdrekeje të vonët vere. Pemët kishin parandjenjën e vjeshtës – jo të vjeshtës së venitjes, por të vjeshtës së pjekurisë. Drita ishte flori dhe kaltërsia një flamur i fundmë i mëndafshtë i verës.

Raviku ndenji gjatë aty. Pa se si ndërroi drita dhe se si hijet filluan të zgjateshin. E dinte: këto ishin orët e fundit që do t'i kalonte i lirë. Hotelierja e *Internacionalit* s'mund të fshihte më askënd, po të shpallej lufta. I shkoi mendja te Rolanda. Por as Rolanda s'mund ta ndihmonte dot. Askush. Të përpiqeshe për t'u arratisur në këtë situatë, do të thoshte të të arrestonin si spiun.

Ai qëndroi aty deri në mbrëmje. Nuk ishte i trishtuar. Fytyra i kalonin përpara sysh. Fytyra dhe vite. Dhe pastaj iu shfaq e fundmja, e ngrira fytyrë.

Në orën shtatë u ngrit për të ikur. La nga pas të fundmen çikëz paqe, atë park të madh që po e pushtonte mugëtira. Dhe këtë e dinte fort mirë. S'kishte bërë as disa hapa në rrugë, kur pa numrat e posaçëm të gazetave. Lufta ishte shpallur.

Hyri në një bar–bufe që s'kishte radio. Pastaj u kthye në klinikë. Veberi i doli përpara:

– A do mund të bëni edhe një "cezariane"? Sapo na e sollën njërën.

– Posi jo.

Ai shkoi të vishej. Në korridor takoi Ëzheninë. Ajo shtangu kur e pa.

– Nuk më prisnit më, me sa shoh? – e pyeti ai.

– Jo, – tha ajo dhe e vështroi në një mënyrë të çuditshme.

"Cezariania" ishte një punë e thjeshtë për Ravikun. Ai e bëri operacionin aq lehtë, sa të linte përshtypjen se nuk e kishte mendjen fare aty. Disa herë me radhë ndjeu vështrimin e Ëzhenisë mbi vete. Vrau mendjen ç'të kishte ajo me të.

Foshnja filloi të kuakte. I bënë një banjë. Raviku e vështroi atë fytyrë të kuqe që këlthiste dhe ata gishtërinj të veckël. Ne nuk lindkemi në këtë botë duke qeshur, mendoi ai. Ia dorëzoi foshnjën një

Erjonixx

infermiereje. Ishte djalë.

– Kushedi në ç'luftë do të hyjë në punë ky! – tha ai.

Shkoi të lante duart. Edhe Veberi po i lante në lavamanin tjetër.

– Në qoftë e vërtetë se do t'ju arrestojnë, Ravik, a do të më çoni lajm menjëherë ku ndodheni?

– Pse doni t'i hapni telashe vetes, Veber? Tani është më mirë të mos njihni njerëz të sojit tim.

– Pse? Sepse jeni gjerman? Ju jeni refugjat!

Raviku buzëqeshi hidhur.

– A nuk e dini që refugjatët janë gjithmonë si guri në mes gurëve? Për vendlindjen e tyre ata janë tradhtarë, kurse për shtetet e tjera mbeten akoma shtetas të vendlindjes së tyre.

– Kjo s'më intereson. Unë dua që të liroheni sa më shpejt që të jetë e mundur. Po deshët mund të thoni të më pyesin mua për ju.

– Meqë doni... – Raviku e dinte që nuk do ta bënte këtë.

– Për një mjek gjendet kudo punë.

Raviku fshiu duart.

– A do të më bëni një nder? Të kujdeseni për varrimin e Xhoanë Madusë? Mua s'do të më dalë më koha.

– Patjetër! Ka ndonjë gjë tjetër që duhet rregulluar në këtë mes? Punë trashëgimie apo...

– Këtë lërjani policisë. Nuk e di në ka pasur gjëkundi të afërm. Pastaj, kjo s'ka edhe aq fort rëndësi. – Ai u vesh. – Mbetshi me shëndet, Veber! Kemi kaluar mirë bashkë.

– Mbetshi me shëndet, Ravik! Kemi për të rregulluar akoma llogarinë e këtij operacioni të fundit.

– Mbajeni për varrimin. Ai patjetër që do të kushtojë më shumë. Dëshiroj t'ju lë edhe ça para.

– Në asnjë mënyrë, në asnjë mënyrë, Ravik! Ku dëshironi të varroset?

– Nuk e di. Në ndonjë varrezë. Po ju lë emrin dhe adresën e saj.

Raviku bëri ca shënime në një bllok llogarish të klinikës. Veberi e vuri fletën nën një hapës letrash, doreza e kristaltë e të cilit ishte zbukuruar me një shqerrkë prej sermi.

– Në rregull, Ravik. Besoj se edhe unë do të nisem pas disa ditësh. Edhe shumë operacione s'do të bënim dot këtu, tani që s'do të jeni më ju.

Ai e përcolli Ravikun.

– Mirëmbetshi, Ëzheni, – tha Raviku.

– Lamtumirë, zoti Ravik. – Ajo e vështroi. – Në hotel po shkoni?

Erjonixx

– Po. Pse?
– Jo, kot. Thashë se...

*
* *

Ishte errur. Përpara hotelit kishte qëndruar një kamion.
– Ravik! – i bëri zë Marozovi, strukur nën strehën e një porte aty afër.
– Boris! – Raviku ndali hapat.
– Te ne ka ardhur policia.
– E mora me mend.
– Kam me vete letërnjoftimin e Ivan Kluges. Të kujtohet? Të atij që vdiq. Skadon pas një viti e gjysmë. Eja me mua në *Sheherezade*. Atje i ndërrojmë fotografitë. Pastaj shko e gjej një hotel tjetër dhe që këtej e tutje nuk do të jesh më emigrant gjerman.

Raviku tundi kokën.

– Punë me shumë zarar, Boris. Në kohë lufte njeriu nuk duhet të mbajë dokumente të rreme. Më mirë të mos ketë fare.
– Po ç'do të bësh atëherë?
– Po shkoj në hotel.
– A e ke menduar mirë, Ravik? – e pyeti Marozovi.
– Po, shumë mirë.
– Ta marrë djalli, ta marrë! Kushedi ku do të të rrasin!
– Sidoqoftë nuk do të më nisin e të më dorëzojnë në Gjermani. Kjo nuk bëhet më tani. Dhe as nuk do të më nxjerrin në kufirin e Zvicrës. – Raviku vuri buzën në gaz. – Kjo do të jetë hera e parë gjatë këtyre pesë vjetëve që policia do të kërkojë të na mbajë këtu, Boris. U desh të shpallej lufta që t'ia arrinim kësaj dite.
– Flitet se në Longshan po ngrenë një kamp përqendrimi. – Marozovi filloi të ndukte qimet e mjekrës. – Prandaj u arratise nga një kamp përqendrimi gjerman ti... që të të futin tani në një francez!
– Ndoshta na lirojnë shpejt.

Marozovi nuk iu përgjigj.

– Boris, – i tha Raviku. – Mos u bëj merak për mua. Mjekëve ua kanë nevojën në luftë.
– Me ç'emër do të arrestohesh këtë radhë?
– Me emrin tim të vërtetë. Atë e kam përdorur këtu vetëm një-herë, përpara pesë vjetësh. – Raviku heshti një copë herë. – Boris, – tha pastaj. – Xhoana vdiq. E vrau një mashkull. Ndodhet akoma në klinikën e Veberit. Duhet varrosur. Veberi më premtoi se do ta kryente

Erjonixx

këtë punë, por nuk i dihet, ndoshta e mobilizojnë menjëherë. A do të kujdesesh ti për Xhoanën? Mos më pyet asgjë, thuaj po, dhe pikë.

– Po, – tha Marozovi.

– Në rregull. Mirëmbetsh, Boris! Merr nga plaçkat e mia ato që mund të të hyjnë në punë. Ndërroje dhomën me timen. Gjithmonë e ke pasur qejf banjën time. Po shkoj tani. Mirëmbetsh!

– Punë muti! – tha Marozovi.

– Mirë. Pas lufte takohemi te *Fukeja*.

– Nga ç'anë? Nga *Shanz–Elizeja*, apo nga shëtitorja *Zhorzh V?*

– Nga *Zhorzh V.* Ç'idiotë që jemi ne të dy! Idiotë qurravecë heroikë. Mirëmbetsh, Boris!

– Punë muti! – tha Marozovi. – Nuk guxojmë as të ndahemi siç është për t'u ndarë. Afrohu këtu, idiot!

Ai e puthi Ravikun pllaq–plluq në të dyja faqet. Raviku ndjeu qimet e ashpra të mjekrës dhe erën e duhanit të llullës. Nuk ishte fort e këndshme. Ai u drejtua nga hoteli...

*

* *

Emigrantët po qëndronin në këmbë në *Katakombë*. Si të krishterët e parë, mendoi Raviku. Evropianët e parë. Një i policisë, veshur civil, rrinte përpara një tryeze nën palmën artificiale dhe merrte shënim të dhënat. Dy policë ruanin dyert, nga të cilat askush nuk kishte ndër mend të arratisej.

– Pasaportë? – e pyeti punonjësi i policisë Ravikun.

– S'kam.

– Dokumente të tjera?

– S'kam.

– Ilegalisht jetoni këtu?

– Po.

– Pse?

– Jam arratisur nga Gjermania. S'kisha mundësi të merrja dokumente.

– Mbiemri?

– Frezenburg.

– Emri?

– Ludvig.

– Çifut?

– Jo.

– Profesioni?

– Mjek.

Burri shënonte.

– Mjek? – ia bëri sakaq dhe ngriti një pusullë nga tryeza. – Mos njihni një mjek që quhet Ravik?

– Jo.

– Duhet të banojë këtu. Kemi një denoncim.

Raviku ia qepi sytë. Ëzhenia! i shkoi në mendje. Ajo e kishte pyetur në do të kthehej në hotel dhe qe treguar aq e habitur, kur e kishte parë akoma të lirë.

– Sikur ju thashë njëherë që këtu nuk banon asnjeri me këtë emër! – ia bëri hotelierja që rrinte me kurrizin mbështetur pas derës së kuzhinës.

– Ju pushoni! – ia priti ai i policisë turivarur. – Mos t'ju gënjejë mendja se do të dilni pa lagur. I keni strehuar këta njerëz pa i regjistruar fare.

– Për këtë jam krenare. Në qoftë se u dënoka njerëzillëku, o burrani, bëni ç'keni për të bërë!

Njeriu i policisë u mat t'i jepte një përgjigje; por siç duket u pendua dhe e mbylli muhabetin vetëm me një lëvizje dore. Hotelierja vazhdonte të zhbironte me sy, si një njeri që kërkonte sherr medoemos. Ajo i kishte shpatullat të ngrohta dhe s'ia bënte syri tërr fare.

– Bëni gati plaçkat, – i tha ai i policisë Ravikut. – Merrni ndërresa dhe ushqim për një ditë. Edhe një batanije, po të keni.

Një polic e shoqëroi deri lart. Dyert e shumë dhomave qenë hapur. Raviku mori valixhen, që e kishte bërë gati qyshkur; pastaj mori edhe kuvertën e vet.

– S'keni gjë tjetër? – e pyeti polici.

– S'kam gjë tjetër.

– Po këto do t'i lini këtu.

– Këto do t'i lë këtu.

– Edhe këtë? – Polici rrëfeu me dorë tryezën pranë shtratit, mbi të cilën ndodhej Shën Mëria e vogël prej druri, që ia pati dërguar Xhoana në fillim fare.

– Edhe këtë.

Ata zbritën përsëri poshtë. Klarisa, kamerierja nga Alzasa, i dha Ravikut një pako. Raviku vuri re se edhe të tjerët kishin pako të tilla nëpër duar.

– Diçka për të ngrënë, – tha hotelierja. – Që të mos ngordhni për bukë. Jam e sigurt se atje ku do të shkoni, s'do të gjeni asgjë gati! –

Ajo ia nguli sytë përsëri atij të policisë, që ishte veshur civil.

– Mos llapni kaq shumë, – i tha ky me inat.– Nuk e shpalla unë luftën!

– As këta nuk e kanë shpallur!

– Lërmëni rehat! – Ai vështroi policin. – Gati? Nxirrini të gjithë jashtë!

Grumbulli i errët u vu në lëvizje. Ravikut i zunë sytë atë burrin me atë gruan që kishte parë kacabunjtë. Burri e mbante gruan në njërin krah. Nën tjetrin kishte një valixhe të vogël; një valixhe të dytë e mbante në dorë. Edhe i biri po tërhiqte një valixhe. Burri e vështroi Ravikun me sy lutës. Raviku i bëri një shenjë me krye.

– Kam marrë me vete instrumente dhe ilaçe, – i tha. – Mos u bëni merak.

Ata hipën mbi kamion. Motori u ndez me rrapëllimë. Makina u ndez. Hotelierja qëndronte te pragu i portës dhe ua bënte me dorë.

– Ku po shkojmë? – e pyeti dikush njërin nga policët.

– Nuk e di.

Raviku rrinte midis Rozenfeldit dhe Aron Goldbergut të rremë. Rozenfeldi shtrëngonte një tub të gjatë kartoni nën sqetull. Në të kishte futur kuadrot e Sezanit dhe të Gogenit. Muskujt e fytyrës i dridheshin nga inati.

– Viza spanjolle... – tha ai. – Më skadoi, përpara se të... – ai e preu fjalën në mes. – Kukuvajka ia mbathi, – shtoi pastaj. – Markus Mejeri. U nis dje për në Amerikë.

Kamioni tundej shumë. Të gjithë rrinin ngjeshur pas njëri–tjetrit. Pothuajse askush nuk fliste. Makina mori një kthesë. Raviku pikasi fatalistin Zajdenbaum. Ai qe strukur thellë në një qoshe.

– Ja tek u mblodhëm përsëri, – tha Zejdenbaumi.

Raviku rrëmoi nëpër xhepa se mos gjente ndonjë cigare. Nuk gjeti. Por iu kujtua se kishte futur mjaft paketa në valixhe.

– Po, – tha ai. – Njeriu është i fortë, duron shumë.

Kamioni kaloi nëpër shëtitoren *Vagram* dhe mori për në Sheshin e Yllit. Asgjëkundi nuk dukej qoftë edhe një dritë. Sheshi ishte i shkretuar dhe i kredhur në errësirë të plotë. Aq e thellë ishte errësira, saqë as Harku i Triumfit nuk dallohej më.